

المُسْتَقْبَلُ

مِنْ

مُسَوِّعَاتِ الْأَحْزَانِ بِالنَّبَوِيَّةِ

اللغة الألبانية

إعداد القسم العلمي

جمعية خدمة المحتوى
الإسلامي باللغات



جمعية الدعوة
وتوعية الجاليات بالربوة



شركاء التنفيذ:



المحتوى الإسلامي



رواد الترجمة



جمعية الربوة



دار الإسلام

يتاح طباعة هذا الإصدار ونشره بأي وسيلة مع
الالتزام بالإشارة إلى المصدر وعدم التغيير في النص.



Tel: +966 50 244 7000



info@islamiccontent.org



Riyadh 13245- 2836



www.islamhouse.com

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Parathënie

Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve. Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë, Muhamedin, familjen e mbarë shokët e tij dhe mbi gjithë ata që i ndjekin në besim dhe në punë të mira deri në Ditën e Llogarisë.

Gjëja më madhështore që duhet t'i kushtojë rëndësi muslimani për lexim, përsiatje, meditim, dije dhe veprim, - pas Librit të Allahut, - është Suneti - hadithi i të Dërguarit të Allahut ﷺ. Profeti ﷺ ka thënë: "O ju njerëz! Ju kam lënë në mesin tuaj ato gjëra që, nëse kapeni për to, kursesi nuk do të devijoni: Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij!" E shënon Imam Maliku. Allahu i Lartësuar thotë: "Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj." (El Hashër, 7) Andaj, "Shoqata për Shërbimin e Përmbytjes Islame në Gjuhë të Ndryshme" dhe "Shoqata për Thirrje dhe Ndërgjegjësim të Komuniteteve", në Rabva, u përkujdesën për të përgatitur një enciklopedi të haditheve të Profetit dhe për t'i përkthyer ato në gjuhë të ndryshme.

Allahu i Lartmadhëruar e ka lehtësuar përzgjedhjen e një pjese të kësaj enciklopedie, për të cilën muslimani ka nevojë në çështjet e fesë dhe të kësaj bote, duke i shpjeguar shkurtimisht, duke i sqaruar kuptimet e tyre, duke sjellë disa dobi dhe duke i vendosur në këtë libër, i cili titullohet: "Përzgjedhje nga Enciklopedia e Haditheve Profetike", Po punohet për përkthimin e tyre në të gjitha gjuhët ekzistuese të botës, që dobia e përmbytjes së tyre të përhapet gjithandej dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ t'i arrijë njerëzimit në gjuhët e tyre.

E lusim Allahun ta pranojë këtë vepër dhe ta bëjë të begatë, të sinqertë për hir të Tij, si dhe t'i shpërblejë të gjithë ata që ndihmuan në përgatitjen, përkthimin dhe shpërndarjen e saj! Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë Muhamed!

(1) - عن عمر بن الخطاب رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّةِ، وَإِنَّمَا لِأَمْرِي مَا نَوَى، فَمَنْ كَانَتْ هِجْرَتُهُ إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ، فَهَاجَرَتْهُ إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ، وَمَنْ كَانَتْ هِجْرَتُهُ لِدُنْيَا يُصِيبُهَا أَوْ امْرَأَةٍ يَتَزَوَّجُهَا، فَهَاجَرَتْهُ إِلَى مَا هَاجَرَ إِلَيْهِ».

وفي لفظ للبخاري: «إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ، وَإِنَّمَا لِكُلِّ أَمْرٍ مَا نَوَى». [صحيح] - [متفق عليه]

(1) – Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Veprat vlerësohen sipas nijetit dhe njeriut i takon ajo që e ka bërë nijet. Andaj, atij që ka bërë hixhret për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i vlerësohet si hixhret për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ndërkaq, nëse ka bërë hixhret me qëllim të arritjes së të mirave të dynjasë ose që të martohet me ndonjë grua, hixhreti i tij do të vlerësohet sipas nijetit të tij.” Ndërkaq, në një version të Buhariut, qëndron: "Veprat vlerësohen sipas nijeteve dhe njeriut i takon ajo që e ka bërë nijet." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron se të gjitha veprat llogariten me nijet. Ky vendim është i përgjithshëm për të gjitha adhurimet dhe transaksionet. Kushdo që me veprën e tij synon ndonjë dobi, nuk do të marrë asgjë tjetër përveç asaj dobie dhe nuk do të shpërblehet për të. Ndërkaq, kushdo që me veprën e tij synon t'i afrohet Allahut të Lartësuar, do

ta marrë shpërblimin për veprën e tij, edhe nëse është vepër e zakonshme, siç janë ngrënia e pirja.

Pastaj Profeti ﷺ solli një shembull për të treguar ndikimin e nijetit në vepra, pavarësisht se ajo është e njëjtë në formën e dukshme. Kështu, ai sqaroi se, kushdo që ka për qëllim me hixhretin (shpërnguljen) e largimin nga vendlindja kënaqësinë e Zotit të vet, atëherë hixhreti i tij është hixhret sheriatik dhe i pranuar, për të cilin shpërblehet, për shkak të sinqeritetit të tij. Ndërkaq, kushdo që me hixhretin e tij synon ndonjë dobi të kësaj bote, si: para, pozitë, tregti ose grua, i tilli nuk do të përfitojë nga hixhreti i tij gjë, përveçse atë dobi që ka pasur për qëllim dhe nuk do të ketë hise nga shpërblimi.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të qenë të sinqertë, sepse Allahu e pranon vetëm atë vepër që bëhet për hir të Tij.
2. Veprat me të cilat njeriu afrohet tek Allahu i Plotfuqishëm, nëse personi i ngarkuar me obligime fetare i bën ato në aspektin e zakonit, atëherë nuk ka shpërblim, derisa të synojë me anë të tyre që të afrohet me Allahun.

(4560)

(2) - عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ أَحَدَّثَ فِي أَمْرِنَا هَذَا مَا لَيْسَ فِيهِ فَهُوَ رَدٌّ» متفق عليه.
ولمسلم: «مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ». [صحيح] - [متفق عليه]

(2) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atij që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është e saj, i refuzohet." (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi) Në motërzimin e Muslimit qëndron: "Atij që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, i refuzohet." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se kushdo që shpik në fe ose bën diçka për të cilën nuk ka argument nga Kurani dhe Suneti, ajo do t'i refuzohet vepruesit të saj dhe do të jetë e papranueshme tek Allahu.

Mësime nga hadithi:

1. Adhurimet duhet të bazohen në atë që ndodhet në Kuran dhe në Sunet, kështu që e adhurojmë Allahun e Lartësuar vetëm sipas asaj që e ka ligjësuar, e jo me bidate dhe shpikje.
2. Feja nuk bazohet në hamendësime dhe në gjërat që i shohim si të mira, por në ndjekje të të Dërguarit ﷺ.
3. Ky hadith është argument se feja është e përsosur.

4. Bidat është gjithçka që është futur në fe dhe nuk ka qenë e pranishme gjatë kohës së Profetit ﷺ dhe shokëve të tij, qoftë besim e fjalë, qoftë veprim.
5. Ky hadith është një nga bazat e Islamit dhe është si peshore për veprimet. Ashtu si çdo veprim, me të cilin nuk synohet kënaqësia e Allahut, që nuk ka shpërblim për atë që e kryen atë, po ashtu çdo veprim që nuk është në përputhje me atë që e solli i Dërguari i Allahut ﷺ, i refuzohet atij që e vepron.
6. Shpikje të ndaluara janë ato që ndërliohen me çështjet e fesë, e jo të kësaj bote.

(4792)

(3) - عن عمر بن الخطاب رضي الله عنه قال: بَيْنَمَا نَحْنُ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ذَاتَ يَوْمٍ إِذْ طَلَعَ عَلَيْنَا رَجُلٌ شَدِيدُ بَيَاضِ الثِّيَابِ، شَدِيدُ سَوَادِ الشَّعْرِ، لَا يُرَى عَلَيْهِ أَثَرُ السَّفَرِ، وَلَا يَعْرِفُهُ مِنَّا أَحَدٌ، حَتَّى جَلَسَ إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَأَسْنَدَ رُكْبَتَيْهِ إِلَى رُكْبَتَيْهِ، وَوَضَعَ كَفَّيْهِ عَلَى فَخْذَيْهِ، وَقَالَ: يَا مُحَمَّدُ، أَخْبِرْنِي عَنِ الْإِسْلَامِ، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «الْإِسْلَامُ أَنْ تَشْهَدَ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَتَقِيمَ الصَّلَاةَ، وَتُؤْتِيَ الزَّكَاةَ، وَتَصُومَ رَمَضَانَ، وَتَحُجَّ الْبَيْتَ إِنْ اسْتَطَعْتَ إِلَيْهِ سَبِيلًا» قَالَ: صَدَقْتَ، قَالَ: فَعَجِبْنَا لَهُ، يَسْأَلُهُ وَيُصَدِّقُهُ، قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ الْإِيمَانِ، قَالَ: «أَنْ تُؤْمِنَ بِاللَّهِ، وَمَلَائِكَتِهِ، وَكُتُبِهِ، وَرُسُلِهِ، وَالْيَوْمِ الْآخِرِ، وَتُؤْمِنَ بِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ» قَالَ: صَدَقْتَ، قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ الْإِحْسَانِ، قَالَ: «أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ، فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ» قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ السَّاعَةِ، قَالَ: «مَا الْمَسْئُولُ عَنْهَا بِأَعْلَمَ مِنَ السَّائِلِ» قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنْ أَمَارَتِهَا، قَالَ: «أَنْ تَلِدَ

الْأَمَّةُ رَبَّتْهَا، وَأَنْ تَرَى الْحَفَاةَ الْعُرَاةَ الْعَالَةَ رِعَاءَ الشَّاءِ يَتَطَاوُلُونَ فِي الْبُنْيَانِ» قَالَ: ثُمَّ
انْطَلَقَ، فَلَبِثْتُ مَلِيًّا ثُمَّ قَالَ لِي: «يَا عَمْرُ، أَتَدْرِي مَنِ السَّائِلُ؟» قُلْتُ: اللَّهُ وَرَسُولُهُ
أَعْلَمُ، قَالَ: «فَإِنَّهُ جَبْرِيلُ، أَتَاكُمْ يُعَلِّمُكُمْ دِينَكُمْ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(3) – Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Një ditë, ndërsa rrinim ulur tek i Dërguari i Allahut ﷺ, u shfaq një njeri fort rrobëbardhë e tejet flokëzi, tek i cili nuk vëreheshin shenja udhëtimi. Atë nuk e njihte asnjëri prej nesh. U ul pranë Profetit ﷺ duke i vendosur gjunjët e tij afër gjunjëve të të Dërguarit e duke i vënë shuplakat e duarve të tij mbi kofshët e veta, e në atë rast pyeti: “O Muhamed, më trego për Islamin.” I Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Islami është të dëshmosh se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhillëkun (këtë të fundit) po pate mundësi.” Ai i tha: “Ashtu është.” Ne u çuditëm, sepse vetë e pyeste, vetë ia vërtetonte! Ai tha: “Më trego për besimin (imanin).” I Dërguari tha: “Besimi është të besosh në Allahun, në melekët, në librat e Tij, në të dërguarit, në Ditën e Fundit dhe të besosh në paracaktimin (kaderin), qoftë i mirë, qoftë i keq.” Ai i tha: “Ashtu është.” Më trego për ihsanin (përsosurinë e adhurimit).” I Dërguari tha: “Ta adhurosh Allahun sikurse të jesh duke e parë Atë. Edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai gjithsesi të sheh ty.” Ai i tha: “Më trego për Kiametin.” I Dërguari tha: “Në lidhje me këtë i pyeturi nuk di më shumë sesa pyetësi.” Ai i tha: “Atëherë, tregomë për shenjat e tij.” I Dërguari tha: “(Kiameti vjen) kur robëresha

ta lindë zonjën e saj dhe kur t'i shohësh këmbëzbathurit, të zhveshurit, fukarenjtë e barinjtë e deleve duke garuar për të bërë ndërtesa sa më të larta.” Pastaj, ai u largua, kurse ne qëndruam për një kohë. Më pas, i Dërguari më tha: “O Omer, a e di kush është ai që pyeste.” Unë thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai tha: “Ai që Xhibrili dhe erdhi për t’jua mësuar fenë.” [Ky hadith është sahih]

- [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Omer ibën Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na tregon se Xhibrili (alejhi selam) u shfaq para sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) në formën e një njeriu që nuk njihej. Karakteristikë e tij ishte se rrobat i kishte fort të bardha dhe ishte tejet flokëzi, tek i cili nuk vëreheshin shenja udhëtimi, fjala vjen, të shfaqej lodhja, pluhuri, flokët e ndarë dhe rrobat e pista. Askush nga të pranishmit nuk e njohu. Sahabët ishin ulur me Profetin ﷺ, kështu që ai u ul para Profetit ﷺ në atë mënyrë si ulet nxënësi dhe e pyeti për Islamin dhe kësisoj Profeti ﷺ u përgjigj me këto shtylla që përfshijnë pranimin e dy dëshmimeve, faljen e pesë namazeve ditore në vazhdimësi, dhënien e zekatit atyre që e meritojnë, agjërimin e muajit Ramazan dhe kryerjen e haxhillëkut për atë që ka mundësi.

Pyetësi tha: "Ashtu është." Kështu, sahabët u befasuan nga pyetja e Xhibrilit (alejhi selam), që tregonte në pamje të jashtme se ai nuk e dinte atë, e pastaj ai e miratoi vetë përgjigjen e Profetit.

Xhibrili (alejhi salam) pastaj e pyeti për besimin dhe ai iu përgjigj me këto gjashtë shtylla, të cilat përfshinin besimin rreth ekzistimit të Allahut të Lartësuar dhe cilësive të Tij, si dhe veçimin e Tij me veprat e Veta, bie fjala, krijimi, si dhe veçimin e Tij me adhurim. Githashtu besimin se melekët, që krijoi Allahu, janë robër të nderuar që nuk e kundërshtojnë Allahun e Lartësuar dhe me urdhrin e Tij ata punojnë. Besimin në librat që u janë shpallur të dërguarve nga Allahu i Lartësuar, si: Kurani, Tevrati, Inxhili e të tjerë. Besimin në të Dërguarit, të cilët e kumtojnë nga Allahu fenë e Tij. Prej tyre janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe i fundit prej tyre është Muhamedi ﷺ dhe profetët e të dërguarit e tjerë. Besimin në Ditën e Fundit dhe gjërat që vijnë pas vdekjes, si: varri e jeta në varreza dhe se njeriu do të ringjallet pas vdekjes dhe do të merret në llogari, si dhe fundi i tij do të jetë ose në Xhenet, ose në Zjarr. Besimin se Allahu i paracaktoi gjërat sipas dijes së Tij si dhe ndodhën sipas urtësisë, shkrimit e vullnetit të Tij. Ato ndodhën mu ashtu siç i përcaktoi dhe i krijoi Allahu. Pastaj e pyeti për ihsanin (përsosurinë e adhurimit), kështu që i tregoi se ihsani është: "Ta adhurosh Allahun sikurse të jesh duke e parë Atë." Nëse nuk mund ta realizojë të arrijë deri te kjo pozitë, atëherë: "Ta adhurojë Allahu e Lartësuar sikur ta shohë Allahu atë." Shkalla e parë është: adhurimi i Allahut sikur je duke e parë, kjo është shkalla më e lartë, ndërsa e dyta është shkalla e vëzhgimit (ndjenjës se Allahu të vëzhgon).

Më pas e pyeti për Kiametin se kur do të ndodhë e Profeti ﷺ sqaroi se dijen rreth Kiametit e ka mbajtur Allahu

të fshehtë në dijen e Tij, kështu që askush përveç Tij nuk e di, rrjedhimisht as i pyeturi e as pyetësi.

Më pas e pyeti për shenjat e Kiametit e pastaj sqaroi se ndër shenjat e Kiametit është se do të shtohen robëreshat dhe fëmijët e tyre, ose do të shtohet mosrespektimi i nënave nga ana e fëmijëve duke i trajtuar si robëresha. Gjithashtu, barinjve të deleve dhe të varfërve do t'u hapet kjo botë në fundin e botës, kështu që do të mburren ndaj njëri-tjetrit rreth zbukurimit dhe ndërtimit të ndërtesave (të larta).

Pastaj Profeti ﷺ tregoi se pyetësi ishte Xhibrili (alejhi selam) i cili erdhi për t'ua mësuar sahabëve këtë fe besimdrejtë.

Mësime nga hadithi:

1. Karakteri i mirë i Profetit ﷺ, i cili ulej me shokët e tij e ata uleshin me të.
2. Butësia ndaj pyetësit dhe afrimi i tij është e ligjshme, në mënyrë që ai ta bëjë pyetjen pa kufizim dhe pa frikë.
3. Mirësjellja me mësuesin, ashtu siç bëri Xhibrili (alejhi selem) kur u ul para Profetit ﷺ, me një ulje të një njeriu të sjellshëm, që të marrë prej tij dije.
4. Shtyllat e Islamit janë pesë, kurse bazat e besimit janë gjashtë.
5. Kur Islami dhe besimi bashkohen, Islami shpjegohet me çështje të dukshme (të gjymtyrëve), kurse besimi me çështje të brendshme (të zemrës).

6. Sqarimi se feja ka shkallë të ndryshme. Shkalla e parë: islami, e dyta: imani (besimi), dhe e treta: ihsani (përsosuria e adhurimit), e cila është më e larta.
7. Pyetësi, në esencë, nuk ka njohuri rreth pyetjes dhe mosdija është shtytësi për ta parashtruar pyetjen, prandaj sahabët u çuditën se si (vetë) bënte pyetje dhe (vetë) e vërtetonte (përgjigjen).
8. Fillimi me gjërat më të rëndësishme, sepse në shpjegimin e Islamit u fillua me dy dëshmitë (shehadetin) dhe në shpjegimin e besimit u fillua me besimin në Allahun e Lartësuar.
9. Shtrimi i pyetjes dijetarëve nga ai që e di përgjigjen, me qëllim që t'i mësojë të tjerët.
10. Dija se kur do të ndodhë Kiameti është dije që Allahu e ka ruajtur për Vete.

(4563)

(4) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «بُيِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ: شَهَادَةٌ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، وَإِقَامُ الصَّلَاةِ، وَإِيتَاءُ الزَّكَاةِ، وَحَجُّ الْبَيْتِ، وَصَوْمُ رَمَضَانَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(4) – Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Mbi dëshminë se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi ﷺ është i Dërguari

i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, kryerjen e haxhit dhe agjërimin e Ramazanit.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Në këtë hadith, Profeti ﷺ e krahasoi Islamin me një ndërtesë të fortë, e cila i ka pesë shtyllat që e bartin atë, si dhe pjesa tjetër e karakteristikave të Islamit janë si plotësim i kësaj ndërtese. E para nga këto shtylla janë dy dëshmitë: dëshmia se s'ka të adhurar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Këto dyja konsiderohen një shtyllë: janë të pandashme nga njëra-tjetra. Robi i shqipton, duke e pranuar të qenët e Allahut Një dhe se Ai është meritë të adhurohet, e askush pos Tij nuk e meriton këtë gjë, si dhe duke vepruar sipas kërkesave të tyre, duke besuar në mesazhin e Muhamedit ﷺ dhe duke e ndjekur atë. Shtylla e dytë: falja e namazit. Janë pesë namaze farz (të detyrueshme) gjatë ditës e natës: sabahu, dreka, ikindia, akshami dhe jacia, të cilat duhet të falen sipas kushteve, shtyllave dhe obligimeve të tyre. Shtylla e tretë: dhënia e zekatit të detyrueshëm. Ai është një adhurim i detyrueshëm financiar për çdo pasuri që arrin një shumë të caktuar sipas ligjit islam, e cila u jepet atyre që e meritojnë. Shtylla e katërt: haxhillëku. Ai nënkupton shkuarjen në Mekë për t'i kryer ritualet e haxhillëkut, si shenjë adhurimi ndaj Allahut të Lartësuar. Shtylla e pestë: agjërimi i Ramazanit. Ai nënkupton largimin nga ngrënia, pija dhe gjërat e tjera që prishin agjërimin, me qëllim të adhurimit ndaj Allahut, nga agimi deri në perëndim të Diellit.

Mësime nga hadithi:

1. Dy dëshmitë janë të pandashme nga njëra-tjetra, kështu që nuk saktësohet njëra pa tjetrën, prandaj i llogariti si një shtyllë e vetme.
2. Dy dëshmitë janë themeli i fesë dhe asnjë fjalë e vepër nuk është e pranueshme pa ato.

(65000)

(5) - عَنْ مُعَاذٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: كُنْتُ رَدَفَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَى حِمَارٍ يُقَالُ لَهُ عَقِيرٌ، فَقَالَ: «يَا مُعَاذُ، هَلْ تَدْرِي حَقَّ اللَّهِ عَلَى عِبَادِهِ، وَمَا حَقَّ الْعِبَادِ عَلَى اللَّهِ؟»، قُلْتُ: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ، قَالَ: «فَإِنَّ حَقَّ اللَّهِ عَلَى الْعِبَادِ أَنْ يَعْبُدُوهُ وَلَا يُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا، وَحَقَّ الْعِبَادِ عَلَى اللَّهِ أَنْ لَا يُعَذِّبَ مَنْ لَا يُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا»، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ أَفَلَا أُبَشِّرُ بِهِ النَّاسَ؟ قَالَ: «لَا تُبَشِّرْهُمْ، فَيَتَكَلَّبُوا». [صحيح] - [متفق عليه]

(5) – Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rrëfen: "Isha ulur mbrapa Profetit ﷺ në një gomar të quajtur Ufejr. Profeti ﷺ më tha: “O Muadh! Vallë, e di cila është e drejta e Allahut kundrejt njerëzve dhe e drejta e njerëzve tek Allahu?” - Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri, - i thashë. - “E drejta e Allahut kundrejt njerëzve është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë ortak asgjë. Ndërkaq, e drejta e njerëzve tek Allahu është që të mos dënojnë askënd që nuk i bën ortak Atij asgjë”, - tha Profeti ﷺ. - O i Dërguari i Allahut! A t'i përgëzoj njerëzit? - i thashë. - “Jo. Mos i përgëzo, se pastaj i mbështeten kësaj (dhe i lënë veprat)”, - tha Profeti ﷺ." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron të drejtën e Allahut kundrejt njerëzve dhe të drejtën e njerëzve tek Allahu, e që e drejta e Allahut kundrejt njerëzve është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë ortak asgjë. Ndërkaq, e drejta e njerëzve tek Allahu është që të mos i dënojnë monoteistët (besimdrejtët) që nuk i bëjnë ortak Atij asgjë. Pastaj Muadhi tha: "O i Dërguar i Allahut! A nuk duhet t'i përgëzoj njerëzit, që ata të gëzohen e të zgazëlleshin me këtë begati?" Kështu, Profeti ﷺ e ndaloi nga frika se mos i mbështeteshin asaj (duke i lënë veprat).

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i së drejtës së Allahut të Lartësuar, që Ai ua ka bërë obligim njerëzve, që është: ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar asgjë në adhurim.
2. Sqarimi i së drejtës së njerëzve tek Allahu i Lartësuar, të cilën Ai ia ka bërë obligim Vetes, si mirësi dhe begati nga ana e Tij, e cila është: t'i futë në Xhenet dhe të mos i dënojë ata (që nuk i shoqërojnë asgjë në adhurim).
3. Ky hadith është përgëzim madhështor për monoteistët (muvehidët), të cilët nuk i bëjnë shok Allahut të Lartësuar asgjë dhe se fundi i tyre është hyrja në Xhenet.

4. Muadhi e ka transmetuar këtë hadith para vdekjes së tij, nga frika e rënies në mëkatin e fshehjes së dijes.
5. Paralajmërim kundër përhapjes së disa haditheve te disa njerëz, nga frika se nuk e perceptojnë domethënien e tyre. Kjo vlen për ato hadithe që nuk i nënshtrohen ndonjë vepre ose për ato hadithe që nuk tregojnë për ndonjë dënim të paracaktuar sheriatik.
6. Monoteistët mëkatarë janë nën dëshirën dhe vullnetin e Allahut: nëse do, i ndëshkon, e, nëse do, i fal dhe pastaj fundin do ta kenë në Xhenet.

(65007)

(6) - عن أنس بن مالك رضي الله عنه: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَمُعَاذٌ رَدِيفُهُ عَلَى الرَّحْلِ قَالَ: «يَا مُعَاذُ بْنُ جَبَلٍ»، قَالَ: لَبَّيْكَ يَا رَسُولَ اللَّهِ وَسَعْدَيْكَ، قَالَ: «يَا مُعَاذُ»، قَالَ: لَبَّيْكَ يَا رَسُولَ اللَّهِ وَسَعْدَيْكَ، ثَلَاثًا، قَالَ: «مَا مِنْ أَحَدٍ يَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ صِدْقًا مِنْ قَلْبِهِ إِلَّا حَرَّمَهُ اللَّهُ عَلَى النَّارِ»، قَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَفَلَا أُخْبِرُ بِهِ النَّاسَ فَيَسْتَبْشِرُوا؟ قَالَ: «إِذَا يَتَكَلَّمُوا». وَأَخْبَرَ بِهَا مُعَاذٌ عِنْدَ مَوْتِهِ تَأْتِمًا. [صحيح] - [متفق عليه]

(6) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ i tha Muadhut, i cili ishte ulur mbrapa tij mbi samar: “O Muadh ibn Xhebel!” Muadhi tha: "Të përgjigjem me kënaqësi, o i Dërguari i Allahut!" Profeti ﷺ sërish tha: “O Muadh!” Muadhi tha tri herë: "Të përgjigjem

me kënaqësi, o i Dërguari i Allahut!" Profeti ﷺ tha: "Nuk ndodh që një rob të deklarojë sinqerisht nga zemra se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, e që Allahu atë njeri të mos ia ndalojë Zjarrit." Muadhi i tha: "O i Dërguari i Allahut! A t'i njoftoj njerëzit, që të gëzohen?" Profeti ﷺ tha: "(Kur ta dëgjojnë këtë njerëzit), atëherë do t'i mbështeten vetëm asaj (e do t'i braktisin veprat)." Muadhi e tregoi këtë në fund të jetës së tij, nga frika se do të mëkatonte (nëse nuk do ta tregonte)."

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Muadh ibën Xhebeli (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte hipur pas Profetit ﷺ mbi kafshën e tij dhe ai e thirri: "O Muadh!", ku këtë thirrje e përsëriti tri herë; duke e konfirmuar kështu rëndësinë e asaj që do t'i thoshte.

Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) iu përgjigj të gjitha këtyre thirrjeve duke thënë: "Të përgjigjem me kënaqësi, o i Dërguari i Allahut!" Domethënë, unë të përgjigjem ty, o i Dërguari i Allahut, përgjigje njëra pas tjetrës dhe e kërkoj lumturinë kur të të përgjigjem.

Kështu, Profeti ﷺ tregoi se nuk ndodh që ndokush të deklarojë sinqerisht nga zemra, pa përgënjeshtruar, se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, dhe vdes në këtë gjendje, e Allahu atë njeri të mos ia ndalojë Zjarrit.

Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) kërkoi nga Profeti ﷺ që t'i informojë njerëzit, në mënyrë që të gëzohen dhe të marrin sihariq për hair!

Profeti ﷺ kishte frikë mos mbështeteshin (te kjo fjalë) e i pakësonin veprat.

Muadhi nuk ia tha askujt këtë hadith, deri para vdekjes së tij, nga frika mos binte në mëkatin e fshehjes së diturisë.

Mësime nga hadithi:

1. Modestia e Profetit ﷺ, meqë e uli mbrapa vetes në kafshën e vet Muadhin (Allahu qoftë i kënaqur me të!).
2. Mënyra si i mësonte Profeti ﷺ (sahabët), meqë e përsëriti thirrjen drejtuar Muadhit, për t'i tërhequr vëmendjen për atë që do t'ia thoshte.
3. Prej kushteve të dëshmisë: "S'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij", është ta thotë atë sinqerisht, pa kurrfarë përgënjeshtrimi a dyshimi.
4. Ithtarët e teuhidit (monoteistët) nuk do të qëndrojnë përherë në Xhehenem. Ata, edhe nëse ndodh të hyjnë në të për shkak të gjynaheve, nxirren prej tij pasi të dëliren.
5. Vlera e shehadetit (dëshmisë islame) për atë që e thotë atë sinqerisht.
6. Lejohet të mos tregohet ndonjë hadith në ndonjë rast, nëse si pasojë e kësaj rezulton ndonjë dëm.

(7) - عن طارق بن أشيم الأشجعي رضي الله عنه قال: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «مَنْ قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَكَفَرَ بِمَا يُعْبَدُ مِنْ دُونِ اللَّهِ حَرَّمَ مَالُهُ وَدَمُهُ، وَحَسَابُهُ عَلَى اللَّهِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(7) – Tarik ibën Ushejm Eshxheiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "Për atë që thotë: "La ilahe il-lallah" dhe mohon çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, pasuria dhe gjaku i tij janë të ndaluara, e llogaria e tij është tek Allahu." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që thotë dhe dëshmon me gjuhën e tij: "La ilahe il-lallah", që do të thotë: nuk ka të adhuroar me të drejtë përveç Allahut dhe mohon çdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe distancohet nga të gjitha fetë përveç Islamit, pasuria dhe gjaku i tij janë të ndaluara për muslimanët, kështu që ne i shikojmë vetëm veprat që i shfaq botërisht, kështu nuk i merret pasuria e as nuk i derdhet gjaku, përveç nëse ai kryen ndonjë krim që e bën të domosdoshme këtë gjë sipas dispozitave të Islamit.

Në Ditën e Kiametit, Allahu do ta marrë në llogari: nëse ka qenë i sinqertë, do ta shpërblejë, e, nëse ka qenë hipokrit, do ta ndëshkojë.

Mësime nga hadithi:

1. Shqiptimi i dëshmisë: "La ilahe il-lallah" dhe mohimi i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut është kusht për të hyrë në Islam.
2. Kuptimi i dëshmisë: "La ilahe il-lallah" nënkupton mohimin e çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut, bie fjala, idhujt, varret e gjërat e tjera dhe veçimi i Allahut të Lartësuar me adhurim.
3. Kushdo që jetëson monoteizmin (teuhidin) dhe u përmbahet ligjeve të tij të jashtme, është person që nuk duhet të preket, përveç nëse bëhet e qartë nga ana e tij e kundërta e kësaj.
4. Pasuria dhe gjaku i muslimanit janë të paprekshme, përveçse me hak (kur e parasheh ligji islam).
5. Dispozitat në këtë botë ndërliken me pamjen e jashtme, atë që e shfaq njeriu, ndërsa në botën tjetër, në bazë të nijetit dhe synimit.

(6765)

(8) - عَنْ جَابِرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: أَتَى النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَجُلٌ فَقَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، مَا الْمُوجِبَاتُ؟ فَقَالَ: «مَنْ مَاتَ لَا يُشْرِكُ بِاللَّهِ شَيْئًا دَخَلَ الْجَنَّةَ، وَمَنْ مَاتَ يُشْرِكُ بِاللَّهِ شَيْئًا دَخَلَ النَّارَ» [صحيح] - [رواه مسلم]

(8) – Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Një burrë erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut,

cila është veçoria që e fut njeriun në Xhenet dhe cila është që e fut në Zjarr?" Ai iu përgjigj: "Ai që vdes pa i bërë shirk Allahut asgjë, do të hyjë në Xhenet, ndërsa ai që vdes duke i bërë shirk Allahut ndonjë gjë, do të hyjë në Zjarr." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Një burrë e pyeti Profetin ﷺ për dy veçoritë: atë që e shkakton hyrjen në Xhenet dhe atë që e shkakton hyrjen në Zjarr? Kështu, Profeti ﷺ iu përgjigj: "Veçoria që shkakton hyrjen në Xhenet është që njeriu të vdesë duke e adhuruar vetëm Allahun dhe duke mos i bërë shok Atij. Ndërkaq, veçoria që shkakton hyrjen në Zjarr është që një person të vdesë duke i bërë shok Allahut diçka, kështu që i bën Allahut të barabartë e të ngjashëm ndokënd në të drejtën e Tij për t'u adhuruar, në zotrueshmërinë e Tij ose në emrat dhe cilësitë e Tij.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e teuhidit (monoteizmit) dhe se kushdo që vdes si besimtar, duke mos i bërë shok Allahut, do të hyjë në Xhenet.
2. Rreziku i shirkut (idhujtarisë) dhe se kushdo që vdes duke i bërë shok Allahut, do të hyjë në Xhehenem.
3. Monoteistët mëkatarë janë nën dëshirën dhe vullnetin e Allahut: nëse do, i ndëshkon, e, nëse do, i fal dhe pastaj fundin do ta kenë në Xhenet.

(9) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَلِمَةً وَقُلْتُ أُخْرَى، قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ مَاتَ وَهُوَ يَدْعُو مِنْ دُونِ اللَّهِ يَدًّا دَخَلَ النَّارَ» وَقُلْتُ أَنَا: مَنْ مَاتَ وَهُوَ لَا يَدْعُو لِلَّهِ يَدًّا دَخَلَ الْجَنَّةَ. [صحيح] - [متفق عليه]

(9) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "Profeti ﷺ ka thënë një fjalë, ndërsa unë kam thënë një tjetër. Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që vdes duke i bërë Allahut shok, do të hyjë në Zjarr.” Ndërkaq, unë kam thënë: "Ai që vdes pa i bërë shok Allahut, do të hyjë në Xhenet." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që i kushton dikujt tjetër pos Allahut diçka që duhet t'i kushtohet Atij, si: lutja ndaj dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar ose kërkimi i ndihmës nga dikush tjetër përveç Tij, e vdes në këtë gjendje, ai është prej banorëve të Zjarrit. Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) shtoi se kushdo që vdes pa i bërë shok Allahut, vendi i tij është Xheneti.

Mësime nga hadithi:

1. Lutja është adhurim, kështu që i kushtohet vetëm Allahut të Lartësuar.

2. Vlera e teuhidit. Pra, kush vdes si muvehid (monotesit), do të hyjë në Xhenet, edhe nëse dënohet për disa mëkate që i ka bërë.
3. Rreziku i shirkut (idhujtarisë). Ai që vdes si mushrik (idhujtar), do të hyjë në Zjarr.

(3419)

(10) - عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لِمُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ، حِينَ بَعَثَهُ إِلَى الْيَمَنِ: «إِنَّكَ سَتَأْتِي قَوْمًا أَهْلَ كِتَابٍ، فَإِذَا جِئْتَهُمْ فَأَدْعُهُمْ إِلَى أَنْ يَشْهَدُوا أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لَكَ بِذَلِكَ، فَأَخْبِرْهُمْ أَنَّ اللَّهَ قَدْ فَرَضَ عَلَيْهِمْ خَمْسَ صَلَوَاتٍ فِي كُلِّ يَوْمٍ وَلَيْلَةٍ، فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لَكَ بِذَلِكَ، فَأَخْبِرْهُمْ أَنَّ اللَّهَ قَدْ فَرَضَ عَلَيْهِمْ صَدَقَةً تُؤْخَذُ مِنْ أَعْيَانِهِمْ فَتُرَدُّ عَلَى فُقَرَائِهِمْ، فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لَكَ بِذَلِكَ، فَإِيَّاكَ وَكَرَائِمَ أَمْوَالِهِمْ، وَاتَّقِ دَعْوَةَ الْمَظْلُومِ، فَإِنَّهُ لَيْسَ بَيْنَهُ وَبَيْنَ اللَّهِ حِجَابٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(10) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) tregon: "Kur i Dërguari i Allahut ﷺ e dërgoi Muadh ibn Xhebelin në Jemen, i tha: “Ti po shkon te një popull që janë ithtarë të Librit. Kur të arrish tek ata, thirri të dëshmojnë se askush përveç Allahut nuk meriton të adhurohet dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Nëse të binden në këtë, tregoju se Allahu ua ka bërë obligim pesë namaze brenda ditës e natës. Nëse të binden në këtë, tregoju se Allahu ua ka bërë obligim zekatin, që u merret të pasurve e u jepet të varfërve të tyre. E, nëse të binden, kujdes, mos ua merr pasurinë e çmuar!

Ruaju lutjes së atij që i bëhet padrejtësi, sepse mes tij dhe Allahut nuk ka perde!” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ e dërgoi Muadh ibn Xhebelin (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në Jemen, - si thirrës për tek Allahu dhe mësues, - ia sqaroi se do të përballej me një grup të krishterësh, që kështu të ishte i gatshëm për ta dhe të fillojë t'i thërrasë ata fillimisht në gjërat më të rëndësishme e kështu me radhë. Pra, së pari i thërret për ta përmirësuar akiden (besimin), që të dëshmojnë se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, sepse me këtë futen në Islam. E, nëse i nënshtrohen kësaj, atëherë urdhërohen ta falin namazin, sepse ai është obligimi më i madh pas teuhidit (monoteizmit). Nëse ata e falin namazin, atëherë i urdhëron të pasurit e tyre që ta japin zekatin e pasurisë së tyre për të varfrit e tyre. Më pas ua tërhoqi vërejtjen që të mos ua merrte pasurinë më të çmuar, sepse obligim është ajo e mesmja. Në fund e këshilloi që të shmangë padrejtësinë, respektivisht që të mos lutet kundër tij ndonjë që i është bërë padrejtësi, sepse lutja e tij pranohet.

Mësime nga hadithi:

1. Dëshmia se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut nënkupton veçimin e Allahut me adhurim dhe braktisjen e adhurimit kushtuar dikujt tjetër përveç Tij.

2. Dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut nënkupton besimin në të, në atë gjë me të cilën ka ardhur dhe pohimi se ai është i Dërguari i fundit i Allahut dërguar te njerëzit.
3. T'i drejtohesh dijetarit dhe atyre që kanë ngjashmëri me të, nuk është njësoj si t'i drejtohesh injorantit, për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ e paralajmëroi Muadhin duke i thënë: "Ti po shkon te një popull që janë ithtarë të Librit."
4. Rëndësia që muslimani të jetë i vetëdijshëm për fenë e tij, respektivisht të largohet nga dyshimet e atyre që hedhin dyshime, gjë që arrihet duke kërkuar ditudi.
5. Pavlefshmëria e fesë së hebrenjve dhe të krishterëve pas dërgimit të profetit Muhamed ﷺ si i dërguar dhe se ata nuk do të jenë prej atyre që do të shpëtojnë në Ditën e Kijametit, derisa të hyjnë në fenë islame dhe t'i besojnë Profetit ﷺ.

(3390)

(11) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ قَالَ: قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، مَنْ أَسْعَدُ النَّاسِ بِشَفَاعَتِكَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ؟ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَقَدْ ظَنَنْتُ يَا أَبَا هُرَيْرَةَ أَنْ لَا يَسْأَلَنِي عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ أَحَدٌ أَوَّلَ مِنْكَ؛ لِمَا رَأَيْتُ مِنْ حِرْصِكَ عَلَى الْحَدِيثِ، أَسْعَدُ النَّاسِ بِشَفَاعَتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ، مَنْ قَالَ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ خَالِصًا مِنْ قَلْبِهِ أَوْ نَفْسِهِ».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(11) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: I Dërguari i Allahut ﷺ është pyetur "Kush është njeriu më

fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) tënd Ditën e Gjykimit?" I Dërguari i Allahut ﷺ i tha: "Kam pandehur, o Ebu Hurejre, se askush para teje nuk do të më pyesë për këtë çështje, për shkak se kam vënë re se ke interesim të madh për hadithin. Njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) tim Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il-lallah (s'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut)" me zemër të sinqertë, - ose ka thënë: me sinqeritet." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shefatin) e tij në Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il-lallah (s'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut)" me zemër të sinqertë dhe është i pastër nga shirku (idhujtaria) e rijaja (syefaqsia).

Mësime nga hadithi:

1. Pohimi i shefatit (ndërmjetësimit) të Profetit ﷺ në botën tjetër dhe se ai është vetëm për muvehidët (monoteistët, besimtarët e drejtë).
2. Shefati i Profetit ﷺ nënkupton që ai të kërkojë afrim (ar. tevesul) tek Allahu i Lartësuar për ata muvehidë që e meritojnë Zjarrin, që të mos hyjnë fare në të, si dhe për ata që kanë hyrë (përkohësisht), që të dalin që andej.

3. Vlera e fjalës së teuhidit (shehadetit), kur thuhet singlerisht për Allahun e Lartësuar dhe ndikimi i saj madhështor.
4. Jetësimi i fjalës së teuhidit bëhet duke e ditur kuptimin e saj dhe duke vepruar sipas kërkesave të saj.
5. Vlera e Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe zelli i tij për dituri.

(3414)

(12) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «الْإِيمَانُ بَضْعٌ وَسَبْعُونَ - أَوْ بَضْعٌ وَسِتُّونَ - شُعْبَةٌ، فَأَفْضَلُهَا قَوْلُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَدْنَاهَا إِمَاطَةُ الْأَذَى عَنِ الطَّرِيقِ، وَالْحَيَاءُ شُعْبَةٌ مِنَ الْإِيمَانِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(12) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Imani është shtatëdhjetë e ca degë, më e larta e të cilave është dëshmia "la ilahe il-lallah", ndërsa më e ulëta largimi i pengesave nga rruga. Edhe turpi është degë e imanit.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se imani ka shumë degë dhe virtyte, ku përfshihen veprat, besimet dhe fjalët.

Virtyti më i lartë dhe më i mirë i imanit është të thuash: "La ilahe il-lallah", duke e ditur kuptimin e saj dhe duke

vepruar në përputhje me të, se Allahu është i vetmi Zot që meriton të adhurohet dhe askush tjetër nuk meriton një gjë të tillë.

Më e vogla nga veprat e besimit është të largojmë mënjane çdo gjë që i dëmton njerëzit në rrugët e tyre.

Pastaj Profeti ﷺ tregoi se turpi është një nga virtytet e imanit dhe është një moral që nxit ta bëjmë atë që është e bukur dhe ta braktisim atë që është e shëmtuar.

Mësime nga hadithi:

1. Besimi ka shkallë, disa prej të cilave janë më të mira se të tjerat.
2. Besimi është fjalë (me gjuhë), vepër (me gjymtyrë) dhe besim (me zemër).
3. Turpi ndaj Allahut të Lartësuar nënkupton që Ai të të mos shohë aty ku të ka ndaluar dhe të të mos shohë se mungon aty ku të ka urdhëruar.
4. Përmendja e numrit nuk nënkupton kufizimin, por, përkundrazi, tregon se veprat e imanit janë të shumta, sepse arabët mund të përmendin një numër të caktuar për diçka dhe nuk synojnë kufizimin e tij.

(6468)

(13) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَأَلْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَيُّ الذَّنْبِ أَعْظَمُ عِنْدَ اللَّهِ؟ قَالَ: «أَنْ تَجْعَلَ لِلَّهِ نِدًّا وَهُوَ خَلَقَكَ» قُلْتُ: إِنَّ ذَلِكَ لَعَظِيمٌ، قُلْتُ: ثُمَّ أَيُّ؟ قَالَ: «وَأَنْ تَقْتُلَ وَلَدَكَ؛ تَخَافُ أَنْ يَطْعَمَ مَعَكَ» قُلْتُ: ثُمَّ أَيُّ؟ قَالَ: «أَنْ تُزَانِيَ حَلِيلَةَ جَارِكَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(13) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "E kam pyetur Profetin ﷺ: "Cili është gjynahu më i madh tek Allahu?" Më tha: "T'i bësh ortak Allahut, ndërsa Ai të ka krijuar." Thashë: "Kjo me të vërtetë që është e madhe. E, pastaj cili?" Më tha: "Të vrasësh fëmijën tënd nga frika se do të ushqehet së bashku me ty." E pyeta prapë: "Pastaj cili?" Më tha: "Të bësh kurvëri me gruan e fqinjit." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ është pyetur për gjynahun më të madh, e në atë rast ka thënë: Gjynahu më i madh është shirku i madh, që nënkupton: t'i bësh Allahut të ngjashëm ose të barabartë në uluhijen (adhurimin), rububijen (zotërimin) ose emrat dhe cilësitë e Tij. Këtë mëkat Allahu i Lartësuar e fal vetëm me pendim dhe nëse kryerësi i tij vdes në këtë gjendje, do të mbetet përgjithmonë në Zjarr. Pastaj vrasja që njeriu ia bën fëmijës së tij nga frika se do të hajë me të, pastaj vrasja e njeriut që është e ndaluar (të vritet), por mëkati i tij zmadhohet nëse i vrari është i afërm me vrasësin, gjithashtu mëkati i tij zmadhohet edhe kur qëllimi i vrasësit është frika se personi i vrarë do të marrë pjesë me të në rizkun e

Allahut. Pastaj, që një njeri të bëjë kurvëri me gruan e fqinjit të tij duke u përpjekur të mashtrojë gruan e fqinjit të tij, në mënyrë që të bëjë kurvëri me të dhe ajo t'i nënshtrohet atij. Kurvëria është e ndaluar, por mëkati i saj rritet nëse ajo me të cilën është kryer ky akt është gruaja e fqinjit, ndaj të cilit feja urdhëron bamirësi, mirësi dhe shoqërim të mirë.

Mësime nga hadithi:

1. Mëkatet dallojnë prej njëri-tjetrit sa i përket peshës së rëndë, ashtu siç dallojnë mes vete veprat e mira sa i përket mirësisë.
2. Mëkati më i madh është: t'i bësh ortak Allahut të Lartësuar (shirku), pastaj ta vrasësh fëmijën nga frika se do të ushqehet me ty e pastaj të bësh kurvëri me gruan e fqinjit tënd.
3. Riziku është në duart e Allahut dhe Ai, i Lartësuari, e ka marrë përsipër furnizimin e krijesave.
4. E drejta e fqinjit është e madhe dhe dëmtimi i tij është mëkat më i madh sesa dëmtimi i të tjerëve.
5. Krijuesi është meritori për t'ia kushtuar adhurimin, i Vetmi, i Cili nuk ka ortak.

(5359)

(14) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «قَالَ اللَّهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: أَنَا أَغْنَى الشُّرَكَاءِ عَنِ الشُّرْكِ، مَنْ عَمِلَ عَمَلًا أَشْرَكَ فِيهِ مَعِيَ غَيْرِي تَرَكْتُهُ وَشِرْكُهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(14) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu i Larmadhëruar thotë: "Unë aspak nuk kam nevojë për ortak. Kushdo që bën një vepër duke më bërë Mua ortak dikë në atë vepër, Unë e braktis atë së bashku me ortakërinë që ma ka bërë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se Allahu i Lartmadhëruar thotë: "Unë aspak nuk kam nevojë për ortak." Ai është i Vetëmjaftueshëm kundrejt çdo gjëje. Nëse njeriu bën një akt adhurimi dhe e bën për Allahun a për dikë tjetër, atëherë Allahu do ta braktisë atë dhe nuk do t'ia pranojë, si dhe do t'ia kthejë mbrapsht vepruesit atë që e ka bërë. Është obligim që vepra të bëhet singërisht për Allahun e Lartësuar, sepse Ai i pranon vetëm ato vepra që janë të singërtë për fytyrën e Tij fisnike.

Mësim nga hadithi:

1. Paralajmërim kundër shirkut (idhujtarisë) me të gjitha format e tij dhe se ai është pengesë për pranimin e veprës.

2. Kur robi ia kujton vetes vetëmjaftueshmërinë dhe madhësitinë e Allahut, kjo i ndihmon që veprën ta bëjë sinqerisht për Të.

(3342)

(15) - عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «كُلُّ أُمَّتِي يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ إِلَّا مَنْ أَبَى»، قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ، وَمَنْ يَأْبَى؟ قَالَ: «مَنْ أَطَاعَنِي دَخَلَ الْجَنَّةَ، وَمَنْ عَصَانِي فَقَدْ أَبَى». [صحيح] - [رواه البخاري]

(15) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Gjithë umeti im do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë.” Të pranishmit pyetën: "O i Dërguar i Allahut, e kush refuzon?" Profeti ﷺ tha: "Kush më bindet mua, do të hyjë në Xhenet, e, kush më kundërshton, ka refuzuar." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na njofton se tërë umeti i tij do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë!

Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) pyetën: "Kush refuzon, o i Dërguari i Allahut?!"

Kësisoj Profeti ﷺ iu përgjigj atyre: "Kushdo që i nënshtrohet, e pason dhe i bindet Profetit ﷺ, do të hyjë në Xhenet. Sa i përket atij që nuk iu bind dhe nuk iu nënshtrova fesë, në fakt ai refuzoi të hyjë në Xhenet me veprat e tij të këqija.

Mësime nga hadithi:

1. Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ është njëkohësisht bindje ndaj Allahut, sikundër që kundërshtimi i tij është kundërshtim i Allahut.
2. Bindja ndaj të Dërguarit ﷺ e bën të obliguar Xhenetin, sikundër që kundërshtimi i tij e bën të obliguar Zjarrin.
3. Sihariqi për të bindurit e këtij umeti (populli) se që të gjithë do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që nuk i binden Allahut e të Dërguarit të Tij.
4. Dhembshuria e Profetit ﷺ për umetin e tij dhe kujdesi i tij që ata të udhëzohen.

(4947)

(16) - عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «لَا تُظْرُونِي كَمَا أَظُرَّتِ النَّصَارَى ابْنَ مَرْيَمَ؛ فَإِنَّمَا أَنَا عَبْدُهُ، فَقُولُوا: عَبْدُ اللَّهِ وَرَسُولُهُ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(16) – Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "E kam dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: “Mos më shenjtëroni siç e kanë shenjtëruar të krishterët të birin e Merjemes. Unë jam rob i Allahut, andaj thoni: "Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e ndaloi teprimin dhe tejkalimin e kufirit fetar në raport me lavdërimin dhe përshkrimin e tij me cilësitë e Allahut të Lartësuar dhe veprimet e Tij të veçanta, ose se ai e di të fshehtë, ose të lutet së bashku me Allahun, siç vepruan të krishterët me Isain, të birin e Merjemes (alejhima selam). Më pas sqaroi se ai është prej robërve të Allahut, si dhe urdhëroi të themi: "Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij."

Mësime nga hadithi:

1. Tërheqja e vërejtjes nga tejkalimi i kufirit fetar në raport me madhërimin dhe lavdërimin, sepse kjo çon drejt shirkut (idhujtarisë).
2. Ajo për të cilën tërëhoqi vërejtjen Profeti ﷺ ndodhi në këtë umet. Kështu, një grup e tepruan në raport me të Dërguarin e Allahut ﷺ, një grup tjetër e teproi në raport me ehli bejtin (familjen profetike), ndërsa një grup tjetër e tepruan në raport me evlijatë, kështu që ranë në shirk.
3. I Dërguari i Allahut ﷺ e përshkroi veten si rob i Allahut, për të treguar se ai është rob i nënshtruar i Allahut, të cilit nuk i lejohet t'i kushtohet asnjë nga karakteristikat e Zotit.
4. I Dërguari i Allahut ﷺ e përshkroi veten si i Dërguari i Allahut, për të treguar se ai është profet i dërguar i Allahut, kështu që duhet besuar dhe duhet ndjekur.

(17) - عن أنس رضي الله عنه قال: قال النبي صلى الله عليه وسلم: «لَا يُؤْمِنُ أَحَدُكُمْ حَتَّى أَكُونَ أَحَبَّ إِلَيْهِ مِنْ وَالِدِهِ وَوَلَدِهِ وَالتَّائِسِ أَجْمَعِينَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(17) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Nuk ka besuar ndokush prej jush derisa të më dojë mua më shumë sesa prindin, fëmijën dhe të gjithë njerëzit e tjerë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ në këtë hadith na tregon se një musliman nuk është besimplotë derisa t'i japë përparësi dashurisë për të Dërguarin e Allahut ﷺ kundrejt dashurisë ndaj nënës, babait, djalit, vajzës dhe të gjithë njerëzve. Kjo dashuri e bën të domosdoshme që t'i bindesh Profetit ﷺ, ta ndihmosh dhe të mos e kundërshtosh.

Mësimet nga hadithi:

1. Është obligim që i Dërguari ﷺ të duhet dhe t'i jepet përparësi kësaj dashurie ndaj dashurisë së çdo krijese.
2. Shenjë e dashurisë së përsosur është përkrahja e Sunetit të të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe sakrifikimi i jetës dhe pasurisë për këtë.

3. Dashuria për të Dërguarin ﷺ nënkupton t'i bindemi në atë që na urdhëron, t'i besojmë asaj që na tregon, t'i largohemi asaj që na qorton dhe ndalon e ta ndjekim e t'i braktisim bidatet (risitë në fe), nga të cilat na paralajmëron.
4. E drejta e Profetit ﷺ është më e madhe se e të gjithë njerëzve, sepse ishte shkak që ne të udhëzoheshim e të shpëtonim nga devijimi, si dhe të na shpëtonte nga Xhehenemi e ta fitonim Xhenetin.

(5953)

(18) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «دَعُونِي مَا تَرَكْتُكُمْ، إِنَّمَا هَلَكَ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ بِسُؤَالِهِمْ وَاخْتِلَافِهِمْ عَلَى أَنْبِيَائِهِمْ، فَإِذَا نَهَيْتُكُمْ عَنْ شَيْءٍ فَاجْتَنِبُوهُ، وَإِذَا أَمَرْتُكُمْ بِأَمْرٍ فَأَتُوا مِنْهُ مَا اسْتَطَعْتُمْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(18) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Mos më pyesni për gjëra që ende nuk jua kam thënë. Ata që ishin para jush janë shkatërruar për shkak të pyetjeve (të panevojshme) dhe kundërshtimit të pejgamberëve të tyre. Andaj, nëse jua ndaloj një gjë, largohuni prej saj, e, nëse ju urdhëroj të bëni diçka, bëjeni sa të keni mundësi.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka përmendur se vendimet fetare ndahen në tri kategori: ato për të cilat është heshtur, ndalesat dhe urdhëresat.

E para: ajo për të cilën feja ka heshtur: ku nuk ka asnjë vendim fetar për të e, sipas parimit gjërat nuk janë të obligueshme për sa kohë që nuk ka tekst. Gjatë kohës së Profetit ﷺ ishte e obligueshme të mos parashtrohej pyetje për diçka që nuk kishte ndodhur, nga frika se mund të bëhej obligim ose mund të ndalohej për shkak të pyetjes. Allahu i Madhëruar nuk i bëri të obligueshme apo të ndalueshme këto gjëra në formë mëshire ndaj robërve të Tij. Ndërkaq, pas vdekjes së Profetit ﷺ, nëse pyetja është në formë fetvaje ose mësimi për gjëra të nevojshme në lidhje me çështjen e fesë, atëherë na lejohet madje jemi të urdhëruar ta parashtrojmë, e, nëse është në formë kokëfortësie dhe ekzagjerimi, atëherë kjo formë pyetjeje është ajo që duhet ta braktisim sipas këtij hadithi, për faktin se kjo mund të çojë në diçka të tillë si ajo që ndodhi me bijtë e Israilit kur u urdhëruan të therin një lopë e, sikur të thernin çfarëdo lope, do ta kishin zbatuar urdhrin, por ata u treguan të rreptë e për rrjedhojë Allahu u tregua i rreptë me ta.

E dyta: ndalesat, që janë gjëra për të cilat mosvepruesi shpërblehet, ndërsa vepruesi dënohet, kësisoj duhet të ruhemi nga të gjitha ndalesat.

E treta: urdhëresat, që janë gjëra për të cilat vepruesi shpërblehet, ndërsa mosvepruesi dënohet, kësisoj besimtari duhet t'i zbatojë ato sa të ketë mundësi.

Mësime nga hadithi:

1. Duhet të angazhohemi me atë që është më e rëndësishme dhe e nevojshme, e ta lëmë atë që nuk është e nevojshme për momentin dhe të mos angazhohemi me pyetje rreth gjërave që nuk kanë ndodhur ende.
2. Është e ndaluar të parashtrohet një pyetje që mund të çojë drejt komplikimit të çështjeve dhe hapjes së derës së dyshimeve që çojnë drejt shumëfishimit të mosmarrëveshjeve.
3. Jemi urdhëruar të heqim dorë nga të gjitha ndalesat, ngase në lënien e tyre nuk ka vështirësi dhe kjo është arsyeja që urdhri për braktisjen e tyre është i përgjithshëm.
4. Jemi urdhëruar t'i zbatojmë urdhëresat sipas mundësisë, sepse ndodh që në zbatimin e një urdhëri të ketë stërmundim ose pafuqishmëri, prandaj jemi urdhëruar të bëjmë aq sa mundemi.
5. Ndalimi i pyetjeve të shumta. Dijetarët i kanë ndarë pyetjet në dy pjesë: 1. Pyetje që bëhen me qëllim për të mësuar çështjet e nevojshme të fesë; këto pyetje jemi urdhëruar t'i bëjmë, të kësaj natyre qenë pyetjet që sahabët i bënë Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). 2. Pyetje që bëhen në formën e kokëfortësisë dhe ekzagjerimit; kjo kategori e pyetjeve është e ndaluar.

6. Ky umet është paralajmëruar që të mos e kundërshtojë Profetin ﷺ, siç ndodhi në popujt e kaluar.
7. Pyetjet e shumta klasifikohen si të panevojshme dhe kundërshtimi i pejgamberëve është shkak i shkatërrimit, veçanërisht në çështjet që nuk mund të perceptohen, si: çështjet e së padukshmes (ar. gajb), që vetëm Allahu i di, si dhe detajet që lidhen me Ditën e Kiametit.
8. Është e ndaluar të parashtrihen pyetje rreth çështjeve të vështira dhe të ndërlikuara. Euzaiu ka thënë: "Nëse Allahu dëshiron ta privojë robin e Tij nga begatia e diturisë, bën që ai të merret me çështjet e ngatërrueshme; kam vënë re se njerëzit e tillë janë më pak të ditur." Ibën Vehbiu ka thënë: "E kam dëgjuar Malikun duke thënë: "Polemikat rreth (çështjeve të) diturisë e largojnë dritën e diturisë nga zemra e njeriut."

(4295)

(19) - عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «بَلَّغُوا عَنِّي وَلَوْ آيَةً، وَحَدِّثُوا عَنْ بَنِي إِسْرَائِيلَ وَلَا حَرْجَ، وَمَنْ كَذَبَ عَلَيَّ مُتَعَمِّدًا فَلْيَتَّبِعُوا مَقْعَدَهُ مِنَ النَّارِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(19) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Kumtoni prej meje

qoftë dhe një ajet, si dhe nuk ka të keqe t'i transmetoni gojëdhënat e benu israilëve. Ai që gënjen për mua qëllimisht, le të përgatitet për ulësen e tij në Zjarr.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na urdhëron në këtë hadith që të kumtohet dituria prej tij, qoftë nga Kurani, qoftë nga Suneti, edhe nëse është diçka e vogël, bie fjala, një ajet nga Kurani ose një hadith, me kusht që ai ta dijë atë që po e kumton dhe të thërrasë tek ai. Më pas Profeti ﷺ sqaroi se nuk ka të keqe që të transmetohen gojëdhënat e benu israilëve se çfarë u ndodhi atyre, por që nuk bien ndesh me shariat tonë. E më pas tërhoqi vërejtjen që të mos gënjehet për të dhe se ai që gënjen për të qëllimisht, le të përgatitet për ulësen e tij në Zjarr.

Mësim nga hadithi:

1. Nxitja për ta kumtuar fenë e Allahut dhe se njeriu duhet ta zbatojë atë që e ka mësuar përmendsh dhe e ka kuptuar, edhe nëse është e lehtë.
2. Është detyrë të kërkohet dija fetare, që njeriu të ketë mundësi ta adhurojë Allahun dhe ta kumtojë fenë e Tij në mënyrë të saktë.
3. Është obligim të vërtetohemi se a është i vërtetë hadithi para se ta kumtojmë ose ta shpërndajmë, duke pasur kështu kujdes që të mos futemi në këtë kërcënim të rëndë.

4. Inkurajimi për ta thënë të vërtetën dhe për të pasur kujdes në raport me hadithet, për të mos rënë kështu në gënjeshtëri, sidomos në fenë e Allahut të Lartmadhëruar.

(3686)

(20) - عن المقدم بن معدٍ كَرِب رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «أَلَا هَلْ عَسَى رَجُلٌ يَبْلُغُهُ الْحَدِيثُ عَنِّي وَهُوَ مُتَكَيٌّ عَلَى أَرِيكَتِهِ فَيَقُولُ: بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ كِتَابُ اللَّهِ، فَمَا وَجَدْنَا فِيهِ حَلَالًا اسْتَحْلَلْنَاهُ، وَمَا وَجَدْنَا فِيهِ حَرَامًا حَرَّمْنَاهُ، وَإِنَّ مَا حَرَّمَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَمَا حَرَّمَ اللَّهُ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه]

(20) – Mikdam ibën Madijekribi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Nuk është e largët koha kur ndonjë personi t'i arrijë hadithi nga unë, ndërkohë ai, duke qenë i mbështetur në kolltukun e tij, të thotë: "Mes nesh dhe jush është Libri i Allahut: çfarë gjejmë në të hallall, e konsiderojmë hallall, e çfarë gjejmë në të haram, e konsiderojmë haram. Atë që e bën haram i Dërguari i Allahut ﷺ është sikurse ta bënte haram Allahu." [Ky hadith është sahih] - [Hadithin e shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibën Maxheh]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se është afuar koha kur disa njerëzve do t'u arrijë hadithi i Profetit ﷺ duke qenë ulur, kurse ndonjëri prej tyre, kur t'i arrijë hadithi, duke qenë i shtrirë në shtrat, do të thotë: "Ai që bën gjykimin mes nesh

dhe jush në çështjet (fetare) është Kurani i Madhërishëm, sepse ai na mjafton: çdo gjë që e gjejmë hallall në të, e veprojmë, sikundërqë çdo gjë që e gjejmë haram në të, largohemi prej saj. Pastaj Profeti ﷺ sqaroi se çdo gjë që ai e bëri haram ose e ndaloi në Sunetin e tij, ajo gjë, sa i përket vendimit fetar, është sikurse ajo që Allahu e bëri haram në Librin e Tij, sepse ai është kumtues nga Zoti i tij.

Mësime nga hadithi:

1. Madhërimi i Sunetit, ashtu siç madhërohet Kurani dhe veprimi sipas tij.
2. Bindja ndaj Profetit është bindje ndaj Allahut dhe kundërshtimi i tij është kundërshtim i Allahut të Lartësuar.
3. Pohimi se Suneti është burim bazë që merret si argument dhe kundërpërgjigja ndaj atyre që i refuzojnë hadithet.
4. Kushdo që ia kthen shpinën Sunetit dhe pretendon se Kurani i mjafton, është larguar prej të dyve dhe gënjen duke pretenduar se e ndjek Kuranin.
5. Një nga treguesit e profecisë së Pejgamberit ﷺ është kur të tregojë për diçka që do të ndodhë në të ardhmen dhe ndodh ashtu siç ka treguar.

(65005)

(21) - عن عائشة أم المؤمنين وعبد الله بن عباس رضي الله عنهما قالا: لَمَّا نَزَلَ بِرَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ طَفِقَ يَطْرَحُ حَمِيصَةً لَهُ عَلَى وَجْهِهِ، فَإِذَا اغْتَمَّ بِهَا كَشَفَهَا عَنْ وَجْهِهِ، فَقَالَ وَهُوَ كَذَلِكَ: «لَعَنَهُ اللَّهُ عَلَى الْيَهُودِ وَالنَّصَارَى، اتَّخَذُوا قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ مَسَاجِدَ» يُحَدِّثُ مَا صَنَعُوا. [صحيح] - [متفق عليه]

(21) - Aishja dhe Abdullah ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) tregojnë: "Kur të Dërguarin e Allahut ﷺ e kapluan dhimbjet e vdekjes, e mbulonte fytyrën me një këmishë. E, kur i pushonin dhimbjet, e zbulonte. Duke qenë në këtë gjendje, tha: "Allahu i mallkoftë hebrenjtë dhe të krishterët: varret e të dërguarve i shndërruan në faltore!" Pra, tërhiqte vërejtjen kundër veprimeve të tyre. [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Aishja dhe Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) na tregojnë se, kur Profetiti ﷺ i afrua vdekja, vendosi një copë pëlhere në fytyrën e tij, e, kur e kishte të vështirë frymëmarrjen për shkak të agonisë së vdekjes, e hoqi nga fytyra dhe në atë gjendje të rëndë tha: "Allahu i mallkoftë hebrenjtë e të krishterët dhe i dëboftë nga mëshira e Tij, për shkak se ndërtuan xhami mbi varret e profetëve të tyre!" Sikur të mos ishte kjo çështje e rrezikshme, nuk do të përmendte një gjë të tillë në këtë gjendje, prandaj Profeti ﷺ e ndaloi umetin e tij që të mos u shëmbëllejné atyre në këtë vepër, sepse është një vepër e hebrenjve dhe e të krishterëve,

dhe se është shteg që çon drejt shirkut ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalesa që varret e profetëve dhe njerëzve të mirë të shndërrohen në faltore, që bëhet namaz në to për hir të Allahut, sepse kjo është mjet që dërgon në shirk (idhujtari).
2. Interesimi i madh dhe kujdesi i të Dërguarit të Allahut ﷺ për teuhidin dhe frika e tij nga madhërimi i varreve, sepse kjo çon drejt shirkut.
3. Lejimi i mallkimit të hebrenjve e të krishterëve dhe atyre që veprojnë njëjtë si ata, duke ndërtuar mbi varre dhe duke i shndërruar ato në faltore.
4. Ndërtimi mbi varre është një nga traditat e hebrenjve dhe të krishterëve, prandaj hadithi e ndalon shëmbëllimin me ta.
5. Nga shndërrimi i varreve në faltore - xhami është namazi në to dhe në drejtim të tyre, edhe nëse nuk është ndërtuar faltore (mbi to).

(3330)

(22) - عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم: «اللَّهُمَّ لَا تَجْعَلَ قَبْرِي وَتَنَاءً، لَعَنَ اللَّهُ قَوْمًا اتَّخَذُوا قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ مَسَاجِدَ». [صحيح] - [رواه أحمد]

(22) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "O Allah, mos ma bëj varrin idhull! Allahu mallkoi një popull që i shndërruan varret e profetëve të tyre në faltore." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ahmedi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i bëri lutje Zotit të tij që të mos ia bëjë varrin sikurse idhull që njerëzit e adhurojnë duke e madhëruar dhe duke pasur përballë e duke i bërë sexhde. Pastaj Profeti ﷺ tregoi se Zoti i ka larguar dhe dëbuar nga mëshira e Tij ata që i kanë marrë varret e profetëve faltore, sepse marrja e tyre si faltore është shkak për t'i adhuruar dhe për të besuar në to.

Mësime nga hadithi:

1. Tejkalimi i kufirit legjitim në raport me varret e profetëve dhe të devotshmëve bën që ata të adhurohen në vend të Allahut, andaj duhet pasur kujdes nga mjetet që çojnë drejt shirkut (idhujtarisë).
2. Nuk lejohet t'i synosh varret (me vizitë) për t'i nderuar dhe për të bërë adhurim tek ato, sado afër Allahut të Lartëruar (me pozitë) të jetë i varrosuri.

3. Është haram të ndërtohen xhamitë mbi varre.
4. Është e ndaluar falja e namazit te varret, edhe nëse nuk është ndërtuar faltore - xhami, përveç namazit të xhenazes, së cilës nuk i është falur namazi (në xhami, bën t'i falet aty).

(3336)

(23) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «لَا تَجْعَلُوا بُيُوتَكُمْ قُبُورًا، وَلَا تَجْعَلُوا قُبُورِي عِيدًا، وَصَلُّوا عَلَيَّ؛ فَإِنَّ صَلَاتَكُمْ تَبْلُغُنِي حَيْثُ كُنْتُ». [حسن] - [رواه أبو داود]

(23) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varre e as mos e shndërroni varrin tim në vendfestë, por më dërgoni salavate, sepse salavati juaj më arrin kudo që jeni!" [Hadith hasen] - [E shënon Ebu Davudi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ me këtë hadith ndaloi që shtëpitë të jenë të zhveshura nga falja e namazit (vullnetar), sepse shdërrohen në varreza, në të cilat nuk falet namazi. Ai po ashtu e ndaloi të vizitohet varri i tij shpesh dhe të tubohen rregullisht tek ai, sepse kjo është shkak që çon në shirk (idhujtari). Në vend të kësaj, ai i urdhëroi që t'i çohen salavate e selame kudo qofshin nëpër botë, sepse këto do t'i arrijnë, nga i afërti e nga

i largëti, krejt njëjtë, kështu që nuk ka nevojë ta vizitojnë shpesh varrin e tij.

Mësim nga hadithi:

1. Është e ndaluar që shtëpitë të zhvishen nga adhurimi kushtuar Allahut të Lartësuar.
2. Ndalohet udhëtimi për të vizituar (ekskluzivisht) varrin e Profetit ﷺ, sepse ai urdhëroi t'i çojmë salavate dhe tregoi se ato i arrijnë. Mirëpo, udhëtimi merret me qëllim të Xhamisë (së Profetit) dhe për të bërë namaz në të.
3. Është e ndaluar që vizita e varrit të Profetit ﷺ të shndërrohet në vendfestë, duke e përsëritur rregullisht në një mënyrë të caktuar në një kohë të caktuar. E njëjta gjë vlen edhe për vizitën e ndonjë varri tjetër.
4. Ky hadith dëshmon nderimin që Zoti ia bëri Profetit ﷺ, meqë i përligji salavatet dhe selamet për të, në çdo kohë dhe vend.
5. Pasi ndalimi i faljes së namazit te varret ishte ngulitur te sahabët, kjo është arsyeja pse Profeti ﷺ e ndaloi shndërrimin e shtëpive në varreza, në të cilat nuk falet namazi.

(3350)

(24) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا: أَنَّ أُمَّ سَلَمَةَ ذَكَرَتْ لِرَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَنِيْسَةً رَأَتْهَا بِأَرْضِ الْحَبَشَةِ، يُقَالُ لَهَا مَارِيَةُ، فَذَكَرَتْ لَهُ مَا رَأَتْ فِيهَا مِنَ الصُّوْرِ، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أُولَئِكَ قَوْمٌ إِذَا مَاتَ فِيهِمُ الْعَبْدُ الصَّالِحُ، أَوِ الرَّجُلُ الصَّالِحُ، بَنَوْا عَلَى قَبْرِهِ مَسْجِدًا، وَصَوَّرُوا فِيهِ تِلْكَ الصُّوْرَ، أُولَئِكَ شِرَارُ الْخَلْقِ عِنْدَ اللَّهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(24) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Umu Seleme i rrëfeu të Dërguarit të Allahut ﷺ se, gjatë kohës sa ishin në Abisini, kishte parë një kishë të quajtur Maria, dhe ia përmendi pikturat (e frymorëve) që kishte parë aty. Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Ata janë njerëz që, kur u vdes ndonjë rob i devotshëm, - ose ka thënë: burrë i devotshëm, - mbi varrin e tij ndërtojnë faltore dhe vizatojnë brenda saj piktura të atilla. Ata janë krijesat më të këqija tek Allahu.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Nëna e besimtarëve, Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i tregoi Profetit ﷺ në mënyrë të çuditshme se, kur ishte në Abisini, kishte parë një kishë, të cilën e quanin Maria, ku kishte piktura (frymorësh), dekorime dhe portrete. Profeti ﷺ sqaroi shkaqet e vendosjes së këtyre pikturave, e në atë rast tha: "Ata njerëz që po i përmend, kur u vdes ndonjë burrë i devotshëm, - mbi varrin e tij ndërtojnë faltore, ku falen dhe vizatojnë brenda saj piktura të atilla." Si dhe sqaroi se ai që e bën këtë është krijesa më e keqe tek

Allahu i Lartësuar, sepse veprimi i tij shpie në shirk (idhujtari).

Mësime nga hadithi:

1. Ndalimi i ndërtimit të xhamive mbi varre, falja e namazit tek ato ose varrosja e të vdekurve në xhami; duke ia mbyllur kështu shtigjet shirkut (idhujtarisë).
2. Ndërtimi i xhamive mbi varre dhe vendosja e pikturave (me imazhe frymorësh) në to është vepër e hebrenjve dhe e të krishterëve dhe kushdo që e bën këtë u shëmbëllen atyre.
3. Ndalimi i vendosjes së pikturave me qenie të gjalla.
4. Kushdo që ndërton një xhami mbi një varr dhe vizaton brenda saj piktura (frymorësh), ai është ndër krijesat më të këqija tek Allahu i Lartësuar.
5. Mbrojtja që feja ua bën aspekteve të teuhidit (monoteizmit) është mbrojtje e plotë, ngaqë i mbylli të gjitha rrugët që mund të çojnë në shirk (idhujtari).
6. Ndalimi i teprimit në raport me njerëzit e devotshëm, sepse është shkak për të rënë në shirk (idhujtari).

(10887)

(25) - عن جندب رضي الله عنه قال: سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَبْلَ أَنْ يَمُوتَ بِحُمْسٍ وَهُوَ يَقُولُ «إِنِّي أَبْرَأُ إِلَى اللَّهِ أَنْ يَكُونَ لِي مِنْكُمْ خَلِيلٌ فَإِنَّ اللَّهَ تَعَالَى قَدْ اتَّخَذَنِي خَلِيلًا كَمَا اتَّخَذَ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا، وَلَوْ كُنْتُ مُتَّخِذًا مِنْ أُمَّتِي خَلِيلًا لَا تَخَذْتُ أَبَا بَكْرٍ خَلِيلًا! أَلَا وَإِنَّ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ كَانُوا يَتَّخِذُونَ قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ وَصَالِحِيهِمْ مَسَاجِدَ، أَلَا فَلَا تَتَّخِذُوا الْقُبُورَ مَسَاجِدَ! إِنِّي أَنَهَاكُمُ عَنْ ذَلِكَ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(25) – Xhundubi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Pesë ditë para se të vdiste, e kam dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: “Me ndërgjegje të pastër para Allahut, refuzoj të kem ndonjë mik të ngushtë nga mesi juaj, sepse Allahu i Lartësuar më ka zgjedhur mua për mik të ngushtë (ar. halil) ashtu siç e ka zgjedhur mik të ngushtë Ibrahimin. Madje, sikur të kisha zgjedhur dikë për mik të ngushtë, do ta kisha zgjedhur Ebu Bekrin. Dijeni se popujt para jush varret e profetëve të vet dhe të njerëzve të devotshëm i shndërronin në faltore. Prandaj, mos i shndërroni varret në faltore. Unë po ju ndaloj një vepër të tillë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon për pozitën që ai e gëzon tek Allahu i Lartësuar, respektivisht se ajo arriti shkallën më të lartë të dashurisë (ar. el hul-leh, miqësia e ngushtë), siç e arriti Ibrahim (alejhi selam), prandaj ai mohoi se kishte mik të ngushtë përveç Allahut, sepse zemra e tij ishte e mbushur me dashurinë, madhërimin dhe njohjen

e Allahut të Lartësuar, kështu që nuk kishte vend për askënd përveç Tij. Sikur ai të kishte mik të ngushtë prej krijesave, do ta kishte Ebu Bekër Sidikun (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Më pas paralajmëroi që të mos tejkalohet kufiri i lejuar në dashuri, siç bënë hebrenjtë dhe të krishterët në raport me varret e profetëve dhe të njerëzve të devoshtëm, derisa i shndërruan në hyjni idhujtareske që adhurohen në vend të Allahut dhe ndërtuan faltore - xhami e tempuj mbi varret e tyre, si dhe e ndaloi umetin e tij të bëjnë të njëjtën gjë si ata.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e Ebu Bekër Sidikut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe se ai është më i miri nga sahabët e njeriu më i denjë për t'u bërë kalif pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ.
2. Ndërtimi i xhamive mbi varre është nga të këqijat e popujve të mëparshëm.
3. Është e ndaluar marrja e varreve si vende adhurimi për t'u falur tek ato ose në drejtim të tyre, ose të ndërtohen mbi to xhami a kupola. Kjo, për t'u ruajtur nga rënia në shirk (idhujtari) për shkak të kësaj.
4. Paralajmërim ndaj teprimit në raport me njerëzit e devotshëm, për shkak se një gjë e tillë çon në shirk (idhujtari).
5. Rreziku i asaj për të cilën tërhoqi vërejtjen Profeti ﷺ, sepse këtë e theksoi pesë net para vdekjes së tij.

(26) - عن أبي الهيثاج الأسدي قال: قَالَ لِي عَيِّي بْنُ أَبِي طَالِبٍ: أَلَا أَبْعَثُكَ عَلَى مَا بَعَثَنِي عَلَيْهِ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ؟ أَنْ لَا تَدَعَ تِمَثَالًا إِلَّا طَمَسْتَهُ، وَلَا قَبْرًا مُشْرِفًا إِلَّا سَوَّيْتَهُ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(26) – Ebu Hejaxh Esediu tregon se Ali ibn Ebu Talibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ka thënë: “A të të dërgoj për atë me të cilën më ka dërguar i Dërguari i Allahut ﷺ: të mos lësh statujë pa prishur e as varr të ngritur pa e rrafshuar!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i dërgonte shokët e tij që të mos linin asnjë statujë - që nënkupton figurën e dikujt a diçkaje - pa e hequr a rrafshuar.

Si dhe të mos lënë asnjë varr të ngritur, përveçse ta bëjnë rrafsh me token e të rrënojnë çdo ndërtim mbi varre, ose ta bëjnë në atë nivel që të mos jetë i ngritur shumë lart nga toka, por duke e ngritur rreth një pëllëmbë.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalimi i pikturimit të qenieve të gjalla, sepse është mjet drejt idhujtarisë.
2. Është e lejuar të largohet e keqja me dorë për atë që ka autoritet ose fuqi për ta bërë këtë.

3. Profeti ﷺ ishte i kujdesshëm për t'i hequr të gjitha gjurmët e xhahiletit (kohës para se të vinte Profeti), si: imazhet (frymore), statujat dhe ndërtimin mbi varre.

(5934)

(27) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «الطَّيْرَةُ شِرْكٌ، الطَّيْرَةُ شِرْكٌ، الطَّيْرَةُ شِرْكٌ، -ثَلَاثًا-»، وَمَا مِنَّا إِلَّا، وَلَكِنَّ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ يُذْهِبُهُ بِالتَّوَكُّلِ. [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(27) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Tijera (besimi në ogure të zeza) është shirk. Tijera është shirk. Tijera është shirk." - Këtë e tha tri herë. - "Secili prej nesh përjeton diçka nga kjo, por Allahu i Lartmadhëruar e largon atë me mbështetjen në Të." [Ky hadith është sahih] - [Hadithin e shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxheh dhe Ahmed]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith paralajmëroi kundër tijeras (besimit në ogure të zeza), që nënkupton besimin në ndjelljen e së keqes të diçkaje që dëgjohet ose shihet, përfshirë zogjtë, kafshët, njerëzit me të meta, numrat, ditët etj. Fjala tijera, që nënkupton besimin në ogure të zeza, rrjedh nga fjala “tajr”, që do të thotë “zog”, sepse në periudhën paraislame, arabët, kur dëshiron të bënin ndonjë punë, qoftë udhëtim e tregti, qofshin gjëra të tjera, e kishin

zakon të lëshonin një zog. Nëse ai fluturonte në anën e djathtë, atëherë kishin mendim të mirë dhe nisin punën që ia kishin mësyre. Por, nëse zogu fluturonte në anën e majtë, atëherë mendonin se kjo ishte një shenjë ogurzezë, prandaj hiqnin dorë nga ajo punë. Profeti ﷺ tregoi se kjo është shirk. Besimi në ogure të zeza është shirk, për faktin se askush nuk e sjell të mirën përveç Allahut dhe askush nuk e largon të keqen përveç Tij, të Vetmit, i Cili nuk ka ortak.

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përmendi se njëfarë mendimi ogurzi mund ta godasë zemrën e një muslimani, por ai duhet ta largojë atë duke u mbështetur tek Allahu dhe duke i marrë masat.

Mësime nga hadithi:

1. Besimi në ogure të zeza është shirk, sepse në këtë mënyrë zemra lidhet me dikë tjetër përveç Allahut.
2. Rëndësia e përsëritjes së çështjeve të rëndësishme, në mënyrë që ato të mbahen në mend dhe të skaliten në zemër.
3. Mendimet ogurzeza i largon mbështetja në Allahun e Lartësuar.
4. Urdhri për t'iu mbështetur vetëm Allahut dhe për ta lidhur zemrën vetëm me Të.

(3383)

(28) - عن عمران بن حصين رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «لَيْسَ مِنَّا مَنْ تَطَيَّرَ أَوْ تُطَيِّرَ لَهُ، أَوْ تَكَهَّنَ أَوْ تُكَهَّنَ لَهُ، أَوْ سَحَرَ أَوْ سُحِرَ لَهُ، وَمَنْ عَقَدَ عُقْدَةً، وَمَنْ أَتَى كَاهِنًا فَصَدَّقَهُ بِمَا يَقُولُ فَقَدْ كَفَرَ بِمَا أُنْزِلَ عَلَى مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ». [حسن] - [رواه البزار]

(28) – Imran ibën Husajni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Nuk është sipas udhëzimit tonë ai që bën tetajur (beson në ogure të zeza) ose bëhet për të tetajur, e as ai që bën fall ose shkon tek ai që bën fall, e as ai që bën magji ose bëhet për të magji dhe as ai që lidh nyja. Ai që shkon te falltari dhe i beson asaj që thotë, ka mohuar atë që i ka zbritur Muhamedit ﷺ." [Hadith hasen] - [E shënon Bezzari]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith i kërcënoi ata nga umeti i tij që bënëin disa vepra, duke thënë: “Nuk është sipas udhëzimit tonë”, prej të cilave theksojmë:

E para: "Ai që bën tetajur (beson në ogure të zeza) ose bëhet për të tetajur.“ Origjina e kësaj është: lëshimi i zogut kur fillon një veprim, si: udhëtimi, tregtia ose ndonjë gjë tjetër; nëse fluturon në të djathtë, ai bëhet optimist dhe vazhdon ta bëjë atë që dëshiron, e, nëse fluturon në të majtë, ai bëhet pesimist dhe heq dorë nga ajo që dëshiron. Andaj, nuk i lejohet që ta bëjë këtë vetë e as të autorizojë ndokënd të bëjë këtë gjë për të. Në këtë pikë përfshihet pesimizmi për çdo gjë, qoftë që dëgjohet, qoftë që shihet, qofshin zogj,

qofshin kafshë, qofshin njerëz me aftësi të kufizuara, numra, ditë e çdo gjë tjetër.

E dyta: “E as ai që bën fall ose shkon tek ai që bën fall.” Pra, kushdo që pretendon se e di të fshehtën duke përdorur yjet dhe gjëra të tjera ose shkon te ndokush që pretendon se e di të fshehtën, bie fjala, shkon te ndonjë falltar e të ngjashëm dhe i beson pretendimit që thotë se e di të fshehtën, e ka mohuar atë që i ka zbritur Muhamedit ﷺ.

E treta: “E as ai që bën magji ose bëhet për të magji.” Pra, që ai vetë të bëjë magji ose ta porositë dikë që të bëjë magji për të, kësisoj të përfitojë ose të dëmtohet ndokush prej saj. Ose lidh nyja me fije për të bërë magji, ku i lexon në to magjitë e ndaluara dhe fryn në to.

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim të mbështemi tek Allahu dhe të besojmë në caktimin dhe paracaktimin e Allahut, si dhe të besojmë se janë të ndaluara: et tjerah, pesimizmi, magjia, tregimi i fatit dhe të pyeturit e personave që i bëjnë këto gjëra.
2. Pretendimi i njohjes së të fshehtës është shirk që e mohon teuhidin.
3. Është haram t'u besosh falltarëve dhe të shkosh tek ata. Këtu hyjnë: leximi i pëllëmbës, filxhanit, horoskopi dhe shikimi në të, qoftë dhe thjesht për informacion.

(29) - عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا عَدْوَى، وَلَا طَيْرَةٌ، وَيُعْجِبُنِي الْفَالُ» قَالَ قَيْلٌ: وَمَا الْفَالُ؟ قَالَ: «الْكَلِمَةُ الطَّيِّبَةُ» [صحيح] - [متفق عليه]

(29) – Nga Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Nuk ka sëmundje ngjitëse e as ogur të zi, mirëpo mua më pëlqen optimizmi (ndjellja e së mirës)" Dikush i tha: Çfarë është optimizmi (ndjellja e së mirës)? Ai tha: "Fjala e mirë!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se transmetimi i sëmundjeve ngjitëse vetvetiu, nga një njeri te tjetri, pa iu nënshtruar caktimit të Zotit, siç besonin njerëzit e periudhës së injorancës, është koncept i gabuar. Po ashtu, besimi në ogure të zeza është koncept i gabuar. Oguret e zeza nënkuptojnë ndjelljen e së keqes nga gjëra të ndryshme, si: shpendët, kafshët, njerëzit me të meta, numrat, ditët etj., qoftë përmes dëgjimit, qoftë përmes shikimit. Në kohën paraislame, shpendët ishin më të njohur për oguret se gjërat e tjera. Ata e lëshonin shpendin në fillim të një pune qoftë ajo udhëtim, qoftë tregti, qoftë diçka tjetër; nëse shpendi merrte djathtas, ata bëheshin optimistë dhe e ndërmerrnin punën që synonin, e nëse merrte majtas, ata bëheshin pesimistë dhe e linin punën që synonin. Pastaj Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tregoi se atij i pëlqente optimizmi, i cili

nënkupton ndjesinë e gëzimit dhe të lumturisë, që ndjen njeriu nga një fjalë e mirë që e dëgjon nga dikush dhe e bën atë të mendojë mirë për Zotin e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Mbështetja në Allahun e Madhërishëm dhe se mirësinë e sjell vetëm Ai dhe të keqen e largon vetëm Ai.
2. Ndalimi i besimit në ogure, të cilat nënkuptojnë gjërat që të bëjnë pesimist dhe të pengojnë nga ndërmarrja e punës.
3. Optimizmi nuk është pjesë e ogureve të ndaluara, por është pjesë e mendimeve të mira për Allahun e Madhëruar.
4. Çdo gjë ndodh me caktimin e Allahut të Madhëruar, të Vetmit pa ortak.

(3422)

(30) - عَنْ زَيْدِ بْنِ خَالِدٍ الْجُهَنِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: صَلَّى لَنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ صَلَاةَ الصُّبْحِ بِالْحَدِيثِيَّةِ عَلَى إِثْرِ سَمَاءٍ كَانَتْ مِنَ اللَّيْلَةِ، فَلَمَّا انْصَرَفَ أَقْبَلَ عَلَى النَّاسِ، فَقَالَ: «هَلْ تَذَرُونَ مَاذَا قَالَ رَبُّكُمْ؟» قَالُوا: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ، قَالَ: «أَصْبَحَ مِنْ عِبَادِي مُؤْمِنٌ يِي وَكَافِرٌ، فَأَمَّا مَنْ قَالَ: مُطِرْنَا بِفَضْلِ اللَّهِ وَرَحْمَتِهِ، فَذَلِكَ مُؤْمِنٌ يِي وَكَافِرٌ بِالْكَوْكِبِ، وَأَمَّا مَنْ قَالَ: بِنَوْءٍ كَذَا وَكَذَا، فَذَلِكَ كَافِرٌ يِي وَمُؤْمِنٌ بِالْكَوْكِبِ.» [صحيح] - [متفق عليه]

(30) – Zejd ibën Halid Xhuheniu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ na e fali namazin e sabahut në Hudejbije pas një nate me shi. Pasi e kreu namazin, u kthye nga njerëzit dhe u tha: “E dini se çfarë tha Zoti juaj?” Të pranishmit thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." I Dërguari vazhdoi: “Ai tha: "Disa robër të Mi më besuan, e disa të tjerë më mohuan. Ata që thanë: "Ra shi nga mirësia dhe mëshira e Allahut", më besuan Mua dhe i mohuan yjet. Ndërkaq, ata që thanë: "Ra shi për shkak të këtij e atij ylli", më mohuan Mua, e u besuan yjeve." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e fali namazin e sabahut në Hudejbije, - fshat afër Mekës, - pasi atë natë ra shi. Kur dha selam dhe e mbaroi namazin, iu drejtua njerëzve dhe i pyeti: "E dini se çfarë tha Zoti juaj i Lartmadhërishëm?" Ata iu përgjigjën: "Allahu dhe i Dërguari i tij e dinë më së miri!" Ai tha: "Allahu i Lartësuar e ka bërë të qartë se njerëzit ndahen në dy grupe kur bie shi: një grup që beson në Allahun e

Lartësuar dhe një grup që nuk beson në Allahun e Lartësuar. Ata që thanë: "Ra shi nga mirësia dhe mëshira e Allahut", ia adresuan zbritjen e shiut Allahut të Lartësuar dhe të tillët janë besimtarë në Allahun, Krijuesin, i Cili e kontrollon Universin dhe janë mohues të yjeve. Ndërkaq, ata që thanë: "Na ra shi për shkak të filan yllit", të tillët e mohuan Allahun dhe u besuan yjeve. Një veprim i tillë është kufër (mosbesim) i vogël, pasi shiu iu adresua yjeve, meqë Allahu nuk e bëri atë as shkak fetar (sheratik) e as shkak të krijimit (kaderik). E, ata që ia adresojnë rënien e shiut dhe ngjarjet e tjera tokësore lëvizjeve të yjeve gjatë ngritjes dhe rënies së tyre, duke besuar se ato janë vepruesi i vërtetë, atëherë janë jobesimtarë, që kanë bërë kufër të madh (që i nxjerr nga feja).

Mësime nga hadithi:

1. Pasi të bjerë shiu, është e pëlqyeshme të thuhet: "Ra shi nga mirësia dhe mëshira e Allahut."
2. Kushdo që ua adreson yjeve mirësinë e zbritjes së shiut dhe të gjërave të tjera, qoftë si krijim, qoftë si sjellje në ekzistencë, është jobesimtar, që ka bërë kufër të madh (që e nxjerr nga feja). E, nëse ia adreson si shkak, atëherë ai është jobesimtar, që ka bërë kufër të vogël (që nuk e nxjerr nga feja), sepse nuk është as shkak fetar e as shkak lëndor - konkret.
3. Mirësia është shkak për të bërë kufër (mobesim), nëse ajo mohohet, si dhe është shkak për iman (besim), nëse për të falënderohet.

4. Është e ndaluar të thuhet: "Ra shi për shkak të këtij e atij ylli", edhe nëse është për qëllim koha, për t'i mbyllur kështu rrugët e shirkut (idhujtarisë).
5. Është obligim që zemra të jetë e lidhur me Allahun e Lartësuar, për tërheqjen e begative dhe pengimin e dënimit.

(65010)

(31) - عَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ الْجُهَنِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَقْبَلَ إِلَيْهِ رَهْطٌ، فَبَايَعَ تِسْعَةً وَأَمْسَكَ عَنْ وَاحِدٍ، فَقَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ، بَايَعْتَ تِسْعَةً وَتَرَكْتَ هَذَا؟ قَالَ: «إِنَّ عَلَيْهِ تَمِيمَةً»، فَأَدْخَلَ يَدَهُ فَقَطَعَهَا، فَبَايَعَهُ، وَقَالَ: «مَنْ عَلَّقَ تَمِيمَةً فَقَدْ أَشْرَكَ». [حسن] - [رواه أحمد]

(31) – Nga Ukbeh ibën Amir el-Xhuheni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) i erdhi një delegacion dhe ai lidhi besën me nëntë prej tyre, ndërsa me njërin jo. Ata i thanë: "O Profet i Allahut, e lidhe besën me nëntë veta dhe le njërin?" Pejgamberi tha: "Ai mban në trup një hajmali!" Sakaq, personi e mori dhe e grisi hajmalinë dhe lidhi besën me Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!). Mandej Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tha: "Kush var hajmali në trup ka bërë shirk (idhujtari)!" [Hadith hasen] - [E shënon Ahmedi]

Shpjegimi:

Një grup njerëzish prej dhjetë vetash erdhën te Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) dhe ai lidhi besën e Islamit dhe të ndjekjes me nëntë prej tyre dhe e la të dhjetin. Kur e pyetën për arsyen e kësaj, ai tha se në trupin e tij gjendet një hajmali, e cila lidhet ose varet në trup dhe përbëhet nga rruaza ose nga gjëra të tjera, dhe mbahet për të larguar mësyshin apo dëmet e tjera. Personi e futi dorën menjëherë te vendi ku ndodhej hajmalia dhe e grisi atë dhe më pas e hodhi. Pas kësaj, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e lidhi besën me të, e duke paralajmëruar nga hajmalitë dhe duke sqaruar dispozitën fetare mbi to tha: "Kush var hajmali ka bërë shirk!"

Mësime nga hadithi:

1. Kush mbështetet te dikush tjetër veç Allahut, Ai e trajton atë me të kundërtën e qëllimit të tij.
2. Besimi se varja e hajmalive është shkak për largimin e së keqes dhe të mësyshit, është shirk i vogël. E, nëse beson se ato kanë forcë në vetvete për të të ndihmuar, atëherë ky është shirk i madh.

(6762)

(32) – عن عبد الله بن مسعود رضي الله عنه قال: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «إِنَّ الرُّقَى وَالتَّمَائِمَ وَالتَّوَلَةَ شِرْكٌ». [صحيح] - [رواه أبو داود وابن ماجه وأحمد]

(32) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Me të vërtetë rukjet (yshtjet, që nuk përputhen me fenë), temimet (hajmalitë) dhe tiveleja (diçka që bëhej me pretendimin se sillte dashuri) janë shirk." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ sqaroi se veprimi i disa gjërave është shirk (idhujtari). Prej tyre theksoi:

1. Rukjet (yshtjet): fjalë përmes të cilave kërkonin shërim njerëzit e xhahilietit (periudhës para se të vinte Profeti), të cilat përmbanin shirk.

2. Hajmalitë prej rruazave dhe të ngjashme, të cilat u ngjiten fëmijëve, kafshëve dhe të tjerëve, për të shmangur mësyshin.

3. Tivele, e cila bëhet për ta bërë të dashur njërin bashkëshort për tjetrin.

Këto gjëra janë shirk, sepse është konsideruar diçka shkak (për shërim etj.), që nuk është shkak fetar, që vërtetohet me argument, e as shkak konkret, që vërtetohet me përvojë. Sa u përket shkaqeve fetare, si: leximi i Kuranit ose shkaqeve konkrete, siç janë barnat, që janë vërtetuar me përvojë (se janë të dobishme), ato lejohen, por duke besuar

se janë shkaktare dhe se dobia dhe dëmi janë në Dorë të Allahut.

Mësime nga hadithi:

1. Mbrojtja e teuhidit dhe akides nga gjërat që e cenojnë atë.
2. Është haram të përdoren rukjet shirkore, hajmalitë dhe tiveletë.
3. Nëse njeriu ka bindje se këto tria janë shkaqe, atëherë një veprim i tillë është shirk i vogël, sepse i tilli e konsideroi shkak një gjë që nuk është shkak, ndërsa bindja se ato vetvetiu bëjnë dobi dhe dëm, është shirk i madh (që e nxjerr njeriun nga feja).
4. Tërheqja e vërejtjes nga veprimi i shkaqeve shirkore dhe të ndaluara.
5. Ndalimi i rukjeve dhe se ato janë shirk, përveç asaj që është legjitime (me Kuran dhe Sunet).
6. Zemra duhet të lidhet vetëm me Allahun, sepse vetëm nga Ai, i Cili nuk ka ortak, vjen dëmi dhe dobia, kështu që askush nuk sjell të mira përveç Allahut dhe askush nuk e largon të keqen përveç Tij.
7. Rukje e lejuar është ajo që përfshin tri kushte: 1. Të besojë se ajo është shkak dhe bën dobi vetëm me lejen e Allahut. 2. Të bazohet në Kuran, në emrat dhe cilësitë e Allahut, në lutjet profetike dhe në lutjet e

ligjshme. 3. Të jetë në gjuhë të kuptueshme dhe të mos përmbajë fjalë të pakuptueshme dhe magji.

(5273)

(33) - عَنْ بَعْضِ أَزْوَاجِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ أَتَى عَرَّافًا فَسَأَلَهُ عَنْ شَيْءٍ لَمْ تُقْبَلْ لَهُ صَلَاةٌ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً». [صحيح] - [رواه مسلم]

(33) - Një grua e Profetit ﷺ tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Atij që shkon te fatthënësi dhe e pyet për diçka, nuk do t'i pranohet namazi dyzet ditë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na njofton se kushdo që shkon te ndonjë fatthënës (ar. el arraf), që është një emër i përgjithshëm për falltarin, astrologun, atë që shikon në rërë e të ngjashëm, të cilët argumentojnë për njohjen e së fshehtës me anë të premisave që ata i përdorin, thjesht të pyeten për diçka nga çështjet e fshehta, bën që Allahu ta privojë atë nga shpërblimi i namazit për dyzet ditë, që është si dënim për këtë mëkat të madh.

Mësim nga hadithi:

1. Falli është haram dhe shkuarja te falltarët e pyetja e tyre rreth gjërave të fshehta.

2. Njeriu mund të privohet nga shpërblimi i adhurimit, si ndëshkim për shkak të ndonjë gjynahu të bërë.
3. Në ndalesën e përmendur në hadith bën pjesë horoskopi dhe shikimi në të, leximi i pëllëmbës e filxhanit, qoftë dhe thjesht për informacion, sepse e tërë kjo është prej tregimit të fatit dhe nga pretendimi i njohjes së të fshehtës.
4. Nëse ky është dënimi për atë që shkon te fatthënësi, ç'mund të thuhet për dënimin e vetë fatthënësit?!
5. Namazi që është falur përgjatë dyzet ditëve llogaritet i kryer, nuk duhet kompensuar, por nuk ka shpërblim për të.

(5986)

(34) - عَنْ ابْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّهُ سَمِعَ رَجُلًا يَقُولُ: لَا وَالْكَعْبَةِ، فَقَالَ ابْنُ عُمَرَ: لَا يُحْلَفُ بِغَيْرِ اللَّهِ، فَإِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ حَلَفَ بِغَيْرِ اللَّهِ فَقَدْ كَفَرَ أَوْ أَشْرَكَ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

(34) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se dëgjoi një njeri duke thënë: "Jo, pasha Qabenë!" Në atë rast Ibn Omeri tha: "Nuk bën të betohet në dikë a diçka tjetër përveç Allahut. Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Ai që betohet në dikë a diçka tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër ose shirk." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se kushdo që betohet në dikë tjetër përveç Allahut, pra përveç emrave dhe cilësive të Tij, ka mohuar Allahun (ka bërë kufër) ose ka bërë shirk, sepse betimi nënkupton madhërimin e atij që betohet në të, e madhështia është vetëm për Allahun. Andaj, betimi bëhet vetëm në Allahun, në emrat dhe në cilësitë e Tij. Ky betim është shirk i vogël (që nuk e nxjerr njeriun nga feja), por, nëse ai që betohet, e madhëron atë për të cilin betohet ashtu siç madhërohet Allahu, ose më shumë, atëherë konsiderohet prej shirkut të madh (që e nxjerr njeriun nga feja).

Mësime nga hadithi:

1. Madhërimi i dikujt duke u betuar në emër të tij është një e drejtë ekskluzive e Allahut të Madhëruar, andaj betimi bëhet në Allahun, në emrat dhe në cilësitë e Tij.
2. Kujdesi që tregonin sahabët për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar të keqen, veçanërisht kur e keqja kishte të bënte me shirkun a kufrin.

(3359)

(35) – عَنْ بُرَيْدَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ

حَلَفَ بِالْأَمَانَةِ فَلَيْسَ مِنَّا». [صحيح] - [رواه أبو داود وأحمد]

(35) – Burejde (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që betohet në amanet, nuk është prej nesh.” [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ndaloi dhe paralajmëroi kundër betimit në amanet (besë), duke thënë se kush e bën këtë, nuk është prej nesh.

Mësim nga hadithi:

1. Është e ndaluar të betohesh në dikë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, dhe në këtë përfshihet edhe betimi në emër të amanetit (besës), sepse kjo konsiderohet vepër e shirkut të vogël.
2. Amaneti përfshin nënshtrimin, adhurimin, kaparin, pasurinë dhe sigurinë.
3. Betimi nuk është i vlefshëm dhe as detyrues, përveç nëse bëhet në emër të Allahut të Lartësuar ose në një nga emrat apo cilësitë e Tij.
4. Hatabiu ka thënë: "Mospëlqimi këtu ka të ngjarë të jetë i bazuar në urdhrin e tij, që betimi të bëhet vetëm në emër të Allahut dhe cilësive të Tij, ndërsa amaneti nuk është prej cilësive të Tij, por është një nga urdhrat e Tij dhe një prej gjërave që Ai i ka bërë

obligim. Prandaj ata janë të ndaluar nga ky veprim, sepse kjo nënkupton barazimin e amanetit me emrat dhe cilësitë e Allahut të Lartmadhëruar."

(8964)

(36) - عَنْ أَبِي مُوسَى الْأَشْعَرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: أَتَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي رَهْطٍ مِنَ الْأَشْعَرِيِّينَ اسْتَحْمِلُهُ، فَقَالَ: «وَاللَّهِ لَا أَحْمِلُكُمْ، مَا عِنْدِي مَا أَحْمِلُكُمْ» ثُمَّ لَبِثْنَا مَا شَاءَ اللَّهُ فَأُتِيَ بِإِبِلٍ، فَأَمَرَ لَنَا بِثَلَاثَةِ دَوْدٍ، فَلَمَّا انْطَلَقْنَا قَالَ بَعْضُنَا لِبَعْضٍ: لَا يُبَارِكُ اللَّهُ لَنَا، أَتَيْنَا رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَسْتَحْمِلُهُ فَحَلَفَ أَنْ لَا يَحْمِلَنَا فَحَمَلَنَا، فَقَالَ أَبُو مُوسَى: فَأَتَيْنَا النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَذَكَّرْنَا ذَلِكَ لَهُ، فَقَالَ: «مَا أَنَا حَمَلْتُكُمْ، بَلِ اللَّهُ حَمَلَكُمْ، إِنِّي وَاللَّهِ -إِنْ شَاءَ اللَّهُ- لَا أَحْلِفُ عَلَى يَمِينٍ، فَأَرَى غَيْرَهَا خَيْرًا مِنْهَا، إِلَّا كَفَرْتُ عَنْ يَمِينِي، وَأَتَيْتُ الَّذِي هُوَ خَيْرٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(36) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Unë, së bashku me disa pjesëtarë të fisit eshari, shkuam tek i Dërguari i Allahut ﷺ për t'i kërkuar të na jepte kafshë bartëse (për luftë), por ai tha: “Betohem në Allahun se nuk do t'ju marr me vete, por as kam me se t'ju bart.” Pastaj pritëm aq sa deshi Allahu të prisnim dhe, kur të Dërguarit të Allahut ﷺ i sollën disa deve, ai na i dha tri kokë të majme. Kur u nisëm për rrugë, thamë: "Betohemi në Allahun se Ai nuk do të na japë bereqet, sepse shkuam dhe i kërkuam Profetit ﷺ të na japë kafshë bartëse, por ai na u betua se nuk do të na i japë, megjithatë na i dha. Andaj, u

kthyem te Profeti ﷺ dhe ia përmendëm. Ai na tha: “Nuk ju mora unë, por Allahu jua mundësoi të vini. Betohem në Allahun se, me lejen e Tij, sa herë që betohem për diçka, ndërkohë kuptoj se ka një zgjidhje më të mirë, e shpaguaj betimin tim. Pra, veproj atë që është më e mira, pastaj e shpaguaj betimin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se së bashku me një grup nga fisi i tij shkuan tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe qëllimi i tyre ishte që Profeti ﷺ t'u japë deve që të hipnin në to, për të qenë në gjendje të merrnin pjesë në xhihad. Profeti ﷺ u betua se nuk do t'ua jepte, se nuk kishte çfarë t'u jepte. Kështu, ata u kthyen dhe qëndruan pak, pastaj tri deve i sollën te Profeti ﷺ dhe ai ua dërgoi. Ata thënë: "Allahu nuk do të çojë bekim në këto deve, sepse Profeti ﷺ u betua se nuk do të na i japë." Prandaj, vajtën tek ai dhe e pyetën: Atëherë Profeti ﷺ u tha: "Ai që ua dha është Allahu i Lartësuar, sepse Ai është që ka dhënë sukses dhe furnizim, por unë jam shkak që kjo të ndodhë përmes duarve të mia. Pastaj Profeti ﷺ u tha: "Betohem në Allahun se, me lejen e Tij, sa herë që betohem për të bërë diçka ose për të mos e bërë, dhe shoh se diçka tjetër përveç atij betimi është më e mirë dhe më me vlerë se ajo, e veproj atë që është më e mira dhe e braktis atë për të cilën jam betuar dhe shlyej betimin tim.

Mësime nga hadithi:

1. Lejohet betimi pa të kërkuar dikush që të betohesh, për ta konfirmuar kështu lajmin, edhe nëse është për të ardhmen.
2. Lejohet që pas betimit të bëhet përjashtim duke thënë: "Me lejen e Allahut." Nëse përjashtimi (duhet thënë: inshaallah - me lejen e Allahut) bëhet me nijetin së bashku me betimin dhe lidhet me të, atëherë nuk kërkohet shlyerje nga ai që e thyen betimin.
3. Inkurajimi për të thyer betimin, nëse sheh diçka më të mirë se ai dhe për ta shlyer betimin e tij më pas.

(2961)

(37) - عَنْ حُذَيْفَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا تَقُولُوا: مَا شَاءَ اللَّهُ وَشَاءَ فُلَانٌ، وَلَكِنْ قُولُوا: مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ شَاءَ فُلَانٌ». [صحيح بمجموع طرقه] - [رواه أبو داود والنسائي في الكبرى وأحمد]

(37) – Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Mos thoni: "Siç dëshiron Allahu dhe siç dëshiron filani!", por thoni: "Siç dëshiron Allahu, pastaj siç dëshiron filani!" [صحيح بمجموع طرقه] - [رواه أبو داود والنسائي في الكبرى وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ndaloi që muslimani të thotë gjatë të folurit të tij: "Siç dëshiron Allahu dhe siç dëshiron filani!" Ose: "Siç dëshiron Allahu dhe filani!!" Kjo është për shkak se dëshira dhe vullneti i Allahut janë absolut, ku askush nuk është bashkëpjesëmarrës me Të në to. Kur të përdoret lidhëza "dhe" - (ar. ve), lë për të kuptuar bashkëpjesëmarrjen e ndokujt me Allahun ose barazimin mes tyre. Por, të thotë: "Siç dëshiron Allahu, pastaj siç dëshiron filani!" Kësisoj, dëshirën e njeriut e bën pasuese të dëshirës së Allahut, me ndajfoljen "pastaj", - (ar. thumme), në vend të lidhëzës "dhe", për faktin se ndajfolja "pastaj" tregon për diçka që vjen dhe e pason një gjë më pas.

Mësime nga hadithi:

1. Është haram të thuhet: "Çfarë dëshiroi Allahu dhe deshe ti!" e shprehje të ngjashme që tregojnë lidhjen me emrin e Allahut përmes lidhëzës "dhe", sepse kjo është formë shirku (idhujtarie) në shprehje dhe në fjalë.
2. Është e lejuar të thuhet: "Siç dëshiron Allahu e pastaj siç dëshiron ti!", dhe shprehje të ngjashme që tregojnë lidhjen me emrin e Allahut përmes ndajfoljes "pastaj", sepse kështu e ndaluarra mënjanohet.

3. Pohimi i dëshirës së Allahut dhe pohimi i dëshirës së njeriut dhe se dëshira e këtij të fundit është pasuese e dëshirës së Allahut të Lartësuar.
4. Është e ndaluar që njerëzit të bëhen ortakë me Allahun në dëshirën e Tij, qoftë dhe verbalisht.
5. Nëse ai që e barazon dëshirën e Allahut me dëshirën e ndonjë krijese në të shprehur beson se dëshira e njeriut është sikurse dëshira e Allahut të Lartmadhëruar, respektivisht e barabartë me të në gjithëpërfshirje e përgjithësim, ose se njeriu ka dëshirë të pavarur, atëherë kjo është shirk i madh, e, nëse beson se është poshtë kësaj, atëherë është shirk i vogël.

(3352)

(38) - عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ لَبِيدٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ أَخَوْفَ مَا أَخَافُ عَلَيْكُمُ الشِّرْكَ الْأَصْغَرَ» قَالُوا: وَمَا الشِّرْكَ الْأَصْغَرُ يَا رَسُولَ اللَّهِ؟ قَالَ: «الرِّيَاءُ، يَقُولُ اللَّهُ عز وجل لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِذَا جُزِيَ النَّاسُ بِأَعْمَالِهِمْ: اذْهَبُوا إِلَى الَّذِينَ كُنْتُمْ تُرَاوُونَ فِي الدُّنْيَا، فَاَنْظُرُوا هَلْ تَجِدُونَ عِنْدَهُمْ جَزَاءً؟». [حسن] - [رواه أحمد]

(38) – Mahmud ibën Lebidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Vërtet gjëja që kam më shumë frikë për ju është shirku i vogël.” Të pranishmit i thanë: “Çfarë është shirku i vogël, o i Dërguari i Allahut?” Profeti ﷺ tha: “Syefaqësia. Allahu i

Lartmadhëruar do t'u thotë atyre në Ditën e Kiametit, kur njerëzit do të shpërblehen për veprat e tyre: "Shkoni tek ata për të cilët bënit syfaqësi në këtë botë dhe shihni se a do të gjeni ndonjë shpërblim tek ata!" [Hadith hasen] - [E shënon Ahmedi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se gjëja që frikësohet më shumë për umetin e tij është shirku i vogël, respektivisht syfaqësia: që të veprojë për shkak të njerëzve. Pastaj tregoi për dënimin e atyre që bëjnë syfaqësi në Ditën e Kiametit, se do t'u thuhet: "Shkoni tek ata për të cilët keni vepruar dhe shihni nëse ata kanë fuqi t'ju shpërblejnë dhe t'ju japin shpërblim për veprat që i keni bërë?!"

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim që veprat t'i bëjmë singërisht për Allahun e Lartmadhëruar dhe të kemi kujdes nga syfaqësia.
2. Dhembshuria e madhe e Profetit ﷺ për umetin e tij dhe kujdesi i tij për udhëzimin dhe këshillimin e tyre.
3. Nëse kjo ishte frika e Profetit ﷺ teksa u drejtohej sahabëve, të cilët ishin zotërinjtë e të devotshmëve, atëherë frika për ata pas tyre duhet qenë edhe më e madhe.

(39) - عَنْ أَبِي ذَرٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «لَا يَرِي رَجُلٌ رَجُلًا بِالْفُسُوقِ، وَلَا يَرْمِيهِ بِالْكُفْرِ، إِلَّا ارْتَدَّتْ عَلَيْهِ، إِنْ لَمْ يَكُنْ صَاحِبُهُ كَذَلِكَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(39) – Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Nuk ndodh që dikush ta etiketojë tjetrin si mëkatar e as ta etiketojë me kufër, e kjo të mos i kthehet vetë atij, nëse i etiketuari nuk është i tillë.”

[Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka paralajmëruar se kush i thotë një personi tjetër: "Ti je mëkatar (ar. fasik)." Ose: "Ti je jobesimtar." Nëse ky person nuk është ashtu siç tha ai, atëherë ky përshkrim i kthehet atij që e tha. Mirëpo, nëse ai person është ashtu siç u tha, atëherë nuk ka gjynah mbi atë që e tha, sepse ka folur të vërtetën.

Mësim nga hadithi:

1. Është e ndaluar ta etiketosh një musliman për mosbesim apo mëkat pa arsye të lejuar nga feja.
2. Verifikimi është i detyrueshëm para se të jepen gjykime për njerëzit (muslimanët).
3. Ibn Dekik Idi thënë: “Ky është një kërcënim i rëndë për atë që e akuzon padrejtësisht një musliman për

mosbesim (duke e bërë tekfir), gjë që është një rrezik i madh.”

4. Ibën Haxher Askalaniu ka thënë: “Fakti që ai nuk bëhet automatikisht mëkatar apo jobesimtar (kur ta etiketojë padrejtësisht), nuk do të thotë se nuk është mëkatar, kur i thotë tjetrit: "Ti je mëkatar"; përkundrazi, kjo çështje kërkon sqarim të hollësishëm. Nëse ai e ka për qëllim këshillimin e tij apo të të tjerëve duke sqaruar gjendjen e tij, atëherë kjo është e lejuar. Por nëse e ka për qëllim fyerjen, turpërimin dhe ofendimin e tij, atëherë kjo është e ndaluar, sepse ai është i urdhëruar t'i fshehë mangësitë e tij dhe ta mësojë e ta këshillojë në mënyrën më të bukur. Prandaj, kurdo që mund ta realizojë këtë në mënyrë të butë, nuk i lejohet ta bëjë në mënyrë të ashpër, sepse mund të bëhet shkak që ai të sprovohet dhe të këmbëngulë në atë vepër, sepse shumë njerëz natyrshëm veprojnë kështu me ata që janë të ashpër. E sidomos e refuzojnë urdhrin kur ai vjen nga dikush që është më poshtë se ata në pozitë.”

(8883)

(40) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «اِئْتَنَانِ فِي النَّاسِ هُمَا بِهِمْ كُفْرٌ: الظُّعْنُ فِي النَّسَبِ، وَالتِّيَاحَةُ عَلَى الْمَيِّتِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(40) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Dy gjëra, nëse gjenden ndër njerëz, janë kufër (mosbesim): Fyerja e prejardhjes dhe vajtimi për të vdekurin.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon për dy cilësi të njerëzve që janë nga veprat e jobesimtarëve dhe morali i injorancës (xhahilijetit), e ato janë:

E para: Fyerja e prejardhjes së njerëzve, nënvlerësimi dhe mendjemadhësia ndaj tyre.

E dyta: Ngritja e zërit gjatë fatkeqësisë si shenjë pakënaqësie ndaj kaderit (përcaktimit të Allahut) ose shqyerja e rrobave nga dëshpërimi i madh.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për thjeshtësi dhe modesti ndaj njerëzve.
2. Është obligim të durojmë gjatë fatkeqësisë dhe të mos shfaqim pakënaqësi.
3. Këto vepra janë nga kufri i vogël, kështu që, ai që kryen një prej degëve të kufrit (të vogël) nuk bëhet jobesimtar me atë lloj kufri që e nxjerr nga feja,

derisa ta kryejë kufrin e madh (që e nxjerrë prej fesë).

4. Islami e ndalon çdo gjë që çon në përçarje mes muslimanëve, siç është fyerja e prejardhjes dhe të ngjashme me të.

(6361)

(41) - عَنْ أَبِي مَرْثَدٍ الْعَنَوِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ

وَسَلَّمَ: «لَا تَجْلِسُوا عَلَى الْقُبُورِ، وَلَا تُصَلُّوا إِلَيْهَا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(41) – Ebu Merthed Ganeviu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Mos u ulni mbi varre e mos u falni në drejtim të tyre!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e ka ndaluar uljen mbi varre.

Gjithashtu e ndaloi faljen në drejtim të varreve, pra, që varri të jetë në drejtim të kibles së namazliut, sepse kjo është mjet drejt shirkut (idhujtarisë).

Mësime nga hadithi:

1. Është e ndaluar falja e namazit në varre, mes tyre ose në drejtim të tyre, me përjashtim të namazit të xhenazes, siç është vërtetuar një gjë e tillë në sunet (udhëzimin profetik).

2. Ndalimi i faljes së namazit te varrret është për t'i mbyllur shtigjet që çojnë drejt shirkut (idhujtarisë).
3. Islami e ndaloi teprimin në raport me varret dhe nënçmimin e tyre, kështu që nuk ka teprim e as cungim.
4. Pacenushmëria e muslimanit të vdekur mbetet edhe pasi të ndërrojë jetë. Këtë e mbështet hadithi i Profetit ﷺ: "Thyerja e eshtrave të të vdekurit është sikur t'i thyhen duke qenë gjallë."

(10647)

(42) - عَنْ أَبِي طَلْحَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا تَدْخُلُ الْمَلَائِكَةُ بَيْتًا فِيهِ كَلْبٌ وَلَا صُورَةٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(42) – Ebu Talhai (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Melekët nuk hyjnë në atë shtëpi që ka qen ose piktura (frymorësh).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se melekët e mëshirës nuk hyjnë në atë shtëpi ku ka qen ose ndonjë pikturë të qenieve të gjalla. Kjo, se piktura e diçkaje që ka frymë është një mëkat i rëndë, se përmban imitim të krijimit të Allahut dhe është mjet drejt shirkut. Madje, disa prej tyre janë piktura që adhurohen në vend të Allahut. Sa i përket arsyes

së abstenimit të tyre nga një shtëpi ku ka qen, është për faktin se ai ha shumë papastërti dhe për shkak se disa prej tyre quhen shejtanë, ndërkohë melekët janë kundër shejtanëve. Dhe se qeni mban erë të keqe, ndërsa melekët e urrejnë erën e keqe... Rrjedhimisht, ai që i mban këto piktura, ndëshkohet në atë formë që melekët e mëshirës privohen të hyjnë në shtëpinë e tij, të falen aty, të kërkojnë falje për të, të luten për bekim për të dhe për shtëpinë e tij e për ta larguar dëmin e shejtanit prej tij.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalohet mbajtja e qenit, përveç qenit të gjuetisë, bagëtisë ose të fermës.
2. Përvetësimi i pikturave (me qenie të gjalla) është një nga gjërat e shëmtura, nga të cilat melekët zbrapsen dhe prania e tyre në një vend shkakton privim nga mëshira dhe i tillë është rasti me qenin.
3. Melekët që nuk hyjnë në shtëpi ku ka qen ose figura frymorësh janë melekët e mëshirës. Por, sa u përket melekëve mbrojtës dhe të tjerëve që janë të ngarkuar me ndonjë mision, si: meleku i vdekjes, atëherë ata hyjnë në çdo shtëpi.
4. Është haram të vendosen në mur ose diku tjetër fotografite me figura frymorësh.
5. Hatabi ka thënë: "Pra, melekët nuk hyjnë në atë shtëpi ku ka qen ose figura që janë ndaluar të mbahen, ndërsa qentë që nuk janë të ndaluar, bie

fjala, qeni i gjuetisë, fermës, bagëtive, si dhe figurat që përdoren në qilima, jastëkë dhe gjëra të tjera, melekët nuk pengohen të hyjnë për shkak të tyre."

(8950)

(43) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا تَصْحَبُ الْمَلَائِكَةَ رُفْقَةً فِيهَا كَلْبٌ وَلَا جَرَسٌ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(43) – Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Melekët nuk e shoqërojnë atë grup të njerëzve që kanë qen apo këmborë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka njoftuar se melekët nuk e shoqërojnë atë grup të udhëtarëve, të cilët kanë me vete qen apo këmborë të varur në qafën e bagëtisë, që lëshon tinguj kur lëviz.

Mësim nga hadithi:

1. Ndalimi i mbajtjes së qenve dhe marrjes së tyre me vete në udhëtim. Nga ndalesa përjashtohen qeni i gjahut dhe qeni që bën roje.
2. Melekët që refuzojnë të shoqërohen me këta njerëz janë melekët e mëshirës, ndërsa melekët roje nuk ndahen nga njerëzit kudo që të jenë ata, në vendbanimet e tyre apo në udhëtim.

3. Ndalimi i këmborës, ngase ajo konsiderohet si fyell i djallit dhe ka ngjashmëri me kambanën e të krishterëve.
4. Muslimani duhet të ruhet nga çdo gjë që i mban melekët larg tij.

(8951)

(44) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يَأْتِي الشَّيْطَانُ أَحَدَكُمْ فَيَقُولُ: مَنْ خَلَقَ كَذَا؟ مَنْ خَلَقَ كَذَا؟ حَتَّى يَقُولَ: مَنْ خَلَقَ رَبَّكَ؟ فَإِذَا بَلَغَهُ فَلْيَسْتَعِذْ بِاللَّهِ وَلْيَنْتِهِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(44) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Shejtani i shkon ndokujt dhe i thotë: "Kush e ka krijuar këtë? Kush e ka krijuar atë?" Derisa t'i thotë: "Kush e ka krijuar Zotin tënd?" Nëse arrin deri aty, atëherë (njeriu) le të kërkojë mbrojtjen e Allahut dhe le të ndalet së menduari (këto gjëra).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ në këtë hadith na tregon ilaçin efektiv ndaj pyetjeve që shejtani ia pëshpërit besimtarit. Pastaj shejtani i thotë: "Kush e krijoi këtë? Kush e krijoi atë? Kush e krijoi Qiellin? Kush e krijoi Tokën?" Besimtari i përgjigjet i shtyrë nga feja, natyrshmëria e pandryshuar dhe arsyeja (e shëndoshë), duke thënë: "Allahu." Por, shejtani

nuk ndalet në këtë pikë të pëshpëritjes (vesveseve), por, përkundrazi, vazhdon derisa të thotë: "Kush e krijoi Zotin tënd?" Pastaj besimtari ia pengon këtë pëshpëritje (vesvese) me tri gjëra:

Me besimin në Allahun.

Me kërkimin mbrojtje prej Allahut kundër shejtanit.

Duke u ndaluar dhe duke mos ua vënë veshin pëshpëritjeve (vesveseve).

Mësim nga hadithi:

1. Shmangia e pëshpëritjeve (vesveseve) dhe rreziqeve të shejtanit, duke mos menduar për to dhe duke iu drejtuar Allahut të Lartësuar për t'i larguar ato.
2. Çdo pëshpëritje (vesvese) që bie në zemrën e njeriut, që është në kundërshtim me fenë, është prej shejtanit.
3. Ndalimi i meditimit rreth Qenies së Allahut dhe nxitja për meditimin rreth krijesave dhe argumenteve të Tij.

(65013)

(45) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ قَالَ: مَنْ عَادَى لِي وَلِيًّا فَقَدْ آذَنْتُهُ بِالْحَرْبِ، وَمَا تَقَرَّبَ إِلَيَّ عَبْدِي بِشَيْءٍ أَحَبَّ إِلَيَّ مِمَّا افْتَرَضْتُ عَلَيْهِ، وَمَا يَزَالُ عَبْدِي يَتَقَرَّبُ إِلَيَّ بِالتَّوَافِلِ حَتَّى أُحِبَّهُ، فَإِذَا أَحْبَبْتُهُ: كُنْتُ سَمْعَهُ الَّذِي يَسْمَعُ بِهِ، وَبَصَرَهُ الَّذِي يُبْصِرُ بِهِ، وَيَدَهُ الَّتِي يَبْطِشُ بِهَا، وَرِجْلَهُ الَّتِي يَمْشِي بِهَا، وَإِنْ سَأَلَنِي لَأُعْطِيَنَّهُ، وَلَئِنْ اسْتَعَاذَنِي لَأُعِيذَنَّهُ، وَمَا تَرَدَّدْتُ عَنْ شَيْءٍ أَنَا فَاعِلُهُ تَرَدُّدِي عَنْ نَفْسِ الْمُؤْمِنِ، يَكْرَهُ الْمَوْتَ وَأَنَا أَكْرَهُ مَسَاءَتَهُ».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(45) – Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Allahu i Madhëruar ka thënë: "Unë i shpall luftë atij që shfaq armiqësi ndaj mikut Tim! Veprat më të dashura me të cilat më afrohet robi Im, janë ato të cilat Unë ia kam bërë detyrim atij. Robi im më afrohet vazhdimisht, duke kryer vepra nafile (vullnetare), derisa Unë ta dua atë. E kur Unë ta dua atë, atëherë do të bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën godet, këmba e tij me të cilën ecën dhe nëse ai më kërkon diçka, do t'ia jap atë e nëse më kërkon ta mbroj, do ta mbroj atë. Unë nuk ngurroj për asnjë punë sa ç'ngurroj të marr shpirtin e një besimtari, sepse ai e urren vdekjen dhe Unë urrej t'i bëj keq atij". [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Përmes këtij hadithi kudsi Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka njoftuar se Allahu i Madhëruar ka thënë se Ai që

lëndon dikë nga miqtë e Mi, e zemëron dhe e urren atë, Unë i shpall armiqësinë Time atij.

Miku i Zotit është besimtari i devotshëm. Niveli i miqësisë së njeriut me Allahun është sipas besimit dhe devotshmërisë së tij. Ajo që e afron njeriun më së tepërmi me Zotin e tij është ajo që Ai ia ka bërë të detyrueshme, si: bërja e punëve të mira dhe largimi nga punët e këqia. Nëse njeriu vazhdon t'i afrohet Zotit të tij me punë vullnetare, duke i bërë dhe punët e detyrueshme, atëherë ai fiton dashurinë e Allahut. E kur Allahu ta dojë atë, atëherë Ai ia drejton atij këto katër gjymtyrë:

I drejton dëgjimin e ai dëgjon vetëm ato fjalë që kënaqin Allahun.

I drejton shikimin e ai sheh vetëm atë që Allahu do dhe pëlqen të shihet.

I drejton dorën e ai bën me dorën e tij vetëm atë që i pëlqen Allahut.

I drejton këmbën e ai shkon vetëm atje ku i pëlqen Allahut dhe vetëm te punët e mira.

Veç kësaj, nëse Ai i kërkon diçka Allahut, Ai ia jep atë atij. Kështu, ai bëhet njeri që i pranohet lutja. E nëse kërkon mbrojtjen e Allahut, Ai e mbron atë nga gjërat që i frikësohet.

Mandej Allahu i Madhëruar thotë se Unë nuk ngurroj për diçka që do e bëj, aq sa ngurroj kur i marr shpirtin besimtarit. Më dhimbset, ngase ai nuk e pëlqen vdekjen prej dhimbjeve të saj. Kështu, Allahut nuk i pëlqen ajo që i shkakton dhimbje besimtarit.

Mësime nga hadithi:

1. Ky është prej haditheve që Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e përcjell nga Zoti i tij. Ky lloj i hadithit quhet hadith kudsi ose hadith hyjnor. Teksti dhe domethënia e tij janë prej Allahut të Madhëruar, vetëm se ai nuk i plotëson veçoritë e Kuranit që e dallojnë atë nga tekstet e tjera fetare, si: leximi i tij është adhurim, pastërtia është kusht për ta prekur dhe është mrekulli sfiduese... etj.
2. Ndalimi i lëndimit të miqve të Allahut dhe nxitja për t'i dashur ata dhe për të pranuar meritat e tyre.
3. Urdhëresa e armiqësimit me armiqtë e Allahut dhe ndalesa e miqësimit me ta.
4. Ai që pretendon se është mik i Allahut, duke mos e zbatuar legjislacionin e Tij, është gënjeshtar në atë që pretendon.
5. Miqësia e Allahut arrihet përmes kryerjes së punëve të detyrueshme dhe lënies së punëve të ndaluara.
6. Një prej shkaqeve të dashurisë së Allahut për robin e Tij dhe të pranimi të lutjeve është kryerja e punëve të mira, pasi të ketë kryer punët e detyrueshme dhe të ketë lënë gjërat e ndaluara.
7. Ky hadith dëshmon për finikërinë e miqve të Allahut dhe për pozitën e tyre të lartë.

(46) - عن العِرْبَاضِ بن سارية رضي الله عنه قال: قام فينا رسول الله صلى الله عليه وسلم ذات يوم، فَوَعظَنَا مَوْعِظَةً بليغةً وَجِلْتُ منها القلوبُ، وَدَرَفْتُ منها العيونُ، فقليل: يا رسول الله، وعظمتنا موعظةٌ مُودِّعٌ فاعهد إلينا بعهد. فقال: «عليكم بتقوى الله، والسمع والطاعة، وإن عبدًا حبشيًّا، وسترون من بعدي اختلافًا شديدًا، فعليكم بسنتي وسنة الخلفاء الراشدين المهديين، عَصُوا عليها بالنواجذ، وإياكم والأمر المحدثات، فإن كل بدعة ضلالة». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(46) - Irbad ibën Sarije (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ u ngrit dhe na këshilloi me një këshillë drithëruese, që na i tronditi zemrat e na i përloti sytë. Atëherë ne i thamë: "O i Dërguari i Allahut, këto fjalë po na duken sikur janë këshillë lamtumirëse, andaj na porosit!" Ai tha: "Ju porosis të keni frikë Allahun dhe të jeni të dëgjueshëm e të bindur, edhe nëse ju bëhet prijës ndonjë rob abisinas. Pas meje do të shihni kundërshti të shumta, andaj kapuni fort pas traditës sime dhe traditës së kalifëve të drejtë e të përudhur, shtrëngojeni me dhëmballë dhe ruajuni nga gjërat e shpikura, sepse çdo bidat është lajthitje." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i këshilloi shokët e tij me një këshillë drithëruese, prej së cilës zemrat u tronditën dhe sytë u përlotën. Atëherë ata i thanë: "O i Dërguari i Allahut, këto fjalë po na duken sikur janë këshillë lamtumirëse!" Kjo, pasi

panë se Profeti ﷺ i këshilloi drithërueshëm, prandaj kërkuan një porosi që t'i përmbahen asaj. Profeti ﷺ u tha: "Ju porosis që ta keni frikë Allahun e Lartmadhëruar, duke i kryer obligimet dhe duke i braktisur gjërat e ndaluara, të jeni të dëgjueshëm dhe të bindur, pra, ndaj prijësve, edhe nëse një rob bëhet prijës (i vendit) ose udhëheqës (për ndonjë çështje të veçantë), respektivisht edhe nëse njeriu më i ulët bëhet prijës për ju, mos u zbrapsni nga kjo dhe bindjuni atij, nga frika se ndodhin fitne (trazira e telashe), sepse kushdo nga ju që jeton do të shohë kundërshti të shumta. Pastaj ai ua shpjegoi atyre rrugën e daljes nga kjo kundërshti, pra, duke u kapur fort pas traditës së tij dhe traditës së kalifëve të drejtë e të udhëzuar pas tij: Ebu Bekër Sidikut, Omer ibn Hatabit, Othman ibn Afanit dhe Ali ibn Ebu Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!) dhe shtrëngimi i saj me dhëmballë. Me këtë kishte për qëllim të jemi të përpiktë duke u kapur fort për të. Po ashtu ua tërhoqi vërejtjen nga çështjet e shpikura dhe bidatet (risitë) në fe, sepse çdo bidat është devijim.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e të kapurit fort për traditën profetike (sunetin) dhe pasimi i saj.
2. Kujdesi për dhënien e këshillave dhe zbutjen e zemrave të të tjerëve.
3. Urdhri për ndjekjen e katër kalifëve të drejtë e të udhëzuar pas Profetit ﷺ, që janë: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

4. Ndalimi i bidatit (risive) në fe dhe se të gjitha bidatet janë devijim.
5. Dëgjimi dhe bindja ndaj atyre që i kanë në dorë çështjet e muslimanëve (prijësit) bëhet në gjëra që nuk përbëjnë mëkatim (ndaj Allahut).
6. Rëndësia e frikës ndaj Allahut të Lartmadhëruar (devotshmërisë) në çdo kohë dhe në çdo gjendje.
7. Kundërshtitë do të ndodhin te muslimanët e, kur të ndodhin, duhet të kthehemi te tradita profetike dhe te tradita e kalifëve të drejtë.

(65057)

(47) - عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم أنه قال: «مَنْ خَرَجَ مِنَ الطَّاعَةِ، وَفَارَقَ الْجَمَاعَةَ فَمَاتَ، مَاتَ مِيتَةً جَاهِلِيَّةً، وَمَنْ قَاتَلَ تَحْتَ رَايَةِ عِمِّيَّةٍ، يَغْضَبُ لِعَصْبَةٍ، أَوْ يَدْعُو إِلَى عَصْبَةٍ، أَوْ يَنْصُرُ عَصْبَةً، فَقُتِلَ، فَقِتْلُهُ جَاهِلِيَّةٌ، وَمَنْ خَرَجَ عَلَى أُمَّتِي، يَضْرِبُ بَرَّهَا وَفَاجِرَهَا، وَلَا يَتَحَاشَى مِنْ مُؤْمِنِهَا، وَلَا يَفِي لِذِي عَهْدٍ عَهْدُهُ، فَلَيْسَ مِنِّي وَلَسْتُ مِنْهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(47) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Kush refuzon t'i bindet prijësit dhe largohet nga muslimanët e unifikuar (në të vërtetën) e pastaj vdes në këtë gjendje, vdekja e tij i ngjan vdekjes së periudhës (së injorancës) paraislame. Kush lufton nën një flamur të lajthitur, hidhërohet për shkak të fanatizmit fisnor dhe thërret në këtë fanatizëm, ose e përkrah

fanatizmin, pastaj vritet në këtë gjendje, vrasja e tij i ngjan vrasjes së periudhës (së injorancës) paraislame. Kush ngrihet kundër umetit tim (të unifikuar që i janë besatuar prijësit), duke sulmuar e vrarë si të keqin ashtu dhe të mirin, duke mos e kursyer fare besimtarin dhe duke mos e mbajtur besatimin me atë (prijës) që i janë besatuar, të tillët nuk janë në mësimet dhe udhëzimin tim, si dhe mësimet e udhëzimi im s'janë me ta.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, kush refuzon t'i bindet prijësit dhe largohet nga muslimanët e unifikuar (në të vërtetën) për t'ia dhënë besën prijësit dhe vdes në këtë gjendje, duke refuzuar dhe duke qenë larg bindjes, vdes sikur ata të periudhës së injorancës (para se të vinte Profeti), të cilët nuk i bindeshin asnjë prijësi dhe nuk i bashkoheshin asnjë grupi të vetëm, por, përkundrazi, ishin sekte dhe banda që luftonin njëra-tjetrën.

Po ashtu Profeti ﷺ tregoi se, kushdo që lufton nën një flamur, në të cilin nuk mund të dallohet e vërteta nga e pavërteta, si dhe zemërohet nga fanatizmi për popullin ose fisin e tij, e jo për ta mbështetur fenë dhe të vërtetën, rrjedhimisht lufton nga fanatizmi e pa mprehtësi dhe dituri, nëse vritet në këtë gjendje, atëherë do të jetë vrasje si në periudhën e injorancës.

Kushdo që rebelohet kundër umetit (islam) të Profetit ﷺ, e kështu i lufton të devotshmit dhe të prishurit nga umeti i tij; nuk e çan kokën se çfarë bën e nuk i frikësohet dënimit

për vrasjen e besimtarëve; nuk i përmbahet besëlidhjes me jobesimtarët ose prijësit, por, përkundrazi, e thyen besëlidhjen e tyre, atëherë ky veprim është një nga mëkatet e mëdha, rrjedhimisht kushdo që e bën këtë, e meriton këtë kërcënim të rëndë.

Mësime nga hadithi:

1. Bindja ndaj prijësit është detyrë, përderisa nuk i bëhet mëkat Allahut të Lartmadhëruar.
2. Në këtë hadith ka paralajmërim të ashpër për ata që nuk i binden imamet (prijësit) dhe largohen nga muslimanët (e unifikuar në të vërtetën), kështu që, nëse vdesin në këtë gjendje, vdekja e tyre i ngjan vdekjes së periudhës (së injorancës) paraislame.
3. Në këtë hadith ka ndalesë që të luftohet për fanatizëm fisnor.
4. Përmbushja e marrëveshjeve është detyrë.
5. Në bindjen (ndaj prijësit) dhe të kapurit për bashkësinë (e unifikur të muslimanëve në të vërtetën) ka shumë të mira, siguri, qetësi dhe përmirësim të gjendjes.
6. Është e ndaluar t'i shëmbëllemë gjendjes së njerëzve të periudhës së injorancës.
7. Ka urdhër për të qëndruar bashkë me bashkësinë (e unifikuar) të muslimanëve (në të vërtetën).

(48) - عَنْ مَعْقِلِ بْنِ يَسَارٍ الْمُرِّي رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: إِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَا مِنْ عَبْدٍ يَسْتَرْعِيهِ اللَّهُ رَعِيَّةً، يَمُوتُ يَوْمَ يَمُوتُ وَهُوَ غَاشٌّ لِرَعِيَّتِهِ، إِلَّا حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(48) – Makil ibn Jesar Muzeniu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "Çdo njeriu, të cilin Allahu e ka bërë përgjegjës për një tufë njerëzish, që vdes duke e mashtruar tufën e vet, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se secilin që Allahu i Lartësuar e ka bërë udhëheqës dhe përgjegjës mbi njerëzit, qoftë ajo udhëheqësi e përgjithshme, si të qenët prijës, qoftë udhëheqësi e veçantë, si burri në shtëpinë e tij dhe një grua në shtëpinë e saj, kështu që tregohet i mangët në të drejtat e tufës së tij: i mashtron dhe nuk tregohet i çiltër me ta, e kështu ua humb të drejtat e fesë dhe të kësaj bote, i tilli e meriton këtë dënim të rëndë.

Mësim nga hadithi:

1. Ky kërcënim nuk është i veçantë për imamin e madh [prijësin kryesor] dhe zëvendësit e tij, por është i përgjithshëm për të gjithë ata që Allahu i ka bërë përgjegjës për një tufë njerëzish.

2. Është obligim për secilin që është caktuar të bëjë diçka në punët e muslimanëve, të jetë i çiltër dhe t'i këshillojë, të përpiket për të përmbushur amanetin dhe të ruhet nga tradhtia.
3. Përgjegjësia e madhe e çdo përgjegjësi të ndonjë tufe njerëzish, qoftë publike, qoftë private, qoftë e madhe, qoftë e vogël.

(5335)

(49) - عَنْ أُمِّ سَلَمَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «سَتَكُونُ أُمَرَاءُ فَتَعْرِفُونَ وَتُنَكِّرُونَ، فَمَنْ عَرَفَ بَرِيءٌ، وَمَنْ أَنْكَرَ سَلِيمٌ، وَلَكِنْ مَنْ رَضِيَ وَتَابَعَ» قَالُوا: أَفَلَا نُقَاتِلُهُمْ؟ قَالَ: «لَا، مَا صَلَّوْا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(49) – Umu Seleme, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të), tregon: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Do të vijnë prijës të cilët do të veprojnë gjëra të lejuara dhe të ndaluara, andaj, ai që i dallon ato, i ka ikur mëkatit, e ai që i kundërshton ato, ka shpëtuar, kurse ai që pajtohet me to dhe i pason (nuk ka shpëtuar)." Thanë: "A t'i luftojmë?" Tha: "Jo, përderisa e falin namazin." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregoi se do të na caktohen prijës, disa vepra të të cilëve i dimë, sepse janë në përputhje me atë që njihet nga feja, si dhe mohojmë disa prej tyre, për

shkak se bien ndesh me fenë. Ai që e urren të keqen me zemrën e tij dhe nuk mund ta ndryshojë është i liruar nga mëkati dhe hipokrizia, ndërsa ai që mund ta ndryshojë atë me dorën ose gjuhën e tij dhe ua tërheq vërejtjen për këtë, atëherë ai është i liruar nga mëkati dhe pjesëmarrja në të. Por, ai që është i kënaqur me veprimet e tyre dhe i pason, do të shkatërrohet ashtu siç u shkatërruan ata.

Pastaj e pyetën Profetin ﷺ: "A nuk duhet t'i luftojmë prijësit që i kanë këto cilësi?" Ai i ndaloi dhe tha: "Jo, përderisa e falin namazin mes jush."

Mësimet nga hadithi:

1. Një nga treguesit e profecisë së Pejgamberit ﷺ është se atij i tregoi Allahu për gjërat e fshehta që do të ndodhnin në të ardhmen dhe ato ndodhnin mu ashtu siç i tregonte ai.
2. Nuk lejohet të kënaqurit me të keqen e as pjesëmarrja në të. Ajo duhet të kundërshtohet.
3. Nëse prijësit shpikin gjëra që bien ndesh me fenë, nuk lejohet t'u bindemi në këtë gjë.
4. Nuk lejohet rebelimi kundër prijësve muslimanë, për shkak të dëmit, gjakderdhjes dhe humbjes së sigurisë që do të rezultojë si pasojë e kësaj. Më e lehtë është t'i durosh të këqijat e prijësve mëkatarë dhe të jesh i durueshëm për dëmin që ata e shkaktojnë (sesa të rebelohesh).

5. Namazi ka pozitë madhështore dhe është dallues mes kufrit dhe Islamit.

(3481)

(50) - عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «سَتَكُونُ أَثَرَةٌ وَأُمُورٌ تُنْكِرُوهَا» قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ فَمَا تَأْمُرُنَا؟ قَالَ: «تُؤَدُّونَ الْحَقَّ الَّذِي عَلَيْكُمْ، وَتَسْأَلُونَ اللَّهَ الَّذِي لَكُمْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(50) – Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Do të përballeni me anashkalim të të drejtave tuaja (nga prijësit) dhe do të shihni gjëra që nuk do t’ju pëlqejnë.” Të pranishmit pyetën: "O i Dërguari i Allahut, çfarë po na porosit, pra?" Ai tha: “T’i kryeni detyrat që ju përkasin dhe t’i kërkoni Allahut atë që ju takon.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregoi se mbi muslimanët do të ketë prijës, të cilët do t’i monopolizojnë pasuritë e muslimanëve dhe punët e tjera të kësaj bote, duke i shpenzuar kështu ato sipas dëshirës dhe duke ua mohuar muslimanëve të drejtën e tyre në raport me to. Ata do të bëjnë gjëra në fe, të cilat nuk janë të mira dhe nuk pëlqehen. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) pyetën se çfarë duhej të bënin në këtë situatë. Kësisoj, Profeti ﷺ u tha atyre se fakti që ata e monopolizojnë pasurinë, nuk ju përligj që ju ta ndaloni atë që e keni të obliguar ta bëni karshi tyre: për t’i

dëgjuar dhe për t'iu bindur. Përkundrazi, jini të durueshëm, dëgjojini, bindjuni dhe mos i kundërshtoni në çështjen (që ju është besuar). Hakun që ju takon juve, kërkojani Allahut, si dhe luteni Allahun që t'i përmirësojë dhe ta largojë të keqen e padrejtësinë e tyre!

Mësime nga hadithi:

1. Hadithi është një nga shenjat e profecisë së Muhamedit ﷺ, sepse ai tregoi se çfarë do të ndodhte në umetin e tij, gjë që ndodhi siç tha.
2. Lejohet që i sprovuari të informohet për fatkeqësinë që pritët ta godasë, që ta qetësojë veten kur ajo ta godasë e të jetë i durueshëm dhe të shpresojë shpërblimin (tek Allahu).
3. Kapja fort për Kuran dhe Sunet është rrugëdalje nga fitnet (sprovat) dhe mospajtimet.
4. Inkurajimi që t'i dëgjojmë dhe t'u bindemi prijësve (muslimanë) në gjëra të mira dhe të mos bëjmë kryengritje kundër tyre, edhe nëse ata bëjnë padrejtësi.
5. Përdorimi i urtësisë dhe pasimit të Sunetit në kohë fitnesh (trazirash).
6. Njeriu duhet ta përmbushë atë që e ka për detyrë, edhe nëse i ndodh ndonjë padrejtësi.

7. Ky hadith ngërthen në vete rregullën fikhore: zgjedh të keqen më të vogël nga dy të këqijat ose dëmin më të vogël nga dy dëmet.

(3156)

(51) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «كُلُّكُمْ رَاعٍ فَمَسْئُولٌ عَنْ رَعِيَّتِهِ، فَالْأَمِيرُ الَّذِي عَلَى النَّاسِ رَاعٍ وَهُوَ مَسْئُولٌ عَنْهُمْ، وَالرَّجُلُ رَاعٍ عَلَى أَهْلِ بَيْتِهِ وَهُوَ مَسْئُولٌ عَنْهُمْ، وَالْمَرْأَةُ رَاعِيَةٌ عَلَى بَيْتِ بَعْلِهَا وَوَلَدِهِ وَهِيَ مَسْئُولَةٌ عَنْهُمْ، وَالْعَبْدُ رَاعٍ عَلَى مَالِ سَيِّدِهِ وَهُوَ مَسْئُولٌ عَنْهُ، أَلَا فَكُلُّكُمْ رَاعٍ وَكُلُّكُمْ مَسْئُولٌ عَنْ رَعِيَّتِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(51) – Nga Abdullah ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Të gjithë ju jeni barinj dhe secili është përgjegjës për tufën e tij. Prijësi i një populli është bari dhe ai është përgjegjës për tufën e tij. Burri është bari i njerëzve të shtëpisë së tij dhe ai është përgjegjës për ta. Gruaja është bareshë e shtëpisë së burrit të saj dhe fëmijëve të tij dhe ajo është përgjegjëse për ta. Skllavi është bari i pasurisë së zotërisë së tij dhe ai është përgjegjës për të. Secili prej jush është bari dhe secili prej jush është përgjegjës për tufën e tij." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se të gjithë muslimanët kanë nga një përgjegjësi në shoqëri dhe ata

duhet të kujdesen dhe ta mbartin atë. Prijësi dhe udhëheqësi janë barinj të atyre që Allahu i ka vendosur në përgjegjësinë e tyre. Andaj ata duhet të ruajnë të drejtat e tyre, t'i mbrojnë nga agresorët, të përballen me armiqtë e tyre dhe të mos i neglizhojnë të drejtat e tyre. Burri është përgjegjës për shpenzimet e jetesës së familjes së tij, për sjelljen e mirë me ta dhe për arsimimin dhe edukimin e tyre. Gruaja është përgjegjëse për menaxhimin e mirë të shtëpisë së burrit të saj dhe edukimin e fëmijëve të tij. Shërbëtori dhe punëtori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së pronarit të tyre që e kanë në menaxhimin e tyre dhe për kryerjen e shërbimeve që i detyrohen atij. Kësisoj, çdo njeri është bari i detyrës që i është ngarkuar dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e saj.

Mësime nga hadithi:

1. Përgjegjësia në shoqërinë muslimane është gjithëpërfshirëse dhe çdo individ ka në supet e veta një përgjegjësi sipas pozicionit, aftësisë dhe detyrës së tij.
2. Femra ka një përgjegjësi të madhe, e cila konsiston në kryerjen e detyrimeve të shtëpisë së burrit të saj dhe detyrave të saj karshi fëmijëve të saj.

(5819)

(52) - عن عائشة رضي الله عنها قالت: سمعتُ من رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول في بيتي هذا: «اللَّهُمَّ مَنْ وَلِيَ مِنْ أَمْرِ أُمَّتِي شَيْئًا فَشَقَّ عَلَيْهِمْ فَاشَقُّ عَلَيْهِ، وَمَنْ وَلِيَ مِنْ أَمْرِ أُمَّتِي شَيْئًا فَرَفَقَ بِهِمْ فَارْفُقْ بِهِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(52) – Aishja (Allahu goftë i kënaqur me të!) tansmeton e thotë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë në shtëpinë time: "O Allah! Ai që merr post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve dhe i mundon ata, mundoje edhe Ti atë! E, ai që merr post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve dhe i trajton me butësi, trajtoje edhe Ti me butësi!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ bëri lutje kundër gjithë atyre që marrin ndonjë post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve, qofshin ato të vogla, qofshin të mëdha, qoftë kjo udhëheqësi e përgjithshme, qoftë udhëheqësi e pjesshme, e veçantë, ku i mundon dhe nuk tregohet i butë. Të tillin Allahu i Lartësuar do ta "shpërblejë" në varësi të veprës së tij, pra, do ta mundojë e do t'ia vështirësojë.

Me atë që tregohet i butë dhe ua lehtëson punët muslimanëve, Allahu do të sillet butësisht dhe do t'ia lehtësojë punët.

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim për atë që merr ndonjë post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve që t'i trajtojë me butësi, aq sa mundet.
2. Shpërblimi-ndëshkimi është sipas llojit të veprës.
3. Peshorja e asaj që konsiderohet butësi ose mundim - ashpërsi është ajo që nuk bie në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin.

(5330)

(53) – عن تميم الداري رضي الله عنه أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «الدِّينُ النَّصِيحَةُ» قُلْنَا: لِمَنْ؟ قَالَ: «لِلَّهِ وَلِكِتَابِهِ وَلِرَسُولِهِ وَلِأَئِمَّةِ الْمُسْلِمِينَ وَعَامَّتِهِمْ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(53) – Temim Dariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Feja është singeriteti." E pyetëm: "Ndaj kujt?" Ai tha: "Ndaj Allahut, ndaj Librit dhe të Dërguarit të Tij, ndaj prijësve të muslimanëve, si dhe ndaj shtresës së përgjithshme të muslimanëve." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se feja bazohet në singeritet dhe çiltërsi, në mënyrë që ajo të kryhet ashtu siç ka urdhëruar Allahu, plotësisht, pa cungim e pa mashtrim.

E pyetën Profetin ﷺ: "Ndaj kujt është sinqeriteti?"
Atëherë tha:

Së pari: sinqeriteti ndaj Allahut të Lartmadhëruar, duke punuar sinqerisht për Të, duke mos i bërë ortak (ar. shirk), duke besuar në zotërimin, në denjësinë e Tij për t'u adhuruar dhe në emrat e cilësitë e Tij, duke e madhëruar urdhrin e Tij dhe duke thirrur për të besuar në Të.

Së dyti: sinqeriteti ndaj Librit të Tij, që është Kurani i madhërishëm. Pra, të besojmë se ai është Fjala e Tij e Libri i Tij i fundit, dhe se ai i shfuqizoi të gjitha ligjet (shariatet) para tij. Ne e madhërojmë atë dhe e lexojmë ashtu si duhet. Punojmë sipas ajeteve të tij krejtësisht të qarta (ar. muhkemat) dhe i pranojmë ato që janë jo krejtësisht të qarta (ar. muteshabihat). E largojmë nga ai interpretimin e shtrembëruesve, i marrim në konsideratë këshillat e tij, i përhapim dituritë e tij dhe bëjmë thirrje tek ai.

E treta: sinqeriteti ndaj të Dërguarit të Tij, Muhamedit ﷺ. Pra, të besojmë se ai është profeti i fundit, t'i besojmë asaj që solli, t'u bindemi urdhrave të tij dhe t'u shmangemi ndalesave të tij. Ta adhurojmë Allahun vetëm me atë që ai solli, ta respektojmë, ta nderojmë, ta përhapim thirrjen e tij, ta përhapim ligjin (shariatin) e tij dhe t'i mënjanojmë akuzat që hidhen kundër tij.

E katërta: sinqeriteti ndaj prijësve të muslimanëve, duke i ndihmuar ata në të vërtetën, të mos i kundërshtojmë çështjet e tyre, t'i dëgjojmë dhe t'u bindemi për sa kohë që i binden Allahut.

Së pesti: sinqeriteti ndaj muslimanëve, duke u bërë mirë dhe duke i thirrur, duke e mënjeluar dëmtimin prej tyre,

duke e dashur hairin për ta dhe duke bashkëpunuar me ta në mirësi e devotshmëri.

Mësim nga hadithi:

1. Urdhri për të qenë të singertë me (e për të këshilluar) të gjithë.
2. Pozita madhështore që gëzon singëriteti (këshilla) në fe.
3. Feja ngërthen në vete besime, fjalë dhe vepra.
4. Nga singëriteti është që të jesh i dëlirë nga mashtrimi ndaj atij që e këshillon dhe ta dëshirosh të mirën për të.
5. Metoda e shkëlqyer e mësimdhënies nga ana e Profetit ﷺ, meqë e përmendi singëritetin fillimisht në mënyrë të përgjithshme, e më pas e sqaroi hollësisht.
6. Fillimi me gjërat që janë më të rëndësishme e kështu me radhë, sepse Profeti ﷺ filloi me singëritetin ndaj Allahut, Librit (Kuranit), Profetit ﷺ, prijësve të muslimanëve e më pas singëritetin ndaj shtresës së përgjithshme të muslimanëve.

(4309)

(54) - عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: تَلَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ هَذِهِ الْآيَةَ: {هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ مُتَشَابِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ، وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ، وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ كُلٌّ مِنْ عِنْدِ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ} [آل عمران: 7]. قَالَتْ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِذَا رَأَيْتَ الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ سَمَى اللَّهُ، فَأَحْذَرُوهُمْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(54) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut e lexoi këtë ajet: “Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa ajete të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit, kurse disa (ajete) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve piren nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërkaq, ata që janë thelluar në dijeni, thonë: "Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (ajete të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë! Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.” (Al Imran, 7) - dhe tha: “Kur t'i shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur. Andaj, ruajuni prej tyre!” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e lexoi këtë ajet: “Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa ajete të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (ajete) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: "Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (ajete të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë! Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.” (Al Imran, 7) Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar tregoi se Ai është që ia zbriti Profetit të Tij Kuranin, i cili përfshin ajete me kuptim të qartë, vendimet e të cilit janë të ditura e nuk ka pështjellime, e të cilat janë themelet e Librit dhe referenca e tij, respektivisht janë referencë kur ka mospajtime. Ka edhe ajete të tjera që bartin më shumë se një kuptim, kuptimi i të cilave disa njerëzve u përziehet, ose mendojnë se ka kontradiktë midis tyre dhe ajeteve të tjera. Më pas Allahu e sqaroi se si duhet të sillen njerëzit me këto ajete; kështu që ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, i braktisin ajetet e qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë, e i marrin ajetet jo krejtësisht të qarta, e që bartin disa kuptime, duke synuar me këtë të ngjallin dyshime dhe t'i devijojnë njerëzit, si dhe synojnë t'i interpretojnë sipas asaj që pajtohet me dëshirat e tyre, ndërsa ata që janë të palëkundur në dituri, e dinë se këto janë ajete jo krejtësisht të qarta, kështu që i kthejnë tek ajetet

e qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë; u besojnë dhe besojnë se janë prej Allahut të Lartësuar, e nuk mund të pësjtjellohen ose të kenë kontradiktë mes vete, por vetëm ata me mendje të shëndoshë mund të marrin mësim. Pastaj Profeti ﷺ i tha nënës së besimtarëve, Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se, kur t'i shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur në fjalën e Tij: "Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta", andaj ruajuni prej tyre e mos i dëgjoni!

Mësim nga hadithi:

1. Ajetet muhkemat të Kuranit janë ato, domethënia dhe kuptimi i të cilave është i qartë, ndërsa muteshabihat janë ato që kanë më shumë se një kuptim dhe kanë nevojë për këndvështrim dhe të kuptuar (për t'i kuptuar drejt).
2. Paralajmërim kundër shoqërimit me të devijuarit, bidatçinjtë dhe ata që hedhin dyshime për t'i mashtruar njerëzit dhe për t'i vënë ata në mëdyshje.
3. Në fund të ajetit, në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Këtë e kuptojnë vetëm mendarët", ka demaskim ndaj atyre që priren nga e pavërteta dhe ka lavdërim për të thelluarit (në dije). Pra, ai që nuk rikujtohet dhe nuk merr mësim, si dhe e ndjek egon e tij, nuk është prej mendarëve.
4. Ndjekja e teksteve jo krejtësisht të qarta është shkak për devijimin e zemrës.

5. Është obligim që ajetet jo krejtësisht të qarta, të cilave mbase nuk mund t'u dihet kuptimi, të kthehen tek ajetet e qarta.
6. Allahu i Lartësuar disa ajete të Kuranit i ka bërë të qarta dhe disa jo krejtësisht të qarta, si sprovë për njerëzit, në mënyrë që besimtarët e vërtetë të dallohen nga njerëzit e devijuar.
7. Fakti që në Kuran ka ajete jo krejtësisht të qarta e shpërfaq epërsinë e dijetarëve ndaj të tjerëve dhe është tregues se mendjet janë të mangëta, prandaj duhet t'u dorëzohen Krijuesit të tyre dhe ta konfirmojnë se janë të paafta.
8. Vlera e të qenit i thelluar në dije dhe domosdoshmëria e qëndrueshmërisë në të.
9. Komentuesit e Kuranit i kanë dy mendime për ndaljen te fjala "Allahu", tek ajeti: "Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu dhe ata që janë të thelluar në dijeni." Ata që ndalen te fjala "Allahu", shprehjes tevil ia japin kuptimin: njohja e realitetit të një gjëje, që Allahu atë dije e ka fshehur për Vetën dhe që nuk ka mënyrë se si të perceptohet ajo, si çështja e shpirtit dhe Kiametit (se kur do të ndodhë). Që do ta kishte kuptimin: "Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu." Ndërkaq, të thelluarit në dije u besojnë atyre dhe realitetin e tyre ua lënë Allahut, kështu që dorëzohen dhe i pranojnë. Ndërkaq, ata që gjatë leximit vazhdojnë dhe nuk

ndalen te fjala "Allahu", kuptimin do ta kishte: "Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu dhe ata që janë të thelluar në dijeni." Pra, shprehja tevil në këtë rast e ka kuptimin: shpjegim dhe qartësim. Rrjedhimisht, Allahu e di dhe e dinë edhe të thelluarit në dije, kështu që u besojnë atyre dhe i kthejnë tek ajetet e qarta.

(65062)

(55) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ رَأَى مِنْكُمْ مُنْكَرًا فَلْيُغَيِّرْهُ بِيَدِهِ، فَإِنْ لَمْ يَسْتَطِعْ فَبِلِسَانِهِ، فَإِنْ لَمْ يَسْتَطِعْ فَبِقَلْبِهِ، وَذَلِكَ أَضْعَفُ الْإِيمَانِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(55) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Kushdo prej jush që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij, e, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e, nëse nuk mundet as kështu, atëherë me zemrën e tij, por ky është imani më i dobët." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëron të ndryshohet e keqja, respektivisht gjithçka që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar, gjë që duhet bërë sipas mundësive. Kështu, nëse sheh një të keqe, duhet ta ndryshojë me dorë, nëse ka forcë (ekzekutuese). E, nëse nuk mund ta bëjë këtë, atëherë le ta

ndryshojë me gjuhën e tij, respektivisht duke e ndaluar personin që po e vepron atë, duke ia shpjeguar dëmin e saj dhe duke e udhëzuar në mirësi, në vend të asaj të keqeje. Nëse nuk është në gjendje ta arrijë ndryshimin në këtë nivel, atëherë duhet ta ndryshojë me zemër, respektivisht duke e urryer këtë të keqe dhe duke vendosur që, po të ishte në gjendje ta ndryshonte, do ta bënte. Ndryshimi me zemër është niveli më i dobët i besimit në raport me ndryshimin e së keqes.

Mësime nga hadithi:

1. Ky hadith është bazë që tregon nivelet e ndryshimit të së keqes.
2. Urdhri që e keqja të ndalohet shkallë-shkallë, secili sipas aftësive dhe mundësive që ka.
3. Ndalimi i së keqes është një kapitull madhështor në fe, i cili nuk bie nga askush dhe çdo musliman është i obliguar ta bëjë atë sipas mundësive të tij.
4. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi i së keqes janë prej virtyteve të besimit, i cili shtohet e pakësohet.
5. Për të ndaluar të keqen, kushtëzohet të diturit se vepra e tillë është e keqe.
6. Kusht për të ndryshuar një të keqe është që të mos rezultojë ky ndryshim në një të keqe më të madhe.
7. Për të ndaluar të keqen ka rregulla dhe kushte, që muslimani duhet t'i mësojë.

8. Ndalimi i së keqes kërkon një politikë shariatike, dituri dhe urtësi.
9. Mosndalimi i së keqes me zemër tregon se besimi është dobët.

(65001)

(56) - عَنِ التُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَثَلُ الْقَائِمِ عَلَى حُدُودِ اللَّهِ وَالْوَاقِعِ فِيهَا، كَمَثَلِ قَوْمٍ اسْتَهَمُوا عَلَى سَفِينَةٍ، فَأَصَابَ بَعْضُهُمْ أَعْلَاهَا وَبَعْضُهُمْ أَسْفَلَهَا، فَكَانَ الَّذِينَ فِي أَسْفَلِهَا إِذَا اسْتَقَوْا مِنَ الْمَاءِ مَرُّوا عَلَى مَنْ فَوْقَهُمْ، فَقَالُوا: لَوْ أَنَّا خَرَقْنَا فِي نَصِيبِنَا خَرْقًا وَلَمْ نُؤْذِ مَنْ فَوْقَنَا، فَإِنْ يَتْرَكُوهُمْ وَمَا أَرَادُوا هَلَكُوا جَمِيعًا، وَإِنْ أَخَذُوا عَلَى أَيْدِيهِمْ نَجَوْا، وَنَجَّوْا جَمِيعًا».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(56) – Numan ibën Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që i respekton kufijtë e Allahut dhe ai që i shkel ata i shëmbëllezin një populli që kanë vënë short për një anije. Njëri grup (sipas shortit) qëndroi sipër (në kuvertë), kurse tjetri poshtë (në hambar). Këta, që ishin poshtë, atyre që ishin sipër, u kërkonin ujë për të pirë dhe thanë: "Sikur të shponim një vrimë në pjesën tonë, më s'do t'i bezdisnim këta sipër nesh." Nëse ata sipër do t'i lejonin të vepronin atë që dëshironin këta, atëherë do të shkatërroheshin të gjithë, por, nëse do t'i ndalonin, do të shpëtonin të gjithë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith solli shembull për ata që i respektojnë kufijtë e Allahut, që i përmbahen urdhrit të Tij, që urdhërojnë të mirën, që ndalojnë të keqen, dhe shembull për ata që i shkelin kufijtë e Allahut, që braktisin të mirën, e që e veprojnë të keqen, si dhe ndikimin e kësaj në shpëtimin e shoqërisë, me shembullin e një populli që hipën në një anije dhe hodhën short se kush do të qëndrojë sipër anijes dhe kush do të qëndrojë poshtë saj. Disave u ra pjesa e sipërme e disave pjesa e poshtme, kështu që ata që ishin poshtë, nëse donin të merrnin ujë, kalonin pranë atyre që ishin sipër. Ata që ishin poshtë, thanë: "Sikur ta kishim bërë një vrimë në vendin tonë poshtë, për të nxjerrë prej saj (ujë), në mënyrë që të mos i bezdisim ata sipër nesh." Nëse ata që ishin sipër do t'i lejonin ta bënë këtë, anija do të ishte fundosur me të gjithë ata, e sikur t'i kishin ndaluar dhe penguar, të dyja grupet do të kishin shpëtuar.

Mësimet nga hadithi:

1. Rëndësia e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja për ruajtjen dhe shpëtimin e shoqërive.
2. Një nga metodat e mësimdhënies është edhe sjellja e shembujve, për t'i përafruar kuptimet në mendje me një imazh konkret.
3. Veprimi i së keqes së dukshme duke mos e refuzuar është gjë e dëmshme, që faktikisht ky dëm u kthehet të gjithëve.

4. Shkatërrimi i shoqërisë vjen si pasojë, nëse të ligjtë lihen të bëjnë çrregullime në Tokë.
5. Veprimi i gabuar dhe qëllimet e mira nuk mjaftojnë që një vepër të jetë në rregull.
6. Përgjegjësia në shoqërinë islame është kolektive dhe nuk i lihet vetëm një individ të caktuar.
7. Masa e gjerë e njerëzve dënohet për shkak të mëkateve individuale, nëse nuk refuzohen.
8. Të ligjtë e shfaqin të keqen e tyre në mënyrë të mirë për shoqërinë, ashtu si bëjnë hipokritët.

(3341)

(57) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ دَعَا إِلَى هُدًى كَانَ لَهُ مِنَ الْأَجْرِ مِثْلُ أُجُورِ مَنْ تَبِعَهُ، لَا يَنْقُصُ ذَلِكَ مِنْ أُجُورِهِمْ شَيْئًا، وَمَنْ دَعَا إِلَى ضَلَالَةٍ كَانَ عَلَيْهِ مِنَ الْإِثْمِ مِثْلُ آثَامِ مَنْ تَبِعَهُ، لَا يَنْقُصُ ذَلِكَ مِنْ آثَامِهِمْ شَيْئًا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(57) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që thërret në udhëzim, do të ketë shpërblim aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre, por edhe ai që thërret në lajthitje, do të ketë mëkat po aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak mëkati i tyre.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se ai që i udhëzon dhe i nxit njerëzit drejt një rruge në të cilën ka hak (të vërtetë) dhe mirësi, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, do të ketë shpërblim të ngjashëm me atë të atyre që e pasojnë, pa iu zvogëluar shpërblimi i këtyre të fundit. Po ashtu, ai që i udhëzon e i përudh njerëzit drejt një rruge të kotë dhe të keqe që përmban mëkat dhe të bërët keq ose diçka që nuk lejohet, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, atëherë ai do ta bartë barrën e barabartë të mëkatit të atyre që e ndjekin, pa u zvogëluar asgjë nga mëkatet e tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e thirrjes për në udhëzim, qoftë pak, qoftë shumë, dhe se thirrësi e ka shpërblimin të ngjashëm me atë që vepron (sipas udhëzimit të tij), e kjo është nga mirësia e madhe e Allahut dhe bujaria e Tij e përsosur.
2. Rreziku i thirrjes drejt devijimit, qoftë i vogël, qoftë i madh, dhe se thirrësi e ka barrën e mëkatit të njëjtë sikurse vepruesi.
3. Shpërblimi është sipas llojit të veprës: ai që thërret drejt së mirës, do ta ketë shpërblimin të barabartë me shpërblimin e vepruesit, sikundërqë ai që thërret drejt së keqes, do të ketë barrë të barabartë mëkati me atë që e vepron.

4. Muslimani duhet të ruhet që të mos merret shembull nga të tjerët, duke bërë mëkat haptazi, teksa e shohin njerëzit, sepse ai bën mëkat, meqë të tjerët e imituan, edhe nëse ai nuk i inkurajoi për të bërë këtë.

(3373)

(58) - عن أبي مسعود الأنصاري رضي الله عنه قال: جَاءَ رَجُلٌ إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ: إِنِّي أَبْدِعُ بِي فَأَحْمِلْنِي، فَقَالَ: «مَا عِنْدِي»، فَقَالَ رَجُلٌ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَنَا أَذْلُهُ عَلَى مَنْ يَحْمِلُهُ، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ دَلَّ عَلَى خَيْرٍ فَلَهُ مِثْلُ أَجْرِ فَاعِلِهِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(58) – Ebu Mesud Ensariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Një person erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "Më ka ngordhur kafsha, andaj a mund të më gjesh një kafshë për udhëtim (për në betejë)?" Ai ﷺ tha: "Nuk kam." Një person tjetër tha: "O i Dërguari i Allahut, unë do ta drejtoj te dikush që do t'i gjejë kafshë udhëtimi." I Dërguari i Allahut ﷺ tha: "Kushdo që udhëzon dikë për një punë të mirë, do ta ketë shpërblimin të njëjtë sikurse ai që e bën atë punë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Një njeri erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "Kafsha kalëruese më ka ngordhur, andaj a mund të më gjesh një kafshë për udhëtim, që të më dërgojë (për ku jam nisur)." Profeti ﷺ i kërkoi falje sepse nuk kishte asnjë kafshë për ta bartur,

kështu që një person që ishte i pranishëm tha: "O i Dërguari i Allahut, unë do ta drejtoj te dikush që do t'i gjejë kafshë udhëtimi." Kështu, i Dërguari i Allahut ﷺ e lajmëroi se ai ishte ortak në shpërblim me atë që do t'ia japë kafshën e udhëtimit, sepse nevojtarin e drejtoi tek ai.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për t'i drejtuar të tjerët drejt hairit.
2. Nxitja për të bërë mirë është nga faktorët e solidaritetit dhe integritetit të komunitetit musliman.
3. Mirësia e gjerë e Allahut të Lartësuar.
4. Ky hadith është një rregull e përgjithshme, tek e cila bëjnë pjesë krejt veprat e hairit.
5. Nëse njeriu nuk ka mundësi ta realizojë dëshirën e atij që kërkon diçka, atëherë e drejton te tjetri.

(5354)

(59) - عَنْ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ يَوْمَ خَيْبَرَ: «لَأُعْطِينَ هَذِهِ الرَّايَةَ عَدَا رَجُلًا يَفْتَحُ اللَّهُ عَلَى يَدَيْهِ، يُحِبُّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيُحِبُّهُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ»، قَالَ: فَبَاتَ النَّاسُ يَدُوكُونَ لَيْلَتَهُمْ أَتَيْتُهُمْ يُعْطَاهَا، فَلَمَّا أَصْبَحَ النَّاسُ عَدَوْا عَلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كُلُّهُمْ يَرْجُونَ أَنْ يُعْطَاهَا، فَقَالَ: «أَيْنَ عَلِيُّ بْنُ أَبِي طَالِبٍ؟» فَقِيلَ: هُوَ يَا رَسُولَ اللَّهِ يَشْتَكِي عَيْنَيْهِ، قَالَ: «فَأَرْسِلُوا إِلَيْهِ»، فَأَتَى بِهِ فَبَصَقَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي عَيْنَيْهِ وَدَعَا لَهُ، فَبَرَأَ حَتَّى كَأَنَّ لَمْ يَكُنْ بِهِ وَجَعٌ، فَأَعْطَاهُ الرَّايَةَ، فَقَالَ عَلِيٌّ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَقَاتِلُهُمْ حَتَّى يَكُونُوا مِثْلَنَا؟ فَقَالَ: «انْقُذْ عَلَى رِسْلِكَ حَتَّى تَنْزِلَ بِسَاحَتِهِمْ، ثُمَّ ادْعُهُمْ إِلَى الْإِسْلَامِ، وَأَخْبِرْهُمْ بِمَا يَجِبُ عَلَيْهِمْ مِنْ حَقِّ اللَّهِ فِيهِ، فَوَاللَّهِ لَأَنْ يَهْدِيَ اللَّهُ بِكَ رَجُلًا وَاحِدًا، خَيْرٌ لَكَ مِنْ أَنْ يَكُونَ لَكَ حُمْرُ النَّعَمِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(59) – Sehël ibën Sa'di (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se, ditën e Hajberit i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Nesër do t'ia jap këtë flamur një njeriu, nëpërmjet të cilit Allahu do të mundësojë çlirimin: njeri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ dhe që Allahu dhe i Dërguari i Tij ﷺ e duan atë.” Kështu, të gjithë njerëzit e kaluan natën duke hamendësuar se kujt do t'i jepej (flamuri). E, kur u gdhinë njerëzit, shkuan tek i Dërguari i Allahut ﷺ, duke shpresuar secili që flamuri t'i jepej atij. Profeti ﷺ pyeti: “Ku është Ali ibën Ebi Talibi?” Dikush tha: "Ka shqetësime me sytë, o i Dërguari i Allahut." - "Thirreni këtu", - tha Profeti ﷺ. Kur erdhi, i Dërguari i Allahut ﷺ vendosi pështymën e tij në sytë e tij, u lut për të dhe ai u shërua, sikur të mos kishte pasur asgjë. Pastaj Profeti ﷺ ia dha flamurin dhe Aliu tha: "O i

Dërguari i Allahut, t'i luftoj derisa të bëhen sikurse ne (muslimanë)?" Profeti ﷺ i tha: "Mos vepro asgjë pa shkuar në mesin e tyre e t'i ftosh në Islam dhe t'u tregosh çfarë obligimi kanë kundrejt Allahut në Islam. Pasha Allahun, që Allahu të udhëzojë një njeri nëpërmjet teje është më e mirë për ty sesa të posedosh devetë e kuqe (lloji më i çmueshëm i deveve)." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith u tregoi sahabëve se muslimanët nesër do të fitojnë kundër hebrejve të Hajberit, nëpërmjet një burri që do t'ia jepte personalisht flamurin, flamur këtë të cilin ushtria e përdorte si simbol të saj. Një prej virtyteve të këtij burri ishte se e donte Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe se Allahu dhe i Dërguari i Tij e donin atë gjithashtu. Kështu, sahabët e kaluan natën duke diskutuar dhe duke biseduar se kujt do t'i jepej flamuri e duke qenë të interesuar për këtë nder të madh. Kur erdhi mëngjesi, shkuan te Profeti ﷺ, që të gjithë, duke shpresuar të merrnin këtë nder.

Profeti ﷺ pyeti për Ali ibën Ebi Talibin (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

I thanë: "Ai është i sëmure, po ankohet prej syve."

Profeti ﷺ i dërgoi tek ai dhe ata ia sollën. Ai vendosi në sytë e Aliut diçka nga pështyma e tij fisnike dhe u lut për të dhe ai u shërua nga sëmundja që kishte, sikur të mos kishte asnjë sëmundje, sakaq ia dha flamurin dhe e urdhëroi që të vazhdonte me butësi derisa t'i afrohej fortesës së armikut dhe

t'i ftonte në Islam, e, nëse pranonin, atëherë t'i tregonte çfarë obligimesh kanë.

Pastaj Profeti ﷺ ia sqaroi Aliut vlerën e thirrjes tek Allahu dhe, nëse thirrësi bëhet shkak për udhëzimin e një njeriu, kjo është më mirë për të sesa të posedojë deve të kuqe, - të cilat ishin pasuria më e çmuar e arabëve, - t'i mbajë në pronësinë e vet ose t'i japë lëmoshë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e Ali ibën Ebi Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe dëshmia e Profetit ﷺ për të se Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan dhe se ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.
2. Interesimi i sahabëve për të bërë mirë dhe garimi i tyre në këtë drejtim.
3. Pëlqyeshmëria e ruajtjes së edukatës gjatë luftës dhe shmangia e rrëmbyeshmërisë dhe britmave të bezdisshme e të panevojshme.
4. Ndër dëshmitë e profecisë së Muhamedit ﷺ ishte lajmi i fitores ndaj hebrenjve dhe shërimi i syve të Ali ibn Ebi Talibit përmes tij, me lejen e Allahut.
5. Qëllimi më madhor i xhihadit është hyrja e njerëzve në Islam.
6. Thirrja bëhet gradualisht; nga jobesimtari kërkohet fillimisht të bëhet musliman duke shqiptuar

shehadetin (dëshminë islame) e më pas ai urdhërohet t'i kryejë detyrat e Islamit.

7. Vlera e thirrjes në Islam dhe të mirat që ajo i sjell atij që ftohet dhe atij që fton në Islam: ai që ftohet mund të udhëzohet, ndërsa ai që fton merr me një shpërblim të madh.

(3409)

(60) – عن ابنِ عُمَرَ رضي الله عنهما قال: قال رسولُ الله صَلَّى الله عليه وسلم:

«مَنْ تَشَبَّهَ بِقَوْمٍ فَهُوَ مِنْهُمْ». [حسن] - [رواه أبو داود وأحمد]

(60) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Ai që i përngjan një populli është prej tyre." [Hadith hasen] - [رواه أبو داود وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që i përngjan një populli, qofshin jobesimtarë, gjynahmëdhenj, qofshin njerëz të drejtë - duke bërë diçka që është karakteristikë e tyre në aspektin e besimit, adhurimit ose zakonit, - atëherë ai është njëri prej tyre, sepse përngjasimi me ta në pamjen e jashtme shpie drejt përngjasimit me ta në anën e brendshme. Nuk ka dyshim se përngjasimi me një popull është rezultat i admirimit të tyre, gjë që mund të shkatojë që ata të duhen, të madhërohen dhe të mbështetet njeriu tek ata. Allahu na ruajttë!

Mësime nga hadithi:

1. Paralajmërimi kundër përngjasimit me jobesimtarët dhe gjynahmëdhenjtë.
2. Inkurajimi që të përngjasojmë me njerëzit e mirë dhe t'i marrim shembull ata.
3. Përngjasimi në anën e jashtme trashëgon dashurinë në anën e brendshme.
4. Njeriu e merr kërcënimin dhe mëkatin në varësi të llojit të përngjasimit.
5. Ndalimi i shëmbëllimit të jomuslimanëve është ndalim i shëmbëllimit të tyre në fenë dhe në zakonet e tyre, që janë të veçanta për ta. E, sa i përket asaj që nuk është e tillë, si mësimi i zanateve dhe të ngjashme, nuk përfshihet në ndalim.

(5353)

(61) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «الرَّجُلُ عَلَى دِينِ خَلِيلِهِ، فَلْيَنْظُرْ أَحَدُكُمْ مَنْ يُخَالِلُ». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

(61) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Njeriu është në fenë e shokut të tij, andaj secili prej jush të shikojë se kë shoqëron!" [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se njeriu i ngjan mikut dhe shokut të tij të ngushtë në sjelljen e zakonet e tij dhe se kjo miqësi ndikon në moralin, sjelljen dhe veprimet e njeriut. Për këtë arsye Profeti ﷺ udhëzoi të përzgjidhet miku, sepse ai e udhëzon shokun e tij drejt besimit, udhëzimit dhe mirësisë dhe është ndihmë për shokun e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Urdhërimi që të shoqërohen njerëzit e mirë dhe përzgjedhja e tyre, si dhe ndalimi që të shoqërohen njerëzit e këqij.
2. Profeti ﷺ e veçoi me përmendje shokun e jo të afërmin, sepse ti je ai që përzgjedh shokun, ndërsa për vëllanë dhe të afërmin nuk ke liri zgjedhjeje.
3. Përzgjedhja e shoqërisë duhet të burojë nga meditim.
4. Njeriu fenë e forcon duke i shoqëruar besimtarët dhe e dobëson atë duke i shoqëruar të prishurit.

(3122)

(62) - عن تميم الداري رضي الله عنه، قال: سمعتُ رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «يَبْلُغَنَّ هَذَا الْأَمْرُ مَا بَلَغَ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ، وَلَا يَتْرُكُ اللَّهُ بَيْتَ مَدْرٍ وَلَا وَبَرٍ إِلَّا أَدْخَلَهُ اللَّهُ هَذَا الدِّينَ، بِعِزِّ عَزِيزٍ أَوْ بِذُلِّ ذَلِيلٍ، عِزًّا يُعِزُّ اللَّهُ بِهِ الْإِسْلَامَ، وَذُلًّا يُذِلُّ اللَّهُ بِهِ الْكُفْرَ» وَكَانَ تَمِيمُ الدَّارِيُّ يَقُولُ: قَدْ عَرَفْتُ ذَلِكَ فِي أَهْلِ بَيْتِي، لَقَدْ أَصَابَ مَنْ أَسْلَمَ مِنْهُمْ الْخَيْرُ وَالشَّرَفُ وَالْعِزُّ، وَلَقَدْ أَصَابَ مَنْ كَانَ مِنْهُمْ كَافِرًا الذُّلُّ وَالصَّغَارُ وَالْحِزْيَةُ. [صحيح] - [رواه أحمد]

(62) – Temim Dariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "Kjo çështje (fe) do të mbërrijë aty ku ka mbërritur nata dhe dita. Allahu nuk do të lërë shtëpi e tendë pa e futur këtë fe; me krenarinë e krenarit ose me nënçmimin e të nënçmuarit. Krenari me të cilën Allahu e bën krenar Islamin dhe nënçmim me të cilin Allahu e nënçmon kufrin (mosbesimin)." Temim Dariu thoshte: "Këtë e vura re te familjarët e mi. Ata që u bënë muslimanë u begatuan me mirësi, nder dhe krenari, ndërsa ata që mbetën jobesimtarë, u nënçmuan, poshtëruan dhe paguan xhizjen (taksën vjetore)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ahmedi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ në këtë hadith tregon se kjo fe do të përhapet në të gjitha anët e botës, kështu që kjo fe do të arrijë në çdo vend ku arrin nata dhe dita. Allahu i Lartësuar nuk do të lërë shtëpi në qytete, fshatra e shkretëtirë pa e futur këtë fe. Kushdo që e pranon këtë fe dhe e beson, do të

nderohet me krenarinë e Islamit. Kushdo që e refuzon atë dhe e mohon, do të poshtërohet dhe do të jetë i nënçmuar.

Pastaj sahabiu, Temim Darius (Allahu qoftë i kënaqur me të!), tregoi se këtë çfarë i kishte thënë i Dërguari i Allahut ﷺ e kishte vënë re te familjarët e vet. Atyre që u bënë muslimanë u begatuan me mirësi, nder dhe krenari, ndërsa ata që ishin jobesimtarë, u nënçmuan, u poshtëruan dhe i paguajtën muslimanëve xhizjen (taksën vjetore).

Mësime nga hadithi:

1. Sihariq për muslimanët se feja e tyre do të përhapet në të gjitha anët e botës.
2. Krenaria është për Islamin dhe muslimanët, ndërsa poshtërimi është për mosbesimin dhe mosbesimtarët.
3. Në këtë hadith pohohet një prej profecive të të Dërguarit ﷺ, sepse ajo që ai tregoi ndodhi mu ashtu siç tha.

(11220)

(63) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ قَالَ: «وَالَّذِي نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ لَا يَسْمَعُ بِي أَحَدٌ مِنْ هَذِهِ الْأُمَّةِ يَهُودِيٍّ وَلَا نَصْرَانِيٍّ، ثُمَّ يَمُوتُ وَلَمْ يُؤْمِنْ بِالَّذِي أُرْسِلْتُ بِهِ إِلَّا كَانَ مِنْ أَصْحَابِ النَّارِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(63) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se nuk ka njeri nga ky umet, qoftë hebre, qoftë i krishterë, që dëgjon për mua, e pastaj vdes pa besuar shpalljen me të cilën jam dërguar, vetëm se do të jetë banor i Zjarrit." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith betohet në Allahun se askush nga ky umet (popull i thirrjes), qoftë hebre, qoftë i krishterë, qoftë dikush tjetër, të cilit i ka arritur thirrja e Profetit ﷺ, pastaj vdes dhe nuk beson në të, vetëm se do të jetë një nga banorët e Zjarrit, ku do të qëndrojë përgjithmonë.

Mësim nga hadithi:

1. Mesazhi i Profetit ﷺ është për mbarë botën; është detyrë të ndiqet dhe legjislacioni i tij i ka shfuqizuar të gjitha legjislacionet.
2. Kushdo që nuk i beson Profetit ﷺ, nuk do t'i bëjë dobi pretendimi i tij se beson në profetët e tjerë.

3. Kushdo që nuk ka dëgjuar për Profetin ﷺ dhe nuk i ka arritur thirrja islame, është i arsyetuar dhe çështja e tij në botën tjetër i takon Allahut të Lartësuar.
4. Pranimi i Islamit i bën dobi njeriut edhe nëse ai është afër vdekjes, madje edhe gjatë sëmundjes së rëndë, përderisa shpirti nuk i arrin në fyt.
5. Konsiderimi i saktë i fesë së jomuslimanëve, si ajo e hebrenjve dhe e të krishterëve, është kufër (dalje prej fesë).
6. Fakti që hebreu dhe i krishteri janë përmendur në hadith është paralajmërim për të gjithë të tjerët. Kjo, se hebrenjtë dhe të krishterët kishin Libër (hyjnor), kështu që, nëse e tillë është puna e tyre, atëherë me të tjerët, që nuk kishin libër, është më parësore, sepse të gjithë ata e kanë obligim të hyjnë në fenë e Profetit ﷺ dhe t'i binden atij.

(3272)

(64) - عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ غَدَاةَ الْعَقَبَةِ وَهُوَ عَلَى نَاقَتِهِ: «الْفُطْ لِي حَصَى» فَلَقِطْتُ لَهُ سَبْعَ حَصِيَّاتٍ، هُنَّ حَصَى الْحَذَفِ، فَجَعَلَ يَنْفُضُهُنَّ فِي كَفِّهِ وَيَقُولُ: «أَمْثَالُ هَؤُلَاءِ فَارُمُوا» ثُمَّ قَالَ: «أَيُّهَا النَّاسُ، إِيَّاكُمْ وَالْعُلُوَّ فِي الدِّينِ، فَإِنَّمَا أَهْلَكَ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ الْعُلُوَّ فِي الدِّينِ».

[صحيح] - [رواه ابن ماجه والنسائي وأحمد]

(64) – Nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se ka thënë: "Mëngjesin e Akabesë, i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!), ndërsa qëndronte mbi devenë e tij, më tha: ‘Kap disa guralecë për mua!’ Unë kapa për të shtatë guralecë të vegjël sa gurët që përdoren për të qëlluar. Ai i shkundi ato në dorën e tij dhe tha: ‘Si këta gurët përdorni për të hedhur!’ Mandej, ai tha: ‘O njerëz, ruhuni nga ekstremizmi në fe, sepse ata që ishin para jush u shkatërruan nga ekstremizmi në fe!’” [Ky hadith është sahih] - [رواه ابن ماجه والنسائي وأحمد]

Shpjegimi:

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se ai ishte me të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) në haxhin e lamtumirës, ditën e kurbanit në mëngjesin e hedhjes së gurëve te Xhemereja e Akabesë. I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) e urdhëroi të mblidhte për të gurët e Xhemeres dhe ai mori për të shtatë gurë të vegjël, ku secili prej tyre ishte sa një qiqër apo sa një lajthi. Profeti (paqja qoftë mbi të!) i vuri në dorën e tij dhe pasi i shkundi tha: "Gjuani me gurë të kësaj madhësie!" Mandej Profeti

(paqja qoftë mbi të!) paralajmëroi ruajtjen nga ekstremizmi, rreptësia dhe tejkalimi i caqeve në çështjet e fesë, ngase popujt e mëparshëm u shkatërruan pikërisht për shkak të tejkalimit të caqeve dhe ekstremizmit në fe.

Mësimet nga hadithi:

1. Ndalimi i ekstremizmit në fe, si dhe sqarimi i përfundimit të tij të keq dhe se ai është shkak për shkatërrimin e njeriut.
2. Reflektimi dhe meditimi mbi gjendjen e popujve të mëparshëm për të evituar gabimet që ata bënë.
3. Këshilla dhe nxitja për të ndjekur sunetin.

(3395)

(65) – عن عبد الله بن مسعود قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «هَلَكَ

الْمُتَنَطِّعُونَ» قالها ثلاثاً. [صحيح] - [رواه مسلم]

(65) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Do të shkatërrohen (në botën tjetër) ata që e teprojnë në shtrëngim (të dispozitave të fesë)." Këtë e tha tri herë. [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith për dështimin dhe humbjen që do t'i godasë tepruesit, - të cilët veprojnë pa

udhëzim (fetar) e pa dituri, - në fenë e tyre, në jetën e kësaj bote, si dhe në fjalët e veprimet e tyre. Pra, tepruesit, të cilët e tejkalojnë kufirin ligjor që e solli Profeti ﷺ.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalimi i teprimit në të gjitha çështjet dhe nxitja për të shmangur atë nga çdo gjë, sidomos në aktet e adhurimit dhe në madhërimin e njerëzve të devotshëm.
2. Të kërkosh përsosurinë në adhurim dhe në gjëra të tjera është gjë e lavdërueshme, por bëhet duke ndjekur udhëzimet e fesë.
3. Është e preferuar që çështja e rëndësishme të nënvizohet, sepse Profeti ﷺ e përsëriti këtë fjali tri herë.
4. Islami është fe tolerante dhe e lehtë.

(3420)

(66) - عَنْ عَدِيِّ بْنِ حَاتِمٍ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «الْيَهُودُ مَغْضُوبٌ

عَلَيْهِمْ، وَالنَّصَارَى ضَلَالٌ». [صحيح] - [رواه الترمذي]

(66) – Adij ibën Hatimi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Hebrenjtë janë ata me të cilët Allahu është i zemëruar, ndërsa të krishterët janë të humbur." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se hebrenjtë janë një popull me të cilin Allahu është hidhëruar, sepse e njohën të vërtetën dhe nuk vepruan sipas saj. Ndërkaq, të krishterët janë popull i devijuar, sepse vepruan pa dituri.

Mësime nga hadithi:

1. Harmonizimi ndërmjet dijes dhe veprimit është shpëtim nga ruga e atyre me të cilët është hidhëruar Allahu dhe që janë të humbur.
2. Paralajmërim nga rruga e hebrenjve dhe të krishterëve e kapja fort për rrugën e drejtë, që është Islami.
3. Që të dy popujt, hebrenjtë dhe të krishterët, janë të humbur dhe me ta Allahu është i hidhëruar, mirëpo përshtkrimi më i veçantë për hebrenjtë është hidhërimi (i Allahut ndaj tyre), ndërsa përshtkrimi më i veçantë për të krishterët është humbja.

(65061)

(67) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «كَتَبَ اللَّهُ مَقَادِيرَ الْخَلَائِقِ قَبْلَ أَنْ يَخْلُقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بِخَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ، قَالَ: وَعَرَّشُهُ عَلَى الْمَاءِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(67) – Abdullah ibën Amër ibën Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ

duke thënë: “Allahu i shkroi caktimet për të gjitha krijesat, pesëdhjetë mijë vjet para se t'i krijonte qiejt e Tokën, ndërkohë që Arshi i Tij ishte mbi ujë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu i shkroi hollësisht caktimet e të gjitha krijesave, të cilat do të ndodhin, përfshirë: jetën, vdekjen, riskun dhe gjëra të tjera. Këto i shkroi në Leuhul Mahfudh (Pllakën e Ruajtur Mirë) pesëdhjetë mijë vjet para se t'i krijonte qiejt dhe Tokën, të cilat do të ndodhin sipas asaj që ka paracaktuar Allahu i Lartmadhëruar. Çdo gjë që ndodh, ndodh me kadanë dhe kaderin e Allahut (caktimin dhe paracaktimin e Tij). Ajo që e ka goditur njeriun, nuk ka mundësi të mos e godiste, ndërsa ajo që nuk e ka goditur njeriun, nuk ka mundësi ta godiste.

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim të besohet në kadanë dhe kaderin e Allahut.
2. Kaderi nënkupton: dijen e Allahut rreth gjërave, shkrimin, vullnetin dhe krijimin e tyre.
3. Besimi se cakimet janë të shkruara para krijimit të qiejve dhe Tokës, jep si fryt të qenët i kënaqur dhe i nënshtruar (ndaj çdo gjëje që e ka caktuar Allahu).

4. Arshi (Froni) i të Gjithëmëshirshmit ka qenë mbi ujë para krijimit të qiejve e Tokës.

(65038)

(68) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: حَدَّثَنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَهُوَ الصَّادِقُ الْمَصْدُوقُ: «أَنَّ خَلْقَ أَحَدِكُمْ يُجْمَعُ فِي بَطْنِ أُمِّهِ أَرْبَعِينَ يَوْمًا وَأَرْبَعِينَ لَيْلَةً، ثُمَّ يَكُونُ عِلَاقَةً مِثْلَهُ، ثُمَّ يَكُونُ مُضْغَةً مِثْلَهُ، ثُمَّ يُبْعَثُ إِلَيْهِ الْمَلَكُ، فَيُؤَذِّنُ بِأَرْبَعِ كَلِمَاتٍ، فَيَكْتُبُ: رِزْقَهُ وَأَجَلَهُ وَعَمَلَهُ وَشَقِيَّ أَمْ سَعِيدٌ، ثُمَّ يَنْفُخُ فِيهِ الرُّوحَ، فَإِنَّ أَحَدَكُمْ لَيَعْمَلُ بِعَمَلِ أَهْلِ الْجَنَّةِ حَتَّى لَا يَكُونَ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُ إِلَّا ذِرَاعٌ، فَيَسْبِقُ عَلَيْهِ الْكِتَابُ، فَيَعْمَلُ بِعَمَلِ أَهْلِ النَّارِ فَيَدْخُلُ النَّارَ، وَإِنْ أَحَدَكُمْ لَيَعْمَلُ بِعَمَلِ أَهْلِ النَّارِ حَتَّى مَا يَكُونَ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُ إِلَّا ذِرَاعٌ، فَيَسْبِقُ عَلَيْهِ الْكِتَابُ، فَيَعْمَلُ عَمَلَ أَهْلِ الْجَنَّةِ فَيَدْخُلُهَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(68) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar, dhe thoshte: “Çdo njeriu i tubohet krijimi në mitrën e nënës së tij për dyzet ditë e dyzet net, pastaj, për po aq ditë shndërrohet në droçkë gjaku, më pas, për po aq ditë, shndërrohet në copë mishi (sikurse mishi i përtypur). Pastaj, atij i dërgohet një melek i urdhëruar me katër gjëra: të shkruajë furnizimin e tij, jetëgjatësinë, veprën, si dhe nëse do të jetë fatzi ose i lumtur (në botën tjetër). Më pas, i fryhet shpirti. Prej jush ka të atillë që, bën vepra të xhenetlinjve, madje aq sa vetëm një kut e ndan prej Xhenetit, por, ja që vjen në shprehje ajo që i është shkruar,

kështu që punon vepra të banorëve të Zjarrit, rrjedhimisht hyn në të, dhe anasjelltas, ka të atillë që bën vepra të xhehenemlinjve, saqë mes tij dhe Zjarrit s'ka më shumë se një kut, por, ja që vjen në shprehje caktimi që i është ndarë, ndaj bën punë të banorëve të Xhenetit dhe hyn në të." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Ibën Mesudi thoshte: "I Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar nga Allahu i Lartësuar: Ai ka thënë: "Çdo njeriu i tubohet krijimi, e kjo është kur burri kryen marrëdhënie me bashkëshorten e tij, ku sperma e tij e shpërndarë mblidhet në mitrën e gruas për dyzet ditë si copë e varur gjaku, më pas, në dyzetëshen e dytë, shndërrohet në copë mishi, pra, gjak i trashë e i fortë. e më pas shndërrohet në copë mishi, e cila është aq sa përtpet dhe kjo është dyzetëshja e tretë. Pastaj Allahu ia dërgon melekun, i cili i fryn shpirtin, pas përfundimit të dyzetëshes së tretë. Meleku urdhërohet të shkruajë katër gjëra: furnizimin e tij, respektivisht sasinë e begative që do të marrë gjatë jetës së tij; jetëgjatësinë, respektivisht periudhën se sa do të qëndrojë në këtë botë; veprën e tij, se çfarë do të bëjë dhe se a do të jetë i lumtur a fatzi (në botën tjetër). Pastaj Profeti ﷺ u betua se ndonjë njeri do të bëjë vepra të banorëve të Xhenetit dhe veprat e tij do të jenë të mira, pra, njerëzve u duken të tilla, si dhe do të vazhdojë kështu, derisa mes tij dhe Xhenetit të jetë vetëm sa një kut, që do të thotë: ajo që mbetet mes tij dhe arritjes në Xhenet është gjatësia e një kuti, por libri ia parakalon dhe ajo që

është caktuar për të, kështu që bën vepra të banorëve të Zjarrit dhe në këtë gjendje përfundon dhe, si rrjedhojë, futet në Zjarr, sepse kusht që puna e tij të pranohet është që të jetë i qëndrueshëm në të dhe të mos ndryshojë. Ndërkaq, një njeri tjetër bën vepra të banorëve të Zjarrit, derisa të jetë afër hyrjes në të, saqë ajo që mbetet mes tij dhe arritjes në Zjarr është gjatësia e një kuti, por libri ia parakalon dhe ajo që është caktuar për të, kështu që bën vepra të banorëve të Xhenetit dhe, si rrjedhojë, futet në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Fundi i çështjeve varet nga ajo që është vendosur dhe përcaktuar më parë.
2. Paralajmërim për të mos u mashtruar me llojet e veprave, sepse veprat vlerësohen sipas përfundimit të tyre.

(65037)

(69) - عن ابن مسعود رضي الله عنه قال: قال النبي صلى الله عليه وسلم: «الْجَنَّةُ أَقْرَبُ إِلَى أَحَدِكُمْ مِنْ شِرَاكِ نَعْلِهِ، وَالتَّارُ مِثْلُ ذَلِكَ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(69) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Xheneti është më afër jush sesa lidhësja e nallaneve tuaja. Ashtu është edhe Zjarri.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se Xheneti dhe Zjarri janë afër njeriut, si lidhësja e këpucëve që është në pjesën e sipërme të këmbës, sepse ai mund të bëjë një vepër e ta fitojë kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar e përmes saj të futet në Xhenet, ose të bëjë një gjynah e të jetë shkak për të hyrë në Zjarr.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për hair, sado i paktë që të jetë, si dhe kërcënimi nga sherri, sado i paktë që të jetë.
2. Muslimani medoemos gjatë jetës së tij duhet të bashkojë shpresën e frikën dhe gjithmonë ta lusë Allahun e Lartësuar që të jetë i palëkundur në të vërtetën, që të shpëtojë e të mos mashtrohet nga gjendja e tij.

(3581)

(70) - عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال:

«حُجِبَتِ النَّارُ بِالشَّهَوَاتِ، وَحُجِبَتِ الْجَنَّةُ بِالْمَكَارِهِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(70) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Zjarri është rrethuar me epshe, kurse Xheneti është rrethuar me vështirësi.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na sqaron në këtë hadith se Zjarri është i rrethuar nga gjëra që i dëshiron shpirti, bie fjala, kryerja e gjërave të ndaluara ose lënia pas dore e vaxhibeve (obligimeve fetare); andaj, kushdo që ndjek tekat dhe dëshirat e veta në këtë, e meriton Zjarrin. Ndërkaq, Xheneti është i rrethuar me gjëra që shpirti i urren, si: vazhdimësia në gjërat e urdhëruara, lënia e gjërave të ndaluara dhe durimi në këtë gjë, kështu që, nëse përpiqet për këtë, meriton të hyjë në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Një nga shkaqet e rënies në epshe është se shejtani e zbukuron të keqen dhe të shëmtuarën, që shpirti ta shohë si të mirë e të priret drejt saj.
2. Urdhri për t'u larguar nga dëshirat e ndaluara, sepse është rruga për në Zjarrin e Xhehenemit dhe durimi gjatë vështirësive, sepse është rruga për në Xhenet.
3. Vlera e vetëpërmbajtjes, zellit në adhurim dhe durimit gjatë vështirësive që i rrethojnë adhurimet.

(3702)

(71) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَمَّا خَلَقَ اللَّهُ الْجَنَّةَ وَالتَّارَ أَرْسَلَ جَبْرِيلَ عَلَيْهِ السَّلَامُ إِلَى الْجَنَّةِ، فَقَالَ: انْظُرْ إِلَيْهَا وَإِلَى مَا أَعَدَدْتُ لِأَهْلِهَا فِيهَا. فَنَظَرَ إِلَيْهَا فَرَجَعَ، فَقَالَ: وَعِزَّتِكَ لَا يَسْمَعُ بِهَا أَحَدٌ إِلَّا دَخَلَهَا. فَأَمَرَ بِهَا فَحُقَّتْ بِالْمَكَارِهِ، فَقَالَ: أَذْهَبَ إِلَيْهَا فَاَنْظُرْ إِلَيْهَا وَإِلَى مَا أَعَدَدْتُ لِأَهْلِهَا فِيهَا. فَنَظَرَ إِلَيْهَا، فَإِذَا هِيَ قَدْ حُقَّتْ بِالْمَكَارِهِ، فَقَالَ: وَعِزَّتِكَ لَقَدْ خَشِيتُ أَنْ لَا يَدْخُلَهَا أَحَدٌ. قَالَ: أَذْهَبَ فَاَنْظُرْ إِلَى التَّارِ وَإِلَى مَا أَعَدَدْتُ لِأَهْلِهَا فِيهَا. فَنَظَرَ إِلَيْهَا فَإِذَا هِيَ يَرْكَبُ بَعْضُهَا بَعْضًا، فَرَجَعَ فَقَالَ: وَعِزَّتِكَ لَا يَدْخُلُهَا أَحَدٌ. فَأَمَرَ بِهَا فَحُقَّتْ بِالشَّهَوَاتِ، فَقَالَ: ارْجِعْ فَاَنْظُرْ إِلَيْهَا. فَنَظَرَ إِلَيْهَا فَإِذَا هِيَ قَدْ حُقَّتْ بِالشَّهَوَاتِ، فَرَجَعَ وَقَالَ: وَعِزَّتِكَ لَقَدْ خَشِيتُ أَنْ لَا يَنْجُو مِنْهَا أَحَدٌ إِلَّا دَخَلَهَا». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

(71) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Kur Allahu e krijoi Xhenetin dhe Zjarrin, e dërgoi Xhibrilin (alejhi salam) në Xhenet dhe i tha: "Shikoje atë dhe çfarë kam përgatitur në të për banorët e tij!" E shikoi dhe u kthye, pastaj tha: "Pasha krenarinë Tënde, kushdo që do të dëgjojë për të, do të (mundohet të) hyjë në të." Atëherë (Allahu) urdhëroi që të rrethohet (Xheneti) me vështirësi. Sërish i tha: "Shko dhe shikoje atë dhe çfarë kam përgatitur në të për banorët e tij!" Kështu, e shikoi, kur ja, ishte rrethuar me vështirësi, kështu që tha: "Pasha krenarinë Tënde, kam frikë se askush nuk do të hyjë në të." (Allahu) i tha: "Shko shikoje Zjarrin dhe çfarë kam përgatitur në të për banorët e tij!" E shikoi atë, kur ja, ishte ndërtuar në shtresa një mbi një, kështu që u kthye dhe tha: "Pasha krenarinë Tënde, askush

nuk do (të dëshirojë) të hyjë në të!" Atëherë (Allahu) urdhëroi që të rrethohet (Zjarri) me epshe. Sërish i tha: "Kthehu dhe shikoje!" Kështu, e shikoi, kur ja, ishte rrethuar me epshe, kështu që u kthye dhe tha: "Pasha krenarinë Tënde, kam frikë se askush nuk do t'i shpëtojë hyrjes në të!"

[رواه أبو داود والترمذي والنسائي] - [Hadith hasen]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se, kur Allahu e krijoi

Xhenetin dhe Zjarrin, i tha Xhibrilit (alejhi selam): "Shko në Xhenet dhe shikoje atë!" Kështu ai shkoi dhe e shikoi, e pastaj u kthye. Xhibrili tha: "O Zot, pasha krenarinë Tënde, kushdo që dëgjon për të dhe për begatinë, nderimet dhe mirësitë që i përmban, do të dëshirojë të hyjë në të e të punojë për të. Pastaj Allahu e rrethoi Xhenetin me gjëra të padëshiruara dhe me vështirësi, bie fjala, me: kryerjen e urdhrave dhe shmangien e ndalesave. Andaj, kushdo që dëshiron të hyjë në Xhenet, duhet t'i kalojë këto vështirësi. Pastaj Allahu i Larmadhëruar i tha: "O Xhibril! Shko shikoje Xhenetin, pasi e kam rrethuar me vështirësi!" Kështu, shkoi dhe e shikoi atë, pastaj erdhi dhe tha: "O Zot, pasha krenarinë Tënde, kam frikë se askush nuk do të hyjë në të, për shkak të vështirësive që janë në rrugën drejt tij!" Ndërkaq, kur Allahu e krijoi Zjarrin, tha: "O Xhibril! Shko dhe shikoje atë!" Kështu, shkoi dhe e shikoi atë, pastaj erdhi dhe Xhibrili tha: "O Zot, pasha krenarinë Tënde, kushdo që dëgjon për dënimin, mundimin dhe torturën që gjendet në të, do ta urrejë të hyjë në të, kështu që do të qëndrojë larg shkaqeve që çojnë drejt tij!" Më pas, Allahu i Lartmadhëruar

e rrethoi Zjarrin dhe e bëri rrugën që çon tek ai (të përbërë) me epshe dhe kënaqësi. Pastaj tha: "O Xhibril, shko dhe shikoje atë!" Kështu, Xhibrili shkoi dhe e shikoi atë, pastaj u kthye dhe tha: "O Zot, pasha krenarinë Tënde, kam frikë se askush nuk do të shpëtojë prej tij, për shkak se është i rrethuar me epshe dhe kënaqësi."

Mësime nga hadithi:

1. Besimi se Xheneti dhe Zjarri ekzistojnë tani.
2. Është obligim të besohet në të fshehtën dhe në çdo gjë që ka ardhur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij ﷺ.
3. Rëndësia e durimit përballë vështirësive, sepse kjo është rruga drejt Xhenetit.
4. Rëndësia e shmangies së haramëve, sepse është rruga që dërgon drejt Zjarrit.
5. Xheneti u rrethua me vështirësi, ndërsa Zjarri me epshe. Kjo nënkupton sprovën dhe provimin në jetën e kësaj bote.
6. Rruga për në Xhenet është e vështirë, e mundimshme dhe kërkon durim e përpjekje, duke e shoqëruar me besim, ndërsa rruga për në Zjarr është e mbushur me kënaqësi dhe epshe të kësaj bote.

(65034)

(72) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «نَارُكُمْ جُزْءٌ مِنْ سَبْعِينَ جُزْءًا مِنْ نَارِ جَهَنَّمَ»، قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنْ كَانَتْ لَكَافِيَةً. قَالَ: «فُضِّلَتْ عَلَيْهِنَّ بِتِسْعَةٍ وَسِتِّينَ جُزْءًا كُلُّهُنَّ مِثْلُ حَرِّهَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(72) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Zjarri juaj është një e shtatëdhjeta pjesë e zjarrit të Xhehenemit.” Dikush i tha: "O i Dërguari i Allahut, edhe po të ishte sa zjarri i dynjasë, do të ishte i mjaftueshëm." Ai tha: “Ai (zjarri i Xhehenemit) është për gjashtëdhjetë e nëntë hise më i nxehtë. Secila hise ka nxehtësinë e zjarrit të kësaj bote.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se zjarri i kësaj bote është një e shtatëdhjeta pjesë e zjarrit të Xhehenemit. Zjarri i botës tjetër është gjashtëdhjetë e nëntë herë më i nxehtë se nxehtësia e zjarrit të kësaj bote, ku secila hise e tij është e barabartë me nxehtësinë e zjarrit të kësaj bote. Dikush tha: "O i Dërguari i Allahut, zjarri i kësaj bote do të mjaftonte për t'i dënuar ata që futen në të!" Ai tha: "Zjarri i Xhehenemit është gjashtëdhjetë e nëntë herë më i nxehtë. Secila hise ka nxehtësinë e zjarrit të kësaj bote.

Mësime nga hadithi:

1. Paralajmërim për Zjarrin, që njerëzit të rrinë larg veprimeve që çojnë drejt tij.

2. Madhësia e zjarrit të Xhehenemit dhe ndëshkimit të tij, si dhe nxhehtësia e tij e madhe.

(65036)

(73) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «يَقْبِضُ اللَّهُ الْأَرْضَ، وَيَطْوِي السَّمَوَاتِ بِيَمِينِهِ، ثُمَّ يَقُولُ: أَنَا الْمَلِكُ، أَتَيْنَ مُلُوكُ الْأَرْضِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(73) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: “Allahu do ta kapë Tokën, ndërsa qiejt do t'i palosë me të Djathtën e Tij, pastaj do të thotë: "Unë jam Mbreti! Ku janë mbretërit e Tokës?" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se Allahu i Lartësuar, në Ditën e Kiametit, do ta kapë dhe do ta tubojë Tokën, ndërsa qiejt do t'i palosë me Dorën e Tij të djathtë dhe do t'i mbështjellë njërin mbi tjetrin e pastaj do t'i asgjësojë e do t'i zhdukë, e më pas do të thotë: "Unë jam Mbreti! Ku janë mbetërit e Tokës?!"

Mësime nga hadithi:

1. Rikujtim se mbretëria e Allahut do të jetë e vazhdueshme, ndërsa mbretëria e të tjerëve do të zhduket.

2. Madhëria e Allahut dhe madhështia e fuqisë, pushtetit dhe mbretërisë së Tij të përsosur.

(65028)

(74) – عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: دَخَلَ عَلَيَّ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، وَقَدْ سَتَرْتُ سَهْوَةً لِي بِقِرَامٍ فِيهِ تَمَائِيلٌ، فَلَمَّا رَأَاهُ هَتَكَهُ وَتَلَوْنَ وَجْهَهُ وَقَالَ: «يَا عَائِشَةُ، أَشَدُّ النَّاسِ عَدَابًا عِنْدَ اللَّهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ الَّذِينَ يُصَاهُونَ بِخَلْقِ اللَّهِ» قَالَتْ عَائِشَةُ: «فَقَطَعْنَا مِنْهُ وَسَادَةً أَوْ وَسَادَتَيْنِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(74) – Nga Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë: "Njëherë Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) erdhi në dhomën time dhe unë kisha mbuluar një dollap me një pëlhurë në të cilën kishte figura frymorësh. Kur e pa, atij i ndryshoi ngjyra e fytyrës dhe pasi e grisi atë, tha: 'O Aishe, njerëzit që do të kenë dënimin më të ashpër tek Allahu në Ditën e Gjykimit, janë ata që imitojnë krijimin e Allahut.'" Aishja tha: "Ne e premë atë dhe me të bëmë një ose dy jastëkë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) hyri në dhomën e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe pa që ajo kishte mbuluar një dollap të vogël, ku vendosen sendet, me një pëlhurë në të cilën kishte piktura frymorësh. Nga zemërimi për Allahun, Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) i ndryshoi ngjyra e fytyrës, e hoqi pëlhurën dhe tha: "Njerëzit që do të kenë dënimin më të ashpër në Ditën e Gjykimit do të jenë

ata që përpiqen të imitojnë Allahun, duke pikturuar krijesat e Allahut." Aisheja tha që e prenë atë pëlhurë dhe me të bënë një ose dy jastëkë.

Mësime nga hadithi:

1. E keqja duhet kritikuar që në çastin e parë që shihet dhe nuk duhet vonuar, me përjashtim kur një gjë e tillë sjell një dëm më të madh.
2. Dënimi në Ditën e Gjykimit ndryshon sipas madhësisë së mëkatit.
3. Portretizimi i frymorëve është prej mëkateve të mëdha.
4. Prej urtësisë së ndalimit të portretizimit të frymorëve është se një gjë e tillë është imitim i krijimit të Allahut të Madhëruar, pa dallim nëse portretizuesi e synon imitimin apo jo.
5. Sheriati ka treguar kujdes në ruajtjen e pasurisë, duke e lejuar shfrytëzimin e saj pas heqjes së pjesës së ndaluar.
6. Nuk lejohet portretizimi i frymorëve në mënyrë kategorike edhe nëse bëhet me qëllim për t'i poshtëruar.

(5931)

(75) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ، لَيُوشِكَنَّ أَنْ يَنْزَلَ فِيكُمْ ابْنُ مَرْيَمَ حَكَمًا مُفْسِطًا، فَيَكْسِرَ الصَّلِيبَ، وَيَقْتُلَ الْخَنَزِيرَ، وَيَضَعَ الْحِزْيَةَ، وَيَفِيضَ الْمَالَ حَتَّى لَا يَقْبَلَهُ أَحَدٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(75) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se është afruar koha kur Isai, i biri Merjemes, do të zbresë mes jush dhe do të gjykojë me drejtësi: do ta thyejë kryqin, do ta mbysë derrin dhe do ta shfuqizojë xhizjen. Pasuria do të rrjedhë aq shumë, saqë askush nuk do të ketë nevojë për të.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith u betua se zbritja e Isait, të birit të Merjemes (alejhi selam) është e afërt, i cili do të gjykojë mes njerëzve me drejtësi, sipas sheriatit muhamedan, do ta thyejë kryqin, të cilin e madhërojnë të krishterët dhe Isai (alejhi selam) do ta mbysë derrin. Gjithashtu Isai (alejhi selam) do ta shfuqizojë xhizjen dhe do të kërkojë nga të gjithë njerëzit që të futen në Islam. Pasuria në atë kohë do të rrjedhë aq shumë, saqë askush nuk do ta pranojë. Kjo, për shkak të bollëkut të saj dhe se çdo njeriu do t'i mjaftojë ajo që ka në duart e tij: begatitë do të zbresin dhe të mirat do të jenë të vazhdueshme.

Mësime nga hadithi:

1. Pohimi se Isai (alejhi selam) do të zbresë në fund të kohës (para Kiametit) dhe se ai është prej shenjave të Kiametit.
2. Sheriatin e Profetit Muhamed ﷺ nuk e shfuqizon asnjë sheriat tjetër.
3. Begatitë e të mirat do të zbresin në fund të kohës (para Kiametit), ndërsa njerëzit do t'i kushtojnë rëndësi atyre.
4. Sihariq se feja islame do të vazhdojë, meqë Isai (alejhi selam) me të do të gjykojë në fund të kohës (para Kiametit).

(65025)

(76) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لِعَمِّهِ: «قُلْ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، أَشْهَدُ لَكَ بِهَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ»، قَالَ: لَوْلَا أَنْ تُعَبِّرَنِي قُرَيْشٌ، يَقُولُونَ: إِنَّمَا حَمَلَهُ عَلَى ذَلِكَ الْجَزَعُ لَأَقَرَّرْتُ بِهَا عَيْنَكَ. فَأَنْزَلَ اللَّهُ: {إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ} [القصص: 56]. [صحيح] - [رواه مسلم]

(76) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ i tha xhaxhait të vet: “Thuaj: "La ilahe il-lallah, që të dëshmoj për ty në Ditën e Kiametit.” Ai ia ktheu: "Sikur kurejshët të mos ma llogarisnin për turp, do të ta gëzoja zemrën duke e shqiptuar atë, por ata do të thonë: "Frika ishte ajo që e shtyu të thoshte kështu." - Atëherë

Allahu zbriti ajetin: “Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.” (El Kasas, 56) [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i kërkoi xhaxhait të tij, Ebu Talibit, derisa ishte në grahmat e vdekjes, të thoshte: "La ilahe ilallah", që të ndërmjetësonte për të me këtë fjalë në Ditën e Kiametit dhe të dëshmonte se ishte bërë musliman. Ai nuk pranoi ta shqiptonte dëshminë (shehadetin) nga frika se kurejshët do ta shanin dhe do të thoshin: "Ai u bë musliman nga frika e vdekjes dhe për shkak të dobësisë!" Prandaj ai i tha Profetit ﷺ: "Po të mos ishte kjo, do të fusja gëzim në zemrën tënde duke e shqiptuar dëshminë (shehadetin) dhe do ta realizoja dëshirën tënde derisa të kënaqeshe!" Kështu, Allahu i Lartësuar e zbriti ajetin që tregon se Profeti ﷺ nuk e ka në dorë udhëzimin e suksesit, që dikush të bëhet musliman, por vetëm Allahu i Lartmadhëruar i jep sukses kujt të dojë, ndërsa Profeti ﷺ i udhëzon njerëzit me udhërrëfim, sqarim, përudhje dhe thirrje në rrugën e drejtë.

Mësime nga hadithi:

1. E vërteta nuk braktiset nga frika e asaj që thonë njerëzit.
2. Profeti ﷺ e ka në dorë udhëzimin e përudhjes dhe tregimit të rrugës, e jo udhëzimin e suksesit.

3. Është e lejuar që i sëmuri jobesimtar të vizitohet, për ta ftuar në Islam.
4. Kujdesi që tregonte Profeti ﷺ për të ftuar tek Allahu i Lartësuar, në çdo gjendje dhe në çdo situatë.

(65069)

(77) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «حَوْضِي مَسِيرَةُ شَهْرٍ، مَاءُهُ أَبْيَضُ مِنَ اللَّبَنِ، وَرِيحُهُ أَطْيَبُ مِنَ الْمِسْكِ، وَكَيْزَانُهُ كَنْجُومِ السَّمَاءِ، مَنْ شَرِبَ مِنْهَا فَلَا يَظْمَأُ أَبَدًا». [صحيح] - [متفق عليه]

(77) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Gjerësia e Hauzit tim është sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është më e mirë se myshku, enët e tij janë sikurse yjet e qiellit. Kush pi prej tij, nuk do të ketë etje kurrë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se ai do të ketë Hauz (Pellg) në Ditën e Kiametit, gjatësia dhe gjerësia e të cilit do të jetë sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është e pastër dhe më e këndshme se aroma e myshkut, enët e tij janë sikurse yjet në qiell, pra, aq shumë. Kush pi prej Hauzit me këto enë, nuk do të ketë etje kurrë.

Mësime nga hadithi:

1. Hauzi i Profetit ﷺ është një pellg - vendtubim i madh uji tek i cili do të shkojnë besimtarët nga umeti i tij në Ditën e Kiametit.
2. Ai që pi nga Hauzi do të jetë i begatuar, meqë nuk do të ketë kurrë etje.

(65030)

(78) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يُؤْتَى بِالْمَوْتِ كَهَيْئَةِ كَبْشٍ أَمْلَحَ، فَيَنَادِي مُنَادٍ: يَا أَهْلَ الْجَنَّةِ، فَيَشْرَبُونَ وَيَنْظُرُونَ، فَيَقُولُ: هَلْ تَعْرِفُونَ هَذَا؟ فَيَقُولُونَ: نَعَمْ، هَذَا الْمَوْتُ، وَكُلُّهُمْ قَدْ رَأَاهُ، ثُمَّ يُنَادِي: يَا أَهْلَ النَّارِ، فَيَشْرَبُونَ وَيَنْظُرُونَ، فَيَقُولُ: هَلْ تَعْرِفُونَ هَذَا؟ فَيَقُولُونَ: نَعَمْ، هَذَا الْمَوْتُ، وَكُلُّهُمْ قَدْ رَأَاهُ، فَيَذْبَحُ ثُمَّ يَقُولُ: يَا أَهْلَ الْجَنَّةِ خُلُودٌ فَلَا مَوْتَ، وَيَا أَهْلَ النَّارِ خُلُودٌ فَلَا مَوْتَ، ثُمَّ قَرَأَ: {وَأَنذَرُكُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ إِذْ قُضِيَ الْأَمْرُ وَهُمْ فِي غَفْلَةٍ} [مريم: 39]، وَهَؤُلَاءِ فِي غَفْلَةٍ أَهْلُ الدُّنْيَا {وَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ} [مريم: 39]».

[صحيح] - [متفق عليه]

(78) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Vdekja do të sillet në formë të një dashi laraman dhe dikush do të thërrasë: "O banorë të Xhenetit!" Ata do t'i zgjasin kokat për të shikuar. Thirrësi pyet: "E njihni këtë?" Ata thonë: "Po, kjo është vdekja." Profeti ﷺ thotë: "Dhe, të gjithë tanimë e kanë parë." Pastaj thërret: "O banorë të Zjarrit!" Ata i zgjasin kokat për të shikuar. Ai pyet: "E njihni këtë?" Ata thonë:

"Po, kjo është vdekja." Profeti ﷺ thotë: "Dhe, të gjithë tanimë e kanë parë." Në atë rast ajo theret dhe thirrësi thotë: "O banorë të Xhenetit, jetoni përjetësisht, se nuk ka më vdekje, dhe, o banorë të Zjarrit, jetoni përjetësisht, se nuk ka më vdekje!" Pastaj, i Dërguari i Allahut ﷺ lexoi ajetin: "Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë." (Merjem, 39) Këta, që përshkruhen se janë të shkujdesur, janë njerëzit që jepen pas dynjasë. [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se vdekja do të sillet në Ditën e Kiametit në formën e një dashi, i cili ka (ngjyrë) të bardhë dhe të zezë. Do të bëhet thirrja: "O banorë të Xhenetit!" Ata do t'i zgjasin qafat dhe do t'i ngrenë kokat për të shikuar. Ai pyet: "A e njihni këtë?" Ata thonë: "Po, kjo është vdekja." Dhe, të gjithë tanimë e shohin dhe e njohin. Pastaj thirrësi thërret: "O banorë të Xhehenemit!" Ata do t'i zgjasin qafat dhe do t'i ngrenë kokat për të shikuar. Ai pyet: "E njihni këtë?" Ata thonë: "Po, kjo është vdekja." Dhe, të gjithë tanimë e kanë parë; pastaj ajo theret. Në atë rast thirrësi thotë: "O banorë të Xhenetit, jetoni përjetësisht, se nuk ka më vdekje, dhe, o banorë të Zjarrit, jetoni përjetësisht, se nuk ka më vdekje!" E, kjo do të jetë shtim për lumturinë e besimtarëve dhe hakmarrje për t'i dënuar jobesimtarët. Pastaj Profeti ﷺ lexoi ajetin: "Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë."

(Merjem, 39) Dita e Kiametit bën që të ndahen banorët e Xhenetit dhe të Zjarrit, ku secili do të hyjë në atë që ka ndjekur dhe do të qëndrojë aty përgjithmonë. Keqbërësi pendohet dhe i bie pishman përse nuk ka bërë mirë, gjithashtu ai që u tregua i mangët i bie pishman përse nuk shtoi më shumë vepra të mira.

Mësimet nga hadithi:

1. Fundi i njeriut në botën tjetër është përjetësia në Xhenet ose në Zjarr.
2. Paralajmërimi i ashpër për tmerrin e Ditës së Kiametit dhe se ajo është Dita e Pikëllimit dhe Pendimit.
3. Sqarimi se banorët e Xhenetit do të jenë të lumtur në vazhdimësi dhe se banorët Zjarrit do të jenë të pikëlluar në vazhdimësi.

(65035)

(79) – عن عمر بن الخطاب رضي الله عنه قال: إنه سمع نبي الله صلى الله عليه وسلم يقول: «لَوْ أَنَّكُمْ تَتَوَكَّلُونَ عَلَى اللَّهِ حَقَّ تَوَكُّلِهِ، لَرَزَقَكُمْ كَمَا يَرْزُقُ الطَّيْرَ، تَغْدُو خِمَاصًا وَتَرُوحُ بِطَانًا». [صحيح] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(79) – Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin e Allahut ﷺ të thotë: "Sikur të mbështeteshit tek Allahu denjësisht, do t'ju furnizonte siç

i furnizon zogjtë: gdhihen barkzbrazur, por kthehen barkplotë." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na inkurajon që të mbështetemi tek Allahu i Lartmadhëruar për sjelljen e gjërave të dobishme dhe për të larguar gjërat e dëmshme, në çështjet e kësaj bote dhe në ato të fesë. Kjo, se nuk jep, as privon, as sjell dëm e as dobi askush përveç Allahut të Lartësuar. Gjithashtu na nxit t'i veprojmë shkaqet që i sjellin gjërat e dobishme dhe i largojnë gjërat e dëmshme, duke u mbështetur sinqerisht në Allahun. Kur e bëjmë këtë, Allahu na furnizon ashtu siç i furnizon zogjtë, të cilët dalin në mëngjes të uritur e pastaj kthehen në mbrëmje me barkun plot. Ky veprim i zogjve është një lloj shkaku për të bërë përpjekje për të kërkuar ushqim, e jo për të qenë pasivë e përtacë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e mbështetjes (në Allahun) dhe se ajo është ndër faktorët më madhështorë për përfitimin e rizkut.
2. Mbështetja (në Allahun) nuk bie në kundërshtim me marrjen e masave, sepse Profeti ﷺ njoftoi se mbështetja e vërtetë nuk kundërshtohet nëse dilet në mëngjes e në mbrëmje në kërkim të rizkut.
3. Feja u kushtoi rëndësi veprave të zemrës, për faktin se mbështetja (në Allahun) është vepër e zemrës.

4. Lidhja vetëm pas shkaqeve është mangësi në fe, ndërsa mosmarrja e shkaqeve është mangësi në mendje.

(4721)

(80) - عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «نِعْمَتَانِ مَغْبُورٌ فِيهِمَا كَثِيرٌ مِنَ النَّاسِ: الصَّحَّةُ وَالْفَرَاغُ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(80) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ndaj dy mirësive shumica e njerëzve janë të shkujdesur: Ndaj shëndetit dhe kohës së lirë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka treguar për dy begati të mëdha, që Allahu ia dhuron njeriut, në të cilat shumë njerëz pësojnë humbje, ngase i përdorin ato në mënyrë të gabuar. Kur njeriu është i begatuar me shëndet dhe kohë të lirë, por e kaplon dembelia për adhurim, atëherë ai është prej të humburve; e kjo është gjendja e shumicës së njerëzve. Por, nëse njeriu e shfrytëzon kohën e tij të lirë dhe shëndetin në adhurim ndaj Allahut, atëherë ai është fitimtar, sepse kjo botë është vendi i mbjelljes për botën tjetër, dhe në të zhvillohet tregtia, fitimi i së cilës do të shfaqet në botën tjetër. Pas kohës së lirë vjen angazhimi, dhe pas shëndetit vjen sëmundja, e nëse nuk do të kishte asgjë tjetër për t’u kujtuar, do të mjaftonte pleqëria si këshillë.

Mësime nga hadithi:

1. Personi që është i ngarkuar me përgjegjësi fetare krahasohet me një tregtar, ndërsa shëndeti dhe koha e lirë krahasohen me kapitalin; ai që e shfrytëzon mirë kapitalin e tij do të arrijë sukses dhe fitim, ndërsa ai që e shpërdoron do të përjetojë humbje dhe keqardhje.
2. Ibën Hazini ka thënë: “Mirësia është diçka që njeriu e shijon dhe gjen kënaqësi në të, kurse mashtrimi nënkupton të blesh diçka shumë më shtrenjtë sesa vlen, ose ta shesësh më lirë sesa vlera e saj reale. Kështu që, kush ka trup të shëndetshëm dhe është i lirë nga angazhime të lodhshme, por nuk përpiket për përmirësimin e ahiretit të tij, është si ai që është mashtruar në një tregti.”
3. Kujdesi për të përfitur nga shëndeti dhe koha e lirë me qëllim afrimin tek Allahu i Lartmadhëruar dhe kryerjen e veprave të mira para se ato të humbin (është mënyra e të kuptuarit të vërtetë të këtyre mirësive).
4. Shprehja e falënderimit ndaj Allahut për begatitë e Tij bëhet duke i shfrytëzuar ato në adhurim ndaj Tij.
5. Kadi Ijadi dhe Ebu Bekër ibnul Arabiu kanë thënë: “Ka mospajtim lidhur me atë se cila është mirësia e parë që Allahu ia dhuron një robi. Disa thonë se është imani, të tjerë thonë jeta, dhe disa të tjerë

thonë shëndeti. Mendimi më i saktë është se imani është mirësia e parë, sepse ajo është mirësi absolute, ndërsa jeta dhe shëndeti janë mirësi të kësaj bote, dhe konsiderohen të tilla vetëm nëse shoqërohen me iman. Pikërisht këtu shumica e njerëzve mashtrohen me këto mirësi, pra, fitimi i tyre humbet ose pakësohet. Kush i jepet shpirtit të tij që e urdhëron për të keqe, që kërkon vetëm rehatinë, duke neglizhuar përmbajtjen brenda kufijve të Allahut dhe qëndrueshmërinë në adhurim, është i mashtruar. Po ashtu, nëse një person ka kohë të lirë, ai është më i ngarkuar me përgjegjësi sesa ai që është i zënë, sepse ai që është i zënë mund të ketë ndonjë arsyetim, ndërsa ai që ka kohë të lirë nuk ka asnjë justifikim dhe i është ngritur argumenti."

(5449)

(81) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يُسَلِّمُ الرَّاَكِبُ عَلَى الْمَاشِي، وَالْمَاشِي عَلَى الْقَاعِدِ، وَالْقَلِيلُ عَلَى الْكَثِيرِ». وَلِلْبُخَارِيِّ: «يُسَلِّمُ الصَّغِيرُ عَلَى الْكَبِيرِ، وَالْمَارُّ عَلَى الْقَاعِدِ، وَالْقَلِيلُ عَلَى الْكَثِيرِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(81) – Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Profeti i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Ai që është në mjet i jep selam atij që është në këmbë. Ai që është në këmbë i jep selam atij që është ulur. Ata që janë

pak i japin selam atyre që janë shumë." [Ky hadith është sahih]

- [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti (paqja qoftë mbi të!) na ka mësuar etikën e përshëndetjes me selam midis njerëzve me shprehjen: "Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu!" Andaj, i vogli duhet t'i japë selam të madhit, ai që është në mjet duhet t'i japë atij që është në këmbë, ai që është në këmbë duhet t'i japë atij që është ulur dhe ata që janë pak në numër duhet t'i japin atyre që janë shumë.

Mësime nga hadithi:

1. Pëlqehet që selami të jepet në mënyrën që është cekur në këtë hadith, por nëse ai që është në këmbë i jep selam atij që është në mjet apo përdoret ndonjë formë tjetër ndryshe nga ajo që është cekur në hadith, atëherë një gjë e tillë lejohet, por ajo është në kundërshtim me formën më të mirë dhe më të preferuar.
2. Përhapja e selamit në formën që është cekur në hadith është pjesë e shkaqeve të dashurisë dhe të harmonisë.
3. Nëse palët janë njësoj dhe të barabartë, atëherë më i miri prej tyre është ai që jep selam i pari.
4. Legjislacioni islam është i përsosur dhe jep shpjegime për çdo gjë që i nevojitet njerëzimit.

5. Mësimi i normave të selamit dhe dhënia e secilit të drejtën që i takon.

(4243)

(82) - عن أبي ذر رضي الله عنه: عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِيمَا رَوَى عَنِ اللَّهِ تَبَارَكَ وَتَعَالَى أَنَّهُ قَالَ: «يَا عِبَادِي إِنِّي حَرَمْتُ الظُّلْمَ عَلَى نَفْسِي، وَجَعَلْتُهُ بَيْنَكُمْ مُحَرَّمًا، فَلَا تَظَالَمُوا، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ ضَالٌّ إِلَّا مَنْ هَدَيْتُهُ، فَاسْتَهْدُونِي أَهْدِكُمْ، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ جَائِعٌ إِلَّا مَنْ أَطْعَمْتُهُ، فَاسْتَطْعِمُونِي أُطْعِمَكُمْ، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ عَارٍ إِلَّا مَنْ كَسَوْتُهُ، فَاسْتَكْسُونِي أَكْسُكُمْ، يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ تُخْطِئُونَ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَأَنَا أَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا فَاسْتَغْفِرُونِي أَغْفِرْ لَكُمْ، يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ لَنْ تَبْلُغُوا ضُرِّي فَتَضُرُّونِي، وَلَنْ تَبْلُغُوا نَفْعِي فَتَنْفَعُونِي، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوْلَكُمْ وَأَخْرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجَنَّتْكُمْ كَانُوا عَلَى قَلْبِ رَجُلٍ وَاحِدٍ مِنْكُمْ مَا زَادَ ذَلِكَ فِي مُلْكِي شَيْئًا، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوْلَكُمْ وَأَخْرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجَنَّتْكُمْ كَانُوا عَلَى أَفْجَرِ قَلْبِ رَجُلٍ وَاحِدٍ مَا نَقَصَ ذَلِكَ مِنْ مُلْكِي شَيْئًا، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوْلَكُمْ وَأَخْرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجَنَّتْكُمْ قَامُوا فِي صَعِيدٍ وَاحِدٍ فَسَأَلُونِي فَأَعْطَيْتُ كُلَّ إِنْسَانٍ مَسْأَلَتَهُ مَا نَقَصَ ذَلِكَ مِمَّا عِنْدِي إِلَّا كَمَا يَنْقُصُ الْمَخِيطُ إِذَا أُدْخِلَ الْبَحْرَ، يَا عِبَادِي إِنَّمَا هِيَ أَعْمَالُكُمْ أَحْصِيهَا لَكُمْ ثُمَّ أَوْفِيكُمْ بِهَا، فَمَنْ وَجَدَ خَيْرًا فَلْيَحْمَدِ اللَّهَ، وَمَنْ وَجَدَ غَيْرَ ذَلِكَ فَلَا يَلُومَنَّ إِلَّا نَفْسَهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(82) - Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ tregon se Allahu i Lartësuar thotë: "O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë dhe e kam bërë të ndaluar edhe ndërmjet jush, andaj mos i bëni

padrejtësi njëri-tjetrit. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të devijuar, përveç atij që Unë e udhëzoj, andaj më kërkoni udhëzim, që t'ju udhëzoj. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të uritur, përveç atij që Unë e ushqej, andaj më kërkoni ushqim, që t'ju ushqej. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të zhveshur, përveç atij që Unë e vesh, andaj më kërkoni veshmbathje, që t'ju furnizoj me të. O robërit e Mi! Ju bëni gabime natë e ditë, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet, andaj më kërkoni falje, që t'ju fal. Ju kurrë nuk do të arrini të më bëni dëm e as që do të keni mundësi të më bëni dobi. O robërit e Mi, edhe po qe se të gjithë ju, i pari e i fundit, përfshirë njerëzit e xhinët, bëheni si njeriu më zemërmirë prej jush, kjo gjë aspak nuk do ta shtonte sundimin Tim. O robërit e Mi, edhe nëse të gjithë njerëzit e xhinët, fillim e mbarim, bëheni si njeriu më zemërprishur nga mesi juaj, kjo gjë as që do të pakonte sundimin Tim. O robërit e Mi, në qoftë se të gjithë njerëzit e xhinët, fund e krye, tubohen në një vend, më drejtohen me kërkesa e Unë i jap gjithsecilit atë që kërkon, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga ajo që gjendet tek Unë, respektivisht aq sa përthith gjilpëra kur futet në det. O robërit e Mi! Vërtet ato janë veprat tuaja, të cilat i ruaj e më pas jua shpërblej, kështu që, kushdo që gjen mirë, le ta falënderojë Allahun, ndërsa, ai që gjen keq, le ta qortojet vetëm vetveten." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na sqaron se Allahu i Lartmadhëruar ia ka ndaluar padrejtësinë Vetvetes dhe e ka bërë të ndaluar te krijesat e Tij, në mënyrë që askush të mos

i bëjë padrejtësi ndokujt tjetër. Të gjithë njerëzit janë të devijuar nga rruga e vërtetë, përveç atyre që i udhëzon Allahu e u jep sukses, kështu që, atij që i kërkon Allahut udhëzim, Ai i jep sukses dhe udhëzim. Njerëzit janë të varfër dhe nevojtarë për Allahun në të gjitha nevojat e tyre, andaj, kushdo që i kërkon Allahut, Ai ia plotëson e nevojat dhe i mjafton. Ata mëkatojnë gjatë ditës e natës dhe Allahu i Lartësuar ia mbulon e ia fal robit kur ai kërkon falje. Ata nuk kanë mundësi aspak t'i bëjnë dëm e as dobi Allahut. Ata edhe sikur të bëheshin si njeriu më zemërmirë, kjo gjë aspak nuk do ta shtonte sundimin e Allahut. Ata edhe sikur të bëheshin si njeriu më zemërprishur, kjo gjë nuk do të pakonte sundimin e Tij, sepse janë të dobët e të varfër për Allahun; nevojtarë për Të në çdo gjendje, kohë e vend, e Ai është i Vetëmjaftueshmi, i Latësuari. Nëse ata do të qëndronin në një vend, njerëzit dhe xhinët, fund e krye, duke e lutur Allahun dhe Ai do t'i jepte secilit prej tyre atë që kërkon, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga ajo që ka Allahu, sikurse një gjilpërë, nëse futet në det dhe pastaj hiqet, nuk do të pakësonte asgjë prej detit. Kjo është për shkak të vetëmjaftueshmërisë së përsosur të Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar i ruan veprat e robërve, ua llogarit dhe i shpërblen për to në Ditën e Kiametit. Andaj, kushdo që e gjen shpërblimin për punën e tij të mirë, le ta falënderojë Allahun që i dha sukses t'i bindet Atij, e, kushdo që e gjen shpërblimin e punës së tij, të jetë diçka tjetër, atëherë le të mos qortojë askënd pos vetes - shpirtit, i cili është i prirur për të keqen, gjë që e dërgoi në humbje.

Mësime nga hadithi:

1. Ky hadith është nga ato që Profeti ﷺ i transmeton nga Zoti i tij dhe quhet hadith i shenjtë (ar. kudsij) ose hyjnor, që shprehja dhe kuptimi i tij janë nga Allahu, vetëm se nuk i ka karakteristikat e Kuranit, që e dallojnë atë nga çdo gjë tjetër, si: të bërët adhurim me leximin e Kuranit, të qenët i pastër gjatë leximit, sfidimi (që të sjellin një të ngjashëm me të), paimitueshmëria etj.
2. Dijen dhe udhëzimin që e arrijnë robërit është prej udhëzimit dhe dijes që ua jep Allahu.
3. Çdo e mirë që i ndodh robit është nga mirësia e Allahut të Lartësuar dhe çdo e keqe që i ndodh atij është nga vetë ai dhe dëshirat e tij.
4. Kush bën vepra të mira, kjo është me suksesin e Allahut, ndërsa shpërblimin që e merr, e ka si mirësi prej Allahut, të Cilit i takon lavdërimi. E, kush bën keq, të mos qortojë askënd pos vetes.

(4810)

(83) - عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «اتَّقُوا الظُّلْمَ، فَإِنَّ الظُّلْمَ ظُلُمَاتٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ، وَاتَّقُوا الشُّحَّ، فَإِنَّ الشُّحَّ أَهْلَكَ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ، حَمَلَهُمْ عَلَى أَنْ سَفَكُوا دِمَاءَهُمْ وَاسْتَحْلَوْا مَحَارِمَهُمْ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(83) – Nga Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Ruhuni nga padrejtësia, sepse padrejtësia është errësirë në Ditën e Gjykimit. Ruhuni nga koprracia, sepse koprracia i shkatërroi ata që ishin para jush. I shtyu që të derdhin gjakun e njëri-tjetrit dhe të përligjin uzurpimin e të drejtave të njëri-tjetrit." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka paralajmëruar nga padrejtësia. Ndër format e padrejtësisë janë: padrejtësia ndaj njerëzve, padrejtësia ndaj vetes dhe padrejtësia kundrejt detyrimeve që njeriu ka ndaj Allahut të Madhëruar. Përkufizimi i padrejtësisë është: të mos i japësh tjetrit të drejtën që i takon. Padrejtësia do të jetë errësirë në Ditën e Gjykimit ndaj atyre që kanë bërë padrejtësi, duke krijuar vështirësi dhe frikë për ta. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ndaloi gjithashtu nga koprracia, e cila do të thotë të jesh shumë dorështrënguar dhe lakmitar i madh. Pjesë e koprracisë është dhe shkujdesja ndaj detyrimeve monetare dhe lakmia e madhe për të mirat materiale. Pikërisht kjo formë e padrejtësisë i shkatërroi popujt që jetuan para nesh,

duke i shtyrë ata të vrisnin njëri-tjetrin dhe të përlegnin gjërat që Allahu i pati ndaluar.

Mësime nga hadithi:

1. Ndhima monetare dhe solidarizimi janë pjesë e shkaqeve që krijojnë dashuri dhe marrëdhënie të mira midis vëllezërve.
2. Dorështrëngimi dhe koprracia i tërheqin njerëzit drejt mëkateve, paturpësive dhe krimeve.
3. Besimtarët duhet të marrin mësim nga popujt e mëparshëm.

(5787)

(84) - عن أبي موسى رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ اللَّهَ لَيُمْلِي لِلظَّالِمِ، حَتَّى إِذَا أَخَذَهُ لَمْ يُفْلِتْهُ» قَالَ: ثُمَّ قَرَأَ: «وَكَذَلِكَ أَخَذُ رَبِّكَ إِذَا أَخَذَ الْقُرَى وَهِيَ ظَالِمَةٌ إِنَّ أَخَذَهُ أَلِيمٌ شَدِيدٌ» [هود: 102] [صحيح] - [متفق عليه]

(84) – Ebu Musai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu e lë zullumqarin të vazhdojë me zullumin e tij, që, kur ta dënojë, të mos shpëtojë”, pastaj e lexoi ajetin: “I tillë është dënimi i Zotit tënd, kur ndëshkon vendbanimet që bënin gjynahe. Me të vërtetë, dënimi i Tij është i dhembshëm dhe i ashpër.” (Hud, 102) [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tërheq vërejtjen nga vazhdimësia në padrejtësi përmes mëkatit, idhujtarisë dhe duke u bërë padrejtësi njerëzve në të drejtat e tyre. Allahu i Lartësuar i jep afat zullumqarit, e vonon e ia zgjat jetën dhe pasurinë, kështu që nuk ia përshpejton dënimin. E, nëse nuk pendohet, do ta dënojë dhe nuk do ta lërë, për shkak të padrejtësive të shumta që i ka bërë.

Pastaj lexoi ajetin: “I tillë është dënimi i Zotit tënd, kur ndëshkon vendbanimet që bënin gjynahe. Me të vërtetë, dënimi i Tij është i dhembshëm dhe i ashpër.” (Hud, 102)

Mësime nga hadithi:

1. Njeriu i mençur duhet të nxitojë të pendohet dhe nuk duhet të jetë i sigurt nga të papriturat e Allahut, nëse vazhdon në padrejtësi.
2. Allahu i Lartësuar u jep afat të padrejtëve dhe nuk shpejton për t'i dënuar, duke i afatizuar kështu, në mënyrë që t'ua shtojë dënimin, nëse nuk pendohen.
3. Padrejtësia është shkak që Allahu i dënon popujt.
4. Nëse Allahu shkatërron një qytet, ku mund të ketë njerëz të devotshëm, atëherë ata do të ringjallen në Ditën e Kiametit në atë gjendje devotshmërie që ishin, e nuk do të dëmtohen nëse i përfshin dënimi.

(5811)

(85) - عن ابن عباس رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم فيما يروى عن ربه عز وجل قال: قال: «إِنَّ اللَّهَ كَتَبَ الْحَسَنَاتِ وَالسَّيِّئَاتِ، ثُمَّ بَيَّنَ ذَلِكَ، فَمَنْ هَمَّ بِحَسَنَةٍ فَلَمْ يَعْمَلْهَا كَتَبَهَا اللَّهُ لَهُ عِنْدَهُ حَسَنَةً كَامِلَةً، فَإِنْ هُوَ هَمَّ بِهَا فَعَمِلَهَا كَتَبَهَا اللَّهُ لَهُ عِنْدَهُ عَشْرَ حَسَنَاتٍ إِلَى سَبْعِمِائَةٍ ضَعِيفٍ، إِلَى أَضْعَافٍ كَثِيرَةٍ، وَمَنْ هَمَّ بِسَيِّئَةٍ فَلَمْ يَعْمَلْهَا كَتَبَهَا اللَّهُ لَهُ عِنْدَهُ حَسَنَةً كَامِلَةً، فَإِنْ هُوَ هَمَّ بِهَا فَعَمِلَهَا كَتَبَهَا اللَّهُ لَهُ سَيِّئَةً وَاحِدَةً». [صحيح] - [متفق عليه]

(85) – Abdullah Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ përcjell se Allahu i Lartmadhërishëm ka thënë: "Me të vërtetë, Allahu i ka caktuar veprat e mira dhe të këqijat, pastaj i ka sqaruar. Nëse dikush dëshiron të bëjë ndonjë vepër të mirë, por nuk e bën, Allahu i shkruan një shpërblim të plotë. Mirëpo, nëse dëshiron ta bëjë atë dhe e bën, Allahu ia shkruan dhjetë shpërblime, madje ia shton deri në shtatëqindfish, bile-bile edhe më shumë se kaq. Ndërkaq, nëse dëshiron të kryejë ndonjë vepër të keqe, por nuk e bën, Allahu ia shkruan një shpërblim të plotë. Por, nëse dëshiron ta kryejë atë dhe e kryen, atëherë Allahu ia shkruan vetëm një të keqe." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ sqaron në këtë hadith se Allahu i caktoi veprat e mira e të këqijat dhe ua sqaroi dy melekëve se si t'i shkruajnë ato:

Kushdo që dëshiron, synon dhe vendos të bëjë një vepër të mirë, do t'i shënohet një vepër e mirë, edhe nëse nuk e bën, e, nëse e bën, do t'i shënohet dhjetëfish deri në shtatëqindfish, bile-bile edhe më shumë se kaq. Shtimi i shpërblimit është sipas sinjeritetit që është në zemër dhe tejkalimit të dobisë (së asaj veprë te të tjerët) e kështu me radhë.

Dhe kushdo që dëshiron, synon dhe vendos të bëjë një vepër të keqe, pastaj e lë atë për hir të Allahut, i shënohet një vepër e mirë. E, nëse e lë atë për shkak se ishte i angazhuar, duke mos bërë shkaqet për veprimin e saj, atëherë nuk i shënohet gjë. Ndërkaq, nëse e ka lënë për shkak se nuk ka mundur ta bëjë, atëherë i shënohet nijeti (që e ka pasur për ta bërë), e, nëse e ka bërë, i shënohet një vepër e keqe.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i mëshirës së madhe të Allahut ndaj këtij umeti (populli musiman) sa i përket shumëfishimit të veprave të mira dhe shkrimit të tyre tek Ai dhe mosshumëfishimit të veprave të këqija.
2. Rëndësia e nijetit (qëllimit) në vepra dhe ndikimi i tyre.
3. Mirësia, butësia dhe bamirësia e Allahut të Lartësuar, se, nëse dikush dëshiron të bëjë ndonjë vepër të mirë, por nuk e bën, Allahu ia shkruan një shpërblim të plotë.

(86) - عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قَالَ رَجُلٌ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَتُؤَاخِذُ بِمَا عَمَلْنَا فِي الْجَاهِلِيَّةِ؟ قَالَ: «مَنْ أَحْسَنَ فِي الْإِسْلَامِ لَمْ يُؤَاخِذْ بِمَا عَمَلَ فِي الْجَاهِلِيَّةِ، وَمَنْ أَسَاءَ فِي الْإِسْلَامِ أُخِذَ بِالْأَوَّلِ وَالْآخِرِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(86) – Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një person pyeti: "O i Dërguari i Allahut, a do të merremi në përgjegjësi për atë që e kemi vepruar në periudhën paraislame?"

Profeti ﷺ tha: “Ai që bën mirë në Islam, nuk do të llogaritet për veprat e periudhës paraislame, ndërsa ai që bën keq në Islam, do të llogaritet edhe për të parat, edhe për të fundit.”

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron vlerën e hyrjes në Islam, rrjedhimisht, kushdo që bëhet musliman, e zbaton mirë Islamin, është i sinqertë dhe e i çiltër; nuk do të llogaritet për gjynahet që ka bërë gjatë periudhës paraislame (para ardhjes së Profetit ﷺ). E, kushdo që bën keq në Islam, duke qenë hipokrit ose duke dezertuar nga feja; do të llogaritet për atë që ka bërë teksa ishte jobesimtar dhe për atë që ka bërë duke qenë musliman.

Mësime nga hadithi:

1. Shqetësimi i sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dhe frika e tyre nga veprat që kanë bërë në periudhën paraislame.

2. Inkurajimi për të qenë të qëndrueshëm në Islam.
3. Vlera e hyrjes në Islam dhe se ai i shlyen veprat e kaluara.
4. Dezertorët (ar. el murted) dhe hipokritët do të llogariten për çdo veprim që kanë kryer gjatë periudhës paraislame dhe për çdo mëkat që kanë bërë në Islam.

(65002)

(87) - عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: أَنَّ نَاسًا مِنْ أَهْلِ الشَّرْكِ، كَانُوا قَدْ قَتَلُوا وَأَكْثَرُوا، وَزَنَوْا وَأَكْثَرُوا، فَأَتَوْا مُحَمَّدًا صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالُوا: إِنَّ الَّذِي تَقُولُ وَتَدْعُو إِلَيْهِ لِحَسَنٍ، لَوْ تَخْبِرُنَا أَنَّ لِمَا عَمِلْنَا كَفَّارَةً، فَزَلَّ {وَالَّذِينَ لَا يَدْعُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ وَلَا يَقْتُلُونَ النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَا يَزْنُونَ} [الفرقان: 68]، وَنَزَلَتْ: {قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَى أَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِنْ رَحْمَةِ اللَّهِ} [الزمر:

[53]. [صحيح] - [متفق عليه]

(87) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: "Disa idhujtarë, të cilët e kishin tepruar me vrasje e zina, shkuan te Muhamedi ﷺ dhe i thanë: "Ajo që ti e thua dhe në të cilën thërret është gjë e mirë. Sikur të na tregoje se a ka shpagim për veprat tona!" Atëherë zbriti ajeti: “Edhe ata që pos Allahut nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar Allahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë zina.” (El Furkan, 68) Po ashtu, zbriti ajeti: “Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq

vetvetes, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut.”
(Ez Zumer, 53) [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Disa idhujtarë shkuan te Profeti ﷺ dhe kishin bërë shumë vrasje e zina, e në atë rast i thanë Profetit: "Ajo që po thërret në islam dhe mësimet e tij është një gjë e mirë, por cili është halli ynë që kemi rënë në idhujtari dhe mëkate të mëdha: a ka shpagim?"

Kështu, zbritën dy ajetet, ku Allahu e pranoi pendimin nga njerëzit përkundër numrit të madh të gjynaheve të tyre dhe, po të mos ishte kështu, ata do të vazhdonin në mosbesimin dhe tiraninë e tyre e nuk do të kishin hyrë në këtë fe.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e madhështia e Islamit dhe se ai i shkatërron gjynahet që janë bërë më parë.
2. Mëshira dhe falja e Allahut ndaj robërve të Tij.
3. Ndalimi i shirkut, ndalimi i vrasjes së njeriut pa të drejtë, ndalimi i zinasë dhe kërcënimi i atyre që i bëjnë këto gjynahe.
4. Pendimi i sinqertë i harmonizuar me çiltërsi dhe vepra të mira i shlyen të gjitha mëkatet e mëdha, përfshirë edhe mosbesimin në Allahun e Lartësuar.
5. Ndalimi i dëshpërimit dhe humbjes së shpresës nga mëshira e Allahut të Lartësuar.

(88) - عَنْ حَكِيمِ بْنِ حَزَامٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَرَأَيْتَ أَشْيَاءَ كُنْتُ أَتَحَنَّنُ بِهَا فِي الْجَاهِلِيَّةِ مِنْ صَدَقَةٍ أَوْ عَتَاقَةٍ، وَصَلَةٍ رَحِمٍ، فَهَلْ فِيهَا مِنْ أَجْرٍ؟ فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَسَلَمْتَ عَلَى مَا سَلَفَ مِنْ خَيْرٍ». [صحيح] - [متفق عليه]

(88) – Hakim ibën Hizami (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ: "O i Dërguari i Allahut, a do të shpërblehem për punët e mira që i kam vepruar në periudhën paraislame, bie fjala, për lëmoshën, lirimin e robërve dhe mbajtjen e lidhjeve familjare?" I Dërguari i Allahut ﷺ iu përgjigj: “Në Islam ke hyrë bashkë me veprat e mira të së kaluarës.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron se nëse një jobesimtar hyn në Islam, do të shpërblehet për veprat e mira që ka bërë në kohën paraislame para se të hyjë në Islam, si për lëmoshën, lirimin e robërve ose për mbajtjen e lidhjeve familjare.

Mësime nga hadithi:

1. Për veprat e mira që i ka bërë jobesimtari në këtë botë, nuk do të shpërblehet në botën tjetër, nëse vdes në kufër (mosbesim).

(89) - عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ لَا يَظْلِمُ مُؤْمِنًا حَسَنَةً، يُعْطَى بِهَا فِي الدُّنْيَا وَيُجْزَى بِهَا فِي الْآخِرَةِ، وَأَمَّا الْكَافِرُ فَيُطْعَمُ بِحَسَنَاتٍ مَا عَمِلَ بِهَا لِلَّهِ فِي الدُّنْيَا، حَتَّى إِذَا أَفْضَى إِلَى الْآخِرَةِ، لَمْ تَكُنْ لَهُ حَسَنَةٌ يُجْزَى بِهَا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(89) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu nuk i pakëson besimtarit asnjë vepër të mirë: për to i jep të mira në këtë botë dhe e shpërblen në botën tjetër, kurse jobesimtarit për të mirat që i ka bërë për hir të Allahut, i jepen të mira në këtë botë, e, kur kalon në botën tjetër, nuk do të ketë asnjë të mirë që të shpërblehet për të.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron mirësinë e madhe të Allahut ndaj besimtarëve dhe drejtësinë e Tij ndaj jobesimtarëve. Sa i përket besimtarit, shpërblimi për veprat e tij të mira nuk i pakësohet, përkundrazi, atij do t'i jepen të mira në këtë botë për adhurimin e tij, së bashku me shpërblim që do t'i ruhet për në botën tjetër. Ndodh që i gjithë shpërblimi mund t'i ruhet në botën tjetër. Ndërkaq, sa i përket jobesimtarit, Allahu do ta shpërblejë për veprat e mira që ka bërë, me të mirat e kësaj bote, e, kur kalon në botën tjetër, nuk do të ketë asnjë sevap për të cilin do të

shpërblehet, sepse një vepër e mirë që bën dobi në të dyja botët, medoemos duhet të bëhet nga një besimtar.

Mësim nga hadithi:

1. Atij që vdes në mosbesim, nuk i bën dobi asnjë vepër.

(65015)

(90) – عَنْ أُدَيْسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «قَالَ اللَّهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: يَا ابْنَ آدَمَ إِنَّكَ مَا دَعَوْتَنِي وَرَجَوْتَنِي غَفَرْتُ لَكَ عَلَى مَا كَانَ فِيكَ وَلَا أُبَالِي، يَا ابْنَ آدَمَ لَوْ بَلَغَتْ ذُنُوبُكَ عَنَانَ السَّمَاءِ ثُمَّ اسْتَغْفَرْتَنِي غَفَرْتُ لَكَ، وَلَا أُبَالِي، يَا ابْنَ آدَمَ إِنَّكَ لَوْ أَتَيْتَنِي بِقَرَابِ الْأَرْضِ خَطَايَا ثُمَّ لَقَيْتَنِي لَا تَشْرُكَ بِي شَيْئًا لَا تَيْتُكَ بِقَرَابِهَا مَغْفِرَةً». [حسن] - [رواه الترمذي]

(90) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Allahu i Lartësuar thotë: “O bir i Ademit, sa herë që më lutesh e shpreson tek Unë, do të t'i fal ato që ke bërë dhe s'e kam dert. O bir i Ademit, nëse gjynahet e tua arrijnë kupën e qiellit, dhe pastaj më kërkon falje, Unë do të të fal dhe s'e kam dert. O bir i Ademit, nëse ti më vjen me gabime sa Toka, por më takon duke mos më shoqëruar asgjë në adhurim, Unë do të të vij me po aq falje.” [Hadith hasen] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se Allahu i Lartmadhëruar thotë në një hadith kudsij (hyjnor, të shenjtë): "O bir i Ademit, përderisa më lutesh dhe shpreson në mëshirën Time e nuk i humb shpresat, mëkatën do të ta mbuloj dhe do të ta fshij, pa e pasur dert, edhe sikur ky mëkat apo kjo mosbindje të jetë nga mëkatet e mëdha. O bir i Ademit, sikur mëkatet e tua të ishin aq të shumta, sa ta mbushnin hapësirën ndërmjet Qiellit dhe Tokës, duke i përfshirë dhe mbuluar të gjitha anët dhe cepat, pastaj të më kërkoje falje; Unë do të t'i fshija dhe do të t'i falja të gjitha, e nuk do të kisha asnjë gajle nëse do të ishin të shumta.

O bir i Ademit, sikur të më vije pas vdekjes me gjynahe dhe mëkate sa sipërfaqja e Tokës, e ndërkohë ke vdekur si monoteist, duke mos më shoqëruar asgjë; këto mëkate dhe gjynahe do t'i prisja me falje sa sipërfaqja e tokës. Kjo sepse falja Ime është e gjerë dhe Unë i fal të gjitha gjynahet, përveç shirkut (idhujtarisë).

Mësime nga hadithi:

1. Gjerësia e mëshirës, faljes dhe mirësisë së Allahut të Lartësuar.
2. Vlera e teuhidit (monoteizmit) dhe se Allahu ua fal monoteistëve, gjynahet dhe mosbindjet (nëse pendohen).
3. Rreziku i shirkut dhe se Allahu nuk i fal idhujtarët.

4. Ibën Rexhebi ka thënë: "Ky hadith përfshin tri arsye që shërbejnë për faljen e mëkateve: 1. Lutja së bashku me shpresën. 2. Kërkimi i faljes dhe pendimi. 3. Vdekja si monoteist."
5. Ky hadith është nga ato thënie që Profeti ﷺ i transmeton nga Zoti i tij dhe quhet hadith i shenjtë (ar. kudsij) ose hyjnor; shprehja dhe kuptimi i tij janë nga Allahu, vetëm se nuk i ka karakteristikat e Kuranit, që e dallojnë atë nga çdo gjë tjetër, si: të bërët adhurim me leximin e tij, të qenët i pastër gjatë leximit, sfidimi (që të sjellin një të ngjashëm me të), paimitueshmëria etj.
6. Gjynahet ndahen në tri lloje: 1. Shirku (politeizmi) ndaj Allahut; këtë Allahu nuk e fal (nëse njeriu vdes pa u penduar). Allahu i Lartmadhëruar thotë: "Atij që i përshkruan Allahut shok (i bën shirk), Ai ia ka ndaluar Xhenetin." 2. Padrejtësia që robi ia bën vetes në raport me Zotin e tij, duke bërë gjynahe dhe mëkate; Allahu i Lartmadhëruar ia fal këtë dhe ia toleron, po deshi. 3. Gjynahet që Allahu nuk i lë pa shpagim, e këto janë padrejtësitë e robërve ndaj njëri-tjetrit. Këtu medoemos duhet të ketë shpagim.

(5456)

(91) - عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فِيمَا يَحْكِي عَنْ رَبِّهِ عَزَّ وَجَلَّ، قَالَ: «أَذْنَبَ عَبْدٌ ذَنْبًا، فَقَالَ: اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، فَقَالَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: أَذْنَبَ عَبْدِي ذَنْبًا، فَعَلِمَ أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ، وَيَأْخُذُ بِالذَّنْبِ، ثُمَّ عَادَ فَأَذْنَبَ، فَقَالَ: أَيُّ رَبِّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، فَقَالَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: عَبْدِي أَذْنَبَ ذَنْبًا، فَعَلِمَ أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ، وَيَأْخُذُ بِالذَّنْبِ، ثُمَّ عَادَ فَأَذْنَبَ، فَقَالَ: أَيُّ رَبِّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، فَقَالَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: أَذْنَبَ عَبْدِي ذَنْبًا، فَعَلِمَ أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ، وَيَأْخُذُ بِالذَّنْبِ، اْعْمَلْ مَا شِئْتَ فَقَدْ عَفَرْتُ لَكَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(91) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ transmeton nga Zoti i vet i Lartmadhërishëm dhe thotë: “Një njeri bëri një mëkat dhe tha: “O Allah, më fal mëkatin!” Allahu i Lartmadhërishëm thotë: “Robi Im bëri mëkat, por e diti se ka një Zot që fal mëkatet dhe dënon për to.” Pastaj bëri mëkat sërish dhe tha: “O Zot, më fal mëkatin!” Allahu i Lartmadhërishëm thotë: “Robi Im bëri mëkat, por e diti se ka një Zot që fal mëkatet dhe dënon për to.” Pastaj bëri mëkat sërish dhe tha: “O Zot, më fal mëkatin!” Allahu i Lartmadhërishëm thotë: “Robi Im bëri mëkat, por e diti se ka një Zot që fal mëkatet dhe dënon për to. Bëj ç'të duash (përderisa kërkon falje pas çdo mëkati), se ta kam falur.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ transmeton nga Zoti i tij se, nëse njeriu bën mëkat dhe pastaj thotë: "O Allah, më fal mëkatin!", Allahu i Lartmadhërishëm thotë: “Robi Im bëri mëkat, por e diti se

ka një Zot që fal mëkatet, i mbulon, i tejkalon ose dënon për to, e Unë e kam falur atë." Pastaj njeriu bëri mëkat përsëri dhe tha: "O Zot, më fal mëkatin!" Allahu i Lartmadhërishëm thotë: "Robi Im bëri mëkat, por e diti se ka një Zot që i fal mëkatet, i mbulon, i tejkalon ose dënon për to, e Unë e kam falur robin Tim." Sërish ky njeri bën mëkat dhe thotë: "O Zot, më fal mëkatin!" Allahu i Lartmadhërishëm thotë: "Robi Im bëri mëkat, por e diti se ka një Zot që i fal mëkatet, i mbulon, i tejkalon ose dënon për to, e Unë e kam falur robin Tim. Le të bëjë çfarë të dojë, përderisa sa herë që bën një mëkat, e braktis mëkatin dhe pendohet e vendos që të mos kthehet në të, por ja që atë e pushton vetja e kësisoj bie përsëri në mëkat, kështu që përderisa e bën këtë: mëkaton dhe pendohet, Unë do ta fal, sepse pendimi e shkatërron atë që ka ndodhur më herët."

Mësime nga hadithi:

1. Mëshira e gjerë e Allahut ndaj robërve të Tij dhe se çfarëdo mëkati të bëjë njeriu dhe çfarëdo që të veprojë, nëse pendohet dhe kthehet tek Ai, Allahu ia pranon pendimin.
2. Besimtari në Allahun e Lartësuar shpreson në faljen e Zotit të vet, i frikësohet dënimit të Tij, shpejton drejt pendimit dhe nuk vazhdon në mëkat.
3. Kushtet e pendimit të singertë janë: heqja dorë nga mëkati, keqardhja për të dhe vendosmëria për të mos u kthyer në mëkat. E, nëse pendimi është prej padrejtësive që ua ka shkaktuar njerëzve, që

ndërlidhen me pasuri, nder ose shpirt, këtu shtohet kushti i katërt, që është: kërkimi i hallallëkut nga pronari i së drejtës ose dhënia e së drejtës së tij.

4. Rëndësia e njohjes së Allahut, gjë që e bën njeriun të vetëdijshëm për çështjet e fesë, kështu që pendohet sa herë që bën ndonjë mëkat, prandaj nuk dëshpërohet dhe nuk këmbëngul në gjynahe.

(4817)

(92) - عَنْ عَلِيٍّ قَالَ: إِنِّي كُنْتُ رَجُلًا إِذَا سَمِعْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ حَدِيثًا نَفَعَنِي اللَّهُ مِنْهُ بِمَا شَاءَ أَنْ يَنْفَعَنِي بِهِ، وَإِذَا حَدَّثَنِي رَجُلٌ مِنْ أَصْحَابِهِ اسْتَحْلَفْتُهُ، فَإِذَا حَلَفَ لِي صَدَقْتُهُ، وَإِنَّهُ حَدَّثَنِي أَبُو بَكْرٍ، وَصَدَقَ أَبُو بَكْرٍ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَا مِنْ رَجُلٍ يُذْنِبُ ذَنْبًا، ثُمَّ يَقُومُ فَيَتَطَهَّرُ، ثُمَّ يُصَلِّي، ثُمَّ يَسْتَغْفِرُ اللَّهَ، إِلَّا عَفَرَ اللَّهُ لَهُ»، ثُمَّ قَرَأَ هَذِهِ الْآيَةَ: {وَالَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا فَاحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ} [آل عمران:

135]. [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه وأحمد]

(92) – Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Vërtet unë jam një njeri që, kur dëgjoja ndonjë hadith nga i Dërguari i Allahut ﷺ, Allahu më bëri dobi aq sa donte që unë të përfitoja prej tij. Kur ndonjëri nga sahabët më transmetonte ndonjë hadith, unë i kërkova atij të betohej. Kur ai betohej, unë i besoja. Ebu Bekri më tregoi një hadith, ndërkohë Ebu Bekri tha të vërtetën, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Nuk ka njeri që bën një

mëkat, pastaj ngrihet dhe merr abdes, pastaj fal namaz e i kërkon falje Allahut, përveçse Allahu do ta falë." Pastaj lexoi këtë ajet: "Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre..." (Al Imran, 135) [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se, nëse një njeri bën një mëkat, pastaj merr abdes mirë, e pastaj ngrihet dhe i fal dy rekate, me qëllim që të pendohet për këtë mëkat të tijin, e më pas i kërkon falje Allahut, Allahu do ta falë atë me siguri. Pastaj Profeti ﷺ e lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar: "Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre..." (Al Imran, 135)

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të falur namaz e pastaj kërkimi i faljes (istigfarit) pas mëkatit.
2. Falja e gjerë e Allahut të Lartmadhëruar dhe se Ai e pranon pendimin e kërkimfaljen.

(65063)

(93) - عَنْ أَبِي مُوسَى رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ يَبْسُطُ يَدَهُ بِاللَّيْلِ لِيَتُوبَ مُسِيءُ النَّهَارِ، وَيَبْسُطُ يَدَهُ بِالنَّهَارِ لِيَتُوبَ مُسِيءُ اللَّيْلِ، حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ مِنْ مَغْرِبِهَا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(93) – Ebu Musai (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Allahu i Lartmadhëruar e shtrin Dorën gjatë natës, që të pendohet ai që bën mëkate gjatë ditës, dhe e shtrin Dorën gjatë ditës, që të pendohet ai që bën mëkate gjatë natës, derisa Dielli të lindë nga perëndimi.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se Allahu i Lartësuar e pranon pendimin nga robërit e Tij. Nëse robi bën mëkat gjatë ditës dhe pendohet gjatë natës, Allahu ia pranon pendimin, sikundër që, nëse bën mëkat gjatë natës dhe pendohet gjatë ditës, Allahu ia pranon pendimin. Allahu i Lartësuar e shtrin dorën e Tij për ta pranuar pendimin (e robërve), duke u gëzuar dhe duke e pranuar këtë veprim. Dera e pendimit mbetet e hapur derisa të lindë Dielli nga Perëndimi, duke sinjalizuar fundin e botës, e kur të lindë nga Perëndimi, dera e pendimit mbyllet.

Mësimet nga hadithi:

1. Pranimi i pendimit vazhdon, përderisa dera e tij është e hapur, ndërsa dera e tij mbyllet kur Dielli të lindë nga Perëndimi. Gjithashtu njeriu duhet të

pendohet para se t'i vijë shpirti në fyt (para agonisë së vdekjes), sepse pas kësaj kohe pendimi nuk pranohet.

2. Mosdëshpërimi dhe moshumbja e shpresës për shkak të mëkatit, sepse falja dhe mëshira e Allahut të Lartësuar janë të gjera dhe dera e pendimit është e hapur.
3. Kushtet e pendimit: 1. Heqja dorë nga mëkati. 2. Keqardhja për kryerjen e tij. 3. Vendosmëria për të mos u kthyer më në të. Këto janë kur mëkati është në raport me të drejtën e Allahut të Lartësuar, e, nëse ka të bëjë me të drejtën e njerëzve, atëherë për vlefshmërinë e pendimit kërkohet që ajo e drejtë t'i jepet të zotit të saj ose i zoti i saj t'ia falë.

(4318)

(94) - عن أبي هريرة رضي الله عنه: أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «يَنْزِلُ رَبُّنَا تَبَارَكَ وَتَعَالَى كُلَّ لَيْلَةٍ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا حِينَ يَبْقَى ثُلُثُ اللَّيْلِ الْآخِرِ، يَقُولُ: «مَنْ يَدْعُونِي فَأَسْتَجِيبَ لَهُ؟ مَنْ يَسْأَلُنِي فَأُعْطِيَهُ؟ مَنْ يَسْتَغْفِرُنِي فَأَغْفِرَ لَهُ؟».

[صحيح] - [متفق عليه]

(94) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Zoti ynë i Lartësuar zbret (ashtu siç i takon madhërisë së Tij) çdo natë, pasi të mbetet e treta e fundit e natës, në qiellin e kësaj bote, dhe thotë: "A ka kush më lutet Mua, që t'i përgjigjem? A ka

kush kërkon nga Unë, që t'i jap? A ka kush kërkon falje prej Meje, që ta fal?" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se Allahu i Lartmadhëruar zbret në qiellin e kësaj bote çdo natë kur mbetet e treta e fundit e natës dhe i inkurajon robërit e Tij ta lusin Atë, e Ai u përgjigjet atyre; i inkurajon që t'i kërkojnë atë që duan, e Ai ua jep atë që e kërkojnë; i inkurajon që të kërkojnë falje nga mëkate, e Ai i fal robërit e Vet besimtarë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e një të tretës së fundit të natës dhe e namazit, lutjes dhe kërimit të faljes gjatë saj.
2. Kur njeriu ta dëgjojë këtë hadith, duhet të kujdeset shumë që t'i shfrytëzojë këto kohë të pranimit të lutjes.

(10412)

(95) - عن الثُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ - وَأَهْوَى الثُّعْمَانُ بِإِصْبَعِيهِ إِلَى أُذُنَيْهِ -: «إِنَّ الْحَلَالَ بَيْنَ وَإِنَّ الْحَرَامَ بَيْنَ، وَبَيْنَهُمَا مُشْتَبِهَاتٌ لَا يَعْلَمُهُنَّ كَثِيرٌ مِنَ النَّاسِ، فَمَنْ اتَّقَى الشُّبُهَاتِ اسْتَبْرَأَ لِدِينِهِ وَعِرْضِهِ، وَمَنْ وَقَعَ فِي الشُّبُهَاتِ وَقَعَ فِي الْحَرَامِ، كَالرَّاعِي يَرَعَى حَوْلَ الْحِمَى يُوشِكُ أَنْ يَرْتَعَ فِيهِ، أَلَا وَإِنَّ لِكُلِّ مَلِكٍ حِمًى، أَلَا وَإِنَّ حِمَى اللَّهِ مُحَارِمُهُ، أَلَا وَإِنَّ فِي الْجَسَدِ مُضْغَةً، إِذَا صَلَحَتْ صَلَحَ الْجَسَدُ كُلُّهُ، وَإِذَا فَسَدَتْ فَسَدَ الْجَسَدُ كُلُّهُ، أَلَا وَهِيَ الْقَلْبُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(95) – Numan ibën Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë, - ndërkohë Numani i drejtoi dy gishtat nga veshët e vet: "Pa dyshim, hallalli dhe harami janë të qartë, por në mes tyre ka gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Ai që ruhet nga të dyshimtat, e ka ruajtur fenë dhe nderin e vet, kurse ai që bie në të dyshimtat, tashmë ka rënë në haram, si bariu që kullot kopenë përbri zonës së ndaluar, ku kopeja mund të bjerë në çdo çast. Me të vërtetë, çdo mbret ka zonën e vet të ndaluar, porse zona e ndaluar e Allahut janë haramet. Vini re, në trupin e njeriut është një copë mishi, që, nëse ajo është në rregull, tërë trupi është në rregull, por, nëse ajo prishet, prishet tërë trupi. Kini kujdes, ajo është zemra." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na sqaroi në këtë hadith një rregull të përgjithshme në lidhje me gjërat dhe se ato në sheriat ndahen

në tri kategori: hallall i qartë, haram i qartë dhe gjëra të dyshimta, vendimi i të cilave nuk është i qartë në aspektin e hallallit dhe haramit e këtë vendim nuk e dinë shumë njerëz.

Kushdo që i braktis këto gjëra të dyshimta, feja e tij do të jetë e sigurt duke e larguar nga rënia në haram dhe nderi i tij do të jetë i sigurt nga fjalët e njerëzve, për faktin se ata do ta kritikojnë për kryerjen e kësaj veprë të dyshimtë. Kushdo që nuk u shmanget të dyshimitave, e ka ekspozuar veten: ose duke rënë në haram, ose duke përfoluar njerëzit nderin e tij. Profeti ﷺ ka dhënë një shembull për të treguar gjendjen e atij që i vepron të dyshmitat, se i tilli është sikurse bariu që kullot bagëtinë e tij pranë një toke që e ka rrethuar pronari i saj, kështu që bagëtitë e bariut mund të kullotin në këtë zonë të rrethuar, për shkak të afërsisë me të. Po ashtu, kushdo që bën diçka të dyshimtë, atëherë ai i afrohet haramit dhe është gati për të rënë në të. Pas kësaj, Profeti ﷺ tregoi se në trupin e njeriut është një copë mishi (zemra), që, nëse ajo është në rregull, tërë trupi është në rregull, por, nëse ajo prishet, prishet i tërë trupi.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për ta braktisur të dyshimtën, vendimi për të cilën nuk është qartësuar ende.

(4314)

(96) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا تَسُبُّوا أَصْحَابِي، فَلَوْ أَنَّ أَحَدَكُمْ أَنْفَقَ مِثْلَ أُحُدٍ ذَهَبًا مَا بَلَغَ مُدًّا أَحَدِهِمْ، وَلَا نَصِيفَهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(96) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Mos i shani shokët e mi, sepse, edhe nëse ndonjëri prej jush dhuron ar sa mali Uhud, (vlera e tij), nuk arrin as sa grushtet e tyre (që ata kanë dhuruar), madje as sa gjysma e kësaj.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ndaloi që të shahen sahabët, veçanërisht besimtarët e parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve. Gjithashtu tregoi se, nëse ndonjë njeri dhuron ar sa mali Uhud, shpërblimi i tij për këtë nuk do ta arrinte shpërblimin e asaj që dhuroi ndonjëri prej sahabëve prej ushqimit, qoftë dy grushte, qoftë gjysma e kësaj. Kjo është për shkak të sinqeritetit të tyre të madh, qëllimit të tyre të çiltër dhe se shpenzuan e luftuan para Çlirimit të Mekës, ku nevoja për këtë ishte e madhe.

Mësime nga hadithi:

1. Sharja e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) është haram dhe prej mëkateve të mëdha.

(11000)

(97) - عن ابن عباس رضي الله عنهما قال: كُنْتُ خَلْفَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَوْمًا، فَقَالَ: «يَا غُلَامُ، إِنِّي أَعَلَّمْتُ كَلِمَاتٍ، أَحْفَظِ اللَّهَ يَحْفَظَكَ، أَحْفَظِ اللَّهَ تَجِدْهُ تُجَاهَكَ، إِذَا سَأَلْتَ فَاسْأَلِ اللَّهَ، وَإِذَا اسْتَعَنْتَ فَاسْتَعِنْ بِاللَّهِ، وَاعْلَمْ أَنَّ الْأُمَّةَ لَوِ اجْتَمَعَتْ عَلَى أَنْ يَنْفَعُوكَ بِشَيْءٍ، لَمْ يَنْفَعُوكَ إِلَّا بِشَيْءٍ قَدْ كَتَبَهُ اللَّهُ لَكَ، وَلَوْ اجْتَمَعُوا عَلَى أَنْ يَضُرُّوكَ بِشَيْءٍ، لَمْ يَضُرُّوكَ إِلَّا بِشَيْءٍ قَدْ كَتَبَهُ اللَّهُ عَلَيْكَ، رُفِعَتِ الْأَقْلَامُ وَجَفَّتِ الصُّحُفُ». [صحيح] - [رواه الترمذي]

(97) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: “Një ditë, ndërsa isha mbrapa Profetit ﷺ, më tha: "O djalosh, po të mësoj disa fjalë: “Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut, e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, po qe se të gjithë njerëzit do të mblidheshin për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bënin mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjellas, nëse bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtonin, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se ishte i ri, hipur (mbi kafshë) me Profetin ﷺ, kur i tha: "Unë po të mësoj disa çështje dhe gjëra, përmes të cilave Allahu do të të bëjë dobi:

"Ruaje Allahun duke i ruajtur urdhrat e Tij dhe duke iu shmangur ndalesave të Tij, në mënyrë që Ai të të gjejë duke

bërë adhurime e të të mos gjejë duke bërë mëkate. E, nëse e bën këtë, shpërblimi yt do të jetë që Zoti të të ruajë nga të këqijat e kësaj bote dhe të botës tjetër, si dhe do të të ndihmojë në punët e tua kudo që të shkosh.

Nëse dëshiron të lypësh diçka, lypi vetëm Allahut, sepse vetëm Ai u përgjigjet kërkesave të atyre që e lusin.

Nëse dëshiron ndihmë, mos e kërko prej askujt pos Allahut.

Duhet të jesh i bindur se nuk do të kesh asnjë dobi, edhe nëse të gjithë njerëzit e tokës mblidhen për të të bërë ndonjë dobi, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjeltas, nuk do të të ndodhë asnjë e keqe, edhe nëse të gjithë njerëzit e tokës mblidhen për të të bërë ndonjë dëm, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu.

Kjo çështje është caktuar nga Allahu i Lartmadhëruar dhe është vendosur sipas asaj që përkon me urtësinë dhe diturinë e Tij, e nuk ka ndryshim të asaj që ka caktuar Ai.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e mësimit fëmijëve çështjet e fesë, si: teuhdin (monoteizmin), normat e edukatës, e kështu me radhë.
2. Shpërblimi është sipas llojit të veprës.
3. Urdhri për t'u mbështetur në Allahun, e jo në dikë tjetër. Eh, sa Mbështetës i mirë që është Ai!

4. Besimi në caktimin dhe paracaktimin dhe të kënaqurit me të dhe se Allahu ka paracaktuar çdo gjë.
5. Atë që e humb urdhrin e Allahut, Ai do ta humbë dhe nuk do ta ruajë.

(4811)

(98) - عَنْ سُفْيَانَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْثَّقَفِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، قُلْ لِي فِي الْإِسْلَامِ قَوْلًا لَا أَسْأَلُ عَنْهُ أَحَدًا غَيْرَكَ، قَالَ: «قُلْ: آمَنْتُ بِاللَّهِ، ثُمَّ اسْتَقِمَّ».

[صحيح] - [رواه مسلم وأحمد]

(98) – Sufjan ibën Abdullah Thekafiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Thashë: "O i Dërguari i Allahut, më thuaj një fjalë lidhur me Islamin, që, pas teje, nuk do të kem nevojë të pyes askënd." I Dërguari ﷺ tha: "Thuaj: "Besoj në Allahun e pastaj qëndro fuqishëm!" [Ky hadith është sahih] - [رواه مسلم وأحمد]

Shpjegimi:

Sahabiu, Sufjan ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i kërkoi Profetit ﷺ që t'i mësonte një thënie që përfshin në mënyrë gjithëpërfshirëse kuptimet e Islamit, në mënyrë që ai t'i përmbahej asaj dhe të mos pyeste askënd tjetër në lidhje me të. Atëherë Profeti ﷺ i tha: "E veçoj Allahun me adhurim dhe i besoj Zotit tim, Krijuesit tim dhe të Adhuruarit tim të vërtetë, i Cili nuk ka shok. Më pas i nënshtrohet Allahut, duke iu bindur me kryerjen e

obligimeve që ka ndaj Tij dhe duke i braktisur ndalesat e Tij, si dhe vazhdon në këtë rrugë.

Mësime nga hadithi:

1. Themeli i fesë është besimi në Allahun se Ai është Krijues, meritore për t'u adhuruar dhe se Atij i takojnë emrat dhe cilësitë e përkryera.
2. Rëndësia e të qenit në rrugë të drejtë pas besimit, vazhdimësia në adhurim dhe qëndrueshmëria në këtë rrugë.
3. Besimi është kusht për pranimin e veprave.
4. Imani në Allahun përfshin atë që duhet besuar nga bindjet dhe parimet e besimit, si dhe atë që rrjedh nga kjo, siç janë: veprat e zemrës, nënshtrimi dhe dorëzimi para Allahut me zemër dhe me gjymtyrë.
5. Qëndrueshmëria në fe nënkupton t'i përmbahemi kësaj rruge, duke i kryer obligimet dhe duke i braktisur ndalesat.

(65018)

(99) - عَنِ الثُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَثَلُ الْمُؤْمِنِينَ فِي تَوَادُّهِمْ وَتَرَاحُمِهِمْ وَنِعَاطُفِهِمْ مَثَلُ الْجَسَدِ، إِذَا اشْتَكَى مِنْهُ عُضْوٌ تَدَاعَى لَهُ سَائِرُ الْجَسَدِ بِالسَّهْرِ وَالْحَمَى». [صحيح] - [متفق عليه]

(99) – Nga Numan ibën Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Profeti i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën e në solidarizimin ndërmjet tyre i ngjan një trupi të vetëm, aq sa kur vuan një gjymtyrë e tij, atëherë i gjithë trupi ndan me të pagjumësinë dhe ethet.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se gjendja e muslimanëve midis tyre sa i takon dashamirësisë, mëshirës, përkrahjes, mbështetjes dhe shqetësimit nga e keqja që u ndodh atyre, duhet të jetë si gjendja e një trupi të vetëm: kur njëri organ i tij sëmuret, i gjithë trupi reagon me pagjumësi dhe ethe.

Mësime nga hadithi:

1. Muslimanët duhet të respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit dhe të nxisin njëri-tjetrin për solidarizim dhe mirësjellje të ndërsjellë.
2. Midis besimtarëve duhet të mbizotërojë dashuria dhe përkrahja.

(100) – عن عثمان بن عفان رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ تَوَضَّأَ فَأَحْسَنَ الوُضُوءَ خَرَجَتْ خَطَايَاهُ مِنْ جَسَدِهِ حَتَّى تَخْرُجَ مِنْ تَحْتِ أَظْفَارِهِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(100) – Othman ibën Afani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atij që merr abdes dhe e përsos atë, mëkatet do t'i dalin prej trupit të tij, saqë i dalin edhe ato nën thonjtë e tij." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që merr abdes duke i respektuar sunetet dhe normat e abdesit, kjo do të jetë nga shkaqet e shlyerjes dhe faljes së veprave të këqija dhe gjynaheve, "saqë i dalin" mëkatet edhe nën thonjtë e duarve dhe këmbëve të tij.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi që t'u kushtohet kujdes mësimit të abdesit, suneteve, normave të tij dhe veprimit me to.
2. Vlera e abdesit dhe se ai është shlyerje për gjynahet e vogla, por për gjynahet e mëdha duhet pendim.
3. Kusht për heqjen e gjynaheve është ta përkryesh abdesin dhe ta marrësh ashtu siç duhet, siç e ka sqaruar Profeti ﷺ.

4. Shlyerja e gjynaheve në këtë hadith është e kushtëzuar me shmangien nga gjynahet e mëdha dhe pendimin për to. Allahu i Lartësuar thotë: "Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'jua falim gabimet tuaja të vogla..." (En Nisa, 31)

(6263)

(101) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَأَلَ رَجُلٌ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنَّا نَرْكَبُ الْبَحْرَ، وَنَحْمِلُ مَعَنَا الْقَلِيلَ مِنَ الْمَاءِ، فَإِنْ تَوَضَّأْنَا بِهِ عَطِشْنَا، أَفَتَتَوَضَّأُ مِنَ الْبَحْرِ؟ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «هُوَ الطَّهُّورُ مَاءُهُ، الْحُلُّ مَيْتَتُهُ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

(101) – Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një njeri e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ, duke thënë: "O i Dërguar i Allahut, ne udhëtojmë me anije dhe marrim pak ujë me vete. Nëse marrim abdest me të, do të kemi etje. Atëherë, a mund të marrim abdest me ujin e detit?" I Dërguari i Allahut ﷺ u tha: "Uji i detit është pastrues dhe e ngordhura e tij është e lejueshme." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Një njeri e pyeti Profetin ﷺ, duke thënë: Ne udhëtojmë me anije në det për peshkim, tregti dhe aktivitete të ngjashme, dhe marrim pak ujë të pijshëm me vete. Nëse e

përdorim ujin e pijshëm për abdest dhe gusël, ai do të harxhohet dhe nuk do të kemi më ujë për të pirë. A na lejohet të marrim abdest me ujin e detit?

Kësisoj, Profeti ﷺ i tha për ujin e detit: "Uji i tij është i pastër dhe pastrues; lejohet të merret abdest dhe gusël me të. Gjithashtu, është e lejuar të hahet çdo gjë që del prej tij, si peshqit, balenat dhe të tjera, edhe nëse gjendet e ngordhur dhe ka dalë në sipërfaqe pa u peshkuar.

Mësime nga hadithi:

1. Kafsha e ngordhur e detit është e lejuar për t'u ngrënë. Me termin "e ngordhur", nënkuptohet çdo krijesë detare që ka ngodhur në det dhe që jeton vetëm në të.
2. Përgjigjja ndaj pyetësit me më shumë sesa ka pyetur, është që dobia të jetë më e plotësuar.
3. Ujit, nëse i ndryshon shija, ngjyra ose era e tij nga diçka e pastër, mbetet i pastër për sa kohë që vazhdon të jetë ujë në natyrën e tij të vërtetë, edhe nëse rritet kripshmëria, nxehtësia, ftohtësia apo diçka e ngjashme.
4. Uji i detit e largon papastërtinë e madhe (mund të merret me të gusël) dhe të vogël (mund të merret me të abdest) dhe pastron ndyrësinë e rastësishme mbi diçka të pastër, qoftë nga trupi, rrobat apo diçka tjetër.

(102) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: سُئِلَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنِ الْمَاءِ وَمَا يُنُوبُهُ مِنَ الدَّوَابِّ وَالسَّبَاعِ، فَقَالَ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِذَا كَانَ الْمَاءُ قُلَّتَيْنِ لَمْ يَحْمِلِ الْحَبْثُ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

(102) – Abdullah ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ u pyet për ujin dhe për kafshët e buta e të egra, që e frekuentojnë atë. Atëherë Profeti ﷺ tha: "Nëse uji është dy fuçi, nuk mban papastërti." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ u pyet për pastërtinë e ujit që përdoret nga kafshët e buta dhe të egra, për të pirë apo për gjëra të ngjashme. Kështu Profeti ﷺ tha: Nëse uji arrin sasinë e dy enëve të mëdha (rreth 210-të litra), atëherë ai konsiderohet ujë i shumtë dhe nuk bëhet i papastër, përveç nëse ndryshon një nga tre cilësitë e tij: ngjyra, shija ose era, me diç të papastër.

Mësim nga hadithi:

1. Uji bëhet i papastër nëse ndryshon një nga tre cilësitë e tij: ngjyra, shija ose era, me diçka të papastër. Hadithi në këtë rast vlen për shumicën e

situatave dhe nuk është i kufizuar në një rast specifik.

2. Dijetarët kanë rënë në ujdi se uji bëhet i papastër pa përjashtim; nëse ndyrësia e ndryshon, pavarësisht nëse ai është i vogël apo i madh.

(8357)

(103) - عَنْ أَبِي أَيُّوبَ الْأَنْصَارِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِذَا أَتَيْتُمُ الْعَايِطَ فَلَا تَسْتَقْبِلُوا الْقِبْلَةَ، وَلَا تَسْتَدْبِرُوهَا وَلَكِنْ شَرَّفُوا أَوْ عَرَّبُوا» قَالَ أَبُو أَيُّوبَ: فَقَدِمْنَا الشَّامَ فَوَجَدْنَا مَرَا حِصَّ بَيْنَتْ قِبَلَ الْقِبْلَةِ فَتَنَحَرَفُ، وَتَسْتَغْفِرُ اللَّهُ تَعَالَى. [صحيح] - [متفق عليه]

(103) – Ebu Ejub Ensariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur të shkoni për të kryer nevojën fiziologjike, as mos u drejtoni nga kibla, as mos ia ktheni shpinën, por kthehuni nga lindja ose nga perëndimi!” Më pas Ebu Ejubi vijon: "Kur erdhëm në Sham, nevojtoret i gjetëm të ndërtuara në drejtim të kiblës. Kështu që ndërronim drejtimin dhe (pasi dilnim), i kërkonim falje Allahut të Lartësuar." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ia ndaloi njeriut që dëshiron të kryejë nevojat fiziologjike, qoftë nevojën e madhe apo të vogël, të kthehet me fytyrë nga kibla dhe drejtimi i Qabesë, si dhe ia ndaloi të

kthejë shpinën andej. Por, ai duhet të kthehet në drejtim të lindjes ose perëndimit, nëse kibla në vendin e tij është njësoj si kibla e banorëve të Medinës. Pastaj Ebu Ejubi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregoi se, kur vajtën në Sham, gjetën nevojtoire të ndërtuara për nevojat fiziologjike, në drejtim të Qabesë, andaj muslimanët i mënjanonin trupat e tyre nga kibla, e megjithatë i kërkonin falje Allahut duke thënë: "Estagfirullah (kur dilnin prej nevojtoireve).

Mësim nga hadithi:

1. Urtësia e kësaj është madhërimi dhe respektimi i Qabesë së nderuar.
2. Istigfari (kërkimi faljes) pas daljes nga vendi i kryerjes së nevojave fiziologjike.
3. Metoda e mrekullueshme e Profetit ﷺ gjatë mësimdhënies; ai nuk u mjaftua vetëm pe përmendjen e veprimit të ndaluar, por udhëzoi drejt alternativës së lejuar.

(3078)

(104) – عَنْ أَبِي قَتَادَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا يُمَسِّكَنَّ أَحَدُكُمْ ذَكَرَهُ بَيْنَيْنِهِ وَهُوَ يَبُولُ، وَلَا يَتَمَسَّحُ مِنَ الْخَلَاءِ بَيْنَيْنِهِ، وَلَا يَتَنَفَّسُ فِي الْإِنَاءِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(104) – Ebu Katadja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Mos e mbani

me dorën e djathtë organin gjenital gjatë urinimit e as mos u pastroni nga jashtëqitja me dorën e djathtë, si dhe mos merrni frymë në enë (gjatë pirjes në të)!” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka shpjeguar disa norma të edukatës; ai e ka ndaluar që njeriu ta mbajë organin gjenital me dorën e djathtë gjatë urinimit dhe e ka ndaluar të hiqet papastërtia nga organi gjenital ose anusi me dorën e djathtë, sepse e djathta përdoret për gjëra fisnike dhe të pastra. Gjithashtu e ka ndaluar që njeriu të marrë frymë në enën në të cilën është duke pirë.

Mësime nga hadithi:

1. Islami u ka paraprirë kulturave të tjera në vendosjen e normave edukative dhe në higjenë.
2. Shmangia e prekjes së gjërave të pista por, nëse dikush detyrohet t'i prekë, atëherë le t'i prekë me të majtën.
3. Dora e djathtë është më e nderuar dhe më superiore se e majta.
4. Sheriati islam është i përsosur dhe mësimet e tij janë gjithëpërfshirëse.

(3079)

(105) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِذَا اسْتَيْقَظَ أَحَدُكُمْ مِنْ مَنَامِهِ فَلْيَسْتَنْزِلْ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ، فَإِنَّ الشَّيْطَانَ يَبِثُّ عَلَى خَيَاشِيمِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(105) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Kur dikush zgjohet nga gjumi, le t'i shpërlajë hundët tri herë, ngase shejtani futet në zgavrat e hundës së tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith inkurajon atë që zgjohet nga gjumi ta shpërlajë hundën tri herë. Shpërlarja nënkupton nxjerrjen e ujit nga hunda pas futjes së tij, sepse shejtani kalon natën në zgavrat e hundës.

Mësimet nga hadithi:

1. Është e përligjur që çdo person që zgjohet nga gjumi të nxjerrë ujë nga hunda, për të hequr ndikimin e shejtanit nga hunda e tij. E nëse do të marrë abdest, atëherë urdhri për shpërlajen e hundës është më i theksuar.
2. Istinhari (nxjerrja e ujit nga hunda) plotëson dobinë e Istinshakut (futjes së ujit në hundë), sepse Istinshaku pastron hundën nga brenda, ndërsa Istinhari e nxjerr atë papastërti së bashku me ujin.

3. Fakti që është kufizuar në hadith gjumi i natës, kjo është marrë nga folja "jebitu", sepse njeriu ka më shumë mundësi të fle thellë dhe për një periudhë të gjatë gjatë natës.
4. Në hadith ka argument se shejtani e shoqëron njeriun, por njeriu nuk e ndjen atë.

(8377)

(106) – عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَغْتَسِلُ، أَوْ كَانَ يَغْتَسِلُ، بِالصَّاعِ إِلَى خَمْسَةِ أَمْدَادٍ، وَيَتَوَضَّأُ بِالْمُدِّ. [صحيح] - [متفق عليه]

(106) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se: "Profeti ﷺ merrte abdes me një palë grushte me ujë dhe lahej me një saë, deri në pesë palë grushte me ujë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ lahej nga xhububllëku me një saë, deri në pesë palë grushte me ujë dhe merrte abdes me një palë grushte. Një saë është sa katër muddë, e një mudd është sa sasia e mbushur e dy grushteve të një njeriu mesatar.

Mësime nga hadithi:

1. Përligjja e kursimit të ujit për abdes e larje dhe mosshpërdorimi i tij, edhe nëse ka ujë.

2. Është e rekomanduar të zvogëlohet sasia e përdormit të ujit për abdes dhe larje, aq sa është e nevojshme dhe ky është udhëzimi i Profetit ﷺ.
3. Qëllimi është që të përmbushen (kushtet e) abdesit dhe larjes së plotë (guslit), duke i pasur parasysh sunetet dhe normat, pa shpërdorim e cungim, duke marrë parasysh kohën, bollëkun dhe mungesën e ujit etj.
4. Xhunubllëku është një gjendje që i referohet kujtdo që ejakulon ose kryen marrëdhënie intime. Është quajtur kështu (në arabisht), sepse personi i tillë rri larg nga namazi dhe ibadetet, derisa të pastrohet nga kjo gjendje.
5. Sai është një masë e njohur, por qëllimi është për sain e Profetit ﷺ, ku pesha e tij është 480 mithkalë grurë të mirë, ndërsa në litra i bie tri litra.
6. Muddi është një njësi matëse fetare, e cila përfaqëson dy grushte të një njeriu me madhësi mesatare kur ai i mbush ato dhe i shtrin. Muddi, sipas pajtimit të juristëve muslimanë, është një e katërta e sait. Pra, sasia e tij është 750 mililitra.

(8387)

(107) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه عَنِ النَّبِيِّ صلى الله عليه وسلم قَالَ: «لَا يَقْبَلُ اللَّهُ صَلَاةَ أَحَدِكُمْ إِذَا أَحْدَثَ حَتَّى يَتَوَضَّأَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(107) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Allahu nuk e pranon namazin e asnjërit prej jush, nëse e ka prishur abdesin, derisa të marrë sërish." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se një nga kushtet e vlefshmërisë së namazit është pastërtia, kështu që, kushdo që dëshiron të falë namaz, duhet të marrë abdes, nëse ka bërë ndonjë veprim që ia prish abdesin, si: jashtëqitja, urina, gjumi etj.

Mësime nga hadithi:

1. Namazi i atij që e ka prishur abdesin nuk pranohet, derisa të pastrohet me larje të tërësishme të trupit (gusël), nëse ka papastërti të madhe; ose me abdes, nëse ka papastërti të vogël.
2. Forma e abdesit është kështu: të marrësh ujë, ta rrotullosh në gojë dhe ta nxjerrësh jashtë, pastaj ta tërheqësh ujin me frymë në pjesën e brendshme të hundës, pastaj ta nxjerrësh jashtë. E më pas ta lash fytyrën tri herë, duart së bashku me bërryla tri herë, pastaj t'i japësh mes'h gjithë kokës një herë dhe, në fund, t'i lash këmbët së bashku me kyçet tri herë.

(108) - عَنْ جَابِرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: أَخْبَرَنِي عُمَرُ بْنُ الْخَطَّابِ: أَنَّ رَجُلًا تَوَضَّأَ فَتَرَكَ مَوْضِعَ ظُفْرِ عَلَى قَدَمِهِ فَأَبْصَرَهُ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ: «ارْجِعْ فَأَحْسِنْ وَضُوءَكَ» فَرَجَعَ، ثُمَّ صَلَّى. [صحيح بشواهده] - [رواه مسلم]

(108) – Nga Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë që Umer ibn Hatabi i ka treguar se një burrë mori abdes dhe e la një pjesë në këmbën e tij sa një thua pa e larë. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e pa dhe i tha: "Kthehu dhe merr abdes mirë!" Ai e përmirësoi abdesin dhe pastaj u fal. [Ky hadith është sahih përmes transmetimeve të tjera përforcuese] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka treguar se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) pa një burrë, i cili e kishte mbaruar marrjen e abdesit, por kishte lënë një pjesë në këmbën e tij sa një thua pa e larë gjatë abdesit. Ai i tha atij duke ia bërë me shenjë nga pjesa e palarë: "Kthehu dhe merr abdes mirë, duke e plotësuar atë dhe duke i dhënë çdo gjymtyrë hisen e ujit që i takon." Burri u kthye, e plotësoi abdesin, pastaj u fal.

Mësim nga hadithi:

1. Obligimi i nxitimit në urdhërimin për mirë dhe këshillimin e të paditurit dhe të pavëmendshmit,

sidomos kur mangësia e tij bëhet shkak për prishjen e adhurimit.

2. Obligimi i larjes me ujë të të gjitha gjymtyrëve të abdesit dhe se nëse dikush lë një pjesë të një gjymtyre pa e larë, qoftë dhe pak, abdesi i tij nuk është i saktë dhe ai duhet ta përsërisë atë nga fillimi, nëse distanca kohore është e gjatë.
3. Ligjshmëria e përsosjes së abdesit, duke e plotësuar dhe përkryer atë sipas mënyrës së urdhëruar nga sheriatu.
4. Këmbët janë pjesë e gjymtyrëve të abdesit dhe nuk mjafton fërkimi i tyre me dorë të lagur, por duhet të lahen patjetër.
5. Gjymtyrët e abdesit duhet të lahen njëra pas tjetrës, duke mos u vonuar aq sa të thahet gjymtyra paraprake.
6. Padija dhe harresa nuk e shfuqizojnë obligimin. Ato shfuqizojnë vetëm mëkatën. Ngase Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) nuk e shfuqizoi obligimin nga ky burrë, i cili nuk e kishte përkryer abdesin e tij për shkak të padijes, por e urdhëroi ta përsëriste atë.

(8386)

(109) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: رَجَعْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مِنْ مَكَّةَ إِلَى الْمَدِينَةِ حَتَّى إِذَا كُنَّا بِمَاءٍ بِالطَّرِيقِ تَعَجَّلَ قَوْمٌ عِنْدَ الْعَصْرِ، فَتَوَضَّؤُوا وَهُمْ عِجَالٌ، فَانْتَهَيْنَا إِلَيْهِمْ وَأَعْقَابُهُمْ تَلُوحُ لَمْ يَمَسَّهَا الْمَاءُ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «وَيْلٌ لِلْأَعْقَابِ مِنَ النَّارِ أَسْبِغُوا الْوُضُوءَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(109) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: "Teksa po ktheheshim me të Dërguarin e Allahut ﷺ nga Meka në Medinë, kaluam pranë ujit përgjatë rrugës. Në kohën e ikindisë, një pjesë e njerëzve nxituan dhe morën abdes me nguti. Kur arritëm tek ata, pamë se thembrat i kishin pasur të terura dhe nuk ua kishte përshkuar uji. Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Mjerë thembrat (që do të preken) nga Zjarri! Përsoseni abdesin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ udhëtoi nga Meka në Medinë së bashku me shokët e tij dhe gjatë rrugës gjetën ujë. Disa sahabë nxituan për të marrë abdes për namazin e ikindisë, aq sa themrat e tyre dukeshin se janë të teruara dhe nuk i kishte përshkuar uji, me ç'rast Profeti ﷺ tha: "Do të ketë dënim dhe shkatërrim në Zjarr për ata që tregohen të mangët teksa i lajnë këmbët e tyre kur marrin abdes", kështu që i urdhëroi që të marrin abdes sipas rregullave dhe ta përsosin atë.

Mësimet nga hadithi:

1. Është obligim larja e këmbëve gjatë abdesit, se, nëse fshirja do të ishte e lejuar, ai që e lë thembrën pa larë, nuk do të kërcënohej me Zjarr.
2. Është obligim të përfshihen me ujë të gjitha pjesët që janë të parapara për t'u larë, kështu që kushdo që me dashje ose nga pakujdesia lë një pjesë të vogël të asaj që është obligim për t'u pastruar, namazi i tij nuk është i vlefshëm.
3. Rëndësia e mësimit dhe udhëzimit të të paditurit.
4. Dijetari ndalon dhe tërheq vërejtjen në mënyrë të duhur, nëse sheh se obligimet ose veprat e pëlqyeshme po lihen pas dore.
5. Muhamed Ishak Dehleviu ka thënë: "Përsosja e avdesit është trellojëshe: (1) e detyrueshme (farz), që është larja duke e përfshirë tërësisht vendin një herë, (2) sunet, që është larja e gjymtyrëve nga tri herë, dhe (3) e pëlqyeshme, që është larja e gjymtyrëve nga tri herë dhe duke i larë ato edhe më shumë se ç'është e përcaktuar.

(66392)

(110) - عَنْ عَمْرِو بْنِ عَامِرٍ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ قَالَ: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَتَوَضَّأُ عِنْدَ كُلِّ صَلَاةٍ، فُلْتُ: كَيْفَ كُنْتُمْ تَصْنَعُونَ؟ قَالَ: يُجْزِي أَحَدَنَا الْوُضُوءُ مَا لَمْ يُحْدِثْ. [صحيح] - [رواه البخاري]

(110) – Amër ibën Amiri tregon se Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz. E pyeta: "Po ju, si vepronit?" Tha: "Mjaftoheshim me një abdes, përderisa nuk e prishnim atë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz farz, edhe nëse abdesi nuk i prishej. Kjo, për të marrë shpërblim dhe mirësi.

Namazliut i lejohet të falë më shumë se një namaz farz me një abdes, përderisa vazhdon të ketë abdes.

Mësim nga hadithi:

1. Veprimi më i zakonshëm i Profetit ﷺ ishte marrja e abdesit për çdo namaz, sepse kështu e kërkonte gjënë më të përsosur.
2. Pëlqehet marrja e abdesit për çdo namaz.
3. Lejohet falja e më shumë se një namazi me një abdes.

(65080)

(111) - عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: تَوَضَّأَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

مَرَّةً مَرَّةً. [صحيح] - [رواه البخاري]

(111) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: "Profeti ﷺ mori abdes duke i larë gjymtyrët vetëm nga një herë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Ndonjëherë, kur Profeti ﷺ merrte abdes, lante çdo pjesë të abdesit një herë, kështu që lante fytyrën, - përfshirë shpëlarjen e gojës dhe hundës, - duart dhe këmbët një herë. Kjo është pjesa e detyrueshme.

Mësime nga hadithi:

1. Është e detyrueshme larja e gjymtyrëve një herë, e çka shtohet më shumë se kaq është gjë e preferuar.
2. Është e ligjësuar që ndonjëherë të merret abdes duke i larë gjymtyrët vetëm nga një herë.
3. Fërkimi i kokës është i ligjësuar të bëhet vetëm një herë.

(65081)

(112) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ زَيْدٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ تَوَضَّأَ مَرَّتَيْنِ مَرَّتَيْنِ. [صحيح] - [رواه البخاري]

(112) – Abdullah ibën Zejdi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Profeti ﷺ mori abdes duke i larë gjymtyrët nga dy herë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Ndonjëherë, kur Profeti ﷺ merrte abdes, lante çdo pjesë të abdesit dy herë, kështu që lante fytyrën, - përfshirë shpëlarjen e gojës dhe hundës, - duart dhe këmbët dy herë.

Mësim nga hadithi:

1. Është e detyrueshme larja e gjymtyrëve një herë, e çka shtohet më shumë se kaq është gjë e preferuar.
2. Është e ligjësuar që ndonjëherë të merret abdes duke i larë gjymtyrët nga dy herë.
3. Fërkimi i kokës është i ligjësuar të bëhet vetëm një herë.

(65082)

(113) - عَنْ حُمْرَانَ مَوْلَى عُثْمَانَ بْنِ عَفَّانَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّهُ رَأَى عُثْمَانَ بْنَ عَفَّانَ دَعَا بِوُضُوءٍ، فَأَفْرَعَ عَلَى يَدَيْهِ مِنْ إِبَائِهِ، فَعَسَلَهُمَا ثَلَاثَ مَرَّاتٍ، ثُمَّ أَدْخَلَ يَمِينَهُ فِي الْوُضُوءِ، ثُمَّ تَمَضَّمَ وَاسْتَنْشَقَ وَاسْتَنْتَرَّ، ثُمَّ غَسَلَ وَجْهَهُ ثَلَاثًا، وَيَدَيْهِ إِلَى الْمِرْفَقَيْنِ ثَلَاثًا، ثُمَّ مَسَحَ بِرَأْسِهِ، ثُمَّ غَسَلَ كُلَّ رِجْلٍ ثَلَاثًا، ثُمَّ قَالَ: رَأَيْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَتَوَضَّأُ نَحْوَ وَضُوءِي هَذَا، وَقَالَ: «مَنْ تَوَضَّأَ نَحْوَ وَضُوءِي هَذَا ثُمَّ صَلَّى رَكْعَتَيْنِ لَا يُحَدِّثُ فِيهِمَا نَفْسَهُ غَفَرَ اللَّهُ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(113) – Humrani, i çrobëruari i Othmanit, tregon se pa Othmanin teksa kërkoi një enë me ujë (për të marrë abdes). Kështu, fillimisht derdhi (ujin nga ena) në duart e tij dhe i lau duart tri herë, pastaj futi dorën e djathtë në ujë dhe shpëlau gojën e hundën dhe e nxori (ujin) jashtë, pastaj lau fytyrën dhe duart deri në bërryla nga tri herë, i dha mes'h kokës dhe, fare në fund, lau secilën këmbë nga tri herë. Pastaj tha: "E kam parë Profetin ﷺ duke marrë abdes në këtë formë e pastaj tha: “Atij që merr abdes sikurse ky abdes imi dhe i fal dy rekate, pa u shpërqendruar, do t'i falen mëkatet e së kaluarës.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ua mësoi përshkrimin e abdesit të Profetit ﷺ sipas një metode praktike, që të jetë më i kuptueshëm. Ai kërkoi një enë me ujë (për të marrë abdes), kështu që e derdhi (ujin nga ena) në duart e tij dhe i lau duart tri herë. Më pas e futi dorën e tij të djathtë në enë, ku mori ujë, e shpëlau gojën dhe e nxori ujin

jashtë. Pastaj e tërhoqi me frymëmarrjen e tij ujin për te hunda, e më pas e nxori ujin jashtë. Pastaj lau fytyrën dhe duart nga tri herë, përfshirë bërrylat, nga tri herë, i dha mes'h tërë kokës një herë me duar të lagura dhe, fare në fund, lau këmbët, përfshirë edhe thembrat nga tri herë.

Kur e përfundoi këtë, i njoftoi se e ka parë Profetin ﷺ duke marrë abdes në këtë formë e pastaj Profeti ﷺ i ka përgëzuar se, atij që merr abdes sikurse ky abdesi im dhe i fal dy rekate, i përkushtuar dhe zemra e tij të jetë e pranishme para Zotit të tij të Lartmadhërishëm, Ai, i Lartësuari, në saje të mirësisë së Tij, do ta shpërblejë për këtë abdes të plotë dhe për këtë namaz të singertë duke ia falur mëkatet e së kaluarës.

Mësime nga hadithi:

1. Është e pëlqyer të lahen duart para se të futen në enë në fillim të abdesit, edhe nëse nuk është zgjuar nga gjumi, se, nëse është zgjuar nga gjumi i natës, atëherë është obligim të lahen (se nuk e di ku i ka shkuar dora në gjumë).
2. Mësuesi duhet të ndjekë rrugën më të afërt drejt kuptimit dhe ngulitjes së dijes te nxënësi, e këtu përfshihet mësimdhënia në praktikë.
3. Namazliu duhet t'i largojë mendimet që kanë të bëjnë me punët e kësaj bote. Namazi është i plotë dhe i përkryer atëherë kur zemra të jetë e pranishme gjatë faljes, përndryshe është e pamundur t'i largojë (plotësisht) mendimet,

prandaj duhet të përpiqet e të mos lëshohet në këtë gjë.

4. Gjatë abdesit është e rekomanduar të fillohet nga ana e djathtë.
5. Ligjshmëria e renditjes ndërmjet shpëlarjes së gojës, hundës dhe nxjerrjes së ujit prej saj.
6. Rekomandohet larja e fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tri herë, por është e detyrueshme (vaxhib) larja e tyre nga një herë.
7. Falja e mëkateve të së kaluarës nga ana e Allahut arrihet kur të bashkohen të dyja gjërat: abdesi dhe falja e dy rekateve, në mënyrën e përmendur në hadith.
8. Çdo pjesë e abdesit ka një përkufizim, kështu që përkufizimi i fytyrës është nga vendi i zakonshëm ku dalin flokët e deri te mjekra dhe nofullat vertikalisht, si dhe nga veshi deri në veshin tjetër horizontalisht. Përkufizimi i dorës është nga majat e gishtave deri në bërryl, që është nyja ndarëse midis parakrahut dhe krahut të sipërm. Përkufizimi i kokës është nga vendi i zakonshëm ku dalin flokët nga ana e fytyrës deri në majë të qafës, ku dhe fshirja e veshëve përfshihet në përkufizimin e kokës. Ndërkaq, përkufizimi i këmbës përfshin gjithë këmbën me nyjën ndarëse midis saj dhe kërcirit.

(114) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِذَا تَوَضَّأَ أَحَدُكُمْ فَلْيَجْعَلْ فِي أَنْفِهِ ثَمَّ لِيَنْثُرَ، وَمَنْ اسْتَجَمَرَ فَلْيُوتِرْ، وَإِذَا اسْتَيْقَظَ أَحَدُكُمْ مِنْ نَوْمِهِ فَلْيَغْسِلْ يَدَهُ قَبْلَ أَنْ يُدْخِلَهَا فِي وَضُوئِهِ، فَإِنْ أَحَدُكُمْ لَا يَدْرِي أَيْنَ بَاتَتْ يَدُهُ».

ولفظ مسلم: «إِذَا اسْتَيْقَظَ أَحَدُكُمْ مِنْ نَوْمِهِ فَلَا يَغْمِسْ يَدَهُ فِي الْإِنَاءِ حَتَّى يَغْسِلَهَا ثَلَاثًا، فَإِنَّهُ لَا يَدْرِي أَيْنَ بَاتَتْ يَدُهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(114) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që merr abdes, le ta futë ujin në hundë dhe le t'i fryjë, ndërsa ai që pastrohet me gurë nga jashtëqitja, le ta bëjë në numër tek. Kur dikush zgjohet nga gjumi, së pari le ta pastrojë dorën e tij, para se ta fusë në enën e abdesit, sepse nuk e di ku i ka qëndruar dora gjatë gjumit.” Ndërkaq te Muslimi gjendet kështu: “Kur dikush zgjohet nga gjumi, le të mos e fusë dorën e tij në enë para se ta lajë tri herë, sepse nuk e di ku i ka qëndruar dora gjatë gjumit.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron disa vendime fetare që ndërlidhen me pastërtinë, duke përfshirë: Së pari: Ai që merr abdes duhet të fusë ujë në hundë përmes frymëmarrjes, pastaj, po ashtu, duhet ta nxjerrë përmes saj. E dyta: Ai që dëshiron ta pastrojë papastërinë që del prej tij dhe ta largojë me diçka tjetër përveç ujit, bie fjala, me gurë dhe të

ngjashme, atëherë duhet të pastrohet me numër tek, ku minimumi është tre dhe maksimumi është aq sa do të mjaftojë për ta ndërprerë atë gjë që del prej tij dhe ta pastrojë vendin ku është papastërtia. E treta: Ai që zgjohet nga gjumi, të mos e fusë dorën në enë për të marrë abdes, derisa ta lajë tri herë jashtë enës, sepse nuk e di se ku ka qëndruar dora gjatë gjumit, kështu që nuk është i sigurt a e ka dorën të pastër, sepse shejtani mund të ketë luajtur me të dhe të ketë vendosur në të gjëra që janë të dëmshme për njeriun ose që e prishin ujin.

Mësime nga hadithi:

1. Gjatë avdesit është obligim istinshaku, që nënkupton futjen e ujit në hundë përmes frymëmarrjes, po ashtu është obligim istinthari, që nënkupton largimin e ujit nga hunda përmes frymëmarrjes.
2. Pastrimi me gurë nga jashtëqitja preferohet të bëhet në numër tek.
3. Përligjja e larjes së duarve tri herë pas zgjimit nga gjumi i natës.

(3033)

(115) - عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: مَرَّ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ بِقَبْرَيْنِ، فَقَالَ: «إِنَّهُمَا لَيُعَذَّبَانِ، وَمَا يُعَذَّبَانِ فِي كَبِيرٍ، أَمَّا أَحَدُهُمَا فَكَانَ لَا يَسْتَتِرُ مِنَ الْبَوْلِ، وَأَمَّا الْآخَرُ فَكَانَ يَمْشِي بِالنَّمِيمَةِ» ثُمَّ أَخَذَ جَرِيدَةً رَطْبَةً، فَشَقَّهَا نِصْفَيْنِ، فَغَرَزَ فِي كُلِّ قَبْرٍ وَاحِدَةً، قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ، لِمَ فَعَلْتَ هَذَا؟ قَالَ: «أَعْلَهُ يُخَفَّفُ عَنْهُمَا مَا لَمْ يَنْبَسَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(115) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: "Profeti ﷺ kaloi pranë dy varreve dhe tha: “Këta dy po dënohen, por nuk po dënohen për ndonjë mëkat të madh (sipas tyre). Njëri prej tyre nuk ruhej nga stërpikat e urinës, kurse tjetri bartte fjalë.” Pastaj mori një degë të njomë, e ndau në dysh dhe e nguli në secilin varr nga një pjesë. I thanë: "O i Dërguari i Allahut, pse e bërë këtë?" Tha: “Me shpresë që t'u lehtësohet dënimi për sa kohë që degët nuk thahen.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ kaloi pranë dy varreve dhe tha: Këta dy persona në këto dy varre po dënohen, por nuk po dënohen për ndonjë mëkat të madh, sipas tyre, edhe pse tek Allahu është i madh. Sa i përket njërit prej tyre, ai nuk kujdesej për ruajtjen e trupit dhe rrobave nga urina kur e kryente këtë proces. Ndërkaq, tjetri bartte fjalë midis njerëzve, ku i transmetonte ato te të tjerët, me qëllim që të shkaktonte dëm, mosmarrëveshje dhe përçarje midis tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Bartja e fjalëve dhe moskujdesi gjatë urinimit janë mëkate të mëdha dhe janë shkaktarë që njeriu të dënohet në varr.
2. Allahu i Lartësuar zbuloi disa nga gjërat e padukshme, - siç është dënimi i varrit, - për ta shpërfaqur profecinë e Pejgamberit ﷺ.
3. Ky veprim i ndarjes në dysh të pemës së njomë dhe vendosjes së tyre mbi varr është i veçantë për Profetin ﷺ, sepse Allahu e informoi për gjendjen e këtyre dyve në varr, kështu që askush tjetër nuk mund të krahasohet me të, sepse askush nuk e di gjendjen e njerëzve në varre.

(3010)

(116) - عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا دَخَلَ الْحَلَاءَ قَالَ: «اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبْثِ وَالْخَبَائِثِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(116) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Para se Profeti ﷺ të hynte në nevojtoire, thoshte: "Allahume inni eudhu bike minel-hubuthi vel-habaith! - O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde kundrejt të këqijve dhe të këqijave (shejtanëve meshkuj dhe femra)!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Sa herë që Profeti ﷺ dëshironte të hynte në vendin ku do të kryente nevojën, qoftë duke urinuar, qoftë duke bërë jashtëqitjen, kërkonte mbrojtje dhe strehim tek Allahu që ta ruante nga e keqja e shejtanëve meshkuj dhe femra. Shprehja e përmendur në hadith: "*hubuth dhe habaith*" është komentuar po ashtu si “e keqja dhe e ndyra”.

Mësim nga hadithi:

1. Është e pëlqyer të thuhet kjo lutje kur dëshirojmë të futemi në nevojto.
2. Të gjitha krijesat kanë nevojë për Zotin e tyre që t'i mbrojë nga ajo që i lëndon ose i dëmton në të gjitha rrethanat që i kanë.

(3150)

(117) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ إِذَا خَرَجَ مِنَ الْعَائِطِ قَالَ: «عُفْرَانُكَ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(117) – Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), tregon se Profeti ﷺ, kur dilte nga nevojto, thoshte: "Gufraneke - Kërkoj faljen Tënde (o Allah)!" [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ e kryente nevojën dhe dilte nga nevojtorja, thoshte: "Kërkoj faljen Tënde, o Allah!"

Mësim nga hadithi:

1. Është e rekomanduar të thuhet: "Gufraneke", pas daljes nga vendi i kryerjes së nevojave fiziologjike.
2. Profeti ﷺ i kërkonte falje Zotit të tij në të gjitha gjendjet.
3. Shkaku pse kërkohet falje prej Allahut pas kryerjes së nevojave fiziologjike është thënë: 1. Të qenët neglizhent ndaj falënderimit të Allahut për begatitë e shumta, prej të cilave është edhe lehtësimi i largimit të asaj që është e dëmshme. 2. Kërkoj falje se jam shpërqendruar nga përmendja Jote gjatë kohës së kryerjes së nevojave psikologjike.

(10046)

(118) – عن عائشة رضي الله عنها قالت: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم:

«السَّوَالُكَ مَطْهَرَةٌ لِلْفَمِ، مَرْضَاءٌ لِلرَّبِّ». [صحيح] - [رواه النسائي وأحمد]

(118) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Misvaku e pastron gojën dhe e kënaq Zotin." [Ky hadith është sahih] - [رواه النسائي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se pastrimi i dhëmbëve me degën e pemës arak (misvak) e të ngjashme, e pastron gojën nga papastërtitë dhe era e keqe dhe është nga shkaqet që Allahu të kënaqet me robin, sepse ky veprim tregon bindjen ndaj Allahut e përgjigjen ndaj urdhrit të Profetit ﷺ dhe, njëkohësisht, me të arrihet pastërtia që e do Allahu i Lartësuar.

Mësim nga hadithi:

1. Vlera e pastrimit të dhëmbëve me misvak dhe inkurajimi që Profeti ﷺ ia bëri umetit të tij për të shtuar një veprim të tillë.
2. Gjatë pastrimit të dhëmbëve është më mirë të përdoret shkopi i pemës arak (misvaku), por përdorimi i furçës dhe pastës kryen të njëjtin funksion.

(3588)

(119) – عَنْ حُذَيْفَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا قَامَ

مِنَ اللَّيْلِ يَشُوصُ فَاهُ بِالسَّوَاكِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(119) – Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Kur Profeti ﷺ ngrihej për namaz nate, e pastronte gojën me misvak.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ shpeshherë i pastronte dhëmbët me misvak dhe urdhëronte të përdorej. Përdorimi i misvakut në disa kohë është më i kërkuar: përdorimi i misvakut kur të ngrihemi për namaz nate, meqë Profeti ﷺ i bënte masazh dhe e pastronte gojën me misvak.

Mësime nga hadithi:

1. Përligjja e përdorimit të misvakut pas gjumit të natës është bërë për shkak se gjumi është faktor i ndryshimit të erës së gojës dhe misvaku është mjet pastrimi.
2. Përdorimi i misvakut kërkohet kur bëhen ndryshime të pakëndshme në gojë, duke u bazuar në kuptimin e lartcekur.
3. Përligjja e pastërtisë në përgjithësi është bërë se ajo është pjesë e Sunetit të Profetit ﷺ dhe e normave të larta morale.
4. Përdorimi i misvakut në tërë gojën përfshin: dhëmbët, mishrat e gojës dhe gjuhën.
5. Misvaku është një shkop i këputur nga pema e arakut ose nga ndonjë pemë tjetër, përdoret për të pastruar gojën dhe dhëmbët, për të freskuar gojën dhe për të hequr erën e keqe.

(120) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَوْلَا أَنْ أَشَقَّ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ - أَوْ: عَلَى أُمَّتِي - لَأَمَرْتُهُمْ بِالسَّوَاكِ عِنْدَ كُلِّ صَلَاةٍ». [صحيح] - [متفق عليه]

(120) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Sikur të mos më dukej e rëndë për besimtarët, - Zuhejri thotë: për umetin tim, - do t'i urdhëroja ta përdorin misvakun për çdo namaz.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith njoftoi se, po të mos ishte frika e vështirësisë për besimtarët nga umeti i tij, do t'ua kishte bërë obligim përdorimin e misvakut për çdo namaz.

Mësime nga hadithi:

1. Butësia e Profetit ﷺ ndaj umetit të tij dhe frika e tij se mos u shkaktohej vështirësi.
2. Parimi bazë sa i përket urdhrorit të Profetit ﷺ është se ai është obligativ, përveç nëse ka ndonjë argument që tregon se është vullnetar.
3. Pëlqyeshmëria e përdorimit të misvakut dhe vlera e tij para çdo namazi.
4. Ibn Dekik Idi ka thënë: "Urtësia se përse është e pëlqyeshme të përdoret misvaku kur ngrihesh për namaz, është se namazfalësi është një gjendje afrimi me Allahun, prandaj kërkohet që të jetë një gjendje

e përsosur dhe pastërtie, për të shfaqur kështu madhësitë e adhurimit."

5. Kuptimi i përgjithshëm i hadithit përfshin përdorimin e misvakut për agjëruetin, edhe pas mesditës, si në namazet e drekës dhe ikindisë.

(3364)

(121) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «حَقٌّ عَلَى كُلِّ مُسْلِمٍ أَنْ يَغْتَسِلَ فِي كُلِّ سَبْعَةِ أَيَّامٍ يَوْمًا، يَغْسِلُ فِيهِ رَأْسَهُ وَجَسَدَهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(121) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Secili musliman e ka për detyrë që të lahet (të paktën) një herë në çdo të shtatën ditë, kur dhe lan kokën dhe trupin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Në këtë hadith i Dërguari i Allahut ﷺ tregon se është obligim i përforcuar për çdo musliman, moshërritur e të mençur, që të lahet një herë në çdo shtatë ditë të javës dhe në këtë ditë të lajë kokën dhe trupin duke synuar kështu pastërtinë. Dita më parësore e këtyre ditëve është xhumaja, siç kuptohet nga disa transmetime. Gusli (larja e tërësishme trupit) në ditën e xhuma para namazit është një rekomandim i përforcuar, edhe nëse dikush lahet, bie fjala, të enjten. Ajo që dëshmon se një gjë e tillë nuk është obligim është thënia

e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!): "Njerëzit i kryenin vetë punët e tyre, andaj në namazin e xhumasë vinin në gjendjen që ishin duke punuar. Prandaj, Profeti ﷺ u tha: "Sikur të laheshit!" E shënon Buhariu dhe në transmetimin tjetër të tij qëndron: "Ndonjëherë kundërmonin erë të pakëndshme." Pra, erë djerse e të ngjashme dhe, megjithatë, atyre u tha: "Sikur të laheshit", kështu që të tjerëve pos tyre më parësore është t'u thuhet diçka e tillë.

Mësime nga hadithi:

1. Interesimi dhe kujdesi që Islami i ka kushtuar pastrimit dhe pastërtisë.
2. Gusli në ditën e xhuma për namaz është një veprim me rekomandim të përforcuar.
3. Meqë u përmend edhe koka, ndonëse kur të përmendet trupi e përfshin edhe kokën, kjo tregon rëndësinë që duhet t'i kushtohet asaj gjatë larjes.
4. Gusli është obligim për këdo që kundërmon aromë të pakëndshme, që i bezdis muslimanët.
5. Dita që ëshë më mirë të bëhet gusli është dita e xhuma, për shkak të vlerës së saj.

(65084)

(122) - عن أبي هريرة رضي الله عنه: سمعتُ النبيَّ صلى الله عليه وسلم يقول: «الْفِطْرَةُ خَمْسٌ: الْحِثَانُ وَالِاسْتِحْدَادُ وَقَصُّ الشَّارِبِ وَتَقْلِيمُ الْأَظْفَارِ وَتَنْفُ الْآبَاطِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(122) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Natyrshtëria është në pesë: synetimin, rruajtjen e qimeve (në vendet e turpshme), shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve dhe shkuljen e qimeve të nënsqetullave.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi pesë tipare të fesë islame dhe tradita të të dërguarve:

1. Synetimi (rrethprerja), që nënkupton prerjen e lëkurës së tepërt të organit, që është mbi glans (kokën e organit), si dhe prerjen e majës së lëkurës në mitrën e femrës, mbi vendin e kryerjes së kontaktit intim.
2. Rruajtja e qimeve përreth organit gjenital.
3. Shkurtimi i mustaqeve, që nënkupton shkurtimin e asaj që është rritur në buzën e sipërme të njeriut, në mënyrë që të shfaqet buza.
4. Prerja e thonjve.
5. Shkulja e qimeve të nënsqetullave.

Mësime nga hadithi:

1. Kjo është tradita e të dërguarve, të cilën Allahu e do, është i kënaqur, e urdhëron dhe thërret në të,

karakterizohet nga përsosuria, pastërtia dhe bukuria.

2. Ligjshmëria e përkujdesjes për kryerjen e këtyre gjërave dhe mosshpërfillja e tyre.
3. Për këto tipare ekzistojnë dobi fetare dhe të kësaj bote, bie fjala, përmirësimi i pamjes së jashtme, pastrimi i trupit, siguria për pastërti, dallimi nga jobesimtarët, si dhe nënshtrimi ndaj urdhrit të Allahut.
4. Në hadithe të tjera është përmendur se ka tipare shtesë të natyrshmërisë, përveç këtyre pesë që u përmendën, si: lëshimi (rritja) e mjekrës, përdorimi i misvakut e të tjera.

(3144)

(123) - عَنْ عَلِيٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كُنْتُ رَجُلًا مَذَّاءً وَكُنْتُ أَسْتَحْيِي أَنْ أَسْأَلَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لِمَكَانِ ابْنَتِهِ فَأَمَرْتُ الْمُقَدَّادَ بْنَ الْأَسْوَدِ فَسَأَلَهُ فَقَالَ: «يَغْسِلُ ذَكَرَهُ وَيَتَوَضَّأُ».

وَلِلْبُخَارِيِّ: فَقَالَ: «تَوَضَّأَ وَاعْسَلَ ذَكَرَهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(123) – Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Shpesh më rridhte lëngu paraspermal, por, për shkak të raportit me të bijën e tij, kisha turp ta pyesja Profetin ﷺ për këtë, andaj e porosita Mikdad ibn Esvedin ta pyeste. Profeti ﷺ iu përgjigj: “Vetëm e pastron organin gjenital dhe merr abdes.”

Në transmetimin e Buhariut qëndron: "Merr abdes dhe pastroje organin gjenital!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Ali ibën Ebi Talibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se kishte shpesh lëng paraspermal (ar. el-medhju), i cili është një ujë i bardhë, i hollë e ngjites, që del nga organi gjatë epshit ose para marrëdhënieve intime. Ai nuk dinte çfarë të bënte kur i dilte ky lëng, kështu që kishte turp të pyeste Profetin ﷺ, sepse ishte burrë i Fatimes, bijës së Profetit ﷺ. Andaj kërkoi nga Mikdad ibn Esvedi ta pyeste Profetin ﷺ për këtë gjë. Në këtë rast Profeti ﷺ i tha ta pastronte organin dhe të merrte abdes.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e Ali ibën Ebi Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), meqë turpi nuk e shtyri ta braktiste pyetjen me ndërmjetësim (të Mikdadit).
2. Lejohet që gjatë kërkimit të fetvasë (përgjigjes për çështje fetare) të caktohet një zëvendësues.
3. Lejohet që njeriu të tregojë për veten për gjërat prej të cilave turpërohet, kur ka dobi në këtë gjë.
4. Lëngu paraspermal (ar. el-medhju) është i papastër dhe është obligim të pastrohet prej trupit dhe rrobave.

5. Dalja e lëngut paraspermal është prej gjërave që e prishin abdesin.
6. Është e obliguar larja e organit dhe testikujve, siç përmendet në një hadith tjetër.

(3348)

(124) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا اغْتَسَلَ مِنَ الْجَنَابَةِ، غَسَلَ يَدَيْهِ، وَتَوَضَّأَ وَضُوءَهُ لِلصَّلَاةِ، ثُمَّ اغْتَسَلَ، ثُمَّ يُحَلِّلُ بِيَدِهِ شَعْرَهُ، حَتَّى إِذَا ظَنَّ أَنَّهُ قَدْ أَرَوَى بَشْرَتَهُ، أَقَاضَ عَلَيْهِ الْمَاءَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ، ثُمَّ غَسَلَ سَائِرَ جَسَدِهِ، وَقَالَتْ: كُنْتُ أُغْتَسِلُ أَنَا وَرَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مِنْ إِنَاءٍ وَاحِدٍ، نَعْرِفُ مِنْهُ جَمِيعًا. [صحيح] - [رواه البخاري]

(124) – Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: "Kur i Dërguari i Allahut ﷺ pastrohej nga xhunubllëku, së pari fillonte me duart, pastaj merrte abdes sikurse për namaz, pastaj lahej: shpupurishte flokët me dorë (që të depërtonte uji) e, kur sigurohej se kishte larë lëkurën e kokës, i hidhte ujë kokës tri herë dhe, më pas, e pastronte tërë trupin me ujë." Vazhdon e thotë: "Unë dhe i Dërguari i Allahut ﷺ laheshim nga një enë e përbashkët, nga e cila merrnim ujë së bashku." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ dëshironte të pastrohej nga xhunubllëku, fillimisht i lante duart, pastaj merrte abdes ashtu siç merrte

abdes për namaz, e më pas derdhte ujë mbi trupin e tij, e pastaj i shpupurishte flokët me duar (që të depërtonte uji). Kur mendonte se uji kishte arritur deri te rrënjët e flokëve dhe e kishte larë lëkurën (e kokës), derdhte ujë tri herë mbi kokën e tij dhe më pas lante pjesën tjetër të trupit. Aishja vazhdon e thotë: "Unë dhe i Dërguari i Allahut ﷺ laheshim nga një enë e përbashkët, nga e cila merrnim ujë së bashku."

Mësimet nga hadithi:

1. Gusli (larja e tërësishme e trupit) ndahet në dy lloje: gusli i mjaftueshëm dhe i plotë. Sa i përket guslit të mjaftueshëm, ai është kur njeriu bën nijet të pastrohet, pastaj e përfshin tërë trupin e tij me ujë, duke përfshirë në këtë larje shpëlarjen e gojës dhe hundës. Ndërkaq, gusli i plotë është kur njeriu të pastrohet ashtu siç është pastruar Profeti ﷺ, siç ceket në këtë hadith.
2. Nocioni xhunubllëk përfshin personin që ka ejakuluar ose ka kryer kontakt intim, edhe nëse ky i dyti nuk ka ejakuluar.
3. Lejohet që njëri prej bashkëshortëve t'i shikojë pjesët intime të tjetrit dhe që të dy të pastrohen prej një ene.

(3316)

(125) - عَنْ عَمَّارِ بْنِ يَاسِرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: بَعَثَنِي رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي حَاجَةٍ، فَأَجْنَبْتُ فَلَمْ أَجِدِ الْمَاءَ، فَتَمَرَّعْتُ فِي الصَّعِيدِ كَمَا تَمَرَّعُ الدَّابَّةُ ثُمَّ أَتَيْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَذَكَرْتُ ذَلِكَ لَهُ فَقَالَ: «إِنَّمَا كَانَ يَكْفِيكَ أَنْ تَقُولَ بِيَدَيْكَ هَكَذَا» ثُمَّ ضَرَبَ بِيَدَيْهِ الْأَرْضَ ضَرْبَةً وَاحِدَةً، ثُمَّ مَسَحَ الشَّمَالَ عَلَى الْيَمِينِ، وَظَاهَرَ كَفَّيْهِ وَوَجْهَهُ. [صحيح] - [متفق عليه]

(125) - Nga Amar ibën Jasiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë: "Më dërgoi Profeti i Allahut (paqja qoftë mbi të!) për një nevojë dhe u bëra xhunub, dhe ngaqë nuk gjeta ujë u rrokullisa në dhe ashtu siç rrokulliset kafsha. Kur u ktheva te Profeti (paqja qoftë mbi të!), ia përmenda atë që bëra dhe ai më tha: "Të mjaftonte të bëje me duart a tua kështu; mandej ai i përplasi duart e tij në tokë një herë dhe fërkoj shuplakën e djathtë me të majtën dhe pjesën e sipërme të duarve dhe fytyrën." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti (paqja qoftë mbi të!) e dërgoi Amar ibn Jasirin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në një udhëtim për një nevojë. Ndërkohë, gjatë udhëtimit ai u bë xhunub nga marrëdhënia intime bashkëshortore ose në gjumë dhe nuk gjeti ujë për t'u larë. Ai nuk e dinte dispozitën e tejemumit për xhunubllëkun, por dinte vetëm dispozitën e tij për abdesin. Kështu që, ai nxori një gjykim nga ana e tij dhe mendoi se meqenëse fërkohen me dhe disa gjymtyrë të abdesit, atëherë për shkak të xhunubllëkut duhet fërkuar me

dhe i gjithë trupi! Duke bërë kështu analogji me larjen e trupit me ujë. Kësisoj, ai u rrokullis në tokë, derisa e fërkoi të gjithë trupin me dhe, dhe fali namazin. Kur u kthye te Profeti (paqja qoftë mbi të!) ia përmendi atij atë që kishte bërë, për të parë nëse ajo që kishte bërë ishte e saktë apo jo! Kësisoj, Profeti (paqja qoftë mbi të!) i shpjegoi atij se mënyra e pastrimit nga papastërtia e vogël si: urinimi, dhe nga papastërtia e madhe si: xhunubllëku, është që të përplasë shuplakat në dhe, një herë, dhe të fërkojë shuplakën e djathtë me të majtën dhe pjesën e jashtme të të dyja duarve dhe fytyrën.

Mësim nga hadithi:

1. Obligimi i kërkimit të ujit para marrjes së tejemumit.
2. Lejimi i marrjes së tejemumit në rast xhunubllëku kur nuk ka ujë.
3. Tejemumi nga papastërtia e madhe është i njëjtë si tejemumi nga papastërtia e vogël.

(3461)

(126) - عَنْ الْمُغِيْرَةِ رَضِيَ اللهُ عَنْهُ قَالَ: كُنْتُ مَعَ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي سَفَرٍ، فَأَهْوَيْتُ لِأَنْزِعَ حُقْفِيْهِ، فَقَالَ: «دَعُهُمَا، فَإِنِّيْ أَدْخَلْتُهُمَا طَاهِرَتَيْنِ» فَمَسَحَ عَلَيْهِمَا. [صحيح] - [متفق عليه]

(126) – Mugire ibën Shu’be (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rrëfen: "Isha në një udhëtim bashkë me Profetin ﷺ dhe u ula

për t'ia hequr mestet, por ai më tha: "Lëri, se i kam mbathur duke qenë me abdes." Kështu, ai u dha vetëm mes'h." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ishte në një udhëtim dhe mori avdes. Kur arriti te larja e këmbëve, Mugire ibn Shu'be (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i zgjati duart për t'ia hequr mestet që i kishte në këmbë Profetit ﷺ, për t'i larë ato. Profeti ﷺ i tha: "Lëri e mos i hiq, sepse këmbët i kam futur në meste duke qenë me abdes." Kësisoj, Profeti ﷺ u dha mes'h mesteve të tij, në vend që t'i lante këmbët.

Mësime nga hadithi:

1. Përligjja e dhënies mes'h mesteve është kur merret abdes nga papastërtia e vogël kuptimore (ar. el-hadeth el-asgar), ndërsa për larjen e tërësishme nga papastëritia e madhe kuptimore (ar. el-hadeth el-ekber), patjetër duhen larë këmbët.
2. Mes'hu (fshirja) bëhet një herë, duke e kaluar dorën e lagur mbi pjesën e sipërme të mesteve, e jo pjesën e poshtme.
3. Për mes'hin mbi meste kushtëzohet që të vishen pas një abdesi të plotë, në të cilin i ka larë këmbët me ujë dhe që mestet të jenë të pastra, ta mbulojnë pjesën e detyrueshme të këmbës dhe mes'hu të jetë nga ndonjë papastërti e vogël kuptimore, e jo për shkak të xhunubllëkut ose diçkaje që e bën të detyrueshëm

guslin (larjen e tërësishme të trupit). Po ashtu që mes'hu të jetë në kohën të përcaktuar fetarisht, që është një ditë e një natë për vendasin dhe tri ditë e tri net për udhëtarin.

4. Çdo gjë që i mbulon këmbët, bie fjala, çorapet dhe gjëra të tjera, krahasohen me mestet, rrjedhimisht lejohet dhënia mes'h atyre.
5. Në këtë hadith tregohet karakteri dhe mësimdhënia e mirë e Profetit ﷺ, sepse e ndali Mugiren që t'i hiqte mestet dhe ia shpjegoi arsyen se i kishte futur ato me avdes, që ta qetësojë dhe t'ia mësojë vendimin.

(3014)

(127) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا أَنَّ فَاطِمَةَ بِنْتَ أَبِي حُبَيْشٍ سَأَلَتِ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَتْ: إِنِّي أُسْتَحَاضُ فَلَا أَطْهَرُ، أَفَادَعُ الصَّلَاةَ؟ فَقَالَ: «لَا، إِنَّ ذَلِكَ عِرْقٌ، وَلَكِنْ دَعِيَ الصَّلَاةَ قَدَرُ الْأَيَّامِ الَّتِي كُنْتَ تَحِيضِينَ فِيهَا، ثُمَّ اغْتَسِلِي وَصَلِّيْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(127) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Fatime bint Hubejshi e pyeti Pejgamberin ﷺ: "Kam gjakrrjedhje të pandërprerë, kështu që nuk po pastrohem. A ta lë namazin?" Profeti ﷺ tha: “Jo, ajo që po të ndodh ty është gjakrrjedhje e çrregullt. Lëre namazin aq ditë sa të janë paraqitur menstruacionet më parë, pastaj laju dhe falu.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Fatime bint Hubejshi e pyeti Profetin ﷺ dhe i tha: "Gjakrrjedhja ime nuk po ndalet dhe vazhdon edhe kur nuk jam me menstruacione, a e merr kjo gjendje vendimin fetar sikur për menstruacione, e kësisoj gjatë kësaj periudhe ta lë namazin?" Profeti ﷺ i tha: "Ai është gjak i istihadës (gjakrrjedhje e çrregullt - hemorragji); gjak patologjik që rezulton nga ndërprerja e gjakrrjedhjes në mitër dhe nuk është gjak menstrual. Nëse vjen koha e menstruacioneve gjatë së cilës ke pasur menstruacione sipas zakonit tënd mujor, para se të sëmuresh me gjakrrjedhje të çrregullt, atëherë gjatë kësaj kohe lëre namazin, agjërimin dhe gjërat e tjera që femra me menstruacione pengohet t'i bëjë në kohën e menstruacioneve. Kur të kalojë kjo periudhë e të jesh pastruar nga menstruacionet, atëherë pastroje vendin e gjakut, e pastaj laje plotësisht trupin tënd, që ta largosh kështu papastërtinë kuptimore (ar. hadeth), e më pas falu.

Mësimet nga hadithi:

1. Femra e ka obligim të pastrohet tërësisht kur t'i mbarojnë ditët e menstruacioneve.
2. Femra që ka gjakrrjedhje të çrregullt e ka obligim ta falë namazin.
3. Menstruacionet janë gjak i natyrshëm që lëshohet nga mitra përmes vulvës (organit të jashtëm) të një gruaje të rritur dhe vjen tek ajo në ditë të caktuara.

4. Gjaku i çrregullt (ar. el-Istihada) është rrjedhje e gjakut afër fundit të mitrës jo në kohë të vet.
5. Dallimi midis gjakut të menstruacioneve dhe gjakut të çrregullt është se gjaku i menstruacioneve është i zi, i trashë dhe ka erë të keqe, ndërsa gjaku i çrregullt është i kuq, i hollë dhe nuk ka erë të keqe.

(3029)

(128) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِذَا وَجَدَ أَحَدُكُمْ فِي بَطْنِهِ شَيْئًا، فَأَشْكَلَ عَلَيْهِ أَخْرَجَ مِنْهُ شَيْءٌ أَمْ لَا، فَلَا يَخْرُجَنَّ مِنَ الْمَسْجِدِ حَتَّى يَسْمَعَ صَوْتًا، أَوْ يَجِدَ رِيحًا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(128) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Nëse dikush ndien diç (gazra) në bark, gjë që i ngjall dyshime nëse ka lëshuar ndonjë gaz apo jo, assesi të mos dalë nga xhamia pa dëgjuar zë ose pa ndier erë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, nëse diçka lëviz në barkun e namazliut dhe ai është në dyshim, a ka dalë diçka prej tij apo jo, nuk duhet të largohet nga namazi e ta ndërpresë për ta përsëritur abdesin, derisa të sigurohet se ka bërë ndonjë veprim që ia prish abdesin: duke dëgjuar zhurmën e gazrave ose duke e nuhatur erën, sepse gjënë e sigurt nuk e zhvleftëson dyshimi. Në fakt, ai është i sigurt

për pastërtinë (se ka abdes), ndërsa prishja e abdesit është dyshimtë.

Mësim nga hadithi:

1. Ky hadith është një nga bazat e Islamit dhe nga rregullat e jurisprudence (fikhut), e cila është: "Bindja nuk zhbëhet me dyshim", dhe: "Në parim çdo gjë mbetet siç ka qenë", derisa të vërtetohet e kundërta.
2. Dyshimi nuk ndikon në pastërti (abdes), kështu që namazliu vazhdon të ketë abdes, përderia nuk është i bindur se e ka prishur atë.

(65083)

(129) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِذَا شَرَبَ الْكَلْبُ فِي إِنَاءٍ أَحَدِكُمْ فَلْيَغْسِلْهُ سَبْعًا».

ولمسلم: «أَوْ لَاهَنَّ بِالْثَّرَابِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(129) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Nëse qeni pi në enën e ndokujt, le ta lajë atë shtatë herë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëroi që ena të lahet shtatë herë nëse qeni e fut gjuhën në të, e para prej tyre të

shoqërohet me dhe, kështu që uji të vijë pas tij, e kështu pastërtia të jetë e plotë nga papastëria dhe dëmi.

Mësime nga hadithi:

1. Pështyma e qenit është papastëri e rëndë.
2. Nëse qeni lëpin në enë, e bën atë të papastër, e edhe ujin që gjendet në të.
3. Procesi i pastrimit përmes dheut dhe përsëritja e tij shtatë herë është specifike për pastrimin e enës në të cilën qeni e ka futur gjuhën, e jo për urinën, nevojën e gjëra të tjera që i përlyen qeni.
4. Mënyra e pastrimit të enës përmes dheut: hidhet ujë në enë e i shtohet dhe më pas lahet ena me këtë përzierje.
5. Kuptimi i jashtëm i hadithit është i përgjithshëm, ku i përfshin të gjithë qentë, madje edhe qentë që feja i ka lejuar të mbahen, siç janë qentë e gjuetisë, rojës dhe blegtorisë.
6. Sapuni dhe detergjenti nuk e zëvendësojnë dheun në këtë rast, sepse Profeti ﷺ tekstualisht e ka përmendur dheun.

(3143)

(130) - عن عمر بن الخطاب رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِذَا قَالَ الْمُؤَدِّنُ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، فَقَالَ أَحَدُكُمْ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، ثُمَّ قَالَ: أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، قَالَ: أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، ثُمَّ قَالَ: أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، قَالَ: أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، ثُمَّ قَالَ: حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ، قَالَ: لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، ثُمَّ قَالَ: حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ، قَالَ: لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، ثُمَّ قَالَ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، قَالَ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، ثُمَّ قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مِنْ قَلْبِهِ دَخَلَ الْجَنَّةَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(130) – Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur myezini thotë: "Allahu ekber, Allahu ekber!" dhe ai që e dëgjon e përsërit: "Allahu ekber, Allahu ekber"; pastaj, kur ai thotë: "Eshhedu en la ilahe il-lallah", ky thotë: "Eshhedu en la ilahe il-lallah"; kur thotë: "Eshhedu enne Muhammeden resulullah", ky thotë: "Eshhedu enne Muhammeden resulullah"; kur thotë: "Haje ales-salah", ky thotë: "La havle ve la kuvete il-la bil-lah"; kur thotë: "Haje alel-felah", ky thotë: "La havle ve la kuvete ila bilah"; kur thotë: "Allahu ekber, Allahu ekber", ky thotë: "Allahu ekber, Allahu ekber", dhe, kur thotë: "La ilahe il-lallah", ky thotë: "La ilahe il-lallah", nga zemra e tij, do të hyjë në Xhenet.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Ezani është për të informuar njerëzit se koha e namazit ka filluar. Fjalët e ezanit janë fjalë gjithëpërfshirëse për doktrinën e besimit.

Në këtë hadith, Profeti ﷺ sqaroi atë që është e ligjësuar gjatë dëgjimit të ezanit, respektivisht dëgjuesi e thotë atë që e thotë myezini. Nëse myezini thotë: "Allahu ekber", atëherë dëgjuesi thotë: "Allahu ekber" e kështu me radhë. Me përjashtim të rastit kur myezini thotë: "Haje ales-salah", dhe: "Haje al-el-felah", ky thotë: "La havle ve la kuvete il-la bil-lah."

Profeti ﷺ sqaroi se, kush e përsërit ezanin pas myezinit, sinqerisht nga zemra e tij, do të hyjë në Xhenet.

Kuptimet e fjalëve të ezanit: "Allahu ekber", që do të thotë se Ai, i Lartësuar, është më madhështori, më i çmuari dhe më i madhi se çdo gjë e çdokush tjetër.

"Eshhedu en la ilahe il-lallah", që do të thotë se nuk meriton të adhurohet askush me të drejtë pos Allahut.

"Eshhedu enne Muhammeden resulullah", pra, e pranoj dhe dëshmoj me gjuhën e zemrën time se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, të cilin e dërgoi Allahu i Lartmadhërishëm dhe është obligim t'i bindemi atij.

"Haje ales-salah", që do të thotë: Ejani në namaz! Ndërkaq, fjala e dëgjuesit, kur thotë: "La havle ve la kuvete il-la bil-lah", e ka kuptimin: Nuk ka rrugë për të shpëtuar nga pengesat për të kryer adhurim dhe nuk ka forcë për ta bërë atë e as fuqi për të bërë ndonjë gjë, përveçse me suksesin e Allahut të Lartësuar.

"Haje alel-felah", që do të thotë: Ejani te shkaku i shpëtimit, që është fitimi i Xhenetit dhe shpëtimi nga Xhehenemi.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera që të thuhet ashtu siç thotë myezini, përveç te pjesa:
2. "Haje ales-salah" dhe "Haje alel felah", të thuhet: "La havle ve la kuvete il-la bil-lah."

(65086)

(131) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «إِذَا سَمِعْتُمُ الْمُؤَذِّنَ فَقُولُوا مِثْلَ مَا يَقُولُ، ثُمَّ صَلُّوا عَلَيَّ، فَإِنَّهُ مَنْ صَلَّى عَلَيَّ صَلَاةً صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ بِهَا عَشْرًا، ثُمَّ سَلُوا اللَّهَ لِي الْوَسِيلَةَ، فَإِنَّهَا مَنْزِلَةٌ فِي الْجَنَّةِ، لَا تَنْبَغِي إِلَّا لِعَبْدٍ مِنْ عِبَادِ اللَّهِ، وَأَرْجُو أَنْ أَكُونَ أَنَا هُوَ، فَمَنْ سَأَلَ لِي الْوَسِيلَةَ حَلَّتْ لَهُ الشَّفَاعَةُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(131) – Abdullah ibën Amër ibën Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: “Kur të dëgjoni myezinin, përsëritni fjalët që i thotë e pastaj dërgoni salavate për mua, sepse ai që dërgon salavate për mua një herë, Allahu do të dërgojë salavate (do ta lavërojë) për të dhjetë herë. Pastaj kërkon prej Allahut për mua vesilen, e cila është pozitë në Xhenet që i takon vetëm një rob të Allahut. Kam shpresë të jem unë ai. Ai që kërkon

vesilen për mua, do ta gëzojë ndërmjetësimin tim.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith porosit këdo që e dëgjon myezinin teksa bën thirrje për namaz, që të përsëritë pas tij dhe të thotë njëjtë siç thotë ai, përveç te pjesët: "Hajje ales-salah" dhe: "Hajje alel-felah", thotë: "La havle ue la kuvvete il-la bil-lah!" Pastaj, pas përfundimit të ezanit, dërgon salavate për Profetin ﷺ, sepse ai që dërgon salavate për të një herë, Allahu do të dërgojë salavate (do ta lavdërojë) për të dhjetë herë. Kuptimi i salavatit të Allahut ndaj robit të Tij është: lavdërimi që Ai ia bën robit para melekëve.

Pastaj u urdhërua që t'ia kërkojë Allahut vesilen për Profetin ﷺ, e cila është një pozitë në Xhenet dhe është më e larta e tij, dhe ajo pozitë është vetëm për një rob nga të gjithë robërit e Allahut të Lartësuar, e unë shpresoj se do të jem ai. Profeti ﷺ e tha këtë vetëm nga modestia, sepse nëse ajo pozitë e lartë i takon vetëm një personi, atëherë ai person mund të jetë vetëm Profeti ﷺ, meqë ai është krijesa më e mirë.

Pastaj Profeti ﷺ sqaroi se, kushdo që lutet për Profetin ﷺ që Allahu t'ia japë vesilen, do ta arrijë ndërmjetësimin e tij ﷺ.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për t'iu përgjigjur myezinit.

2. Vlera e salavatit për Profetin ﷺ pas përgjigjes ndaj myezinit.
3. Inkurajimi për ta lutur Allahun që t'ia japë Profetit ﷺ vesilen pasi t'i dërgojmë salavate atij.
4. Sqarimi i kuptimit të vesiles dhe pozitës së saj të lartë, meqë është vetëm për një rob.
5. Sqarimi i vlerës së Profetit ﷺ, meqë është veçuar me këtë pozitë të lartë.
6. Ai që e lut Allahun e Lartësuar që t'ia japë vesilen Profetit ﷺ, do ta gëzojë ndërmjetësimin e tij.
7. Sqarimi i modestisë së Profetit ﷺ, meqë kërkoi nga umeti i tij që të luten që Allahu t'ia japë këtë pozitë, megjithëse kjo pozitë do të jetë për të.
8. Mirësia dhe mëshira e gjerë e Allahut, meqë vepra e mirë dhjetëfishohet.

(65087)

(132) - عَنْ سَعْدِ بْنِ أَبِي وَقَّاصٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ قَالَ: «مَنْ قَالَ حِينَ يَسْمَعُ الْمُؤَذِّنَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولًا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا، غُفِرَ لَهُ ذَنْبُهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(132) – Nga Sa'd ibën ebi Uekasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka

thënë: "I falen mëkatet atij njeriu i cili i thotë këto fjalë kur dëgjon muezinin: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i vetëm dhe nuk ka ortak dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Jam i kënaqur me Allahun si Zot dhe me Muhamedin si Pejgamber dhe me Islamin si fe". [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se kush thotë kur dëgjon muezinin: "Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i vetëm dhe nuk ka ortak." Domethënë: Pohoj, pranoj dhe njoftoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se çdo i adhuruar tjetër veç Tij është i kotë. Dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij" D.m.th: Ai është rob e nuk adhurohet dhe është i dërguar që nuk gënjen. "Jam i kënaqur me Allahun si Zot" Domethënë: jam i kënaqur me faktin që Allahu është Zot, i adhuruar dhe që ka cilësitë dhe emrat më të bukur. "Dhe me Muhamedin si pejgamber" Domethënë: jam i kënaqur me të gjitha çështjet që ai solli dhe që i predikoi. "Dhe me Islamin" Domethënë: jam i kënaqur me të gjitha ligjet e Islamit qofshin ato urdhëresa apo ndalesa. "Si fe" domethënë: si diçka që besohet dhe pasohet. "I falen mëkatet" domethënë: mëkatet e vogla.

Mësime nga hadithi:

1. Thënia e kësaj lutjeje kur dëgjojmë ezanin është prej gjërave që shlyejnë mëkatet.

(133) - عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ قَالَ حِينَ يَسْمَعُ النَّدَاءَ: اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدَّعْوَةُ الثَّامَّةُ، وَالصَّلَاةُ الْقَائِمَةُ، آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ، وَابْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتُهُ، حَلَّتْ لَهُ شَفَاعَتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(133) – Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që, pasi ta dëgjojë ezanin, thotë: “Allahumme rabbe hadhihi davetit-tammeti ves-salatil kaimeti, ati Muhammedenil vesilete vel fadilete, veb athhu mekamen mahmudenil-ledhi veadtehu. (O Allah, Zot i kësaj thirrjeje të përsosur dhe këtij namazi që po falet, jepja Muhamedit ndërmjetësimin dhe mirësinë. Ngrije në pozitën e lartë, - Mekami Mahmud, - të cilën ia ke premtuar), e meriton ndërmjetësimin tim Ditën e Kiametit.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se kushdo që thotë këtë lutje pasi ta përfundojë muezini ezanin:

"O Allah, Zot i kësaj thirrjeje", që janë fjalët e ezanit, me të cilat thirren njerëzit për të adhuruar Allahun dhe për të kryer namazin. "të përsosur", do të thotë të plotë, pra thirrja e teuhidit dhe e mesazhit hyjnor. "dhe këtij namazi që po falet", që është i vazhdueshëm dhe i afërt për t'u kryer. "...jepja Muhamedit ndërmjetësimin", që është pozita më e

lartë në Xhenet, e cila nuk do t'i jepet askujt tjetër përveç tij ﷺ. "...dhe mirësinë", që është shkalla e epërsisë ndaj shkallëve të tjera të krijesave. "Ngrije në pozitën e lartë, - Mekami Mahmud", që i sjell lavdërim atij që qëndron aty, dhe që i referohet ndërmjetësimit të madh në Ditën e Gjykimit. " të cilën ia ke premtuar", me fjalën e Tënde: "Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar." (El Isra 79), e meriton ndërmjetësimin tim Ditën e Kiametit.

Kushdo që thotë këtë lutje, do ta meritojë ndërmjetësimin e Profetit ﷺ, dhe ajo me siguri do t'i jepet atij në Ditën e Gjykimit.

Mësime nga hadithi:

1. Ligjshmëria e kësaj lutjeje është pas përfundimit të përsëritjes pas muezinit, dhe kush nuk e dëgjon thirrjen, nuk e thotë atë.
2. Vlera e të Dërguarit të Allahut ﷺ qëndron në faktin se atij iu dha ndërmjetësimi, mirësia, pozita e lartë, - Mekami Mahmud, dhe ndërmjetësimi i madh për ndarjen (gjykimin) mes krijesave.
3. Pohimi i ndërmjetësimit për të Dërguarin e Allahut ﷺ, siç tregohet në fjalën e tij: "e meriton ndërmjetësimin tim Ditën e Kiametit."
4. Ndërmjetësimi i Profetit ﷺ do të jetë për ata që kanë bërë mëkate të mëdha nga umeti i tij, në mënyrë që të mos hyjnë në Zjarr, ose për ata që tashmë kanë

hyrë në të që të nxirren prej tij, ose që të futen në Xhenet pa llogari, ose për ata që kanë hyrë në Xhenet që t'u ngrihen shkallët.

5. Tibiu ka thënë: "Prej fillimit të ezanit e deri te fjala "Muhamedi është i Dërguari i Allahut" është thirrja e përsosur. "Hajalah" (thënia: Ejani në namaz, ejani në shpëtim) i referohet namazit, që do të falet, siç është në fjalën e Tij: "E kryejnë namazin." Është e mundshme që "namazi" të ketë kuptimin e lutjes dhe "el kaimeh - që do të falet", nënkupton të qenët i vazhdueshëm. Sipas kësaj, fjala e tij "namazi që po falet" është një sqarim i thirrjes së përsosur. Është gjithashtu e mundshme që me "namazin" këtu të synohet namazi specifik dhe i vendosur për të cilin po bëhet thirrja në atë moment, dhe kjo është më e sakta."
6. Muhelebi ka thënë: "Hadithi inkurajon lutjen në kohët e namazit, sepse është një gjendje kur shpresohet që lutjet të pranohen."

(10635)

(134) - عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «الدُّعَاءُ لَا يُرَدُّ بَيْنَ الْأَذَانِ وَالْإِقَامَةِ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

(134) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Lutja që bëhet në

mes të ezanit dhe të ikametit nuk refuzohet." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

Shpjegimi:

Pejgamberi ﷺ në këtë hadith ka sqaruar vlerën e lutjes midis ezanit dhe ikametit, duke theksuar se ajo nuk refuzohet dhe është shumë e mundshme të pranohet. Prandaj, lutjuni Allahut në atë kohë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e kësaj kohe për lutje.
2. Nëse lutësi përmbahet ndaj edukatës gjatë lutjes, zgjedh momentet dhe vendet e saj me vlerë, largohet nga mëkatet, ruan veten nga rënia në gjëra të dyshimta dhe ka mendim të mirë për Allahun, atëherë është e mundshme që t'i pranohet lutja, me lejen e Allahut.
3. Munaviu ka thënë për pranimin e lutjes: "Domethënë, pasi të plotësohen kushtet, shtyllat dhe edukata gjatë lutjes. Nëse ndonjë prej tyre mungon, atëherë le të fajësojë vetëm veten e tij."
4. Pranimi i lutjes nënkupton: Ose lutja e tij i plotësohet menjëherë, ose largohet prej tij një e keqe e barasvlershme me të, ose ruhet për të në botën tjetër; e gjitha kjo sipas urtësisë dhe mëshirës së Allahut.

(135) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: أَتَى النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَجُلٌ أَعْمَى، فَقَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنَّهُ لَيْسَ لِي قَائِدٌ يَقُوْدُنِي إِلَى الْمَسْجِدِ، فَسَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنْ يُرَخَّصَ لَهُ فَيُصَلِّيَ فِي بَيْتِهِ، فَرَخَّصَ لَهُ، فَلَمَّا وَلَّى دَعَاهُ، فَقَالَ: «هَلْ تَسْمَعُ الدَّاءَ بِالصَّلَاةِ؟» فَقَالَ: نَعَمْ، قَالَ: «فَأَجِبْ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(135) – Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon “Një njeri i verbër erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, nuk kam askënd të ma tregojë rrugën për në xhami.” Pastaj kërkoi nga i Dërguari i Allahut ﷺ ta lejojë të falet në shtëpi. Profeti ﷺ ia lejoi, mirëpo, kur ai mori të kthehej, Profeti ﷺ i tha: “A e dëgjon ezanin për namaz?” Ai iu përgjigj: “Po.” Profeti ﷺ i tha: “Përgjigjju, pra!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Një i verbër erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Unë jam i verbër dhe nuk kam njeri që të më ndihmojë e të më marrë për dore në xhami për faljen e pesë vakteve" dhe kështu kërkonte lehtësim nga Profeti ﷺ, që të mos merrte pjesë në faljen e namazit me xhemat, e në atë rast Profeti ﷺ ia lejoi. Mirëpo, kur njeriu po largohej, Profeti ﷺ e thirri dhe e pyeti: "A e dëgjon ezanin për namaz?" Ai iu përgjigj: “Po.” Profeti ﷺ i tha: “Përgjigjju pra thirrësit për në namaz!”

Mësime nga hadithi:

1. Namazi me xhemat është obligim (vaxhib), sepse lehtësimi ndodh për një gjë që është e obliguar dhe vaxhib.
2. Fjala e Profetit ﷺ: "Përgjigju!", për atë që e dëgjon thirrjen, tregon se namazi me xhemat është obligim, sepse në parim urdhri tregon se një gjë e tillë është obligim.

(11287)

(136) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ سَمِعَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «أَرَأَيْتُمْ لَوْ أَنَّ نَهْرًا بِبَابِ أَحَدِكُمْ يَغْتَسِلُ فِيهِ كُلَّ يَوْمٍ خَمْسًا، مَا تَقُولُ ذَلِكَ يُبْقِي مِنْ دَرَنِهِ؟» قَالُوا: لَا يُبْقِي مِنْ دَرَنِهِ شَيْئًا، قَالَ: «فَذَلِكَ مِثْلُ الصَّلَوَاتِ الْخَمْسِ، يَمْحُو اللَّهُ بِهِ الْخَطَايَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(136) – Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) duke thënë: “Çfarë mendoni sikur para portës së ndonjërit prej jush të ishte një lumë ku ai lahej pesë herë në ditë, a do të mbetej papastërti në trupin e tij?! Të pranishmit thanë: 'Nuk do të mbetej asnjë papastërti në trupin e tij!' Ai tha: 'Ky është dhe shembulli i namazeve me të cilat Allahu shlyen mëkatet.'” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti i Allahut (paqja qoftë mbi të!) i përngjasoi pesë namazet e ditës dhe të natës në shlyerjen e mëkateve dhe gabimeve të vogla me një lumë që rrjedh para derës së shtëpisë së njeriut, ku ai lahet pesë herë në ditë dhe nga kjo në trupin e tij nuk mbetet asnjë papastërti.

Mësim nga hadithi:

1. Kjo vlerë është specifike për shlyerjen e mëkateve të vogla. Ndërsa, për mëkate të mëdha duhet të pendohemi patjetër.
2. Vlera e faljes së pesë namazeve dhe kujdesi ndaj tyre, duke i plotësuar kushtet që janë para se futemi në namaz dhe kushtet që janë brenda në namaz dhe duke i kryer veprimet e detyrueshme dhe veprimet e pëlqyeshme.

(4968)

(137) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَأَلْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَيُّ الْعَمَلِ أَحَبُّ إِلَى اللَّهِ؟ قَالَ: «الصَّلَاةُ عَلَى وَفْتِهَا»، قَالَ: ثُمَّ أَيٌّ؟ قَالَ: «تُحِبُّ بِرَّ الْوَالِدَيْنِ» قَالَ: ثُمَّ أَيٌّ؟ قَالَ: «الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ» قَالَ: حَدَّثَنِي بِهِنَّ، وَلَوْ اسْتَرَدَّتُهُ لَرَادَنِي. [صحيح] - [متفق عليه]

(137) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "E pyeta Profetin ﷺ - Cila vepër është më e dashur tek Allahu? - “Namazi që falet në kohën e vet”, - u

përgjigj ai. - Pastaj cila? - “Mirësjellja me prindërit”, - tha Profeti ﷺ. - Pastaj cila? - “Lufta në rrugën e Allahut.” Kështu më tha Profeti ﷺ. Sikur ta pyesja më shumë, do të më tregonte edhe më tej." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ qe pyetur: "Cila është vepra më e dashur tek Allahu?" Në këtë rast tha: "Namazi i obliguar në kohën e vet, të cilën e ka përcaktuar feja. Pastaj mirësjellja me prindërit, bërja mirë atyre, përmbushja e të drejtave të tyre dhe braktisja e mosrespektimit ndaj tyre. E pastaj xhihadi në rrugë të Allahut për ta lartësuar Fjalën e Allahut të Lartmadhërishëm, për ta mbrojtur fenë islame dhe muslimanët e për t'i shpërfaqur simbolet e tij të dukshme, përmes (dhënies së) shpirtit dhe pasurisë.

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Më tregoi për këto vepra, saqë, po t'i thosha: "Pastaj cila?", do të më tregonte më tej.

Mësime nga hadithi:

1. Veprat dallojnë nga njëra-tjetra, në varësi të dashurisë që ka Allahu për to.
2. Inkurajimi i muslimanit që t'i veprojë veprat më të mira, e kështu me radhë.
3. Përgjigjet e Profetit ﷺ për veprat më të mira ndryshojnë varësisht njerëzve e rrethanave të tyre dhe asaj që është më e dobishme për secilin prej tyre.

(138) - عَنْ عُثْمَانَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَا مِنْ أَمْرٍ مُسْلِمٍ تَحْضُرُهُ صَلَاةٌ مَكْتُوبَةٌ فَيُحْسِنُ وُضْوءَهَا وَخُشُوعَهَا وَرُكُوعَهَا، إِلَّا كَانَتْ كَفَّارَةً لِمَا قَبْلَهَا مِنَ الذُّنُوبِ، مَا لَمْ يُؤْتِ كَبِيرَةً، وَذَلِكَ الدَّهْرَ كُلَّهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(138) – Nga Uthmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se e ka dëgjuar Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!) të thotë: "Cilido musliman, që kur hyn koha e namazit obligativ, merr abdes me përpikëri dhe i kryen veprimet e namazit me kujdes dhe përlulje, ky namaz do të jetë shlyerje për mëkatet e tij të kaluara, për sa kohë që ai nuk kryen ndonjë mëkat të madh. Dhe kjo mirësi është për gjatë gjithë kohës." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se muslimani, i cili kur hyn koha e namazit të detyrueshëm, merr abdes me përpikëri dhe më pas qëndron i përlulur gjatë faljes së namazit, duke i pasur të gjitha gjymtyrët të përkushtuara dhe të përqendruara te madhështia e Allahut, dhe duke i plotësuar veprimet e namazit, si: rukunë, sexhden dhe veprimet e tjera, atëherë ky namaz i shlyen mëkatet e tij të vogla që ka bërë më herët, për sa kohë që nuk vepron ndonjë mëkat të madh. Dhe kjo mirësi është e vazhdueshme gjatë gjithë kohës dhe në çdo namaz.

Mësime nga hadithi:

1. Namazi, i cili i shlyen mëkatet është ai në të cilin njeriu merr abdes në mënyrë të përsosur dhe i kryen veprimet me përlulje, duke synuar kënaqësinë e Allahut.
2. Vlera e vazhdimësisë në kryerjen e adhurimeve dhe se ato shërbejnë për faljen e mëkateve të vogla.
3. Vlera e përsosjes së abdesit dhe e përsosjes së veprimeve të namazit me përlulje.
4. Rëndësia e shmangies së mëkateve të mëdha, për të përfituar falje për mëkatet e vogla.
5. Mëkatet e mëdha falen vetëm me anë të pendimit.

(6254)

(139) – عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم كان يقول: «الصَّلَاةُ الْحُمْسُ، وَالْجُمُعَةُ إِلَى الْجُمُعَةِ، وَرَمَضَانُ إِلَى رَمَضَانَ، مُكْفِّرَاتٌ مَا بَيْنَهُنَّ إِذَا اجْتَنَبَ الْكَبَائِرَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(139) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ thoshte: “Pesë namazet ditore, namazi i xhumasë deri në namazin e xhumasë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër janë falje për gjynahet e bëra mes tyre, nëse njeriu ruhet prej gjynaheve të mëdha.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se pesë namazet e detyrueshme gjatë ditës dhe natës, namazi i xhumasë çdo javë dhe agjërimi i muajit Ramazan çdo vit janë shlyerje për gjynahet e vogla që ndodhin mes tyre, me kusht që të shmangen gjynahet e mëdha. Sa u përket gjynaheve të mëdha, si: kurvëria e konsumimi i alkoolit, ato i fshin vetëm pendimi.

Mësime nga hadithi:

1. Gjynahet ndahen në të mëdha dhe të vogla.
2. Shlyerja e gjynaheve të vogla është e kushtëzuar me shmangien e gjynaheve të mëdha.
3. Gjynahet e mëdha janë ato gjynahe për të cilat ka ndëshkim të paracaktuar fetar (ar. hadd) në këtë botë, ose për to ka kërcënim në botën tjetër me ndëshkim, ose zemërim (të Allahut), ose për to ka kërcënim e mallkim për vepruesin e tyre, si: kurvëria e konsumimi i alkoolit.

(3591)

(140) - عن عمرو بن شعيب عن أبيه عن جده قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مُرُوا أَوْلَادَكُمْ بِالصَّلَاةِ وَهُمْ أَبْنَاءُ سَبْعِ سِنِينَ، وَاضْرِبُوهُمْ عَلَيْهَا وَهُمْ أَبْنَاءُ عَشْرِ، وَفَرِّقُوا بَيْنَهُمْ فِي الْمَضَاجِعِ». [حسن] - [رواه أبو داود]

(140) – Amër ibën Shuajbi ka përcjellë nga i ati e ai nga gjyshi i tij se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Urdhërojini fëmijët tuaj të falen që në moshën shtatë vjeçe e disiplinojini ata nëse nuk falen në moshën dhjetë vjeçe dhe ndajini në shtretër të veçantë.” [Hadith hasen] - [E shënon Ebu Davudi]

Shpjegimi:

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se prindi e ka për detyrë t'i urdhërojë djemtë dhe vajzat e tij të falin namazin në moshën shtatë vjeçe dhe t'u mësojë atyre njohuritë e nevojshme për faljen e tij. E kur të arrijnë moshën dhjetë vjeçe, ai duhet ta përforcojë urdhrin e tij, duke i disiplinuar ata nëse tregojnë shkujdesje në faljen e namazit. Gjithashtu, në këtë moshë, ai duhet t'i ndajë ata në shtretër të veçantë.

Mësime nga hadithi:

1. Mësimi i çështjeve të fesë (në veçanti namazin) fëmijëve të vegjël, që nuk kanë arritur ende moshën e pubertetit.

2. Disiplinimi me rrahje të jetë për t'i edukuar e jo për t'i ndëshkuar dhe të jetë në mënyrë të përshtatshme dhe të arsyeshme.
3. Sheriati i ka kushtuar kujdes të veçantë mbrojtjes së nderit, duke mbyllur çdo rrugë që mund të shpjerë në shthurje.

(5272)

(141) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: قَسَمْتُ الصَّلَاةَ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي نِصْفَيْنِ، وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ، فَإِذَا قَالَ الْعَبْدُ: {الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ}، قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: حَمَدَنِي عَبْدِي، وَإِذَا قَالَ: {الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ}، قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: أَثْنَى عَلَيَّ عَبْدِي، وَإِذَا قَالَ: {مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ}، قَالَ: حَجَّدَنِي عَبْدِي، -وَقَالَ مَرَّةً: فَوَضَّ إِلَيَّ عَبْدِي-، فَإِذَا قَالَ: {إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ}، قَالَ: هَذَا بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ، فَإِذَا قَالَ: {اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ، صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ}، قَالَ: هَذَا لِعَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(141) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: “Allahu i Lartësuar ka thënë: "Fatihanë e kam ndarë përgjysmë mes Meje dhe robit Tim, e robit Tim i takon ajo që e kërkon. Kur robi thotë: "Elhamdu lil-lahi rabbil-alemin", Allahu i Lartësuar thotë: "Robi Im më falënderoi." Kur thotë: "Err-Rrahmanir-Rrahim", Allahu thotë: "Robi Im më lavdëroi." Kur ai thotë: "Maliki jeumid-din", Allahu thotë: "Robi Im

më madhëroi", - një herë pati thënë: "Robi Im më besoi çdo gjë të tij." Kur robi thotë: "Ijjake nabudu ue ijjake nestein", Allahu thotë: "Kjo është mes Meje dhe robit Tim, e robit Tim i takon ajo që e kërkon." Kur robi thotë: "Ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine enamte alejhim, gajril-magdubi alejhim, ueled-dal-lin", Allahu thotë: "Kjo i përket robit Tim dhe atij i takon ajo që ka kërkuar." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ tregon se Allahu i Lartësuar në hadithin kudsî thotë: "Në namaz e ndava suren el Fatiha përgjysmë mes Meje dhe robit Tim: gjysma është për Mua e gjysma është për të."

Gjysma e parë është falënderim, lavdërim dhe madhërim kushtuar Allahut, për të cilin Allahu jep shërblim të madh.

Gjysma e dytë është përgjërëm dhe lutje, të cilit Allahu i përgjigjet e i jep çfarë kërkon.

Kur namazliu të thotë: "Elhamdulil-lahi rabbil-alemin", Allahu i Lartësuar thotë: "Robi Im më falënderoi." Kur thotë: "Err-Rrahmanir-rrahim", Allahu thotë: "Robi Im më lavdëroi" e më falënderoi dhe kjo, njëherazi, është miratim nga ana e tij për Mua se Unë i begatoj të gjitha krijesat. Kur ai thotë: "Maliki jeumid-din", Allahu thotë: "Robi Im më madhëroi", e ky është nderim i gjerë.

Kur robi thotë: "Ijjake nabudu ue ijjake nestein", Allahu thotë: "Kjo është mes Meje dhe robit Tim."

Gjysma e parë e këtij ajeti është për Allahun, e cila është: "Ijjake nabudu - Vetëm Ty të adhurojmë", që nënkupton

veçimin e Allahut me adhurim dhe duke iu përgjigjur me ibadet, e me të përfundon gjysma që i takon Allahut.

Gjysma e dytë e ajetit është për robin: "ue ijjake nestein - vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", që nënkupton kërkimin e ndihmës prej Allahut dhe është premtim prej Tij për ndihmë.

E, kur ai thotë: "Ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine enamte alejhim, gajril-magdubi alejhim, ueled-dalin - Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!", Allahu thotë: "Ky është përgjërëm dhe lutje nga robi Im, e robët Tim i takon ajo që kërkoj, ndërsa Unë iu përgjigja lutjes së tij."

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e madhe e Fatihasë, saqë Allahu i Lartësuar e quajti atë namaz.
2. Sqarimi i kujdesit të Allahut të Lartësuar për robin e Tij, pasi Ai e falënderoi atë për falënderimin, lavdërimin dhe madhërimin që ia kushtoi Atij dhe i premtoi se do t'i jepte atë që ai kërkoj.
3. Kjo sure fisnike ngërthen në vete falënderimin për Allahun, përmendjen e Ditës së Kiametit, lutjen kushtuar Allahut, adhurimin e sinqertë kushtuar Atij dhe lutjen për udhëzim në rrugën e drejtë e paralajmërimin nga rrugët e kota.

4. Kur namazliu ta ketë parasysh këtë hadith teksa e lexon Fatihanë, ia shton përkushtimin në namaz.

(65099)

(142) – عن بريدة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ الْعَهْدَ الَّذِي بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمُ الصَّلَاةُ، فَمَنْ تَرَكَهَا فَقَدْ كَفَرَ». [صحيح] - [رواه الترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

(142) – Burejde (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Besëlidhja ndërmjet nesh dhe atyre është namazi. Andaj, ai që e lë namazin, ka rënë në kufër (mosbesim)." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se besa dhe besëlidhja ndërmjet muslimanëve dhe të tjerëve, qofshin jobesimtarë, qofshin hipokritë, është namazi, e kushdo që e lë atë bën kufër.

Mësim nga hadithi:

1. Rëndësia e madhe e namazit dhe se ai është dalluesi mes besimtarit dhe jobesimtarit.
2. Vendimet e Islamit vërtetohen nga ana e jashtme e njeriut, e jo nga ajo e brendshme.

(65094)

(143) - عن جابر رضي الله عنه قال: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول:

«إِنَّ بَيْنَ الرَّجُلِ وَبَيْنَ الشَّرْكِ وَالْكُفْرِ تَرْكُ الصَّلَاةِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(143) – Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: "Vërtet ndërmjet njeriut dhe shirkut e kufrit qëndron lënia e namazit." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka tërhequr vërejtjen për lënien e namazit farz (të detyrueshëm) dhe ka thënë se ndërmjet njeriut dhe rënies në shirk e kufër është lënia e namazit, pasi namazi është shtylla e dytë e Islamit dhe rëndësia e tij është e madhe në Islam. Kush e lë atë duke e mohuar obligueshmërinë e tij, ka bërë kufër sipas konsensusit të muslimanëve. Edhe nëse e lë atë plotësisht nga pakujdesia dhe përtacia është jobesimtar. Për këtë gjë është transmetuar konsensusi i sahabëve (se ai është jobesimtar). E, nëse ndonjëherë e lë e ndonjëherë falet, atëherë ai i ekspozohet këtij kërcënimi të rëndë.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e namazit dhe kryerja e tij në vazhdimësi, pasi është vija ndarëse mes mosbesimit dhe besimit.
2. Paralajmërim i ashpër kundër lënies së namazit dhe braktisjes së tij.

(144) – عن سالم بن أبي الجعد قال: قال رجل: ليتني صليتُ فاسترحْتُ، فكأنهم عابُوا ذلك عليه، فقال: سمعتُ رسولَ الله صلى الله عليه وسلم يقول: «يا بلالُ، أقم الصَّلَاةَ، أرخنا بها». [صحيح] - [رواه أبو داود]

(144) – Salim ibën Ebu Xhadi tregon se një njeri tha: "Sikur të isha falur dhe të isha qetësuar!" Ata sikur e qortuan për këtë gjë. E kam dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: "O Bilal! Thirre ikametin (për namaz) dhe na qetëso me të!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ebu Davudi]

Shpjegimi:

Dikush nga sahabët tha: "Sikur të isha falur dhe të isha qetësuar!" Ata që ishin përreth tij sikur e qortuan për këtë gjë. Kësisoj (Salimi tha se) e kam dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: "O Bilal! Thirre ezanin për namaz, që të qetësohemi me të!" Sepse në namaz i drejtohem Allahut të Lartësuar dhe e qetësojmë shpirtin dhe zemrën.

Mësim nga hadithi:

1. Rehatia e zemrës arrihet me namaz, sepse në të i drejtohem Allahut të Lartësuar.
2. Refuzimi ndaj atij që adhurimi i duket i rëndë.
3. Ai që kryen obligimin e tij dhe heq përgjegjësinë e tij për të, do të arrijë rehati dhe ndjenjë sigurie.

(65095)

(145) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، إِذَا كَبَّرَ فِي الصَّلَاةِ، سَكَتَ هُنَيْئَةً قَبْلَ أَنْ يَقْرَأَ، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ بِأَيِّ أَنْتَ وَأُمِّي أَرَأَيْتَ سُكُوتَكَ بَيْنَ التَّكْبِيرِ وَالْقِرَاءَةِ، مَا تَقُولُ؟ قَالَ «أَقُولُ: اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْ خَطَايَايَ كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنَ خَطَايَايَ بِالْثَّلَجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرَدِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(145) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se, kur i Dërguari i Allahut ﷺ merrte tekbirin fillestar për namaz, heshte pak para se të fillonte leximin e Kuranit. Unë e pyeta: "O i Dërguari i Allahut, kurban t'u bëfshin im atë e ime më, gjatë kohës që ti hesht, mes tekbirit fillestar dhe leximit të Kuranit, çfarë thua?" Ai m'u përgjigj: "Them: "Allahume baid bejni ue bejne hatajaje kema ba'adte bejnel meshriki uel magribi. Allahume nekkini min hatajaje kema junekkath-theubul ebjedü mined-denesi. Allahume igsilni min hatajaje bith-thelxhi uelmai uel beradi (O Allah, më largo prej mëkateve të mia, siç e ke larguar lindjen prej perëndimit! O Allah, më pastro nga mëkatet e mia, siç pastrohet rrobja e bardhë nga ndyrësirat! O Allah, më laj nga mëkatet e mia me borë, me ujë dhe breshër)!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ merrte tekbirin fillestar për namaz, heshte pak para se të fillonte këndimin e Fatihasë; ai e fillonte

namazin e tij me disa lutje. Prej lutjeve që transmetohen është dhe kjo: "Allahume baid bejni ue bejne hatajaje kema ba'adte bejnel meshriki uel magribi. Allahume nekkini min hatajaje kema junekkath-theubul ebjedü mined-denesi. Allahume igsilni min hatajaje bith-thelxhi uelmai uel beradi!" I lutej Allahut të Lartmadhëruar ta largojë nga mëkatet që të mos bjerë në to, aq larg sa të mos takohet fare me to, ashtu siç nuk ka kurrë takim mes lindjes dhe perëndimit. E, nëse ndodh që të bjerë në to, ta pastrojë dhe t'ia heqë ato ashtu siç hiqet papastërtia nga rrobja e bardhë, si dhe ta pastrojë nga mëkatet dhe ta freskojë prej zjarrit dhe nxehtësisë së tyre me këta pastrues të freskët: ujë, borë dhe breshër.

Mësime nga hadithi:

1. Lutja e hapjes së namazit duhet të lexohet pa zë, edhe nëse namazi është me zë.
2. Kujdesi i sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) për të mësuar rreth situatave të ndryshme të Profetit ﷺ, qofshin lëvizje apo momente të qetësisë.
3. Janë transmetuar forma të tjera të lutjes së hapjes së namazit, kështu që më mirë është që njeriu t'i thotë të gjitha lutjet hapëse të transmetuara dhe të vërtetuara nga Profeti ﷺ duke thënë herë njëren e herë tjetrën.

(146) - عَنْ ابْنِ عُمَرَ رضي الله عنهما: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَرْفَعُ يَدَيْهِ حَذْوَ مَنْكَبَيْهِ إِذَا افْتَتَحَ الصَّلَاةَ، وَإِذَا كَبَّرَ لِلرُّكُوعِ، وَإِذَا رَفَعَ رَأْسَهُ مِنَ الرُّكُوعِ، رَفَعَهُمَا كَذَلِكَ أَيْضًا، وَقَالَ: «سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ، رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ»، وَكَانَ لَا يَفْعَلُ ذَلِكَ فِي السُّجُودِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(146) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se, kur i Dërguari i Allahut ﷺ e fillonte namazin, i ngrinte duart paralelisht me supet. Pastaj, kur bënte tekbinin për ruku dhe kur ngrihej nga rukuja, sërish i ngrinte duart, sikurse në fillim, dhe thoshte: "Semiallahu limen hamideh, rabbena ue lekel hamd." Ndërkaq, në sexhde, nuk i ngrinte duart. [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ gjatë namazit i ngrinte duart paralelisht me supet në tri pozicione të ndryshme të namazit. Supi është pjesa ku bashkohen kockat e shpatullës me të krahut.

Pozicioni i parë: kur fillonte namazin, në tekbinin fillestar.

Pozicioni i dytë: kur bënte tekbinin për të shkuar në ruku.

Pozicioni i tretë: kur ngrihej nga rukuja dhe thoshte: "Semiallahu limen hamideh, rabbena ue lekel hamd."

Ai nuk i ngrinte duart kur shkonte në sexhde e as kur ngrihej prej saj.

Mësime nga hadithi:

1. Një nga urtësitë e ngritjes së duarve gjatë namazit është zbukurimi i namazit dhe madhërimi i Allahut të Lartësuar.
2. Është vërtetuar se Profeti ﷺ i ngrinte duart në një pozicion të katërt, siç qëndron në transmetimin e Ebu Humejd Saidiut tek Ebu Davudi dhe të tjerë: gjatë ngritjes nga teshehudi i parë në namazet trerekatëshe dhe katërrekatëshe.
3. Gjithashtu është vërtetuar se Profeti ﷺ i ngrinte duart deri te veshët, pa i prekur, siç qëndron në transmetimin e Malik ibn Huvejrithit në dy Sahihët: "Kur i Dërguari i Allahut ﷺ merrte tekbir, i ngrinte duart deri te veshët."
4. Këto dy shprehje: "Semiallahu limen hamideh, rabbena ue lekel hamd," i thotë imami dhe ai që falet vetëm, ndërsa ai që falet pas imamit (xhematliu), thotë vetëm: "Rabbena ue lekel hamd."
5. Për shprehjen: "Rabbena ue lekel hamd", pas rukusë, përcillen katër forma nga Profeti ﷺ, e kjo që kemi cekur është njëra prej tyre. Më e mira është që besimtari t'i thotë këto shprehje; herë njërën, herë tjetrën.

(147) - عَنْ عُبَادَةَ بْنِ الصَّامِتِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا صَلَاةَ لِمَنْ لَمْ يَقْرَأْ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(147) – Nga Ubadeh ibën es-Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Nuk ka namaz ai që nuk këndon Hyrjen e Kuranit (suren el-fatiha)." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se namazi nuk është i saktë pa këndimin e sures el-fatiha, ngaqë ajo është një ndër shtyllat e namazit në çdo rekat të tijin.

Mësime nga hadithi:

1. Nuk vlen këndimi i një surje tjetër në vend të fatihasë, kur personi është i aftë që ta këndojë fatihanë.
2. Rekati në të cilin nuk është kënduar fatihaja nuk vlen, si për atë që e lë atë qëllimisht, ashtu dhe për atë që është i paditur dhe për atë që e lë nga harresa. Kjo, sepse fatihaja është një nga shtyllat e namazit dhe shtyllat e namazit nuk shfuqizohen në asnjë rast.
3. Këndimi i fatihasë nuk është i detyrueshëm për xhematliun kur e kap imamin në ruku.

(5378)

(148) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّهُ كَانَ يُكَبِّرُ فِي كُلِّ صَلَاةٍ مِنَ الْمَكْتُوبَةِ وَغَيْرِهَا، فِي رَمَضَانَ وَغَيْرِهِ، فَيُكَبِّرُ حِينَ يَقُومُ، ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَرْكَعُ، ثُمَّ يَقُولُ: سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ، ثُمَّ يَقُولُ: رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ، قَبْلَ أَنْ يَسْجُدَ، ثُمَّ يَقُولُ: اللَّهُ أَكْبَرُ حِينَ يَهْوِي سَاجِدًا، ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَرْفَعُ رَأْسَهُ مِنَ السُّجُودِ، ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَسْجُدُ، ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَرْفَعُ رَأْسَهُ مِنَ السُّجُودِ، ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَقُومُ مِنَ الْجُلُوسِ فِي الْإِثْنَتَيْنِ، وَيَفْعَلُ ذَلِكَ فِي كُلِّ رُكْعَةٍ، حَتَّى يَفْرُغَ مِنَ الصَّلَاةِ، ثُمَّ يَقُولُ حِينَ يَنْصَرِفُ: وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ، إِنِّي لَأَقْرُبُكُمْ شَبَهًا بِصَلَاةِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، إِنْ كَانَتْ هَذِهِ لَصَلَاتُهُ حَتَّى فَارَقَ الدُّنْيَا. [صحيح] - [متفق عليه]

(148) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte "Allahu Ekber" (tekbir) në çdo namaz farz e vullnetar, në Ramazan e jashtë tij. Bënte tekbirin kur ngrihej për t'u falur dhe kur binte në ruku. Pastaj (duke u ngritur nga rukuja dhe) para se të binte në sexhde, thoshte: "Semiallahu limen hamideh", dhe: "Rabbena ve lekel-hamd." Duke rënë në sexhde, thoshte: "Allahu ekber". Kur e ngrinte kokën, bënte tekbirin, kur binte sërish, bënte tekbirin dhe, kur ngrihej prej sexhdes, sërish bënte tekbirin. Bënte tekbirin sa herë që ngrihej prej uljes pas dy rekatesh. Kështu vepronte në çdo rekat, derisa e përfundonte namazin. Pasi e përfundonte, thoshte: "Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se nga të gjithë ju namazi im më së shumti i ngjason namazit të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Kështu falej derisa u nda nga kjo botë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në këtë hadith transmeton një pjesë të përshkrimit të namazit të Profetit ﷺ dhe tregon se, kur ngrihej për t'u falur, merrte tekbir, kur qëndronte në këmbë gjatë tekbirit fillestar, e pastaj merrte tekbir kur shkonte në ruku, kur bënte sexhde, kur e ngrinte kokën nga sexhdja dhe kur bënte sexhden e dytë; kur e ngrinte kokën prej saj dhe kur ngrihej në këmbë pas dy rekateve të para pasi ishte ulur për teshehudin e parë në namazin trerekatësh ose katërrakatësh, e kështu vepronte gjatë tërë namazit, derisa e përfundonte. Kur e ngrinte shpinën nga rukuja, thoshte: "Semiallahu limen hamideh", dhe duke qëndruar në këmbë, thoshte: "Rabena ve lekel hamd."

Pastaj Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), pasi e përfundonte namazin, thoshte: "Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, se nga të gjithë ju, namazi im më së shumti i ngjason namazit të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Kështu falej derisa u nda nga kjo botë."

Mësim nga hadithi:

1. Tekbiri bëhet gjatë çdo uljeje dhe ngritjeje, përveç kur namazliu ngrihet nga rukuja, e në atë rast thotë: "Semiallahu limen hamideh."
2. Kujdesi i sahabëve për ta ndjekur shëmbëlltyrën e Profetit ﷺ dhe për ta ruajtuar Sunetin e tij.

(149) - عن ابنِ عَبَّاسٍ رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «أُمِرْتُ أَنْ أَسْجُدَ عَلَى سَبْعَةِ أَعْظُمٍ: عَلَى الْجَبْهَةِ وَأَشَارَ بِيَدِهِ عَلَى أَنْفِهِ، وَالْيَدَيْنِ، وَالرُّكْبَتَيْنِ، وَأَطْرَافِ الْقَدَمَيْنِ، وَلَا نَكُفُّ الثِّيَابَ وَالشَّعَرَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(149) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Jam urdhëruar të bëj sexhden me shtatë gjymtyrë: me ballë - dhe bëri me shenjë në hundën e tij, - me duar, me gjunjë dhe me majat e gishtërinjve të këmbëve, si dhe të mos i mbledhim flokët (nëse bien përpara gjatë sexhdes) e të mos i përvjelim rrobat." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se Allahu e urdhëroi që, kur të falet, të bëjë sexhde me shtatë pjesë të trupit, të cilat janë:

E para: balli, që është pjesa e fytyrës mbi hundë dhe sy. dhe Profeti ﷺ bëri me dorë në hundën e tij, duke sqaruar se balli dhe hunda konsiderohen një gjymtyrë nga të shtatat, si dhe duke theksuar se namazliu në sexhde e prek tokën me hundë.

E dyta dhe e treta: dy duart.

E katërta dhe e pesta: dy gjunjët.

E gjashta dhe e shtata: majat e gishtërinjve të këmbëve.

Gjithashtu na urdhëroi që të mos i lidhim flokët dhe të mos i mbledhim rrobat kur bëjmë sexhde në tokë për t'i

ruajtur ato, por, përkundrazi, t'i lëshojmë, derisa të bien në tokë dhe të bien në sexhde së bashku me gjymtyrët.

Mësim nga hadithi:

1. Është obligim që sexhdeja të bëhet me shtatë gjymtyrët.
2. Është e urryer që rrobat dhe flokët të mbliidhen gjatë namazit.
3. Namazliu e ka obligim të jetë i qetë gjatë namazit, t'i vendosë shtatë gjymtyrët e sexhdes në tokë dhe të qëndrojë në këtë pozitë derisa ta kryejë dhikrin që ligjësohet të thuhet.
4. Ndalimi i mbledhjes së flokëve është i veçantë për burrat, jo për gratë, sepse gratë gjatë namazit urdhërohen të mbulohen.

(10925)

(150) - عَنْ أَبِي أُمَامَةَ قَالَ: حَدَّثَنِي عَمْرُو بْنُ عَبْسَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «أَقْرَبُ مَا يَكُونُ الرَّبُّ مِنَ الْعَبْدِ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ الْآخِرِ، فَإِنْ اسْتَطَعْتَ أَنْ تَكُونَ مِمَّنْ يَذْكُرُ اللَّهَ فِي تِلْكَ السَّاعَةِ فَكُنْ». [صحيح]

- [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

(150) – Ebu Umame tregon se Amër ibën Abese (Allahu goftë i kënaqur me të!) i tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: "Zoti është më afër robit në mes të natës, kështu që,

nëse mund të jesh ndër ata që e përmendin Allahun në atë orë, bëje." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Zoti i Lartësuar është më afër robit në të tretën e fundit të natës. Andaj, nëse të jepet sukses dhe ke mundësi, o besimtar, që të jesh në mesin e atyre që e adhurojnë, falen, përmendin Allahun dhe pendohen në këtë kohë, atëherë kjo është diçka që duhet ta shfytëzosh dhe të derdhësh mund për të.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi i muslimanit që ta përmendë Allahun në fund të natës.
2. Kohët dallojnë nga njëra-tjera sa i përket përmendjes së Allahut, lutjes dhe namazit.
3. Mejraku thotë: "Dallimi mes hadithit: "Zoti është më afër robit" dhe hadithit: "Robi është më afër me Zotin e tij teksa është në sexhde", është: "Sa i përket të parit, qëllimi është që të sqarohet koha kur Zoti është më afër robit, e që është mesi i natës, ndërsa i dyti i sqaron gjendjet e afërsisë së robit me Zotin, që është kur ai bën sexhden.

(3236)

(151) - عن جَرِيرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كُنَّا عِنْدَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَنَظَرُ إِلَى الْقَمَرِ لَيْلَةً -يَعْنِي الْبَدْرَ- فَقَالَ: «إِنَّكُمْ سَتَرُونَ رَبَّكُمْ كَمَا تَرَوْنَ هَذَا الْقَمَرَ، لَا تُصَامُونَ فِي رُؤْيَيْهِ، فَإِنْ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ لَا تُغْلَبُوا عَلَى صَلَاةٍ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلِ غُرُوبِهَا فَافْعَلُوا» ثُمَّ قَرَأَ: «وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ الْغُرُوبِ» [صحيح] - [متفق عليه]

(151) – Xherir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Një natë, duke ndenjmur me Profetin ﷺ, e pa Hënën të plotë dhe tha: “Do ta shihni Zotin tuaj, ashtu siç po e shihni Hënën: pa asnjë vështirësi. Po patët mundësi që të mos ju pengojë asgjë nga falja e namazit të sabahut dhe të ikindisë, bëjeni.” Pastaj lexoi: “... madhëroje Zotin tënd dhe falënderoje Atë para lindjes së Diellit dhe para perëndimit.” (Kaf, 39) [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Sahabët ishin me Profetin ﷺ një natë, i cili shikoi drejt Hënës së plotë (katërmbëdhjetëshe) dhe tha: Besimtarët do ta shohin Zotin e tyre me sy, realisht, pa asnjë dyshim; nuk do të shtyhen me njëri-tjetrin dhe nuk do të përjetojnë lodhje e vështirësi kur ta shohin Atë, të Lartësuarin. Pastaj i Dërguari i Allahut ﷺ tha: Nëse jeni në gjendje t'i ndërprisni shkaqet që ju largojnë nga namazi i sabahut dhe namazi i ikindisë, atëherë veproni kështu dhe kryeni ato plotësisht në kohën e duhur me xhemat, sepse kjo është një nga shkaqet (që mundësojnë) të parët e Allahut të Lartmadhëruar. Pastaj Profeti ﷺ lexoi ajetin: “... madhëroje Zotin tënd dhe

falënderoje Atë para lindjes së Diellit dhe para perëndimit.”
(Kaf, 39)

Mësim nga hadithi:

1. Sihariq për besimtarët se do ta shohin Allahun e Lartësuar në Xhenet.
2. Ndër metodat e dvetit (thirrjes) janë: theksimi, inkurajimi dhe dhënia e shembujve.

(5657)

(152) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَرَأَ فِي رُكْعَتَيِ الْفَجْرِ: {قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ}، {وَقُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ}. [صحيح] - [رواه مسلم]

(152) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ i lexoi në dy rekatet sunet të sabahut suret: Kafirun dhe Ihlas.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e preferonte ta lexonte suren Kafirun në rekatën e parë të namazit të rregullt ditor të sunetit të sabahut, pas leximit të sures Fatiha, dhe suren Ihlas në rekatën e dytë.

Mësim nga hadithi:

1. Pëlqehet të lexohen këto dy sure pas sures Fatiha në sunetin e sabahut.

2. Secila prej këtyre dy sureve quhet “Sureja Ihlas”, ngase surja Kafirun përmban një shpallje të qartë të shkëputjes dhe distancimit nga çdo gjë që adhuronin idhujtarët përveç Allahut, përveçse tregon se ata gjithashtu nuk janë adhurues të Allahut, sepse shirku (idhujtaria) i tyre i bën të pavlefshme veprat e tyre, dhe se vetëm Allahu i Lartësuar është i denjë për adhurim. Ndërsa, surja Ihlas shpall teuhidin (monoteizmin) e Allahut, thekson sinqeritetin ndaj Tij dhe sqaron cilësitë e Tij.

(11256)

(153) - عَنْ أَبِي مُوسَى الْأَشْعَرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ

وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ صَلَّى الْبَرْدَيْنِ دَخَلَ الْجَنَّةَ» [صحيح] - [متفق عليه]

(153) – Ebu Musa Esh'ariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që i fal dy namazet e freskëta (sabahun dhe ikindinë), do të hyjë në Xhenet.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na ka inkurajuar të jemi të kujdesshëm në faljen e dy namazeve që falen në kohë të freskët, që janë: namazi i sabahut dhe i ikindisë, si dhe ka përgëzuar se, kushdo që i fal ato, duke i përmbushur rregullat e tyre, si: koha e saktë, falja me xhemat dhe rregulla

të tjera, atëherë këto dy namaze do të jenë shkak që ai njeri të hyjë në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e kujdesit ndaj namazit të sabahut dhe të ikindisë, sepse sabahu është atëherë kur gjumi është i këndshëm, kurse ikindia është kur njeriu është i zënë me punë, kështu që, kushdo që kujdeset për këto dy namaze, e ka më të lehtë që të kujdeset dhe për namazet e tjera.
2. Namazi i sabahut dhe i ikindisë u quajten "dy namazet e freskëta", sepse në namazin e sabahut gjendet freskia e natës, kurse në namazin e ikindisë gjendet freskia e ditës, edhe nëse ndodh që ky i fundit të jetë në kohë të nxehtë, mirëpo ajo kohë është më pak e nxehtë se koha para saj, ose këtu janë quajtur të dyja kohët të freskëta për shkak të bashkimit të tyre në një fjalë të vetme, siç thuhet kur bashkohet dielli dhe hëna në një fjalë të vetme: "Dy hënat".

(4198)

(154) - عن جُنْدُب بن عبد الله الْقَسْرِي رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ صَلَّى صَلَاةَ الصُّبْحِ فَهُوَ فِي ذِمَّةِ اللَّهِ، فَلَا يَطْلُبَنَّكُمُ اللَّهُ مِنْ ذِمَّتِهِ بِشَيْءٍ، فَإِنَّهُ مَنْ يَطْلُبُهُ مِنْ ذِمَّتِهِ بِشَيْءٍ يُدْرِكُهُ، ثُمَّ يَكُوبُهُ عَلَى وَجْهِهِ فِي نَارٍ جَهَنَّمَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(154) – Xhundub ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që e fal namazin e sabahut është në besë të Allahut, andaj të mos ju kërkojë Allahu diçka prej besës së Tij (që nuk e mbani), sepse atij që Allahu i kërkon diçka prej besës së Tij (që nuk e mbajti), do ta hedhë me fytyrë në zjarrin e Xhehenemit.”
[Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që e fal sabahun është në mbrojtjen, ruajtjen dhe kujdesin e Allahut. Ai e mbron dhe e bën të ngadhënjejë.

Pastaj Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër prishjes dhe zhvlerësimit të kësaj bese, qoftë duke braktisur namazin e sabahut, qoftë duke sulmuar namazfalësit. Kushdo që e bën këtë, e ka shkelur këtë mbrojtje dhe meriton kërcënim të rëndë, se Allahu do t'i kërkojë atij atë që ka lënë pas dore, e, kujtdo që Allahu ia kërkon këtë gjë, do ta dënojë atë, e pastaj do ta hedhë me fytyrë në Zjarr.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i rëndësisë dhe vlerës së namazit të sabahut.
2. Paralajmërimi i ashpër kundër atij që i bën keq atij që e ka falur sabahun.
3. Allahu i Lartësuar merr hak ndaj atyre që sulmojnë robërit e Tij të devotshëm.

(5435)

(155) - عن بريدة بن الحصيب رضي الله عنه أنه قال: بَكَّرُوا بِصَلَاةِ الْعَصْرِ، فَإِنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ تَرَكَ صَلَاةَ الْعَصْرِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ».
[صحيح] - [رواه البخاري]

(155) – Nga Burajde ibën Husajbi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmetohet se ka thënë: "Faleni namazin e ikindisë sa më parë, sepse Profeti ﷺ ka thënë: "Atij që e lë namazin e ikindisë, i shkatërrohet puna." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër vonimit të namazit të ikindisë qëllimisht përtej kohës së caktuar dhe se kushdo që e bën këtë, puna e tij do të jetë e pavlefshme, e shkatërruar dhe e kotë.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për faljen e namazit të ikindisë në fillim të kohës së tij dhe nxitimi për ta bërë këtë.
2. Kërcënimi i rëndë për atë që e lë namazin e ikindisë. Mosfalja e ikindisë në kohën e saj të caktuar është më e rëndë sesa e namazeve të tjera, sepse ai është namazi i mesëm, që ka urdhëruar Allahu në mënyrë të veçantë në fjalën e Tij: "Kushtojuni kujdes namazeve, veçanërisht namazit të mesëm..." (El Bekare, 238)

(6261)

(156) – عن أنس بن مالك رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ نَسِيَ صَلَاةً فَلْيُصَلِّ إِذَا ذَكَرَهَا، لَا كَفَّارَةَ لَهَا إِلَّا ذَلِكَ: {وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي} [طه: 14]». [صحيح] - [متفق عليه]

(156) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Nëse dikush harron ndonjë namaz, le ta falë kur t'i kujtohet. Nuk ka shpagim tjetër, përveçse ta falë atë: “... dhe fale namazin për të më kujtuar Mua.” (Taha, 14) [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se kushdo që harron të falë ndonjë namaz farz derisa të kalojë koha e tij, duhet të shpejtojë për ta kryer sapo t'i kujtohet. Nuk ka fshirje dhe

mbulim të mëkatit të lënies së tij, përveç nëse muslimani e fal atë kur e kujton. Allahu në Librin e Tij fisnik thotë: "... dhe fale namazin për të më kujtuar Mua", (Taha, 14) që do të thotë: Fale namazin e harruar kur të kujtohet.

Mësim nga hadithi:

1. Sqarimi i rëndësisë së namazit dhe të mosqenët i shkujdesur në kryerjen dhe kompensimin e tij.
2. Nuk lejohet vonimi i namazit me qëllim përtej kohës së caktuar, pa arsye.
3. Është obligim kompensimi i namazit për atë që e ka harruar atëherë kur t'i kujtohet dhe për atë që ka qenë fjetur, kur të zgjohet.
4. Namazet duhet të kompensohen menjëherë, edhe në kohë të ndaluara.

(65088)

(157) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ أَثْقَلَ صَلَاةٍ عَلَى الْمُنَافِقِينَ صَلَاةُ الْعِشَاءِ وَصَلَاةُ الْفَجْرِ، وَلَوْ يَعْلَمُونَ مَا فِيهِمَا لَأَتَوْهُمَا وَلَوْ حَبَوًّا، وَلَقَدْ هَمَمْتُ أَنْ أُمَرَ بِالصَّلَاةِ فَتَقَامَ، ثُمَّ أُمِرَ رَجُلًا فَيُصَلِّيَ بِالنَّاسِ، ثُمَّ أُنْطِلَقَ مَعِيَ بِرِجَالٍ مَعَهُمْ حُزْمٌ مِنْ حَطَبٍ إِلَى قَوْمٍ لَا يَشْهَدُونَ الصَّلَاةَ، فَأُحَرِّقَ عَلَيْهِمْ يُبَوِّتُهُمْ بِالنَّارِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(157) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Namazi më

i rëndë për hipokritët është namazi i jacisë dhe i sabahut. Sikur ta dinin se çfarë (shpërblimi) ka në to, do të vinin, qoftë dhe zvarrë. Më ka shkuar mendja të urdhëroj (myezinin) ta thërrasë ikametin për namaz, pastaj të lë dikë që t'ua falë njerëzve namazin e unë të shkoj me disa burra, që me vete të marrin turra drush e t'ua mësyjmë atyre që nuk vijnë për namaz e t'ua fus zjarrin shtëpive të tyre." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ lajmëron në këtë hadith për hipokritët dhe përtacinë e tyre në raport me pjesëmarrjen në namaz, veçanërisht në namazin e jacisë dhe sabahut. E, sikur ta dinin vlerën e shpërblimit për pjesëmarrjen e tyre me xhematin e muslimanëve, do të vinin, qoftë dhe zvarrë, ashtu siç zvarritet fëmija me duar dhe gjunjë.

Profeti ﷺ deshi të urdhërojë që të falet namazi dhe të caktojë një njeri që t'u prijë njerëzve në vend të tij, pastaj të shkojë me disa burra, që do të marrin me vete turra drush, për te njerëzit që nuk marrin pjesë në namazin me xhemat dhe t'ua djegë me zjarr shtëpitë e tyre. Kjo, për shkak të mëkatit të rëndë që bënë, - por ai nuk e bëri këtë gjë, - për shkak të grave dhe fëmijëve të pafajshëm e të tjerëve që janë të arsyetuar (për mospjesëmarrje në xhami) dhe nuk kanë kurrfarë mëkati.

Mësime nga hadithi:

1. Rreziku i mospjesëmarrjes në namazit me xhemat në xhami.
2. Hipokritët me adhurimin e tyre synonin syfaqësinë dhe famën, sepse ata merrnin pjesë në namaz kur i shihnin njerëzit.
3. Shpërblimi i madh për faljen e namazit të jacisë dhe të sabahut me xhemat, madje ato meritojnë të shkojmë t'i falim, qoftë dhe zvarrë.
4. Kujdesi për namazin e akshamit dhe të sabahut është siguri nga hipokrizia, ndërsa neglizhimi i tyre është një nga cilësitë e hipokritëve.

(3366)

(158) - عَنِ ابْنِ أَبِي أَوْفَى رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا رَفَعَ ظَهْرَهُ مِنَ الرُّكُوعِ قَالَ: «سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ، اللَّهُمَّ رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ، مِلْءَ السَّمَاوَاتِ وَمِلْءَ الْأَرْضِ وَمِلْءَ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(158) – Ibën Ebu Eufai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Kur i Dërguari i Allahut ﷺ ngrihej nga rukuja, thoshte: “Semiallahu limen hamideh, Allahumme rabbena, lekel-hamd, mil’es-semavati ve mil’el-erdi, ve mi’e ma shite min shejin badu (Allahu e pranon lavdinë e atij që i bën lavdi! O Allah, Zoti ynë, ty të takon lavdia, aq sa mbushen

qiejt, Toka dhe çdo gjë tjetër që Ti do).” [Ky hadith është sahih]

- [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ e ngrinte shpinën nga rukuja në namaz, thoshte: “Semiallahu limen hamideh”, që do të thotë: kush e lavdëron Allahun e Lartësuar, Ai i përgjigjet dhe ia pranon lavdërimin dhe e shpërblen. Pastaj e lavdëron Allahun duke thënë: “Allahumme rabbena, lekel-hamd, mil’es-semavati ve mil’el-erdi, ve mi’e ma shite min shejin badu.” Lavdërim, aq sa mbushen qiejt, Toka e çfarë ka mes tyre dhe çdo gjë tjetër që do Allahu.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi se çfarë është e rekomanduar të thotë namazliu kur ta ngrëjë kokën nga rukuja.
2. Obligueshmëria që të qëndrojmë drejt dhe të jemi të qetë pas ngritjes nga rukja, sepse nuk mund ta themi këtë dhikër nëse nuk jemi të drejtuar dhe të qetë.
3. Ky dhikër është i ligjshëm të thuhet në të gjitha namazet, qofshin obligative, qofshin vullnetare.

(65101)

(159) - عَنْ حُذَيْفَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَقُولُ
بَيْنَ السَّجْدَتَيْنِ: «رَبِّ اغْفِرْ لِي، رَبِّ اغْفِرْ لِي». [صحيح] - [رواه أبو داود والنسائي
وابن ماجه وأحمد]

(159) – Hudhejfja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se
Profeti ﷺ ndërmjet dy sexhdeve thoshte: "Rabbigfirlij,
rabbigfirlij!" [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والنسائي وابن ماجه
وأحمد]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ ulej ndërmjet dy sexhdeve, thoshte:
"Rabbigfirlij, rabbigfirlij!", dhe e përsëriste.

Kuptimi i frazës: "Rabigfirlij" është: kërkesa e robit
drejtuar Zotit të tij, që t'ia fshijë gjynahet dhe t'ia mbulojë të
metat.

Mësime nga hadithi:

1. Kjo lutje është e ligjshme të thuhet ndërmjet dy
sexhdeve në namazin farz (obligativ) dhe në atë
nafile (vullnetar).
2. Është e rekomanduar të përsëritet fraza:
"Rabbigfirlij", ndërsa obligim është të thuhet vetëm
një herë.

(65104)

(160) – عن ابن عباس رضي الله عنهما: كان النبي صلى الله عليه وسلم يقول بين السجدين: «اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وارْحَمْنِي، وعافني، واهْدِنِي، وارزُقني». [حسن بشواهد] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(160) – Abdullah ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se Profeti ﷺ midis dy sexhdeve thoshte: "O Allah, më fal, më mëshiro, më jep shëndet, më udhëzo dhe më furnizo!" [حسن بشواهد] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në namazin e tij i bënte këto pesë lutje ndërmjet dy sexhdeve, për të cilat muslimani ka shumë nevojë. Këto lutje ngërthejnë në vete të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, bie fjala, kërkimi i faljes, mbulimi i mëkateve dhe tejkalimi i tyre, kërkimi i mëshirës, shpëtimi nga dyshimet, epshet e sëmundjet; lutja drejtuar Allahut për udhëzim drejt së vërtetës dhe qëndrueshmërisë në të; lutja për të të dhënë besim, dituri, vepra të mira dhe për të të dhënë pasuri hallall e të mirë.

Mësime nga hadithi:

1. Ligjësimi i kësaj lutjeje në uljen që bëhet ndërmjet dy sexhdeve.
2. Vlera e kësaj lutjeje, sepse ngërthen në vete të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

(10930)

(161) - عَنْ حِطَّانَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الرَّقَاشِيِّ قَالَ: صَلَّيْتُ مَعَ أَبِي مُوسَى الْأَشْعَرِيِّ صَلَاةً، فَلَمَّا كَانَ عِنْدَ الْقُعْدَةِ قَالَ رَجُلٌ مِنَ الْقَوْمِ: أُقِرَّتِ الصَّلَاةُ بِالْبَرِّ وَالزَّكَاةِ، قَالَ: فَلَمَّا قَضَى أَبُو مُوسَى الصَّلَاةَ وَسَلَّمْ أَنْصَرَفَ فَقَالَ: أَيُّكُمْ الْقَائِلُ كَلِمَةً كَذَا وَكَذَا؟ قَالَ: فَأَرَمَ الْقَوْمُ، ثُمَّ قَالَ: أَيُّكُمْ الْقَائِلُ كَلِمَةً كَذَا وَكَذَا؟ فَأَرَمَ الْقَوْمُ، فَقَالَ: لَعَلَّكَ يَا حِطَّانُ قُلْتَهَا؟ قَالَ: مَا قُلْتُهَا، وَلَقَدْ رَهَبْتُ أَنْ تَبْكَعَنِي بِهَا، فَقَالَ رَجُلٌ مِنَ الْقَوْمِ: أَنَا قُلْتُهَا، وَلَمْ أُرِدْ بِهَا إِلَّا الْخَيْرَ، فَقَالَ أَبُو مُوسَى: أَمَا تَعْلَمُونَ كَيْفَ تَقُولُونَ فِي صَلَاتِكُمْ؟ إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ خَطَبَنَا فَبَيَّنَ لَنَا سُنَّتَنَا وَعَلَّمَنَا صَلَاتَنَا، فَقَالَ: «إِذَا صَلَّيْتُمْ فَأَقِيمُوا صُفُوفَكُمْ، ثُمَّ لِيَوْمُكُمْ أَحَدُكُمْ فَإِذَا كَبَّرَ فَكَبِّرُوا، وَإِذَا قَالَ: {غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ} [الفاتحة: 7]، فَقُولُوا: آمِينَ، يُجِبْكُمْ اللَّهُ، فَإِذَا كَبَّرَ وَرَكَعَ فَكَبِّرُوا وَارْكَعُوا، فَإِنَّ الْإِمَامَ يَرْكَعُ قَبْلَكُمْ، وَيَرْفَعُ قَبْلَكُمْ»، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «فَتِلْكَ بَيْتُكَ، وَإِذَا قَالَ: سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ، فَقُولُوا: اللَّهُمَّ رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ، يَسْمَعُ اللَّهُ لَكُمْ، فَإِنَّ اللَّهَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى قَالَ عَلَى لِسَانِ نَبِيِّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ، وَإِذَا كَبَّرَ وَسَجَدَ فَكَبِّرُوا وَاسْجُدُوا، فَإِنَّ الْإِمَامَ يَسْجُدُ قَبْلَكُمْ وَيَرْفَعُ قَبْلَكُمْ»، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «فَتِلْكَ بَيْتُكَ، وَإِذَا كَانَ عِنْدَ الْقُعْدَةِ فَلْيَكُنْ مِنْ أَوَّلِ قَوْلِ أَحَدِكُمْ: التَّحِيَّاتُ الطَّيِّبَاتُ الصَّلَوَاتُ لِلَّهِ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(161) - Hitan ibën Abdullah Rrekashiu tregon: "Njëherë u fala me Ebu Musa Eshariun dhe në uljen e fundit, një burrë nga të pranishmit tha: "Namazi sjell mirësinë dhe pastërtinë." Kur Ebu Musai kreu namazin dhe dha selam, u

kthye dhe tha: "Kush tha kështu e kështu?" Të pranishmit heshtën. Ai sërish përsëriti: "Kush nga ju tha kështu e kështu?" Të pranishmit vazhduan të heshtin. Ebu Musai tha: "Ndoshta fole ti, o Hitan?"

- Nuk fola unë, - tha Hitani, - kësaj i frikohesha, se do të më fajësoje mua.

Në atë rast, një burrë nga të pranishmit tha: "Unë i thashë ato fjalë, por mendova se po bëja mirë." Atëherë Ebu Musai tha: "A nuk dini, vallë, çfarë duhet të thoni në namazin tuaj?! I Dërguari i Allahut ﷺ na ligjëroi dhe na qartësoi Sunetin dhe na mësoi namazin. Ai na pati thënë: “Kur të faleni, drejtojini safat dhe le t’ju prijë dikush nga ju. Kur të marrë tekbir, merrni edhe ju. Kur të thotë: "Gajril-magdubi alejhim ve ledal-lin", (El Fatiha, 7) thoni: "Amin!", sepse Allahu ju përgjigjet. Kur të marrë tekbir dhe të bjerë në ruku, merrni edhe ju tekbir dhe bini në ruku. Imami bie dhe ngrihet para jush nga rukuja.” I Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Kjo (kompensohet) me të. Kur të thotë: "Semiallahu limen hamideh", thoni: "Allahumme, rabbena lekel-hamd", Allahu ju dëgjon. Allahu i Lartësuar, nëpërmjet gjuhës së të Dërguarit të Tij ﷺ, ka thënë: "Allahu i përgjigjet atij që e falënderoi (semiallahu limen hamideh)." Kur të marrë tekbir dhe të bjerë në sexhde, merrni edhe ju tekbir dhe bini në sexhde. Imami bie dhe ngrihet para jush nga sexhdja.” I Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Kjo (kompensohet) me të. Kur të qëndrojnë në ulje, gjëja e parë që thoni, le të jetë: "Et-tehijatu et-tajibatu es-salavatu lil-lahi, es-selamu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu, es-selamu alejna ve ala ibadil-lahis-salihin, eshhedu en la ilahe il-lallah, ve

eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluh. (Përshëndetjet, selamet dhe mirësitë i takojnë Allahut. Paqja, mëshira dhe bekimi qofshin mbi ty, o Pejgamber! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë! Dëshmoj se s'ka të adhurar të denjë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Sahabiu, Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), fali një namaz e, kur ishte në pozicionin ulur, në teshehud, një nga namazlinjtë tha: "Namazi është përmendur në Kuran së bashku me mirësinë dhe zekatin." Kur Ebu Musai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e mbaroi namazin, u kthye nga xhemati dhe i pyeti: "Kush prej jush e tha fjalinë: "Namazi është përmendur në Kuran së bashku me mirësinë dhe zekatin?" Xhemati heshtën dhe asnjëri prej tyre nuk foli, prandaj ai ua përsëriti pyetjen dhe, kur askush nuk iu përgjigj, kështoj Ebu Musai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha: "Ndoshta ti, Hitan, e ke thënë!" Për shkak të guximit të tij, afërsisë dhe lidhjes së tij me të, gjë që akuza nuk do ta dëmtonte dhe do ta shtynte vepruesin e vërtetë ta miratojë veprimin e bërë. Hitani e mohoi këtë dhe tha: "Kisha frikë se do të më qortoje, duke menduar se unë kisha thënë." Kështu, njëri nga të pranishmit tha: "Unë i thashë ato fjalë, por mendova se po bëja mirë."

Në atë rast, një burrë nga të pranishmit tha: Atëherë Ebu Musai, duke dashur ta mësojë atë, tha: "A nuk dini, vallë, çfarë duhet të thoni në namazin tuaj?!", duke kundërshtuar.

Pastaj, tregoi se i Dërguari i Allahut ﷺ ua kishte shpjeguar Sunetin dhe namazin, duke thënë:

Kur të faleni, drejtoni safat (rreshtat) tuaj dhe qëndroni drejt në ta dhe njëri prej tyre t'u prijë njerëzve në namaz. Kur imami të marrë tekbirin fillestar, merrni edhe ju njëjtë. Kur ai e lexon Fatihanë dhe thotë: "Gajril-magdubi alejhim ve led-dalin", (El Fatiha, 7) thoni: "Amin!" Nëse e bëni këtë, Allahu do t'i përgjigjet lutjes suaj! Kur të marrë tekbir dhe të bjerë në ruku, merrni edhe ju tekbir dhe bini në ruku. Imami bën ruku para jush dhe ngrihet nga rukuja para jush, andaj mos i paraprini, ngase çasti në të cilin imami ju paraprin në ruku ju plotësohet duke ju lënë në ruku pas çastit që ai ngrihet nga rukuja. Ky çast (paraprirja e tij në ruku) plotësohet me atë çast (lënien tuaj në ruku pas ngritjes së tij), kështu që koha e qëndrimit tuaj në ruku bëhet sa qëndrimi i tij në ruku. E, nëse imami thotë: "Semiallahu limen hamideh", thoni: "Allahumme rabbena lekel hamd." Nëse namazlinjtë thonë kështu, atëherë Allahu i Lartësuar ua dëgjon lutjet dhe fjalët e tyre. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë në gjuhën e Profetit të Tij ﷺ: "Semiallahu limen hamideh." Pastaj, kur imami merr tekbir dhe bie në sexhde, atëherë namazlinjtë duhet të marrin tekbir dhe të bëjnë sexhde, sepse imami bie në sexhde para tyre dhe ngrihet para tyre, kështu që ky moment është për atë tjetrin. Kësisoj koha e qëndrimit në sexhde të xhematit është aq sa koha e sexhdes së imamit. Kur ulet për teshehud, gjëja e parë që namazliu e thotë duhet të jetë: "Et tehijatu et tajibatu es salavatu lil-lah", pra, sundimi, përhershmeria dhe madhështia i takojnë që të gjitha Allahut të Lartësuar dhe po kështu edhe pesë namazet

ditore janë për Allahun. "Es-selamu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berakatuhu, es-selamu alejna ve ala ibadilahis-salihin." Pra, lutju Allahut për shpëtim nga çdo e metë, mundim, mangësi dhe telashe. Me përshëndetjet tona veçojmë Profetin tonë, Muhamedin ﷺ, pastaj përshëndesim veten tonë, pastaj përshëndesim robërit e devotshëm të Allahut, që i përmbushin obligimet, qofshin të drejtat e Allahut të Lartësuar, qofshin të drejtat e robërve të Tij. Pastaj dëshmojmë se nuk meriton askush adhurimin me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Mësimet nga hadithi:

1. Sqarimi i një prej formave të teshehudit.
2. Veprimet dhe fjalët gjatë namazit duhet të jenë nga ajo që është vërtetuar nga Profeti ﷺ, andaj nuk i lejohet askujt që në to të shpikë një fjalë ose veprim që nuk është vërtetuar në Sunet.
3. Nuk lejohet që imami të parakalohet ose të vonohemi pas tij. Ajo që është e ligjshme të bëhet është ta ndjekim imamin gjatë veprimeve të tij.
4. Ai përmendi kujdesin që Profeti ﷺ e kishte për ta kumtuar mesazhin dhe për t'ia mësuar umetit të tij dispozitat e fesë.
5. Imami duhet të ndiqet nga xhemati, kështu që nuk i lejohet ta parakalojë në veprat e namazit, as të jetë i njëjtë me të, as të mbetet prapa tij, por duhet të

fillojë ta ndjekë, pasi të jetë i sigurt se imami ka filluar veprimin që dëshiron të bëjë, kështu që sunet është që ta pasojë imamin në këto veprime.

6. Ligjshmëria që safat (rreshtat) të drejtohen në namaz.

(65097)

(162) - عَنِ ابْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: عَلَّمَنِي رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، وَكَفَّنِي بَيْنَ كَفَّيْهِ، التَّشَهُّدَ، كَمَا يُعَلِّمُنِي السُّورَةَ مِنَ الْقُرْآنِ: «التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ، وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ». وفي لفظ لهما: «إِنَّ اللَّهَ هُوَ السَّلَامُ، فَإِذَا قَعَدَ أَحَدُكُمْ فِي الصَّلَاةِ فَلْيَقُلْ: التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، فَإِذَا قَالَهَا أَصَابَتْ كُلَّ عَبْدٍ لِلَّهِ صَالِحٍ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، ثُمَّ يَتَخَيَّرُ مِنَ الْمَسْأَلَةِ مَا شَاءَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(162) – Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut ﷺ ma mësoi teshehudin ashtu siç më mësonte ndonjë sure Kurani, ndërkohë shuplaka ime ishte mes dy shuplakave të tij: "Et-tehijjatu lil-lahi ues-salavatu uet-tajjibatu. Es-selamu alejke ejjuhen-nebijju ue rahmetullahi ue berakatuhu. Es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin. Eshhedu en la ilahe il-lallah ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu (Përsëndetjet, lutjet dhe

mirësitë i takojnë Allahut. Paqja, mëshira dhe bekimi qofshin mbi ty, o Pejgamber! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë! Dëshmoj se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij)." Në një tekst të Buhariut dhe të Muslimit, qëndron: "Vetë Allahu quhet Es-Selam. Kur dikush të ulet në namaz, le të thotë: "Et-tehijjatu lil-lahi ues-salavatu uet-tajjibatu. Es-selamu alejke ejjuhen-nebijju ue rahmetullahi ue berakatuhu. Es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin." Duke e thënë këtë, përfshini çdo rob të mirë të Allahut, në qiell dhe në Tokë. (Pastaj le të vazhdojë:) "Eshhedu en la ilahe il-lallah ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu" Pastaj le të lavdërojë Allahun me çfarë të dojë."

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ia mësoi Ibën Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) teshehudin që thuhet gjatë namazit, ku e futi dorën e Ibën Mesudit në mes të duarve të tij, që t'ia ngjallte kureshtjen atij për këtë gjë, njëjtë siç i mësonte ndonjë sure nga Kurani, gjë që tregon se Profeti ﷺ i kushtonte rëndësi teshehudit, qoftë shprehimisht, qoftë kuptimisht. Ai tha: "Et-tehijjatu lil-lahi": Këto janë të gjitha fjalët ose veprat që tregojnë madhërim dhe që të gjitha janë meritore për Allahun e Lartmadhëruar. "Salavat": Është për qëllim namazi që e dimë të gjithë, qoftë obligativ, qoftë vullnetar, pra, të jetë për hir të Allahut të Lartësuar. "Tajjibat": Ato janë fjalët, veprat dhe përshtkrimet e mira që tregojnë përsosuri. Krejt këto i meriton Allahu i Lartësuar. "Es-

selamu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berakatuhu": Lutje për Profetin që të jetë i shpëtuar nga çdo mundim e dëm dhe t'i shtohen të mirat me bollëk. "Es-selamu alejna ve ala ibadil-Lahis-salihin": Kjo është lutje për namazliun dhe për çdo rob të mirë, në qiell dhe në Tokë. "Eshhedu en la ilahe il-lallah": Domethënë: e pranoj me vendosmëri se nuk ka Zot të vërtetë që meriton të adhurohet pos Allahut. "ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu": Domethënë: e pranoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguari i fundit.

Pastaj Profeti ﷺ e inkurajoi namazliun të përzgjedhë çfarëdo lutjeje që dëshiron.

Mësim nga hadithi:

1. Vendi i teshehudit është ulja pas sexhdes së fundit në çdo namaz dhe pas rekatit të dytë në namazet trerekatëshe dhe katërrekatëshe.
2. Përshëndetjet (tehiyat) janë të detyrueshme gjatë teshehudit dhe lejohet të thuhet cilitdo lloj i teshehudit që vërtetohet nga Profeti ﷺ.
3. Lejohet që namazliu të bëjë lutje gjatë namazit për çka të dojë, përderisa nuk është mëkatim.
4. Është e rekomanduar gjatë lutjes të fillohet me veten.

(163) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَدْعُو وَيَقُولُ: «اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ النَّارِ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ».

وَفِي لَفْظٍ لِمُسْلِمٍ: «إِذَا قَرَعَ أَحَدُكُمْ مِنَ التَّشَهُّدِ الْآخِرِ، فَلْيَتَعَوَّذْ بِاللَّهِ مِنْ أَرْبَعٍ: مِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(163) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Profeti ﷺ lutej dhe thoshte: “Allahume, inni eudhu bike min adhabil-kabri, ve min adhabin-nari, ve min fitnetil-mahja vel-memat, ve min fitnetil-mesihid-dexhal!” - "(O Allah, kërkoh mbrojtjen Tënde nga dënimi në varr dhe dënimi në Zjarr! Kërkoh mbrojtjen Tënde nga sprova e jetës dhe e vdekjes, si dhe nga sprova e mesihut Dexhall!" Në transmetimin e Muslimit qëndron: “Pasi të përfundoni leximin e teshehudit të fundit, kërkoni mbrojtjen e Allahut nga katër gjëra: 1. Nga dënimi i Xhehenemit. 2. Nga dënimi në varr. 3. Nga sprova e jetës dhe vdekjes, dhe 4. Nga e keqja e sprovës së Dexhallit.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Para se Profeti ﷺ ta përfundonte teshehudin e fundit, i kërkonte mbrojtje Allahut që ta ruante nga katër gjëra dhe na urdhëroi edhe ne të bëjmë një gjë të tillë.

E para: Nga dënimi i varrit.

E dyta: Nga dënimi i Zjarrit, që është në Ditën e Kiametit.

E treta: Nga sprova e kësaj jete, si: epshet e ndaluara të kësaj bote dhe nga dyshimet lajthitëse, si dhe nga sprova e vdekjes, respektivisht çasti para vdekjes, që të mos largohemi nga Islami ose Suneti ose nga sprova e varrit, siç është pyetja e dy melekëve.

E katërta: Sprova e mesihut Dexhall, që do të shfaqet në fund të kohës, para Kiametit, me të cilin Allahu do t'i sprovtojë robërit e Tij. Profeti ﷺ e veçoi me përmendje, për shkak të fitnes (sprovës) dhe devijimit të madh që ua bën të tjerëve.

Mësime nga hadithi:

1. Kjo lutje kërkimstrehimi është një nga lutjet më të rëndësishme dhe më gjithëpërfshirëse, sepse përfshin kërkimstrehimin (tek Allahu) që të na mbrojë nga të këqijat e kësaj bote dhe të botës tjetër.
2. Pohimi dhe vërtetimi i dënimit të varrit dhe se ai është hak (i vërtetë).
3. Rreziku i fitneve (sprovave) dhe rëndësia e kërkimit të ndihmës së Allahut dhe lutjes drejtuar Atij që të na shpëtojë prej tyre.
4. Pohimi se Dexhalli do të dalë dhe se fitneja (sprova) e tij është e madhe.
5. Thënia e kësaj lutjeje është e rekomanduar pas teshehudit të fundit.

6. Pas veprës së mirë është e rekomanduar të bëhet lutje.

(3103)

(164) - عَنْ مَعْدَانَ بْنِ أَبِي طَلْحَةَ الْيَعْمَرِيِّ قَالَ: لَقِيتُ ثَوْبَانَ مَوْلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقُلْتُ: أَخْبِرْنِي بِعَمَلٍ أَعْمَلُهُ يُدْخِلُنِي اللَّهُ بِهِ الْجَنَّةَ؟ أَوْ قَالَ قُلْتُ: بِأَحَبِّ الْأَعْمَالِ إِلَى اللَّهِ، فَسَكَتَ. ثُمَّ سَأَلْتُهُ فَسَكَتَ. ثُمَّ سَأَلْتُهُ الثَّالِثَةَ فَقَالَ: سَأَلْتُ عَنْ ذَلِكَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ: «عَلَيْكَ بِكَثْرَةِ السُّجُودِ لِلَّهِ، فَإِنَّكَ لَا تَسْجُدُ لِلَّهِ سَجْدَةً، إِلَّا رَفَعَكَ اللَّهُ بِهَا دَرَجَةً، وَحَظَّ عَنْكَ بِهَا خَطِيئَةٌ» قَالَ مَعْدَانُ: ثُمَّ لَقِيتُ أَبَا الدَّرْدَاءِ فَسَأَلْتُهُ فَقَالَ لِي: مِثْلَ مَا قَالَ لِي: ثَوْبَانُ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(164) – Ma'dan ibn Ebi Talha Ja'meriu ka thënë: "E kam takuar Theubanin (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili kishte qenë dikur skllav i të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe ai e pati liruar, dhe i thashë: "Më trego një punë që unë ta bëj dhe Allahu të më fusë në Xhenet nëpërmjet saj". Ose tha: "I thashë 'Më trego cila është puna më e dashur për Allahun.' Ai heshti. E pyeta për së dyti, e ai sërish heshti. Kur e pyeta për së treti, më tha: 'E kam pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ për këtë dhe më pati thënë: “Bëj sa më shumë sexhde për Allahun, ngase për çdo sexhde që ia bën Allahut, Ai të ngre një shkallë dhe të fshin një mëkat.” Ma'dani thotë: "Më vonë e pata takuar edhe Ebu Derdain, të cilit ia bëra të njëjtën pyetje dhe ai m'u përgjigj njëjtë sikurse Theubani." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ është pyetur për veprat që janë shkak për hyrjen në Xhenet ose për veprat që janë më të dashura për Allahun.

Ai ﷺ i tha pyetësit: "Bëj sa më shumë sexhde në namaz, se, sa herë që t'i bësh sexhde Allahut, Ai të ngre një shkallë për shkak të saj dhe të fal një mëkat."

Mësim nga hadithi:

1. Inkurajimi i muslimanit që të jetë i zellshëm në faljen e namazeve të detyrueshme dhe vullnetare, sepse namazet përmbajnë në vetvete sexhdet.
2. Ky hadith nxjerr në pah përceptimin dhe dijen e sahabëve se Xheneti nuk mund të arrihet, - pas mëshirës së Allahut, - përveçse me punë.
3. Sexhdja në namaz është nga shkaqet më të mëdha për ngritjen e shkallëve (në Xhenet) dhe faljen e mëkateve.

(3732)

(165) - عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: إِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «لَا صَلَاةَ بِحَضْرَةِ الطَّعَامِ، وَلَا هُوَ يُدَافِعُهُ الْأَخْبَثَانِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(165) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Nuk ka

namaz kur shtrohet ushqimi e as nën presionin e nevojave fiziologjike." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ në këtë hadith e ka ndaluar faljen e namazit kur shtrohet ushqimi, tek i cili shpirti i namazliut anon dhe zemra e tij është e lidhur me të.

Gjithashtu, e ndaloi të falet namazi nën presionin e nevojave fiziologjike: nevojës së vogël dhe të madhe, për shkak se mendja e tij angazhohet për ta larguar këtë presion.

Mësime nga hadithi:

1. Namazliu duhet të largojë çdo gjë që e shpërqendron atë nga namazi i tij, para se ta fillojë atë.

(3088)

(166) - عَنْ عُثْمَانَ بْنِ أَبِي الْعَاصِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّهُ أَتَى النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنَّ الشَّيْطَانَ قَدْ حَالَ بَيْنِي وَبَيْنَ صَلَاتِي وَقِرَاعَتِي يَلْبِسُهَا عَلَيَّ، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «ذَاكَ شَيْطَانٌ يُقَالُ لَهُ خَنْزَبٌ، فَإِذَا أَحْسَسْتَهُ فَتَعَوَّذْ بِاللَّهِ مِنْهُ، وَانْقُلْ عَلَى يَسَارِكَ ثَلَاثًا»، قَالَ: فَفَعَلْتُ ذَلِكَ فَأَذْهَبَهُ اللَّهُ عَنِّي. [صحيح] - [رواه مسلم]

(166) – Othman ibën Ebi el-Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të) shkoi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Shejtani po ndërhyr mes meje e namazit dhe leximit tim nga

Kurani, si dhe po m'i ngatërron." Profeti ﷺ i tha: "Ai është një shejtan që quhet Hinzeb. Kur ta vësh praninë e tij, kërko mbrojtjen e Allahut kundrejt tij dhe pështyj tri herë lehtë nga ana jote e majtë!" Më pas Othmani tha: "Ashtu veprova dhe Allahu ma largoi atë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Othman ibën Ebi el-Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) shkoi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, shejtani ka ndërhyrë mes meje e namazit tim dhe më ka penguar që të jem i përkushtuar, si dhe ma ngatërroi leximin e (Kuranit) dhe më bëri të dyshoja." Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ i tha: "Ky është një shejtan, që quhet Hinzeb, andaj, nëse e vëren praninë e tij, kërko strehim tek Allahu që të të ruajë prej tij, si dhe fryj tri herë në anën tënde të majtë me pak pështymë." Othmani tha: "Veprova siç më urdhëroi Profeti ﷺ dhe Allahu ma largoi atë."

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e përkushtimit dhe përsëritshmërisë gjatë namazit, dhe se shejtani përpiket ta shpërqendrojë (namazliun) dhe të hedhë dyshime mbi të.
2. Rekomandohet të kërkojmë mbrojtje tek Allahu, të na ruajë nga shejtani, kur ai pëshpërit gjatë namazit, si dhe të pështymë në të majtë tri herë.

3. Sqarimi i gjendjes në të cilën ishin sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), sepse ata ktheheshin te Profeti ﷺ në lidhje me problemet që u ndodhnin, në mënyrë ai t'ua zgjidhte.
4. Zemrat e sahabëve kishin gjallëri dhe brenga e tyre ishte ahireti.

(65105)

(167) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَسْوَأُ النَّاسِ سَرَقَةً الَّذِي يَسْرِقُ صَلَاتَهُ» قَالَ: وَكَيْفَ يَسْرِقُ صَلَاتَهُ؟ قَالَ: «لَا يُتِمُّ رُكُوعَهَا، وَلَا سُجُودَهَا». [صحيح] - [رواه ابن حبان]

(167) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Personi më i keq vjedhës është ai që vjedh në namazin e tij.” I tha: “Si mund ta vjedhë namazin?” Profeti ﷺ ia ktheu: “Nuk e plotëson as sexhden e as rukunë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ibn Hibbani]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se njeriu më i shëmtuar që vjedh është ai që vjedh në namazin e tij. Kjo, për shkak se përvetësimi i pasurisë së dikujt tjetër mund t'i bëjë dobi njeriut në këtë botë, ndryshe nga ky hajdut, sepse ai ka vjedhur shpërblimin e hakut të vet. I thanë: "O i Dërguari i Allahut, si mund të vjedhë në namazin e tij?" Profeti ﷺ tha: "Nuk e plotëson as rukunë e as sexhden." Kjo, sepse nxiton

gjatë rukusë dhe sexhdes, e nuk i kryen ato në mënyrë të përsosur.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e faljes së namazit në mënyrë të përkryer, duke i çuar në vend shtyllat e tij me qetësi dhe përkushtim.
2. Përshkrimi i atij që nuk e plotëson rukunë dhe sexhden se është hajdut, për ta larguar nga ky veprim dhe për t'ia tërhequr vërejtjen ndaj këtij harami.
3. Është e obligueshme që gjatë namazit të plotësohet rukuja e sexhdeja dhe të drejtohem mes tyre.

(65100)

(168) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «أَمَّا يَخْشَى أَحَدُكُمْ - أَوْ: لَا يَخْشَى أَحَدُكُمْ - إِذَا رَفَعَ رَأْسَهُ قَبْلَ الْإِمَامِ، أَنْ يَجْعَلَ اللَّهُ رَأْسَهُ رَأْسَ حِمَارٍ، أَوْ يَجْعَلَ اللَّهُ صُورَتَهُ صُورَةَ حِمَارٍ». [صحيح] - [متفق عليه]

(168) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Si nuk ka frikë ai që e ngre kokën para imamit se Allahu mund t'ia shndërrojë kokën në kokë gomari?" - Ose ka thënë: "... se Allahu mund t'ia shndërrojë pamjen në pamje gomari?" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron kërcënimin e rëndë ndaj atij që ngre kokën para imamet (gjatë namazit), se Allahu mund t'ia shndërrojë kokën në kokë gomari ose mund t'ia shndërrojë pamjen në pamje gomari.

Mësimet nga hadithi:

1. Ekzistojnë katër situata në raport me namazfalësin dhe imamet: tri janë të ndaluara: parakalimi i tij, të qenët njëjtë me të dhe vonimi pas tij. Ajo që është obligim është pasimi i imamet.
2. Namazfalësi e ka obligim ta pasojë imamet gjatë namazit.
3. Kërcënimi për t'ia shndërruar imazhin e dikujt që ngre kokën para imamet në imazhin e gomarit është gjë e mundur dhe konsiderohet prej deformimit.

(3086)

(169) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِذَا شَأَكَ أَحَدُكُمْ فِي صَلَاتِهِ، فَلَمْ يَدْرِ كَمْ صَلَّى ثَلَاثًا أَمْ أَرْبَعًا، فَلْيُطْرَحِ الشَّكُّ، وَلْيَبْنِ عَلَى مَا اسْتَيْقَنَ، ثُمَّ يَسْجُدْ سَجْدَتَيْنِ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ، فَإِنْ كَانَ صَلَّى خَمْسًا شَفَعْنَ لَهُ صَلَاتَهُ، وَإِنْ كَانَ صَلَّى إِتِمَامًا لِأَرْبَعٍ كَانَتْ تَرْغِيمًا لِلشَّيْطَانِ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(169) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur dikush

ka dyshime në namaz dhe nuk di sa rekate i ka falur, tri apo katër, le ta shpërfillë dyshimin dhe le të mbështetet në atë që është i sigurt. Pastaj le t'i bëjë dy sexhde para se të japë selam. Nëse i ka falur pesë rekate, këto dy sexhde do t'ia bëjnë namazin çift, e, nëse i ka plotësuar katër rekate, atëherë dy sexhdet do ta poshtërojnë shejtanin.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, nëse namazliu është në mëdyshje rreth namazit të tij dhe nuk e di sa rekate ka falur, tri apo katër, atëherë të heqë numrin shtesë për të cilin dyshon dhe të mos e marrë për bazë. Në këtë rast trerekatëshi është i sigurt, kështu ai duhet të falë rekatin e katërt, pastaj të bëjë dy sexhde para se të japë selam.

Nëse realisht namazliu i ka falur katër rekate, atëherë me shtimin e një rekati janë bërë pesë, e dy sexhdet janë zëvendësim për një rekat, rrjedhimisht numri do të jetë çift e jo tek. Ndërkaq, nëse me rekatin shtesë në fakt i ka falur katër rekate, atëherë e ka kryer atë që e ka pasur obligim, pa shtuar e pa cunguar gjë.

Dy sexhdet e harresës shërbejnë si poshtërim e mposhtje për shejtanin dhe bëjnë që ai të largohet i përbuzuar, larg nga synimi i tij, sepse ai ia ngatërroi namazin besimtarit dhe bëri përpjekje për t'ia prishur, mirëpo namazi i birit të Ademit u plotësua kur ai e zbatoi urdhrin e Allahut të Lartësuar dhe e bëri sexhden, ndërsa Iblisi mëkatoi kur refuzoi t'i bindet Allahut për t'i bërë sexhde Ademit.

Mësime nga hadithi:

1. Nëse namazliu dyshon në namazin e tij dhe njëra prej këtyre dy numrave (tri a katër rekate) nuk mbizotëron tek ai, atëherë ai duhet të shpërfillë dyshimin dhe të veprojë me atë që është i bindur, që në këtë rast është numri më i vogël (tri rekate), kështu që duhet ta plotësojë namazin dhe t'i dy bëjë dy sexhde të harresës para se të japë selam, e pastaj jep selam për ta përfunduar namazin.
2. Këto dy sexhde e plotësojnë namazin dhe e kthejnë shejtanin mbrapsht të poshtëruar, të nënçmuar, larg asaj që synon.
3. Dyshimi në këtë hadith nënkupton dilemën, pa asnjë anim tek njëri prej dy mendimeve, e nëse ekziston një mendim që mbizotëron mbi tjetrin, atëherë veprohet sipas tij.
4. Inkurajimi për t'i luftuar dhe për t'i larguar vesveset përmes zbatimit të urdhrave të fesë.

(11231)

(170) - عَنْ وَابِصَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَأَى رَجُلًا صَلَّى وَحْدَهُ خَلْفَ الصَّفِّ، فَأَمَرَهُ أَنْ يُعِيدَ صَلَاتَهُ. [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(170) – Uabisa (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ pa një burrë, duke u falur vetëm

prapa safit (rreshtit), dhe e urdhëroi atë që ta përsëriste namazin. [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ pa një burrë duke u falur vetëm prapa rreshtit, dhe e urdhëroi që ta përsëriste namazin, sepse namazi i tij në atë gjendje ishte i pavlefshëm.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajohet shkuarja herët në namazin me xhemat dhe përpjekja për të zënë vend në rreshtat e parë, si dhe shmangia e faljes vetëm, prapa rreshtit, në mënyrë që të mos priset namazi.
2. Ibën Haxheri ka thënë: "Kushdo që e fillon namazin vetëm, prapa rreshtit, dhe pastaj i bashkohet rreshtit para se të ngrihet nga rukuja (përkulja), nuk ka nevojë ta përsërisë namazin, ashtu siç tregon hadithi i Ebu Bekres; përndryshe, ai duhet ta përsërisë namazin, sipas kuptimit të përgjithshëm të hadithit të Vabisas."

(11303)

(171) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: ذُكِرَ عِنْدَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَجُلٌ نَامَ لَيْلَهُ حَتَّى أَصْبَحَ، قَالَ: «ذَاكَ رَجُلٌ بَالَ الشَّيْطَانُ فِي أُذُنَيْهِ، أَوْ قَالَ: فِي أُذُنِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(171) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një njeri u përmend në prani të Profetit ﷺ, për të cilin u tha se ka fjetur tërë natën deri në mëngjes, e nuk është ngritur për namaz. Atëherë Profeti ﷺ tha: “Shejtani ka urinuar në dy veshët e tij, - ose ka thënë: në veshin e tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Është përmendur në prani të Profetit ﷺ një njeri që kishte fjetur deri në mëngjes, derisa ka lindur dielli, kështu që nuk ishte zgjuar për ta falur namazin e obliguar (të sabahut). Kësisoj Profeti ﷺ tha: Ai është një njeri, në veshin e të cilit ka urinuar shejtani.

Mësime nga hadithi:

1. Lënia e namazit të natës është e papëlqyer, dhe shejtani është shkaktar i kësaj.
2. Ruaju nga shejtani, i cili i zë pritë njeriut në çdo rrugë, për ta penguar atë nga bindja ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

3. Ibën Haxheri ka thënë: "Fjala e tij: "...e nuk është ngritur për namaz" nënkupton ose namazin e natës, ose namazin farz (të obliguar)."
4. Tībiu ka thënë: "Profeti ﷺ i përmendi posaçërisht veshët, edhe pse sytë do të ishin më të përshtatshëm në kontekstin e gjumit, për të treguar se gjumi ishte i rëndë. Veshët lidhen më shumë me vëmendjen. Ai e përmendi gjithashtu urinën, sepse ajo depërton lehtë dhe shpejt në zgavra dhe vena, duke i prekur kështu të gjithë gjymtyrët me plogështi."

(3714)

(172) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «خَيْرُ يَوْمٍ طَلَعَتْ عَلَيْهِ الشَّمْسُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ، فِيهِ خُلِقَ آدَمُ، وَفِيهِ أُدْخِلَ الْجَنَّةَ، وَفِيهِ أُخْرِجَ مِنْهَا، وَلَا تَقُومُ السَّاعَةُ إِلَّا فِي يَوْمِ الْجُمُعَةِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(172) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Dita e premte është dita më e mirë në të cilën ka lindur Dielli: në këtë ditë është krijuar Ademi, në të është futur në Xhenet dhe në këtë ditë është nxjerrë prej tij, dhe kiameti nuk do të ndodhë vetëm se në ditën e premte.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se dita më e mirë në të cilën lind dielli është dita e xhuma. Prej veçorive të kësaj ditë është se Allahu e krijoi Ademin (paqja qoftë mbi të!) në

këtë ditë dhe po në këtë ditë e futi në Xhenet, gjithashtu në këtë ditë e nxori prej Xhenetit dhe e zbriti në tokë. Po ashtu në ditën e premte do të ndodhë dhe kiameti.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e ditës së premte kundrejt ditëve të tjera të javës.
2. Inkurajimi për shtimin e veprave të mira ditën e premte dhe përgatitja për të fituar mëshirën e Allahut të Lartësuar dhe për të larguar dënimin e Tij.
3. Këto veçori të ditës së premte, të cilat përmendën në këtë hadith, thuhet se nuk janë përmendur si vlerë për të premtën, sepse dëbimi i Ademit (paqja qoftë mbi të!) nga Xheneti dhe ndodhja e kiametit në këtë ditë nuk konsiderohen vlerë. Por gjithashtu thuhet se të gjitha këto konsiderohen vlera, sepse dëbimi i Ademit (paqja qoftë mbi të!) është shkak për ekzistimin e pasardhësve të tij, si: të dërguarit, profetët dhe njerëzit e mirë, kurse ndodhja e kiametit është shkak për përshpejtimin e shpërblimit ndaj njerëzve të mirë dhe fitimin e begative që Allahu i ka përgatitur për ta.
4. Janë përmendur edhe veçori të tjera të së premtes, përveç atyre që u përmendën në këtë transmetim, si: në të Ademit iu pranua pendimi, në të vdiq dhe në të është një orë, të cilën asnjë rob besimtar nuk e has

duke u lutur e duke i kërkuar Allahut diçka, veçse do t'ia japë atij atë.

5. Dita më e mirë e vitit është dita e Arafatit. Ka mendime se është dita e Kurbanit. Ndërsa dita më e mirë e javës është dita e premte (e xhuma) dhe nata më e mirë është nata e Kadrit.

(3711)

(173) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ اغْتَسَلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ غُسْلَ الْجَنَابَةِ ثُمَّ رَاحَ، فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَدَنَةً، وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الثَّانِيَةِ، فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَقَرَةً، وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الثَّالِثَةِ، فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ كَبْشًا أَقْرَنَ، وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الرَّابِعَةِ، فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ دَجَاجَةً، وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الْخَامِسَةِ، فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَيْضَةً، فَإِذَا خَرَجَ الْإِمَامُ حَضَرَتِ الْمَلَائِكَةُ يَسْتَمِعُونَ الذِّكْرَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(173) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që pastrohet ditën e premte, ashtu siç pastrohet prej xhunubllëkut dhe shkon në xhami, konsiderohet sikurse të ketë bërë kurban një deve. Ai që shkon në çastet e dyta, konsiderohet sikurse të ketë bërë kurban një lopë. Ai që shkon në çastet e treta, konsiderohet sikurse të ketë bërë kurban një dash me brirë. Ai që shkon në çastet e katërta, konsiderohet sikurse të ketë bërë kurban një pulë. Ai që shkon në çastet e pesta, konsiderohet sikurse të ketë dhënë sadaka një vezë. E, kur imami të ngjitet në minber, melekët

ndalen për ta dëgjuar dhikrin (hutben).” [Ky hadith është sahih]
- [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith vlerën e vajtjes herët në namazin e xhumasë. Hershmëria fillon nga lindja e diellit deri në ardhjen e imamit. Këto janë pesë çaste dhe ndahen në pesë pjesë sipas kohës ndërmjet lindjes së diellit derisa imami të hyjë dhe të ngjitet në minber për të mbajtur hutben:

I pari: ai që pastrohet me gusël të plotë, ashtu siç pastrohet prej xhunubllëkut dhe shkon në xhami për ta falur namazin e xhumasë në çastet e para, konsiderohet sikur të ketë dhënë sadaka një deve.

I dyti: ai që shkon në çastet e dyta, konsiderohet sikur të ketë dhënë sadaka një lopë.

I treti: ai që shkon në çastet e treta, konsiderohet sikur të ketë dhënë sadaka një dash me brirë.

I katërti: ai që shkon në çastet e katërta, konsiderohet sikur të ketë dhënë sadaka një pulë.

I pesti: ai që shkon në çastet e pesta, konsiderohet sikur të ketë dhënë sadaka një vezë.

Kur imami të hipën në minber për ta mbajtur hutben, melekët që rrinë ulur te dyert ndalen së shkruari emrat e atyre që futen në xhami dhe shkojnë për ta dëgjuar hutben.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për t'u pastruar para namazit të xhumasë, respektivisht para shkuarjes për në namaz.
2. Vlera e shkuarjes herët për në namazin e xhumasë në çastet e para të ditës.
3. Inkurajimi për të përshpejtuar drejt veprave të mira.
4. Melekët marrin pjesë në namazin e xhumasë dhe e mirëdëgjojnë hutben.
5. Melekët qëndrojnë në dyert e xhamive dhe i shkruajnë ata që venë në namazin e xhumasë, një nga një.
6. Ibën Rexhebi ka thënë: "Pjesa e hadithit: "Ai që pastrohet ditën e premtë... dhe shkon në xhami" tregon se abdesi i rekomanduar për ditën e xhuma fillon me lindjen e agimit dhe përfundon me nisjen për në ditën e xhuma."

(5393)

(174) - عَنْ ثَوْبَانَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا انْصَرَفَ مِنْ صَلَاتِهِ اسْتَغْفَرَ ثَلَاثًا، وَقَالَ: «اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ، وَمِنْكَ السَّلَامُ، تَبَارَكْتَ ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ»، قَالَ الْوَلِيدُ: فَقُلْتُ لِلْأَوْرَاعِيِّ: كَيْفَ اسْتَغْفَرُ؟ قَالَ: تَقُولُ: أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ، أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(174) – Theubani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Kur i Dërguari i Allahut ﷺ e përfundonte namazin, kërkonte falje nga Allahu (estagfirullah) tri herë, pastaj thoshte: "O Allah! Ti je Paqedhënësi dhe vetëm prej Teje pres paqen! Ti je përgjithmonë i Begatshëm, o Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit!" Velidi rrëfen: "Euzaiut i thashë: "Po istigfari, si bëhet?" M'u përgjigj: "Thua: "Estagfirullah, estagfirullah (kërkoj faljen e Allahut)!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ e përfundonte namazin, kërkonte falje nga Allahu (estagfirullah) tri herë, e pastaj e madhëronte Zotin e tij duke thënë: "O Allah! Ti je Paqedhënësi dhe vetëm prej Teje e pres paqen! Ti je përgjithmonë i Begatshëm, o Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit!" Allahu është i përkryer në cilësitë e Tij, është i dëlirë nga çdo e metë dhe mangësi. Ti nga Ai e kërkon shpëtimin nga të këqijat e kësaj bote dhe të botës tjetër, e jo nga dikush tjetër. Të mirat e Allahut të Lartësuar janë të shumëfishuara në të dyja botët, Ai është Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit."

Mësim nga hadithi:

1. Është e preferuar të thuhet në vazhdimësi pas çdo namazi (farz) shprehja "estagfirullah".
2. Është i preferuar istigfari për t'i plotësuar mangësitë gjatë adhurimit.

(10947)

(175) - عَنْ أَبِي الزُّبَيْرِ قَالَ: كَانَ ابْنُ الزُّبَيْرِ يَقُولُ فِي دُبُرِ كُلِّ صَلَاةٍ حِينَ يُسَلِّمُ: «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَلَا نَعْبُدُ إِلَّا إِيَّاهُ، لَهُ النَّعْمَةُ وَلَهُ الْفَضْلُ وَلَهُ الثَّنَاءُ الْحَسَنُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ» وَقَالَ: «كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَهْلُلُ بِهِنَّ دُبُرَ كُلِّ صَلَاةٍ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(175) – Ebu Zubejri tregon: Ibn Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!), pas çdo namazi (farz), pasi jepte selam, thoshte: "S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, që është Një dhe i Pashoq. Atij i takon sundimi e lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë! S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asgjë pa ndihmën e Allahut! S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë asnjë tjetër përveç Tij! Dhuntitë dhe mirësitë janë prej Tij dhe vetëm Atij i takon lavdi më i bukur! S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut! Adhurimin e kryejmë me singëritet vetëm për Të, edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët!" Abdullah ibn Zubejri thoshte: "I Dërguari i

Allahut ﷻ e madhëronte Allahun me këto fjalë pas çdo namazi (farz)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ e madhëronte (Allahun me) këtë dhikër madhështor pas selamit të çdo namazi farz dhe kuptimi i tij është:

"S'ka të adhuroar me të drejtë përveç Allahut", respektivisht nuk ka zot që meriton të adhurohet pos Allahut.

"që është Një dhe i Pashoq", respektivisht Ai nuk ka ortakë në adhurimin, zotërimin dhe emrat e cilësitë e Tij.

"Atij i takon sundimi", respektivisht Atij i takon sundimi absolut, i përgjithshëm e gjithëpërfshirës, sundimi i qiejve e i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet ndërmjet tyre.

"dhe lavdia", respektivisht Ai përshkruhet me përsosuri absolute, i lavdëruar me përsosuri nga dashuria dhe madhërimi në të gjitha rrethanat, në mirëqenie dhe në gjendje të vështirë.

"Dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!", pra fuqia e Tij është e përkryer dhe e plotë në çdo aspekt, asgjë nuk mund t'i shpëtojë Atij dhe asgjë nuk është e pamundur për Të.

"S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asgjë pa ndihmën e Allahut!" Pra, nuk ka ndryshim nga një gjendje në tjetrën, ose nga mosbindja ndaj Allahut në bindje ndaj Tij, e as fuqi, përveçse me Allahun, sepse Ai është Ndihmësi dhe tek Ai mbështetemi.

"S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë asnjë tjetër përveç Tij!", vërtetim i kuptimit se Ai është i denjë për adhurim dhe vërtetim i mohimit të idhujtarisë, dhe se askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij.

"Dhuntitë dhe mirësitë janë prej Tij", Ai është që i krijon dhe i posedon dhuntitë dhe ia dhuron kujt të dojë nga robërit e Vet.

"dhe vetëm Atij i takon lavdi më i bukur!", për Qenien, cilësitë, veprat dhe dhuntitë e Tij, si dhe për çdo gjendje.

"S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut! Adhurimin e kryejmë me sinqeritet vetëm për Të", pra, duke e veçuar Atë me adhurim, e jo për syfaqësi e prestigj.

"edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët!", pra, jemi të qëndrueshëm në veçimin e Allahut në adhurim, edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët.

Mësime nga hadithi:

1. Është i rekomanduar që ky dhikër të bëhet në vazhdimësi pas çdo namazi farz.
2. Muslimani është krenar me fenë e tij dhe i shfaq simbolet e fesë, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë këtë gjë.
3. Nëse shprehja "dubur es sal-lah" (pas namazit) vjen në hadith, dhe ajo që përmendet në hadith është dhikër, atëherë në parim ai thuhet pas selamit (përfundimit të namazit), e, nëse është lutje, atëherë thuhet para selamit, para se të përfundojë namazi.

(176) - عَنْ وَرَادٍ كَاتِبِ الْمُغِيرَةِ بْنِ شُعْبَةَ قَالَ: أَمَلَى عَلَيَّ الْمُغِيرَةُ بْنُ شُعْبَةَ فِي كِتَابٍ إِلَى مُعَاوِيَةَ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَقُولُ فِي دُبُرِ كُلِّ صَلَاةٍ مَكْتُوبَةٍ: «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطِي لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ». [صحيح] - [متفق عليه]

(176) – Verradi, i çrobëruari i Mugire ibën Shu’bes, tregon: "Mugire ibën Shu’be i shkroi Muaviut se, kur i Dërguari i Allahut ﷺ e përfundonte namazin e detyrueshëm, thoshte: “La ilahe il-lallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu, ve huve ala kul-li shej’in Kadir. Allahumme la mania lima a’tajte, ve la mu’tije lima mena’të, ve la jenfeu dhel-xheddi minkel-xhed.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ pas çdo namazi obligativ, thoshte*: “La ilahe il-lallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu, ve huve ala kul-li shej’in Kadir. Allahumme la mania lima a’tajte, ve la mu’tije lima mena’të, ve la jenfeu dhel-xheddi minkel-xhed.”

Kjo nënkupton se unë e miratoj dhe e pranoj fjalën e teuhidit (monoteizmit): La ilahe il-lallah. Adhurimin e vërtetë e pohoj për Allahun dhe e mohoj atë nga çdo gjë tjetër, kështu që nuk ka të denjë për t’u adhuruar pos Allahut.

Gjithashtu e miratoj se pushteti i vërtetë e i plotë i takon Allahut dhe gjithë lavdërimi i banorëve të qiejve dhe të Tokës i takon Allahut të Lartësuar, sepse Ai është i plotfuqishëm për çdo gjë. Atë që Allahu e ka caktuar për t'ia dhënë dikujt ose për të mos ia dhënë dikujt tjetër, askush nuk mund ta kthejë dhe tek Ai nuk bën dobi pasuria e të pasurit, por bën dobi vepra e tij e mirë.

Mësim nga hadithi:

1. Është e rekomanduar të thuhet ky dhikër pas namazeve (farz), sepse ngërthen në vete fjalë të monoteizmit dhe lavdërimit (ndaj Allahut).
2. Shpejtimi për t'i praktikuar këto sunete dhe për t'i përhapur.

(65102)

(177) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ سَبَّحَ اللَّهَ فِي دُبُرِ كُلِّ صَلَاةٍ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ، وَحَمَدَ اللَّهَ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ، وَكَبَّرَ اللَّهَ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ، فَتِلْكَ تِسْعَةٌ وَتِسْعُونَ، وَقَالَ: تَمَامَ الْمِائَةِ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ غُفِرَتْ خَطَايَاهُ وَإِنْ كَانَتْ مِثْلَ زَبَدِ الْبَحْرِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(177) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që pas çdo namazi e lartëson Allahun (thotë subhanallah) tridhjetë e tri herë, e falënderon Allahun (thotë elhamdulilah)

tridhjetë e tri herë dhe e madhëron Allahun (thotë Allahu ekber) tridhjetë e tri herë, që të gjitha bëhen nëntëdhjetë e nëntë, dhe të njëqindtën e plotëson duke thënë: "La ilahe il-lallahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul-li shej'in kadir (S'ka të adhurar të denjë përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai ka fuqi për çdo gjë), do t'i falen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se kushdo që thotë pas kryerjes së namazit obligativ:

tridhjetë e tri herë: "Subhanallah", që nënkupton dëlirësimin e Allahut nga mangësitë.

tridhjetë e tri herë: "Elhamdulilah", që nënkupton falënderimin e Allahut përmes cilësive të përsosura, me dashuri dhe madhërim.

tridhjetë e tri herë: "Allahu ekber", që nënkupton se Allahu është më i madh se çdo gjë.

Dhe të njëqindtën e plotëson duke thënë: "La ilahe il-lallahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu, ue huve ala kul-li shej'in kadir", kuptimi i së cilës është: Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit e pa ortak, dhe se Ai, është Ai që ka sundim të plotë, Ai që është i denjë për falënderim dhe lavdërim, duke i thënë këto me dashuri dhe madhërim, e duke besuar se askush tjetër nuk është i denjë për këto përveç Tij, si dhe se Ai është i

Plotfuqishëm për çdo gjë dhe se asgjë nuk është e pamundur për Të.

Kështu, ai që e thotë këtë, mëkatet do t'i fshihen dhe do t'i falen, edhe nëse janë të shumta, si shkuma e bardhë që ngrihet mbi ujin e detit kur dallgëzohet dhe egërsohet.

Mësim nga hadithi:

1. Ky dhikër është i pëlqyeshëm të thuhet pas namazeve të obliguara.
2. Ky dhikër është shkak për faljen e mëkateve.
3. Mirësia, mëshira dhe falja e Allahut të Lartësuar janë madhështore.
4. Ky dhikër është shkak për shlyerjen e mëkateve, respektivisht shlyerjen e mëkateve të vogla, sepse mëkatet e mëdha i shlyen vetëm pendimi.

(10948)

(178) - عَنْ أَبِي أُمَامَةَ رضي الله عنه قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ قَرَأَ آيَةَ الْكُرْسِيِّ فِي دُبُرِ كُلِّ صَلَاةٍ مَكْتُوبَةٍ لَمْ يَمْنَعْهُ مِنْ دُخُولِ الْجَنَّةِ إِلَّا أَنْ يَمُوتَ». [صحيح] - [رواه النسائي في الكبرى]

(178) – Ebu Uname (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Atë që e lexon Ajetin Kursij pas çdo namazi obligativ, nuk e pengon të hyjë në Xhenet asgjë përveç vdekjes.” [Ky hadith është sahih] - [رواه النسائي في الكبرى]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se atë që e lexon Ajetin Kursij pas çdo namazi obligativ, nuk e pengon të hyjë në Xhenet asgjë përveç vdekjes. Ky ajet është në suren el Bekare, respektivisht Fjala e Allahut të Lartësuar: "Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur para tyre dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursia e Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!" (El Bekare, 255)

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e këtij ajeti është e madhe, për faktin se ngërthen në vete emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta të Allahut të Lartësuar.
2. Është e pëlqyeshme që të lexohet ky ajet madhështor pas çdo namazi farz (obligativ).
3. Veprat e mira janë shkak për të hyrë në Xhenet.

(10950)

(179) - عَنِ ابْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: حَفِظْتُ مِنَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَشْرَ رَكَعَاتٍ: رَكَعَتَيْنِ قَبْلَ الظُّهْرِ، وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَهَا، وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرِبِ فِي بَيْتِهِ، وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْعِشَاءِ فِي بَيْتِهِ، وَرَكَعَتَيْنِ قَبْلَ صَلَاةِ الصُّبْحِ، وَكَانَتْ سَاعَةً لَا يُدْخَلُ عَلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِيهَا، حَدَّثَنِي حَفْصَةُ أَنَّهَا كَانَتْ إِذَا أَدَّانَ الْمُؤَدِّنَ وَطَلَعَ الْفَجْرُ صَلَّى رَكَعَتَيْنِ، وَفِي لَفْظٍ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يُصَلِّي بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكَعَتَيْنِ. [صحيح] - [متفق عليه بجميع رواياته]

(179) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: "Nga Profeti ﷺ mbaj në mend dhjetë rekate (vullnetare): dy rekate para drekës dhe dy pas saj, dy rekate pas akshamit në shtëpinë e tij, dy rekate pas jacisë në shtëpinë e tij dhe dy rekate para farzit të sabahut. Gjatë kësaj kohe nuk hynim te Profeti ﷺ (në shtëpinë e tij). Hafsa më tregoi se, kur myezini e thërriste ezanin dhe hynte sabahu, i falte dy rekate. Në një transmetim qëndron: "Profeti ﷺ i falte dy rekate pas xhumasë." [Ky hadith është sahih] - [Të gjitha transmetimet janë muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Abdullah ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) sqaron se prej namazeve vullnetare që i ka mbajtur në mend nga Profeti ﷺ janë dhjetë, të cilat quhen sunetet e rregullta ditore (ar. es-sunen er-ravatib). Dy rekate para drekës dhe dy pas saj, dy rekate pas akshamit në shtëpinë e tij dhe dy rekate pas jacisë në shtëpinë e tij dhe dy rekate para namazit të sabahut. Kështu, bëjnë dhjetë rekate. Sa i përket namazit të xhumasë, Profeti ﷺ i falte dy rekate pas tij.

Mësime nga hadithi:

1. Është e pëlqyeshme që këto sunete të rregullta ditore të falen në vazhdimësi.
2. Është e ligjshme që sunetet të falen në shtëpi.

(3062)

(180) – عن عائشة أم المؤمنين رضي الله عنها: أن النبي صلى الله عليه وسلم كان لا يدع أربعاً قبل الظهر وركتين قبل العداة. [صحيح] - [رواه البخاري]

(180) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ asnjëherë nuk i linte katër rekate para drekës dhe dy para sabahut. [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregoi se Profeti ﷺ zakonisht i falte namazet nafile (vullnetare) në shtëpinë e saj pa i lënë kurrë ato: katër rekate me dy selame para namazit të drekës dhe dy rekate para namazit të sabahut.

Mësime nga hadithi:

1. Është e preferuar që rregullisht të falen katër rekate para namazit të drekës dhe dy rekate para namazit të sabahut.
2. Është më e preferuar që sunetet e rregullta ditore të falen në shtëpi, dhe për këtë arsye Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka treguar për to.

(181) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مُغَفَّلٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «بَيْنَ كُلِّ أَذَانَيْنِ صَلَاةٌ، بَيْنَ كُلِّ أَذَانَيْنِ صَلَاةٌ» ثُمَّ قَالَ فِي الثَّالِثَةِ: «لِمَنْ شَاءَ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(181) – Abdullah ibën Mugafeli (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Mes dy ezaneve (ezanit dhe ikametit) ka namaz. Mes dy ezaneve ka namaz.” - Pastaj, herën e tretë, tha: - “Për atë që dëshiron.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e bëri të qartë se ndërmjet çdo ezani e ikameti ka namazi vullnetar dhe këtë e përsëriti tri herë. Herën e tretë tha se kjo është e rekomanduar për këdo që dëshiron të falet.

Mësime nga hadithi:

1. Është e rekomanduar të falet namaz ndërmjet ezanit dhe ikametit.
2. Ishte udhëzim i Profetit ﷺ që (ndonjëherë) ta përsëriste fjalën tri herë. Kjo, për t'ia bërë të mundshme dëgjuesit ta dëgjojë dhe për ta shpërfaqur rëndësinë e asaj që po e thotë.
3. Me frazën "dy ezane" është për qëllim ezani dhe ikameti. Kështu përdoret në gjuhën arabe. Sikur dy

hënat, që janë për qëllim Dielli dhe Hëna dhe dy Omerët, që janë për qëllim Ebu Bekri dhe Omeri.

4. Ezani është lajmërim për hyrjen e kohës së namazit, kurse ikameti është lajmërim për kohën e kryerjes së namazit.

(65479)

(182) - عَنْ أَبِي قَتَادَةَ السَّلَمِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِذَا دَخَلَ أَحَدُكُمُ الْمَسْجِدَ فَلْيَرْكَعْ رَكَعَتَيْنِ قَبْلَ أَنْ يَجْلِسَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(182) – Ebu Katade Sulemiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush hyn në xhami, le t'i falë dy rekate para se të ulet.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith inkurajon këdo që vjen dhe hyn në xhami, në çfarëdo kohe dhe për çfarëdo qëllimi, që të falë dy rekate para se të ulet. Këto ndryshe quhen dy rekartet e përshëndetjes së xhamisë.

Mësime nga hadithi:

1. Është e rekomanduar të falen dy rekate përshëndetje xhamisë para se të ulemi.

2. Ky urdhër (rekomandimi) është për ata që duan të ulen, e këdo që hyn në xhami dhe del para se të ulet, nuk e përfshin ky urdhër.
3. Nëse namazliu hyn (në xhami) dhe besimtarët janë duke u falur e ky u bashkohet atyre, atëherë kjo i mjafton kundrejt dy rekateve.

(65091)

(183) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ:
«إِذَا قُلْتَ لِصَاحِبِكَ: أَنْصِتْ، يَوْمَ الْجُمُعَةِ، وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ، فَقَدْ لَعَوْتُ». [صحيح] -
[متفق عليه]

(183) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Nëse në ditën e premte, teksa imami është duke ligjëruar, i thua shokut tënd: "Hesht!", veçse e ke humbur shpërblimin." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron një nga normat e detyrueshme për ata që marrin pjesë në hutben e xhumasë, që është: të heshtet teksa imami ligjëron, që të përsiatë mbi hutben. Ai që flet, - qoftë dhe pak, - teksa imami është duke ligjëruar, fjala vjen, i thotë ndokujt: “Hesht!”, ose: “Dëgjo!”, veçse e ka humbur shpërblimin e namazit të xhumasë.

Mësim nga hadithi:

1. Të folurit gjatë dëgjimit të hutbes është haram, qoftë dhe me ndalimin e së keqes, qoftë me kthimin e selamit, qoftë duke i thënë teshtitësit: "Jerhamukallah - Allahu të mëshiroftë!"
2. Nga kjo gjë bën përjashtim ai që i drejtohet imamit ose imami i drejtohet atij.
3. Në rast nevojë lejohet të folurit ndërmjet dy hutbeve.
4. Nëse Profeti ﷺ përmendet gjatë kohës kur imami e mban hutben, atëherë i dërgon salavate dhe selame në heshtje, e njëjtë vepron kur të thuash: "Amin", pasi imami të bëjë lutje.

(3107)

(184) – عن عمران بن حصين رضي الله عنه قال: كَانَتْ بِي بَوَاسِيرُ، فَسَأَلْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنِ الصَّلَاةِ، فَقَالَ: «صَلِّ قَائِمًا، فَإِنْ لَمْ تَسْتَطِعْ فَقَاعِدًا، فَإِنْ لَمْ تَسْتَطِعْ فَعَلَى جَنْبٍ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(184) – Imran ibën Husajni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Vuaja nga hemorroidet, andaj e pyeta Profetin ﷺ rreth namazit, e në atë rast më tha: "Falu në këmbë. Nëse nuk mundesh, falu ulur. Nëse nuk mundesh, falu shtrirë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, në parim, namazi falet në këmbë, mirëpo, nëse personi nuk mund të qëndrojë në këmbë, falet ulur. E, nëse nuk mund të falet ulur, atëherë i lejohet të falet i shtrirë anash.

Mësime nga hadithi:

1. Obligueshmëria e namazit nuk bie për sa kohë që njeriu ka mendje (të shëndoshë), kështu që namazliu kalon nga një gjendje në tjetrën.
2. Ky hadith tregon se Islami është tolerant dhe i lehtë, sepse njeriu e kryen adhurimin në formën që ka mundësi.

(10951)

(185) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «صَلَاةٌ فِي مَسْجِدِي هَذَا خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيمَا سِوَاهُ إِلَّا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(185) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Një namaz në këtë xhaminë time është më i vlefshëm sesa një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç në Xhaminë e Shenjtë (Qabe).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron vlerën e namazit në xhaminë e tij dhe se ai është më i mirë në shpërblim sesa një mijë namaze në çdo xhami tjetër në tokë, përveç Xhamisë së Shenjtë në Mekë, ku namazi në të është më me vlerë sesa namazi në Xhaminë e Profetit ﷺ.

Mësime nga hadithi:

1. Shumëfishimi i shpërblimit për faljen e namazit në Xhaminë e Shenjtë (Qabe) dhe në Xhaminë Profetike.
2. Namazi në Xhaminë e Shenjtë është më i mirë se njëqind mijë namaze në xhamitë e tjera.

(65090)

(186) - عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ لَبِيدٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ عُثْمَانَ بْنَ عَفَّانَ أَرَادَ بِنَاءَ الْمَسْجِدِ فَكَّرَ النَّاسُ ذَلِكَ، وَأَحْبَبُوا أَنْ يَدْعَهُ عَلَى هَيْئَتِهِ، فَقَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ بَنَى مَسْجِدًا لِلَّهِ بَنَى اللَّهُ لَهُ فِي الْجَنَّةِ مِثْلَهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(186) – Mahmud ibën Lebidi (Allahu qoftë i kënaqur m të!) tregon se Othman ibn Afani deshi ta rindërtojë xhaminë, por njerëzve nuk u pëlqeu kjo gjë, kështu që parapëlqyen ta linte ashtu siç ishte, e ai u tha: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Atij që ndërton një xhami për hir të

Allahut, Allahu i ndërton një të tillë në Xhenet.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Othman ibën Afani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) donte ta rindëronte Xhaminë e Profetit ﷺ në një mënyrë më të mirë se ndërtimi i saj i parë, por njerëzit nuk e pëlqyen këtë gjë, për shkak të ndryshimit të ndërtimit të xhamisë nga mënyra e ndërtimit të saj në kohën e Profetit ﷺ. Xhamia më parë ishte e ndërtuar me baltë dhe çatia e saj ishte me degë të palmës, por Othmani deshi ta ndërtojë me gurë dhe suva. Kështu, Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u tregoi se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: "Atë që ndërton një xhami, duke synuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar e jo syefaqësinë e reputacionin, Allahu do ta shpërblejë me shpërblimin më të mirë nga lloji i veprës së tij, dhe ky shpërblim është se Allahu do t'i ndërtojë një të ngjashme në Xhenet."

Mësimet nga hadithi:

1. Inkurajimi për të ndërtuar xhami dhe vlera e kësaj gjëje.
2. Zgjerimi dhe renovimi i xhamisë bën pjesë në vlerën e ndërtimit të saj.
3. Rëndësia që ka sinqeriteti për hir të Allahut të Lartësuar në të gjitha veprat.

(65089)

(187) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَا مِنْ صَاحِبٍ ذَهَبٍ وَلَا فِصَّةٍ، لَا يُؤَدِّي مِنْهَا حَقَّهَا، إِلَّا إِذَا كَانَ يَوْمُ الْقِيَامَةِ، صُفِّحَتْ لَهُ صَفَائِحُ مِنْ نَارٍ، فَأُحْمِيَ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ، فَيُكْوَى بِهَا جَنْبُهُ وَجَبِينُهُ وَظَهْرُهُ، كُلَّمَا بَرَدَتْ أُعِيدَتْ لَهُ، فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ، حَتَّى يُقْضَى بَيْنَ الْعِبَادِ، فَيَرَى سَبِيلَهُ، إِمَّا إِلَى الْجَنَّةِ، وَإِمَّا إِلَى النَّارِ»

قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، فَلَا يِلَّ؟ قَالَ: «وَلَا صَاحِبُ يِلٍّ لَا يُؤَدِّي مِنْهَا حَقَّهَا، وَمِنْ حَقَّهَا حَلَبَهَا يَوْمَ وَرْدِهَا، إِلَّا إِذَا كَانَ يَوْمُ الْقِيَامَةِ، بُطِحَ لَهَا بِقَاعٍ قَرَقَرٍ، أَوْفَرَ مَا كَانَتْ، لَا يَفْقِدُ مِنْهَا فَصِيلًا وَاحِدًا، تَطْوُهُ بِأَخْفَافِهَا وَتَعَضُّهُ بِأَفْوَاهِهَا، كُلَّمَا مَرَّ عَلَيْهِ أُولَاهَا رُدَّ عَلَيْهِ أُخْرَاهَا، فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ، حَتَّى يُقْضَى بَيْنَ الْعِبَادِ، فَيَرَى سَبِيلَهُ إِمَّا إِلَى الْجَنَّةِ، وَإِمَّا إِلَى النَّارِ»

قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، فَالْبَقَرُ وَالْعَنَمُ؟ قَالَ: «وَلَا صَاحِبُ بَقَرٍ، وَلَا غَنَمٍ، لَا يُؤَدِّي مِنْهَا حَقَّهَا، إِلَّا إِذَا كَانَ يَوْمُ الْقِيَامَةِ بُطِحَ لَهَا بِقَاعٍ قَرَقَرٍ، لَا يَفْقِدُ مِنْهَا شَيْئًا، لَيْسَ فِيهَا عَقْصَاءٌ، وَلَا جِلْدَاءٌ، وَلَا عَضْبَاءٌ تَنْطَحُهُ بِقُرُونِهَا وَتَطْوُهُ بِأَظْلَافِهَا، كُلَّمَا مَرَّ عَلَيْهِ أُولَاهَا رُدَّ عَلَيْهِ أُخْرَاهَا، فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ، حَتَّى يُقْضَى بَيْنَ الْعِبَادِ، فَيَرَى سَبِيلَهُ إِمَّا إِلَى الْجَنَّةِ، وَإِمَّا إِلَى النَّارِ»

قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، فَالْحَيْلُ؟ قَالَ: «الْحَيْلُ ثَلَاثَةٌ: هِيَ لِرَجُلٍ وَزُرٌّ، وَهِيَ لِرَجُلٍ سِتْرٌ، وَهِيَ لِرَجُلٍ أَجْرٌ، فَأَمَّا الَّتِي هِيَ لَهُ وَزُرٌّ، فَرَجُلٌ رَبَطَهَا رِبَاءً وَفَخْرًا وَنَوَاءً عَلَى أَهْلِ الْإِسْلَامِ، فَهِيَ لَهُ وَزُرٌّ، وَأَمَّا الَّتِي هِيَ لَهُ سِتْرٌ، فَرَجُلٌ رَبَطَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ، ثُمَّ لَمْ يَنْسَ حَقَّ اللَّهِ فِي ظُهُورِهَا وَلَا رِقَابِهَا، فَهِيَ لَهُ سِتْرٌ وَأَمَّا الَّتِي هِيَ لَهُ أَجْرٌ، فَرَجُلٌ رَبَطَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لِأَهْلِ الْإِسْلَامِ، فِي مَرْجٍ وَرَوْضَةٍ، فَمَا أَكَلَتْ مِنْ ذَلِكَ الْمَرْجِ، أَوْ الرَّوْضَةِ مِنْ شَيْءٍ، إِلَّا كُتِبَ لَهُ، عَدَدَ مَا أَكَلَتْ حَسَنَاتٌ، وَكُتِبَ لَهُ، عَدَدَ أَرْوَائِهَا وَأَبْوَالِهَا، حَسَنَاتٌ، وَلَا تَقْطَعُ طَوْلَهَا فَاسْتَنْتَ شَرَفًا، أَوْ شَرَفَيْنِ، إِلَّا كُتِبَ اللَّهُ لَهُ عَدَدَ أَثَارِهَا وَأَرْوَائِهَا حَسَنَاتٍ، وَلَا مَرَبَّيْهَا صَاحِبُهَا عَلَى نَهْرٍ، فَشَرِبَتْ مِنْهُ وَلَا يُرِيدُ أَنْ يَسْقِيَهَا، إِلَّا كُتِبَ اللَّهُ لَهُ، عَدَدَ مَا شَرِبَتْ، حَسَنَاتٍ»

قِيلَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، فَالْحُمْرُ؟ قَالَ: «مَا أُنْزِلَ عَلَيَّ فِي الْحُمْرِ شَيْءٌ، إِلَّا هَذِهِ الْآيَةُ الْفَادَةُ الْجَامِعَةُ»: {فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ، وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ} [الزلزلة:

8]. [صحيح] - [متفق عليه]

(187) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Pronarit të arit dhe argjendit, që nuk e jep hakun e tyre (zekatin), kur të bëhet Dita e Kiametit ato do t'i shndërrohen në pllaka prej Zjarri, të cilat skuqen në zjarr të Xhehenemit e me to i hekuroset trupi, balli e shpina. Sa herë që ftohen, ato sërish skuqen në zjarr për atë, në Ditën, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet. Kur të mbarojë gjykimi mes njerëzve, atij do t'i tregohet rruga: ose për në Xhenet, ose për në Zjarr.”

- O i Dërguari i Allahut, po devetë? - e pyeti dikush. - “Pronari i deveve, i cili nuk e jep hakun e tyre (zekatin), e

prej hakut të tyre është mjelja e tyre ditën kur të pinë ujë (për t'u dhënë qumësht kalimtarëve), kur të ndodhë Dita e Kiametit, hidhet (me fytyrë) përtokë, ndërkohë devetë do të jenë në numrin më të madh dhe në peshën më të rëndë nga sa e kishin (në këtë botë), nuk do t'i mungojë as dhe një deve e vogël, por do ta shkelin me shputa dhe do ta kafshojnë me dhëmbë. Sa herë që kalojnë të parat, i kthehen sërish ato të fundit. Kjo do të ndodhë ditën, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet, derisa të mbarojë gjykimi mes njerëzve. Atëherë do ta shohë rrugën: ose për në Xhenet, ose për në Zjarr.”

- O i Dërguari i Allahut, po lopët dhe delet? - e pyeti dikush. - “Pronari i lopëve ose i deleve, i cili nuk e jep hakun e tyre (zekatin), kur të ndodhë Dita e Kiametit, hidhet (me fytyrë) përtokë. Atij nuk do t'i mungojë asgjë. Ato nuk janë me brirë të dredhura mbrapa, as janë pa brirë, e as i kanë të thyera. Do ta godasin me brirë e do ta shkelin me thundra. Sa herë që kalojnë të parat, i kthehen sërish ato të fundit. Kjo do të ndodhë Ditën, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet, derisa të mbarojë gjykimi mes njerëzve. Atëherë do ta shohë rrugën: ose për në Xhenet, ose për në Zjarr.”

- O i Dërguari i Allahut, po kuajt? - e pyeti dikush. “Kuajt ndahen në tri lloje: për dikë janë barrë e mëkat, për dikë mburojë, e për dikë janë shpërblim. Sa i përket atij për të cilin janë mëkat, është personi që mban kuaj nga syfaqësia, mendjemadhësia dhe i shfrytëzon në armiqësi të muslimanëve. Këtij i llogariten barrë dhe mëkat. Ai për të cilin janë mburojë, është personi që mban kuaj për hir të Allahut dhe nuk e harron hakun e tyre, për shpinën

(kalërimin) dhe kokat (zekatin) e tyre, me të cilin Allahu e ka ngarkuar. Këtij i llogariten mburojë (nga varfëria). Ndërkaq, atij që i llogaritet shpërblim është personi që mban kuaj për luftë në rrugën e Allahut, për (t'i ndihmuar) muslimanët. Ai i lidh në kullosë ose kopsht, kështu që sa hanë nga kullosa ose kopshti, i llogaritet shpërblim pronarit me aq të mira. Po ashtu i shkruhen shpërblimet aq sa është numri i bajgave dhe i urinave të tyre. Nëse ndodh ta këpusin litarin dhe të ikin një ose dy kodra larg, Allahu ia llogarit shpërblim pronarit aq sa është numri i fërkimeve dhe bajgave të tyre. Sa herë që pronari kalon pranë lumit dhe kali pi aty, pa dashur pronari t'i japë ujë, Allahu ia llogarit shpërblim pronarit, aq sa ka pirë.”

- O i Dërguari i Allahut, po gomarët? - e pyeti dikush. - “Nuk më ka zbritur shpallje që flet konkretisht për gomarët, përveç këtyre ajeteve të përgjithshme e të pashoq: “Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë. E kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (Ez Zelzele, 7- 8) [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith i sqaroi llojet e pasurisë dhe ndëshkimin për atë që nuk e jep zekatin e saj në Ditën e Kiametit. Prej tyre i përmendi këta:

E para: Ari, argjendi dhe çdo pasuri tjetër e ngjashme me to, si mallrat tregtare, për të cilat është obliguar zekati, por nuk është dhënë. Kur të vijë Dita e Kiametit, ato do të shkrihen dhe do të derdhen në formën e pllakave, pastaj do

të nxehen në zjarrin e Xhehenemit dhe pronari i tyre do të ndëshkohet me to. Me to i hekuroset trupi, balli e shpina, si dhe sa herë që të ftohen, do të rinxehen përsëri. Ky ndëshkim do të vazhdojë gjatë gjithë Ditës së Kiametit, e cila zgjat pesëdhjetë mijë vjet, derisa Allahu të gjykojë mes krijesave dhe të vendosë nëse ai do të jetë banor i Xhenetit apo i Zjarrit.

E dyta: Pronari i deveve që nuk e jep zekatin dhe të drejtat e tyre, përfshirë lejimin e të varfërve të marrin qumështin e tyre. Në Ditën e Kiametit, këto deve do të sillen të mëdha, të shëndosha dhe në numrin më të madh që kanë pasur ndonjëherë. Pronari i tyre do të shtrihet në një tokë të gjerë dhe të sheshtë, ku ato do ta shkelin me shputat e tyre dhe do ta kafshojnë me dhëmbët e tyre. Sa herë që të kalojë tufa e fundit, do t'i kthehet përsëri e para. Ky ndëshkim do të vazhdojë gjatë gjithë Ditës së Kiametit, e cila zgjat pesëdhjetë mijë vjet, derisa Allahu të gjykojë mes krijesave dhe të vendosë nëse ai do të jetë banor i Xhenetit apo i Zjarrit.

E treta: Pronari i lopëve dhe deleve, qofshin ato dhen apo dhi, që nuk jep zekatin e tyre të detyrueshëm. Në Ditën e Kiametit, ato do të sillen në numrin e tyre më të madh, pa munguar asnjëra prej tyre. Pronari i tyre do të shtrihet në një tokë të gjerë dhe të sheshtë, ku nuk do të ketë asnjë me brirë të thyer, pa brirë apo me të meta, por të gjitha do të jenë në formën e tyre më të plotë. Ato do ta godasin me brirët e tyre dhe do ta shkelin me thundrat e tyre. Sa herë që të kalojë tufa e fundit, do t'i kthehet përsëri e para. Ky ndëshkim do të vazhdojë gjatë gjithë Ditës së Kiametit, e cila zgjat

pesëdhjetë mijë vjet, derisa Allahu të gjykojë mes krijesave dhe të vendosë nëse ai do të jetë banor i Xhenetit apo i Zjarrit.

E katërta: Pronari i kuajve, të cilët ndahen në tre kategori:

E para: Kuajt për të cilët bart barrë mëkati. Kjo vlen për atë që i mban kuajt për t'u mburrur, për syfaqësi dhe për luftë kundër muslimanëve.

E dyta: Kuajt që janë mbrojtje për të. Kjo vlen për atë që i mban kuajt për xhihad në rrugë të Allahut, pastaj sillet mirë me ta duke u siguruar ushqimin dhe kujdesin e nevojshëm, përfshirë edhe lënien e tyre për çiftëzim.

E treta: Kuaj për të cilët ka shpërblim. Kjo vlen për atë që i mban kuajt për xhihad në rrugë të Allahut për t'ia dhënë muslimanëve. Nëse ata kullosin në një livadh apo luginë, çdo kafshatë që hanë do t'i shkruhet si sevap. Gjithashtu, çdo jashtëqitje dhe urinë e tyre do t'i shkruhet si sevap. Nëse e këpusin litarin me të cilin janë lidhur dhe vrapojnë shpejt në një vend të ngritur, çdo gjurmë e tyre dhe çdo jashtëqitje do t'i numërohet si sevap. Po ashtu, nëse kalon pranë një lumi dhe ata pinë ujë prej tij, ndërsa pronari nuk kishte ndërmend t'u jepte ujë, do t'i shkruhet sevap për çdo gllënkë që pinë.

Pastaj Profeti ﷺ u pyet se a janë gomarët si kuajt?

Atëherë Profeti ﷺ tha se nuk është shpallur ndonjë ligj specifik për to, përveç këtij ajeti të rrallë, i cili është i përgjithshëm për të gjitha llojet e veprave, qofshin të mira apo të këqija, ku thotë Allahu i Lartësuar: "Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë

atë." (Ez Zelzele, 8) Pra, kush i mban gomarët me qëllim të mirë dhe për bindje ndaj Allahut, do ta shohë shpërblimin për këtë, sikurse kush i mban ata për mosbindje ndaj Tij, do ta shohë ndëshkimin. Ky parim i përfshin të gjitha veprat.

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim dhënia e zekatit dhe ka kërcënim të ashpër për ata që nuk e japin.
2. Ai që nuk e jep zekatin nga përtacia nuk është jobesimtar, por është në rrezik të madh.
3. Njeriu shpërblehet për detajet që ndodhin gjatë kryerjes së një akti adhurimi, nëse ka pasur për qëllim vetë veprën, edhe nëse nuk ka pasur për qëllim ato detaje.
4. Në pasuri ka edhe të drejta tjera përveç zekatit.
5. Ndër të drejtat në raport me devetë është që të millet qumështi i tyre për të varfrit, që ndodhen pranë vendit ku ato pinë ujë, në mënyrë që të jetë më e lehtë për nevojtarin, sesa të shkojë nëpër shtëpi dhe më e përshtatshme për bagëtinë. Ibën Betali ka thënë: "Në pasuri ka dy të drejta: një që është obligim individual dhe një tjetër. Mjelja e deveve për të varfrit është nga ato të drejta që hyjnë te vlerat e larta morale."

6. Një nga të drejtat e detyrueshme në deve, lopë dhe dele është huazimi i mashkullit të tyre për çiftëzim atëherë kur kërkohet.
7. Vendimi për gomarët dhe çdo gjë që nuk është e përcaktuar në tekst fetar është se ajo hyn në fjalën e Allahut: "Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë." (Ez Zelzele, 7-8)
8. Ajeti na inkurajon të bëjmë mirë, edhe nëse është diçka e vogël, si dhe na kërcënon për të mos bërë keq, edhe nëse është diçka e parëndësishme.

(6611)

(188) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ:
 «مَا نَقَصَتْ صَدَقَةٌ مِنْ مَالٍ، وَمَا زَادَ اللَّهُ عَبْدًا بِعَفْوٍ إِلَّا عِزًّا، وَمَا تَوَاضَعَ أَحَدٌ لِلَّهِ إِلَّا رَفَعَهُ اللَّهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(188) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Sadakaja (lëmosha) nuk e pakëson pasurinë. Robit i cili fal, Allahu i shton krenari dhe Ai do të lartësojë këdo që bëhet modest për hir të Allahut." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se sadakaja nuk e pakëson pasurinë, por, përkundrazi, i largon të këqijat dhe Allahu ia zëvendëson personit të tillë me mirësi madhështore, prandaj i shtohet dhe nuk i pakësohet.

Falja, duke pasur mundësi për t'u hakmarrë ose për ta ndëshkuar personin që të ka bërë dëm, vetëm e shton fuqinë dhe krenarinë tënde.

Kushdo që tregohet modest dhe i thjeshtë për hir të Allahut, e jo nga frika a lajkatimi për ndokënd ose për të përfituar prej ndokujt, shpërblimi i tij do të jetë lartësim dhe nderim te të tjerët.

Mësime nga hadithi:

1. Mirësia dhe suksesi qëndron në respektimin e fesë dhe të bërët mirë, edhe nëse disa njerëz mendojnë se është ndryshe.

(5512)

(189) – عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال:

«قَالَ اللَّهُ: أَنْفَقَ يَا ابْنَ آدَمَ أَنْفَقَ عَلَيْكَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(189) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu thotë: "Jep, o biri i Ademit, të të jap." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se Allahu i Lartmadhërishëm thotë: "Jep, o biri i Ademit, - nga lëmoshat e detyrueshme dhe të rekomanduara - do të ta zgjeroj (furnizimin), do të të jap në këmbim të saj dhe do të të bekoj në të."

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të dhënë sadaka dhe për të shpenzuar në rrugën e Allahut.
2. Lëmosha për bamirësi është një nga arsyet më të mëdha për ta arritur bereqetin dhe shumëfishimin e riskut dhe që Allahu t'ia japë robit atë që ka shpenzuar.
3. Ky hadith është nga ato që Profeti ﷺ i transmeton nga Zoti i tij dhe quhet hadith i shenjtë (ar. kudsij) ose hyjnor, që shprehja dhe kuptimi i tij janë nga Allahu, vetëm se nuk i ka karakteristikat e Kuranit, që e dallojnë atë nga çdo gjë tjetër, si: të bërët adhurim me leximin e tij, të qenët i pastër gjatë leximit, sfidimi (që të sjellin një të ngjashëm me të), paimitueshmëria etj.

(5805)

(190) – عن أبي مسعود رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «إِذَا أَنْفَقَ الرَّجُلُ عَلَى أَهْلِهِ يَحْتَسِبُهَا فَهُوَ لَهُ صَدَقَةٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(190) – Ebu Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Nëse njeriu (musliman) shpenzon për familjen e tij, duke llogaritur në shpërblimin (e Allahut), atëherë kjo i shkruhet sadaka (lëmoshë).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se, nëse një njeri (musliman) shpenzon për familjen e tij, respektivisht për ata që është i detyruar të shpenzojë, si: grua, prindërit, fëmija dhe të tjerët, e me këtë synon të afrohet me Allahun e Lartësuar dhe e llogarit shpërblimin tek Ai për atë që shpenzon, atëherë ai do të ketë shpërblimin e sadakasë.

Mësime nga hadithi:

1. Duke shpenzuar për familjen, arrihet shpërblimi (tek Allahu).
2. Besimtari përmes veprave të tij synon Fytyrën e Allahut dhe shpërblimet që ndodhen tek Ai.
3. Qëllimet e mira duhet të kihen ndërmend në çdo vepër, e këtu përfshihen shpenzimet për familjen.

(6460)

(191) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صلى الله عليه وسلم قَالَ: «إِذَا مَاتَ الْإِنْسَانُ انْقَطَعَ عَنْهُ عَمَلُهُ إِلَّا مِنْ ثَلَاثَةٍ: إِلَّا مِنْ صَدَقَةٍ جَارِيَةٍ، أَوْ عِلْمٍ يُنْتَفَعُ بِهِ، أَوْ وَلَدٍ صَالِحٍ يَدْعُو لَهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(191) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur të vdesë njeriu, i ndërpriten (shpërblimet për) veprat, përveç tri veprave: lëmoshës rrjedhëse, dijes prej së cilës kanë dobi (njerëzit) dhe fëmijës së mirë që lutet për të.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka treguar në këtë hadith se të vdekurit i ndërpriten veprat me vdekjen e tij, kështu që ai nuk merr vepra të mira pas vdekjes, përveçse këto tri vepra, sepse ishte shkaktar për to:

E para: lëmosha, shpërblimi i së cilës është i vazhdueshëm dhe i rrjedhshëm, pa ndërprerje, si: vakëfet, ndërtimi i xhamive, hapja e puseve etj.

E dyta: dituria që u bën dobi njerëzve, bie fjala, përpilimi i librave të diturisë ose mësimi i dikujt, ku ky person pastaj e përhap atë dituri pas vdekjes së tij.

E treta: një fëmijë i mirë dhe besimtar që lutet për prindërit e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Dijetarët janë pajtuar njëzëri se ndër shpërblimet që merr njeriu pas vdekjes janë: lëmosha rrjedhëse,

dituria e dobishme dhe lutja. Në hadithe të tjera është përmendur edhe haxhillëku.

2. Këto tri vepra janë përmendur në mënyrë specifike në këtë hadith, sepse ato janë themelet e mirësisë dhe shumica e asaj që bamirësit synojnë të mbeten pas tyre.
3. Çdo dituri që është e dobishme shpërblehet, por në krye dhe në majë të tyre është dituria e fesë dhe shkencat që e mbështesin atë.
4. Dituria është prej veprave më të dobishme nga këto tria, sepse dituria i sjell dobi njeriut që e mëson atë: përmes diturisë ruhet feja, ajo u sjell dobi njerëzve në përgjithësi dhe ajo është më gjithëpërfshirëse dhe e përgjithshme, sepse muslimani përfiton gjatë kësaj jete dhe pas vdekjes.
5. Inkurajimi për të edukuar fëmijët që të bëhen të mirë, sepse ata u bëjnë dobi prindërve në botën tjetër e nga këto dobi është se luten për ta.
6. Inkurajimi që t'u bëjmë mirë prindërve pas vdekjes së tyre, ku kjo në fakt është edhe mirësi prej së cilës përfiton vetë fëmija.
7. Lutja i bën dobi të vdekurit, edhe nëse ai nuk është fëmija i vet, por fëmija është specifikuar në hadith, sepse ai është që në vazhdimësi lutet për prindërit, derisa vetë të vdesë.

(192) - عَنْ مَالِكِ بْنِ أُوَيْسِ بْنِ الْحَدَثَانِ أَنَّهُ قَالَ: أَقْبَلْتُ أَقُولُ مَنْ يَصْطَرِفُ الدَّرَاهِمَ؟ فَقَالَ طَلْحَةُ بْنُ عُبَيْدٍ اللَّهِ وَهُوَ عِنْدَ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: أَرِنَا ذَهَبَكَ، ثُمَّ اثْنَيْنَا، إِذَا جَاءَ خَادِمُنَا، نُعْطِكَ وَرِقَّكَ، فَقَالَ عُمَرُ بْنُ الْخَطَّابِ: كَلَّا، وَاللَّهِ لَتُعْطِيَنَّهُ وَرِقَّهُ، أَوْ لَتَرُدَّنَّ إِلَيْهِ ذَهَبَهُ، فَإِنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «الْوَرِقُ بِالذَّهَبِ رِبًّا، إِلَّا هَاءَ وَهَاءَ، وَالْبُرُّ بِالْبُرِّ رِبًّا، إِلَّا هَاءَ وَهَاءَ، وَالشَّعِيرُ بِالشَّعِيرِ رِبًّا، إِلَّا هَاءَ وَهَاءَ، وَالتَّمْرُ بِالتَّمْرِ رِبًّا، إِلَّا هَاءَ وَهَاءَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(192) – Malik ibën Eus ibën Hadethani tregon: "Vajta te disa dhe u thashë: "Kush shet dërhëmë?" Atëherë Talha ibën Ubejdullahu, i cili ishte tek Omer ibën Hatabi, tha: "Na e trego arin tënd (lëre këtu), pastaj eja te ne, që, kur të na vijë shërbëtori ynë, ta japim argjendin që të takon." Atëherë Omer ibën Hatabi tha: "Jo, assesi! Për Allahun, ose jepja argjendin në dorë, ose ktheja arin e vet, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Këmbimi i argjendit me ar konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë; këmbimi i grurit me grurë konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë; këmbimi i elbit me elb konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë dhe këmbimi i hurmave me hurma konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehen dorë me dorë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Tabiini, Malik ibën Eusi tregon se kishte disa dinarë ari dhe dëshironte t'i shkëmbente me dërhëmë argjendi. Talha bin Ubejdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i tha: "Na jep dinarët e tu që t'i shoh!" Pasi vendosi për blerjen e tyre, i tha: "Hajde tek ne kur të vijë shërbëtori ynë më vonë, që të të japim dërhëmët e argjendit." Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte i pranishëm në atë mbledhje dhe e kundërshtoi këtë lloj marrëveshjeje. Ai iu përбетua Talhasë që t'ia jepte argjendin menjëherë ose t'ia kthente arin që kishte marrë prej tij, si dhe ia shpjegoi arsyen, duke thënë se i Dërguari i Allahut ﷺ kishte thënë që shkëmbimi i argjendit me ar, ose anasjelltas, duhet të kryhet dorë më dorë dhe menjëherë, përndryshe, një marrëveshje e tillë konsiderohet si kamatë e ndaluar dhe tregti e pavlefshme. Ai sqaroi më tej se ari nuk duhet të shitet për argjend, as argjendi për ar, përveçse dorë më dorë, dhe duke marrë menjëherë të dyja palët atë që shkëmbejnë. Po ashtu, nuk lejohet të shitet gruri me grurë, elbi me elb, apo hurmat me hurma, përveçse në mënyrë të barabartë, peshë për peshë, sasi për sasi, e dorë më dorë. Gjithashtu, nuk lejohet që këto të shkëmbehen, duke marrë diçka tani, për t'i dozëzuar diçka me vonesë, as të ndahen palët para se të dorëzohet malli i shkëmbyer

Mësime nga hadithi:

1. Kategoritë e përmendura në këtë hadith janë pesë: ari, argjendi, gruri, elbi dhe hurmat. Nëse tregtia

- ndodh brenda të njëjtës kategori, duhet të përmbushen dy kushte që të jetë e vlefshme. Marrja e dorëzimi në të njëjtin vend të aktmarrëveshjes dhe barazia në peshë, si në rastin e shkëmbimit të arit me ar. Përndryshe, kjo konsiderohet kamatë e shtesës (ar. riba el-fadl). Ndërsa, nëse kategoritë janë të ndryshme, si për shembull argjendi me grurë, atëherë kërkohet vetëm një kusht për vlefshmërinë e aktmarrëveshjes: marrja e dorëzimi i çmimit në vendin e aktmarrëveshjes. Përndryshe, kjo konsiderohet kamatë e vonesës (ar. riba en-nesie).
2. Me "vendi i kontratës" nënkuptohet vendi ku ndodh shkëmbimi/tregëtia, qoftë kur palët janë ulur, duke ecur, apo duke qenë mbi kafshë ose mjete transporti. Ndërsa me "ndarje" nënkuptohet çdo largim që, sipas zakonisht të njerëzve, konsiderohet si ndarje.
 3. Ndalimi në hadith përfshin të gjitha llojet e arit, qofshin të shndërruara (në monedha) apo jo, si dhe të gjitha llojet e argjendit, qofshin të shndërruara apo jo.
 4. Monedhat bashkëkohore duhet të trajtohen sipas rregullave të shkëmbimit të arit me argjend. Pra, nëse dëshiron të shkëmbesh një monedhë me një tjetër, si për shembull rijal (saudit) me euro, lejohet të ketë dallim në vlerë sipas marrëveshjes së palëve,

por është e domosdoshme që marrja e dorëzimit të bëhet në vendin e shitjes. Përndryshe, marrëveshja bëhet e pavlefshme dhe ky transaksion konsiderohet kamatë e ndaluar.

5. Transaksionet kamatore nuk lejohen dhe kontrata e tyre është e pavlefshme, edhe nëse të dy palët bien dakord, sepse Islami ruan të drejtat e individit dhe të shoqërisë, edhe nëse vetë individ i heq dorë prej tyre.
6. Ndalimi i së keqes dhe pengimi i saj për këdo që ka mundësi ta bëjë këtë.
7. Përmendja e argumentit gjatë ndalimit të së keqes, ashtu siç veproi Omer ibën Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

(5889)

(193) - عَنْ ابْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: فَرَضَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ زَكَاةَ الْفِطْرِ صَاعًا مِنْ تَمْرٍ، أَوْ صَاعًا مِنْ شَعِيرٍ، عَلَى الْعَبْدِ وَالْحُرِّ، وَالذَّكَرِ وَالْأُنْثَى، وَالصَّغِيرِ وَالْكَبِيرِ مِنَ الْمُسْلِمِينَ، وَأَمَرَ بِهَا أَنْ تُؤَدَّى قَبْلَ خُرُوجِ النَّاسِ إِلَى الصَّلَاةِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(193) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ e ka obliguar sadakanë e fitrit: një saë me hurma ose elb, për muslimanin, qoftë rob a i lirë, mashkull a femër, i vogël a i madh, si dhe ka urdhëruar

që të jepet para se njerëzit të dalin për namaz (të Bajramit).”

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e bëri obligim sadakanë e fitrit pas Ramazanit. Sasia e tij është një saë, që i barazohet katër muddëve në peshë. Një mudd është sa dy grushte të mbushura të një personi mesatar me hurma apo elb, dhe është obligim për çdo musliman, qofshin të lirë apo robër, meshkuj apo femra, të vegjël apo të rritur. Kjo vlen për atë që ka mjaftueshëm mbi nevojat e ditës dhe natës për veten dhe për ata që përkujdeset. Profeti ﷺ urdhëroi që kjo të jepet para se njerëzit të dalin për faljen e namazit të Bajramit.

Mësime nga hadithi:

1. Sadakaja e fitrit në Ramazan duhet të jepet në emër të të vegjëlve dhe të mëdhenjve, të lirëve dhe robërve. Ajo i besohet kujdestarit dhe zotërisë (pronarit). Burri duhet ta japë atë në emër të vet, fëmijëve të tij dhe atyre që është i obliguar t'i furnizojë.
2. Nuk është obligim të jepet sadakaja e fitrit në emër të fetusit (foshnjës në bark), por është e preferuar.
3. Sqarimi i asaj që duhet të jepet si sadaka e fitrit dhe se ajo është nga ushqimi bazë i zakonshëm i njerëzve.

4. Është obligim që të jepet para namazit të Bajramit, më së miri në mëngjesin e ditës së Bajramit, dhe është e lejuar që të jepet një apo dy ditë para Bajramit.

(4520)

(194) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَلَامٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: لَمَّا قَدِمَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الْمَدِينَةَ انْجَمَلَ النَّاسُ قَبْلَهُ، وَقِيلَ: قَدِمَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَدِمَ رَسُولُ اللَّهِ، قَدِمَ رَسُولُ اللَّهِ، ثَلَاثًا، فَجِئْتُ فِي النَّاسِ لِأَنْظُرَ، فَلَمَّا تَبَيَّنْتُ وَجْهَهُ، عَرَفْتُ أَنَّ وَجْهَهُ لَيْسَ بِوَجْهِ كَذَّابٍ، فَكَانَ أَوَّلُ شَيْءٍ سَمِعْتُهُ تَكَلَّمَ بِهِ أَنْ قَالَ: «يَا أَيُّهَا النَّاسُ، أَفْشُوا السَّلَامَ، وَأَطْعِمُوا الطَّعَامَ، وَصَلُّوا الْأَرْحَامَ، وَصَلُّوا بِاللَّيْلِ وَالنَّاسُ نِيَامٌ، تَدْخُلُوا الْجَنَّةَ بِسَلَامٍ».

[صحيح] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(194) – Abdullah ibën Selami (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rrëfen: "Kur Profeti ﷺ erdhi në Medinë, njerëzit nxituan ta takonin. Njerëzit thoshin: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka ardhur! I Dërguari i Allahut ﷺ ka ardhur! I Dërguari i Allahut ﷺ ka ardhur!" Tri herë. Vajta te njerëzit për ta parë dhe ja, kur pashë qartë fytyrën e tij, e kuptova se fytyra e tij nuk ishte fytyrë gënjeshtari. Gjëja e parë që e dëgjova të thoshte ishte: “O ju njerëz, përhapeni selamin (përsëndetjen islame mes jush), ushqeni të tjerët, mbani lidhjet farefisnore dhe faluni natën kur njerëzit janë në gjumë do të hyni në Xhenet të qetë.” [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ vajtë në Medinë dhe njerëzit e panë, nxituan drejt tij. Prej të tillëve ishte edhe hebreu, Abdullah ibën Selami. Kur e pa, e kuptoi se fytyra e tij nuk ishte fytyrë gënjeshtari, për shkak të dritës, bukurisë dhe dinjitetit të sinqertë që shfaqej. Gjëja e parë që e dëgjoi prej Profetit ﷺ ishte inkurajimi për të vepruar disa vepra, që janë shkak për të hyrë në Xhenet. Prej tyre:

E para: Përhapja e përshëndetjes islame (Es selamu alejkum), shfaqja dhe shtimi i saj sa më shumë ndaj atyre që i njohim dhe nuk i njohim.

E dyta: Ushqimi dhënë të tjerëve, përmes sadakasë, dhuratave dhe mikpritjes.

E treta: Mbajtja e lidhjeve farefisnore me ata që ke lidhje gjaku dhe afërsie, nga ana e babait dhe nënës.

E katërta: Namazi vullnetar, namazi i natës, kur njerëzit janë në gjumë.

Mësime nga hadithi:

1. Është e preferuar që përshëndetja islame të përhapet në mesin e muslimanëve, e, sa u përket jomuslimanëve, atyre nuk u japim selam të parët: nëse na japin duke na thënë: "Es Selam alejkum", ua kthejmë: "Ue alejkum."

(5520)

(195) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَيُّهَا النَّاسُ، إِنَّ اللَّهَ طَيِّبٌ لَا يَقْبَلُ إِلَّا طَيِّبًا، وَإِنَّ اللَّهَ أَمَرَ الْمُؤْمِنِينَ بِمَا أَمَرَ بِهِ الْمُرْسَلِينَ، فَقَالَ: {يَا أَيُّهَا الرُّسُلُ كُلُّوا مِنَ الطَّيِّبَاتِ وَاعْمَلُوا صَالِحًا، إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ} [المؤمنون: 51] وَقَالَ: {يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُلُوا مِنْ طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ} [البقرة: 172] ثُمَّ ذَكَرَ الرَّجُلُ يُطِيلُ السَّفَرَ أَشْعَثَ أَغْبَرَ، يَمُدُّ يَدَيْهِ إِلَى السَّمَاءِ: يَا رَبَّ، يَا رَبَّ، وَمَطْعَمُهُ حَرَامٌ، وَمَشْرَبُهُ حَرَامٌ، وَمَلْبَسُهُ حَرَامٌ، وَغُذِيَ بِالْحَرَامِ، فَأَنَّى يُسْتَجَابُ لِذَلِكَ؟». [صحيح] - [رواه مسلم]

(195) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “O ju njerëz, Allahu është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Allahu i urdhëroi besimtarët për atë që i urdhëroi pejgamberët, duke u thënë: "O të dërguar! Hani nga të mirat dhe punoni vepra të mira! Unë me të vërtetë, e di mirë çka punoni ju!" (El Muminun, 51) Po ashtu ka thënë: "O besimtarë! Hani nga ushqimet e këndshme që jua kemi dhuruar." (El Bekare, 172) Pastaj e përmendi njeriun, i cili është në udhëtim të gjatë, me flokë të shprishur e i pluhurosur, i ngre duart nga qielli: "O Zot! O Zot!" Mirëpo, ushqimin e ka haram, pijen e ka haram, veshjen e ka haram, është ushqyer me haram, e si t'i përgjigjet atij?!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka treguar se Allahu është i pastër dhe i shenjtë, i paprekshëm nga mangësitë dhe të metat dhe se Ai posedon cilësitë e përsosura. Ai pranon

vetëm veprat, fjalët dhe bindjet që janë të pastra, respektivisht që janë të sinqerta për Allahun dhe në përputhje me udhëzimin e Profetit ﷺ. Nuk duhet të afrohemi tek Allahu me diçka tjetër përveç kësaj. Ndër gjërat më të rëndësishme që e bëjnë veprën e një besimtari të mirë është ushqimi i tij i pastër dhe hallall. Kjo bën që vepra e tij të jetë e pranuar. Për këtë arsye, Allahu i ka urdhëruar besimtarët me të njëjtën gjë që ka urdhëruar të dërguarit: për të ngrënë hallall dhe për të bërë vepra të mira. Ai ka thënë: "O të dërguar! Hani nga të mirat dhe punoni vepra të mira! Unë me të vërtetë, e di mirë çka punoni ju!" (El Muminun, 51) Po ashtu ka thënë: "O besimtarë! Hani nga ushqimet e këndshme që jua kemi dhuruar." (El Bekare, 172)

Pastaj, Profeti ﷺ paralajmëroi kundër ngrënies së haramit, e cila e prish veprën dhe pengon pranimin e saj, sado që të përpiqet njeriu të plotësojë shkaqet e dukshme për pranimin e veprës, siç janë:

Së pari: udhëtimi i gjatë për akte adhurimi, si: haxhillëku, xhihadi, mbajtja e lidhjeve fafeshnore dhe të tjera të ngjashme.

Së dyti: flokët e shprishur nga moskrehja, ndryshimi i ngjyrës së tij dhe i rrobave të tij nga pluhuri, pra, ai gjendet në një situatë të rënduar dhe të mjeruar.

Së treti: ngre duart drejt qiellit duke bërë lutje.

Së katërti: i drejtohet Allahut duke e lutur përmes emrave të Tij dhe ngulmon në këtë: "O Zot! O Zot!"

Megjithëse i ka plotësuar këto shkaqe për pranimin e lutjes, lutja e tij nuk merr përgjigje. Kjo, sepse ushqimi, pija dhe veshja e tij ishin nga harami, si dhe ishte ushqyer me

haram. Prandaj, është e largët që t'i pranohet lutja dikujt që është në këtë gjendje. E si mund t'i pranohet?!

Mësime nga hadithi:

1. Allahut i Lartësuar është i përsosur në Qenien - Vetën e Tij, cilësitë, veprimet dhe në gjykimet e Tij.
2. Urdhri për ta bërë veprën singerisht për Allahun e Lartmadhëruar dhe për ta ndjekur Profetin ﷺ.
3. Përdorimi i shprehjeve që nxisin për veprim, pasi Profeti ﷺ ka thënë: "Allahu i urdhëroi besimtarët për atë që i urdhëroi pejgamberët." Kur besimtari e di se kjo është nga gjërat që u janë urdhëruar të dërguarve, ai motivohet dhe nxitet për t'iu bindur Allahut të Lartësuar.
4. Prej pengesave të pranimit të lutjes është ngrënia e haramit.
5. Prej shkaqeve të pranimit të lutjes janë pesë gjëra:
 1. Udhëtimi i gjatë, i cili bën që njeriu të jetë i përulur, e që është një nga shkaqet më të mëdha të pranimit të lutjes,
 2. Gjendja e vështirë,
 3. Ngritja e duarve drejt qiellit,
 4. Lutja drejtuar Allahut me ngulm, duke e përmendur vazhdimisht frazën: "O Zot!", që është një nga shkaqet më të fuqishme për pranimin e lutjes,
 5. Ngrënia dhe pirja e produkteve të pastra.

6. Ngrënia e ushqimit hallall dhe të pastër është një nga shkaqet që ndihmojnë në kryerjen e veprave të mira.
7. Kadi Ijadi ka thënë: "Fjala: "Tajjib" (i pastër - i mirë) është antonim i fjalës "Habith" (i pistë-i lig), prandaj, kur i atribuohet Allahut të Madhëruar, do të thotë se Ai është i pastër nga mangësitë dhe i shenjtëruar nga ligësitë. Kur një gjë e tillë i atribuohet njeriut, do të thotë se ai nuk ka moral të keq apo vese të shëmtuara, dhe se posedon të kundërtën e kësaj domethënë moral të mirë dhe virtyte të larta. E kur i atribuohet pasurisë, nënkuptohet se ajo është hallall dhe prej pasurive më të mira."

(4316)

(196) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ أَنْظَرَ مُعْسِرًا، أَوْ وَصَعَ لَهُ، أَظْلَلَهُ اللَّهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ تَحْتَ ظِلِّ عَرْشِهِ يَوْمَ لَا ظِلَّ إِلَّا ظِلُّهُ». [صحيح] - [رواه الترمذي وأحمد]

(196) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atë që e afatizon borxhliun ose ia fal, Allahu do ta strehojë nën hijen e Arshit (Fronit) të Tij në Ditën e Kiametit, atë Ditë kur s'do të ketë hije tjetër pos kësaj hijeje." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na lajmëroi se atë që e afatizon borxhliun ose ia fal, shpërbimi i tij do të jetë se Allahu do ta strehojë nën hijen e Arshit (Fronit) të Tij në Ditën e Kiametit, në të cilën Dielli u afrohet robërve dhe nxehësia e tij shtohet. Së këndejmi, askush nuk do të gjejë asnjë hije, pos hijes në të cilën do t'i strehojë Allahu.

Mësimet nga hadithi:

1. Vlera e lehtësimit ndaj robërve të Allahut të Lartësuar dhe se kjo është një nga shkaqet e shpëtimit nga tmerret e Ditës së Kiametit.
2. Shpërblimi është sipas llojit të veprës.

(4186)

(197) – عن جابر رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «رَجِمَ

الله رجلاً سَمَحًا إِذَا بَاعَ، وَإِذَا اشْتَرَى، وَإِذَا اقْتَضَى». [صحيح] - [رواه البخاري]

(197) – Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu e mëshiroftë atë burrë që tregon tolerancë e mirësjellje kur shet e blen, si dhe kur e merr borxhin e dhënë!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ bëri lutje për mëshirë për këdo që tregohet i lehtë, bujar e zemërgjerë në shitjen e tij, meqë nuk ia

vështirëson çmimin blerësit dhe e trajton atë njerëzishëm. Pra, i tilli tregohet i lehtë, bujar e zemërgjerë: nuk e nënvlerëson e as ul vlerën e artikullit. Tregohet i lehtë, bujar dhe zemërgjerë kur ta kërkojë borxhin që ia kanë të tjerët, pra, nuk tregohet i ashpër ndaj të varfrit e nevojtarit, por ia kërkon me butësi e dashamirësi dhe e afatizon huamarrësin.

Mësime nga hadithi:

1. Prej objektivave të ligjit islam është ruajtja e gjërave që i përmirësojnë marrëdhëniet mes njerëzve.
2. Nxitja për të pasur moral të lartë në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, si: shitblerja e të ngjashme.

(3716)

(198) – عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «كان رجلٌ يُدَايِنُ النَّاسَ، فكان يقول لفتاه: إِذَا أَتَيْتَ مُعْسِرًا فَتَجَاوَزْ عَنْهُ، لَعَلَّ اللَّهَ يَتَجَاوَزُ عَنْكَ، فَلَقِيَ اللَّهَ فَتَجَاوَزَ عَنْهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(198) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Një burrë u jepte borxh njerëzve dhe i thoshte shërbëtorit të vet: "Kur të shkosh te ndonjë huamarrës, toleroje, me shpresë që edhe Allahu të na tolerojë ne." Kështu, kur e takoi Allahun, Allahu e fali.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon për një burrë që njerëzve u jepte borxh ose i shiste me pritje. Ai i thoshte shërbëtorit të vet, i cili ua kërkonte njerëve borxhin e marrë: "Nëse shkon te ndonjë huamarrës e nuk ka asgjë për të shlyer borxhin që ka, për shkak të pamundësisë së tij, atëherë toleroje, ose duke ia shtyrë afatin dhe duke mos këmbëngulur duke ia kërkuar, ose duke ia pranuar atë që e ka, edhe nëse ka më pak se ajo që kërkohet." Kjo, duke shpresuar dhe dëshiruar që Allahu ta tolerojë e ta falë. E, kur vdiq, Allahu e fali dhe nuk e ndëshkoi për gjynahet e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Mirësia në raport me marrëdhëniet me njerëzit, falja e tyre dhe tolerimi i huamarrësit janë ndër arsytet më të mëdha për të shpëtuar robë në Ditën e Kiametit.
2. Mirësia ndaj krijesave, sinqeriteti ndaj Allahut dhe shpresa në mëshirën e Tij janë ndër arsytet e faljes së gjynaheve.

(3753)

(199) - عن حَوَلة الأنصارية رضي الله عنها قالت: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول: «إِنَّ رَجُلًا يَتَحَوَّضُونَ فِي مَالِ اللَّهِ بِغَيْرِ حَقٍّ، فَلَهُمُ النَّارُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(199) – Havle Ensarija (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Disa njerëz po zhyten në pasurinë e Allahut padrejtësisht. Ditën e Kiametit, të tillët i pret Zjarri.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ lajmëroi për disa njerëz që i përdorin pasuritë e muslimanëve padrejtësisht dhe i marrin ato pa hak. Ky është një kuptim i përgjithshëm i pasurisë, për sa i përket grumbullimit dhe fitimit të saj në mënyrë të paligjshme dhe shpenzimit të saj në vende të gabuara. Këtu përfshihet ngrënia e pasurisë së jetimëve dhe pasurisë së institucionit të vakëfit. Gjithashtu përfshihet mohimi i amaneteve dhe marrja padrejtësisht nga fondet publike.

Më pas Profeti ﷺ lajmëroi se të tillët do të dënohen me zjarr në Ditën e Kiametit.

Mësim nga hadithi:

1. Pasuria që është në duart e njerëzve është pasuri e Allahut. Ai i ka caktuar ata për ta shpenzuar në mënyra të ligjshme dhe për të shmangur përdorimin e saj në mënyrë të paligjshme. Ky është i

përgjithshëm (si vendim), për udhëheqësit dhe për njerëzit e tjerë.

2. Feja është treguar rigorozë në lidhje me pasuritë publike dhe se kujtdo që i besohet ndonjë prej tyre do të japë llogari në Ditën e Kiametit për mbledhjen dhe shpenzimin e tyre.
3. Ky kërcënim i përfshin ata që e përdorin pasurinë në mënyrë të paligjshme, qoftë e tyre, qoftë e dikujt tjetër.

(5331)

(200) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «قَالَ اللَّهُ: كُلُّ عَمَلِ ابْنِ آدَمَ لَهُ، إِلَّا الصَّيَّامَ، فَإِنَّهُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ، وَالصَّيَّامُ جُنَّةٌ، وَإِذَا كَانَ يَوْمُ صَوْمِ أَحَدِكُمْ فَلَا يَرَفُثُ وَلَا يَصْحَبُ، فَإِنْ سَابَهُ أَحَدٌ أَوْ قَاتَلَهُ، فَلْيُقِلْ إِيَّيَ أَمْرُ صَائِمٍ، وَالَّذِي نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ، لَخُلُوفُ فَمِ الصَّائِمِ أَطْيَبُ عِنْدَ اللَّهِ مِنْ رِيحِ الْمِسْكِ، لِلصَّائِمِ فَرْحَتَانِ يَفْرَحُهُمَا: إِذَا أَفْطَرَ فَرِحَ، وَإِذَا لَقِيَ رَبَّهُ فَرِحَ بِصَوْمِهِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(200) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu thotë: "Çdo vepër e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë, andaj, ditën që dikush agjëron, të mos thotë fjalë të ndyta e as të mos bërtasë. Nëse dikush e shan ose e sulmon, le të thotë: "Unë jam agjërues!" Beto hem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se era e gojës së

agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa era e myshkut. Agjëruesi i ka dy gëzime që i përjeton: gëzohet kur të bëjë iftar dhe gëzohet kur ta takojë Zotin për agjërimin e tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se Allahu i Lartësuar në hadith kudsij thotë:

"Çdo vepër e birit të Ademit shumëfishohet: një e mirë shpërblehet dhjetëfish deri në shtatëqindfish, përveç agjërimit: ai është vetëm për Mua, pasi në të nuk ka hipokrizi, dhe Unë jam që shpërblej për të, duke e veçuar vetëm për Vete dijen për masën e shpërblimit dhe shumëfishimin e të mirave të tij."

Pastaj tha: "agjërimi është mburojë" dhe mbrojtje, mbulesë dhe kështjellë e fortifikuar nga Zjarri, sepse është largimi nga dëshirat epshore dhe kryerja e mëkateve, kurse Zjarri është i rrethuar me dëshira epshore.

"andaj, ditën që dikush agjëron, të mos thotë fjalë të ndyta" rreth marrëdhënieve intime dhe gjërave që i paraprijnë asaj, e as të mos flasë në mënyrë absolute asnjë fjalë të turpshme.

"e të mos bërtasë", duke u zënë me të tjerët dhe duke bërë piskamë.

"Nëse dikush e shan ose e sulmon", në Ramazan, le të thotë: "Unë jam agjërues!", ndoshta kjo do ta ndalojë atë. Por, nëse ai këmbëngul dhe nuk ndalet përveçse duke sulmuar seriozisht, atëherë (duhet) ta zmbrapsë me mjetin

më të lehtë dhe më të butë, siç do të veprohej kundrejt një sulmuesi.

Pastaj, Profeti ﷺ u betua në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i tij, se ndryshimi i erës së gojës së agjëruesit për shkak të agjërimit është më i këndshëm për Allahun në Ditën e Gjykimit sesa era e myshkut te ju dhe është më i shpërblyer sesa përdorimi i myshkut që rekomandohet për ditën e xhuma dhe për tubimet e diturisë, ku përmendet Allahu.

Agjëruesi ka dy gëzime që i përjeton: kur të bëjë iftar, gëzohet për iftarin e tij, për shkak të largimit të urisë dhe etjes, pasi i është lejuar të prishë agjërimin, si dhe gëzohet për përfundimin e agjërimit dhe mbylljen e adhurimit, për lehtësimin që Zoti ia dha dhe për ndihmën për agjërimet e ardhshme.

"dhe gëzohet kur ta takojë Zotin për agjërimin e tij", për shkak të shpërblimit dhe sevapeve që do t'i marrë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e agjërimit është se ai e ruan agjëruesin në këtë botë nga dëshirat epshore dhe në botën tjetër nga dënimi i Zjarrit.
2. Nga normat dhe edukata e agjërimit është të shmangësh fjalët e ndyra e të kota, të durosh ndaj lëndimeve që t'i shkaktojnë njerëzit dhe t'u përgjigjesh sjelljeve të tyre të këqija me durim e mirësi.

3. Agjëruesi ose adhuruesi, nëse gëzohen për shkak të përfundimit të adhurimit të tyre dhe përmbylljes së tij, kjo nuk ua pakëson shpërblimin në botën tjetër.
4. Gëzimi i plotë është në takimin me Allahun e Lartësuar, ku durimtarëve dhe agjëruesit do t'u japë shpërblime pa masë.
5. Njoftimi i njerëzve për një adhurim, kur ka nevojë dhe dobi, nuk konsiderohet si hipokrizi, duke u mbështetur në fjalën e tij ﷺ: "Unë jam agjërues!"
6. Agjëruesi që ka agjërime të përsosur është ai që i kanë agjëruar gjymtyrët nga mëkatet, gjuha nga gënjeshtria, fjalët e ndyra dhe dëshmia e rreme, si dhe stomaku nga ushqimi dhe pija.
7. Gjatë agjërimit, ndalimi i zhurmës, grindjeve dhe piskamave është më i ndaluar, përndryshe, ai që nuk është agjërues, gjithashtu ndalohet nga këto veprime.
8. Ky hadith është nga ato që Profeti ﷺ i transmeton nga Zoti i tij dhe quhet hadith i shenjtë (ar. kudsij) ose hyjnor, që shprehja dhe kuptimi i tij janë nga Allahu, vetëm se nuk i ka karakteristikat e Kuranit, që e dallojnë atë nga çdo gjë tjetër, si: të bërët adhurim me leximin e tij, të qenët i pastër gjatë leximit, sfidimi (që të sjellin një të ngjashëm me të), paimitueshmëria etj.

(201) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم:
«مَنْ صَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ» [صحيح] - [متفق عليه]

(201) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atij që agjëron Ramazanin duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se atij që e agjëron muajin Ramazan duke besuar në Allahun dhe duke qenë i binduar se agjërimi është obligim, si dhe është i binduar në shpërblimin e madh që Allahu i Lartësuar e ka përgatitur për agjëruarit, duke synuar kështu fytyrën e Tij, e jo syfaqësi e reputacion, do t'i falen gjynahet e së kaluarës.

Mësim nga hadithi:

1. Vlera dhe rëndësia e sinjeritetit gjatë agjërimit të Ramazanit dhe veprave të tjera të mira.

(4196)

(202) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ نَسِيَ وَهُوَ صَائِمٌ، فَأَكَلَ أَوْ شَرِبَ، فَلَيْتَمَ صَوْمُهُ، فَإِنَّمَا أَطْعَمَهُ اللَّهُ وَسَقَاهُ.» [صحيح] - [متفق عليه]

(202) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kush harron se është agjërueshëm, pastaj ha ose pi, le ta plotësojë agjërimin, se Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se kushdo që ha ose pi pa qëllim (nga harresa) gjatë agjërimit, qoftë ai agjërim obligativ apo vullnetar, duhet ta plotësojë agjërimin dhe të mos e ndërpresë atë, sepse nuk e kishte për qëllim ta prishte agjërimin; përkundrazi, ai është furnizim që Allahu ia ka dhënë. Pra, Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë.

Mësim nga hadithi:

1. Vlefshmëria e agjërimit të atij që ha ose pi nga harresa.
2. Kushdo që ha ose pi nga harresa nuk bart mëkat, sepse ai nuk e bën këtë me dëshirën e tij.
3. Butësia e Allahut ndaj robërve të Tij dhe mënyra se si Ai ua lehtëson çështjet atyre dhe ua largon vështirësitë e pengesat.

4. Agjëruesi nuk e prish agjërimin me asnjë nga gjërat që e prishin atë, përveçse nëse plotësohen tre kushte:
5. 1. Të jetë i vetëdijshëm; nëse është i paditur (i painformuar), agjërimi nuk i priset.
6. 2. Të kujtojë; nëse është harrestar, agjërimi i tij është i vlefshëm dhe nuk ka nevojë ta kompensojë.
7. 3. Të jetë me dëshirë dhe jo i detyruar, që do të thotë ta marrë gjënë që e prish agjërimin me vullnetin e tij.

(4525)

(203) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا زَوْجَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَعْتَكِفُ الْعَشْرَ الْأَوَّلَ مِنْ رَمَضَانَ، حَتَّى تَوَفَّاهُ اللَّهُ، ثُمَّ اعْتَكَفَ أَزْوَاجُهُ مِنْ بَعْدِهِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(203) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), nëna e besimtarëve, gruaja e Profetit ﷺ tregon: “Profeti ﷺ hynte në itikaf në dhjetëshen e fundit të Ramazanit derisa vdiq. Pastaj gratë e tij vazhduan të hyjnë në itikaf pas tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka treguar se Profeti ﷺ e praktikonte itikafin gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit në kërkim të Natës së Kadrit.

Ai vazhdoi ta bënte këtë, derisa ndërroi jetë. Pas vdekjes së tij, edhe gratë e tij (Allahu qoftë i kënaqur me to!) vazhduan ta praktikojnë itikafin.

Mësim nga hadithi:

1. Lejueshmëria e praktikimit të itikafit në xhami, madje edhe për gratë, me kusht që t'u përmbahen rregullave të fesë dhe të jenë të sigurta nga sprovat (fitnet).
2. Itikafi është më i theksuar gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit, ngase Profeti ﷺ e praktikonte atë rregullisht.
3. Itikafi është një Sunet i vazhdueshëm, që nuk është shfuqizuar, pasi gratë e Profetit ﷺ e kanë praktikuar itikafin edhe pas vdekjes së tij.

(4495)

(204) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ

وَسَلَّمَ يَجْتَهِدُ فِي الْعَشْرِ الْأَوَاخِرِ مَا لَا يَجْتَهِدُ فِي غَيْرِهِ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(204) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon "I Dërguari i Allahut ﷺ angazhohej me (adhurim) në dhjetëshen e fundit (të Ramazanit), aq sa nuk angazhohej jashtë tyre." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Kur hynin dhjetë netët e fundit të Ramazanit, Profeti ﷺ angazhohej me përkushtim në adhurim dhe bindje ndaj Allahut. Ai shtonte përpjekjet në kryerjen e veprave të mira, llojeve të ndryshme të bamirësisë dhe akteve të adhurimit, më shumë se në çdo kohë tjetër, për shkak të madhështisë dhe vlerës së këtyre netëve dhe në kërkim të Natës së Kadrit.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për shtimin e devotshmërisë dhe llojeve të ndryshme të adhurimeve në mënyrë të përgjithshme gjatë muajit Ramazan dhe veçanërisht gjatë dhjetë netëve të tij të fundit.
2. Dhjetë netët e fundit të Ramazanit fillojnë nga nata e njëzetënjëtë deri në fund të muajit.
3. Është e preferuar të shfrytëzohen kohët me vlerë, duke u angazhuar në adhurime.

(3755)

(205) – عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا دَخَلَ الْعَشْرُ أَحْيَا اللَّيْلَ، وَأَيْقَظَ أَهْلَهُ، وَجَدَّ وَشَدَّ الْمِئْزَرَ. [صحيح] - [متفق عليه]

(205) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Kur hynte dhjetëshja (e fundit e Ramazanit), i Dërguari i Allahut ﷺ e gjallëronte natën (me adhurim), e zgjonte familjen e tij,

e shtonte angazhimin dhe i shtrëngonte rrobat (veçohej me adhurime dhe nuk u afrohej grave).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Me fillimin e dhjetë netëve të fundit të Ramazanit, Profeti ﷺ e gjallëronte tërë natën me adhurime të ndryshme. Ai e zgjonte familjen për t’u falur, përpiquej më shumë në adhurim sesa zakonisht dhe i përkushtohej plotësisht adhurimit, duke u larguar nga marrëdhëniet intime me gratë e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të shfrytëzuar kohët me vlerë për kryerjen e veprave të mira.
2. Neveviu ka thënë: "Siç kuptohet qartë nga ky hadith, është e pëlqyeshme të shtohen adhurimet në dhjetëshen e fundit të Ramazanit dhe është e pëlqyeshme të gjallërohen këto net me adhurim.
3. Njeriu duhet të kujdeset për familjen e tij, duke i urdhëruar ata të bëjnë adhurim dhe të jetë i durueshëm me ta.
4. Kryerja e veprave të mira kërkon vendosmëri, durim dhe këmbëngulje.
5. Neveviu ka thënë: "Dijetarët kanë pasur mendime të ndryshme rreth kuptimit të shprehjes “i shtrëngonte rripat”. Është thënë: nënkupton se

Profeti ﷺ e shtonte përpjekjen në adhurim më shumë se zakonisht në kohë të tjera, pra, tregohej i kujdesshëm dhe i përkushtuar në adhurim. Shprehja “e shtrëngova rrobën time të poshtme për këtë çështje” do të thotë: “jam tërësisht i përkushtuar dhe ia kushtoj gjithë kohën time.” Gjithashtu është thënë: “është metaforë për largimin nga gratë, për t’u përqendruar në adhurim.”

(4944)

(206) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ صَامَ يَوْمًا فِي سَبِيلِ اللَّهِ بَاعَدَ اللَّهُ وَجْهَهُ عَنِ النَّارِ سَبْعِينَ خَرِيفًا». [صحيح] - [متفق عليه]

(206) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Atij që agjëron një ditë në rrugën e Allahut, Allahu do t’ia largojë fytyrën nga Zjarri për shtatëdhjetë vjet (vjeshta).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se kush agjëron një ditë në xhihad (dhe është thënë: në xhihad apo edhe jashtë tij) sinjerisht për hir të Allahut, duke kërkuar shpërblim dhe mirësi prej Tij, atëherë, me mirësinë e Tij, Allahu do ta largojë atë nga Zjarri për shtatëdhjetë vjet.

Mësime nga hadithi:

1. Neveviu ka thënë: "Vlera e agjërimit në rrugë të Allahut, vlen për atë që nuk dëmtohet nga agjërimi, nuk neglizhon ndonjë të drejtë për shkak të tij dhe nuk pengohet në luftim apo në përmbushjen e detyrave të luftës së tij."
2. Nxitja dhe motivimi për agjërimin vullnetar.
3. Është obligim që agjërimi të bëhet sinqerisht për hir të Allahut dhe në kërkim të kënaqësisë së Tij, e jo për syfaqësi, përfitim të reputacionit të mirë apo ndonjë qëllim tjetër.
4. Sindiu ka thënë: "Fjala e Profetit ﷺ "në rrugë të Allahut - fi sebilil-lah", mund të nënkuptojë thjesht të pasurit një qëllim të sinqertë (duke e bërë veprën vetëm për Të), ose se agjërimin e ka bërë ndërkohë që ka qenë luftëtar në betejë. Kuptimi i dytë është ai më i qarti."
5. Ibën Haxheri ka thënë: "Fjala e Profetit ﷺ shtatëdhjetë vjeshta" i referohet vjeshtës si një periudhë e caktuar e vitit, por këtu nënkupton vitin. Vjeshta është përmendur në vend të stinëve të tjera: verës, dimrit dhe pranverës; sepse ajo është stina më e frytshme, ngase është koha kur mblidhen frutat."

(207) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: أَوْصَانِي خَلِيلِي صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ بِثَلَاثٍ: صِيَامٍ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ، وَرُكْعَتَيْنِ الضُّحَى، وَأَنْ أُوتِرَ قَبْلَ أَنْ أَنْامَ. [صحيح] - [متفق عليه]

(207) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "I dashuri im ﷺ më ka porositur me tri gjëra: Agjërimin e tri ditëve të çdo muaji, faljen e dy rekateve të duhasë dhe faljen e vitrit para gjumit." [Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i dashuri dhe shoku i tij, Profeti ﷺ, e këshilloi dhe i la amanet tri gjëra:

E para: Agjërimin e tri ditëve të çdo muaji (hënor).

E dyta: Faljen e dy rekateve të namazit të duhasë çdo ditë.

E treta: Falja e vitrit para gjumit, për atë i cili frikësohet se nuk mund të zgjohet në fund të natës.

Mësime nga hadithi:

1. Meqë këshillat e porositë e Profetit ﷺ drejtuar sahabëve ishin të ndryshme, kjo bazohej në dijen e tij ﷺ mbi gjendjet dhe rrethanat e sahabëve dhe në atë që i përshtatej secilit prej tyre. Për të fortin ishte i përshtatshëm xhihadi, për adhuresin ishte i përshtatshëm adhurimi, për dijetarin ishte e përshtatshme dija, e kështu me radhë.

2. Ibën Haxher Askalaniu, rreth fjalës profetike: "Agjërimin e tri ditëve të çdo muaji", shprehet: "Në aspektin e jashtëm, duket se për qëllim janë tri ditët e bardha, të cilat janë: dita e trembëdhjetë, e katërbëdhjetë dhe e pesëmbëdhjetë e muajit hixhri (hënor)."
3. Ibën Haxher Askalaniu ka thënë: "Nga ky hadith përfitojmë se është e preferuar falja e vitrit para gjumit. Kjo vlen për atë që nuk është i sigurt se do të zgjohet."
4. Rëndësia e këtyre tri veprave qëndron në faktin se Profeti ﷺ i ka këshilluar disa prej sahabëve të tij me to.
5. Ibën Dekik Idi, rreth fjalës profetike: "... faljen e dy rekateve të duhasë," është shprehur: "Ndoshta e ka përmendur minimumin që mjafton për të përmbushur kryerjen e saj. Gjithashtu kjo tregon se falja e namazit të duhasë është e pëlqyer, dhe se më e pakta për këtë është dy rekate."
6. Koha e namazit të duhasë fillon rreth një çerek ore pas lindjes së diellit dhe zgjat afërsisht dhjetë minuta para namazit të drekës. Sa i përket numrit të rekateve, minimumi i tyre është dy rekate, ndërsa për maksimumin ka mendime të ndryshme: disa thonë se janë tetë rekate, ndërsa të tjerë thonë se nuk ka kufi për numrin maksimal.

7. Koha e vitrit fillon pas namazit të jacisë dhe zgjat deri në agim. Minimumi i tij është një rekat, ndërsa maksimumi njëmbëdhjetë rekate.

(4538)

(208) – عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ:

«تَسَحَّرُوا، فَإِنَّ فِي السَّحُورِ بَرَكََةً». [صحيح] - [متفق عليه]

(208) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Hani syfyr, sepse në syfyr ka bereqet.”
[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e ka inkurajuar ngrënien e syfyr, që është ushqimi në pjesën e fundit të natës si përgatitje për agjërimin (gjatë ditës), sepse ai përmban bereqet, domethënë shumë mirësi në shpërbllim dhe sevape, zgjim në pjesën e fundit të natës për lutje, forcim për agjërim, energji për ta përballuar atë dhe lehtësim të vështirësisë së tij.

Mësime nga hadithi:

1. Ngrënia e syfyr është e preferuar dhe është jetësim i urdhrit (të rekomanduar) fetar për ta vepruar.
2. Ibën Haxheri ka thënë në “Fet'hul Bari”: “Bereqeti në syfyr arrihet në shumë mënyra: duke ndjekur Sunetin, duke u dalluar nga ehli kitabi (hebrenjtë dhe të krishterët), duke fituar forcë për adhurim,

duke shtuar energjinë, duke larguar sjelljet e këqija, që mund t'i shkaktojë uria, duke dhënë mundësi për bamirësi ndaj atyre që kërkojnë apo që bashkohen në ushqim, duke nxitur përmendjen e Allahut (dhikrin) dhe lutjen në një kohë kur pritet pranimi i tyre, si dhe duke dhënë mundësinë për të korrigjuar nijetin për agjërime për ata që mund ta kenë harruar para gjumit.”

3. Metoda e mirë mësimore e Profetit ﷺ, e cila shfaqet në bashkimin e dispozitës me arsyen përkatëse, për ta qetësuar dëgjuesin dhe për ta bërë të njohur madhështinë e fesë.
4. Ibën Haxheri ka thënë: "Syfyri plotësohet edhe me sasinë më të vogël të ushqimit apo pijes që njeriu konsumon."

(4498)

(209) - عَنْ أَبِي عُبَيْدٍ، مَوْلَى ابْنِ أَزْهَرَ، قَالَ: شَهِدْتُ الْعِيدَ مَعَ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، فَقَالَ: هَذَانِ يَوْمَانِ نَهَى رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ صِيَامِهِمَا: يَوْمُ فِطْرِكُمْ مِنْ صِيَامِكُمْ، وَالْيَوْمُ الْآخَرُ تَأْكُلُونَ فِيهِ مِنْ نُسُكِكُمْ. [صحيح] - [متفق عليه]

(209) – Ebu Ubejdi, i çrobëruari i Ibën Ez'herit, ka thënë: “Në namazin e Bajramit isha i pranishëm tek Omer ibën Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili tha: “I Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar agjërimin e këtyre dy ditëve: ditën

kur e përfundoni agjërimin tuaj (dita e Bajramit të Fitrit) dhe ditën kur hani prej kurbaneve (dita e Bajramit të Kurbanit).”

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e ndaloi agjërimin në ditët e Bajramit të Fitrit dhe të Kurbanit. Sa i përket Bajramit të Fitrit, ajo është dita e prishjes së agjërimit pas muajit Ramazan, ndërsa sa i përket ditës së Bajramit të Kurbanit, ajo është dita e ngrënies nga kurbanët.

Mësime nga hadithi:

1. Është e ndaluar të agjërohet në ditët e Bajramit të Fitrit, Bajramit të Kurbanit dhe në ditët e Teshrikut (tri ditët pas ditës së parë të Bajramit të Kurbanit), pasi ato janë të lidhura me ditën e Bajramit të Kurbanit, përveç atij që nuk ka kafshë për kurban, atij i lejohet të agjërojë në ditët e Teshrikut (teksta është në haxh).
2. Ibën Haxheri ka thënë: "Thuhet se dobia e përshkrimit të këtyre dy ditëve është të tregojë shkakun pse është i obliguar mosagjërimi i tyre. Pra, të bëhet ndarje mes agjërimit dhe Bajramit dhe të shfaqet plotësimi i agjërimit përmes mosagjërimit pas Ramazanit. Ndërsa tjetri për shkak të kurbanit, me të cilin synohet afrimi tek Allahu përmes therjes së tij, me qëllim të ngrënies prej tij."

3. Pëlqehet që ligjëruesi (hatibi) të përmendë në hutben e tij ato që kanë lidhje me kohën aktuale në aspektin e dispozitave dhe të jetë i kujdesshëm ndaj sezonave të adhurimeve.
4. Lejueshmëria e ngrënies nga kurbanit.

(4527)

(210) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ يَقُمْ لَيْلَةَ الْقَدْرِ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ» [صحيح] - [متفق عليه]

(210) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon për vlerën e Natës së Kadrit, e cila ndodhet në dhjetëshen e fundit të Ramazanit, dhe se ai që tregohet i zellshëm gjatë saj me namaz, lutje, lexim të Kuranit dhe dhikër (përmendje të Allahut), duke besuar në të dhe në atë që përmendet rreth vlerës së saj, si dhe duke shpresuar që përmes veprës së tij ta arrijë shpërblimin e Allahut të Lartësuar, e jo syfaqësi e reputacion, do t'i falen mëkatet e së kaluarës.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e Natës së Kadrit dhe inkurajimi për ta gjallëruar me adhurim.
2. Veprat e mira pranohen vetëm nëse qëllimi është i singertë.
3. Mirësia dhe mëshira e Allahut, meqë atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen gjynahet e kaluara.

(4202)

(211) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول: «مَنْ حَجَّ لِلَّهِ فَلَمْ يَرْفُثْ وَلَمْ يَفْسُقْ رَجَعَ كَيَوْمَ وَلَدَتْهُ أُمُّهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(211) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Ai që e kryen haxhillëkun në Qabe, duke u larguar nga çdo veprim intim bashkëshortor dhe pa mëkatuar, kthehet sikurse ditën që e ka lindur nëna.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se ai që e kryen haxhillëkun për hir të Allahut të Lartësuar dhe nuk bën (ar.) rafeth, respektivisht nuk bën marrëdhënie intime e as gjërat që i nxisin ato, si: puthja dhe prekja (me epsh), gjithashtu kjo fjalë (ar. rafeth) nënkupton fjalët e turpshme, si dhe nuk

bën (ar.) fusuk, që nënkupton se nuk bën mëkate e vepra të këqija, ndërkohë (ar.) fusuk është edhe veprimi i gjërave të ndaluara gjatë ihramit, kështu që i tilli kthehet me mëkate të falura, ashtu siç lind fëmija i pastër nga mëkatet.

Mësimet nga hadithi:

1. Shkelja e dispozitave fetare (ar. fusuk) është e ndaluar në çdo moment dhe gjendje, mirëpo gjatë kryerjes së haxhillëkut është më e ndaluar, si respekt për ritualet e haxhillëkut.
2. Njeriu lind pa mëkate, i liruar nga ato dhe nuk e mbart mëkatën e të tjerëve.

(2758)

(212) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: أَنَّ تَلْبِيَةَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ، لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ» قَالَ: وَكَانَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا يَزِيدُ فِيهَا: لَبَّيْكَ لَبَّيْكَ، وَسَعْدَيْكَ، وَالْخَيْرُ بِيَدَيْكَ، لَبَّيْكَ وَالرَّغْبَاءُ إِلَيْكَ وَالْعَمَلُ. [صحيح] - [متفق عليه]

(212) – Abdullah ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se telbija e të Dërguarit të Allahut ﷺ ka qenë kështu: “Lebbejke Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, inne-l-hamde ven-ni‘mete leke vel-mulk, la sherike lek. (Të përgjigjem, o Allah, vetëm Ty të përgjigjem! Të përgjigjem Ty, që nuk ke ortak, të

përgjigjem! Vetëm Ty të takon lavdfalëndrimi, mirësia dhe sundimi, Ti nuk ke ortak)!” (Nafiu) tha: “Abdullah ibën Omeri e shtonte edhe këtë: “Lebejke, lebejke, ve sadejke. Vel hajru bijedejke, lebejke ver ragbau ilejke vel amelu (Të përgjigjem Ty, të përgjigjem Ty, me kënaqësi! Mirësia është në Duart e Tua, të përgjigjem Ty, lutjen dhe veprën i kemi vetëm për Ty)!” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Telbija e Profetit ﷺ, kur ai niste ritet e Haxhit apo Umres, ishte kështu: “Lebbejke Allahumme lebbejk” - Të përgjigjem, o Allah, vetëm Ty të përgjigjem! - është përgjigje e vazhdueshme ndaj Teje, herë pas here, për gjithçka që na ke thirrur, siç është sinqeriteti, teuhidi, haxhi dhe të tjera. “Lebbejke la sherike leke lebbejk” - Të përgjigjem Ty, që nuk ke ortak, të përgjigjem! - sepse vetëm Ti je i denjë për adhurim, nuk ke shok në zotërimin Tënd, në hyjninë Tënde, në emrat dhe cilësitë e Tua. "innel hamde" - Vetëm Ty të takon lavdfalëndrimi - mirënjohja e lavdërimi. "ven-ni'mete" - mirësia, - është prej Teje dhe Ti e jep atë. "leke" - Ty - ato të përkushtohen në çdo gjendje, "velmulk" - dhe sundimi - po ashtu është për Ty, "la sherike lek" - Ti nuk ke ortak! - të gjitha janë vetëm për Ty. Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) e shtonte edhe këtë: “Lebejke, lebejke, ve sadejke.” - Të përgjigjem Ty, të përgjigjem Ty, me kënaqësi! - domethënë: më gëzo dhe më bën të lumtur herë pas here. "Vel hajru bijedejke" - Mirësia është në Duart e Tua - e tëra është prej Teje dhe prej mirësisë

Sate. "lebejke ver ragbau ilejke vel amelu" - të përgjigjem Ty, lutjen dhe veprën i kemi vetëm për Ty! - kërkesat dhe nevojat i drejtohen Atij, në dorën e të Cilit është çdo mirësi, sepse vetëm Ti je i denjë për adhurim.

Mësime nga hadithi:

1. Lejueshmëria e shqiptimit të telbijes në Haxh dhe Umre është edhe më e theksuar në këto dy raste, sepse ajo është shenja e tyre dalluese, ashtu siç është tekbiri shenja dalluese e namazit.
2. Ibën Muniri ka thënë: "Lejueshmëria e telbijes e thekson nderin që Allahu i Lartësuar u jep robërve të Tij, ngase arritja e tyre në Shtëpinë e Tij është me ftesë nga Ai, i Madhëruari dhe i Lartësuari."
3. Më e e preferuar është të qëndrohet në telbijen e Profetit ﷺ, por nuk ka ndonjë problem në shtesat që thuhet, meqenëse Profeti ﷺ i ka aprovuar ato. Ibën Haxheri ka thënë: "Kjo është qasja më e balancuar, pra që njeriu ta shqiptojë veçmas atë që është transmetuar si merfu (fjalë që i atribuohet drejtpërdrejt Profetit ﷺ), dhe nëse dëshiron të thotë diçka që është mevkuf (fjalë transmetuar nga një sahabi), ose ndonjë lutje të përshtatshme që e ka formuluar vetë, le ta thotë atë veçmas, që të mos përzihet me merfuin. Kjo është e ngjashme me lutjen gjatë teshehudit, për të cilën Profeti ﷺ ka thënë: "Pastaj le të zgjedhë nga lutjet dhe lavdërimet çfarë

të dëshirojë”, domethënë, pasi ta ketë përfunduar recitimën e asaj që është merfu.”

4. Preferohet që burrat ta ngritin zërin kur e shqiptojnë telbijen, ndërsa gratë duhet ta ulin zërin nga frika e shkaktimit të fitnes (sprovës).

(4535)

(213) – عن ابن عباس رضي الله عنهما قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «ما مِنْ أَيَّامٍ الْعَمَلُ الصَّالِحُ فِيهَا أَحَبُّ إِلَى اللَّهِ مِنْ هَذِهِ الْأَيَّامِ» يَعْنِي أَيَّامَ الْعَشْرِ، قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ، وَلَا الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ؟ قَالَ: «وَلَا الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ، إِلَّا رَجُلٌ خَرَجَ بِنَفْسِهِ وَمَالِهِ فَلَمْ يَرْجِعْ مِنْ ذَلِكَ بِشَيْءٍ». [صحيح] - [رواه البخاري وأبو داود، واللفظ له]

(213) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Nuk ka ditë ku veprat e mira janë më të dashura për Allahun sesa këto dhjetë ditë (të dhul hixhes)." Të pranishmit e pyetën: “As xhihadi në rrugën e Allahut, o i Dërguari i Allahut?!” Profeti ﷺ ua ktheu: "As xhihadi në rrugën e Allahut, përveç një burri i cili del me veten dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asnjërinë.” [Ky hadith është sahih] - [رواه البخاري وأبو داود واللفظ له]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se veprat e mira në dhjetëditëshin e parë të muajit dhul hixhe janë më të mira se ditët e tjera të vitit.

Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) e pyetën Profetin ﷺ për xhihadin në ditët e tjera përveç këtyre dhjetë ditëve se a është më i mirë apo veprat e mira në këto ditë, sepse tek ata ishte ngulitur se xhihadi është prej veprave më të mira.

Kështu, Profeti ﷺ iu përgjigj: "Veprat e mira në këto ditë janë më të mira se xhihadi në ditët e tjera, përveç atij që del në xhihad dhe e rrezikon jetën dhe pasurinë e tij për hir të Allahut, ku dhe e humb pasurinë e shpirti i del për hir të Allahut." Kjo është ajo vepër që ua tejkalon në vlerë veprave të mira në këto ditë të çmuara.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e kryerjes së veprave të mira në dhjetë ditët e (para të) dhul hixhes. Andaj, muslimani duhet t'i shfrytëzojë këto ditë dhe të shtojë vepra të mira në to, si: përmendja e Allahut të Lartmadhëruar, leximi i Kuranit, fjalët: Allahu ekber, la ilahe il-lallah, elhamdulilah, namazi, sadakaja, agjërimi dhe të gjitha veprat e devotshmërisë.

(6255)

(214) – عن أنس رضي الله عنه أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «جَاهِدُوا

المشركين بأموالكم وأنفسكم وألسنتكم». [صحيح] - [رواه أبو داود والنسائي

وأحمد]

(214) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Luftoni kundër idhujtarëve me pasuritë,

shpirtrat tuaj dhe me gjuhët tuaja.” [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والنسائي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëroi të bëhet luftë kundër jobesimtarëve dhe dhënien e çdo mundi për t’u përballur me ta, me të gjitha mjetet e mundshme, sipas mundësive, në mënyrë që fjala e Allahut të jetë më e larta. Kjo përfshin:

Së pari: Shpenzimin e pasurisë në rrugë të xhihadit kundër tyre, siç është blerja e armëve, furnizimi i luftëtarëve, e të ngjashme.

Së dyti: Daljen vetë me trupin dhe shpirtin për t’u përballur me ta dhe për t’i mposhtur.

Së treti: Thirrjen e tyre në Islam me anë të fjalës, ngritjen e argumenteve kundër tyre, qortimin dhe rrëzimin e pretendimeve të tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Nxitja për luftë kundër idhujtarëve me shpirt, pasuri dhe fjalë, secili sipas mundësisë së tij, dhe se lufta nuk është e kufizuar vetëm në luftën fizike.
2. Urdhri për të bërë luftë tregon se ky veprim është detyrim, i cili mund të jetë detyrim individual (ar. farz ajn) ose detyrim kolektiv (ar. farz kifaje).
3. Allahu e ka ligjësuar luftën për disa arsye, ndër të cilat janë:

4. 1. Të kundërshtohet shirku (idhujtaria) dhe idhujtarët, sepse Allahu kurrë nuk e pranon shirkun.
5. 2. Të largohen pengesat që e ndalojnë thirrjen drejt Allahut të Lartësuar.
6. 3. Të mbrohet akidja (besimi) nga çdo gjë që e kundërshton atë. 4. Të mbrohen muslimanët, vendet e tyre, nderi dhe pasuritë e tyre.

(64597)

(215) - عَنْ أَبِي الْخَوَرَاءِ السَّعْدِيِّ قَالَ: قُلْتُ لِلْحَسَنِ بْنِ عَلِيٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: مَا حَفِظْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ؟ قَالَ: حَفِظْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «دَعْ مَا يَرِيْبُكَ إِلَى مَا لَا يَرِيْبُكَ، فَإِنَّ الصَّدَقَ طُمَأْنِينَةٌ، وَإِنَّ الْكَذِبَ رِيْبَةٌ». [صحيح] - [رواه الترمذي والنسائي وأحمد]

(215) – Ebu Havra Sadiu transmeton se e ka pyetur Hasanin, djalën e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me ta!): "Çfarë ke mbajtur mend nga i Dërguari i Allahut ﷺ?" Ai tha: "Kam mbajtur mend nga i Dërguari i Allahut ﷺ: "Lëre atë që të ngjall dyshim dhe kapu pas asaj që nuk të ngjall dyshim, sepse e vërteta sjell qetësi, ndërsa gënjeshtra sjell pasiguri." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي والنسائي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar që të lihen fjalët dhe veprat për të cilat njeriu është në dyshim; a janë të ndaluara apo të lejuara; a janë haram apo hallall, dhe të

kapesh pas asaj për të cilën nuk ke asnjë dyshim dhe je i sigurt se është e mirë dhe lejuar, sepse zemra gjen qetësi dhe prehje në atë që është e sigurt, ndërsa ajo që përmban dyshim e pasguri, e shqetëson dhe trazon zemrën.

Mësimet nga hadithi:

1. Muslimani duhet t'i ndërtojë çështjet e tij mbi bindjen e plotë, të shmangë atë që është e dyshimtë, dhe të jetë i vetëdijshëm në fenë e tij.
2. Ndalesa e përfshirjes në gjërat e dyshimta.
3. Nëse dëshiron qetësi dhe rehati, lëre mënjanë atë që të shkakton dyshim.
4. Këtu del në pah mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij, meqë i urdhëroi për gjëra që sjellin qetësi për shpirtin dhe mendjen dhe i ndaloi nga gjërat që sjellin shqetësim dhe mëdyshje.

(4564)

(216) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ اللَّهَ تَجَاوَزَ عَنْ أُمَّتِي مَا حَدَّثَتْ بِهِ أَنْفُسَهَا، مَا لَمْ تَعْمَلْ أَوْ تَتَكَلَّمْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(216) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Vërtet Allahu umetit tim nuk ia merr në konsideratë ato që u vërtiten në mendje, për sa kohë që

nuk i punojnë e nuk i shqiptojnë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se muslimani nuk merret në llogari për përshepëritjet e këqija të shpirtit që i kalojnë nëpër mendje, përderisa ai nuk vepron sipas tyre ose nuk i shpreh me gojë. Allahu e ka hequr përgjegjësinë dhe ka falur, duke mos e ngarkuar umetin e Muhamedit ﷺ për ato që ndodhen në mendje dhe luhaten në shpirt, përderisa nuk zënë vend dhe nuk janë stabile tek ai. Megjithatë, nëse ato janë stabile në zemrën e tij, bie fjala, mendjemadhësia, arroganca, hipokrizia ose, nëse vepron përmes gjymtyrëve ose flet përmes gojës së tij, atëherë për këto njeriu do të merret në llogari.

Mësime nga hadithi:

1. Allahu i Lartmadhëruar nuk e merr në përgjegjësi dhe e fal besimtarin për mendimet që i vijnë shpirtit të tij, për të cilat ai i pëshepërit shpirtit të tij dhe i kalojnë në mendje.
2. Nëse njeriu mendon për shkurorëzim dhe kjo i kalon në mendje, por ai nuk e shpreh me fjalë e as nuk e shkruan, atëherë kjo nuk konsiderohet si shkurorëzim.
3. Për pëshepëritjet e shpirtit besimtari nuk ngarkohet me mëkat, sado të mëdha të jenë, përderisa nuk janë

stabile në zemrën e tij, nuk vepron sipas tyre dhe nuk i shpreh me fjalë.

4. Vlera madhështore e umetit të Muhamedit ﷺ, meqë Allahu nuk e merr në llogari për pëshpëritjet e shpirtit, ndryshe nga popujt para nesh.

(58144)

(217) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ اللَّهَ لَا يَنْظُرُ إِلَى صَوْرَتِكُمْ وَأَمْوَالِكُمْ، وَلَكِنْ يَنْظُرُ إِلَى قُلُوبِكُمْ وَأَعْمَالِكُمْ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(217) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Me të vërtetë, Allahu nuk i shikon pamjet dhe pasuritë tuaja, por i shikon zemrat dhe veprat tuaja." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ tregon se Allahu i Lartësuar nuk i shikon trupat dhe pamjet e robërve të Tij, se a janë ato të bukura apo të shëmtuara, a janë të mëdhenj apo të vegjël e a janë të sëmure a të shëndoshë. Po ashtu nuk shikon në pasuritë e tyre, se a është shumë apo pak. Allahu i Lartmadhëruar nuk i ndëshkon dhe nuk i merr në llogari robërit e Tij për këto çështje dhe dallimet që ata i kanë në to, por Ai i shikon zemrat e tyre: devotshmërinë, bindjen, vërtetësinë dhe sinqeritetin që ndodhet në zemra, pra se a kishte qëllim

syefaqësinë e reputacionin, si dhe i shikon veprat e tyre sa i përket të qenit të tyre në rregull apo jo dhe shpërblen për to.

Mësime nga hadithi:

1. Kujdesi për përmirësimin dhe pastrimin e zemrës nga çdo cilësi e përbuzur.
2. Përmirësimi i zemrës arrihet me sinqeritet, ndërsa përmirësimi i veprës arrihet me pasimin e Profetit ﷺ. Këto dyja (zemra dhe vepra) janë objekt i vëzhgimit dhe marrjes në konsideratë tek Allahu i Lartësuar.
3. Njeriu nuk duhet të mashtrohet nga pasuria, bukuria ose trupi i tij, apo nga çfarëdo gjëje tjetër nga aspektet e kësaj bote.
4. Tërheqja e vërejtjes kundër mbështetjes në anën e dukshme pa e përmirësuar anën e brendshme.

(4555)

(218) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قال: قال رَسُولُ الله صلى الله عليه وسلم:

«إِنَّ اللَّهَ يَغَارُ، وَإِنَّ الْمُؤْمِنَ يَغَارُ، وَغَيْرُهُ اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَ الْمُؤْمِنُ مَا حَرَّمَ عَلَيْهِ». [صحيح]

- [متفق عليه]

(218) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu bëhet xheloz (siç përkon me madhëstsinë e Tij), e edhe besimtari bëhet xheloz. Xhelozia e Allahut është kur besimtari i shkel

gjërat që Allahu ia ka ndaluar.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu xhelozon, hidhërohet dhe urren ashtu siç bëhet xheloz besimtari, siç hidhërohet dhe siç urren. Shkaku i xhelozisë së Allahut është kur besimtari kryen veprime të pamoralshme, që Allahu ia ka ndaluar, si: kurvëria, homoseksualiteti, vjedhja, pirja e alkoolit dhe gjëra të tjera të pamoralshme.

Mësim nga hadithi:

1. Tërheqja e vërejtjes nga zemërimi dhe ndëshkimi i Allahut, nëse nëpërkëmben ndalesat e Tij.

(3354)

(219) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «اجْتَنِبُوا السَّبْعَ الْمُوبِقَاتِ»، قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ وَمَا هُنَّ؟ قَالَ: «الشِّرْكُ بِاللَّهِ، وَالسَّحَرُ، وَقَتْلُ النَّفْسِ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ، وَأَكْلُ الرِّبَا، وَأَكْلُ مَالِ الْيَتِيمِ، وَالتَّوَلَّى يَوْمَ الزَّحْفِ، وَقَذْفُ الْمُحْصَنَاتِ الْمُؤْمِنَاتِ الْغَافِلَاتِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(219) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Largohuni nga shtatë mëkatet shkatërruese!” Të pranishmit thanë: "O i Dërguari i Allahut, cilat janë ato?" Profeti ﷺ tha: 1. “Të bërët ortak Allahut (shirku), 2. Sihri (magjia), 3. Vrasja padrejtësisht e atij që ka ndaluar Allahu, 4. Përdorimi i kamatës, 5. Ngrënia

e pasurisë së jetimit, 6. Ikja nga fronti i luftës, 7. Shpifja për gratë e ndershme, besimtare e të pastra.” [Ky hadith është sahih]

- [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ në këtë hadith urdhëron umetin e tij që të qëndrojë larg shtatë krimeve dhe mëkateve shkatërruese. E, kur u pyet se cilat janë ato, e sqaroi se janë:

1. Të bërët ortak Allahut (shirku), duke i shoqëruar Atij ndonjë të ngjashëm, në çfarëdo forme qoftë, si dhe duke ia drejtuar çfarëdo adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar. Profeti ﷺ filloi me shirkun, sepse është mëkati më i madh.

2. Sihri (magjia). Ai përbëhet nga nyja, lexime, ilaçe dhe tymëra që ndikojnë (me lejen e Allahut) në trupin e atij që i bëhet magji, duke e mbytur, duke i shkaktuar sëmundje ose duke i ndarë bashkëshortët mes vete. Sihri është një akt shejtanor dhe shumë (magjistarë) mund të arrijnë të bëjnë gjëra të tilla vetëm përmes bërjes shirk (duke dalë kështu nga feja) dhe afrimit të shpirtrat e këqij, nëpërmjet diçkaje që e dëshirojnë.

3. Vrasja padrejtësisht e atij që e ka ndaluar Allahu, përveçse me një justifikim legjitim të zbatuar nga sundimtari.

4. Përdorimi i kamatës duke e ngrënë ose duke e përdorur në forma të tjera përfitimi.

5. Shkelja e pasurisë së një të mituri, të cilit i ka vdekur babai duke qenë nën moshën e pubertetit.

6. Ikja nga fushëbeteja kur të ballafaqohet me jobesimtarët.

7. Akuzimi i grave të lira, të dëlira për kurvëri, si dhe akuzimi i burrave.

Mësime nga hadithi:

1. Mëkatet e mëdha nuk kufizohen në shtatë, ndërsa kufizim i i tyre në hadith në shtatë është për shkak se janë të rënda dhe të rrezikshme.
2. Lejueshmëria e vrasjes së njeriut nëse është me të drejtë, si: ligji i barazisë në ndëshkim (ar. kisas), dalja nga feja (ar. ridde) dhe kurvëria nga personi i martuar. Këtë gjë e implemeton sunduesi legjitim.

(3331)

(220) – عن أبي بكرة رضي الله عنه قال: قال النبي صلى الله عليه وسلم: «أَلَا أَنْبِئُكُمْ بِأَكْبَرِ الْكَبَائِرِ؟» ثَلَاثًا، قَالُوا: بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ، قَالَ: «الْإِشْرَاكُ بِاللَّهِ، وَعُقُوقُ الْوَالِدَيْنِ» وَجَلَسَ وَكَانَ مُتَكَيِّئًا، فَقَالَ: «أَلَا وَقَوْلُ الزُّورِ»، قَالَ: فَمَا زَالَ يُكْرِّرُهَا حَتَّى قُلْنَا: لَيْتَهُ سَكَتَ. [صحيح] - [متفق عليه]

(220) – Ebu Bekrete (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “A doni t’ju tregoj për më të mëdhatë e mëkateve të mëdha?” Të pranishmit iu përgjigjën: "Posi, o i Dërguari i Allahut!" (Tha:) “Të bërët shirk Allahut dhe mosrespektimi i prindërve”, - pastaj u ul, sepse ishte i mbështetur, dhe vazhdoi: - “Po ashtu, fjala e

rrejshme!” - të cilën e përsëriti disa herë radhazi, saqë thoshim me vete: Ah, sikur të heshtte (se na vinte rëndë)! [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith i lajmëroi shokët e tij për më të mëdhatë e mëkateve të mëdha, kështu që ua përmendi këto tria:

1. Të bërët shirk (ortakëri) Allahut, që nënkupton kushtimin e çdo lloj adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut dhe barazimi i të tjerëve me Allahun në uluhijen (veçimin e Allahut me adhurim), rububijen (veçimin e Allahut me zotërim) dhe emrat e cilësitë e Tij.

2. Mosrespektimi i prindërve, që nënkupton çdo dëm që u shkaktohet prindërve, qoftë me fjalë, qoftë me vepra, dhe lënia e bamirësisë ndaj tyre.

3. Fjala e rrejshme, e cila e përfshin edhe dëshminë e rrejshme. Kjo nënkupton çdo fjalë të rreme, me të cilën synohet nënçmimi i atij për të cilin është bërë kjo dëshmi, duke ia marrë pasurinë ose duke ia cenuar nderin, e të ngjashme.

Profeti ﷺ e përsëriti (disa herë) tërheqjen e vërejtjes kundër fjalëve të rreme, duke paralajmëruar kështu për qortueshmërinë dhe efektet e këqija të saj në shoqëri, derisa sahabët thanë: "Ah, sikur të heshtte!", si mëshirë për të dhe moskënaqje me atë që e shqetëson atë.

Mësime nga hadithi:

1. Mëkatet më i madh është të bërët shirk (ortakëri) Allahut, sepse Profeti e përmendi në fillim të mëkateve më të mëdha. Këtë gjë e vërteton edhe fjala e Allahut të Lartësuar: "Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush a diçka tjetër përveç Tij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë." (En Nisa, 48)
2. Rëndësia e madhe e të drejtave të prindërve, sepse e bëri bashkë të drejtën e tyre me të drejtën e Allahut të Lartësuar.
3. Mëkatet ndahen në mëkate të mëdha dhe të vogla. Mëkat i madh konsiderohet çdo mëkat për të cilin ka dënim të kësaj bote, si: dënimet e paracaktuara (ar. hudud), mallkimi, kërcënimi për (dënim në) jetën e përtejme dhe kërcënimi për hyrje në Zjarr. Mëkatet e mëdha janë në nivele të ndryshme, disa prej të cilave janë më të rënda se të tjerat në ndalesë, ndërsa mëkatet e vogla janë ato të tjerat jashtë mëkateve të mëdha.

(2941)

(221) - عن عبد الله بن عمرو بن العاص رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «الْكِبَائِرُ: الإِشْرَاكُ بِاللَّهِ، وَعُقُوقُ الْوَالِدَيْنِ، وَقَتْلُ النَّفْسِ، وَالْيَمِينُ الْغَمُوسُ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(221) – Abdullah ibën Amër ibën Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Gjynahet e mëdha janë: t'i bëhet shirk Allahut, mosrespektimi i prindërve, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith i sqaron mëkatet e mëdha, që janë ato, vepruesi i të cilave kërcënohet me një kërcënim të rëndë në këtë botë ose në botën tjetër.

1. Të bërët shirk (ortakëri) Allahut, që nënkupton kushtimin e çdo lloj adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut dhe barazimi i të tjerëve me Allahun në uluhijen (veçimin e Allahut me adhurim), rububijen (veçimin e Allahut me zotërim) dhe emrat e cilësitë e Tij.

2. Mosrespektimi i prindërve, që nënkupton çdo gjë që u shkakton lëndim prindërve, qoftë fjalë e vepër, qoftë lënie e bami-rësisë ndaj tyre.

3. Vrasja e njeriut në mënyrë të paligjshme, bie fjala, vrasja në mënyrë të padrejtë.

4. Betimi i rrejshëm (zhytës), respektivisht betimi i bërë nga një person që është i vetëdijshtëm për gënjeshtren e tij. Quhet kështu (ar. gamus - zhytës), sepse e zhyt vepruesin e tij në mëkat ose në në Zjarr.

Mësime nga hadithi:

1. Për betimin e rrejshëm nuk ka kefaret (shpagim), për shkak të rrezikut dhe krimit të tij të madh, por për të duhet pendim.
2. Kufizimi i përmendjes së këtyre katër mëkateve të mëdha në hadith është për shkak të peshës së rëndë të mëkatit të tyre, e jo për t'i kufizuar ato.
3. Mëkatet ndahen në mëkate të mëdha dhe të vogla. Mëkat i madh konsiderohet çdo mëkat për të cilin ka dënim të kësaj bote, si: dënimet e paracaktuara (ar. hudud), mallkimi, kërcënimi për (dënim në) jetën e përtejme dhe kërcënimi për hyrje në Zjarr. Mëkatet e mëdha janë në nivele të ndryshme, disa prej të cilave janë më të rënda se të tjerat në ndalesë, ndërsa mëkatet e vogla janë të gjitha të tjerat jashtë mëkateve të mëdha.

(3044)

(222) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَوَّلُ مَا يُقْضَى بَيْنَ النَّاسِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِي الدِّمَاءِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(222) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Gjëja e parë që do të gjykohet mes njerëzve në Ditën e Kiametit janë gjaqet." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith përmendi se gjëja e parë që do të gjykohet mes njerëzve në lidhje me padrejtësinë që ua kanë bërë njëri-tjetrit në Ditën e Kiametit është gjaku, si: vrasja dhe plagët e shkaktuara.

Mësimet nga hadithi:

1. Çështja e gjakderdhjes është e rëndë, sepse fillohet me gjërat më të rëndësishme.
2. Mëkatet zmadhohen në varësi se sa i madh konsiderohet dëmi i vepruar. Marrja e jetëve të pafajshme është nga dëmet më të mëdha dhe asgjë nuk është më e madhe se kjo, përveç kufrit dhe shirkut.

(2962)

(223) – عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ قَتَلَ مُعَاهِدًا لَمْ يَرَحْ رَائِحَةَ الْجَنَّةِ، وَإِنَّ رِيحَهَا تُوجَدُ مِنْ مَسِيرَةِ أَرْبَعِينَ عَامًا». [صحيح] - [رواه البخاري]

(223) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Ai që vret një person që është në besë (të ndonjë muslimani), nuk do ta ndiejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij ndihet dyzet vjet larg." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron kërcënimin e rëndë për këdo që vret një person që është në besë (ar. muahed), respektivisht një jobesimtar që hyn në vatrën islame me besëlidhje dhe siguri, se nuk do të ndiejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij ndihet në një distancë prej dyzet vjetësh udhëtimi.

Mësime nga hadithi:

1. Është e ndaluar vrasja e jomuslimanëve, siç janë: muahedi (personi që është në besë, dhimi (qytetari jomusliman që jeton në tokën islame) dhe mustemeni (i siguruari) dhe se ky është mëkat i madh.
2. Muahed quhet ai jobesimtar të cilit i është marrë besëlidhja dhe banon në vendin e tij: ai nuk i lufton muslimanët dhe ata nuk e luftojnë atë. Dhimi është ai që vendoset në shtetin e muslimanëve dhe e jep xhizjen (taksën vjetore). Mustemeni është ai që hyn në shtetin e muslimanëve me një besëlidhje dhe siguri për një kohë të caktuar.
3. Paralajmërim kundër tradhtisë ndaj besëlidhjeve me jomuslimanët.

(64637)

(224) – عن جُبَيْرِ بْنِ مُطْعِمٍ رضي الله عنه أنه سمع النبي صلى الله عليه وسلم

يقول: «لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ قَاطِعٌ رَحِمٍ». [صحيح] - [متفق عليه]

(224) – Xhubejr ibën Mutëimi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e dëgjoi Profetin ﷺ të thotë: “Nuk do të hyjë në Xhenet ai që i shkëput (lidhjet farefisnore).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se, kushdo që i shkëput (lidhjet farefsinore) me të afërmit e tij, të cilat i ka obligim t'i mbajë, ose i lëndon dhe u bën keq, meriton të mos hyjë në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Shkëputja e lidhjeve farefisnore është prej mëkateve të mëdha.
2. Lidhjet familjare janë sipas asaj që dihet zakonisht (në një popull) dhe ndryshojnë sipas vendeve, kohëve dhe njerëzve.
3. Mbajtja e lidhjeve familjare bëhet nëpërmjet vizitës, lëmoshës, mirësjelljes ndaj tyre, vizitës së të sëmurëve, urdhërimit për të mirë, ndalimit të së keqes e kështu me radhë.
4. Kur shkëputja e lidhjeve farefisnore të jetë me ndokënd që është më i afërm, atëherë edhe (pesha) e mëkatit është më e madhe.

(225) - عن أنس بن مالك رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ أَحَبَّ أَنْ يُبْسَطَ لَهُ فِي رِزْقِهِ، وَيُنْسَأَ لَهُ فِي أَثَرِهِ، فَلْيَصِلْ رَحْمَهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(225) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Ai që dëshiron t'i shtohet rizku dhe t'i zgjatet jeta, le t'i mbajë lidhjet farefisnore." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na inkurajon t'i mbajmë lidhjet me të afërmit përmes vizitave, ndihmës fizike e financiare e gjërave të tjera dhe se kjo është shkak për shtim të rizkut dhe jetëgjatësi.

Mësim nga hadithi:

1. Të afërm konsiderohen të afërmit nga ana e babait dhe e nënës, ndërkohë sa më të afërt të jenë, atëherë janë më meritore që lidhjet të mbahen me ta.
2. Shpërblimi është sipas llojit të veprës, kështu që, kushdo që i mban lidhjet farefisnore duke bërë mirë, Allahu i jep jetëgjatësi dhe ia shton rizkun.
3. Mbajtja e lidhjeve farefisnore është shkak për shtimin e zgjerimin e rizkut dhe shkak për jetëgjatësi. Edhe nëse afati jetësor dhe rizku janë të

kufizuara, por mund të ketë bereqet në rizk dhe jetë, kështu që ai bën gjatë jetës së tij më shumë gjëra dhe është më i dobishëm se të tjerët. Gjithashtu për kuptimin e hadithit është thënë se shtimi i rizkut dhe i jetës është diçka reale që ndodh në të vërtetë. Allahu e di më së miri!

(5372)

(226) – عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «لَيْسَ الْوَاصِلُ بِالْمُكَافِي، وَلَكِنَّ الْوَاصِلَ الَّذِي إِذَا قُطِعَتْ رَحْمَتُهُ وَصَلَّهَا».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(226) – Abdullah ibën Amër ibën Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që viziton vetëm pasi të vizitohet nuk quhet mbajtës i lidhjeve, por mbajtës i lidhjeve është ai që i mban lidhjet me farefisin, edhe kur ata i shkëpusin.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon se njeriu që i mban lidhjet farefisnore ashtu siç duhet dhe që u bën mirë të afërmve nuk është ai që e kthen të mirën me të mirë, por mbajtës i vërtetë i lidhjeve farefisnore është ai i cili i mban lidhjet kur i shkëpusin me të dhe kur i bëjnë keq, e ky ua kthen me të mirë.

Mësime nga hadithi:

1. Mbajtje e lidhjeve farefisnore sipas fesë konsiderohet t'i mbash lidhjet me ata që i kanë shkëputur me ty, ta falësh atë që të ka bërë padrejtësi dhe t'i japësh atij që të ka privuar nga ndonjë gjë, e jo ai lloj që të mbash lidhje me atë që mban me ty.
2. Lidhjet farefisnore mbahen duke i bërë farefisit sa më shumë të mira, si: t'u japësh para, të bësh lutje për ta, t'i urdhërosh për mirë dhe t'i ndalosh nga e keqja, e kështu me radhë, si dhe t'i largosh sa më shumë të këqijat prej tyre.

(3854)

(227) - عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «تَدْرُونَ مَا الْغَيْبَةُ؟»، قَالُوا: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ، قَالَ: «ذِكْرُكَ أَخَاكَ بِمَا يَكْرَهُ»، قِيلَ: أَفَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ فِي أَخِي مَا أَقُولُ؟ قَالَ: «إِنْ كَانَ فِيهِ مَا تَقُولُ فَقَدْ اغْتَبَتْهُ، وَإِنْ لَمْ يَكُنْ فِيهِ فَقَدْ بَهَتَتْهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(227) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “A e dini çfarë është përgojimi?” Ata thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Profeti ﷺ tha: “Të përmendësh për vëllanë tënd atë që ai e urren.” Dikush pyeti: "Çfarë mendon nëse vëllai im e ka atë që e them?" Profeti ﷺ tha: “Nëse e ka atë që e thua, pikërisht kjo është përgojim, e, nëse nuk e ka,

atëherë i ke bërë shpifje atij.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron realitetin e përgojimit, që është: përmendja për muslimanin që nuk është i pranishëm diçka që atij nuk i pëlqen, qoftë kjo një nga cilësitë e tij fizike, qoftë morale. Për shembull, i verbri, mashtruesi, gënjeshtari, e cilësi të ngjashme përcmuese, edhe nëse këto cilësi janë të pranishme tek ai.

Por, nëse ai nuk i ka ato cilësi që u përmendën, atëherë kjo është më e rëndë se përgojimi, sepse është shpifje ndaj njeriut me diçka që nuk e ka.

Mësime nga hadithi:

1. Metoda e mësimit efikas nga ana e Profetit ﷺ, sepse i trajton çështjet në formë pyetjeje.
2. Edukata e mirë e sahabëve me Profetin ﷺ, meqë thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri."
3. I pyeturi kur nuk di diçka, thotë: "Allahu e di më së miri."
4. Feja e ruan shoqërinë duke ruajtur të drejtat dhe vëllazërinë (islame) mes tyre.
5. Përgojimi është i ndaluar, përveç në disa raste, për ndonjë dobi, bie fjala, zmbropsja e padrejtësisë, saqë i shtypuri e përmend atë që i ka bërë padrejtësi tek ai që mund ta marrë të drejtën e tij dhe thotë: "Filani

më ka bërë padrejtësi, ose më ka bërë kështu e ashtu." Po ashtu konsultimi për çështjet e martesës, partneritetit ose fqinjësisë e kështu me radhë.

(5326)

(228) – عن ابن عمر رضي الله عنهما قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «كل مُسْكِرٍ حَمْرٌ، وكل مُسْكِرٍ حرام، ومن شرب الخمر في الدنيا فمات وهو يُدْمِنُهَا لَمْ يَتُبْ، لَمْ يَشْرَبْهَا فِي الْآخِرَةِ». [صحيح] - [رواه مسلم وأخرج البخاري الجملة الأخيرة منه]

(228) – Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Çdo pije dehëse është alkool dhe çdo pije dehëse është haram. Ai që pi alkool në këtë botë dhe vdes duke qenë i varur prej tij e nuk është penduar, nuk do ta pijë në botën tjetër.” [Ky hadith është sahih] - [رواه مسلم وأخرج البخاري الجملة الأخيرة منه]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se çdo gjë që shkakton humbjen e arsyes konsiderohet alkool dhe lëndë dehëse, pavarësisht nëse është pije, ushqim, apo substancë që thithet apo diçka tjetër. Çdo gjë që e deh njeriun dhe e bën të humbë mendjen, Allahu i Lartmadhëruar e ka bërë haram dhe e ka ndaluar, qoftë pak apo shumë. Andaj, ai që pi diçka nga lëndët dehëse dhe vazhdon t'i pijë pa u penduar dhe vdes në këtë gjendje, e meriton dënimin e Allahut duke e privuar nga pirja e tyre në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Shkakut i ndalimit të alkoolit është dehja, andaj çdo gjë që deh, çfarëdo qoftë, është haram.
2. Allahu i Lartësuar e bëri haram alkoolin, sepse ai përmban dëme dhe rreziqe të mëdha.
3. Pirja e alkoolit në Xhenet është pjesë e kënaqësisë dhe lumturisë së plotë.
4. Allahu do t'ia ndalojë pirjen e alkoolit në Xhenet atij që nuk heq dorë nga pirja e tij në këtë botë. Kësisoj, ndëshkimi i tij do të jetë sipas llojit të veprës që ka bërë.
5. Duhet të nxitojmë të pendohemi për gjynahet sepse vdekja mund të vijë në çdo çast.

(58259)

(229) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: لعن رسول الله صلى الله عليه وسلم

الرَّاشِيَّ وَالْمُرْتَشِيَّ فِي الْحُكْمِ. [صحيح] - [رواه الترمذي وأحمد]

(229) – Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut ﷺ e mallkoi atë që jep ryshfet dhe atë që merr ryshfet për të ndikuar në ndonjë vendim të caktuar."

[Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith bëri lutje për dëbim dhe largim nga mëshira e Allahut të Lartmadhëruar për ata që japin ryshfet dhe ata që marrin ryshfet.

Kjo përfshin atë që u paguhet gjyqtarëve për të qenë të padrejtë në vendimin që ata japin, në mënyrë që dhuruesi të arrijë atë që dëshiron, pa të drejtë.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalohet dhënia e ryshfetit, marrja, ndërmjetësimi në ryshfet e ndihma në këtë vepër, sepse kjo është bashkëpunim në të kotën.
2. Ryshfeti është prej mëkateve të mëdha, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ e mallkoi marrësin dhe dhënësin e tij.
3. Ryshfeti në fushën e gjykatësisë dhe gjykimit është krimi më i madh dhe mëkati më i rëndë, për shkak të padrejtësisë dhe gjykimit me diçka tjerët pos asaj që ka zbritur Allahut.

(64689)

(230) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا تَحَاسَدُوا، وَلَا تَنَاجَشُوا، وَلَا تَبَاغُضُوا، وَلَا تَدَابَرُوا، وَلَا يَبِيعَ بَعْضُكُمْ عَلَى بَيْعِ بَعْضٍ، وَكُونُوا عِبَادَ اللَّهِ إِخْوَانًا الْمُسْلِمُ أَخُو الْمُسْلِمِ، لَا يَظْلِمُهُ وَلَا يَخْذُلُهُ، وَلَا يَحْقِرُهُ التَّقْوَى هَاهُنَا» وَيُشِيرُ إِلَى صَدْرِهِ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ «بِحَسْبِ امْرِئٍ مِنَ الشَّرِّ أَنْ يَحْقِرَ أَخَاهُ الْمُسْلِمَ، كُلُّ الْمُسْلِمِ عَلَى الْمُسْلِمِ حَرَامٌ، دَمُهُ، وَمَالُهُ، وَعِرْضُهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(230) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Mos kini zili ndaj njëri-tjetrit, mos e mashtroni njëri-tjetrit, mos e urreni njëri-tjetrit, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos ndërhyjni në shitblerjen e njëri-tjetrit. Bëhuni robër të Allahut, vëllezër të vërtetë. Muslimani është vëlla i muslimanit: nuk i bën padrejtësi, nuk e tradhton, nuk e gënjen e as nuk e poshtëron. Devotshmëria është këtu.” - duke bërë me shenjë në gjoksin e tij tri herë. “I mjafton si e keqe njeriut ta përulë vëllanë e vet musliman. Kundrejt muslimanit, muslimani në tërësi është i paprekshëm: gjaku, pasuria dhe nderi i tij.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e ka porositur muslimanin që të sillet mirë me vëllain e tij musliman dhe i ka sqaruar disa prej detyrimeve dhe mirësjelljeve që i takojnë ndaj tij; disa prej të cilave janë: Porosia e parë: Mos kini zili ndaj njëri-tjetrit! Pra, të mos dëshirojë ndonjëri prej jush zhdukjen e mirësisë së tjetrit. Porosia e dytë: Mos e mashtroni njëri-

tjetrin! Duke e ngritur çmimin e mallit pa pasur për qëllim ta blini atë; por vetëm për t'i sjellë dobi shitësit ose për t'i bërë dëm blerësit. Porosia e tretë: Mos u urreni njëri-tjetrin! Pra, mos ia dëshironi të keqen tjetrit, e kjo është e kundërta e dashurisë; përveçse kur urrejtja është për hir të Allahut të Lartësuar, atëherë ajo është obligim. Porosia e katërt: Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit! Duke e shmanguar vëllain e tij, duke e injoruar dhe duke e braktisur. Porosia e pestë: Mos ndërhyjni në shitblerjen e tjetrit! T'i thotë dikush blerësit të një malli: unë kam si malli i tij, por me çmim më të lirë; ose kam mall më të mirë se i atij me të njëjtin çmim. Pastaj, i Dërguari i Allahut ﷺ dha një porosi gjithëpërfshirëse dhe tha: "Bëhuni vëllezër, duke lënë mënjanë gjërat e ndaluara që u përmendën, dhe duke treguar dashuri, butësi, mëshirë, mirësjellje e ndihmë në të mira, së bashku me pastërtinë e zemrave dhe këshillën e sinqertë në çdo gjendje. Disa nga gjërat që rezultojnë nga kjo dashuri, janë: Të mos i bëjë padrejtësi dhe të mos e sulmojë vëllain e tij musliman. Të mos e lërë vëllain e tij musliman t'i bëhet padrejtësi, duke e braktisur në një rast kur ai është në gjendje ta ndihmojë dhe t'ia largojë padrejtësinë. Të mos e përbuzë, të mos ndihet më i lartë se ai dhe të mos e shikojë me sy përçmimi dhe përbuzjeje; sepse kjo buron nga mendjemadhësia që është në zemër. Pastaj Profeti ﷺ e bëri të qartë tri herë se devotshmëria (frika ndaj Allahut) është në zemër. Kush ka në zemrën e tij devotshmëri, që përfshin sjelljen e mirë, frikën ndaj Allahut dhe ndjenjën se Ai të vëzhgon, nuk e përbuz asnjë musliman. Atij i mjafton si veti e keqe dhe ves përbuzja e vëllait të tij musliman; e kjo është

për shkak të mendjemadhësisë që ka në zemrën e tij. Pastaj Profeti ﷺ e theksoi atë që u përmend më herët, duke thënë se çdo musliman ndaj muslimanit tjetër e ka të paprekshëm: gjakun e tij; që të mos i bëhet padrejtësi me vrasje apo me diçka më të vogël se ajo, si plagosje, rrahje e të ngjashme; pasurinë e tij; që të mos i merret pa të drejtë; dhe nderin e tij; që të mos fyhet në veten e tij ose në prejardhjen e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Urdhërimi për gjithçka që kërkon vëllazëria e besimit dhe ndalimi nga çdo gjë që e kundërshton atë, qoftë fjalë apo vepër.
2. Thelbi i devotshmërisë është ajo që gjendet në zemër, si: njohja e Allahut, frika prej Tij dhe ndjenja se Ai të vëzhgon; e kjo devotshmëri sjell si rezultat veprat e mira.
3. Devijimi i dukshëm tregon për dobësinë e devotshmërisë së zemrës.
4. Ndalohet dëmtimi i muslimanit në çfarëdo forme, qoftë me fjalë apo me vepra.
5. Nuk llogaritet si zili, që muslimani të dëshirojë të jetë si tjetri, pa e dëshiruar zhdukjen e mirësisë prej tij; kjo quhet *gibta* në arabisht, që nënkupton lakminë e mirë, kjo është e lejuar, sepse ndihmon në garimin drejt të mirave.

6. Njeriu, nga natyra e tij, e urren që dikush t'ia kalojë në virtytet e mira; e nëse ai dëshiron zhdukjen e saj prej tjetrit, kjo është zilia e qortuar, ndërsa nëse dëshiron të garojë me të, kjo është *gibta* (lakmia e mirë) e lejuar.
7. Nuk konsiderohet ndërhyrje në shitblerjen e vëllait musliman, kur i shpjegohet blerësit se ai është mashtruar rëndë në blerjen e tij; kjo është prej gjërave që burojnë nga këshilla e sinqertë, me kusht që nijeti i tij të jetë këshillimi i vëllait blerës, e jo dëmtimi i shitësit, sepse veprat shpërblehen sipas nijetit.
8. Nuk konsiderohet ndërhyrje në shitblerjen e vëllait musliman, nëse dy palët nuk kanë arritur marrëveshje dhe çmimi nuk është vendosur.
9. Nuk është nga format e urrejtjes së ndaluar në hadith urrejtja për hir të Allahut, sepse ajo është obligim dhe një nga lidhjet më të forta të besimit.

(4706)

(231) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِيَّاكُمْ وَالظَّنَّ؛ فَإِنَّ الظَّنَّ أَكْذَبُ الْحَدِيثِ، وَلَا تَحَسَّسُوا، وَلَا تَجَسَّسُوا، وَلَا تَحَاسَدُوا، وَلَا تَدَابَرُوا، وَلَا تَبَاغَضُوا، وَكُونُوا عِبَادَ اللَّهِ إِخْوَانًا». [صحيح] - [متفق عليه]

(231) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ruajuni nga paragjykimet, sepse paragjykimet janë gënjeshttrat më të mëdha!. Mos spiunoni, mos përgjoni dhe mos urreni njëri-tjetrin, por jini robër të Allahut, vëllezër.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ndalon dhe tërheq vërejtjen nga disa gjëra që çojnë në përçarje dhe armiqësi mes muslimanëve, prej të cilave:

Paragjykimi, që nënkupton akuzën (për tjetrin) që vendoset në zemër, pa asnjë provë, si dhe sqaroi se është gënjeshttra më e madhe.

Përgjimi, që nënkupton hulumtimin për pjesët private të njerëzve, qoftë me sy, qoftë me vesh.

Spiunazhi, që nënkupton hulumtimin rreth gjërave të fshehta, e kjo më së shpeshti thuhet për të keqen.

Zilia, që nënkupton të urrehet që e mira t'u arrijë të tjerëve.

Kthimi i shpinës, që nënkupton se njëri e shpërfill tjetrin, nuk i jep selam dhe nuk e viziton vëllanë e vet musliman.

Urrejtja e njëri-tjetrit, që nënkupton urrejtjen dhe largimin mes vete, si: dëmtimi i të tjerëve, vrenjtja dhe sjellja e keqe gjatë takimit mes vete.

Pastaj tha një fjalë gjithëpërfshirëse, me të cilën gjendjet e muslimanëve rregullohen mes vete: "... por jini robër të Allahut, vëllezër!" Vëllazëria është një lidhje që shëron marrëdhëniet mes njerëzve dhe rrit dashurinë e familjaritetin mes tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Nuk ka gjë të keqe nëse mendohet keq për atë tek i cili shfaqen qartazi shenjat e saj (të këqija). Besimtari duhet të jetë i mençur e i zgjuar, e të mos mashtrohet nga njerëzit e këqij dhe mëkatmëdhenj.
2. Ajo që nënkuptohet është paralajmërimi kundër akuzës që vendoset në shpirt dhe këmbënguljes në të. E, sa i përket asaj që paraqitet në shpirt dhe nuk vendoset, atëherë për këtë gjë nuk ngarkohet (njeriu me gjynah).
3. Ndalimi i shkaqeve që shpijnë drejt prishjes së harmonisë dhe copëtimit ndërmjet anëtarëve të shoqërisë islame, si: spiunazhi, zilia dhe të ngjashme.
4. Urdhri për ta trajtuar muslimanin si vëlla: në këshillim dhe dashuri.

(5332)

(232) - عن حذيفة رضي الله عنه قال: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم

يقول: «لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ قَتَّاتٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(232) – Hudhejfja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: "Nuk do të hyjë në Xhenet bartësi i fjalëve." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na lajmëron se thashethemxhiu, - ai që i bart fjalët mes njerëzve me qëllim të prishjes mes tyre, - është meritör të ndëshkohet, që të mos hyjë në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Thashethemet (ar. en nemimeh) janë prej mëkateve të mëdha.
2. Ndalimi i thashethemeve, për shkak se përmes tyre shkaktohet prishje dhe dëm midis individëve dhe grupeve.

(5368)

(233) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «كُلُّ أُمَّتِي مُعَاقٍ إِلَّا الْمُجَاهِرِينَ، وَإِنَّ مِنَ الْمُجَاهِرَةِ أَنْ يَعْمَلَ الرَّجُلُ بِاللَّيْلِ عَمَلًا، ثُمَّ يُصْبِحَ وَقَدْ سَتَرَهُ اللَّهُ عَلَيْهِ، فَيَقُولُ: يَا فُلَانُ، عَمِلْتُ الْبَارِحَةَ كَذَا وَكَذَا، وَقَدْ بَاتَ يَسْتُرُهُ رَبُّهُ، وَيُصْبِحُ يَكْشِفُ سِتْرَ اللَّهِ عَنْهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(233) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "I gjithë umeti im është i falur, përveç atyre që i publikojnë mëkatet e tyre!" Një formë e publikimit të mëkatit është që njeriu të bëjë një mëkat natën, dhe ndërkohë që Allahu e ka mbuluar ai gdhiet dhe thotë: 'O filan, mbrëmë natën bëra këtë e atë (mëkat)'. E ndërkohë që Zoti i tij e kishte mbuluar atë gjatë natës, ai gdhiet dhe e heq mbulesën e Allahut nga vetja!'" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se muslimanin mëkatar shpresohet që Allahu ta falë. Ndërsa ai që e publikon mëkatin me mburrje dhe me paturpësi, nuk e meriton faljen. Ky njeri e bën mëkatin natën dhe pasi ta ketë mbuluar Allahu, ai gdhiet dhe i tregon të tjerëve për mëkatin që ka bërë natën e kaluar. Pra, edhe pse Zoti i tij e kishte mbuluar atë gjatë natës, ai gdhiet dhe e heq mbulesën e Allahut nga vetja.

Mësime nga hadithi:

1. Publikimi i mëkatit, pas mbulimit nga ana e Allahut të Madhëruar, është gjest i shëmtuar.
2. Publikimi i mëkatit ndikon në përhapjen e paturpësisë midis besimtarëve.
3. Atë që Allahu e mbulon në këtë jetë, do ta mbulojë dhe në jetën tjetër. Kjo është pjesë e mëshirës së gjerë që Allahu ka për robërit e Tij.
4. Ai që sprovohet me ndonjë mëkat, duhet që ta mbulojë veten e tij dhe të pendohet tek Allahu i Madhëruar.
5. Mëkati i publikimit të mëkateve në mënyrë të qëllimshme është i rëndë, pasi për shkak të tij publikuesit e privojnë veten e tyre nga falja.

(3756)

(234) - عَنِ ابْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ خَطَبَ النَّاسَ يَوْمَ فَتْحِ مَكَّةَ، فَقَالَ: «يَا أَيُّهَا النَّاسُ، إِنَّ اللَّهَ قَدْ أَذْهَبَ عَنْكُمْ عُبْيَةَ الْجَاهِلِيَّةِ وَتَعَاضَّطَهَا بِأَبَائِهَا، فَالنَّاسُ رَجُلَانِ: بَرٌّ تَقِي كَرِيمٌ عَلَى اللَّهِ، وَفَاجِرٌ شَقِيٌّ هَيْنَ عَلَى اللَّهِ، وَالنَّاسُ بَنُو آدَمَ، وَخَلَقَ اللَّهُ آدَمَ مِنْ تُرَابٍ، قَالَ اللَّهُ: {يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَى وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا} إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ» [الحجرات: 13]. [صحيح] - [رواه الترمذي وابن حبان]

(234) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqu me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ iu drejtua njerëzve me ligjërim në Ditën e Çlirimit të Mekës dhe u tha: “O njerëz, Allahu jua ka larguar mburrjen me xhahilietin (periudhën paraislame) dhe lavdërimin me baballarët e tij. Njeriu ndahet në dy lloje: i mirë, i devotshëm e i nderuar tek Allahu dhe i shthurur, fatzi e i përbuzur para Allahut. Të gjithë njerëzit janë bij të Ademit, e Allahu e krijoi Ademin prej dheut. Allahu thotë: “O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli e një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Njohës i çdo gjëje.” (El Huxhurat, 13) [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وابن حبان]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ iu drejtua njerëzve në Ditën e Çlirimit të Mekës dhe u tha: "O njerëz, Allahu e ka ngritur dhe larguar prej jush mendjemadhësinë e mburrjen me kohën e

xhahilietit (kohën paraislame) dhe mburrjen me baballarët e dikujt. Njeriu ndahet në dy lloje:

Ose besimtar i mirë, i devotshëm, i bindur, i cili e adhuron Allahun e Lartmadhëruar. Ky është i nderuar tek Allahu, edhe nëse nuk ka familje ose prejardhje fisnike te njerëzit.

Ose është jobesimtar, i shthurur, i mjerë. Ky është i përçmuar tek Allahu e nuk vlen asgjë, edhe nëse është nga një familje fisnike, që ka status të lartë dhe autoritet.

Të gjithë njerëzit janë bij të Ademit dhe Allahu e krijoi Ademin prej dheut, andaj nuk i takon dikujt që e ka origjinën prej dheut të jetë mendjemadh dhe ta pëlqejë veten. Argument për këtë janë fjalët e Allahut të Lartmadhëruar: “O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli e një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për të njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe Njohës i çdo gjëje.” (El Huxhurat, 13)

Mësime nga hadithi:

1. Është e ndaluar të mburresh me familje dhe prejardhje.

(65074)

(235) - عن عائشة رضي الله عنها عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «إِنَّ أْبَعْضَ الرَّجَالِ إِلَى اللَّهِ الْأَلَدُ الْخَصِمُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(235) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Burri më i urryer tek Allahu është kundërshtari i përbetuar.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu i Lartmadhërishëm e urren kundërshtarin e ashpër dhe atë që në vazhdimësi kundërshton, i cili nuk pranon nënshtrimin ndaj së vërtetës dhe që përpiket ta kundërshtojë atë, ose që polemizon për të vërtetën, por e tepron gjatë polemikës dhe del prej kontrollit dhe polemizon pa dituri.

Mësime nga hadithi:

1. Nuk përfshihet në kategorinë e mosmarrëveshjeve - polemikave të përçmuara, kur i shtypuri e kërkon të drejtën e tij përmes procesit gjyqësor fetar.
2. Polemikat dhe mosmarrëveshjet janë ndër të metat e gjuhës që shkaktojnë përçarje dhe konflikt mes muslimanëve.
3. Polemika është e lavdëruar nëse bëhet për të vërtetën dhe me të mirë, si dhe është e përçmuar nëse bëhet për ta refuzuar të vërtetën dhe për të

përforcuar të kotën, ose bëhet pa argument e pa provë.

(5474)

(236) – عن أبي بَكْرَةَ رضي الله عنه قال: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «إِذَا لَقِيَ الْمُسْلِمَانِ بِسَيْفَيْهِمَا فَالْقَاتِلُ وَالْمَقْتُولُ فِي النَّارِ»، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ هَذَا الْقَاتِلُ، فَمَا بَالُ الْمَقْتُولِ؟ قَالَ: «إِنَّهُ كَانَ حَرِيصًا عَلَى قَتْلِ صَاحِبِهِ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(236) – Ebu Bekrete (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: “Kur dy muslimanë ndeshen me shpatat e tyre, vrasësi dhe i vrari do të jenë në Zjarr.” E pyeta: "O i Dërguari i Allahut, për vrasësin po kuptohet, po çfarë është puna e të vرارit?" Më tha: “Edhe ai ishte i vendosur për ta vrarë vëllanë e vet.”

[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se, kur dy muslimanë ndeshen me shpatat e tyre, ku secili synon ta shkatërrojë tjetrin, atëherë vrasësi do të jetë në Zjarr për shkak se fillimisht e vrau tjetrin. Sahabëve u bëri problem çështja e të vرارit: si të jetë vallë ai në Zjarr. Kështu, Profeti ﷺ u tregoi se i tilli do të jetë në Zjarr po ashtu, sepse ishte i vendosur për ta vrarë tjetrin, e nga vrasja e tij e pengoi vetëm fakti se vrasësi shpejtoi dhe e vrau përpara.

Mësime nga hadithi:

1. Dënimin e meriton ai që është i vendosur me zemër dhe është i përgatitur për të bërë mëkat, si dhe i ka marrë shkaqet për diç të tillë.
2. Tërheqja e vërejtjes nga luftimi i muslimanëve mes vete dhe kërcënimi me Zjarr për një vepër të tillë.
3. Luftimi mes muslimanëve me hak (me të drejtë) nuk futet në këtë kërcënim, fjala vjen, luftimi i agresorëve (ar. bugat) dhe i atyre që bëjnë dëme.
4. Vepruesi i mëkatit të madh nuk bën kufër (nuk del nga feja) thjesht pse ka bërë mëkat, sepse Profeti ﷺ i quajti muslimanë ata dy që luftojnë njëri-tjetrin.
5. Nëse dy muslimanë ndeshen me ndonjë mjet me të cilin ndodh vrasja, e kështu njëri prej tyre e vret tjetrin, atëherë vrasësi dhe i vrari do të jenë në Zjarr. Fakti që shpata u përmend në hadith është në aspektin e përmendjes së një lloji që arrihet përmes saj vrasja (e nuk është për qëllim kufizimi vetëm me të).

(4304)

(237) – عن أبي موسى الأشعري رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم

قال: «مَنْ حَمَلَ عَلَيْنَا السَّلَاحَ فَلَيْسَ مِنَّا». [صحيح] - [متفق عليه]

(237) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që ngre armët kundër nesh nuk është prej nesh.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tërheq vërejtjen nga drejtimi i armëve kundër muslimanëve; për t'i frikësuar ose plaçkitur. Kushdo që e bën këtë pa ndonjë të drejtë, ka bërë një krim dhe një gjynah të madh, rrjedhimisht e meriton këtë kërcënim të rëndë.

Mësime nga hadithi:

1. Paralajmërim i ashpër kundër një muslimani që i lufton vëllezërit e tij muslimanë.
2. Prej të këqijave dhe dëmit më të madh në tokë është ngritja e armëve kundër muslimanëve dhe dëmi i shkaktuar përmes vrasjes.
3. Kërcënimi i përmendur nuk e përfshin luftimin që bëhet me të drejtë, siç është luftimi kundër kryngritësve të pabindur (ar. bugat), shkatërrimtarëve etj.
4. Është e ndaluar të frikësohen muslimanët me armë ose me ndonjë gjë tjetër, qoftë dhe me shaka.

(238) – عن عائشة رضي الله عنها قالت: قال النبي صلى الله عليه وسلم: «لَا

تَسُبُّوا الْأَمْوَاتَ، فَإِنَّهُمْ قَدْ أَفْضَوْا إِلَى مَا قَدَّمُوا». [صحيح] - [رواه البخاري]

(238) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Mos i shani të vdekurit, sepse ata kanë arritur te veprat që kanë punuar!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se është e ndaluar sharja e të vdekurve dhe cenimi i nderit të tyre dhe se kjo është një nga veset. Ata tashmë kanë arritur te veprat që kanë punuar, qofshin të mira, qofshin të këqija, si dhe kjo sharje nuk u arrin atyre, por përkundrazi i lëndon të gjallët (nga familjarët e miqtë e tyre).

Mësime nga hadithi:

1. Hadithi është argument për ndalimin e sharjes së të vdekurve.
2. Mossharja e të vdekurve është tregues i pasjes në konsideratë nga të gjallët dhe për të ruajtur sigurinë e shoqërisë nga mllefi dhe urrejtja.
3. Urtësia e ndalimit të sharjes së tyre është se ata arritën tek ajo që e bënë, ndërsa sharja e tyre nuk bën dobi. Gjithashtu, nga urtësia e mossharjes është

se kjo është shkak që të afërmit e tyre të gjallë të lëndohen.

4. Njeriu nuk duhet të thotë diçka prej së cilës nuk ka dobi.

(5364)

(239) – عن أبي أيوب الأنصاري رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «لَا يَحِلُّ لِرَجُلٍ أَنْ يَهْجُرَ أَخَاهُ فَوْقَ ثَلَاثِ لَيَالٍ، يَلْتَقِيَانِ، فَيُعْرِضُ هَذَا وَيُعْرِضُ هَذَا، وَخَيْرُهُمَا الَّذِي يَبْدَأُ بِالسَّلَامِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(239) – Ebu Ejub Ensariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Njeriut nuk i lejohet të mos i flasë vëllait të vet më shumë se tri net. Kur ata dy takohen, ky ia kthen shpinën, e edhe ai i tjetri ia kthen. Më i miri prej tyre është ai që fillon me selam." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ndaloi që muslimani ta bojkotojë vëllanë e tij musliman për më shumë se tri net, duke mos u përshëndetur me njëri-tjetrin e duke mos folur mes vete kur të takohen.

Më i miri nga këta të dy që janë në grindje është ai që përpiket ta largojë këtë bojkot dhe fillon të përshëndesë me selam. Ajo që nënkuptohet me bojkot (ar. hexhër) në hadith është bojkoti për gjëra personale, sepse bojkoti për hir të Allahut të Lartësuar, për hakun e Tij, bie fjala, bojkoti i mëkatarëve, bidatçinjve e shokëve të këqij nuk përcaktohet

me kohë, por është e ndërlidhur me atë shkak, i cili, po u largua, atëherë largohet edhe bojkoti.

Mësime nga hadithi:

1. Prej këtij hadithi kuptohet se bojkotimi është i lejuar deri në tri net ose më pak, duke e marrë në konsideratë natyrshmërinë njerëzore, kështu që i falet nëse e bojkoton deri në tri net, që t'i largohet kjo urrejtje.
2. Vlera e selamit. Ai e heq atë (urrejtjen) që është në shpirt dhe është një shenjë që tregon dashuri.
3. Islami i kushtoi rëndësi vëllazërisë dhe miqësisë së muslimanëve mes vete.

(5365)

(240) – عن سهل بن سعد رضي الله عنه عن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ يَضْمَنْ لِي مَا بَيْنَ لَحْيَيْهِ وَمَا بَيْنَ رِجْلَيْهِ أَضْمَنْ لَهُ الْجَنَّةَ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(240) – Sehël ibën Sadi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Atij që ma garanton atë që është mes dy nofullave dhe atë që është mes dy këmbëve, ia garantoj Xhenetin.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith për gjëra, të cilave, nëse u përmbahet muslimani, ka për të hyrë në Xhenet:

E para: ruajtja e gjuhës nga të folurit e gjërave që e hidhërojnë Allahun e Lartësuar.

E dyta: ruajtja e organit intim nga rënia në kurvëri.

I përmendi këta dy organe, sepse përmes tyre më së shumti bëhet mëkat.

Mësim nga hadithi:

1. Ruajtja e gjuhës dhe organit intim janë shkak për të hyrë në Xhenet.
2. Profeti ﷺ e veçoi gjuhën dhe organin intim, sepse këto janë burim fatkeqësish për njeriun në këtë botë dhe në botën tjetër.

(3475)

(241) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ - وَكَانَ غَزَا مَعَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ثِنْتَيْ عَشْرَةَ غَزْوَةً - قَالَ: سَمِعْتُ أَرْبَعًا مِنَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَأَعَجَبَنِي، قَالَ: «لَا تُسَافِرِ الْمَرْأَةُ مَسِيرَةَ يَوْمَيْنِ إِلَّا وَمَعَهَا زَوْجُهَا أَوْ ذُو مُحَرَّمٍ، وَلَا صَوْمَ فِي يَوْمَيْنِ: الْفِطْرِ وَالْأَضْحَى، وَلَا صَلَاةَ بَعْدَ الصُّبْحِ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ، وَلَا بَعْدَ الْعَصْرِ حَتَّى تَغْرُبَ، وَلَا تُشَدُّ الرَّحَالُ إِلَّا إِلَى ثَلَاثَةِ مَسَاجِدَ: مَسْجِدِ الْحَرَامِ، وَمَسْجِدِ الْأَقْصَى، وَمَسْجِدِي هَذَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(241) – Nga Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili pati marrë pjesë në dymbëdhjetë beteja me Pejgamberin e Allahut (paqja qoftë mbi të!), përcillet se ka thënë që kam dëgjuar nga Pejgamberi i Allahut (paqja qoftë mbi të!) katër gjëra, që më kanë bërë përshtypje të veçantë: "Femra nuk duhet të ndërmarrë udhëtim dyditor pa burrin e saj apo pa një mashkull të familjes. Nuk lejohet të agjërohet në këto dy ditë: dita e festës së fitrit dhe dita e festës së kurbanit. Nuk lejohet të falet namaz pas namazit të sabahut, derisa të lindë dielli e as pas namazit të ikindisë, derisa të perëndojë dielli. Dhe nuk bën të ndërmerret udhëtim i gjatë vetëm se për te këto tri xhami: Xhamia e Shenjtë, Xhamia e Aksasë dhe Xhamia ime". [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Në këtë hadith, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka ndaluar nga katër gjëra:

1. Gruaja e ka të ndaluar të ndërmarrë një udhëtim dyditor pa burrin e saj apo pa dikë nga familjarët e saj, nga

ata të cilët e kanë të ndaluar kategorikisht të martohen me të, si: i biri, i ati, djali i vëllait, djali i motrës, xhaxhai, daja etj.

2. E ka bërë të ndaluar agjërimin e ditës së festës të fitrit dhe të ditës së festës të kurbanit, qoftë agjërim zotimi, vullnetar apo shpagimi.

3. E ka ndaluar namazin vullnetar pas namazit të ikindisë, derisa të perëndojë dielli dhe pasi të agojë, derisa të lindë dielli.

4. E ka ndaluar që të ndërmerret udhëtim i gjatë drejt një vendi, duke besuar se ai ka një mirësi të veçantë apo se shpërblimi në të është shumëfish, përveç këtyre tri xhamive; Xhamia e Shenjtë, Xhamia e Pejgamberit dhe Xhamia e Aksasë. Kësisoj, nuk ndërmerret udhëtim i gjatë drejt vendeve të tjera për t'u falur në to, veç këtyre tri xhamive, ngase vetëm në këto tri xhami shumëfishohet shpërblimi.

Mësime nga hadithi:

1. Nuk lejohet që femra të udhëtojë pa një mahrem (të afërm familjar).
2. Femra nuk vlen për mahrem për një femër tjetër në udhëtim, ngase Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e ka cilësuar: "Burri i saj ose një mahrem i saj."
3. Femrës i ndalohet të ndërmarrë çdo lloj distance që konsiderohet udhëtim pa burrin e saj apo pa një mahrem. Distanca që është cekur në këtë hadith ka qenë sipas gjendjes së pyetësit dhe sipas vendit të tij të banimit.

4. Mahrem i femrës konsiderohen: burri i saj dhe të gjithë ata meshkuj që e ka në mënyrë kategorike të ndaluar të martohet me ta, për shkak të afërsisë së gjakut, si: i ati, i biri, xhaxhai, daja etj. Ose për shkak të gjidhënies, si: i ati nga gjiri, xhaxhai nga gjiri etj. Ose për shkak të krushqisë, si: vjehri. Mahremi duhet të jetë musliman, i rritur, i shëndoshë mendërisht, i besueshëm dhe i sigurt. Ngase qëllimi i vendosjes së mahremit është mbrojtja, ruajtja dhe kujdesi ndaj femrës.
5. Legjislacioni islam është kujdesur në mënyrë të veçantë për ruajtjen dhe mbrojtjen e femrës.
6. Namazi vullnetar që nuk ka asnjë shkak, nuk është i vlefshëm në kohën pas namazit të sabahut dhe pas namazit të ikindisë. Nga kjo ndalesë përjashtohet shlyerja e namazeve të detyrueshme dhe e namazeve me shkaqe të veçanta, si: përshëndetja e xhamisë etj.
7. Nuk lejohet të falet namaz menjëherë pas lindjes së diellit, por duhet të pritët derisa ai të ngrihet sa një shtizë, që është diku dhjetë minuta apo një çerek ore.
8. Koha e ikindisë shtrihet deri në perëndim të diellit.
9. Në hadithin e lartpërmendur ceket lejimi i ndërmarrjes së udhëtimit drejt tri xhamive.

10. Tri xhamitë e mëdha kanë epërsi dhe përparësi ndaj xhamive të tjera.

11. Nuk lejohet të ndërmerret një udhëtim i gjatë për vizitën e varreve, edhe nëse bëhet fjalë për varrin e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!). Ndërsa për ata që banojnë në Medine apo për ata që kanë shkuar në Medine, për ndonjë qëllim të ligjshëm, vizita e tij është e lejuar.

(10603)

(242) – عن أسامة بن زيد رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم

قال: «مَا تَرَكْتُ بَعْدِي فِتْنَةً أَصْرَّ عَلَى الرَّجَالِ مِنَ النِّسَاءِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(242) – Usame ibën Zejdi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Nuk kam lënë pas meje ndonjë sprovë më të dëmshme për burrat sesa gratë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se ai nuk ka lënë pas vetes sprovë më të dëmshme për burrat sesa gratë, rrjedhimisht, nëse ajo është dikush nga familja e tij, atëherë ai mund ta ndjekë atë në kundërshtim me fenë. E, nëse ajo është e huaj për të, atëherë duke u përzier dhe duke u vetmuar me të dhe gjëra të tjera të dëmshme që rrjedhin prej kësaj.

Mësime nga hadithi:

1. Muslimani duhet të ketë kujdes nga sprova e grave dhe duhet ta mbyllë çdo shteg që çon në sprovim përmes saj.
2. Besimtari duhet të kapet fort pas fesë së Allahut dhe të shpresojë tek Ai që ta ruajë nga sprovat.

(5830)

(243) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كُنَّا مَعَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ: «مَنِ اسْتَطَاعَ الْبَاءَةَ فَلْيَتَزَوَّجْ، فَإِنَّهُ أَعْصَى لِلْبَصْرِ، وَأَحْصَنُ لِلْفَرْجِ، وَمَنْ لَمْ يَسْتَطِعْ فَعَلَيْهِ بِالصَّوْمِ، فَإِنَّهُ لَهُ وَجَاءٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(243) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu goftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që i ka mundësitë, le të martohet, sepse e ka më të lehtë uljen e shikimit dhe ruajtjen e nderit. Ndërkaq, ai që nuk i ka mundësitë, le të agjërojë, sepse agjërimi ia shuan epshin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith i nxiti ata që janë në gjendje të kryejnë marrëdhënie intime dhe i kanë mundësitë për martesë, që të martohen, sepse ajo ua mbron shikimin nga gjërat e ndaluara, ua mbron organin (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe i pengon të bien në imoralitet. Ai që nuk i ka mundësitë për martesë, ndërkohë është i aftë të kryejë

marrëdhënie intime, atëherë duhet të agjërojë, pasi kjo do t'ia ndërpresë dëshirën epshore dhe të keqen e spermës.

Mësime nga hadithi:

1. Islami u kushtoi rëndësi shkaqeve të dëlirësisë dhe ruajtjes nga imoraliteti dhe gjërat e turpshme.
2. Profeti ﷺ e nxiti të agjërojë atë që nuk i ka mundësitë për martesë, sepse ajo ia dobëson dëshirën epshore.
3. Shëmbëllimi i agjërimit me tredhjen është për faktin se tredhja nënkupton prerjen e venave të testikujve, duke e bërë që dëshira për marrëdhënie intime të zhduket. Po ashtu, agjërimi e dobëson dëshirën për marrëdhënie seksuale.

(5863)

(244) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ الدُّنْيَا حُلْوَةٌ خَضِرَةٌ، وَإِنَّ اللَّهَ مُسْتَخْلِفُكُمْ فِيهَا، فَيَنْظُرُ كَيْفَ تَعْمَلُونَ، فَاتَّقُوا الدُّنْيَا وَاتَّقُوا النَّسَاءَ، فَإِنَّ أَوَّلَ فِتْنَةٍ بَنِي إِسْرَائِيلَ كَانَتْ فِي النِّسَاءِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(244) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Kjo botë është e ëmbël dhe e bukur. Allahu do t’ju bëjë zëvendës në Tokë, që t’ju shohë se si do të veproni, andaj ruajuni nga mashtrimet e saj dhe ruajuni nga gratë, sepse sprova e parë te bijtë e Israilit ka qenë përmes grave.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se bota është e ëmbël në shije dhe e bukur - e gjelbër në pamje, kështu që njeriu mashtrohet prej saj, preokupohet me të dhe e bën atë shqetësimin e tij më të madh. Allahu i Lartmadhëruar na bëri të atillë që të jemi në jetën e kësaj bote, për të parë se si do të veprojmë: a do t'i bindemi Atij, apo do t'i mëkatojmë Atij? Më pas tha: "Kini kujdes që të mos ju mashtrojnë kënaqësitë dhe stolitë e kësaj bote, të cilat do t'ju bëjnë të braktisni atë që ju ka urdhëruar Allahu dhe të bini në atë që ju ka ndaluar!" Nga gjërat më të mëdha nga të cilat duhet të ruhemi nga sprovat e kësaj bote janë sprovat e grave, ku kjo qe sprovë e parë në të cilën kishin rënë bijtë e Israilit.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi që t'i përmbahemi devotshmërisë dhe të mos preokupohemi me pamjet dhe stolitë e kësaj bote.
2. Tërheqja e vërejtjes që të mos sprovohemi me gratë, qoftë duke i shikuar, qoftë duke u treguar të pavëmendshëm në përzierjen me meshkuj të huaj ose gjëra të kësaj natyre.
3. Sprova e grave është ndër sprovat më të mëdha të kësaj bote.
4. Marrja e këshillës duke marrë mësim nga popujt e kaluar: ajo që u ndodhi bijve të Israilit mund t'u ndodhë edhe të tjerëve.

5. Fitneja (sprova) e grave është e atillë, që, nëse ajo është bashkëshorte, mund ta bëjë burrin të shpenzojë më shumë sesa mund të përballojë, duke e shpërqendruar atë nga kërkimi i çështjeve të fesë dhe duke e rraskapitur nga kërkimi i çështjeve të kësaj bote. E, nëse ajo është e huaj, atëherë sprova e saj mund të jetë e atillë që njerëzit t'i mashtrojnë dhe t'i devijojë nga e vërteta, nëse ato dalin dhe përzihen me ta, veçanërisht nëse janë të zbuluara dhe të stolisura. Kjo mund të jetë shkak i rënies në shkallë të ndryshme të zinasë. Besimtari duhet të kapet për fenë e Allahut dhe të shpresojë tek Ai, që ta ruajë nga fitneja e tyre.

(3053)

(245) - عَنْ مُعَاوِيَةَ الْقَشِيرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، مَا حَقُّ زَوْجَةٍ أَحَدِنَا عَلَيْهِ؟ قَالَ: «أَنْ تُطْعِمَهَا إِذَا طَعِمْتَ، وَتَكْسُوَهَا إِذَا اكْتَسَيْتَ، أَوْ اكْتَسَبْتَ، وَلَا تَضْرِبَ الْوَجْهَ، وَلَا تُقَبِّحَ، وَلَا تَهْجُرَ إِلَّا فِي الْبَيْتِ» [حسن] - [رواه أبو داود وابن ماجه وأحمد]

(245) – Muavi Kushejriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka transmetuar se ka thënë: "O i Dërguar i Allahut, cila është e drejta e gruas ndaj burrit të saj?" Ai tha: “Ta ushqesh kur ushqehesh vetë, ta veshësh kur vesh veten ose kur fiton të ardhura, mos ta godasësh në fytyrë, mos e fyej dhe mos e lër (në shpërfillje), përveçse brenda në shtëpi.” [Hadith hasen] - [رواه أبو داود وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ u pyet për të drejtën e gruas ndaj burrit të saj, dhe ai përmendi disa gjëra, ndër të cilat janë:

E para: Mos e veço veten me ushqim ndaj saj; përkundrazi, ushqeje atë kur ushqehesh vetë.

E dyta: Mos e veço veten me veshje; përkundrazi, vishu dhe vishe edhe atë kur ke mundësi dhe kur fiton pasuri.

E treta: Gruaja nuk duhet të rrihet, përveçse në rast nevojë dhe me arsye të vlefshme. Nëse ka nevojë për disiplinim, si për neglizhencë në obligimet e saj, goditja duhet të jetë e lehtë dhe jo e dëmshme. Për më tepër, nuk lejohet të goditet në fytyrë, sepse ajo është pjesa më e nderuar dhe më e dukshme e trupit, që përmban tiparet më të ndjeshme dhe fisnike.

E katërta: Mos e fyej dhe mos i thuaj: “Allahu ta poshtëroftë fytyrën!”, apo të lidhësh ndonjë pjesë të trupit të saj me shëmtim, që është e kundërta e bukurisë. Kjo, sepse Allahu i Lartësuar është Ai që e ka formësuar fytyrën dhe trupin e njeriut dhe Ai e ka përsosur krijimin e Tij. Kritika ndaj krijesës është një mënyrë e tërthortë për të kritikuar Krijuesin, e ne kërkojmë strehim tek Allahu prej një vepre të tillë.

E pesta: Mos e braktis përveçse në shtrat, dhe mos u largo fizikisht prej saj, as mos e nxirr nga shtëpia. Kjo vlen për rastet normale të braktisjes, që mund të ndodhin mes bashkëshortëve.

Mësime nga hadithi:

1. Përkushtimi i shokëve të Profetit, për të ditur të drejtat që u detyrohen të tjerëve dhe për të njohur të drejtat e tyre vetjake.
2. Burri është i obliguar t'i sigurojë gruas së tij ushqim, veshje dhe strehim.
3. Format konkrete dhe abstrakte të dhunës janë të ndaluara.
4. Një shembull i dhunës së ndaluar është të thuash: “Ti vjen nga një fis i keq” ose “nga një familje e keqe” e të ngjashme.

(58093)

(246) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: خَرَجَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي أَضْحَى أَوْ فِطْرٍ إِلَى الْمُصَلَّى، فَمَرَّ عَلَى النِّسَاءِ، فَقَالَ: «يَا مَعْشَرَ النِّسَاءِ، تَصَدَّقْنَ، فَإِنِّي أُرِيْتُكُنَّ أَكْثَرَ أَهْلِ النَّارِ» فَقُلْنَ: وَبِمَ يَا رَسُولَ اللَّهِ؟ قَالَ: «تُكْثِرْنَ اللَّعْنَ، وَتَكْفُرْنَ الْعَشِيرَ، مَا رَأَيْتُ مِنْ نَاقِصَاتِ عَقْلٍ وَدِينٍ أَذْهَبَ لِلْبَّ الرَّجُلِ الْحَازِمِ مِنْ إِحْدَاكُنَّ»، قُلْنَ: وَمَا نُقْصَانُ دِينِنَا وَعَقْلِنَا يَا رَسُولَ اللَّهِ؟ قَالَ: «أَلَيْسَ شَهَادَةُ الْمَرْأَةِ مِثْلَ نِصْفِ شَهَادَةِ الرَّجُلِ» قُلْنَ: بَلَى، قَالَ: «فَذَلِكَ مِنْ نُقْصَانِ عَقْلِهَا، أَلَيْسَ إِذَا حَاضَتْ لَمْ تُصَلِّ وَلَمْ تَصُمْ» قُلْنَ: بَلَى، قَالَ: «فَذَلِكَ مِنْ نُقْصَانِ دِينِهَا».

[صحيح] - [متفق عليه]

(246) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “I Dërguari i Allahut ﷺ doli në namazgjah për

Bajramin e Kurbanit, - ose ka thënë: Fitrit, - dhe kaloi pranë grave e u tha: “O ju gra! Jepni lëmoshë, sepse (natën që jam ngritur në qiell) kam parë që ju jeni banoret më të shumta të Zjarrit.” Ato e pyetën: “Përse, o i Dërguari i Allahut?” Profeti ﷺ u tha: “Mallkoni shpesh dhe e përbuzni mirësinë (e bashkëshortit ose të dikujt të tillë). Nuk kam parë të mangëta në mendje dhe fe, e që ia turbullojnë mendjen burrit të matur më shumë se ju (gratë).” - "E çfarë mangësie ka në fenë dhe mendjen tonë, o i Dërguari i Allahut?" - pyetën ato. - “A nuk konsiderohet dëshmia e gruas sa gjysma e dëshmisë së burrit?” - i pyeti Profeti ﷺ. - Po, ashtu është, - thanë ato. - “Kjo konsiderohet mangësi në mendje. Po ashtu, kur i vijnë menstruacionet, a nuk e lë namazin dhe agjërimin?” - Po, ashtu është, - thanë gratë. - “Kjo konsiderohet mangësi në fe”, - u tha Profeti ﷺ.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ doli në namazgjah ditën e Bajramit. Ai kishte premtuar që t’u mbante një hutbe të veçantë grave dhe e përmbushi premtimin e tij atë ditë. Ai tha: O ju gra, jepni sadaka (dhe kërkoni shpesh falje nga Allahu), sepse të dyja janë prej shkaqeve më të mëdha që fshijnë mëkatet. Vërtet, unë ju pashë në Natën e Israsë se ju ishit shumica e banorëve të Zjarrit.

Atëherë një grua nga mesi i tyre, e mençur, largpamëse dhe e respektuar, tha: "O i Dërguar i Allahut, përse ne jemi shumica e banoreve të Zjarrit?"

Ai tha: "Për disa arsye: ju shpesh mallkoni dhe përdorni fjalë fyese, dhe mohoni të drejtat e burrave tuaj." Pastaj Profeti ﷺ i përshkroi, duke thënë: "Nuk kam parë askënd me mangësi në mendje dhe në fe, që të jetë më dominues ndaj një njeriu të mençur, të arsyeshëm, të vendosur dhe të përmbajtur sesa ju."

Ajo tha: "O i Dërguar i Allahut, cila është mangësia në mendje dhe në fe?"

Ai tha: "Sa i përket mangësisë në mendje, ajo është fakti se dëshmia e dy grave është e barabartë me dëshminë e një burri; kjo është ajo që nënkuptohet me mangësi në mendje. Sa i përket mangësisë në fe, ajo është pakësimi i veprave të mira, sepse gruaja kalon net dhe ditë pa falur namaz për shkak të menstruacioneve dhe agjëron më pak ditë në Ramazan për të njëjtën arsye; kjo është ajo që nënkuptohet me mangësi në fe. Megjithatë, ato nuk kritikohen dhe as nuk janë përgjegjëse për këtë, sepse kjo është pjesë e natyrës së tyre, ashtu siç njeriu është krijuar i atillë që e do pasurinë, nxiton në çështjet e tij, është i paditur dhe me cilësi të tjera të ngjashme. Megjithatë, kjo është përmendur si paralajmërim ndaj mahnitjes pas tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Është e rekomanduar që gratë të marrin pjesë në faljen e Bajramit dhe t'u jepet një hutbe e veçantë.
2. Përbuzja e mirësive të burrit dhe mallkimi i shpeshtë janë mëkate të mëdha, sepse kërcënimi me

- zjarrin e Xhehenemit është shenjë që tregon se këto mëkate janë të mëdha.
3. Kjo tregon se besimi shtohet dhe pakësohet. Besimi dhe feja e një personi shtohen kur ai kryen shumë adhurime, ndërsa kryerja e pak adhurimeve çon në pakësimin e fesë së tij.
 4. Neveviu ka thënë: "Mendja është e nënshtruar ndaj shtimit dhe pakësimit, ashtu si edhe besimi. Përmendja e mangësisë te gratë nuk ka për qëllim t'i qortojë ato për këtë, pasi është pjesë e natyrës së tyre. Përkundrazi, qëllimi është paralajmërimi ndaj mahnitjes pas tyre. Për këtë arsye, dënimi është lidhur me mosmirënjohjen, përbuzjen (ndaj mirësive të burrit) dhe mëkatet e tjera të përmendura, e jo me vetë mangësinë. Mangësia në fe nuk kufizohet vetëm në atë që çon në mëkat, por përfshin një kuptim më të gjerë."
 5. Kjo nënkupton se nxënësi ose i udhëhequri mund t'i kërkojë dijetarit ose udhëheqësit sqarim për fjalët e tij, nëse ato nuk janë të qarta për të.
 6. Kjo tregon se dëshmia e një gruaje është sa gjysma e dëshmisë së një burri, për shkak të mungesës së përpikërisë së saj.
 7. Ibën Haxheri duke e komentuar fjalën e Profetit ﷺ: "Nuk kam parë të mangëta..." ka thënë: "Më duket se kjo është njëra nga arsyet pse ato janë shumica e

banoreve të Zjarrit; sepse, nëse ato janë shkak që një njeri i arsyeshëm ta humbasë mendjen, deri në atë masë sa të bëjë ose të thotë atë që nuk i ka hije, atëherë ato marrin pjesë në mëkatin e tij dhe madje e tejkalojnë atë në këtë mëkat."

8. Namazi dhe agjërimi janë të ndaluara për gruan gjatë menstruacioneve, dhe e njëjta vlen edhe për atë që është lehonë, dhe në të dyja rastet janë të obliguara të kompensojnë ditët e humbura të agjërimit pasi të pastrohen.
9. Morali i mirë i Profetit ﷺ, pasi ai u përgjigj pyetjeve për gratë pa i qortuar apo fajësuar ato.
10. Ibën Haxheri ka thënë: "Sadakaja e largon dënimin dhe mund të shlyejë mëkatet e bëra mes njerëzve."
11. Neveviu ka thënë: "Mangësia në fenë e grave është për shkak të braktisjes së namazit dhe agjërimit gjatë menstruacioneve. Besimi dhe feja e një personi shtohen kur ai kryen shumë adhurime, ndërsa kryerja e pak adhurimeve çon në pakësimin e fesë së tij. Për më tepër, mangësia në fe mund të ndodhë në mënyrë që të sjellë mëkat, siç është braktisja e namazit, agjërimit, apo ndonjë akti tjetër adhurimi të obliguar pa arsye të vlefshme; dhe mund të ndodhë në mënyrë që të mos të ketë mëkat, siç është braktisja e namazit të xhumasë, luftës në rrugën e Allahut, ose ndonjë vepër tjetër që nuk e ka obligim pa ndonjë arsye; ose mund të ndodhë në një mënyrë

që personi është i ngarkuar me të fetarisht, siç është braktisja e namazit dhe agjërit për një grua në kohën kur është me menstruacione."

(10011)

(247) - عَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِيَّاكُمْ وَالْدُّخُولَ عَلَى النِّسَاءِ» فَقَالَ رَجُلٌ مِنَ الْأَنْصَارِ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَفَرَأَيْتَ الْحُمُو؟ قَالَ: «الْحُمُو الْمَوْتُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(247) – Ukbe ibën Amiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kujdes! Mos hyni te gratë.” Një ensar tha: "O i Dërguari i Allahut, e nëse është kunati?" - “Kunati është sikurse vdekja”, - i tha Profeti ﷺ. [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka paralajmëruar kundër përzierjes me gratë e huaja dhe ka thënë: "Ruajuni që të mos hyni te gratë dhe gratë që të mos hyjnë tek ju!"

Një ensar tha: "Po si është rasti me të afërmit e burrit, si vëllai i tij (kunati), djali i vëllait, xhaxhai, djali i xhaxhait, djali i motrës dhe të ngjashëm me ta, me të cilët do t'i lejohej martesë, po të mos ishte e martuar?"

Profeti ﷺ tha: "Ruajuni e mos hyni te to, ashtu siç ruheni nga vdekja!" Kjo është sepse vetmia me të afërmit e burrit (si vëllai i tij) çon në sprova dhe shkatërrim në fe. Të afërmit e burrit, përveç babait dhe djemve të tij, janë më të ndaluar

se të huajt, sepse vetmia me ta është më e shpeshtë sesa me të tjerët. Nga ta pritet më shumë e keqja, si dhe sprova me ta është më e mundshme, për shkak të lehtësisë së arritjes së tyre tek gruaja dhe mundësisë për të qëndruar vetëm me të pa ndonjë qortim. Për më tepër, prania e tyre është e pashmangshme dhe nuk mund të pengohet, pasi zakonisht njerëzit janë të shkujdesur në këtë çështje. Kështu, ndodh që burri të qëndrojë vetëm me gruan e vëllait të tij, gjë që është e ngjashme me vdekjen, për shkak të neverisë dhe dëmit që sjell, ndryshe nga burri i huaj, ndaj të cilit njerëzit janë më të kujdesshëm.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalesa për të hyrë te gratë e huaja dhe për të qëndruar vetëm me to, bëhet për të mbyllur shtigjet që çojnë në imoralitet.
2. Ky është një rregull i përgjithshëm për të huajt, nga vëllai i burrit dhe të afërmit e tij, të cilët nuk janë mahrem për gruan. Duhet marrë parasysh që hyrja të përfshijë kushtin e qëndrimit të vetmuar.
3. Të qëndruarit larg situatave të rrëshqitjes në gabime është i përgjithshëm, nga frika e rënies në të keqe.
4. Neveviu ka thënë: "Dijetarët e gjuhës janë të një mendimi se termi (ar. ahma) i referohet të afërmeve të burrit të gruas, si babai i tij, xhaxhai, vëllai, djali i vëllait, djali i xhaxhait dhe të ngjashëm me ta.

Ndërsa termi (ar. ahtan) i referohet të afërmve të gruas së burrit. Sa i përket termit (ar. as'har), ai përfshin të dy grupet."

5. Profeti ﷺ e krahasoi (kunatin, të afërmin e burrit, ar. hamv-në) me vdekjen. Ibën Haxheri ka thënë: "Arabët e përshkruajnë diçka të urryer me vdekjen. Arsyeja e ngjashmërisë është se kjo përfaqëson vdekjen e fesë nëse ndodh mëkati; vdekjen e atij që qëndron i vetmuar, nëse ndodh mëkati dhe kërkohet dënimi me gurëzim, si dhe shkatërrimin e gruas për shkak të ndarjes nga burri i saj, nëse xhelozia e shtyn atë ta divorcojë."

(5888)

(248) - عن أبي موسى رضي الله عنه أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «لا

نِكَاحَ إِلَّا بِوَلِيٍّ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(248) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Nuk ka martesë, përveçse me kujdestar." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه] - [وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se martesë e një gruaje nuk është e vlefshme, përveçse me një kujdestar që kryen kontratën e martesës.

Mësime nga hadithi:

1. Kujdestari është kusht që martesë të jetë e vlefshme, nëse ajo bëhet pa kujdestar, ose, nëse gruaja vëtmartohet, atëherë martesë nuk është e vlefshme.
2. Kujdestar quhet ai burrë që është më i afërt me gruan. Andaj, kujdestari i largët nuk mund ta martojë atë, nëse gjendet ndonjë kujdestar më i afërt.
3. Kujdestari kushtëzohet të jetë: i ngarkuar me obligime fetare, të jetë mashkull, të jetë i pjekur sa u përket dobive të martesës, si dhe feja e kujdestarit dhe e asaj për të cilën bëhet kujdestar të jetë e njëjtë. Andaj, kush nuk i ka këto cilësi, nuk ka të drejtë kujdestarie në kontratën martesore.

(58066)

(249) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَيُّمَا امْرَأَةٍ نَكَحَتْ بِغَيْرِ إِذْنِ مَوْلَاهَا، فَنَكَحَهَا بِأُطْلٍ -ثَلَاثَ مَرَّاتٍ- فَإِنْ دَخَلَ بِهَا فَالْمَهْرُ لَهَا بِمَا أَصَابَ مِنْهَا، فَإِنْ تَشَاجَرُوا فَالسُّلْطَانُ وَلِيُّ مَنْ لَا وَلِيَ لَهُ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(249) – Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Çdo grua që martohet pa lejen e kujdestarëve të saj, martesë e saj

është e pavlefshme - tri herë (e përsëriti këtë). E nëse ai ka kryer marrëdhënie me të, ajo ka të drejtë për mehrin, në këmbim të marrëdhënive intime që ka pasur me të. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje mes tyre, atëherë sundimtari është kujdestari i asaj që nuk ka kujdestar." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith paralajmëroi se një grua nuk duhet ta japë veten në martesë, pa lejen e kujdestarëve të saj, dhe se martesë e saj konsiderohet e pavlefshme, ku këtë gjë e përsëriti tri herë, sikur martesë të mos kishte ndodhur fare.

Nëse ai që është martuar me të, pa lejen e kujdestarit të saj, ka kryer marrëdhënie me të, atëherë ajo ka të drejtë të marrë të gjithë mehrin (dhuratën martesore) për shkak të marrëdhënive intime që ka pasur me të.

Nëse kujdestarët polemizojnë për kujdestarinë e kontratës së martesës dhe janë të barabartë në këtë drejtim, atëherë kontrata i takon atij prej tyre që e fillon i pari, me kusht që kjo të bëhet duke pasur parasysh interesin më të mirë të saj.

Nëse kujdestari refuzon ta martojë atë, atëherë është sikur ajo të mos ketë kujdestar; në këtë rast, sundimtari ose përfaqësuesi i tij, si gjykatësi dhe të ngjashmit me të, bëhet kujdestar i saj. Përndryshe, sundimtari nuk ka kujdestari, nëse është i pranishëm një kujdestar legjitim.

Mësime nga hadithi:

1. Kujdestari ligjor është kusht për vlefshmërinë e martesës, dhe është transmetuar nga Ibën Mundhiri se asnjë nga shokët e Profetit ﷺ nuk është i njohur të ketë pasur një mendim tjetër nga ky.
2. Në rast të një martese të pavlefshme, gruaja ka të drejtë të marrë mehrin në këmbim të kryerjes së marrëdhënieve intime me të.
3. Sundimtari është kujdestari ligjor i çdo gruaje, që nuk ka kujdestar, qoftë sepse ai nuk ekziston fare, ose për shkak se ai e pengon atë nga martesa.
4. Sundimtari konsiderohet si kujdestar i atij që nuk ka kujdestar, në rast kur kujdestari është i papranishëm, ose nuk mund të përmbushë rolin e tij. Gjyqtari e luan rolin e sundimtarit, pasi ai është përfaqësuesi i tij në çështje të tilla.
5. Kujdestaria në martesën e një gruaje nuk do të thotë se ajo nuk ka të drejta; përkundrazi, ajo ka të drejta, dhe kujdestari i saj nuk lejohet ta martojë atë pa lejen e saj.
6. Kushtet e një martese të vlefshme janë: 1. Identifikimi i secilit prej bashkëshortëve përmes shenjave, emrit, përshkrimit etj. 2. Pëlqimi i ndërsjellë i të dy bashkëshortëve. 3. Kujdestari ligjor i gruas është ai që përmbyll kontratën e martesës në

emër të saj. 4. Dëshmitarët duhet të dëshmojnë për kontratën e martesës.

7. Kushtet që duhet t'i plotësojë kujdestari që përmyll kontratën e martesës janë: 1. Shëndeti mendor. 2. Të jetë mashkull. 3. Të jetë i rritur, duke arritur moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, ose duke arritur moshën e pjekurisë seksuale. 4. Të ketë të njëjtën fe, pasi askush që është jobesimtar nuk ka të drejtë kujdestarie mbi një besimtar ose një besimtare, po ashtu asnjë besimtar nuk ka të drejtë kujdestarie mbi një jobesimtar ose një jobesimtare. 5. Të jetë kompetent (al. adaleh) dhe jo i pabindur (ar. el fisk), dhe këtu është e mjaftueshme që ai të veprojë me qëllimin e sigurimit të interesit më të mirë të gruas, që ka përgjegjësinë ta martojë. 6. Kujdestari të jetë i mençur dhe jo mendjelehtë, do të thotë të ketë aftësinë të dallojë përshtatshmërinë e bashkëshortit të mundshëm dhe të kuptojë interesat që janë të përfshira në martesë.
8. Kujdestarët ligjorë të gruas për martesë kanë një rend të caktuar, sipas juristëve muslimanë, dhe nuk lejohet të anashkalohet kujdestari më i afërt përveç nëse ai mungon ose nuk i plotëson kushtet e nevojshme. Kujdestari i gruas është: babai i saj, pastaj kujdestari që ai ka caktuar për të, pastaj gjyshi i saj nga babai dhe gjithë paraardhësit e tij, pastaj djali i saj, pastaj djemtë e djalit të saj deri te të gjithë pasardhësit, pastaj vëllai i saj nga të dy

prindërit, pastaj vëllai i saj nga babai, pastaj djemtë e tyre, pastaj xhaxhai i saj nga të dy prindërit, pastaj xhaxhai i saj nga babai, pastaj djemtë e tyre, pastaj mashkulli më i afërt nga asabeh (të afërmit meshkuj që trashëgojnë), pastaj sundimtari musliman ose përfaqësuesi i tij, si gjykatësi, i cili bëhet kujdestar i asaj që nuk ka kujdestar.

(58067)

(250) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَلْعُونٌ مَنْ أَتَى امْرَأَتَهُ فِي دُبْرِهَا». [حسن] - [رواه أبو داود والنسائي في الكبرى وأحمد]

(250) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Është i mallkuar ai që kryen marrëdhënie anale me gruan e tij." [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والنسائي في الكبرى وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith paralajmëroi se burri që kryen marrëdhënie anale me gruan e tij është i mallkuar dhe i përjashtuar nga mëshira e Allahut, dhe se kjo vepër bën pjesë në mëkatet e mëdha.

Mësimet nga hadithi:

1. Është e ndaluar të kryhet marrëdhënie anale me gratë.

2. Lejohet për burrin të kënaqet me trupin e gruas, përveç anusit.
3. Muslimani i afrohet gruas së tij përmes marrëdhënies vaginale, ashtu siç e ka urdhëruar Allahu, ndërsa sa i përket marrëdhënies anale, ajo prish natyrën e shëndoshë, pengon shumimin, bie ndesh me natyrshmërinë e pastër njerëzore dhe shkakton dëme të mëdha për të dy bashkëshortët.

(58090)

(251) – عن عقبه بن عامر رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «أَحَقُّ الشُّرُوطِ أَنْ تُوفُوا بِهِ مَا اسْتَحَلَّتُمْ بِهِ الْفُرُوجَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(251) – Ukbe ibën Amiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Ndër kushtet që më së shumti meritojnë t'i përmbushni janë ato përmes të cilave ju lejohet afrimi me gratë tuaja." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se kushtet më të rëndësishme që meritojnë të përmbushen janë ato përmes të cilave lejohet të kënaqurit me gruan dhe këto janë kushtet e lejuara që i kërkon gruaja në kontratën e martesës.

Mësim nga hadithi:

1. Është obligim të plotësohen kushtet që njëri bashkëshort i ka kushtëzuar tjetrit, përveç kushtit që ndalon të lejuarën ose e bën të lejuar atë që është e ndaluar.
2. Përmbushja e kushteve të martesës është më e rëndësishme se të tjerat, sepse është në këmbim të lejimit të afrimit me gratë.
3. Pozita madhështore e martesës në Islam, sepse e theksoi përmbushjen e kushteve të saj.

(6021)

(252) – عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما أن رسول الله صلى الله عليه

وسلم قال: «الدُّنْيَا مَتَاعٌ، وَخَيْرُ مَتَاعِ الدُّنْيَا الْمَرْأَةُ الصَّالِحَةُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(252) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Dynjaja është një pasuri (kënaqësi) e përkohshme, ndërsa kënaqësia më e mirë e dynjasë është gruaja e devotshme." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se dynjaja dhe ajo që gjendet në të është diçka që përmes saj arrihet kënaqësi për një kohë dhe pastaj kalon, por kënaqësia më e mirë e saj është gruaja e devotshme, të cilën, kur e shikon, e gëzon; kur

e urdhëron, i bindet, e, kur nuk është i pranishëm, e ruan nderin dhe pasurinë e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Lejohet të kënaqemi me të mirat e dynjasë, të cilat Allahu ua ka lejuar robërve të Tij, pa teprim e pa mendjemadhësi.
2. Inkurajimi për ta zgjedhur gruan të devotshme, sepse kjo është ndihmesë për burrin që t'i bindet Zotit të tij.
3. Kënaqësia më e mirë e kësaj dynjaje është ajo gjë që është bindje ndaj Allahut ose të ndihmon për këtë gjë.

(5794)

(253) - عَنْ جَرِيرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ نَظَرِ الْفُجَاءَةِ فَأَمَرَنِي أَنْ أَصْرِفَ بَصَرِي. [صحيح] - [رواه مسلم]

(253) – Xherir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "E kam pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ (a bëj mëkat) në lidhje me shikimin e paqëllimshëm (në femrën e ndaluar), e ai më urdhëroi që ta ndal shikimin e të mos e vazhdoj atë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Xherir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pyeti Profetin ﷺ për një burrë që shikon një grua të huaj befas, paqëllimshëm, kësisoj Profeti ﷺ e urdhëroi që ta kthejë fytyrën nga ana tjetër sapo ta marrë vesh (se nuk e ka të lejuar ta shohë të tillën), kështu që nuk ka mëkat për këtë.

Mësim nga hadithi:

1. Inkurajimi për ta ulur shikimin (nga harami).
2. Tërheqja e vërejtjes kundër vazhdimit të shikimit në atë që është e ndaluar të shikohet, nëse shikimi rastis në të befas, paqëllimshëm.
3. Prej dobive të këtij hadithi është se të qenët haram shikimi i grave është një çështje e vërtetuar në mesin e sahabëve, siç dëshmohet nga fakti se Xheriri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pyeti Profetin ﷺ nëse shikimi i tij rastis mbi një grua paqëllimshëm se a është njësoj ky vendim sikurse vendimi për atë që qëllimshëm e shikon (një grua të huaj).
4. Këtu shfaqet kujdesi i fesë për interesat e njerëzve, pasi ajo ua ka ndaluar atyre shikimin e grave për shkak të dëmeve që sjell, si në këtë botë, ashtu dhe në botën tjetër.
5. Kthimi i sahabëve te Profeti ﷺ dhe pyetja e tij për atë që u dukej e paqartë është një shembull se si njerëzit

e zakonshëm duhet të kthehen te dietarët e tyre dhe t'u bëjnë pyetje për gjërat e paqarta.

(8902)

(254) - عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: ضَحَّى النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ بِكَبْشَيْنِ أَمْلَحَيْنِ أَقْرَنَيْنِ، ذَبَحَهُمَا بِيَدِهِ، وَسَمَى وَكَبَّرَ، وَوَضَعَ رِجْلَهُ عَلَى صِفَاحِهِمَا. [صحيح] - [متفق عليه]

(254) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Profeti ﷺ i theri dy desh të larmë e me brirë. Që të dy i theri me dorën e vet, duke thënë: "Bismilah (me emrin e Allahut)" e duke bërë tekbir (duke thënë: "Allahu ekber") dhe duke ua vendosur këmbën në faqe." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ i theri me dorën e tij në ditën e Bajramit të Kurbanit, dy desh me brirë të bardhë të përzier me të zezë dhe tha: "... duke thënë: "Bismilah, Allahu ekber" dhe duke ua vendosur këmbën në qafë.

Mësime nga hadithi:

1. Përligjja e therjes së kurbanit dhe se muslimanët janë të pajtuar njëzëri për këtë.
2. Më mirë është që kurbanit të jetë i atij lloji që ka bërë kurban Profeti ﷺ, për shkak të pamjes së tij të bukur

- dhe për shkak se dhjami e mishi i tij janë më të këndshëm.
3. Neveviu ka thënë: "Ky hadith tregon se është e pëlqyeshme që njeriu ta marrë përsipër therjen e kurbanit të tij vetë dhe të mos e autorizojë askënd për therjen e tij, përveç në rast arsyeje, e në atë rast është e pëlqyeshme që ai të jetë dëshmitar gjatë therjes së tij. Atij që autorizon një musliman për therjen e kurbanit të tij, i lejohet kjo gjë pa asnjë mospajtim mes dijetarëve."
 4. Ibën Haxheri ka thënë: "Ky hadith tregon se është e pëlqyeshme thënia: "Allahu ekber" së bashku me besmelen gjatë therjes dhe vendosja e këmbës në qafë, në anën djathtë të kurbanit. Dijetarët janë të pajtimit që kafsha të shtrihet në anën e majtë, kështu që kasapi ta vendosë këmbën e tij në anën e djathtë, në mënyrë që ta ketë më të lehtë ta marrë thikën me të djathtën dhe ta mbajë kokën e tij me dorën e majtë."
 5. Është e pëlqyeshme që kurbanit të jetë me brirë, por lejohet të bëhet edhe nëse nuk ka.

(2971)

(255) - عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى أَنَّهُمْ كَانُوا عِنْدَ حُدَيْفَةَ، فَاسْتَسْقَى فَسَقَاهُ مُجُوسِيٌّ، فَلَمَّا وَضَعَ الْقَدَحَ فِي يَدِهِ رَمَاهُ بِهِ، وَقَالَ: لَوْلَا أَنِّي نَهَيْتُهُ غَيْرَ مَرَّةٍ وَلَا مَرَّتَيْنِ - كَأَنَّهُ يَقُولُ: لَمْ أَفْعَلْ هَذَا-، وَلَكِنِّي سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «لَا تَلْبَسُوا الْحَرِيرَ وَلَا الدِّيْبَاجَ، وَلَا تَشْرَبُوا فِي آنِيَةِ الذَّهَبِ وَالْفِضَّةِ، وَلَا تَأْكُلُوا فِي صِحَافِهَا، فَإِنَّهَا لَهُمْ فِي الدُّنْيَا وَلَنَا فِي الْآخِرَةِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(255) – Abdurrahman ibën Ebi Lejla tregon: "Njëherë, teksa ishim te Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ai kërkoi ujë për të pirë. Një zjarrputist i dha një enë për të pirë. Posa ia vuri sapllakun në dorë, Hudhejfja e gjuajti me të dhe tha: "Sikur të mos ia kisha ndaluar këtë gjë më shumë se një a dy herë!" (Disi deshi të thoshte se, nuk do ta gjuaja me të po të mos ia kisha ndaluar një apo dy herë, por në fakt, ia kam ndaluar më shumë se një apo dy herë!). E kam dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Mos vishni mëndafsh e as veshje të përziera me mëndafsh, mos pini në enë prej ari e argjendi dhe mos hani në enë të tilla, sepse ato janë për ta (jobesimtarët) në dynja, kurse për ne në ahiret!” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e ka ndaluar që burrat të veshin mëndafsh, dhe këtu përfshihen të gjitha llojet e tij. Gjithashu ai i ka ndaluar meshkujt dhe femrat të hanë e të pinë në enët e arit dhe argjendit. Ai ka treguar se ato janë ekskluzive për besimtarët në Ditën e Kiametit, ngaqë nuk i përdorën ato në këtë botë në shenjë nënshtrimi ndaj Allahut. E, sa u përket

jobesimtarëve, ata nuk do të kenë gjëra të tilla në ahiret, sepse të mirat e tyre i përshpejtuan në jetën e kësaj bote duke i përdorur dhe duke e kundërshtuar urdhrin e Allahut.

Mësime nga hadithi:

1. Veshja e mëndafshit dhe e veshjeve të tjera të përziera me mendafsh janë të ndaluara të vishen për meshkujt dhe në lidhje me këtë ceket kërcënim i rëndë për atë që i vesh.
2. Lejohet që gratë të veshin mëndafsh dhe veshje të tjera të përziera me mëndafsh.
3. Ndalohet ngrënia dhe pija në enët e arit dhe argjendit për meshkujt dhe femrat.
4. Hudhejfja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u tregua i ashpër në formën e qortimit dhe këtë gjë e arsyetoi me faktin se e kishte ndaluar më shumë se një herë nga përdorimi i enëve prej ari dhe argjendi, por ai nuk ia vuri veshin.

(2985)

(256) - عن علي رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «رُفِعَ الْقَلَمُ عَنْ ثَلَاثَةٍ: عَنْ النَّائِمِ حَتَّى يَسْتَيْقِظَ، وَعَنْ الصَّبِيِّ حَتَّى يَحْتَلِمَ، وَعَنْ الْمَجْنُونِ حَتَّى يَعْقِلَ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه وأحمد]

(256) – Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Lapsi (për shkrimin e mëkateve) është pezulluar për tre persona: për atë që është në gjumë, derisa të zgjohet; për fëmijën, derisa të hyjë në moshën e pubertetit dhe për të çmendurin, derisa t'i kthehet mendja.” [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se njerëzit janë të ngarkuar me obligime fetare, përpos tre prej tyre:

1. Fëmija i vogël, derisa të rritet dhe ta arrijë moshën e pubertetit.
2. I çmenduri, të cilit i ka ikur mendja, derisa t'i kthehet ajo.
3. Ai që është në gjumë, derisa të zgjohet.

Përgjegjësia për të kryer obligime fetare është hequr prej tyre dhe mëkatet që i bëjnë nuk u shkruhen, por veprat e mira u shkruhen fëmijëve të vegjël, ndryshe nga të çmendurit dhe ata që janë në gjumë, sepse këta të fundit janë në kategorinë e atyre që nuk janë të aftë për të kryer adhurime të vlefshme për shkak të mungesës së vetëdijes.

Mësime nga hadithi:

1. Humbja e përgjegjësisë ligjore te njeriu ndodh ose për shkak të gjumit, i cili e privon nga zgjimi për t'i kryer obligimet; ose për shkak të moshës së re dhe fëmijërisë, që e bën të paaftë për përgjegjësi; ose për shkak të çmendurisë, e cila shkakton çrregullime në funksionet mendore ose gjendjeve të ngjashme, siç është dehja. Andaj, kushdo që humb aftësinë për të dalluar dhe për të pasur perceptim të saktë, rrjedhimisht për shkak të ndonjërit prej këtyre tri shkaqeve e humb aftësinë për të qenë përgjegjës për veprimet e tij, atëherë Allahu me drejtësinë, butësinë dhe bujarinë e Tij, ia heq përgjegjësinë - qortimin për çfarëdo lloj gabimi ose mangësie që mund të bëjë në raport me të drejtat e Allahut të Lartësuar.
2. Mosshkrimi i mëkateve për ta nuk bie ndesh me vlefshmërinë e disa gjykimeve të kësaj bote për ta. Për shembull, nëse një i çmendur vret dikë, për të nuk ka ndëshkim me hakmarrje e as shlyerje (ar. kefarah), por përgjegjësia për gjakun (dëmshpërblimin) bie mbi familjen e tij të afërt.
3. Shenjat e moshës së pubertetit janë tri: dalja e spermës, qoftë përmes ëndrrave, qoftë në forma të tjera; rritja e qimeve në vendet e turpshme dhe mbushja e moshës pesëmbëdhjetëvjeçare. Për

femrën shtohet edhe një shenjë e katërt: menstruacionet.

4. Subkiu ka thënë: "Sabija (fëmija i vogël) është vetë gulami (fëmija i vogël)." Ndërkaq, të tjerët kanë thënë: "Fëmija kur është në barkun e nënës quhet xhenin (embrion) e, pasi lind, quhet sabij (foshnjë). Pasi të jetë larguar nga gjiri, quhet gulam deri në moshën shtatëvjeçare. Pastaj quhet jafi' (i ri) deri në moshën dhjetëvjeçare. Pastaj hazur deri në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare." Megjithatë, gjykimi përfundimtar është se në të gjitha këto faza ai quhet sabij (fëmijë), siç e ka theksuar Sujutiu.

(58148)

(257) - عن ابن عمر رضي الله عنهما: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَهَى

عَنِ الْقَزَعِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(257) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqu me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar rruajtjen e pjesërishme të kokës (kazea). [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e ka ndaluar rruajtjen e një pjese të kokës së fëmijës dhe lënien e një pjese tjetër.

Kjo ndalesë është e përgjithshme për të gjithë meshkujt, qofshin të vegjël, qofshin të mëdhenj. E, sa u përket femrave, atyre nuk u lejohet t'i rruajnë flokët.

Mësime nga hadithi:

1. Feja i kushton rëndësi pamjes së njeriut.

(8914)

(258) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «الْحَلِيفُ مَنْفَقَةٌ لِلسَّلْعَةِ، مَمْحَقَةٌ لِلرَّيْبِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(258) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Betimi (në tregti) mundëson shitjen e produktit, por e zhduk bereqetin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka paralajmëruar kundër betimit dhe përsëritjes së tij të shpeshtë, edhe nëse njeriu është i sigurtë gjatë shitblerjes. Ai ka treguar se një gjë e tillë mund të ndihmojë në shitjen e mallit dhe në promovimin e tij, por në të vërtetë e pakëson dhe ia zhduk bereqetin fitimit. Allahu i Lartësuar mund ta shkatërrojë këtë pasuri në forma të ndryshme: përmes vjedhjes, zjarrit, fundosjes, konfiskimit, plaçkitjes ose në çfarëdo mënyre tjetër që e çon në humbjen e pasurisë së njeriut.

Mësime nga hadithi:

1. Madhështia e betimit në emër të Allahut dhe se ai duhet bërë vetëm kur është i domosdoshëm.

2. Fitimi i ndaluar, edhe nëse është i madh në sasi, është i privuar nga begatia dhe i zbrazët nga e mira.
3. El Kariu ka thënë: "Humbja e begatisë në pasurinë e fituar mund të ndodhë përmes shkatërrimit, që e godet atë pasuri, përmes shpenzimit në mënyra që nuk i sjellin asnjë dobi në këtë botë e as shpërblim në botën tjetër; ose mbetet me të, por ai privohet nga përfitimi i saj; ose e trashëgon dikush që nuk e vlerëson."
4. Neveviu ka thënë: "Prej dobive të këtij hadithi është ndalimi i betimit të shpeshtë në shitblerje, pasi betimi pa nevojë është i qortuar. Për më tepër, ai e promovon mallin, ndërsa blerësi mund të mashtrohet nga betimi."
5. Betimi i shpeshtë është mangësi në besim dhe mangësi në teuhid, sepse betimi i tepërt çon në dy gjëra: E para, në pakujdesi dhe moskokëçarje ndaj kësaj çështjeje. E dyta, në gënjeshtëri, sepse ai që betohet shpesh rrezikon të bie në gënjeshtëri. Prandaj, njeriu duhet ta minimizojë këtë dhe të përmbahet nga betimi i tepërt, e për këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Por ruajini betimet tuaja!" (El Maide, 89)

(259) – عن ابن عمر رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال:

«أَحْفُوا الشَّوَارِبَ وَأَعْفُوا اللَّحَى». [صحيح] - [متفق عليه]

(259) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Shkurtojini mustaqet dhe lëshojini mjekrat!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar që të shkurtohen mustaqet e të mos rriten, madje të shkurtohen shumë.

Po ashtu urdhëroi të lëshohet mjekra dhe të lihet ashtu e dendur.

Mësim nga hadithi:

1. Rruajtja e mjekrës është haram.

(3279)

(260) – عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ

وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا يَنْظُرُ الرَّجُلُ إِلَى عَوْرَةِ الرَّجُلِ، وَلَا الْمَرْأَةُ إِلَى عَوْرَةِ الْمَرْأَةِ، وَلَا يُفْضِي الرَّجُلُ إِلَى الرَّجُلِ فِي ثَوْبٍ وَاحِدٍ، وَلَا تُفْضِي الْمَرْأَةُ إِلَى الْمَرْأَةِ فِي الثَّوْبِ الْوَاحِدِ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(260) – Nga Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Burri nuk duhet t'i shikojë pjesët intime të një burri tjetër, e as gruaje nuk duhet t'i shikojë pjesët intime të një gruaje tjetër. Dhe nuk bën që burri të futet në shtrat me një burrë tjetër,

ose të rrijë me të nën të njëjtën rrobë e as gruaja nuk bën të futet në shtrat me një grua tjetër, ose të rrijë me të nën të njëjtën rrobë". [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e ka ndaluar që burri të shikojë pjesët intime të një burri tjetër, ose gruaja të shikojë pjesët intime të një gruaje tjetër.

Pjesët intime janë ato pjesë të trupit që njeriu turpërohet kur ato zbulohen. Pjesët intime të burrit janë pjesët midis kërthizës dhe gjunjëve. Ndërsa trupi i gruas është i gjithi intim sa i takon burrave të huaj. E sa i takon grave dhe njerëzve të familjes, ajo mund të zbulojë përpara tyre ato pjesë që i zbulon zakonisht kur bën punët e shtëpisë.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e ndaloi gjithashtu që burri të rrijë në intimitet me një burrë tjetër nën të njëjtën rrobë, ose nën të njëjtën mbulesë, duke qenë të dy lakuriq. Apo që gruaja të rrijë në intimitet me një grua tjetër nën të njëjtën rrobë, ose nën të njëjtën mbulesë, duke qenë të dyja lakuriq. Ngase kjo mund të shpjerë në prekjen e pjesëve intime të tjetrit, gjë e cila është e ndaluar, siç është i ndaluar shikimi i pjesëve intime. Bile, prekja është më e rëndë se shikimi, ngase prekja shpie në pasoja më të rënda.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalimi i shikimit të pjesëve intime të të tjerëve, me përjashtim të bashkëshortëve.

2. Kujdesi i Islamit për dëlirësinë e shoqërisë dhe për mbylljen e rrugëve të së keqes.
3. Lejohet të shikohen pjesët intime kur e lyp nevoja, siç është nevoja për t'u mjekuar ose diçka e ngjashme, me kusht që të mos jetë me epsh.
4. Muslimani urdhërohet që t'i mbulojë pjesët intime të trupit të tij dhe të ulë shikimin nga pjesët intime të të tjerëve.
5. Ndalesa në këtë hadith është specifikuar me burrat midis tyre dhe gratë midis tyre, sepse shikimi dhe zbulimi i pjesëve intime ndodh më shpesh në raste të këtilla.

(8904)

(261) – عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما قال: لَمْ يَكُنِ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَاحِشًا وَلَا مُتَفَحِّشًا، وَكَانَ يَقُولُ: «إِنَّ مِنْ خِيَارِكُمْ أَحْسَنَكُمْ أَخْلَاقًا».

[صحيح] - [متفق عليه]

(261) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: "Profeti ﷺ nuk ka qenë vulgar në të folur e as në sjellje." Ai thoshte: “Më i miri prej jush është ai që e ka sjelljen më të mirë.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Nuk ishte pjesë e sjelljes së Profetit ﷺ të fliste fjalë të ndyta ose të bënte vepra të ndyta. Ai as që synonte një gjë të tillë, sepse kishte sjellje shumë fisnike.

Profeti ﷺ thoshte: "Më i miri prej jush tek Allahu është ai që e ka sjelljen më të mirë, e kjo arrihet duke bërë mirë, duke qenë i i buzëqeshur, duke e larguar dëmin nga të tjerët dhe duke e duruar dëmin që mund të ta shkaktojnë, si dhe duke u përzier me njerëzit në formë të mirë.

Mësime nga hadithi:

1. Muslimani duhet të largohet nga fjalët dhe vepra e ndyra.
2. Sjellja e Profetit ﷺ ishte e përkryer, sepse bënte vetëm vepra të mira dhe thoshte vetëm fjalë të këndshme.
3. Sjellja e mirë është arenë konkurrence, kështu që, kush del fitimtar, është ndër besimtarët më të mirë dhe me besimin më të plotë.

(5803)

(262) - عن عائشة رضي الله عنها قالت: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «إِنَّ الْمُؤْمِنَ لَيُدرِكُ بِحُسْنِ خُلُقِهِ دَرَجَةَ الصَّائِمِ الْقَائِمِ». [صحيح بشواهدہ] - [رواه أبو داود وأحمد]

(262) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Vërtet besimtari përmes sjelljes së mirë i arrin shkallët e agjëruesit dhe të atij që falet natën (në vazhdimësi)." [Ky hadith është sahih përmes transmetimeve të tjera përforcuese] - [رواه أبو داود وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se sjellja e mirë e sjell pronarin e saj në pozitën e atij që agjëron rregullisht ditën dhe falet rregullisht gjatë natës. Sjellja e mirë përmbledhet në këto gjëra: të bësh mirë, të flasësh mirë, të kesh fytyrë të buzëqeshur, ta largosh dëmin nga të tjerët dhe t'i durosh ata nëse të shkaktojnë dëm.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e madhe që Islami ia kushton rregullimit dhe përsosjes së sjelljes.
2. Vlera e sjelljes së mirë, saqë robi përmes saj e arrin pozitën e atij që agjëron vazhdimisht dhe të atij që falet natën pa u lodhur.
3. Agjërimi gjatë ditës dhe namazi i natës janë dy vepra madhështore, të cilat janë të vështira për shpirtin dhe njeriu me sjellje të mirë e arrin pozitën e tyre,

sepse është në betejë me veten e tij përmes sjelljes së mirë.

(5799)

(263) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «أَكْمَلُ الْمُؤْمِنِينَ إِيمَانًا أَحْسَنُهُمْ خُلُقًا، وَخَيْرُكُمْ خَيْرُكُمْ لِنِسَائِهِمْ». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

(263) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Besimtari me besimin më të plotë është ai që ka moral më të mirë. Më të zgjedhurit prej jush janë ata që janë më të mirët me gratë e tyre." [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se njeriu me besimin më të plotë është ai që e ka moralin më të mirë, e kjo arrihet duke e pasur fytyrën të qeshur, duke bërë vepra të mira, duke folur mirë dhe duke e larguar të keqen.

Besimtarët më të mirë janë ata që janë më të mirët me gjininë femërore, si: bashkëshortet, vajzat, motrat dhe të afërmet e tyre, sepse ato janë ndër njerëzit më meritorë për të pasur moral të mirë me to.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e moralit të mirë dhe se ai është prej besimit.

2. Vepra është prej besimit dhe besimi shtohet e pakësohet.
3. Islami e nderon femrën dhe inkurajon t'i bëhet mirë asaj.

(5792)

(264) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: سُئِلَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ أَكْثَرِ مَا يُدْخِلُ النَّاسَ الْجَنَّةَ، فَقَالَ: «تَقْوَى اللَّهِ وَحُسْنُ الْخُلُقِ»، وَسُئِلَ عَنْ أَكْثَرِ مَا يُدْخِلُ النَّاسَ النَّارَ فَقَالَ: «الْفَمُّ وَالْفَرْجُ». [حسن صحيح] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(264) – Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë." Gjithashtu është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Zjarr, e në atë rast ka thënë: "Goja dhe organi gjenital." [Hadith hasen-sahih] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se dy janë shkaqet më të mëdha që e fusin (besimtarin) në Xhenet, të cilat janë:

Devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë.

Devotshmëria ndaj Allahut (takvallëku) nënkupton që ndërmjet teje dhe dënimit të Allahut të vendosësh mburojë,

gjë që arrihet duke i kryer urdhrat dhe duke iu shmangur ndalesave.

Sjellja e mirë nënkupton që (besimtari) të jetë i buzëqeshur, të bëjë mirë dhe ta largojë pengesën (nga të tjerët).

Dy shkaqe janë kryesoret që fusin në Zjarr, të cilat janë: Gjuha dhe organi gjenital.

Prej mëkateve që i bën gjuha, janë: gënjeshtria, përgojimi, bartja e fjalëve e të tjera.

Prej mëkateve që i bën organi gjenital janë: kurvëria, homoseksualizmi e të tjera.

Mësime nga hadithi:

1. Hyrja në Xhenet ka shkaqe që lidhen me Allahun e Lartësuar, ku bën pjesë: devotshmëria ndaj Allahut dhe shkaqe që lidhen me njerëzit, ku hyn sjellja e mirë.
2. Rreziku i gjuhës për vetë njeriun dhe se ajo është nga shkaqet e futjes në Zjarr.
3. Rreziku i epsheve dhe veprimeve të turpshme për njerëzit, dhe se ato janë ndër shkaqet që më së shumti fusin në Zjarr.

(5476)

(265) – عن أنس بن مالك رضي الله عنه قال: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَحْسَنَ النَّاسِ خُلُقًا. [صحيح] - [متفق عليه]

(265) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu me moralin më të mirë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ishte njeriu me moralin më të mirë dhe ishte i pari në të gjitha moralet dhe virtytet, si: fjalët e mira, bamirësia, fytyra e buzëqeshur, largimi i dëmit nga të tjerët dhe durimi i tij nëse të tjerët shaktojnë dëm.

Mësime nga hadithi:

1. Morali i përkryer i Profetit ﷺ.
2. Profeti ﷺ është modeli i përsosur për moralin e mirë.
3. Nxitja për të ndjekur shembullin e Profetit ﷺ në moralin e tij të mirë.

(6180)

(266) - قال سعد بن هشام بن عامر - عندما دخل على عائشة رضي الله عنها - : يَا أُمَّ الْمُؤْمِنِينَ، أَنْبِئِي عَن خُلُقِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَالَتْ: أَلَسْتُ تَقْرَأُ الْقُرْآنَ؟ قُلْتُ: بَلَى، قَالَتْ: فَإِنَّ خُلُقَ نَبِيِّ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ الْقُرْآنَ. [صحيح] - [رواه مسلم في جملة حديث طويل]

(266) - Kur Sad ibën Hisham ibn Amri hyri tek Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i tha: "Oj nëna e besimtarëve, më informo për moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ!" Ajo i tha: "A nuk e lexon Kuranin?" Thashë: "Po." Ajo tha: "Morali i Profetit të Allahut ﷺ ishte Kurani." [Ky hadith është sahih] - [رواه مسلم في جملة حديث طويل]

Shpjegimi:

Nëna e besimtarëve, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), është pyetur për moralin e Profetit ﷺ e ajo u përgjigj me një fjalë gjithëpërfshirëse, kur pyetësin e ktheu te Kurani i madhërishtëm, i cili ngërthen në vete të gjitha atributet e përsosurisë. Ajo tha se Profeti ﷺ stolisej me moralin e Kuranit: atë që Kurani e urdhëroi, ai e jetësoi; atë që Kurani e ndaloi, ai u largua prej saj. Pra, morali i tij ishte vënia e tij në praktikë, ndalimi të kufijte të tij, stolisja me edukatën e tij dhe marrja mësim nga shembujt e tregimet kuranore.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të ndjekur shembullin e Profetit ﷺ në stolisjen e tij me moralin e Kuranit.

2. Lavdërimi i moralit të të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe se ai kishte zanafillë shpalljen.
3. Kurani është burimi i të gjitha virtyeteve fisnike.
4. Morali në Islam përfshin tërë fenë, duke i vepruar urdhrat dhe duke iu shmangur ndalesave.

(8265)

(267) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُعْجِبُهُ التَّيْمُنُ، فِي تَتَعُّلِهِ، وَتَرْجُلِهِ، وَطُحُورِهِ، وَفِي شَأْنِهِ كُلِّهِ. [صحيح] - [متفق عليه]

(267) – Nga nëna e besimtarëve, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), transmetohet se ka thënë: "Profetiti ﷺ, gjatë mbathjes së sandaleve, krehjes së flokëve, pastrimit dhe çdo pune tjetër, i pëlqente të fillonte nga ana e djathtë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profetiti ﷺ i pëlqente dhe e preferonte të fillonte me të djathtën në çështjet që kanë të bëjnë me nderim, duke përfshirë: Fillimin me këmbën e djathtë gjatë mbathjes së sandaleve, krehjen, rregullimin dhe vajosjen e flokëve dhe mjekrës. Gjithashtu, gjatë marrjes abdes i jep përparësi së djathtës para së majtës, qofshin duar, qofshin këmbë.

Mësime nga hadithi:

1. Neveviu ka thënë: "Kjo është rregull e vazhdueshme në ligjin islam: Çfarë ka të bëjë me çështjen e nderimit dhe respektit, fjala vjen, të veshësh rroba, shallvare e meste, hyrja në xhami, përdorimi i misvakut, vendosja e syrmave në qepalla, prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, krehja (dhe vajosja) e flokëve, shkulja e qimeve të nënsqetullave, rruarja e kokës, dhënia e selamit kur të përfundojë namazi, larja e pjesëve të abdesit, dalja nga tualeti, ngrënia dhe pirja, përshëndetja me duar, prekja e Gurit të Zi (në Qabe dhe puthja e tij) dhe të tjera gjëra që hyjnë në këtë kuptim, rekomandohet të fillohet me anën e djathtë. Sa i përket asaj që është e kundërta (e asaj që është lartcekur), siç është hyrja në tualet, dalja nga xhamia, fryrja e hundëve, heqja e papastërtive, heqja e rrobës, shallvareve, mesteve, dhe të ngjashme, atëherë është e rekomanduar të fillohet me anën e majtë. Kjo, për shkak të nderimit dhe respektit për anën e djathtë.
2. "i pëlqente të fillonte nga ana e djathtë", që përfshin: fillimin e veprimeve me dorën e djathtë, këmbën e djathtë, anën e djathtë dhe trajtimin e diçkaje me të djathtën.
3. Neveviu ka thënë: "Dije se ka nga pjesët e abdesit, për të cilat nuk është gjë e pëlqyeshme të fillohet me të djathtën, siç janë: veshët, pëllëmbët e duarve dhe

dy mollëzat e faqeve, përkundrazi, ato pastrohen njëkohësisht. E, nëse kjo nuk është e mundur, si në rastin e ndonjë personi që ka ndonjë gjymtyrë të tillë të prerë, atëherë i jepet përparësi anës së djathtë."

(3018)

(268) – عن شداد بن أوس رضي الله عنه قال: ثِنْتَانِ حَفِظْتُهُمَا عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ اللَّهَ كَتَبَ الْإِحْسَانَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ، فَإِذَا قَتَلْتُمْ فَأَحْسِنُوا الْقِتْلَةَ، وَإِذَا ذَبَحْتُمْ فَأَحْسِنُوا الذَّبْحَ، وَلِيُحَدِّ أَحَدُكُمْ شَفْرَتَهُ، فَلْيُرِحْ ذَبِيحَتَهُ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(268) – Shedad ibën Evsi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Dy gjëra i kam mbajtur në mend nga i Dërguari i Allahut ﷺ: "Me të vërtetë, Allahu ka urdhëruar mirësinë në çdo çështje, andaj, kur të vrisni, vritni në mënyrën më të mirë dhe, kur të therni, therni në mënyrën më të mirë: mprihni thikat dhe qetësojeni bagëtinë (kurbanin)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar mirësinë në çdo çështje. Mirësia nënkupton që robin ta shoqërojë në vazhdimësi ndjenja se Allahu e vëzhgon gjatë adhurimit të Tij, kur bën hair, kur t'ua largojnë ndonjë dëmtim krijesave. Këtu bëjnë pjesë edhe vrasja e therja.

Mirësia gjatë vrasjes sipas kisasit (ligjit të barazisë në ndëshkim) është që gjatë implementimit të këtij ndëshkimi të zgjidhet mënyra më e lehtë, më e butë dhe më e shpejtë për atë që ekzekutohet.

Mirësia gjatë therjes është që të tregohet i butë ndaj bagëtisë, fillimisht duke mprehur mirë thikën, por të mos e mprehë atë para bagëtisë, si dhe të mos e shohin therjen bagëtitë e tjera.

Mësime nga hadithi:

1. Mëshira dhe butësia e Allahut me krijesat.
2. Mirësia gjatë vrasjes dhe therjes bëhet në formë të ligjësuar.
3. Përsosja e sheriatit (ligjit islam) dhe se ai i përfshin të gjitha të mirat, e prej kësaj janë mëshira dhe butësia ndaj kafshëve.
4. Është i ndaluar gjymtimi i njeriut pas vrasjes së tij.
5. Ndalohet çdo gjë që përfshin torturimin e kafshëve.

(4319)

(269) – عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ الْمُفْسِطِينَ عِنْدَ اللَّهِ عَلَى مَنَابِرٍ مِنْ نُورٍ، عَنْ يَمِينِ الرَّحْمَنِ عَزَّ وَجَلَّ، وَكَلْنَا يَدَيْهِ يَمِينٌ، الَّذِينَ يَعْدِلُونَ فِي حُكْمِهِمْ وَأَهْلِيهِمْ وَمَا وَلُّوا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(269) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Prijësit e drejtë tek Allahu do të jenë në podiume drite, në të djathtën e Rrahmanit (Allahut) të Lartësuar, e që të dyja Duart e Tij i ka të djathta. Këta janë ata të cilët janë të drejtë në gjykimin e tyre, të drejtë me familjet e tyre dhe me këdo që e kanë nën përgjegjësi.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na njofton se ata që gjykojnë me drejtësi dhe me hak mes njerëzve, të cilët i kanë nën përgjegjësinë, gjykimin e tyre dhe janë nga familja e tyre, do të ulen në karrige të larta, që janë krijuar prej dritës, si nderim për ta në Ditën e Kiametit. Këto podiume janë në të djathtë të të Gjithëmëshirshmit të Lartësuar, ndërkohë të dyja Duart e Tij janë të djathta.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera dhe inkurajimi i drejtësisë.
2. Drejtësia është e përgjithshme dhe përfshin të gjitha përgjegjësitë dhe gjykimet midis njerëzve, madje

edhe drejtësinë midis grave dhe fëmijëve, e kështu me radhë.

3. Sqarimi i pozitës së të drejtëve në Ditën e Kiametit.
4. Pozitat e besimtarëve do të dallojnë nga njëri-tjetri në Ditën e Kiametit, në bazë të veprave.
5. Metoda e inkurajimit është një nga metodat e thirrjes, që e inkurajon të thirrurin që të bindet.

(4935)

(270) - عن أبي سعيد الخدري رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «لَا ضَرَرَ وَلَا ضِرَارَ، مَنْ ضَارَّ ضَرَّهُ اللَّهُ، وَمَنْ شَاقَّ شَقَّ اللَّهُ عَلَيْهِ». [صحيح بشواهد] - [رواه الدارقطني]

(270) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "S'ka dëm e as dëmtim. Atë që e dëmton (ndonjë besimtar), Allahu do ta dëmtojë, ndërsa atij që ia vështirëson (ndonjë besimtari), Allahu do t'ia vështirësojë." [Ky hadith është sahih përmes transmetimeve të tjera përforcuese] - [E shënon Darakutniu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka thënë se dëmi me të gjitha llojet dhe manifestimet e tij duhet të pengohet nga vetja dhe nga të tjerët, kështu që është njësoj e nuk i lejohet askujt që të dëmtojë as vetveten e as të tjerët.

Atij nuk i lejohet që ta kthejë dëmin me dëm, sepse dëmi nuk zhbëhet me dëm, veçse gjatë implementimit të ligjit të barazisë në ndëshkim (ar. kisas), duke mos bërë shkelje në këtë rast.

Pastaj Profeti ﷺ e sqaroi kërcënimin për atë që i dëmton të tjerët, se do ta zërë dëmi dhe atë që ua vështirëson njezëzve, do ta zërë vështirësia.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalimi i ndëshkimit me më shumë sesa që ka bërë dëm.
2. Allahu nuk i urdhëroi robërit e Tij diçka që u bën dëm.
3. Dëmtimi është i ndaluar, qoftë me fjalë e vepër, qoftë me lënie.
4. Ndëshkimi është sipas llojit të veprës: "Atë që e dëmton (ndonjë besimtar), Allahu do ta dëmtojë, ndërsa atij që ia vështirëson (ndonjë besimtari), Allahu do t'ia vështirësojë."
5. Prej rregullave të ligjit islam është: "Dëmi duhet mënjanuar." Pra, ligji islam nuk e aprovon dëmin, përkundrazi e refuzon dëmtimin.

(4711)

(271) - عَنْ أَبِي مُوسَى رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّمَا مَثَلُ الْجَلِيسِ الصَّالِحِ وَالْجَلِيسِ السَّوِّءِ كَمَثَلِ الْمِسْكِ وَنَافِخِ الْكَبِيرِ، فَحَامِلُ الْمِسْكِ: إِمَّا أَنْ يُحْذِيكَ، وَإِمَّا أَنْ تَبْتَاعَ مِنْهُ، وَإِمَّا أَنْ تَجِدَ مِنْهُ رِيحًا طَيِّبَةً، وَنَافِخُ الْكَبِيرِ: إِمَّا أَنْ يُحْرِقَ ثِيَابَكَ، وَإِمَّا أَنْ تَجِدَ رِيحًا خَبِيثَةً». [صحيح] - [متفق عليه]

(271) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Shoku i mirë dhe shoku i keq i shëmbëlajnë shitësit të parfumit dhe farkëtarit që i fryn gjyrykut: shitësi i parfumit ose të lyen me parfum, ose blen parfum prej tij, ose ndien aromë të këndshme prej tij, kurse farkëtarit që i fryn gjyrykut, ose ta djeg rrobën, ose ndien erë të keqe prej tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka dhënë shembull për dy lloje njerëzish:

Lloji i parë: shoku dhe miku i mirë i cili të udhëzon nga Allahu dhe drejt gjërave që e kënaqin Atë dhe të ndihmon për të qenë i bindur ndaj Tij. Shembulli i tij është sikurse i shitësit të parfumit i cili ose të lyen me parfum (të jep parfum), ose blen parfum prej tij, ose ndien aromë të këndshme prej tij.

Lloji i dytë: shoku dhe miku i keq, i cili i pengon njerëzit nga rruga e Allahut, ndihmon në kryerjen e gjynaheve dhe prej tij sheh vepra të shëmtuara, kësisoj të përfshin poshtërimi për shkak të shoqërimit dhe uljes me njerëz të tillë. Shembulli i tij është si ai i farkëtarit që i fryn zjarrit i

cili ose do të djegë rrobat nga shkëndijat fluturuese të zjarrit, ose do të ndiesh aromë të keqe duke ndenjur pranë tij.

Mësime nga hadithi:

1. Lejohet përdorimi i shembujve për t'ia bërë të thjeshtë kuptimin dëgjuesit.
2. Inkurajimi dhe motivimi për t'u shoqëruar me njerëzit e devotshëm e të mirë dhe për t'iu shmangur njerëzve të këqij dhe atyre që kanë moral të keq.

(3127)

(272) – عن أبي هريرة رضي الله عنه: أَنَّ رَجُلًا قَالَ لِلنَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَوْصِنِي، قَالَ: «لَا تَغْضَبَ» فَرَدَّدَ مَرَارًا قَالَ: «لَا تَغْضَبَ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(272) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se një njeri i tha Profetit ﷺ: "Më këshillo!" Profeti i tha: "Mos u zemëro!" Ky rikërkonte disa herë, porse Profeti gjithnjë i thoshte: "Mos u zemëro!" [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Një nga sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) i kërkoi Profetit ﷺ ta urdhërojë atë të bëjë diçka që do t'i bënte dobi, kështu që ai e urdhëroi që të mos zemërohej. Kjo do të thotë se ai duhet t'i shmangë arsyet që e çojnë drejt zemërimit dhe ta kontrollojë veten nëse i ndodh zemërimi, në mënyrë që të

mos zgjatet zemërimi i tij e kjo të çojë drejt vrasjes, rrahjes, sharjes e të ngjashme.

Ky njeri e rikërkoi porosinë disa herë, por Profeti ﷺ nuk shtoi në porosi më shumë se: "Mos u zemëro!"

Mësime nga hadithi:

1. Paralajmërimi ndaj zemërimit, sepse ai është tubuesi i të gjitha të këqijave dhe largimi nga ai është tubuesi i çdo të mire.
2. Zemërimi për Allahun është kur zemërohem kur nëpërkëmben ndalesat e Tij, e ky është zemërim i lavdëruar.
3. Bën të përsëritet fjala kur është e nevojshme, derisa dëgjuesi të jetë i vetëdijshëm për të dhe ta kuptojë rëndësinë e saj.
4. Vlera e kërkimit të këshillës nga dietari.

(4709)

(273) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ:

«لَيْسَ الشَّدِيدُ بِالصُّرْعَةِ، إِنَّمَا الشَّدِيدُ الَّذِي يَمْلِكُ نَفْسَهُ عِنْدَ الْغَضَبِ». [صحيح]

[متفق عليه]

(273) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Nuk quhet i fortë ai që triumfon mbi të tjerët, por, në të vërtetë, i fortë

është ai që përmbahet kur është i zemëruar.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na sqaron se forca e vërtetë nuk është forca e trupit e as e atij që triumfon mbi të fortët, por i forti i vërtetë është ai që përpiqet dhe përmban veten kur zemërimi i tij është i madh, sepse kjo tregon se ai ka një fuqi që i mundëson atij të kontrollojë veten dhe ta mposhtë shejtanin.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e butësisë dhe vetëkontrollit gjatë zemërimit dhe se kjo është ndër veprat e mira të cilat i inkurajon Islami.
2. Lufta kundër vetvetes gjatë zemërimit është më e vështirë sesa të luftosh kundër armikut.
3. Islami e ndryshoi konceptin paraislam për forcën drejt virtyteve fisnike. Rrjedhimisht, njeriu më i fuqishëm është ai që e ka nën kontroll veten e tij.
4. Qëndrimi larg zemërimit, për shkak të dëmit që u shkakton individëve dhe shoqërisë.

(5351)

(274) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَرْبَعٌ مَنْ كُنَّ فِيهِ كَانَ مُنَافِقًا خَالِصًا، وَمَنْ كَانَتْ فِيهِ خَلَّةٌ مِنْهُنَّ كَانَتْ فِيهِ خَلَّةٌ مِنْ نِفَاقٍ حَتَّى يَدْعَهَا: إِذَا حَدَّثَ كَذَبَ، وَإِذَا عَاهَدَ غَدَرَ، وَإِذَا وَعَدَ أَخْلَفَ، وَإِذَا خَاصَمَ فَجَرَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(274) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që i ka këto katër tipare është hipokrit i kulluar. Ndërkaq, ai që ka vetëm njërin prej tyre, ka një prej tipareve të hipokrizisë, derisa ta braktisë atë. Ato janë: kur flet, gënjen; kur bën marrëveshje, tradhton; kur premton, nuk e mban premtimin, si dhe kur polemizon, bëhet i pasjellshëm.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka paralajmëruar për katër tipare, të cilat, nëse bashkohen te një musliman, do t'u shëmbëllente shumë hipokritëve, për shkak të këtyre tipareve. Kjo vlen për ata te të cilët mbizotërojnë këto tipare. E, sa u përket atyre te të cilët këto tipare janë të rralla, nuk përfshihen në këtë hadith. Këto tipare janë:

E para: kur flet, qëllimisht gënjen dhe nuk thotë të vërtetën në bisedim.

E dyta: kur bën një marrëveshje, nuk e përmbush atë dhe e tradhton personin me të cilin ka bërë marrëveshje.

E treta: kur premton, nuk e përmbush premtimin dhe nuk e mban atë.

E katërta: nëse polemizon dhe grindet me dikë, bëhet i ashpër dhe mënjanohet nga e vërteta; tregohet dinak në refuzimin dhe zhvlerësimin e së vërtetës dhe thotë të pavërteta e gënjeshtër.

Hipokrizia është shfaqja e së kundërtës së asaj që e fsheh. Ky kuptim është i pranishëm te njeriu që i ka këto tipare. Hipokrizia e tij vlen për atë njeri me të cilin flet, me atë që i premtan, me atë që bën marrëveshje dhe me atë që polemizon, e jo se ai është hipokrit në Islam, në kuptimin që shfaq Islamin dhe fsheh kufrin (mosbesimin). Ndërkaq, ai që ka njërin nga këto tipare, ka një tipar të hipokrizisë, derisa ta braktis atë.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i disa tipareve të hipokritit, për t'i frikësuar dhe paralajmëruar njerëzit të mos bien në to.
2. Kuptimi i hadithit është se këto tipare janë tipare të hipokrizisë dhe njeriu që karakterizohet me këto tipare është i ngjashëm me hipokritët në këto tipare dhe ka përvetësuar moralin e tyre. Nuk do të thotë se ai është hipokrit në kuptimin e plotë, si dikush që shfaq Islamin dhe e fsheh kufrin. Është thënë gjithashtu se kjo vlen për atë që këto tipare mbizotërojnë tek ai dhe ai i nënvlerëson dhe i merr për të lehta. Nëse dikush vepron kështu, në shumicën e rasteve ndodh për shkak se besimin e ka të prishur.

3. Gazaliu ka thënë: "Thelbi i fetarisë përmbledhet në tri gjëra: fjalë, veprë dhe nijet (qëllim). Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen mbi prishjen e fjalës përmes gënjeshtres, prishjen e veprës përmes tradhtisë dhe prishjen e nijetit përmes shkeljes së premtimit, sepse shkelja e premtimit konsiderohet mangësi atëherë kur qëllimi për ta thyer atë është i pranishëm që në momentin e dhënies së premtimit. E, nëse dikush ka qëllim të sinqertë në fillim, por më pas i del ndonjë pengesë ose e sheh më të arsyeshme të veprojë ndryshe, atëherë në këtë rast nuk ka vend për hipokrizi."
4. Hipokrizia ndahet në dy lloje: 1. Hipokrizia ideologjike, që e nxjerr njeriun nga imani, që nënkupton shfaqjen e Islamit dhe fshehjen e kufrit (mosbesimit). 2. Hipokrizia e veprës, që nënkupton shëmbëllimin me hipokritët në tiparet e tyre. Kjo nuk e nxjerr njeriun nga imani, por është mëkat i madh.
5. Ibën Haxheri ka thënë: "Dijetarët janë pajtuar njëzëri se kushdo që beson me zemrën e gjuhën e tij dhe më pas i kryen këto gjëra, nuk do të gjykohet si jobesimtar e as është hipokrit që do të mbetet përjetësisht në Xhehenem."
6. Neveviu ka thënë: "Një grup dijetarësh janë shprehur se në këtë hadith janë për qëllim hipokritët që ishin në kohën e Profetit ﷺ, të cilët e

shprehën imanin dhe e përgënjeshtroan; iu besua çështja e fesë, por tradhtuan; bënë premtime rreth çështjeve të fesë dhe se do ta ndihmojnë, por e thyen premtimin, si dhe gjatë polemikave dhe konflikteve ishin të pasjellshëm."

(65124)

(275) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ

عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَيْسَ الْمُؤْمِنُ بِالطَّعَّانِ وَلَا اللَّعَّانِ وَلَا الْفَاحِشِ وَلَا الْبَذِيءِ». [صحيح]

- [رواه الترمذي]

(275) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Besimtari nuk është fyes e as mallkues i madh, as i pandershëm e as fjalëndyrë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ tregoi në këtë hadith se nuk i ka hije një besimtari besimplotë që t'i poshtërojë njerëzit në lidhje me prejardhjen e tyre, as të ofendojë e të mallkojë shpesh, e as të jetë i pandershëm në vepra ose fjalë, e të mos ketë turp fare.

Mësime nga hadithi:

1. Mohimi i besimit në tekstet e fesë mund të jetë vetëm për shkak të një veprimi të ndaluar ose braktisjes së një obligimi.
2. Inkurajimi për ruajtjen e gjymtyrëve dhe mbrojtjen e tyre nga e keqja, veçanërisht gjuhën.
3. Sindiu ka thënë: "Përdorimi i formës së ekzagjeruar në këtë hadith në fjalët: "ofendon shumë" dhe: "mallkon shumë", tregon se, nëse ofendimi dhe mallkimi ndodhin nga besimtari pak ose ndonjëherë ndaj atyre që i meritojnë këto gjëra, kjo nuk e nënkupton që thënësi i këtyre fjalëve të mos quhet edhe më tej besimtar."

(65869)

(276) - عن عبد الله بن عمر رضي الله عنهما قال: سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَجُلًا يَعِظُ أَحَاهُ فِي الْحَيَاءِ، فَقَالَ: «الْحَيَاءُ مِنَ الْإِيمَانِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(276) – Abdullah ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: Profeti ﷺ dëgjo i një njeri duke e këshilluar vëllanë e tij rreth turpit, e në atë rast Profeti ﷺ tha: "Turpi është prej besimit." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ dëgjoi një njeri tek e këshillonte vëllanë e tij që ta braktiste turpin e tepruar! Kështu, Profeti ﷺ sqaroi se turpi është pjesë e besimit dhe se ai sjell vetëm të mira.

Turpi është karakter që nxit për të bërë vepra dhe për ta lënë anash të shëmtuarën.

Mësim nga hadithi:

1. Ajo që të pengon të bësh mirë nuk quhet turp, por quhet ndrojtje, paaftësi, dobësi dhe frikë.
2. Turpi prej Allahut të Lartmadhëruar arrihet duke i vepruar gjërat e obliguara dhe duke i lënë anash gjërat e ndaluara.
3. Turpi ndaj njerëzve konsiston në respektimin e tyre, që t'u jepet pozita që e meritojnë dhe të shmanget prej asaj që zakonisht është e pakëndshme.

(5478)

(277) - عن المقدم بن معدي كرب رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه

وسلم قال: «إِذَا أَحَبَّ الرَّجُلُ أَحَاهُ فَلْيُخْبِرْهُ أَنَّهُ يُحِبُّهُ». [صحيح] - [رواه أبو داود

والترمذي والنسائي في الكبرى وأحمد]

(277) – Mikdam ibën Madikeribi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Kur njeriu ta dojë vëllanë e tij (musliman), le ta lajmërojë se e do." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود و الترمذي و النسائي في الكبرى و أحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith shpjegon një nga shkaqet që forcojnë lidhjet ndërmjet besimtarëve dhe përhapin dashurinë mes tyre, që është se, nëse dikush e do vëllanë e tij, le ta lajmërojë se e do.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e dashurisë së singertë për hir të Allahut të Lartësuar, e jo për interesa të kësaj bote.
2. Është e pëlqyeshme të lajmërohet ai të cilin e do për hir të Allahut se vërtet e do, në mënyrë që të rritet dashuria dhe afërsia mes jush.
3. Përhapja e dashurisë mes besimtarëve e forcon vëllazërinë në besim dhe e ruan shoqërinë nga shpërbërja dhe përçarja.

(3017)

(278) - عن جابر بن عبد الله رضي الله عنهما عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «كُلُّ مَعْرُوفٍ صَدَقَةٌ». [صحيح] - [رواه البخاري من حديث جابر، ورواه مسلم من حديث حذيفة]

(278) – Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Çdo vepër e mirë është sadaka (lëmoshë)." [Ky hadith është sahih] - [رواه البخاري من حديث جابر] - [ورواه مسلم من حديث حذيفة]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se çdo vepër e mirë dhe dobi për të tjerët, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, është sadaka (lëmoshë) dhe për të ka shpërblim.

Mësime nga hadithi:

1. Hadithi tregon se sadakaja nuk kufizohet në atë që njeriu e jep nga pasuria e tij, por çdo të mirë që e vepron një njeri (besimtar), e thotë ose ia ofron ndokujt tjetër.
2. Ky hadith është inkurajim për të bërë mirë dhe çdo gjë që u sjell dobi të tjerëve.
3. Mosnënçmimi i ndonjë gjëje të mirë, edhe po që e paktë.

(5346)

(279) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «كُلُّ سَلَامٍ مِنَ النَّاسِ عَلَيْهِ صَدَقَةٌ، كُلُّ يَوْمٍ تَطْلُعُ فِيهِ الشَّمْسُ يَعْدِلُ بَيْنَ الْإِثْنَيْنِ صَدَقَةٌ، وَيُعِينُ الرَّجُلَ عَلَى دَابَّتِهِ فَيَحْمِلُ عَلَيْهَا أَوْ يَرْفَعُ عَلَيْهَا مَتَاعَهُ صَدَقَةٌ، وَالْكَلِمَةُ الطَّيِّبَةُ صَدَقَةٌ، وَكُلُّ خُطْوَةٍ يَخْطُوهَا إِلَى الصَّلَاةِ صَدَقَةٌ، وَيُمِيطُ الْأَذَى عَنِ الطَّرِيقِ صَدَقَةٌ». [صحيح] - [متفق عليه]

(279) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Për çdo ditë që lind Dielli, njeriu duhet të japë sadaka (lëmoshë) për

secilën një të trupit. Të gjykosh me drejtësi mes dy personave është sadaka. Të ndihmosh dikë të hipë në kafshë ose t'i ngjisë plaçkat dhe sendet është sadaka. Fjala e mirë është sadaka. Çdo hap që njeriu e hedh për të shkuar në namaz është sadaka. Largimi i një pengese nga rruga është sadaka.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se çdo musliman i rritur dhe i përgjegjshëm duhet të japë sadaka për hir të Allahut të Lartësuar çdo ditë, për aq nyje sa gjenden në kockat e tij, si akt falënderimi ndaj Allahut për mirëqenien që gëzon. Allahu i bëri kockat e njeriut me nyja që ai të jetë në gjendje t'i hapë dhe t'i mbyllë. Dhe kjo sadaka arrihet nëpërmjet të gjitha veprave të mira dhe nuk kufizohet vetëm me dhënien e pasurisë. Disa nga këto vepra të mira janë: Nëse gjykon me drejtësi midis dy personave që janë në konflikt me njëri tjetrin është sadaka. Nëse e ndihmon të paaftin të hipë mbi kafshë (mjet transportues) ose t'ia ngjisësh plaçkat dhe sendet lart, është sadaka. Fjala e mirë, qoftë dhikër (përmendje e Allahut), qoftë lutje, përsëndetje etj, është sadaka. Çdo hap që e bën për të shkuar në namaz është sadaka. Largimi i një pengese nga rruga, prej së cilës dëmtohen të tjerët, është sadaka.

Mësime nga hadithi:

1. Struktura e kockave të njeriut dhe ndërtimi i tyre në një mënyrë të sigurtë, është një nga begatitë më të

mëdha të Allahut të Lartësuar ndaj njeriut, kështu që për çdo kockë duhet të jepet sadaka në mënyrë të veçantë, që falënderimi për këtë mirësi të jetë i plotë.

2. Inkurajimi për të ripërtërirë falënderimin çdo ditë që këto begati të jenë të vazhdueshme.
3. Inkurajimi që veprat vullnetare dhe dhënia e sadakasë të bëhen çdo ditë.
4. Vlera e pajtimit mes njerëzve.
5. Inkurajimi që njeriu ta ndihmojë vëllanë e tij, sepse ky akt kondiserohet për të sadaka.
6. Inkurajimi për të marrë pjesë në namazet me xhemat, për të shkuar në xhami në këmbë dhe gjallërimi i xhamive.
7. Është detyrë që të respektohen rrugët e muslimanëve duke mënjanuar gjërat që i shqetësojnë apo dëmtojnë ata.

(4568)

(280) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ نَفَسَ عَنْ مُؤْمِنٍ كُرْبَةً مِنْ كُرْبِ الدُّنْيَا نَفَسَ اللَّهُ عَنْهُ كُرْبَةً مِنْ كُرْبِ يَوْمِ الْقِيَامَةِ، وَمَنْ يَسَّرَ عَلَى مُعْسِرٍ يَسَّرَ اللَّهُ عَلَيْهِ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، وَمَنْ سَتَرَ مُسْلِمًا سَتَرَهُ اللَّهُ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، وَاللَّهُ فِي عَوْنِ الْعَبْدِ مَا كَانَ الْعَبْدُ فِي عَوْنِ أَخِيهِ، وَمَنْ سَلَكَ طَرِيقًا يَلْتَمِسُ فِيهِ عِلْمًا سَهَّلَ اللَّهُ لَهُ بِهِ طَرِيقًا إِلَى الْجَنَّةِ، وَمَا اجْتَمَعَ قَوْمٌ فِي بَيْتٍ مِنْ بُيُوتِ اللَّهِ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَيَتَدَارَسُونَهُ بَيْنَهُمْ إِلَّا نَزَلَتْ عَلَيْهِمُ السَّكِينَةُ، وَعَشِيَّتُهُمُ الرَّحْمَةُ، وَحَفَّتْهُمُ الْمَلَائِكَةُ، وَذَكَرَهُمُ اللَّهُ فِيمَنْ عِنْدَهُ، وَمَنْ بَطَأَ بِهِ عَمَلُهُ لَمْ يُسْرِعْ بِهِ نَسَبُهُ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(280) - Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Atij që i largon besimtarit një brengë të kësaj bote, Allahu do t'i largojë një brengë të Ditës së Kiametit; atij që ia lehtëson borxhin skamnorit, Allahu do t'ia lehtësojë gjendjen në këtë botë dhe botën tjetër; atij që ia mbulon gabimet muslimanit, Allahu do t'ia mbulojë gabimet në këtë botë dhe botën tjetër. Allahu do ta ndihmojë robin e Vet, për aq kohë sa robi është duke ndihmuar vëllanë e vet. Kush ndjek një rrugë, nëpër të cilën merr dituri, Allahu do t'i lehtësojë një rrugë për në Xhenet. Sa herë që një grup njerëzish tubohen në ndonjë shtëpi të Allahut (xhami), e lexojnë dhe e mësojnë mes vete Librin e Tij, u zbret qetësia, i përfshin mëshira, melekët i mbulojnë me krahët e tyre dhe Allahu i përmend tek ata që janë pranë Tij. Atë që vepra e vet e lë mbrapa, prejardhja nuk e çon përpara.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se shpërblimi që një musliman merr nga Allahu është në përputhje me natyrën e veprave që ai bën për muslimanët e tjerë. Kushdo që ia lehtëson, zbut, largon apo ia heq një vështirësi apo brengë një besimtari në këtë botë, Allahu do ta shpërblejë, duke ia larguar një nga vështirësitë e Ditës së Kiametit. Kushdo që ia lehtëson apo ia largon një skamnori skamjen, Allahu do t’ia lehtësojë atij (punët) në këtë botë dhe në botën tjetër. Kushdo që ia mbulon (të metat) një muslimani, si p.sh. kur ka vënë re prej tij diçka që nuk është e hijshme të zbulohet, si: gabimet dhe rrëshqitjet, Allahu do t’ia mbulojë (të metat) atij në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu ndihmon robin e Vet për aq kohë sa robi ndihmon vëllanë e tij në çështjet fetare apo jetësore. Kjo ndihmë mund të jetë përmes lutjes, veprimit fizik, pasurisë etj. Kushdo që ecën në kërkim të dijes fetare, duke e bërë këtë për hir të Allahut të Lartësuar, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet. Nuk mbledhet një grup njerëzish në një prej shtëpive të Allahut, duke lexuar Librin e Allahut, dhe duke e studiuar mes vete, përveçse zbret mbi ta qetësia dhe madhështia, i përfshin mëshira e Allahut, i rrethojnë melekët dhe Allahu i përmend ata në mesin e atyre që janë pranë Tij. Mjafton si nder që Allahu ta përmendë robin (e Tij) në kuvendin më lartë. Ai që ka vepra të mangëta nuk do të ngrihet në shkallën e atyre që kanë vepra të shumta. Prandaj, njeriu nuk duhet të mbështetet në prejardhjen e tij fisnike apo në meritat e të parëve të tij, duke lënë pas dore veprat e mira.

Mësime nga hadithi:

1. Ibën Dekik el-Idi ka thënë: “Ky është një hadith madhështor, që përmbledh lloje të ndryshme dijesh, rregullash dhe norma të etikës. Ai thekson vlerën e përmbushjes së nevojave të muslimanëve dhe të sjelljes së dobishme në çfarëdo mënyre që është e mundur, qoftë përmes dijes, pasurisë, ndihmës, këshillës së dobishme, udhëzimit apo mënyrave të tjera.”
2. Inkurajimi për ta lehtësuar gjendjen e atij që është në vështirësi (e ka borxhe).
3. Një musliman inkurajohet të ndihmojë muslimanët e tjerë, sepse Allahu i Lartësuar e ndihmon atë që e ndihmon vëllain e tij në varësi të ndihmës që jep.
4. Ndër mënyrat e mbulimit të të metave të një muslimani është: të mos hulumtohen mangësitë e tij. Është transmetuar nga njëri prej të parëve të mirë (selefëve) që ka thënë: “Kam takuar njerëz që nuk kishin të meta, por flisnin për të metat e të tjerëve, prandaj njerëzit filluan të përmendin të metat e tyre. Dhe kam takuar njerëz që kishin të meta, por ruheshin nga përmendja e të metave të të tjerëve, prandaj të metat e tyre u harruan.”
5. Nuk është prej kushteve të mbulimit të të metave të të tjerëve që të lihet ndalimi i së keqes dhe të mos ndërhyhet për ta ndryshuar atë. Përkundrazi, e

keqja duhet të ndalohet dhe njëkohësisht të mbulohet, dhe kjo vlen për ata që nuk janë të njohur për shthurje apo këmbëngulje në mëkate. Sa i përket atij që është i njohur për një sjellje të tillë, nuk është e pëlqyer të mbulohen të metat e tij; përkundrazi, çështja e tij duhet t'u referohet autoriteteve përkatëse, përderisa kjo nuk çon në një dëm më të madh. Kjo sepse mbulimi i të metave të tij e inkurajon atë në shthurje dhe e trimëron për të dëmtuar të tjerët, si dhe trimëron të tjerët që janë të këqij e kokëfortë.

6. Inkurajimi për kërkimin e dijes, leximin dhe studimin e Kuranit.
7. Neveviu ka thënë: "Në këtë hadith ka argument për vlerën e tubimit për leximin e Kuranit në xhami. Kjo vlerë fitohet-në dashtë Allahu-edhe në tubime të tjera të ngjashme me tubimet e xhamisë, si; tubimet në një shkollë, garnizon ushtarak, apo vende të tjera të ngjashme."
8. Allahu e ka lidhur shpërblimin me veprat, e jo me prejardhjen.

(4801)

(281) - عَنْ أَبِي بَرَزَةَ الْأَسْلَمِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا تَزُولُ قَدَمَا عَبْدٍ يَوْمَ الْقِيَامَةِ حَتَّى يُسْأَلَ عَنْ عُمْرِهِ فِيمَا أَفْنَاهُ، وَعَنْ عِلْمِهِ فِيمَ فَعَلَ، وَعَنْ مَالِهِ مِنْ أَيْنَ اكْتَسَبَهُ وَفِيمَ أَنْفَقَهُ، وَعَنْ جِسْمِهِ فِيمَ أَبْلَاهُ». [صحيح] - [رواه الترمذي]

(281) – Nga Ebu Berzeh el-Eslemi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Këmbët e njeriut nuk do të lëvizin në Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për jetën e tij si e kaloi, për dijen e tij sa e zbatoi, për pasurinë e tij si e fitoi dhe si e shpenzoi dhe për trupin e tij si e konsumoi". [Ky hadith është sahih] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Profeti (paqja qoftë mbi të!) na ka njoftuar se asnjë njeri nuk do ta kalojë vendin e llogarisë në Ditën e Gjykimit për në Xhenet ose për në Zjarr derisa të pyetet për disa çështje:

E para: për jetën e tij si e ka konsumuar dhe si e ka kaluar?

E dyta: për dijen e tij, a e ka mësuar për hir të Allahut? A e ka zbatuar? Dhe, a ua ka kumtuar atyre që e meritonin?

E treta: për pasurinë e tij, si e fitoi? A e fitoi në mënyra të ligjshme apo në mënyra të paligjshme? Dhe si e shpenzoi atë? A e shpenzoi për ta kënaqur Allahun apo për ta hidhëruar Atë?

E katërta: për trupin, fuqinë, shëndetin dhe rininë e tij, ku i konsumoi këto dhe për çfarë i përdori?

Mësime nga hadithi:

1. Nxitja për ta shfrytëzuar jetën në gjëra që e kënaqin Allahun e Madhëruar.
2. Dhuntitë e Allahut ndaj robërve të Tij janë të shumta dhe ai do të pyetet për këto dhunti. Prandaj duhet që njeriu t'i përdorë dhuntitë që ia ka falur Allahu në punë që e kënaqin Atë.

(4950)

(282) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «السَّاعِي عَلَى الْأَرْمَلَةِ وَالْمِسْكِينِ، كَالْمُجَاهِدِ فِي سَبِيلِ اللَّهِ، أَوْ الْقَائِمِ اللَّيْلَ الصَّائِمِ النَّهَارَ».
[صحيح] - [متفق عليه]

(282) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që kujdeset për vejushën dhe për nevojtarin është sikurse ai që lufton në rrugën e Allahut, ose sikurse ai që falet natën dhe agjëron ditën.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se, ai që kujdeset për interesat e një gruaje, së cilës i ka vdekur burri dhe që nuk ka kush kujdeset për punët e saj, si dhe ndaj të varfrit nevojtar, ku shpenzon ndaj tyre duke pritur shpërblimin nga Allahu i Lartësuar, e ka shpërblimin si ai që lufton në rrugën e Allahut, ose sikur ai që falet natën e nuk lodhet dhe sikurse ai që agjëron e nuk e prish agjërimin.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për të bashkëpunuar, bashkëndier dhe për t'i plotësuar nevojat e të dobëtëve.
2. Adhurimi përfshin çdo vepër të mirë dhe pjesë e adhurimit është kujdesi për të venë dhe për nevojtarin.
3. Ibën Hubejra ka thënë: "Kuptimi është se Allahu i Lartësuar ia mbledh shpërblimin agjëruesit, atij që fal namaz nate dhe muxhahidit përnjëherësh; për faktin se për të venë ishte në vend të burrit të saj... dhe i ndihmoi nevojtarit, i cili nuk ishte në gjendje t'i ndihmojë vetes, kështu që e shpenzoi për të tepricën e ushqimit të tij ditor dhe dha mund për të, kështu që dobia e tij ishte e barabartë me agjërimin, namazin dhe xhihadin.

(3135)

(283) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلْيُقِلْ خَيْرًا أَوْ لِيَصْمُتْ، وَمَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلْيُكْرِمْ جَارَهُ، وَمَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلْيُكْرِمْ صَيفَهُ».

[صحيح] - [متفق عليه]

(283) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë. Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le ta

nderojë fqinjin. Dhe kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le ta nderojë mysafirin.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se rob i që beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, në të cilën do të kthehet dhe në të cilën do të shpërblehet në varësi të veprave të tij, është ai, besimi i të cilit e nxit që t'i bëjë këto virtyte:

1. Fjala e mirë: tesbihi (lartësimi i Allahut - subhanallah), tehlili (la ilahe il-lallah), urdhërimi për të mirë, ndalimi i së keqes dhe pajtimi ndërmjet njerëzve. E, nëse nuk e bën këtë, atëherë le të heshtë, të mos lëndojë askënd dhe ta ruajë gjuhën.

2. Nderimi i fqinjit: duke i bërë mirë dhe duke mos e dëmtuar.

3. Nderimi i mysafirit që vjen për të vizituar, duke i folur fjalë të mira, duke i shërbyer ushqim e kështu me radhë.

Mësime nga hadithi:

1. Besimi në Allahun dhe në Ditën e Fundit është baza e çdo të mire dhe nxit drejt çdo mirësie.
2. Paralajmërim kundër veseve të gjuhës.
3. Feja islame është fe e dashamirësisë dhe fisnikërisë.
4. Këto virtyte janë nga degët e besimit dhe nga virtytet e larta.

5. Të folurit e tepruar mund të dërgojë në atë që është e papëlqyeshme ose e ndaluar. Njeriu shpëton kur nuk flet, përveç nëse është më mirë që të flitet.

(5437)

(284) – عن أبي ذر رضي الله عنه قال: قال لي النبي صلى الله عليه وسلم: «لَا

تَحْقِرَنَّ مِنَ الْمَعْرُوفِ شَيْئًا، وَلَوْ أَنْ تَلْقَى أَخَاكَ بِوَجْهِ طَلِقٍ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(284) – Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "Profeti ﷺ më ka thënë: "Assesi mos nënvlerëso asnjë gjë, edhe po e takove vëllanë tënd me fytyrë të buzëqeshur." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na inkurajon për të bërë mirë dhe për të mos e nënvlerësuar atë, qoftë dhe e paktë. Kjo përfshin fytyrën e çelur e me buzëqeshje gjatë takimit, kështu që muslimani duhet të ketë kujdes për të, për shkak të dashamirësisë ndaj vëllait musliman dhe se e bën atë të lumtur.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e dashurisë së besimtarëve mes vete dhe buzëqeshja e gëzimi gjatë takimit.
2. Feja është e plotë e gjithëpërfshirëse dhe ka ardhur me çdo gjë që është e mirë për muslimanët dhe për unifikimin e fjalës së tyre.

3. Inkurajimi për të bërë vepra të mira, edhe nëse janë të pakta.
4. Është e rekomandar të futet gëzimi te muslimanët, sepse kjo ndihmon në arritjen e dashamirësisë mes tyre.

(5348)

(285) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «عَلَيْكُمْ بِالصَّدَقِ، فَإِنَّ الصَّدَقَ يَهْدِي إِلَى الْبِرِّ، وَإِنَّ الْبِرَّ يَهْدِي إِلَى الْجَنَّةِ، وَمَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَصْدُقُ وَيَتَحَرَّى الصَّدَقَ حَتَّى يُكْتَبَ عِنْدَ اللَّهِ صَدِيقًا، وَإِيَّاكُمْ وَالْكَذِبَ، فَإِنَّ الْكَذِبَ يَهْدِي إِلَى الْفُجُورِ، وَإِنَّ الْفُجُورَ يَهْدِي إِلَى النَّارِ، وَمَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَكْذِبُ وَيَتَحَرَّى الْكَذِبَ حَتَّى يُكْتَبَ عِنْدَ اللَّهِ كَذَّابًا». [صحيح] - [متفق عليه]

(285) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kapuni fort për çiltërsinë, sepse çiltërsia shpie në mirësi, ndërsa mirësia shpie në Xhenet. Njeriu vazhdon të jetë i çiltër dhe ta synojë çiltërsinë, derisa të shkruhet shumë i çiltër tek Allahu. Ruajuni gënjeshtres, sepse gënjeshttra shpie në shthurje, ndërsa shthurja shpie në Zjarr. Njeriu vazhdon të gënjejë dhe ta synojë gënjeshtren, derisa të shkruhet gënjeshtar i madh tek Allahu.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar të jemi të çiltër dhe ka treguar se, nëse i përmbahemi asaj, ajo do të na shpjerë në vepra të mira të përhershme. Atë që në vazhdimësi bën vepra të mira, ato e dërgojnë në Xhenet. Njeriu në vazhdimësi tregohet i çiltër, si në fshehtësi dhe haptazi, kështu do ta meritojë emrin: shumë i çiltër. Pastaj Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër gënjeshtres dhe të folurit të së kotës, sepse ajo i largon njerëzit nga qëndrueshmëria në fe dhe i nxit të bëjnë vepra të këqija, shkatërrim dhe gjynahe, e kështu i shpien në Zjarr. Njeriu vazhdon të gënjejë shpesh, derisa të shkruhet tek Allahu prej gënjeshtarëve.

Mësime nga hadithi:

1. Çiltëria është një karakter fisnik që arrihet me përvetësim dhe përpjekje. Njeriu vazhdon të jetë i çiltër dhe ta synojë çiltërsinë, derisa çiltëria t'i bëhet cilësi dhe natyrshmëri, e kështu të shkruhet tek Allahut prej të çiltërve dhe të devotshmëve.
2. Gënjeshtria është një karakter i përçmuar, që kryesi i saj e përvetëson nga praktikimi i tepërt i saj dhe e synon atë përmes fjalëve dhe veprave, derisa t'i bëhet karakter dhe cilësi e pandashme, e më pas të shkruhet tek Allahu i Lartësuar prej gënjeshtarëve.
3. Çiltëria i referohet të folurit të së vërtetës, e cila është e kundërta e gënjeshtres; të kemi qëllim të çiltër, që është sinqeriteti; çiltëria për të qenë të

vendosur për të bërë hair, të cilin e kemi synim; çiltëria në vepra, ku më e pakta është që ana e brendshme dhe e jashtme të jenë të njëjta; çiltëria në stacionet shpirtërore drejt Allahut, si: çiltëria në frikën e shpresën tek Allahu dhe të tjera. Ai që cilësohet me këto gjëra është shumë i çiltër, ndërsa ai që cilësohet me disa prej tyre, është njeri i çiltër.

(5504)

(286) - عن جرير بن عبد الله رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ لَا يَرْحَمِ النَّاسَ لَا يَرْحَمُهُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ». [صحيح] - [متفق عليه]

(286) – Xherir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atë që nuk i mëshiron njerëzit, Allahu nuk e mëshiron." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se atë që nuk i mëshiron njerëzit, nuk do ta mëshirojë Allahu i Lartmadhëruar. Mëshira që robi e tregon ndaj njerëzve është një nga shkaqet më të mëdha me të cilat fitohet mëshira e Allahut të Lartësuar.

Mësime nga hadithi:

1. Mëshira kërkohet me të gjitha krijesat, por njerëzit janë përmendur në mënyrë specifike, për t'i kushtuar rëndësi.
2. Allahu është Mëshirëploti, që i mëshiron robërit e Tij të mëshirshëm, prandaj shpërblimi është sipas llojit të veprës.
3. Mëshira ndaj njerëzve përfshin dërgimin e së mirës tek ata, largimin e së keqes prej tyre dhe trajtimin e tyre në formën më të mirë.

(5439)

(287) - عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما أن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «الرَّاحِمُونَ يَرْحَمُهُمُ الرَّحْمَنُ، ارْحَمُوا أَهْلَ الْأَرْضِ يَرْحَمَكُم مِّنَ السَّمَاءِ». [صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

(287) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Të mëshirshmit do t'i mëshirojë i Gjithëmëshirshmi. Mëshirojini banorët e Tokës, që t'ju mëshirojë Ai që është mbi qiell." [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se ata që i mëshirojnë të tjerët, do të mëshirohen nga i Gjithëmëshirshmi, mëshira e

të Cilit përfshin çdo gjë, si shpërblim përkatës (të veprave të tyre).

Pastaj Profeti ﷺ urdhëroi të mëshirohen të gjitha krijesat e Tokës, qofshin njerëz, kafshë, zogj, qofshin lloje të tjera, ndërsa shpërblimi për këtë është se Allahu mbi qiejt e Tij do të mëshirojë.

Mësim nga hadithi:

1. Feja islame është fe e mëshirës dhe bazohet tërësisht në bindjen ndaj Allahut dhe mirësinë ndaj krijesave.
2. Allahu i Lartmadhëruar është i cilësuar me mëshirë dhe Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, që e përcjell mëshirën te robërit e Tij.
3. Shpërbimi është në varësi të veprës: të mëshirshmit do t'i mëshirojë Allahu.

(8289)

(288) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «الْمُسْلِمُ مَنْ سَلِمَ الْمُسْلِمُونَ مِنْ لِسَانِهِ وَيَدِهِ، وَالْمُهَاجِرُ مَنْ هَجَرَ مَا نَهَى اللَّهُ عَنْهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(288) – Nga Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Muslimani (i vërtetë) është ai nga gjuha dhe dora e të cilit muslimanët janë të sigurt dhe mërgimtar (i vërtetë) është ai

i cili i braktis gjërat që Allahu i ka ndaluar." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se muslimani i përsosur është ai nga gjuha e të cilit muslimanët janë të sigurt, duke mos i sharë, mallkuar, përgojuar dhe duke mos përhapur me gjuhën e tij midis tyre asgjë që i shqetëson ata. Si dhe janë të sigurt nga dora e tij, duke mos i dhunuar ata dhe duke mos ua marrë pasurinë padrejtësisht, dhe duke mos u bërë padrejtësi të tjera të ngjashme me këto. Ndërsa mërgimtar i vërtetë është ai i cili braktis gjërat që Allahu i ka bërë të paligjshme.

Mësime nga hadithi:

1. Islami plotësohet vetëm kur njeriu nuk i shqetëson të tjerët si nga ana materiale, po ashtu dhe nga ana shpirtërore.
2. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka përmendur gjuhën dhe dorën në veçanti, ngaqë shumica e gabimeve, e dëmeve dhe e ligësive kryhen nëpërmjet tyre.
3. Nxitja për të braktisur mëkatet dhe për t'ju përmbajtur urdhëresave të Allahut të Madhëruar.
4. Muslimani më i mirë është ai i cili i përmbush detyrimet ndaj Allahut dhe detyrimet ndaj muslimanëve njëkohësisht.

5. Dhunimi mund të jetë me fjalë ose me gojë.
6. Mërgimi i përsosur është lënia e gjërave që Allahu i Madhëruar i ka ndaluar.

(10101)

(289) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «حَقُّ الْمُسْلِمِ عَلَى الْمُسْلِمِ خَمْسٌ: رَدُّ السَّلَامِ، وَعِيَادَةُ الْمَرِيضِ، وَاتِّبَاعُ الْجَنَائِزِ، وَإِجَابَةُ الدَّعْوَةِ، وَتَشْمِيتُ الْعَاطِسِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(289) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "Detyrat e muslimanit ndaj muslimanit janë pesë: kthimi i selamit, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes, përgjigjja ndaj ftesës dhe lutja për atë që teshtin." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na sqaron në këtë hadith disa detyra të muslimanit ndaj vëllait të tij musliman. Detyra e parë: kthimi i selamit ndaj atij që të ka dhënë selam.

Detyra e dytë: vizita e të sëmurit.

Detyra e tretë: përcjellja e xhenazes prej shtëpisë së të vdekurit deri në xhami, më pas deri në varreza derisa të varroset.

Detyra e katërt: përgjigjja ndaj ftesës, kur ta thërrasin për në gosti të martesës dhe të tjera.

Detyra e pestë: lutja për atë që teshtin e thotë: "Elhamdulilah", duke i thënë: "Jerhamukallah (Allahu të mëshiroftë!)", e më pas ai që teshtiu i thotë: "Jehdikumullahu ve juslihu balekum (Allahu ju udhëzoftë dhe jua përmirësoftë gjendjen)!"

Mësime nga hadithi:

1. Madhështia e Islamit në pohimin e detyrave ndërmjet muslimanëve dhe në forcimin e vëllazërisë dhe dashërisë mes tyre.

(3706)

(290) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا تَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ حَتَّى تُؤْمِنُوا، وَلَا تُؤْمِنُوا حَتَّى تَحَابُّوا، أَوْ لَا أَدُلُّكُمْ عَلَى شَيْءٍ إِذَا فَعَلْتُمُوهُ تَحَابَبْتُمْ؟ أَفَسُوا السَّلَامَ بَيْنَكُمْ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(290) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nuk keni për të hyrë në Xhenet derisa të besoni, e nuk keni për të besuar derisa të duheni mes vete. A t’ju tregoj për një gjë që, nëse e bëni, do të duheni ndërmjet vete? Përhapeni selamin në mesin tuaj!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se vetëm besimtarët do të hyjnë në Xhenet dhe besimi nuk është i plotë dhe gjendja e

shoqërisë islame nuk përmirësohet derisa ata të duan njërit-tjetrit. Pastaj Profeti ﷺ na drejtoi drejt gjërave më të mira, përmes të cilave mbizotëron dashuria, që janë: përhapja e selamit mes muslimanëve, të cilën Allahu e ka bërë përshtendetje për robërit e Tij.

Mësim nga hadithi:

1. Hyrja në Xhenet është e kushtëzuar me iman (besim).
2. Prej besimit të plotë është që muslimani ta dojë për vëllanë e tij (musliman) atë që e do për vete.
3. Është e pëlqyeshme që selami (përshtendetja) islame të përhapet dhe të jepet në mesin e muslimanëve, sepse kështu përhapet dashuria dhe siguria mes tyre.
4. Selami (përshtendetja islame) i jepet vetëm atij që është musliman, bazuar në pjesën e hadithit: "në mesin tuaj."
5. Dhënia e selamit (përshtendetjes islame) e largon këputjen e lidhjes, bojkotit dhe armiqësisë.
6. Rëndësia e dashurisë mes muslimanëve dhe se ajo është prej besimit të plotë.
7. Në një hadith tjetër qëndron se forma e plotë e selamit është: "Es-Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu." Por, mjafton edhe: "Es-selamu alejkum."

(291) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا: أَنَّ رَجُلًا سَأَلَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَيُّ الْإِسْلَامِ خَيْرٌ؟ قَالَ: «تُطْعِمُ الطَّعَامَ، وَتَقْرَأُ السَّلَامَ عَلَى مَنْ عَرَفْتَ وَمَنْ لَمْ تَعْرِفْ». [صحيح] - [متفق عليه]

(291) – Nga Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcillet se një burrë e pyeti Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!): "Cila cilësi e Islamit është më e mira?" Ai u përgjigj: "Të japësh ushqim dhe të përshëndesësh me selam ata që i njeh dhe ata që nuk i njeh." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) u pyet se cila nga cilësitë e Islamit është më e mira dhe ai përmendi dy cilësi.

E para: Dhënia ushqim të varfërve sa më shumë. Këtu bën pjesë lëmosha, dhurata, mikëpritja dhe gostia. Vlera e dhënies së ushqimit rritet në kohën e urisë dhe ngritjes së çmimeve.

E dyta: Përshëndetja me selam ndaj çdo muslimani që e njeh apo që nuk e njeh.

Mësime nga hadithi:

1. Dëshira e madhe e sahabëve për të njohur cilësitë që sjellin dobi në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

2. Përshëndetja me selam dhe dhënia e ushqimit janë nga punët më të mira në Islam, ngaqë ato kanë epërsi dhe ngaqë njerëzit kanë nevojë për to në çdo kohë.
3. Njëpërmjet këtyre dy cilësive arrihet bamirësia me fjalë dhe me vepër. Dhe kjo formë e bamirësisë është më e larta.
4. Këto cilësi lidhen me marrëdhëniet e muslimanëve midis tyre, ndërkohë që ka dhe cilësi të tjera që lidhen me marrëdhënien e njeriut me Zotin e vet.
5. Të filluarit e përshëndetjes me selam është specifike për muslimanët midis njëri-tjetrit, ndërsa jobesimtarët ne nuk duhet t'i përshëndesim të parët me selam.

(5808)

(292) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «أَلَا أَذَلُّكُمْ عَلَى مَا يَمْنَحُ اللَّهُ بِهِ الْخَطَايَا، وَيَرْفَعُ بِهِ الدَّرَجَاتِ؟» قَالُوا بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ قَالَ: «إِسْبَاغُ الْوُضُوءِ عَلَى الْمَكَارِهِ، وَكَثْرَةُ الْخُطَا إِلَى الْمَسَاجِدِ، وَانْتِظَارُ الصَّلَاةِ بَعْدَ الصَّلَاةِ، فَذَلِكَ الرَّبَاطُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(292) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “A doni t’ju tregoj për një gjë, me të cilën Allahu jua fshin mëkatet dhe jua lartëson gradat?” - Posi, o i Dërguari i Allahut! - thanë

të pranishmit. Ai tha: “Përsosja e abdesit në kohë vështirësie, hapat e shumtë për në xhami dhe pritja e namazit pas namazit, kjo konsiderohet "ribat" (qëndrim në gatishmëri ushtarake nëpër kufij).” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i pyeti shokët e tij nëse dëshironin që t'u tregonte për vepra që do të ishin shkak për faljen e mëkateve dhe fshirjen e tyre nga regjistrat e melekëve shkrues, si dhe në ngritjen e pozitave të larta në Xhenet?

Sahabët thanë: "Po, e duam një gjë të tillë."

E para: plotësimi dhe përsosja e abdesit në raste vështirësie, si: i ftohti, mungesa e ujit, dhimbjet e trupit dhe uji i nxehtë.

E dyta: hapat e shumtë për të shkuar në xhami, edhe nëse është larg.

E treta: pritja e kohës së namazit, lidhja e zemrës me të, gatishmëria për të dhe ulja në xhami për të pritur namazin me xhemat, dhe qëndrimi pas faljes në vendin e tij për faljen e namazit tjetër.

Pastaj Profeti ﷺ sqaroi se këto vepra janë gatishmëria e vërtetë, për shkak se ua mbyllin rrugët shejtanit që të sundojë mbi shpirtin, i mposhtin dëshirat e shfrenuara dhe e mbrojnë shpirtin nga cytjet, kështu që ushtria e Allahut i mund ushtarët e shejtanit përmes këtyre adhurimeve, e ky është xhihadi më i madh, andaj kjo konsiderohet si gjendje gatishmërie në kufi me armikun.

Mësime nga hadithi:

1. Rëndësia e faljes së namazit me xhemat në xhami në mënyrë të rregullt, kushtimi i vëmendjes ndaj namazeve dhe mosneglizhimi i tyre.
2. Profeti ﷺ e parashtroi këtë çështje në mënyrë të bukur për t'i motivuar sahabët; ai e nisi bisedën me një shpërblim të madh, në formë pyetëse, e kjo është një nga mënyrat e mësimdhënies.
3. Dobia e parashtrimit të çështjes në formë pyetje-përgjigje është se fjala ka ndikim më të madh në shpirt.
4. Neveviu (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Kjo është gatishmëria (ribat)" d.m.th. gatishmëria e lakmueshme dhe e pëlqyeshme. Fjala "ribat" nga ana gjuhësore ka kuptimin e lidhjes së diçkaje, e në këtë rast ajo merr kuptimin e lidhjes së vetes për të kryer këto adhurime. Thuhet se kjo është gatishmëria më e mirë bazuar në shprehjen "Xhihadi më i mië është xhihadi kundër vetes - unit." Mirëpo ka gjasa që Pejgamberi (paqja qoftë me të!) me fjalët " Kjo është gatishmëria (ribat)" të ketë pasur për qëllim që: kjo është një nga llojet e gatishmërisë që mund ta bëjë cilido.
5. Fjala "ribat" është përsëritur disa herë dhe ka ardhur në formë të shquar, për të treguar se këto vepra kanë një rëndësi të madhe.

(293) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «الْمُؤْمِنُ الْقَوِيُّ، خَيْرٌ وَأَحَبُّ إِلَى اللَّهِ مِنَ الْمُؤْمِنِ الضَّعِيفِ، وَفِي كُلِّ خَيْرٍ، اخِرٌ عَلَى مَا يَنْفَعُكَ، وَاسْتَعِنَ بِاللَّهِ وَلَا تَعْجَزْ، وَإِنْ أَصَابَكَ شَيْءٌ، فَلَا تَقُلْ لَوْ أَنِّي فَعَلْتُ كَانَتْ كَذَا وَكَذَا، وَلَكِنْ قُلْ قَدَرُ اللَّهِ وَمَا شَاءَ فَعَلَ، فَإِنَّ (لَوْ) تَفْتَحُ عَمَلَ الشَّيْطَانِ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(293) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët, e megjithatë të dy kanë mirësi. Kujdesu për atë që të bën dobi, kërko ndihmën e Allahut e mos u ndal (lodh), nëse të godet diçka, mos thuaj: “Sikur të kisha vepruar kështu, do të ishte kështu e ashtu”, por thuaj: “Caktim i Allahut dhe çfarë dëshiron Ai vepron”, sepse fjala “sikur” hap dyert për të vepruar shejtani.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) shpjegon se të gjithë besimtarët janë të mirë, por besimtari i fortë në besimin, vendosmërinë dhe mirëqenien e tij dhe në faktorët e tjerë të fuqisë, është më i mirë dhe më i dashur për Allahun e Madhëruar se besimtari i dobët. Mandej, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e porosit besimtarin që të përvetësojë shkaqet e gjërave të dobishme për të, të kësaj jete dhe të jetës tjetër,

duke u mbështetur tek Allahu i Madhëruar dhe duke kërkuar ndihmë nga Ai. Pastaj ai (paqja qoftë mbi të!) ia ndalon besimtarit paaftësinë, përtacinë dhe dembelizmin në gjërat që janë të dobishme për të në të dy botët. Kur besimtari e jep mundin e tij në bërjen e diçkaje, i përvetëson shkaqet e duhura, mbështetet tek Allahu i Madhëruar dhe kërkon mirësinë prej Tij, atëherë pas gjithë kësaj, ai duhet t'ia dorëzojë të gjithë çështjen e vet Allahut të Madhëruar dhe ta dijë se zgjedhja e Allahut është më e mira për të. E nëse pas kësaj, atë e godet ndonjë fatkeqësi, të mos thotë: "Sikur të kisha vepruar kështu, do të kishte ndodhur kështu e ashtu!" Sepse fjala “sikur” i hap derën punës së shejtanit dhe e shtyn njeriun që të kundërshtojë kaderin dhe të brengoset për të kaluarën. Por, le të thotë, i nënshtruar dhe i kënaqur: "Caktimi i Allahut, Ai bën ç'të dëshirojë!" Andaj, ajo që ka ndodhur, ka ndodhur në përputhje me dëshirën e Allahut. Ai bën ç'të dojë, askush nuk e kthen mbrapsht vendimin e Tij dhe askush nuk e ndryshon dot gjykimin e Tij.

Mësime nga hadithi:

1. Njerëzit janë të ndryshëm në shkallët e besimit.
2. Fuqia në kryerjen e punëve është gjë e pëlqyeshme, sepse nëpërmjet fuqisë arrihen gjëra të dobishme, të cilat nuk arrihen dot nëpërmjet dobësisë.
3. Njeriu duhet të përpiqet për gjërat që i sjellin dobi dhe t'i lërë gjërat e padobishme.

4. Besimtari duhet të kërkojë ndihmën e Allahut në të gjitha çështjet e tij dhe të mos mbështetet te vetja e tij.
5. Pohimi i kadasë dhe kaderit (caktimet hyjnore) dhe se një gjë e tillë nuk bie ndesh me përvetësimin e shkaqeve dhe përpjekjen në kërkimin e mirësive.
6. Ndalimi i shprehjes “sikur” në formën e shprehjes së zemërimit në kohën e rënies së fatkeqësive dhe paligjshmëria e kundërshtimit të kaderit të Allahut të Madhëruar.

(5493)

(294) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «قَارِبُوا وَسَدِّدُوا، وَاعْلَمُوا أَنَّهُ لَنْ يَنْجُو أَحَدٌ مِنْكُمْ بِعَمَلِهِ» قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا أَنْتَ؟ قَالَ: «وَلَا أَنَا، إِلَّا أَنْ يَتَعَمَّدَنِي اللَّهُ بِرَحْمَةٍ مِنْهُ وَفَضْلٍ». [صحيح] - [متفق عليه]

(294) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Afro juni përsosmërisë dhe jini mesatarë! Dijeni se asnjëri prej jush nuk do të shpëtojë (nga Zjarri) me veprat e tij. - O i Dërguari i Allahut, as ti?! - e pyetën të pranishmit. - “As unë, përveç nëse Allahu më përfshin me mëshirën dhe mirësinë e Tij, - tha Profeti ﷺ.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i inkurajonte sahabët që të veprojnë dhe t'i frikësohen Allahut aq sa munden, pa teprim dhe cungim, dhe që me veprat e tyre të synojnë saktësinë, duke qenë të sigurtë me Allahun dhe ta ndjekin sunetin, në mënyrë që veprat e tyre të pranohen dhe të bëhen shkak për zbritjen e mëshirës mbi ta.

Pastaj tregoi se askënd nuk do ta shpëtojnë vetëm veprat e tij, por medoemos kjo ndodh përmes mëshirës së Allahut.

Ata thanë: "Edhe ti, o i Dërguari i Allahut, a nuk do të shpëtohesh me veprat e tua, pavarësisht madhështisë së pozitës sate?"

Ai tha: "Edhe unë, përveç nëse Allahu më mbulon me mirësinë e mëshirës së Tij."

Mësime nga hadithi:

1. Neveviu për këtë hadith: "Afrojni përsosurisë dhe jini mesatarë!", ka thënë: "Kërkoni të arrini saktësinë/përsosurinë dhe veproni sipas saj, e nëse nuk jeni në gjendje ta arrini plotësisht, atëherë afrojni sa më shumë. Saktësia/përsosuria nënkupton të drejtën, e cila është mes teprimit dhe cungimit, prandaj mos e teproni dhe mos e cungoni!"
2. Ibën Bazi ka thënë: "Veprat e mira janë shkaqe për hyrjen në Xhenet, ashtu siç janë veprat e këqija shkaqe për hyrjen në Zjarr. Hadithi sqaron se hyrja në Xhenet nuk është vetëm për shkak të veprave, por është e domosdoshme falja dhe mëshira e

Allahut të Lartësuar. Pra, ata do të hyjnë në Xhenet për shkak të veprave të tyre, por ajo që e bëri të detyrueshme këtë është edhe mëshira e Tij."

3. Njeriu nuk duhet të mashtrohet dhe të krenohet me veprat e tij, sado të mëdha të jenë, sepse e drejta e Allahut është më e madhe se veprat e tij. Prandaj, njeriu duhet të ketë gjithmonë frikë dhe shpresë njëkohësisht.
4. Mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij janë më të mëdha se veprat e tyre.
5. Veprat e mira janë shkaqe për hyrjen në Xhenet, ndërsa fitimi përmes tyre është vetëm përmes mirësisë dhe mëshirës së Allahut.
6. Kirmaniu ka thënë: "Nëse të gjithë njerëzit do të hyjnë në Xhenet vetëm me mëshirën e Allahut, atëherë arsyeja e përmendjes së veçantë të të Dërguarit të Allahut ﷺ është se, meqë është e sigurt që ai hyn në Xhenet, e nuk hyn përveçse me mëshirën e Allahut, atëherë të tjerët pos tij janë më parësorë për këtë."
7. Neveviu rreth shpjegimit të fjalës së Allahut të Lartësuar: "Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!" (En Nahl, 32), dhe: "Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni vepruar." (Ez Zuhruf, 72), e të ngjashme me këto ajete që tregojnë se veprat janë shkak për

hyrjen në Xhenet, tregon se këto hadithe nuk janë në kundërshtim me ato ajete. Kjo është sepse kuptimi i ajeteve është se hyrja në Xhenet është për shkak të veprave, pastaj suksesi për t'i kryer veprat dhe udhëzimi për të qenë i singertë në to dhe pranimi i tyre, këto janë në sajë të mëshirës dhe mirësisë së Allahut të Lartësuar. Kështu që kuptimi i vërtetë i haditheve, është se nuk hyhet në Xhenet vetëm me vepra. Gjithashtu është e vërtetë të thuhet që hyn në Xhenet për shkak të veprave, e ato janë në sajë të mëshirës së Allahut.

8. Ibën Xheuziu ka thënë: "Kjo çon në katër mundësi:
9. E para: Suksesi për të kryer vepra të mira është nga mëshira e Allahut. E, po të mos ishte mëshira e Tij paraprake, njeriu nuk do të arrinte besimin apo bindjen që përmes saj vjen shpëtimi.
10. E dyta: Përfitimet e robërve janë në sajë të Zotit të tyre; pra, veprat e tyre janë falë Zotit të tyre, dhe sado i madh të jetë shpërblimi që Ai i jep, kjo tregon mirësinë e Tij.
11. E treta: Në disa hadithe përmendet se hyrja në Xhenet ndodh me mëshirën e Allahut, por përcaktimi i gradës brenda tij varet nga veprat.
12. E katërta: Veprat e adhurimit kryhen për një kohë të shkurtër, ndërsa shpërblimi i tyre është i pafund. Prandaj, kur një begati e përjetshme jepet si

shpërblim për diçka të përkohshme, kjo tregon mirësinë e Allahut dhe jo thjesht një kompensim për veprat."

13.Rafiiu ka thënë: "Njeriu nuk duhet të mbështetet te veprat e tij të mira kur kërkon shpëtim dhe grada të larta, sepse ai ka vepruar vetëm falë suksesit nga Allahu dhe ka mundur të shmangë mëkatet vetëm përmes mbrojtjes së Allahut. Pra, e gjithë kjo ndodh me mirësinë dhe mëshirën e Allahut."

(3469)

(295) – عن ابن عمر رضي الله عنهما قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَا زَالَ يُوصِينِي جِبْرِيلُ بِالْجَارِ، حَتَّى ظَنَنْتُ أَنَّهُ سَيُورِّثُهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(295) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Xhibrili ﷺ vazhdimisht më porosiste për raporte të mira me fqinjin, saqë mendova se do t'i japë të drejtë në trashëgimi.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na njofton se Xhibrili ia përsëriste vazhdimisht dhe e porosiste që të kujdesej për fqinjin, i cili është afër shtëpisë, qoftë musliman, qoftë jomusliman, qoftë i afërm, qoftë i largët, duke ia ruajtur të drejtën dhe duke mos e dëmtuar, duke i bërë mirë dhe duke duruar dëmin që mund ta shkaktojë, saqë Profeti ﷺ, duke e

parë respektin që gëzon fqinji dhe faktin se Xhibrili e porosiste në vazhdimësi për këtë gjë, mendoj se do të zbriste shpallje ku fqinji do të kishte të drejtë në trashëgimi.

Mësime nga hadithi:

1. E drejta e fqinjit është e madhe dhe është obligim që kjo gjë të merret në konsideratë.
2. Theksimi i së drejtës së tij përmes kësaj porosie nënkupton domosdoshmërinë e nderimit të tij, të mirësjelljes me të, të pengimit të dëmit ndaj tij, të vizitës kur është i sëmurë, të urimit kur është i lumtur dhe të ngushëllimit kur është në fatkeqësi.
3. Sa më afër të jetë dera e fqinjit, aq më e fortë është e drejta e tij.
4. Përsosuria e fesë, meqë ajo përfshin në vete atë gjë që është e mirë për shoqërinë, si: mirëbërsia ndaj fqinjëve dhe largimi i dëmeve nga ata.

(4965)

(296) - عن أبي الدرداء رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ

رَدَّ عَنْ عَرَضِ أَخِيهِ رَدَّ اللَّهُ عَنْ وَجْهِهِ النَّارَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ». [صحيح] - [رواه الترمذي

وأحمد]

(296) – Ebu Derdai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Atij që e mbron nderin e vëllait të

vet, Allahu do t'ia mbrojë fytyrën nga Zjarri në Ditën e Kiametit." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se kushdo që e mbron nderin e vëllait të tij musliman, kur ai s'është i pranishëm, duke i ndalur të tjerët që të mos e pëçmojnë ose ofendojnë, Allahu do t'ia largojë atij dënimin në Ditën e Kiametit.

Mësim nga hadithi:

1. Është e ndaluar të merret nëpër gojë nderi i muslimanëve.
2. Shpërblimi është sipas llojit të veprës: Allahu e mbron nga Zjarri atë që ia ruan nderin vëllait të vet.
3. Islami është fe e vëllazërisë dhe e ndihmesës së ndërsjellë.

(5514)

(297) – عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا يُؤْمِنُ أَحَدُكُمْ، حَتَّى يُحِبَّ لِأَخِيهِ مَا يُحِبُّ لِنَفْسِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(297) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e vet atë që e do për veten e tij.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka sqaruar se besimi i plotë nuk mund të realizohet tek asnjë musliman derisa të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete, si: kryerja e adhurimeve dhe llojet e ndryshme të mirësive të kësaj bote dhe të botës tjetër. Si dhe të mos dëshirojë për të ato gjëra që nuk i dëshiron për veten e tij. Nëse sheh mangësi te fetaria e vëllait të tij musliman, duhet të përpiqet ta përmirësojë, e, nëse sheh shenja të mira tek ai, duhet ta orientojë, ta ndihmojë dhe ta këshillojë në çështjet e fesë dhe të jetës.

Mësime nga hadithi:

1. Ky hadith dëshmon se është obligim që njeriu të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete, sepse mohimi i imanit (besimit) të atij që nuk do për vëllanë e tij atë që do për veten tregon se kjo gjë është obligim.
2. Vëllazëria për hir të Allahut është mbi vëllazërinë e prejardhjes, prandaj e drejta e saj është më e detyrueshme.
3. Ndalimi i të gjitha fjalëve dhe veprimeve që kundërshtojnë këtë dashuri, si: mashtrimi, përgojimi, zilia dhe padrejtësia ndaj muslimanit në jetën, pasurinë dhe nderin e tij.
4. Në këtë hadith janë përdorur disa fjalë inkurajuese që e nxisin besimtarin të kryej veprën për të cilën po urdhërohet, si fjala në hadith: "për vëllanë e vet."

5. Kirmani (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Pjesë e besimit është edhe të urrejë për vëllanë e tij të keqen që e urren për veten e vet. Ndonëse nuk është përmendur në hadith, por ajo përfshihet automatikisht sepse të duash për dikë diçka detyrimisht kërkon të urresh për të të kundërtën e saj. Pra, arsyeja e mospërmendjes së urrejtjes së të keqes në hadith vjen nga fakti se ajo është e nënkuptuar.

(4717)

(298) – عن عائشة رضي الله عنها زوج النبي صلى الله عليه وسلم عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «إِنَّ الرَّفَقَ لَا يَكُونُ فِي شَيْءٍ إِلَّا رَأْنَهُ، وَلَا يُنْزَعُ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا شَأْنَهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(298) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), gruaja e Profetit ﷺ, tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Çdo gjë që shoqërohet nga butësia, zbukurohet, e çdo gjë që zhvishet nga butësia, shëmtohet." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se butësia dhe mosnxitimi në fjalë dhe në vepra i bëjnë gjërat më të bukura, më të përsosura e më të mira dhe ka më shumë gjasa që personi i tillë të arrijë ta marrë atë që ka nevojë.

Mungesa e butësisë i bën gjërat të turpshme, i shëmton dhe e pengon personin e tillë ta arrijë nevojën e tij. E, nëse e arrin, e arrin me vështirësi.

Mësim nga hadithi:

1. Inkuraimi për t'u stolisur me virtytin e butësisë.
2. Butësia e zbukuron njeriun dhe ajo është shkak për çdo mirësi në çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër.

(5796)

(299) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ الدِّينَ يُسْرٌ، وَلَنْ يُشَادَّ الدِّينَ أَحَدٌ إِلَّا غَلَبَهُ، فَسَدِّدُوا وَقَارِبُوا، وَأَبْشِرُوا، وَاسْتَعِينُوا بِالْعَدْوَةِ وَالرَّوْحَةِ وَشَيْءٍ مِنَ الدَّلْجَةِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(299) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Feja është e lehtë, kështu që këdo që mbingarkon vetveten në fenë e tij, feja do ta mundë. Andaj, jini mesatarë, afrojuni përsosurisë dhe përgëzohuni (për shpërblimin që ju pret). Kur merrni udhë, shfrytëzoheni mëngjesin e hershëm, pasditen dhe një pjesë të natës.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se feja islame bazohet në lehtësimin në të gjitha çështjet e saj. Ky lehtësim del në pah kur besimtari ka arsye, bie fjala, paaftësia e nevoja. Thellimi

në punët fetare (duke e tepruar) dhe braktisja e butësisë (dhe lehtësimi në raport me to) është pasojë për t'u bërë i paaftë për t'i kryer veprat dhe për t'i ndërprerë ato, ose në tërësi, ose pjesërisht. Pastaj Profeti ﷺ inkurajoi që të jemi mesatarë dhe të mos e teprojmë. Robi nuk duhet të tregohet i mangët në raport me gjëra që urdhërohet e as duhet të bartë gjëra që nuk mund t'i përballojë: nëse nuk është në gjendje ta bëjë punën të plotë, atëherë e bën punën në atë formë sa më afër së plotës.

Gjithashtu Profeti ﷺ dha sihariq për shpërblimin e madh për atë punë që bëhet në vazhdimësi, qoftë dhe të vogël, për ata që nuk janë në gjendje ta punojnë plotësisht, se, nëse paaftësia nuk është nga vetë ata, atëherë, si pasojë e kësaj, nuk u pakësohet shpërblimi.

Dhe, duke qenë se jeta e kësaj bote në të vërtetë është një udhëtim dhe një kalim në botën tjetër, Profeti ﷺ urdhëroi që ta ndihmojmë veten në përkushtimin ndaj adhurimit duke e realizuar atë në tri kohë të favorshme që e aktivizojnë shpirtin:

1. Mëngjesi i hershëm, që të dilet në fillim të ditës, ndërmjet namazit të sabahut dhe lindjes së diellit.
2. Pasdita, që të dilet pas zenitit.
3. Një pjesë e natës, pra, të dilet tërë natën ose në një pjesë të saj, për shkak se puna e natës është më e vështirë se ajo e ditës. Ai urdhëroi në një pjesë të saj, duke thënë: "... një pjesë të natës."

Mësime nga hadithi:

1. Ligji islam është i lehtë, tolerant dhe mesatar ndërmjet teprimit dhe cungimit.
2. Robi duhet ta kryejë obligimin në varësi të mundësive, pa u treguar neglizhent dhe pa e tepruar.
3. Është e rëndësishme që robi të zgjedhë kohë kur është më vital për të bërë adhurim, e këto tri kohë janë ato në të cilat trupi është më i freskët për adhurim.
4. Ibën Haxher Askalani shprehet: "Kështu, duket se Profeti ﷺ i është drejtuar me këto fjalë një udhëtari që po shkonte në një destinacion. Këto tri kohë janë koha më e mirë për udhëtarin, kështoj njoftoi në lidhje me ato kohë kur ka më shumë vitalitet, sepse udhëtari, nëse udhëton natë e ditë pa pushim, do të lodhet dhe do të ndalet, e, nëse ai e zgjedh të udhëtojë në këto kohë energjike, do të jetë në gjendje të vazhdojë udhëtimin pa lodhje."
5. Ibën Haxheri po ashtu ka thënë: "Ky hadith sinjalizon që të kapemi për lehtësimet fetare, sepse kapja pas vështirësisë - vendosmërisë (ar. azimeh), në vend të lehtësimit, është teprim, fjala vjen kur dikush e braktis tejumumin kur nuk është në gjendje ta përdorë ujin dhe përdorimi i ujit e dëmton."

6. Ibën Muniri ka thënë: "Në këtë hadith tregohet një prej shenjave të profecisë. Ne kemi parë, ashtu si kanë parë edhe njerëzit para nesh, se çdo person që tregohet teprues në fe përfundon duke u shkëputur (nga ajo). Qëllimi nuk është ndalimi i kërkimit të përsosurisë në adhurim, pasi kjo është diçka e lavdërueshme, por ndalimi i teprimit që çon në lodhje dhe mërzi, ose teprimi në adhurimet vullnetare që çon në lënien e veprave që janë më të mira ose në nxjerrjen e farzit jashtë kohës së tij, si për shembull, dikush që kalon gjithë natën në namaz, pastaj fle dhe e humb faljen e sabahut me xhemat, ose e lë derisa të lindë Dielli dhe të dalë koha e farzit."

(5795)

(300) – عن أنس بن مالك رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال:

«يَسِّرُوا وَلَا تُعَسِّرُوا، وَبَشِّرُوا وَلَا تُنْفِرُوا». [صحيح] - [متفق عليه]

(300) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Lehtësoni e mos vështirësoni, jepni lajme të mira e mos largoni!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëron që njerëzve t'ua lehtësojmë gjërat e të mos ua vështirësojmë, në të gjitha

çështjet, qofshin fetare, qoftshin të kësaj bote (kuptohet), brenda kufijve të asaj që Allahu e ka lejuar dhe e ka përligjur.

Profeti ﷺ inkurajon që të përgëzojmë për mirësi dhe të mos i largojmë njerëzit prej saj.

Mësime nga hadithi:

1. Besimtari e ka obligim që t'i bëjë njerëzit ta duan Allahun dhe t'i inkurajojë ata të bëjnë mirë.
2. Thirrësi për tek Allahu duhet të shikojë me urtësi se si ua përcjell njerëzve thirrjen në Islam.
3. Dhënia e lajmeve të mira si rezultat ka kënaqësinë, afrimin dhe rehatinë për thirrësin dhe për çështjen që ua paraqet njerëzve.
4. Vështirësimi jep si rezultat largimin, kthimin e shpinës dhe dyshimin në fjalët që thotë thirrësi.
5. Mëshira e gjerë e Allahut ndaj robërve të Tij dhe se Ai është i kënaqur për ta me një fe të lehtësuar dhe një ligj të lehtë.
6. Lehtësimi i urdhëruar është ai me të cilin ka ardhur feja.

(5866)

(301) – عن أنس رضي الله عنه قال: كُنَّا عِنْدَ عُمَرَ فَقَالَ: «نُهِيْنَا عَنِ التَّكْلِيفِ».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(301) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Teksa ishim te Omeri, ai na tha: "Na është ndaluar teprimi." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ua ndaloi atyre çdo gjë që sjell vështirësi pa pasur nevojë për të, qoftë me fjalë, qoftë me vepra.

Mësime nga hadithi:

1. Prej teprimit të ndaluar është: bërja e pyetjeve të tepërta ose ta mbingarkojë (njeriu veten) për atë që ai nuk e di, ose të qenët i rreptë për një çështje për të cilën Allahu e ka lënë të hapur.
2. Muslimani duhet të mësohet të jetë tolerant dhe të mos mbingarkohet në fjalë a në vepra: në ushqimin, pijen, fjalët dhe të gjitha rrethanat e tjera të tij.
3. Islami është fe e lehtë.

(8945)

(302) – عن ابن عمر رضي الله عنهما أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال:
«إِذَا أَكَلَ أَحَدُكُمْ فَلْيَأْكُلْ بِيَمِينِهِ، وَإِذَا شَرِبَ فَلْيَشْرَبْ بِيَمِينِهِ، فَإِنَّ الشَّيْطَانَ يَأْكُلُ
بِشِمَالِهِ، وَيَشْرَبُ بِشِمَالِهِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(302) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Kur ndonjëri prej jush dëshiron të hajë, le të hajë me dorën e djathtë, e, kur të pijë, le të pijë me dorën e djathtë, sepse shejtani ha me dorën e majtë dhe pi me dorën e majtë." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëron që muslimani të hajë dhe të pijë me dorën e djathtë, si dhe ndalon që të hajë e të pijë me dorën e majtë, sepse shejtani ha dhe pi me dorën e majtë.

Mësime nga hadithi:

1. Është e ndaluar t'i ngjajë shejtanit duke ngrënë ose duke pirë me dorën e majtë.

(58122)

(303) - عن عُمر بن أبي سلمة رضي الله عنه قال: كُنْتُ غُلَامًا فِي حَجْرِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، وَكَانَتْ يَدَيَّ تَطِيْشُ فِي الصَّحْفَةِ، فَقَالَ لِي رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يَا غُلَامُ، سَمَّ اللَّهُ، وَكُلَّ بِيَمِينِكَ، وَكُلَّ مِمَّا يَلِيكَ» فَمَا زِلْتُ تِلْكَ طُعْمَتِي بَعْدُ. [صحيح] - [متفق عليه]

(303) – Omer ibën Ebi Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Isha djalosh i vogël nën përkujdesjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Teksa hanim, dora ime shkonte andej-këndej nëpër pjatë. I Dërguari i Allahut ﷺ më tha: “O djalosh! Thuaj: "Bismilah", ha me të djathtën dhe ha pranë vetes!” Që nga ai çast, vazhdimisht veproj ashtu gjatë ngrënies.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Omer ibën Ebi Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ishte i biri i gruas së Profetit ﷺ, Umu Selemes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dhe jetonte nën edukimin dhe përkujdesjen e tij, tregon se gjatë ngrënies i lëvizte duart nëpër të gjithë pjatën për të marrë ushqim andej-këndej. Prandaj, Profeti ﷺ ia mësoi atij këto tri rregulla të edukatës së të ngrënit:

1. Përmendja e emrit të Allahut, me "bismilah", në fillim të ngrënies.
2. Ngrënia me dorën e djathtë.
3. Të hahet nga ajo anë e ushqimit që është më afër tij.

Mësime nga hadithi:

1. Prej rregullave të të ngrënit është të fillohet me bismilah (përmendjen e emrit të Allahut).
2. Fëmijëve t'u mësohen rregullat e edukatës, veçanërisht atyre që janë nën kujdesin e ndonjë njeriu.
3. Butësia e Profetit ﷺ dhe shpirtgjerësia e tij në mësimin dhe disiplinimin e fëmijëve.
4. Pjesë e edukatës së të ngrënit është që njeriu të hajë para vetes, përjashtim bën vetëm nëse ka lloje të ndryshme (ushqimesh a frutash), e në atë rast lejohet të merret (edhe në anët e tjera).
5. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) u përmbaheshin rregullave që ua jepte Profeti ﷺ, e kjo përfitohet nga fjala e Omerit: "Që nga ai çast, vazhdimisht veproj ashtu gjatë ngrënies."

(58120)

(304) – عن أنس بن مالك رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِنَّ اللَّهَ لَيَرْضَى عَنِ الْعَبْدِ أَنْ يَأْكُلَ الْأَكْلَةَ فَيَحْمَدَهُ عَلَيْهَا، أَوْ يَشْرَبَ الشَّرْبَةَ فَيَحْمَدَهُ عَلَيْهَا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(304) – Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Vërtet Allahu kënaqet me robin që ha një kafshatë dhe e falënderon Atë

për të dhe pi një gllënjke dhe e falënderon Atë për të." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, kur robi ta falënderojë Zotin e tij për mirësinë dhe begatitë e Tij, kjo është një nga gjërat me të cilat ai e fiton kënaqësinë e Allahut. Kështu, ha ushqimin dhe thotë: "Falënderimi i takon Allahut", dhe e konsumon pijen dhe thotë: "Falënderimi i takon Allahut."

Mësime nga hadithi:

1. Bujaria e Allahut të Lartmadhëruar; Ai të ka dhuruar furnizim dhe është i kënaqur me ty kur e falënderon.
2. Kënaqësia e Allahut arrihet duke e bërë shkakun më të vogël, bie fjala, falënderimi i Tij pas hajes dhe pijes.
3. Ndër rregullat e ushqimit dhe pijes është falënderimi i Allahut të Lartësuar pas hajes dhe pijes.

(5798)

(305) - عَنْ سَلَمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَجُلًا أَكَلَ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ بِشْمَالِهِ، فَقَالَ: «كُلْ بِيَمِينِكَ»، قَالَ: لَا أَسْتَطِيعُ، قَالَ: «لَا اسْتَطَعْتَ»، مَا مَنَعُهُ إِلَّا الْكِبَرُ، قَالَ: فَمَا رَفَعَهَا إِلَى فِيهِ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(305) – Seleme ibën Ekvai (Allahu qoftë i kënaqur me të) tregon: "Njëherë, një person hëngri me dorën e majtë në prani të të Dërguarit të Allahut ﷺ, e ai i tha: - “Ha me të djathtën!” - Nuk mundem, - ia ktheu ai. - “Mos mundsh!” - tha Profeti ﷺ. E ndaloi mendjemadhësia nga kjo dhe kështu më s'mundi ta ngrëjë deri te goja." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ pa një njeri duke ngrënë me dorën e majtë, kësisoj e urdhëroi të hante me dorën e djathtë. Ky njeri u përgjigj me mendjemadhësi dhe rrejshëm tha se nuk mundej! Prandaj, Profeti ﷺ u lut kundër tij që të privohej nga të ngrënë me dorën e djathtë. Kësisoj Allahu iu përgjigj lutjes së Profetit të Tij, kur ja, dora e tij e djathtë u paralizua, kështu që nuk mund ta ngrinte deri te goja pas kësaj, as për ushqim, as për pije.

Mësime nga hadithi:

1. Është obligim ngrënia me të djathtën dhe është haram ngrënia me të majtën.
2. Ai që tregohet mendjemadh kundrejt jetësimit të vendimeve fetare e meriton ndëshkimin.

3. Nderimi i Allahut për Profetin e Tij, Muhamedin ﷺ, duke iu përgjigjur lutjes së tij.
4. Përligjja e urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes në çdo situatë, edhe gjatë ngrënies.

(3372)

(306) - عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ أَكَلَ ثُومًا أَوْ بَصَلًا، فَلْيَعْتَزِلْنَا - أَوْ قَالَ: فَلْيَعْتَزِلْ - مَسْجِدَنَا، وَلْيَقْعُدْ فِي بَيْتِهِ»، وَأَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أُتِيَ بِقَدْرِ فِيهِ خَضِرَاتٌ مِنْ بُقُولٍ، فَوَجَدَ لَهَا رِيحًا، فَسَأَلَ فَأُخْبِرَ بِمَا فِيهَا مِنَ الْبُقُولِ، فَقَالَ قَرَّبُوهَا إِلَيَّ بَعْضُ أَصْحَابِهِ كَانَ مَعَهُ، فَلَمَّا رَأَاهُ كَرِهَ أَكْلَهَا، قَالَ: «كُلْ فَإِنِّي أَنَا جِي مَنْ لَا تُنَاجِي».

وَلِمُسْلِمٍ عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ أَكَلَ مِنْ هَذِهِ الْبُقْلَةِ، الثُّومِ - وَقَالَ مَرَّةً: مَنْ أَكَلَ الْبَصَلَ وَالثُّومَ وَالْكَرَّاثَ فَلَا يَقْرَبَنَّ مَسْجِدَنَا، فَإِنَّ الْمَلَائِكَةَ تَتَأَذَى مِمَّا يَتَأَذَى مِنْهُ بَنُو آدَمَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(306) - Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që ha hudhër ose qepë, të mos na afrohet, - ose ka thënë: të mos i afrohet xhamisë sonë, por le të qëndrojë në shtëpinë e vet.” Profetit ﷺ i sollën një enë me bishtaja (të gatuara). Ai me t'i nuhatur erën, pyeti se çfarë kishte në të. Kur i treguan se kishte bishtaja, tha: “Afrojuani!” - disa shokëve të tij, që ishin së bashku. Kur (njëri prej tyre) pa (se Profeti ﷺ e refuzoi), hezitoi të hante. Profeti ﷺ tha: “Ha, sepse unë flas me atë që

ti nuk flet (me Xhibrilin).” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e ndaloi atë që ha hudhra ose qepë, që të shkojë në xhami, në mënyrë që të mos i pengojë e shqetësojë vëllezërit e tij, që marrin pjesë në namazin me xhemat për shkak të erës së tyre. Ky ndalim është për shkak të evitimit të shqetësimit të xhematit në xhami, jo për shkak të ngrënies së tyre, pasi hudhrat dhe qepët janë ushqime të lejuara. Një herë Profetit ﷺ i sollën një enë me bishtaja (të gatuara). Me t'i nuhatur erën e tyre u njoftua për përbërësit, kështoj nuk i hëngri dhe ia afroi enën disave prej shokëve të tij që të hanin prej saj. Për këtë arsye, njëri prej tyre hezitoi të hante, nga dëshira për të ndjekur shembullin e tij. Kur Profeti ﷺ e pa këtë, tha: "Ha, sepse unë flas me melekët përmes shpalljes."

Profeti ﷺ njoftoi se melekët shqetësohen dhe irritohen nga erërat e pakëndshme, ashtu siç shqetësohen edhe njerëzit prej tyre.

Mësime nga hadithi:

1. Ndalohet të hyjnë në xhami ai që ka ngrënë hudhër, qepë ose presh.
2. Këtyre gjërave u bashkohet (në vendimin e ndalesës) çdo erë e keqe që i shqetëson namazlinjtë, si era e duhanit, e duhanit të tymosur dhe të ngjashme me to.

3. Shkakun e ndalesës është era, pra nëse ajo largohet për shkak të gatimit të tepërt apo për arsye të tjera, largohet edhe të qenët e urryer pjesëmarrja në xhamia pasi të jenë ngrënë ato.
4. Është e papëlqyeshme ngrënia e këtyre gjërave për atë që e ka obligim të marrë pjesë në xhami për namaz, në mënyrë që të mos i ikë namazi me xhemat në xhami, përveç nëse i ha ato me qëllim për mos marrë pjesë në to, atëherë kjo bëhet e ndaluar.
5. Përmbajtja e Profetit ﷺ nga ngrënia e hudhrës dhe të ngjashmeve me të, nuk ishte për shkak se janë të ndaluara, por për shkak të bisedës së tij me Xhibrilin (alejhi selam).
6. Mënyra e bukur e mësimdhënies së Profetit ﷺ, ku ai e lidh gjykimin, duke e sqaruar shkaku të tij, në mënyrë që personit që po i drejtohet të ndihet i qetë, duke e njohur urtësinë e ndalesës.
7. Kadi Ijadi ka thënë: "Dijetarët kanë bërë analogji mbi këtë, duke përfshirë vendet e tubimit për namaz, përveç xhamisë, si: vendfajla e Bajramit, varrimet dhe të ngjashmet që janë tubime adhurimi. Po ashtu, edhe tubimet për dije, përmendje të Allahut, gosti dhe të ngjashmet. Nuk përfshihen në këtë, tregjet dhe vende të ngjashme me to."
8. Dijetarët kanë thënë: "Në këtë hadith ka argument që ndalohet të hyjë në xhami ai që ka ngrënë hudhër

ose diçka të ngjashme, edhe nëse xhamia është e zbrazur, sepse ajo është vend i melekëve dhe për shkak të ndalesës së përgjithshme të përmendur në hadithe."

(4850)

(307) – عَنْ سَهْلِ بْنِ مُعَاذٍ بْنِ أَنَسٍ عَنْ أَبِيهِ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَنْ أَكَلَ طَعَامًا فَقَالَ: الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنِي هَذَا وَرَزَقَنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةٍ، غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(307) – Sehël ibën Muadhi transmeton nga babai i tij, i cili tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Atij që ha ushqim dhe thotë: "Lavdia i takon Allahut, i Cili ma mundësoi ta ha këtë ushqim dhe më furnizoi pa mundin dhe fuqinë time", do t'i falen mëkatet e mëparshme.” [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e stimulon në këtë hadith atë që ha ushqim ta falënderojë Allahun, pasi që nuk ka fuqi të sjellë ushqim e as të hajë, përveçse me ndihmën e Allahut të Lartësuar. Pastaj Profeti ﷺ dha sihariq se atij që e thotë këtë e meriton që Allahu t'ia falë mëkatet e tij të vogla të mëparshme.

Mësim nga hadithi:

1. Është e rekomanduar që në fund të ushqimit gjatë ngrënies të themi: "Elhamduilah - Falënderimi i takon Allahut."
2. Sqarimi i mirësive të mëdha të Allahut të Lartësuar ndaj robërve të Tij, pasi Ai ua lehtësoi dhe ua siguroi atyre mjetet e furnizimit dhe bëri që përmes kësaj të shlyhen mëkatet.
3. Veprat e robërve janë të gjitha nga Allahu i Lartësuar, e jo nga munda e fuqia e tyre, megjithatë robi është i urdhëruar t'i marrë shkaqet e të përpiqet.

(5431)

(308) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: كان رسول الله صلى الله عليه وسلم إذا عطس وضع يده - أو ثوبه - على فيه، وخَفَضَ - أو غَضَّ - بها صوته. [صحيح] -
[رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

(308) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se, sa herë që teshtinte i Dërguari i Allahut ﷺ, vendoste në gojën e tij dorën ose rrobën, me to e zvogëlonte ose e ulte zërin. [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Kur Profeti ﷺ teshtinte:

Së pari e vendoste dorën ose rrobën e tij në gojë, që nga goja ose hunda të mos dilte asgjë që mund të dëmtonte bashkëbiseduesin e tij.

Së dyti, e ulte zërin dhe nuk e ngrinte.

Mësimet nga hadithi:

1. Udhëzimi i Profetit ﷺ gjatë teshtitjes dhe ndjekja e shëmbëlltyrës së tij në këtë çështje.
2. Është e rekomanduar që gjatë teshtimës të vendoset në gojë ose në hundë një rrobë apo shami ose diçka e ngjashme, që të mos dalë prej tyre diçka që mund ta lëndojë bashkëbiseduesin.
3. Ulja e zërit gjatë teshtitjes është diçka që duhet bërë dhe është shenjë e mirësjelljes së përsosur dhe virtyeteve të larta morale.

(3317)

(309) – عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ أَنْ تُؤْتَى رُحْصُهُ، كَمَا يُحِبُّ أَنْ تُؤْتَى عَزَائِمُهُ». [صحيح] - [رواه ابن حبان]

(309) – Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Vërtet Allahu do që të shfrytëzohen lehtësimet e Tij, ashtu siç do që të plotësohen obligimet e Tij." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ibn Hibbani]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu do që të shfrytëzohen lehtësimet që i ka ligjësuar, siç janë lehtësimet sa u përket vendimeve dhe ibadeteve, ku të ngarkuarit me obligime fetare i jepet lehtësim për shkak të arsyes, bie fjala, shkurtimi dhe bashkimi i namazit gjatë udhëtimit. Ai gjithashtu do që të plotësohet obligimet e Tij. Pra, ato që janë vaxhibe, sepse urdhri i Allahut në lidhje me lehtësimet dhe obligimet është i njëjtë.

Mësime nga hadithi:

1. Mëshira e Allahut të Lartësuar ndaj robërve të Tij dhe se Ai do që të shfrytëzohen lehtësimet që i ka ligjësuar.
2. Përsosuria e kësaj feje dhe se ajo ia largon vështirësitë muslimanit.

(65017)

(310) – عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم:

«مَنْ يُرِدِ اللَّهُ بِهِ خَيْرًا يُصِبْ مِنْهُ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(310) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atë të cilit Allahu i do mirësi, e sprovon." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon, se nëse Allahu ia do të mirën ndokujt prej robërve të Tij besimtarë, do t'a sprovtojë në veten e tij, në pasuri dhe në familje, për shkak se besimtari gjatë sprovës kthehet tek Allahu i Lartësuar me lutje, i shlyhen gjynahet e veprave të këqija dhe i ngrihen shkallët (në Xhenet).

Mësime nga hadithi:

1. Besimtari u ekspozohet llojeve të ndryshme të sprovave.
2. Sprova mund të jetë shenjë treguese se Allahu e do robin e Tij, derisa Ai ta ngrejë gradën e tij, ta lartësojë pozitën e tij dhe t'ia shlyejë gjynahet.
3. Inkurajimi për të bërë durim gjatë fatkeqësive dhe të mos tregohemi të padurueshëm.

(4204)

(311) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ وَعَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَا يُصِيبُ الْمُسْلِمَ مِنْ نَصَبٍ وَلَا وَصَبٍ وَلَا حُزْنٍ وَلَا أَذًى وَلَا غَمٍّ حَتَّى الشُّوْكَةِ يُشَاكُهَا إِلَّا كَفَّرَ اللَّهُ بِهَا مِنْ خَطَايَاهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(311) – Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Çdo fatkeqësi që mund ta godasë muslimanin, qoftë lodhje e sëmundje, qoftë brengë

e pikëllim, qoftë shqetësim e mërzi, madje dhe një shpim gjembi, përmes saj Allahu do t'ia fshijë disa gjynahe." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se çdo sëmundje, brengë, pikëllim, ankth, fatkeqësi, vështirësi, frikë dhe uri që e godet muslimanin, edhe nëse e godet ndonjë gjemb dhe i shkakton dhimbje, do të jenë shlyerje për gjynahet e tij.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i mirësisë dhe mëshirës së Allahut ndaj robërve të Tij besimtarë, i Cili ua fal mëkatet përmes dëmit më të vogël që i godet.
2. Muslimani duhet të shpresojë shpërblim tek Allahu për atë që e godet dhe të jetë i durueshëm për çdo fatkeqësi, qoftë e madhe, qoftë e vogël, në mënyrë që kjo të jetë ngritje në shkallë (të Xhenetit) dhe shlyerje për veprat e këqija.

(3701)

(312) – عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَا يَزَالُ الْبَلَاءُ بِالْمُؤْمِنِ وَالْمُؤْمِنَةِ فِي نَفْسِهِ وَوَلَدِهِ وَمَالِهِ حَتَّى يَلْقَى اللَّهَ وَمَا عَلَيْهِ خَطِيئَةٌ». [حسن] - [رواه الترمذي وأحمد]

(312) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Sprova

vazhdon ta godasë besimtarin dhe besimtaren në vetet e tyre, fëmijët dhe pasurinë derisa ta takojnë Allahun dhe të mos kenë mëkate fare." [Hadith hasen] - [رواه الترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se sprovat dhe provimi nuk pushojnë kurrë për besimtarin e besimtaren, në vetet e tyre: shëndetin dhe trupin, fëmijët: në aspektin e sëmundjes, vdekjes, mosbindjes ose të tjera, dhe në pasuri: varfëri, zhdukje të tregtisë, vjedhje, ngecje në jetesë dhe vështirësi në furnizim, derisa Allahu përmes këtyre sprovave t'ia shlyejë të gjitha mëkatet, që, kur ta takojë Allahun, të jetë i pastër nga të gjitha mëkatet që i ka kryer.

Mësime nga hadithi:

1. Është pjesë e mëshirës së Allahut ndaj robërve të Tij besimtarë që Ai t'ua shlyejë mëkatet në këtë botë përmes sprovave dhe fatkeqësive të kësaj bote.
2. Thjesht prova i shlyen mëkatet, me kusht që robi të jetë besimtar, kështu që, nëse robi bën durim dhe nuk tregohet i pakënaqur, do të shpërblehet.
3. Inkurajimi për të bërë durim në të gjitha çështjet, në ato që i pëlqen dhe nuk i pëlqen. Kësisoj, ai është i durueshëm dhe e kryen atë që ia ka obliguar Allahu; është i durueshëm dhe largohet nga ajo që e ka ndaluar Allahu, duke shpresuar në shpërblimin e Tij dhe duke u frikësuar nga dënimi i Tij.

4. Pjesa në hadith: “besimtarin dhe besimtaren”. Shtimi i fjalës "besimtaren" është argument për të treguar pohim shtesë për gratë, se, po të thoshte: “besimtarin”, gruaja do të ishte përfshirë në të, sepse kjo nuk është specifike për burrat, kështu që, nëse gruas i bie ndonjë sprovë, edhe asaj i premtohet gjithashtu shpërblim i ngjashëm duke iu shlyer mëkatet dhe veprat e këqija.
5. Ajo që ia bën më të lehtë dhimbjet robit, të cilat e godasin herë pas here, është mirësia që vjen si shkak i provës.

(3159)

(313) - عَنْ صُحَيْبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «عَجَبًا لِأَمْرِ الْمُؤْمِنِ، إِنَّ أَمْرَهُ كُلَّهُ خَيْرٌ، وَلَيْسَ ذَاكَ لِأَحَدٍ إِلَّا لِلْمُؤْمِنِ، إِنْ أَصَابَتْهُ سَرَاءٌ شَكَرَ، فَكَانَ خَيْرًا لَهُ، وَإِنْ أَصَابَتْهُ صَرَاءٌ صَبَرَ، فَكَانَ خَيْرًا لَهُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(313) – Suhejbi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Sa e çuditshme që është çështja e besimtarit: gjithçka që e godet atë, është në të mirën e tij dhe kjo nuk është për askënd përveç besimtarit. Kur e kaplon ndonjë begati, ai falënderon, gjë që është në të mirën e tij, e, nëse e godet ndonjë vështirësi, ai bën durim, gjë që është po në të mirën e tij.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ është çuditur me çështjen dhe gjendjen e besimtarit, duke e konsideruar këtë si diçka të bukur, ngase të gjitha situatat nëpër të cilat ai kalon, janë të mira për të, e kjo nuk është për askënd përveç besimtarit. Kur e kaplon ndonjë gëzim, e falënderon Allahun për të dhe kësisoj përmes falënderimit merr shpërblim. E, nëse e godet ndonjë hidhërim, duron dhe shpreson shpërblim prej Allahut, e kështu merr shpërblim prej durimit; pra ai është i shpërblyeshëm në çdo situatë.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e falënderimit në kohë gëzimi dhe e durimit në kohë hidhërimi. Kushdo që e bën këtë, do të fitojë të mirat e dy botëve, sikundër që kushdo që nuk falënderon për begatinë dhe nuk duron për fatkeqësinë, nuk do të ketë shpërblim por mëkat.
2. Vlera e imanit (besimit), ngase shpërblimi në të dyja rastet është vetëm për besimtarët.
3. Falënderimi në rast gëzimi dhe durimi në rast hidhërimi janë prej virtyteve të besimtarëve.
4. Besimi në kadanë dhe kaderin e Allahut (përcaktimin hyjnor) e bën besimtarin plotësisht të kënaqur me të gjitha rrethanat, ndryshe nga jobesimtari, i cili vazhdimisht zemërohet kur e godet ndonjë e keqe a vështirësi. E kur ky fiton ndonjë mirësi të Allahut, preokupohet me të dhe e

braktis adhurimin, madje përmes kësaj mirësie i bën mëkat Allahut.

(3298)

(314) - عن أبي موسى الأشعري رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «إِذَا مَرِضَ الْعَبْدُ أَوْ سَافَرَ كُتِبَ لَهُ مِنْ كُلِّ مِثْلٍ مَا كَانَ يَعْمَلُ مُقِيمًا صَحِيحًا».

[صحيح] - [رواه البخاري]

(314) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur robi sëmuret ose udhëton, shpërblimi i shkruhet njësoj siç ka punuar sa ka qenë vendas dhe i shëndoshë.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith për mirësitë dhe mëshirën e Allahut. Kjo, se, nëse muslimani e kishte zakon të bënte vepra të mira sa ishte shëndoshë e vendas dhe i ka ndodhur ndonjë gjë, fjala vjen, është i sëmure dhe nuk mund ta kryejë atë ose është i zënë me udhëtim, ose ndonjë justifikim tjetër, atëherë i shkruhet shpërblimi i plotë, sikur të kishte punuar sa ishte shëndoshë e vendas.

Mësim nga hadithi:

1. Mirësia e gjerë e Allahut ndaj robërve të Tij.

2. Inkurajimi për të qenë të zellshëm në kryerjen e adhurimeve dhe shfrytëzimi i kohës kur jemi të shëndoshë dhe kemi kohë të lirë.

(3553)

(315) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «بَادِرُوا بِالْأَعْمَالِ فِتْنًا كَقَطْعِ اللَّيْلِ الْمُظْلِمِ، يُصْبِحُ الرَّجُلُ مُؤْمِنًا وَيُمْسِي كَافِرًا، أَوْ يُمْسِي مُؤْمِنًا وَيُصْبِحُ كَافِرًا، يَبِيعُ دِينَهُ بِعَرَضٍ مِنَ الدُّنْيَا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(315) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Shpejtoni në kryerjen e veprave të mira para se të vijnë sprova si copëzat e natës së errët, në atë kohë njeriu do të gdhihet besimtar, e do të ngryset jobesimtar, ose do të ngryset besimtar e do të gdhihet jobesimtar: e shet fenë për një interes të dynjasë.”

[Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e nxit besimtarin që të shpejtojë dhe të bëjë sa më shumë vepra të mira para se ato të bëhen të pamundura për shkak të preokupimit me shfaqjen e sprovave dhe dyshimeve që e pengojnë besimtarin nga kryerja e punëve të mira. Këto sprova janë si errësira e natës, në të cilën e vërteta përzihet me të kotën dhe për rrjedhojë bëhet e vështirë për njerëzit të bëjnë dallimin mes tyre. Ato janë aq të rënda saqë njeriu çoroditet deri në atë pikë sa në mëngjes është besimtar e në mbrëmje bëhet jobesimtar, si

dhe në mbrëmje është besimtar, ndërsa në mëngjes bëhet jobesimtar, duke e braktisur fenë e tij për shkak të kënaqësive kalimtare të kësaj dynjaje.

Mësime nga hadithi:

1. Është e obligueshme të kapemi fort pas fesë dhe të shpejtojmë të bëjmë vepra të mira para se të na dalin pengesa.
2. Vënia në pah se sprovat devijuese do të jenë të njëpasnjëshme në fund të kohës (para Kiametit): sa herë që zhduket një provë, pason një tjetër.
3. Nëse fetaria e një personi është e dobët dhe ai heq dorë nga ajo në këmbim të çështjeve të kësaj dynjaje, si pasuria ose gjëra të tjera, atëherë kjo konsiderohet si shkak i devijimit të tij, braktisjes së fesë dhe përfshirjes në sprovat.
4. Ky hadith është argument se veprat e mira janë shkak për të shpëtuar nga sprovat.
5. Sprovat ndahen në dy lloje: sprovat e dyshimeve, ilaçi i të cilave është dituria, dhe sprovat e epsheve, ilaçi i të cilave është imani (besimi) dhe durimi.
6. Hadithi tregon se kush është punëpakë, sprovat do ta zërë më shpejt, e kush është punëshumë, nuk duhet të mashtrohet nga ajo, por, përkundrazi, të shtojë punët e mira.

(316) - عن معاوية رضي الله عنه قال: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول: «مَنْ يُرِدِ اللَّهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ، وَإِنَّمَا أَنَا قَاسِمٌ، وَاللَّهُ يُعْطِي، وَلَنْ تَزَالَ هَذِهِ الْأُمَّةُ قَائِمَةً عَلَى أَمْرِ اللَّهِ، لَا يَضُرُّهُمْ مَنْ خَالَفَهُمْ، حَتَّى يَأْتِيَ أَمْرُ اللَّهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(316) – Muaviu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Atij që Allahu ia do të mirën, ia mundëson kuptimin e fesë. Unë jam vetëm shpërndarës (i pasurisë dhe kumtues i fesë), kurse Allahu është Dhuruesi. Ky umet do të vazhdojë të qëndrojë i fortë në fenë e Allahut dhe nuk do ta dëmtojnë kundërshtarët, derisa të vijë caktimi i Allahut.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se atij që Allahu ia do të mirën, i jep të kuptuar të thellë në fenë e Tij. Profeti ﷺ është shpërndarës, i cili e shpërndan rrizkun, diturinë dhe gërat e tjera që ia ka dhënë Allahu, ndërsa Dhuruesi i vërtetë është Allahu. Sa u përket të tjerave, ato janë mjete që nuk janë të dobishme, përveçse me lejen e Allahut. Ky umet do të vazhdojë të qëndrojë i fortë në fenë e Allahut dhe nuk do ta dëmtojnë kundërshtarët, derisa të vijë caktimi i Allahut.

Mësime nga hadithi:

1. Madhështia dhe vlera e dijes fetare, mësimit të saj dhe inkurajimit për ta kërkuar atë.
2. Kapja fort pas së vërtetës medoemos do të ekzistojë në këtë umet: nëse një grup e braktis, grupi tjetër do të kapet për të.
3. Të kuptuarit e thellë të fesë është shenjë se Allahu ia ka dëshiruar mirësinë robit të Vet.
4. Profeti ﷺ dhuron me lejen dhe vullnetin e Allahut, sepse ai nuk posedon gjë.

(5518)

(317) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «نَصَرَ اللَّهُ أَمْرًا سَمِعَ مِنْ شَيْئًا قَبْلَهُ كَمَا سَمِعَ، قُرْبَ مُبْلَغِ أَوْعَى مِنْ سَامِعٍ». [صحيح] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(317) – Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Allahu e ndriçoftë një njeri që dëgjon prej nesh diçka dhe e përcjell ashtu siç e ka dëgjuar, sepse ndodh, që ai të cilit i përcillet, të jetë më i kuptueshëm se ai që e ka dëgjuar." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ u lut që Allahu t'i dhurojë ndriçim, gëzim dhe bukuri në këtë botë, si dhe ta çojë atë në ndriçimin dhe begatitë e Xhenetit në botën tjetër, për atë që e dëgjon hadithin e tij, e mëson përmendsh dhe e përcjell te të tjerët. Ndoshta atij që i përcillet hadithi është më i kuptueshëm, më i thellë në dije dhe më i aftë për të nxjerrë dobi e dispozita sesa ai që e përcjell hadithin. Kështu, i pari e zotëron mirë mbajtjen përmendësh dhe transmetimin, ndërsa i dyti e zotëron mirë kuptimin dhe nxjerrjen e dobive dhe dispozitave.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për ta ruajtur Sunetin profetik dhe përcjelljen e tij te njerëzit.
2. Sqarim për vlerën që e gëzojnë ithtarët e dijetarët e hadithit dhe vlera e kërkimit të haditheve.
3. Vlera e dijetarëve, të cilët janë meritoret për të nxjerrë dispozita dhe për t'i kuptuar hadithet (ashtu siç duhet).
4. Vlera e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) qëndron në faktin se ata ishin ata që i dëgjuan hadithet e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe na i përcollën neve.
5. Munaviu ka thënë: "Me këtë (hadith) është sqaruar se për transmetuesin e hadithit, kuptimi i thellë

(fikhu) nuk është prej kushteve të transmetimit të tij; kushti i tij është memorizimi (hifzi), ndërsa detyrë e dijetarit është kuptimi dhe meditimi mbi të.

6. Ibën Ujejne ka thënë: "Nuk ka njeri që e kërkon (dhe e mëson) hadithin, veçse në fytyrën e tij shihet një ndriçim për shkak të këtij hadithi."
7. Memorizimi (hifzi) tek dijetarët e hadithit është dy lloje: ruajtje me zemër dhe gjoks (memorizim përmendsh), dhe ruajtje me libër dhe shkrim. Të dyja këto lloje përfshihen në lutjen e përmendur në hadith.
8. Kuptimet e njerëzve janë të ndryshme; ndodh që ai të cilit i përcillet (hadithi) të jetë më i thellë në kuptim sesa ai që e ka dëgjuar hadithin, dhe ndodh që bartësi i një dijeje (fikh) të mos jetë vetë jurist (fakih).

(6820)

(318) - عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَا تَعْلَمُوا الْعِلْمَ لُتْبَاهُوا بِهِ الْعُلَمَاءَ، وَلَا لُتْمَارُوا بِهِ السُّفَهَاءَ، وَلَا تَحْيَرُوا بِهِ الْمَجَالِسَ، فَمَنْ فَعَلَ ذَلِكَ، فَالْتَارُ النَّارُ». [صحيح] - [رواه ابن ماجه]

(318) – Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Mos kërkonit dituri për t'u mburrur para dijetarëve, as për të diskutuar me mendjelehtët, e as që të bëni vende nëpër kuvende! Kushdo

që e bën këtë, Zjarri (për të është meritör), Zjarri." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ibën Maxhe]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër kërkimit të diturisë për hir të mburrjes para dijetarëve dhe për t'u paraqitur si dijetar, ose për t'iu drejtuar dhe për të debatuar me mendjehetët, ose për të mësuar në mënyrë që të zërë vend në kuvende dhe t'i jepet përparësi në to ndaj të tjerëve. Kushdo që e bën këtë, e meriton Zjarrin, për shkak të hipokrizisë dhe mungesës së sinqeritetit në kërkimin e diturisë për hir të Allahut.

Mësime nga hadithi:

1. Kërcënimi me Zjarr për këdo që kërkon dituri për t'u mburrur me të, për të debatuar, për të zënë vend nëpër kuvende, e kështu me radhë.
2. Rëndësia e nijetit të sinqertë për atë që e mëson dijen dhe ua mëson të tjerëve.
3. Nijeti është themeli i veprave dhe në varësi të tij jepet shpërblimi.

(65047)

(319) – عن عثمان رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال:

«خَيْرُكُمْ مَنْ تَعَلَّمَ الْقُرْآنَ وَعَلَّمَهُ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(319) – Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se muslimani më i mirë dhe me shkallën më të lartë tek Allahu është ai që e mëson Kuranin: për ta lexuar, e memorizon, e lexon ngadalë dhe qartë, si dhe i mëson çështjet e fikhut dhe të tefsirit që lidhen me të, si dhe ua mëson të tjerëve njohuritë që i ka rreth Kuranit dhe i jetëson (urdhrat e tij).

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i madhështisë së Kuranit dhe se ai është fjala më e mirë dhe Fjala e Allahut.
2. Mësuesi më i mirë është ai që i mëson të tjerët, e nuk mjaftohet vetëm me veten e tij.
3. Mësimi i Kuranit për vete dhe mësimi i tij të tjerëve përfshin leximin, kuptimet dhe vendimet.

(5913)

(320) - عَنْ أَبِي عَبْدِ الرَّحْمَنِ السُّلَمِيِّ رَحِمَهُ اللَّهُ قَالَ: حَدَّثَنَا مَنْ كَانَ يُفَرِّئُنَا مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُمْ كَانُوا يَقَرِّئُونَ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَشْرَ آيَاتٍ، فَلَا يَأْخُذُونَ فِي الْعَشْرِ الْأُخْرَى حَتَّى يَعْلَمُوا مَا فِي هَذِهِ مِنَ الْعِلْمِ وَالْعَمَلِ، قَالُوا: فَعَلِمْنَا الْعِلْمَ وَالْعَمَلَ. [حسن] - [رواه أحمد]

(320) – Ebu Abdurrahman Sulemiu (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: Na kanë treguar ata që na mësonin Kuranin nga sahabët e Profetit ﷺ, se ata i mësonin dhjetë ajete nga Profeti ﷺ dhe nuk i mësonin dhjetë ajete të tjera pa e mësuar dijen dhe veprimin që përmbanin ato. Kështu thoshin: "E mësuar dijen dhe veprimin (së bashku)." [Hadith hasen] - [E shënon Ahmedi]

Shpjegimi:

Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) i mësonin nga i Dërguari i Allahut ﷺ dhjetë ajete të Kuranit dhe nuk kalonin në asnjë ajet tjetër pa mësuar dijen që përmbanin këto dhjetë ajete dhe duke e vënë në praktikë, kësisoj e mësuan dijen dhe veprimin së bashku.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dhe kujdesi që tregonin për mësimin e Kuranit.
2. Mësimi i Kurani bëhet me dije dhe duke e vënë në praktikë, e jo thjesht të lexohet e të mësohet përmendsh.

3. Dija është para fjalës dhe veprës.

(65058)

(321) - عن عبد الله بن مسعود رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ بِهِ حَسَنَةٌ، وَالحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا، لَا أَقُولُ {الم} حَرْفٌ، وَلَكِنْ {أَلِفٌ} حَرْفٌ، وَ{لَامٌ} حَرْفٌ، وَ{مِيمٌ} حَرْفٌ». [حسن] - [رواه الترمذي]

(321) - Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, ka një shpërblim, i cili shtohet dhjetëfish. Nuk them se elifi, lami dhe mimi janë një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami një shkronjë dhe mimi shkronjë më vete.” [Hadith hasen] - [E shënon Tirmidhiu]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se çdo musliman që lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, ka një shpërblim, i cili shtohet dhjetëfish.

Pastaj këtë gjë e sqaroi me fjalën e tij: "Nuk them se elifi, lami dhe mimi janë një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami një shkronjë dhe mimi shkronjë më vete", pra këto tri shkronja janë të barabarta me tridhjetë të mira.

Mësim nga hadithi:

1. Inkurajimi për të lexuar Kuranin shpesh.

2. Lexuesi për çdo shkronjë që e lexon, do të marrë nga një të mirë të shumëfishuar dhjetëfish.
3. Mëshira dhe bujaria e gjerë e Allahut, meqë në saje të mirësisë dhe bujarisë së Tij robit ia shumëfishon shpërblimin.
4. Epërsia e Kuranit kundrejt fjalëve të tjera dhe adhurimi i Allahut përmes leximit të tij. Kjo, se ai është fjala e Allahut të Lartësuar.

(6275)

(322) - عن عبد الله بن عمرو رضي الله عنهما قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «يَقَالُ لَصَاحِبِ الْقُرْآنِ: اقْرَأْ وَارْتَقِ، وَرَتَّلْ كَمَا كُنْتَ تَرَتَّلُ فِي الدُّنْيَا، فَإِنْ مَنَزَلَكَ عِنْدَ آخِرِ آيَةٍ تَقْرُؤُهَا». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وأحمد]

(322) – Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Lexuesit të Kuranit do t'i thuhet (në Ditën e Gjykimit): "Lexo dhe ngrihu (shkallëve të Xhenetit), lexo drejt dhe bukur, siç ke lexuar në dynja, se vendi yt është në ajetin e fundit që e lexon." [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se lexuesit të Kuranit, i cili e jetëson atë e në vazhdimësi e lexon dhe e mëson përmendsh, kur të hyjë në Xhenet, do t'i thuhet: "Lexoje

Kuranin dhe ngrihu përmes kësaj në shkallët e Xhenetit, si dhe lexoje drejt e bukur, ashtu siç e ke lexuar në dynja me kujdes dhe me qetësi, se vendi yt është në ajetin e fundit që lexon."

Mësim nga hadithi:

1. Shpërblimi, sa i përket sasisë dhe cilësisë, është në varësi të veprave.
2. Inkurajimi për të lexuar Kuran, për ta perfeksionuar, për ta mësuar përmendsh, për ta meditar dhe për të vepruar sipas tij.
3. Xheneti ka shumë shkallë e grada dhe shkallët më të larta do t'i arrijë lexuesi i Kuranit.

(65054)

(323) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يُحِبُّ أَحَدُكُمْ إِذَا رَجَعَ إِلَى أَهْلِهِ أَنْ يَجِدَ فِيهِ ثَلَاثَ خَلِفَاتٍ عِظَامٍ سَمَانٍ؟» قُلْنَا: نَعَمْ. قَالَ: «فَثَلَاثُ آيَاتٍ يَقْرَأُ بِهِنَّ أَحَدُكُمْ فِي صَلَاتِهِ خَيْرٌ لَهُ مِنْ ثَلَاثِ خَلِفَاتٍ عِظَامٍ سَمَانٍ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(323) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “A dëshiron dikush nga ju që, kur të kthehet te familja e vet, të gjejë tri deve me barrë, të mëdha e të shëndosha?” - Posi, - i thamë. - “Tri ajete të cilat ndonjëri prej jush i lexon gjatë namazit të tij janë më të mira për të sesa tri deve me barrë, të mëdha e

të shëndosha”, - tha Profeti ﷺ." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron se shpërblimi për leximin e tri ajeteve në namaz është më i mirë se një person të gjejë në shtëpinë e tij tri deve me barrë, të mëdha e të shëndosha.

Mësime nga hadithi:

1. Sqarimi i vlerës së leximit të Kuranit në namaz.
2. Veprat e mira janë më të mira dhe më të përhershme sesa të mirat e kësaj bote kalimtare.
3. Kjo vlerë nuk kufizohet në leximin e vetëm tri ajeteve: sa më shumë që namazliu të lexojë ajete në namazin e tij, aq më i mirë do të jetë shpërblimi për ato ajete; aq sa ajete i lexon, i llogariten po aq deve.

(65053)

(324) – عن أبي موسى الأشعري رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «تَعَاهَدُوا هَذَا الْقُرْآنَ، فَوَالَّذِي نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ لَهُوَ أَشَدُّ تَفَلُّتًا مِنَ الْإِبِلِ فِي عُقْلِهَا». [صحيح] - [متفق عليه]

(324) – Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “Përsëriteni Kuranin vazhdimisht, sepse betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është

shpirti i Muhamedit, se ai ikën më shpejt se deveja kur zgjidhet nga litari.” [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar që të përsëritet Kurani dhe të lexohet vazhdimisht, që të mos harrohet pasi është mësuar përmendsh në kraharor, dhe këtë e vërtetoi me betim, se Kurani largohet më shpejt nga kraharori sesa devetë e lidhura me litarë në mes të krahut. Nëse njeriu e përsërit atë, e kap (dhe e ruan), e, nëse e lëshon (nuk e përsërit), largohet dhe humbet.

Mësime nga hadithi:

1. Nëse hafëzi e lexon atë në vazhdimësi, pa pushim, ai do të mbetet i ruajtur në zemrën e tij, përndryshe do të largohet dhe do ta harrojë.
2. Prej dobive të përsëritjes së Kuranit në vazhdimësi është shpërblimi dhe ngritja e shkallëve në Ditën e Kiametit.

(5907)

(325) – عن أبي هريرة رضي الله عنه: أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «لَا تَجْعَلُوا بُيُوتَكُمْ مَقَابِرَ، إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْفِرُ مِنَ الْبَيْتِ الَّذِي تُقْرَأُ فِيهِ سُورَةُ الْبَقَرَةِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(325) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Shtëpitë

tuaja mos i bëni varreza, se shejtani ikën prej shtëpisë në të cilën lexohet surja el Bekare.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ përmes këtij hadithi ndaloi që shtëpitë të jenë të zhveshura nga falja e namazit (vullnetar), e kështu të bëhen si varreza, në të cilat nuk falet namazi.

Pastaj Profeti ﷺ tregoi se shejtani ikën prej shtëpisë në të cilën lexohet surja el Bekare.

Mësime nga hadithi:

1. Është e rekomanduar që në shtëpi të shtohen adhurimet dhe namazi vullnetar.
2. Nuk lejohet falja e namazit në varreza, sepse është mjet që dërgon drejt shirkut (idhujtarisë) dhe teprimit në raport me të vdekurit, në përjashtim të namazit të xhenazes (që lejohet të falet).
3. Pasi ndalimi i faljes së namazit te varret ishte ngulitur te sahabët, kjo është arsyeja pse Profeti ﷺ e ndaloi shndërrimin e shtëpive në varreza, në të cilat nuk falet namazi.

(6208)

(326) - عَنْ أُبَيِّ بْنِ كَعْبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يَا أَبَا الْمُنْذِرِ، أَتَدْرِي أَيُّ آيَةٍ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ مَعَكَ أَعْظَمُ؟» قَالَ: قُلْتُ: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ. قَالَ: «يَا أَبَا الْمُنْذِرِ، أَتَدْرِي أَيُّ آيَةٍ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ مَعَكَ أَعْظَمُ؟» قَالَ: قُلْتُ: {اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ} [البقرة: 255]. قَالَ: فَضَرَبَ فِي صَدْرِي، وَقَالَ: «وَاللَّهِ لِيَهْنِكَ الْعِلْمُ، أَبَا الْمُنْذِرِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(326) – Ubej ibën Kabi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ i ka thënë: “O Ebu Mundhir, a e di se cili është ajeti më i madh (më me vlerë) në Librin e Allahut, që e ke me vete?” - Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri, - i thashë. - “O Ebu Mundhir, a e di se cili është ajeti më i madh (më me vlerë) në Librin e Allahut, që e ke me vete?” - më pyeti sërish. - “Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!” (El Bekare, 255) - i thashë. Atëherë me goditi në gjoks dhe më tha: “Për Allahun, e gëzofsh dijen, o Ebu Mundhir!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e pyeti Ubej ibën Kabin për ajetin më madhështor në Librin e Allahut, kështu që ai hezitoi të përgjigjej, pastaj tha: "Është ajeti kursij: “Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!” (El Bekare, 255) - Profeti ﷺ e mbështeti dhe e goditi gjoksin e tij si shenjë se ishte i

mbushur me dituri dhe urtësi, si dhe u lut që ai të gëzohej me këtë dituri dhe t'i lehtësohej."

Mësime nga hadithi:

1. Virtyti madhështor i Ubej ibën Kabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).
2. Ajet kursij është ajeti më madhështor në Librin e Allahut të Lartësuar, kështu që duhet të mësohet përmendsh, të meditohej kuptimet e tij dhe të jetësohet.

(65059)

(327) – عن أبي مسعود رضي الله عنه قال: قال النبي صلى الله عليه وسلم:

«مَنْ قَرَأَ بِالْآيَتَيْنِ مِنْ آخِرِ سُورَةِ الْبَقَرَةِ فِي لَيْلَةِ كَفْتَاهُ». [صحيح] - [متفق عليه]

(327) – Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Atij që i lexon dy ajetet e fundit të sures el Bekare gjatë natës, do t'i mjaftojnë." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka njoftuar se kushdo që i lexon dy ajetet e fundit të sures el Bekare gjatë natës, Allahu do t'i mjaftojë atij nga çdo gjë e keqe dhe çdo gjë që e urren. Po ashtu është thënë (si mendim se): i mjaftojnë kundrejt namazit të natës; i mjaftojnë kundrejt dhikreve të tjera; ato janë ajetet më të pakta që mjaftojnë për leximin e Kuranit gjatë namazit të

natës dhe janë dhënë edhe mendime të tjera. Të gjitha mendimet që u përmendën janë të sakta dhe kjo shprehje i ngërthen në vete.

Mësim nga hadithi:

1. Sqarimi i vlerës së ajeteve të fundit të sures el Bekare. Këto ajete janë nga fjala e Allahut të Lartësuar: "I Dërguari beson në të (Kuranin)..." , deri në fund të sures.
2. Ajetet e fundit të sures el Bekare, atij që i lexon, ia largojnë të keqen, sherrin e shejtanin, nëse i lexon gjatë natës.
3. Nata fillon me perëndimin e Diellit dhe mbaron me lindjen e agimit.

(6274)

(328) - عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ حَفِظَ عَشْرَ آيَاتٍ مِنْ أَوَّلِ سُورَةِ الْكَهْفِ، عُصِمَ مِنَ الدَّجَالِ». وَفِي رَوَايَةٍ: «مِنْ آخِرِ سُورَةِ الْكَهْفِ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(328) – Ebu Derdai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të jetë i mbrojtur nga (sprova e) Dexhallit.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se kush i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të ruhet, do të mbrohet dhe do të jetë i siguar nga sprova e mesihut Dexhall, i cili do të shfaqet në fund të kohës dhe do të pretendojë se është zot. Sprova e tij do të jetë sprova më e madhe që ka përjetuar toka, që nga krijimi i Adem-it e deri në Ditën e Kiametit, për shkak të veprimeve të jashtëzakonshme që Allahu i Lartësuar do t'ia mundësojë atij, për të mashtruar ndjekësit e tij. Kjo, ngase në fillim të sures Kehf ka tregime dhe argumente madhështore, që janë më të mëdha sesa ato që Dexhalli do të përdorë për të hutuar njerëzit. Kështu, kush mendon e mediton mbi to, nuk do të mashtrohet prej tij. Në një transmetim tjetër, thuhet se janë dhjetë ajetet e fundit të kësaj sureje, që fillojnë me fjalën e Allahut: "A mos mendojnë jobesimtarët se mund t'i marrin robërit e Mi për mbrojtës përveç Meje..."

Mësime nga hadithi:

1. Ky hadith tregon vlerën e sures Kehf, se fillimi ose fundi i saj mbron nga sprova e Dexhallit.
2. Njoftimi rreth çështjes së Dexhallit dhe sqarimi i asaj që mbron prej tij.
3. Inkurajimi për ta mësuar përmendsh tërë suren Kehf, e nëse nuk mundet, le t'i mësojë dhjetë ajetet e para dhe të fundit.

4. Kurtubiu ka thënë për shkakun e kësaj mbrojtjeje: "Thuhet se kjo është për shkak të mrekullive dhe shenjave që gjenden në historinë e Banorëve të Shpellës, e kush mediton mbi të nuk do të çuditet nga çështja e Dexhallit dhe nuk do të frikësohet prej tij, e kështu nuk do të mashtrohet. Gjithashtu, është thënë se kjo lidhet me fjalën e Allahut: "... për të paralajmëruar nëpërmjet tij, dënim të ashpër (për jobesimtarët) ...", që nënvizon ashpërsinë e dënimit dhe faktin se ai vjen nga Allahu, e kjo përputhet me atë që do të ndodhë nga Dexhalli, i cili pretendon hyjnizimin, sundimin e tij dhe sprovën do ta ketë të madhe. Për këtë arsye, Profeti ﷺ e konsideroi të madhe çështjen e tij, paralajmëroi ndaj tij dhe kërkoi mbrojtje tek Allahu nga sprova e tij. Prandaj, kuptimi i hadithit është: Kush i lexon këto ajete, i mediton dhe ndalet në kuptimin e tyre, do të ruhet prej tij dhe do të jetë i sigurt."

(6265)

(329) – عن النعمان بن بشير رضي الله عنه قال: سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول: «الدُّعَاءُ هُوَ الْعِبَادَةُ»، ثُمَّ قَرَأَ: «وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ» [غافر: 60]. [صحيح] -
[رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

(329) – Numan ibën Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ të thotë: "Lutja është vetë

adhurimi." Pastaj e lexoi (ajetin): "Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!" (Gafir, 60) [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se lutja është vetë adhurimi, prandaj duhet të jetë e gjitha e sinqertë ndaj Allahut, qoftë kjo (1) lutje kërkesë, pra, ta lusë Allahun e Lartësuar për gjërat që do t'i bëjnë dobi dhe ta lusë që t'ia largojë atë që e dëmton në këtë botë dhe në botën tjetër; qoftë (2) lutje adhurimi, e cila nënkupton gjithçka që Allahu e do dhe është i kënaqur, qoftë fjalë, qoftë vepër, e jashtme apo e brendshme. Adhurimet janë të zemrës, të trupit dhe që kanë të bëjnë me pasurinë.

Më pas Profeti ﷺ për këtë çështje u argumentua me këtë ajet kuranor, ku Allahu thotë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!"

Mësime nga hadithi:

1. Lutja është themeli i adhurimit dhe si e tillë nuk lejohet t'i kushtohet dikujt tjetër pos Allahut.
2. Lutja ngërthen në vete realitetin e robërimit (ndaj Allahut), pohimin se Allahu i Lartësuar është i

panevojë (për ndokënd) e është i Fuqishëm dhe se robi është nevojtar për Të.

3. Kërcënimi i ashpër (i përmendur në ajet) është dënimi për faktin se u treguan mendjemëdhenj ndaj adhurimit të Allahut dhe e lanë anash lutjen drejtuar Atij. Ata që janë mendjemëdhenj e nuk e lusin Allahun, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar dhe të përçmuar.

(5496)

(330) – عن عائشة رضي الله عنها قالت: كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَذْكُرُ

اللَّهُ عَلَى كُلِّ أَحْيَانِهِ. [صحيح] - [رواه مسلم]

(330) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Profeti ﷺ e përmendte Allahun në çdo gjendje." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), tregon se Profeti ﷺ i kushtonte shumë rëndësi përmendjes së Allahut të Lartësuar dhe se ai e përmendte Allahun e Lartësuar në çdo kohë, vend dhe situatë.

Mësime nga hadithi:

1. Për përmendjen e Allahut të Lartësuar nuk kushtëzohet pastrimi nga papastërtia e vogël (të

qenët pa abdes) dhe nga ajo e madhe (të qenët xhunub).

2. Profeti ﷺ në vazhdimësi e përmendte Allahun e Lartësuar.
3. Inkurajimi që Allahu i Lartësuar të përmendet shpesh në çdo kohë, duke ndjekur kështu shembullin e Profetit ﷺ, me përjashtim të rasteve kur ai përmbahej nga dhikri, siç është kryerja e nevojave fiziologjike.

(8402)

(331) - عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «لَيْسَ

شَيْءٌ أَكْرَمَ عَلَى اللَّهِ تَعَالَى مِنَ الدُّعَاءِ». [حسن] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(331) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Nuk ka asgjë më fisnike për Allahun sesa lutja." [Hadith hasen] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se nuk ka adhurim më të mirë tek Allahu i Lartësuar sesa lutja, sepse ngërthen në vete pohimin se Allahu i Lartmadhëruar është i Vetëmjaftueshëm dhe pohimin se robi është i paaftë e i varfër për Allahun.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e lutjes dhe se kushdo që e lut Allahun, e madhëron Atë dhe e pranon se Ai është i Vetëmjaftueshëm, sepse nuk i lutemi të varfrit. Ai është Gjithëdëgjues, e nuk i lutemi të shurdhrit. Ai është Bujar, e nuk i lutemi koprracit. Ai është i Gjithëmëshirshëm, e nuk i lutemi të vrazhdit. Ai është i Fuqishëm, e nuk i lutemi të pafuqishmit. Ai është afër, e i largëti nuk dëgjon, si dhe cilësi të tjera të madhërueshme e të bukura të Allahut të Lartmadhëruar.

(5509)

(332) - عَنْ أَبِي سَعِيدٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَا مِنْ مُسْلِمٍ يَدْعُو بِدَعْوَةٍ لَيْسَ فِيهَا إِيْمٌ، وَلَا قَطِيعَةٌ رَحِمٍ، إِلَّا أَعْطَاهُ اللَّهُ بِهَا إِحْدَى ثَلَاثٍ: إِمَّا أَنْ تُعَجَّلَ لَهُ دَعْوَتُهُ، وَإِمَّا أَنْ يَدَّخِرَهَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ، وَإِمَّا أَنْ يَصْرِفَ عَنْهُ مِنَ السُّوءِ مِثْلَهَا» قَالُوا: إِذَنْ نُكْثِرُ، قَالَ: «اللَّهُ أَكْثَرُ». [صحيح] - [رواه أحمد]

(332) – Ebu Seidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Asnjë musliman nuk i lutet Allahut me një lutje që nuk përfshin mëkat apo këputje të lidhjeve farefisnore, veçse Allahu do t'i japë një nga këto tre: ose do t'ia pranojë lutjen shpejt, ose do ta ruajë për të në botën tjetër, ose do t'i largojë prej tij një të keqe të barabartë me të." Të pranishmit thanë: "Atëherë do të lutemi më shumë!" Profeti ﷺ tha: "Allahu është edhe më shumë (i

gatshëm për t'ju dhënë)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Ahmedij]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka njoftuar se kur një musliman i lutet Allahut dhe kërkon diçka që nuk është mëkat, si fjala vjen kërkesa për të lehtësuar ndonjë mëkat apo padrejtësi, dhe as nuk kërkon këputje të lidhjeve farefisnore, si fjala vjen të lutet kundër fëmijëve apo të afërmeve të tij, atëherë Allahu, përmes asaj lutjeje, do t'i japë njërën nga tri gjërat: ose do t'ia përmbushë menjëherë dhe do t'ia japë atë që ka kërkuar, ose Allahu i Lartësuar do ta vonojë atë si shpërblim për Ditën e Gjykimit, duke e ngritur në shkallë, apo duke e përfshirë në mëshirë dhe falje të mëkateve, ose do ta mbrojë nga ndonjë e keqe në jetën e kësaj bote, në përpjesëtim me lutjen e bërë. Atëherë sahabët i thanë Profetit ﷺ: "Atëherë duhet të lutemi edhe më shumë, për të fituar njërën nga këto mirësi!" Profeti ﷺ u përgjigj: Ajo që gjendet tek Allahu është shumë më e madhe dhe më e vlefshme se çdo gjë që mund të kërkon, sepse begatia e Tij është e pafund dhe nuk ka mbarim.

Mësime nga hadithi:

1. Lutja e muslimanit pranohet dhe nuk refuzohet, me kusht që të plotësohen kushtet dhe etika e saj. Prandaj, njeriu duhet të angazhohet me përkushtim në lutje, pa u ngutur për përgjigje.

2. Përgjigja ndaj lutjes nuk kufizohet vetëm në përmbushjen e kërkesës; ajo mund të sjellë edhe fshirjen e mëkateve përmes lutjes, ose të ruhet për të në botën tjetër.
3. Ibën Bazi ka thënë: "Këmbëngulja në lutje, mendimi i mirë për Allahun dhe moshumbja e shpresës, janë ndër shkaqet më të mëdha për pranimin e lutjeve. Njeriu duhet t'i lutet Allahut vazhdimisht, të ketë mendim të mirë për Të dhe të jetë i vetëdijshëm se Ai është i Urti dhe i Gjithëdijshmi. Allahu mund ta përshpejtojë përgjigjen për një urtësi, ta vonojë për një urtësi tjetër, ose t'i japë lutësit diçka më të mirë se ajo që ka kërkuar."

(5100)

(333) - عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُكْثِرُ أَنْ يَقُولَ: «يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبَّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ»، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، أَمَّا بِكَ وَبِمَا جِئْتَ بِهِ فَهَلْ تَخَافُ عَلَيْنَا؟ قَالَ: «نَعَمْ، إِنَّ الْقُلُوبَ بَيْنَ أَصْبَعَيْنِ مِنْ أَصَابِعِ اللَّهِ يُقَلِّبُهَا كَيْفَ يَشَاءُ». [صحيح] - [رواه الترمذي وأحمد]

(333) – Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Shpeshherë i Dërguari i Allahut ﷺ e thoshte (këtë lutje): "O rrotullues i zemrave, mbaje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!" I thashë: "O i Dërguari i Allahut! Ne të besuam dhe i besuam asaj me të cilën erdhe, a ke frikë për ne? - "Po. Vërtet zemrat janë ndërmjet dy gishtërinjve të Allahut: i

rrotullon si të dëshirojë", - iu përgjigj Profeti ﷺ. [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وأحمد]

Shpjegimi:

Lutja që më së shpeshti e bënte Profeti ﷺ ishte që Allahu ta bënte të qëndrueshëm në fe e në adhurim dhe ta largonte nga devijimi dhe humbja. Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte çuditur përse kaq shpesh Profeti ﷺ e thoshte këtë lutje, kështu që Profeti ﷺ i tregoi se zemrat janë ndërmjet dy gishtërinjve të Allahut: i rrotullon si të dojë. Zemra është vendi i imanit dhe kufrit. Zemra është quajtur kësisoj (në arabisht el-kalb), për shkak të luhatjeve të saj të shpeshta. Ajo rrotullohet më shumë sesa vorba kur vlon në tenxhere: atij që dëshiron Allahu, ia vendos zemrën në udhëzim dhe e bën të qëndrueshëm në fe, e atij që dëshiron, ia largon zemrën nga udhëzimi drejt devijimit dhe humbjes.

Mësime nga hadithi:

1. Nënshtrimi i Profetit ﷺ ndaj Zotit dhe përgjërimi i tij ndaj Tij, si dhe udhëzimi i muslimanëve që ta lusin Atë me këtë lutje.
2. Rëndësia e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit në fe dhe se në konsideratë merret përfundimi.
3. Robi nuk mund të vetëmjaftohet as aq sa hap e mbyll sytë nga qëndrueshmëria që ia bën Allahu atij në Islam.

4. Inkurajimi që kjo lutje të thuhet sa më shpesh, duke e ndjekur shembullin e Profetit ﷺ.
5. Stabiliteti në Islam është begatia më e madhe, për të cilën duhet të përpiqet njeriu dhe ta falënderojë Zotin për të.

(3142)

(334) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةُ أَمْرِي، وَأَصْلِحْ لِي دُنْيَايَ الَّتِي فِيهَا مَعَاشِي، وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَعَادِي، وَاجْعَلْ الْحَيَاةَ زِيَادَةً لِي فِي كُلِّ خَيْرٍ، وَاجْعَلْ الْمَوْتَ رَاحَةً لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(334) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ lutej: “O Allah, ma rregullo fetarinë time, e cila është mbrojtja e çështjeve të mia; ma rregullo dynjanë time, në të cilën jetoj, dhe ma rregullo botën e përtejme, ku përgjithmonë do të qëndroj! Jetën time ma bëj shkak për shtim të veprave të mira, kurse vdekjen ma bëj rehati nga çdo e keqe!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ bëri një lutje që përmbledh bazat e virtyteve të larta morale, për të cilat ai ishte dërguar për t’i përsosur. Në këtë lutje, ai kërkoi përmirësimin e fesë, jetës së kësaj bote dhe jetës së përtejme. Në këtë shprehje të shkurtër, ai u lut për të mirën e këtyre tri gjërave kryesore, duke filluar me

përmirësimin e fesë, sepse përmes saj përmirësohet gjendja në të dy botët. Ai tha:

"O Allah, ma rregullo fetarinë time," duke më dhënë sukses në zbatimin e normave dhe rregullave të saj në mënyrën më të përkryer dhe më të plotë.

"...e cila është mbrojtja e çështjeve të mia" dhe ruajtësi i të gjitha punëve të mia. Nëse fetaria ime prishet, atëherë prishen edhe punët e mia, dhe unë dështoj e humbas. Dhe meqenëse përmirësimi i fesë së kërkuar nuk mund të plotësohet pa përmirësimin e kësaj bote, ai tha:

"...ma rregullo dynjanë time," duke më dhënë shëndet në trup dhe siguri, furnizim, bashkëshorte të mirë, pasardhës të ndershëm dhe gjithçka që më nevojitet, e që të jetë e lejuar dhe ndihmuese në bindjen ndaj Teje. Pastaj, ai përmendi arsyen për kërkesën e tij për rregullimin e kësaj dynjaje, duke thënë:

"...në të cilën jetoj", pra, aty ku e bëj jetesën dhe e kaloj jetën time.

"...dhe ma rregullo botën e përtejme, ku përgjithmonë do të qëndroj!" dhe do të jetë kthimi im për të të takuar, duke qenë kjo përmes përmirësimit të veprave, suksesit që Allahu ia jep robit për adhurim dhe sinqeritet dhe për të pasur një përfundim të mirë.

Profeti ﷺ e renditi botën e përtejme pas kësaj dynjaje, sepse e para është mjeti për të përmirësuar të dytën. Ai që jeton si duhet në këtë dynja, sipas asaj që dëshiron Allahu, atëherë bota e përtejme e tij do të jetë si duhet, dhe ai do të jetë i lumtur në të.

"...Jetën time" dhe jetëgjatësinë "...ma bëj shkak për shtim të veprave të mira", në të cilën shumëfishoj veprat e mira. "...kurse vdekjen" dhe përshpejtimin e saj "...ma bëj rehati nga çdo e keqe!", qoftë sprovë, fatkeqësi, sprovim me gjynahe e pakujdesi dhe më çliro nga vështirësitë e dynjasë dhe shqetësimet e saj dhe ma mundëso arritjen e rehatisë.

Mësime nga hadithi:

1. Feja është gjëja më e rëndësishme; për këtë arsye, Profeti ﷺ e filloi lutjen me të.
2. Feja është mbrojtje për njeriun, e cila e pengon atë nga çdo e keqe.
3. Lutja për çështjet e kësaj dynjaje, për të përmirësuar fenë dhe botën e pastajme.
4. Nuk urrehet të dëshirohet vdekja për shkak të frikës nga sprovimi në fe, ose të kërkohet prej Allahut vdekja si dëshmor.

(5482)

(335) - عَنِ ابْنِ عُمَرَ رضي الله عنهما قَالَ: لَمْ يَكُنْ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَدْعُ هَؤُلَاءِ الدَّعَوَاتِ، حِينَ يُمَسِّي وَحِينَ يُصْبِحُ: «اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي دِينِي وَدُنْيَايَ وَأَهْلِي وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَتِي - أَوْ: عَوْرَاتِي - وَآمِنْ رَوْعَاتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيْ، وَمِنْ خَلْفِي، وَعَنْ يَمِينِي، وَعَنْ شِمَالِي، وَمِنْ فَوْقِي، وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي». [صحيح] - [رواه أبو داود والنسائي وابن ماجه وأحمد]

(335) – Ibën Omeri (Allahu qoftë i kënaqu me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ nuk i linte këto lutje kur gdhihej dhe kur ngrysej: "All-llāhumme innī es'elukel 'āfijete fid-dun'jā wel āhirah, All-llāhumme innī es'elukel 'afwe wel 'āfijete fī dīnī we dun'jāje we ehlī we mālī, All-llāhummeštur 'awrātī, we āmin raw'ātī. All-llāhumme ihfedhnī min bejni jedejje, we min ħalfī, we 'an jemīnī we 'an shimālī, we min fewķī, we e'ūdhu bi aḍhametike en uḡtāle min taḥtī - O Allah! Të kërkoj të më ruash nga çdo e keqe në këtë botë dhe në botën tjetër. O Allah! Të lutem të më falësh dhe të më ruash nga të këqijat e të metat në fenë time, në jetën time të këtushme, në familjen time dhe në pasurinë time. O Allah! M'i mbulo të metat dhe më qetëso nga gjërat frikësuese. O Allah! Më ruaj nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta, si dhe nga lart. Mbrohem me madhërinë Tënde, që të mos më përpijë toka nga poshtë!" [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والنسائي وابن ماجه] - [وأحمد]

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ nuk i linte këto lutje kur gdhihej dhe kur ngrysej:

"O Allah! Të kërkoj të më ruash nga çdo e keqe" dhe të më shpëtosh nga sëmundjet, fatkeqësitë dhe vështirësitë e kësaj bote, si dhe nga dëshirat dhe sprovat që kanë të bëjnë me fenë "në këtë botë dhe në botën tjetër", qofshin ato të menjëhershme apo të ardhshme."

"O Allah! Të lutem të më falësh", të m'i shlyesh mëkatet dhe të m'i tejkalon ato, "...dhe të më ruash" dhe të më shpëtosh nga të metat "...në fenë time", qofshin shirk (idhujtari), bidate (risi në fe) apo mëkate, dhe "në jetën time të këtushme", nga fatkeqësitë, lëndimet dhe të këqijat, dhe "në familjen time", gruan, fëmijët dhe të afërmit e mi, "dhe në pasurinë time", që e zotëroj dhe në punët e mia.

"O Allah! M'i mbulo të metat" dhe çfarëdo të metash, defekte dhe mangësish që kam, shlyeji mëkatet e mia, "...dhe më qetëso nga gjërat frikësuese", si paniku e të ngjashme.

"O Allah! Më ruaj" dhe largoji nga unë fatkeqësitë, mundimet dhe sprovimet. "...nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta, si dhe nga lart." Profeti ﷺ e luti Allahun ta ruajë nga të gjitha drejtimet, sepse sprovimet dhe dëmet i afrohen njeriut nga këto drejtime.

"Mbrohem me madhërinë Tënde, që të mos më përpijë toka", ose të kapem e të ndëshkohem befasisht, "...nga poshtë!", dhe të shkatërrohem me shembje.

Mësime nga hadithi:

1. Përkujdesja për këto fjalë, duke e ndjekur kështu Profetin ﷺ."
2. Njeriu, ashtu siç është urdhëruar të kërkojë nga Allahu që ta ruajë në fe, ashtu është urdhëruar të kërkojë edhe në këtë botë.
3. Tibiu ka thënë: "(Kjo lutje) ka përfshirë gjashtë drejtimet, sepse të këqijat vijnë prej tyre, si dhe ka theksuar posaçërisht drejtimin e poshtëm për shkak se të këqijat vijnë prej tij."
4. Më e mira për thënien e dhikrit është në mëngjes. Është koha nga lindja e agimit deri në lindjen e diellit në fillim të ditës, dhe pas ikindisë deri para perëndimit të diellit. Nëse e thotë pas këtyre kohëve, pra, në mëngjes pas ngritjes së diellit, i llogaritet tamam. Po ashtu, nëse e thotë pas drekës, i llogaritet tamam, dhe po ashtu pas akshamit, i llogaritet tamam, meqë kjo është koha për dhikër.
5. Nëse argumenti tregon se dhikri ka kohë të caktuar gjatë natës, siç është leximi i dy ajeteve të fundit të surës el-Bekare, atëherë ato lexohen natën, që pas perëndimit të diellit.

(5485)

(336) - عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَّمَهَا هَذَا الدُّعَاءَ: «اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ، عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ، عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا عَادَ بِهِ عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ، وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ، وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَسْأَلُكَ أَنْ تَجْعَلَ كُلَّ قَضَاءٍ قَضَيْتُهُ لِي خَيْرًا». [صحيح] - [رواه ابن ماجه وأحمد]

(336) – Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ia mësoi këtë lutje: "All-llahumme inni eseluke minel hajri kul-lihi, axhilihi ue axhilihi, ma alimtu minhu ue ma lem a'lam, ue eudhu bike mines-sherri kul-lihi, axhilihi ue axhilihi, ma alimtu minhu ue ma lem a'lem. All-llahumme inni eseluke min hajri ma seeleke abduke ue nebij-juke, ue eudhu bike min sherri ma adhe bihi abduke ue nebij-juke. All-llahumme inni eselukel xhennete, ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amelin, ue eudhu bike minen nar, ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amelin, ue eseluke en texhale ala kul-li kadain kadajtehu li hajran! - O Allah, e kërkoj prej Teje çdo të mirë, atë të menjëhershmen dhe të vonuarën, atë që e di dhe atë që nuk e di. Dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga çdo e keqe, ajo e menjëhershme dhe e vonuara, atë që e di dhe atë që nuk e di. O Allah, e kërkoj prej Teje çdo të mirë që ta ka kërkuar robi dhe Profeti Yt, dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga çdo e keqe prej së cilës të ka kërkuar mbrojtje robi dhe Profeti Yt.

O Allah, e kërkoj prej Teje Xhenetin dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër, dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga Zjarri dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër. Dhe të lus që çdo caktim që ke caktuar për mua ta bësh të mirë!" [Ky hadith është sahih] - [رواه ابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ia mësoi Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) lutjet gjithëpërfshirëse, të cilat janë katër lutje:

E para: Lutje gjithëpërfshirëse për çdo mirësi: "O Allah, e kërkoj prej Teje çdo të mirë, atë të menjëhershmen dhe të vonuarën, atë që e di", që ma ke mësuar "dhe atë që nuk e di" që është në dijen Tënde, o i Lartësuar! Në këtë lutje ka dorëzim të çështjes tek Allahu, i Gjithëdituri, i Mirinformuari dhe i Buti; kështu që Allahu i Lartësuar zgjedh për muslimanin atë që është më e mira dhe më e përsosura. "Dhe kërkoj mbrojtje", mbështetem dhe strehohem "tek Ti nga çdo e keqe, ajo e menjëhershme dhe e vonuara, atë që e di dhe atë që nuk e di."

E dyta: Kjo është një mbrojtje për muslimanin që mos t'i tejkalojë kufijtë në lutje. "O Allah, e kërkoj prej Teje", të lus për "çdo të mirë që ta ka kërkuar robi dhe Profeti Yt", Muhamedi ﷺ "dhe kërkoj mbrojtje tek Ti", strehohem dhe mbështetem të më ruash "nga çdo e keqe prej së cilës të ka kërkuar mbrojtje robi dhe Profeti Yt." Kjo është një lutje dhe kërkesë drejtuar Allahut që t'i japë lutësit nga ato që i ka

kërkuar dhe e ka lutur për vete Profeti Muhamed ﷺ, pa përmendur llojet e veçanta të lutjeve që ai ﷺ i ka bërë.

E treta: Kërkesa për hyrjen në Xhenet dhe largimin nga Zjarri, e cila është dëshira e çdo muslimani dhe synimi i veprave të tij. "O Allah, e kërkoj prej Teje Xhenetin" dhe që të shpëtoj në të "...dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër" e mirë që të kënaq Ty, "...dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga Zjarri", sepse nuk ka shpëtim nga veprat e shëmtuara, veçse me mirësinë Tënde. "...dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër", nga mëkatet që të zemërojnë Ty.

E katërta: Lutja për të qenë i kënaqur me caktimin e Allahut. "Dhe të lus që çdo caktim që ke caktuar për mua ta bësh të mirë!" D.m.th., çdo çështje që Allahu ka caktuar për mua, ta bëjë të jetë në të mirën time. Kjo është një lutje për të qenë i kënaqur me caktimin e Allahut.

Mësime nga hadithi:

1. Nga ky hadith përfitojmë që bashkëshorti t'i a mësojë bashkëshortes gjërat e dobishme që kanë të bëjnë me çështjet e fesë dhe të kësaj bote, ashtu siç e mësoi Profeti ﷺ Aishen (Allahu qoftë i kënaqur me të!).
2. Më e mira për muslimanin është t'i mësojë lutjet që kanë ardhur nga Profeti ﷺ, sepse ato janë nga lutjet gjithëpërfshirëse.
3. Dijetarët kanë thënë për këtë hadith: "Ky është hadithi më i plotë ku e lusim Allahun për të mirat

dhe i kërkohet mbrojtje të na ruajë nga të këqijat. Ky është nga lutjet gjithëpërfshirëse që i janë dhënë Profetit ﷺ."

4. Ndër shkaqet për hyrje në Xhenet, pas mëshirës së Allahut, janë veprat dhe fjalët e mira.

(5487)

(337) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ الْإِيمَانَ لَيَخْلُقُ فِي جَوْفِ أَحَدِكُمْ كَمَا يَخْلُقُ الثَّوْبُ الْخَلْقُ، فَاسْأَلُوا اللَّهَ أَنْ يُجَدِّدَ الْإِيمَانَ فِي قُلُوبِكُمْ». [صحيح] - [رواه الحاكم والطبراني]

(337) – Abdullah ibën Amër ibën Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Besimi vjetrohet brenda ndonjërit prej jush ashtu si vjetrohet rroba, prandaj kërkoni nga Allahu që të ripërtërijë besimin në zemrat tuaja." [Ky hadith është sahih] - [رواه الحاكم والطبراني]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se besimi vjetrohet në zemrën e muslimanit dhe dobësohet, sikurse rroba e re që vjetrohet për shkak të përdorimit të gjatë. Kjo, për shkak të shpërfilljes ndaj adhurimeve ose bërjes së gjynaheve dhe zhytjes në epshe. Kështu, Profeti ﷺ na porositi që t'i lutemi Allahut të Lartësuar që të na përtërijë besimin, duke i kryer

obligimet dhe duke bërë shpesh dhikër (përmendje të Allahut) dhe istigfar (kërkimfalje pej Tij).

Mësim nga hadithi:

1. Inkurajimi për t'i kërkuar Allahut të na bëjë të qëndrueshëm (në fe) dhe të na ripërtërijë besimin në zemër.
2. Imani (besimi) është fjalë, vepër dhe bindje; shtohet me adhurim dhe pakësohet me mëkatim.

(65020)

(338) - عَنِ الْعَبَّاسِ بْنِ عَبْدِ الْمُطَّلِبِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ سَمِعَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، يَقُولُ: «ذَاقَ طَعْمَ الْإِيمَانِ مَنْ رَضِيَ بِاللَّهِ رَبًّا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا، وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولًا». [صحيح] - [رواه مسلم]

(338) – Abas ibën Abdulmutalibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: “Ai që është i kënaqur me Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin ﷺ për të Dërguar e ka shijuar ëmbëlsinë e imanit.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se besimtari i sinqertë në besimin e tij, zemra e të cilit është e qetësuar me këtë besim, do të ndiejë dhe do të përjetojë në zemrën e tij kënaqësi shpirtërore, gjerësi, lumturi, ëmbëlsi dhe shije

imanore për shkak të afërsisë me Allahun e Lartësuar, për sa kohë që është i kënaqur me këto tri gjëra:

Së pari: të jetë i kënaqur me Allahun për Zot, që do të thotë që zemra e tij të jetë e qetësuar dhe e kënaqur ndaj gjithçkaje që vjen nga Allahu, sipas zotërueshmërisë së Tij hyjnore në ndarjen e furnizimeve dhe gjendjeve. Kësisoj, ai nuk duhet të ndiejë asnjë kundërshtim në zemrën e tij ndaj caktimeve të Allahut dhe nuk duhet të kërkojë ndonjë Zot tjetër përveç Tij.

Së dyti: të jetë i kënaqur me Islamin për fe, që do të thotë që zemra e tij të jetë e qetësuar ndaj detyrimeve dhe obligimeve që përmban Islami dhe të mos kërkojë rrugë tjetër përveç rrugës së Islamit.

Së treti: të jetë i kënaqur me Muhamedin ﷺ për të Dërguar, që do të thotë që zemra e tij të jetë e qetësuar dhe e gëzuar me gjithçka që ka sjellë ai, pa asnjë hezitim e dyshim, dhe të ndjekë vetëm atë që është në përputhje me udhëzimin e tij ﷺ.

Mësime nga hadithi:

1. Besimi ka një ëmbëlsi dhe shije që shijohet përmes zemrës, ashtu siç shijohet ëmbëlsia e ushqimit dhe pijes përmes gojës.
2. Trupi nuk e gjen ëmbëlsinë e ushqimit dhe pijes, përveçse kur është i shëndetshëm, po ashtu, nëse zemra është e shëndoshë nga sëmundja e epsheve devijuese dhe e dëshirave të ndaluara, ajo do ta gjejë ëmbëlsinë e besimit. E, sa herë që sëmuret, nuk do

ta gjejë ëmbëlsinë e besimit, përkundrazi, mund t'i konsiderojë si të këndshme epshet dhe mëkatet që do ta shkatërrojnë atë.

3. Nëse njeriu është i kënaqur me diçka dhe e konsideron atë të mirë, atëherë ajo do t'i lehtësohet dhe asgjë prej tyre nuk do t'i duket e vështirë, si dhe do të jetë i kënaqur me gjithçka që ka sjellë feja. Po kështu, nëse hyn besimi në zemrën e robit, nënshtrimi ndaj Zotit të tij do të jetë i lehtë për të, shpirti i tij do të kënaqet dhe vështirësitë e mundimet e tij do të jenë të lehta.
4. Ibën Kajimi ka thënë: "Ky hadith përfshin kënaqësinë me zotërueshmërinë e Allahut dhe të qenët e Tij i denjë për t'u adhuruar dhe kënaqësinë me të Dërguarin e Tij, nënshtrimin ndaj tij, si dhe kënaqësinë me fenë e Tij dhe dorëzimin ndaj saj."

(65116)

(339) - عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ صَلَّى عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَخَذَ بِيَدِهِ، وَقَالَ: «يَا مُعَاذُ، وَاللَّهِ إِنِّي لَأُحِبُّكَ»، فَقَالَ: «أُوصِيكَ يَا مُعَاذُ لَا تَدَعَنَّ فِي دُبُرِ كُلِّ صَلَاةٍ تَقُولُ: اللَّهُمَّ أَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ». [صحيح] - [رواه أبو داود والنسائي وأحمد]

(339) – Muadh ibën Xhebeli (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se (një ditë) i Dërguari i Allahut ﷺ e kapi për dore dhe i tha: "O Muadh! Për Allahun, unë të dua ty! Të porosis

që kurrë të mos e braktisësh në fund të çdo namazi të thuash: "O Allah! Më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!" [Ky hadith është sahih] - [رواه أبو داود والنسائي وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ e mori për dore Muadhin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe i tha: "Për Allahun, unë të dua ty! Të porosis, o Muadh, që kurrë të mos e braktisësh në fund të çdo namazi të thuash: "O Allah! Më ndihmo të të përmend", - në çdo fjalë e vepër që më afron drejt adhurimit. "Të të falënderoj", - për t'i arritur begatitë dhe për t'iu shmangur fatkeqësive. dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!", - duka ia kushtuar adhurimin singërisht Allahut dhe duke e ndjekur Profetin ﷺ."

Mësime nga hadithi:

1. Është e ligjshme që të lajmërohet personi të cilin e do për hir të Allahut.
2. Është e rekomanduar të thuhet kjo lutje pas përfundimit të çdo namazi obligativ dhe vullnetar.
3. Në këtë lutje me këto fjalë të shkurtra përfshihen kërkesat për të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër.
4. Nga dobitë e dashurisë për hir të Allahut janë këshillimi i ndërsjellë për të vërtetën, dhënia e këshillave dhe bashkëpunimi në mirësi e devotshmëri.

5. Tibiu tha: "Përmendja e Allahut është fillimi drejt kënaqësisë shpirtërore, falënderimit të Tij dhe mjet për t'i arritur mirësitë e dëshiruara, ndërsa adhurimi i përkryer kërkon shkëputje nga çdo gjë që e shpërqendron njeriun nga Allahu i Lartësuar."

(3518)

(340) – عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال:

«أَقْرَبُ مَا يَكُونُ الْعَبْدُ مِنْ رَبِّهِ وَهُوَ سَاجِدٌ، فَأَكْثِرُوا الدُّعَاءَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(340) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Robi është më së afërti me Zotin e tij kur ndodhet në sexhde, prandaj shpeshtoni lutjet (në të)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ sqaron se robi është më së afërti me Zotin e tij kur ndodhet në sexhde. Kjo, se, kur njeriu bie në sexhde, pjesët më fisnike të trupit i vendos në tokë, duke qenë i nënshtruar, i përlur dhe modest para Allahut të Lartmadhëruar.

Profeti ﷺ urdhëroi që lutjet të shtohen gjatë sexhdes, kështu që në këtë gjendje bëhen bashkë përlulja para Allahut me fjalë dhe me vepër.

Mësime nga hadithi:

1. Adhurimi i shton robët afrimin me Allahun e Lartmadhëruar.
2. Është e rekomanduar që gjatë sexhdes të shpeshtohen lutjet, sepse është vend ku lutjet pranohen.

(5382)

(341) – عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ أَكْثَرُ دُعَاءِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «اللَّهُمَّ رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً، وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً، وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(341) – Nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë: "Lutja më e shumtë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) ishte: 'O Allah, jepna në këtë jetë mirësi dhe në jetën tjetër mirësi dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!'" [Ky hadith është sahih] - [Muttefek alejhi]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) shpesh lutej me dua gjithëpërfshirëse, si: "O Allah, jepna mirësi në këtë jetë dhe mirësi në jetën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!" Kjo lutje përmban mirësitë e kësaj jete, si: jetesë të lehtë, të bollshme dhe të ligjshme, bashkëshorte të devotshme, fëmijë të mbarë, qetësi, dije të dobishme, punë të mira dhe kërkesa të tjera si këto që u përmendën, të mira dhe të ligjshme. Ajo përmban gjithashtu mirësitë e jetës tjetër, si:

shpëtimi nga dënimi i varrit, nga dënimi i Ditës së Llogarisë dhe nga dënimi i Zjarrit. Si dhe fitimi i kënaqësisë së Allahut, fitimi i begative të amshueshme dhe të qenët pranë Zotit të Mëshirshëm.

Mësime nga hadithi:

1. Pëlqehet që lutjet të bëhen me duatë gjithëpërfshirëse, duke ndjekur traditën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!).
2. Mënyra e përsosur është që njeriu të bashkojë në duanë e tij midis mirësive të kësaj jete dhe të jetës tjetër.

(5502)

(342) - عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَلَا أَنْبِئُكُمْ بِخَيْرِ أَعْمَالِكُمْ، وَأَزْكَاهَا عِنْدَ مَلِكِكُمْ، وَأَرْفَعُهَا فِي دَرَجَاتِكُمْ وَخَيْرٌ لَكُمْ مِنْ إِنْقَاقِ الذَّهَبِ وَالْوَرِقِ، وَخَيْرٌ لَكُمْ مِنْ أَنْ تَلْقَوْا عَدُوَّكُمْ فَتَضْرِبُوا أَعْنَاقَهُمْ وَيَضْرِبُوا أَعْنَاقَكُمْ؟» قَالُوا: بَلَى. قَالَ: «ذِكْرُ اللَّهِ تَعَالَى». [صحيح] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(342) – Ebu Derdai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "A t'ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më të pastër te Sunduesi juaj dhe më të lartë për ju në pozitë; më të mirë për ju se shpenzimi i arit dhe argjendit dhe më të mirë për ju sesa të përballeni me armikun tuaj: t'u mëshoni në qafat e tyre dhe t'ju mëshojnë në qafat

tuaja?" Thanë: "Patjetër." Atëherë Profeti ﷺ tha: "Përkujtimi i Allahut të Lartësuar." [Ky hadith është sahih] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ i pyeti sahabët:

A doni t'ju tregoj dhe t'ju mësoj për veprën tuaj më të mirë, më fisnike, më të frytshme, më të pastër dhe më të dëlirë tek Allahu, Sunduesi i Lartmadhëruar?

Më e larta në shkallët tuaja në Xhenet?

Më e mirë për ju sesa të jepni lëmoshë ari dhe argjend?

Më e mirë për ju sesa t'i takoni jobesimtarët për t'i luftuar, kur ua mëshoni qafave të tyre dhe jua mëshojnë qafave tuaja?

Sahabët thanë: "Po, e duam një gjë të tillë."

Profeti ﷺ tha: "Dhikri - përmendja dhe përkujtimi i Allahut të Lartësuar në çdo kohë, në çdo fromë dhe gjendje."

Mësime nga hadithi:

1. Përmendja e vazhdueshme e Allahut të Lartësuar, në aspektin e jashtëm dhe të brendshëm (me gjuhë dhe me zemër), është një nga format më madhështore dhe më të dobishme të afrimit me Allahun e Lartësuar.
2. Të gjitha veprat janë ligjësuar për të përmbushur detyrën e përkujtimit të Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar thotë: "Fale namazin për të më kujtuar Mua!" (Taha, 14) Ndërkaq, Profeti ﷺ ka thënë:

"Tavafi (rrrotullimi) rreth Qabesë, ndërmjet Safasë e Mervasë dhe gjuajtja e guralecëve janë ligjësuar për të përkujtuar Allahun e Lartësuar." E shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

3. Izz ibën Abduselami në librin e tij mbi parimet e fesë ka thënë: "Ky hadith tregon se jo në të gjitha adhurimet shpërblimi merret në varësi të lodhjes, përkundrazi, Allahu i Lartësuar nganjëherë mund të shpërblejë më shumë për veprat e vogla sesa për të mëdhatë, kështu që shpërblimi merret në varësi të epërsisë së veprës në fisnikëri dhe superioritet.
4. Munavi ka thënë në "Fejdul Kadir": "Ky hadith interpretohet në kuptimin se dhikri ishte më i mirë për ata të cilëve u është drejtuar Profeti ﷺ në atë moment. Po t'i drejtohej një personi trim, prej të cilit do të kishte dobi Islami në luftë, atëherë vepër më e mirë për të do të ishte xhihadi (lufta në rrugë të Allahut); ose një njeriu të pasur, pasuria e të cilit u sjell dobi të varfërve, atëherë vepër më e mirë për të do të ishte sadakaja (lëmosha); ose atij që është në gjendje të kryejë haxhin, do t'i thuhej vepra më e mirë është haxhi; ose dikush që i ka dy prindërit (gjallë), do t'iu thuhej të kujdesej e t'i respektojë ata. Kështu bëhet harmonizimi midis haditheve të ndryshme."
5. Forma më e përkryer e dhikrit është ajo që e shpreh gjuha së bashku me meditimin e zemrës, pastaj ajo

që është vetëm me zemër, siç është meditimi, e pastaj ajo që është vetëm me gjuhë, secila nga këto forma ka shpërblim me lejen e Allahut të Lartësuar.

6. Përkushtimi i muslimanit ndaj dhikreve që lidhen me situata të ndryshme, si: dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes, hyrjes dhe daljes nga xhamia, shtëpia, tualeti etj, e bën atë një nga ata që e përmendin shpesh Allahun.

(3575)

(343) - عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كُنْتُ مَعَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي سَفَرٍ، فَأَصْبَحْتُ يَوْمًا قَرِيبًا مِنْهُ وَنَحْنُ نَسِيرُ، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ أَخْبِرْنِي بِعَمَلٍ يَدْخُلُنِي الْجَنَّةَ وَيُبَاعِدُنِي عَنِ النَّارِ، قَالَ: «لَقَدْ سَأَلْتَنِي عَنْ عَظِيمٍ، وَإِنَّهُ لَيْسِيرٌ عَلَى مَنْ يَسِرَّهُ اللَّهُ عَلَيْهِ، تَعْبُدُ اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا، وَتُقِيمُ الصَّلَاةَ، وَتُؤْتِي الزَّكَاةَ، وَتَصُومُ رَمَضَانَ، وَتَحُجُّ الْبَيْتَ» ثُمَّ قَالَ: «أَلَا أَذُلُّكَ عَلَى أَبْوَابِ الْخَيْرِ: الصَّوْمُ جَنَّةٌ، وَالصَّدَقَةُ تُطْفِئُ الْخَطِيئَةَ كَمَا يُطْفِئُ الْمَاءُ النَّارَ، وَصَلَاةُ الرَّجُلِ مِنْ جَوْفِ اللَّيْلِ» قَالَ: ثُمَّ تَلَا: «{تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ}، حَتَّى بَلَغَ {يَعْمَلُونَ}» ثُمَّ قَالَ: «أَلَا أُخْبِرُكَ بِرَأْسِ الْأَمْرِ كُلِّهِ وَعَمُودِهِ، وَذُرْوَةِ سَنَامِهِ؟» قُلْتُ: بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ، قَالَ: «رَأْسُ الْأَمْرِ الْإِسْلَامُ، وَعَمُودُهُ الصَّلَاةُ، وَذُرْوَةُ سَنَامِهِ الْجِهَادُ» ثُمَّ قَالَ: «أَلَا أُخْبِرُكَ بِمَلَكَ ذَلِكَ كُلِّهِ؟» قُلْتُ: بَلَى يَا نَبِيَّ اللَّهِ، فَأَخَذَ بِلِسَانِهِ قَالَ: «كُفَّ عَلَيْكَ هَذَا» فَقُلْتُ: يَا نَبِيَّ اللَّهِ، وَإِنَّا لَمُؤَاخِدُونَ بِمَا نَتَكَلَّمُ بِهِ؟ فَقَالَ: «تَكَلَّمَ أُمُّكَ يَا مُعَاذُ، وَهَلْ يَكُفُّ النَّاسُ فِي النَّارِ عَلَى وُجُوهِهِمْ أَوْ عَلَى مَنَاخِرِهِمْ إِلَّا حَصَائِدُ أَلْسِنَتِهِمْ». [صحيح بمجموع طرقه] - [رواه الترمذي وابن ماجه وأحمد]

(343) – Muadh ibën Xhebeli (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Isha me Profetin ﷺ gjatë një udhëtimi dhe një mëngjes isha afër tij tek sa po ecnim, kështu që i thashë: "O i Dërguari i Allahut! Më trego një punë që më çon në Xhenet dhe më largon nga Zjarri!" Ai tha: "Vërtet më ke pyetur për një çështje të madhe, që është e lehtë për atë të cilit Allahu ia lehtëson: ta adhurosh Allahun pa i shoqëruar asgjë në adhurim, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta kryesh haxhillëkun." Pastaj tha: "A dëshiron të të udhëzoj drejt dyerve të mirësisë?! Agjërimi është mburojë, lëmosha i shlyen mëkatet siç e shuan uji

zjarrin dhe namazi i njeriut në thellësinë e natës." Pastai lexoi: "Ata ngrihen nga shtrati...", derisa arriti te: "... që kanë bërë." (Kuran 32:16-17) Më pas tha: "A të të tregoj për kreun, shtyllën dhe kulmin e çështjes?" Thashë: "Patjetër, o i Dërguari i Allahut." Ai tha: "Kreu i çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi, kurse kulmi është xhihadi." Më tej shtoi: "A dëshiron të të tregoj për boshtin e të gjitha këtyre?" Unë thashë: "Patjetër, o i Dërguari i Allahut." Ai e kapi gjuhën e vet dhe tha: "Ruaje këtë!" I thashë: "O i Dërguari i Allahut, a edhe për atë që themi do të merremi në llogari?!" Ai më tha: "Mos të pastë nëna, o Muadh! S'e ditke se njerëzit do të hidhen me fytyrë (në Zjarr) vetëm për shkak të asaj që korrin me gjuhët e tyre?!" [صحيح بمجموع طرقه] رواه - [الترمذي وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Isha me Profetin ﷺ gjatë një udhëtimi dhe një mëngjes isha afër tij teksa po ecnim, kështu që i thashë: "O i Dërguari i Allahut! Më trego një punë që më çon në Xhenet dhe më largon nga Zjarri!" Në atë rast Pejgamberi i tha: "Më ke pyetur për një vepër, veprimi i së cilës është i rëndë për shpirtrat, por ajo është e lehtë dhe e thjeshtë për atë që Allahu ia lehtëson; kryeji obligimet e Islamit!"

E para: ta adhurosh Allahun dhe të mos i shoqërosh asgjë në adhurim.

E dyta: t'i falësh pesë namazet farz (të detyrueshme) gjatë ditës e natës: sabahun, drekën, ikindinë, akshamin dhe

jacinë, të cilat duhet të falen sipas kushteve, shtyllave dhe obligimeve të tyre.

E treta: të japësh zekatin e detyrueshëm, që është një adhurim i detyrueshëm financiar për çdo pasuri që arrin një shumë të caktuar sipas ligjit islam, e cila u jepet atyre që e meritojnë.

E katërta: të agjërosh muajin e Ramazanit, i cili nënkupton vetëpërmbajtjen nga ushqimi, pija dhe gjërat e tjera që e prishin agjërimin, me qëllim adhurimi, nga agimi deri në perëndim të diellit.

E pesta: të kryesh haxhillëkun (pelegrinazhin) në Shtëpinë e Shenjtë duke pasur si qëllim udhëtimin drejt Mekës për kryerjen e riteve të haxhit, në formë adhurimi ndaj Allahut të Lartësuar.

Pastaj Profeti ﷺ tha: "A të të tregoj për rrugën që të çon te dyert e mirësive? Obligimet fetare t'i shoqërosh me vepra vullnetare (nafile):

Së pari: Agjërimi vullnetar, i cili është një pengesë për rënien në gjynahe, duke e thyer epshin dhe duke dobësuar forcën (që çon në gjynahe).

Së dyti: Lëmosha vullnetare e cila shuan mëkatin pas kryerjes së tij, e largon atë dhe fshin gjurmën e tij.

Së treti: namazi i natës në një të tretën e fundit të natës. Pastaj Profeti ﷺ e lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar: "Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre (me namaz, dhikër lexim të Kuranit dhe lutje) me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ta (në jetën tjetër dhe në Xhenet), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."

Pastaj Profeti ﷺ tha: A të tregoj për bazën e fesë, shtyllën në të cilën mbështetet dhe kulmin e saj?

Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i tha: "Patjetër, o i Dërguari i Allahut."

Profeti ﷺ tha: "Kreu i çështjes është Islami, i cili përfshin dy dëshmitë (dy shehadetet), me të cilat njeriu fiton bazën e fesë." Shtylla e Islamit është namazi, pasi nuk ka Islam pa namaz, ashtu siç nuk mund të ketë shtëpi pa shtylla. Atij që falet, i forcohet dhe i lartësohet fetaria. Lartësimi i fesë arrihet përmes xhihadit, duke dhënë mund në luftën kundër armiqve të fesë për të lartësuar fjalën e Allahut.

Pastaj Profeti ﷺ tha: "A dëshiron të të tregoj për mënyrën më të saktë dhe më të përkryer për atë që thamë?" E kapi gjuhën e tij (me dorë) dhe tha: "Ndaloje këtë dhe mos fol për atë që nuk të përket!" Muadhi tha: "A do të na ndëshkojë dhe do të na marrë në llogari Zoti ynë për gjithçka që flasim?!"

Profeti ﷺ tha: "Mos të pastë nëna!" Këtu nuk është qëllimi të bëhet lutje kundër tij, por kjo është një shprehje arabe që shërben për të tërhequr vëmendjen ndaj një çështjeje që duhet ta kishte kuptuar dhe ditur. Pastaj Profeti ﷺ tha: "A ka diçka tjetër që i hedh njerëzit dhe i rrëzon me fytyrë në Zjarr, përveçse të korrat e gjuhëve të tyre" si: kufri, akuza e rrejshme, fyerja, përgojimi, bartja e fjalëve, shpifja dhe gjëra të tjera të ngjashme me to.

Mësime nga hadithi:

1. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) ishin shumë të përkushtuar ndaj dijes, prandaj shpesh e pyetnin Profetin ﷺ rreth saj.

2. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) kishin kuptim të thellë në dije, sepse e dinin se veprat janë shkak për hyrjen në Xhenet.
3. Pyetja që bëri Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) është një pyetje madhështore, sepse në thelb ajo përmban sekretin e jetës dhe ekzistencës. Çdo qenie në këtë botë, qoftë nga njerëzit, apo xhindët, ka si pikësynim Xhenetin ose Zjarrin. Prandaj, kjo pyetje është shumë e rëndësishme.
4. Hyrja në Xhenet varet nga përmbushja e pesë shtyllave të Islamit, që janë: dy shehadetet (dy dëshmitë), namazi, zekati, agjërimi dhe haxhillëku.
5. Thelbi i fesë, detyra më e çmuar dhe obligimi më i lartë është teuhidi i Allahut, duke e adhuruar vetëm Atë pa i shoqëruar askënd në adhurim.
6. Mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij qëndron në faktin se Ai ua ka hapur dyert e mirësisë, në mënyrë që të pajisen me shkaqet e shpërblimit dhe faljes së mëkateve.
7. Vlera e afrimit tek Allahu përmes veprave vullnetare, pas kryerjes së veprave obligative.
8. Namazi në raport me Islamin është si shtylla për tendën: Islami zhduket me braktisjen e namazit, ashtu siç rrëzohet tenda kur bie shtylla e saj.

9. Detyrimi për të ruajtur gjuhën nga çdo gjë që ia dëmton njeriut fetarinë.
10. Përmbajtja e gjuhës, kontrollimi dhe frenimi i saj është themeli i gjithë mirësisë.

(4303)

(344) - عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ إِذَا أَوَى إِلَى فِرَاشِهِ كُلِّ لَيْلَةٍ جَمَعَ كَفَّيْهِ، ثُمَّ نَفَثَ فِيهِمَا فَقَرَأَ فِيهِمَا: {قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ}، وَ{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ}، وَ{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ}، ثُمَّ يَمْسُحُ بِهِمَا مَا اسْتَطَاعَ مِنْ جَسَدِهِ، يَبْدَأُ بِهِمَا عَلَى رَأْسِهِ وَوَجْهِهِ وَمَا أَقْبَلَ مِنْ جَسَدِهِ، يَفْعَلُ ذَلِكَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ. [صحيح] - [رواه البخاري]

(344) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Çdo natë, kur Profeti ﷺ binte në shtrat, i bashkonte shuplakat e duarve dhe frynte në to duke lexuar suret: el Ihlas, el Felek dhe en Nas, e më pas e përshkonte trupin sa kishte mundësi. Fillonte nga koka dhe fytyra duke vazhduar pastaj me pjesën e mbetur. Kështu vepronte tri herë radhazi." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Një nga udhëzimet e Profetit ﷺ ishte se, kur binte në shtrat për të fjetur, i bashkonte shuplakat e duarve dhe i çonte ato, - siç bën lutësi gjatë lutjes, - dhe frynte butësisht nga goja e tij me një të fryrë të vogël, e cila përmbante pakëz pështymë dhe i lexonte tri suret: el Ihlas, el Felek dhe en

Nas, e më pas e përshkonte trupin me duart e tij, aq sa kishte mundësi. Fillonte nga koka dhe fytyra duke vazhduar pastaj me pjesën e mbetur përpara trupit të tij. Kështu vepronte tri herë radhazi.

Mësim nga hadithi:

1. Është e preferuar të lexohet surja el Ihlas dhe ato el Muavidhetejn (suret: el Felek dhe en Nas) para gjumit, të fryhet me to (duart) dhe të përshkohet trupi sa më shumë me duar.

(65060)

(345) - عَنْ شَدَّادِ بْنِ أَوْسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «سَيِّدُ الْإِسْتِغْفَارِ أَنْ تَقُولَ: اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ، وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ لَكَ بِذُنُوبِي فَاعْفِرْ لِي، فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ» قَالَ: «وَمَنْ قَالَهَا مِنَ النَّهَارِ مُوقِنًا بِهَا، فَمَاتَ مِنْ يَوْمِهِ قَبْلَ أَنْ يُمْسِيَ، فَهُوَ مِنْ أَهْلِ الْجَنَّةِ، وَمَنْ قَالَهَا مِنَ اللَّيْلِ وَهُوَ مُوقِنٌ بِهَا، فَمَاتَ قَبْلَ أَنْ يُصْبِحَ، فَهُوَ مِنْ أَهْلِ الْجَنَّةِ». [صحيح] - [رواه البخاري]

(345) – Nga Sheddad ibën Eusi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Zotëria i istigfarit është të thuash: O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi yt, do të qëndroj besnik në marrëveshjen dhe premtimin Tënd, sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen

Tënde nga e keqja që kam vepruar. Unë jam mirënjohës për dhuntitë e Tua, i pranoj mëkatet e mia, falmë mua, sepse nuk i fal mëkatet askush tjetër përveç Teje." Kush e thotë këtë gjatë ditës, duke qenë i bindur në të dhe vdes atë ditë para se të ngryset, ai do të jetë prej banorëve të Xhenetit. E kush e thotë këtë natën, duke qenë i bindur në të dhe vdes para se të gdhijë, ai do të jetë prej banorëve të Xhenetit". [Ky hadith është sahih] - [E shënon Buhariu]

Shpjegimi:

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se istigfari (pendimi) ka versione të ndryshme dhe se versioni më i mirë dhe më madhështor është që njeriu të thotë: "O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi yt, do të qëndroj besnik në marrëveshjen dhe premtimin Tënd, sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që e kam vepruar. Unë jam mirënjohës për dhuntitë e Tua, i pranoj mëkatet e mia, falmë mua, sepse nuk i fal mëkatet askush tjetër përveç Teje" Kësisoj, së pari njeriu pohon njeshmërinë e Allahut të Madhëruar dhe se Allahu është krijuesi i tij dhe i adhuruari i tij pa asnjë ortak. Dhe se ai i përmbahet besëlidhjes së tij me Allahun në lidhje me besimin dhe adhurimin e Tij, sa të ketë mundësi. Sepse sado adhurime të kryejë njeriu, ai nuk mundet t'i kryejë të gjitha adhurimet për të cilat e ka urdhëruar Allahu dhe as ta falënderojë siç duhet Allahun për dhuntitë që i ka falur. Dhe se ai duhet të strehohet tek Allahu dhe të kërkojë mbrojtjen e Tij, ngase vetëm Ai e mbron njeriun nga e keqja që ka bërë. I pohon dhuntitë që Ai ia ka

falur me dëshirë dhe i pranon mëkatet dhe gabimet që ka bërë duke fajësuar veten e tij. Pas këtij përgjërimi, ai i lutet Allahut që ta falë, duke ia mbuluar mëkatet dhe duke e shpëtuar atë nga e keqja e tyre me faljen, mirësinë dhe mëshirën e Tij, ngase vetëm Ai i fal mëkatet. Mandej, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) na njofton se këto fjalë bëjnë pjesë të dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes. Kësisoj, ai që i thotë këto fjalë me bindje, besim dhe meditim mbi domethënien e tyre, në fillim të ditës, që është nga koha e lindjes së diellit e deri në perëndimin e tij, dhe vdes, hyn në Xhenet. E ai që i thotë ato natën, që është nga koha e perëndimit të diellit e deri kur të agojë, nëse vdes para se të agojë, hyn në Xhenet.

Mësime nga hadithi:

1. Versionet e istigfarit janë të ndryshme dhe disa nga ato janë më të mira se të tjerat.
2. Njeriu duhet të përpiqet që t'i lutet Allahut me këtë dua, sepse ajo përmban zotërinë e istigfarit (pendimit).

(5503)

(346) - عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رضي الله عنه عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: أَنَّهُ كَانَ يَقُولُ إِذَا أَصْبَحَ: «اللَّهُمَّ بِكَ أَصْبَحْنَا، وَبِكَ أَمْسَيْنَا، وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نَمُوتُ، وَإِلَيْكَ النُّشُورُ» وَإِذَا أَمْسَى قَالَ: «بِكَ أَمْسَيْنَا، وَبِكَ أَصْبَحْنَا، وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نَمُوتُ، وَإِلَيْكَ النُّشُورُ» قَالَ: وَمَرَّةً أُخْرَى: «وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ». [حسن] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه]

(346) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ kur gdhihej thoshte: "All-llahumme bike asbahna ue bike emsejna ue bike nahja ue bike nemutu ue ilejken-nushur - O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin dhe me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është ringjallja." Ndërsa kur ngrysej thoshte: "All-llahumme bike emsejna ue bike asbahna ue bike nahja ue bike nemutu ue ilejken-nushur - O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen dhe me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është kthimi." E një herë tjerë ka thënë: "... ue ilejke el mesir - dhe tek Ti është kthimi." [Hadith hasen] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه]

Shpjegimi:

Kur gdhihej, respektivisht kur hynte fillimi i ditës me lindjen e agimit (ar. fexhr), i Dërguari i Allahut ﷺ thoshte:

"O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin", të mbështjellë me ruajtjen Tënde, të mbuluar nga mirësia Jote, të angazhuar me përmendjen Tënde, duke kërkuar ndihmën

përmes emrit Tënd, të përfshirë në udhëzimin Tënd dhe duke vepruar me fuqinë dhe mundësinë Tënde. "... dhe me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim..." njëjtë siç u përmend më parë, por në mbrëmje të thotë: "O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen, me emrin Tënd, Jetëdhënësi, jetojmë dhe me emrin Tënd, Jetëmarrësi, vdesim." ... dhe tek Ti është ringjallja", domethënë kthimi pas vdekjes dhe shpërndarja pas bashkimit. Gjendja jonë vazhdon në këtë mënyrë në të gjitha kohët dhe rrethanat, pa u shkëputur dhe pa e braktisur atë.

Kur e zinte mbrëmja, që i bie nga pas ikindisë, thoshte: "O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen dhe me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është kthimi." Domethënë, kthimi ynë në këtë botë dhe rikthimi ynë në botën tjetër janë tek Ti, sepse Ti je Ai që më jep jetë dhe më bën të vdes.

Mësime nga hadithi:

1. Është e pëlqyeshme të thuhet kjo lutje në mëngjes dhe në mbrëmje, duke ndjekur shembullin e Profetit ﷺ.
2. Njeriu ka nevojë për Zotin e tij në të gjitha gjendjet dhe kohët e tij.
3. Më e mira për thënien e dhikrit është në mëngjes. Është koha nga lindja e agimit deri në lindjen e diellit në fillim të ditës, dhe pas ikindisë deri para perëndimit të diellit. Nëse e thotë pas këtyre kohëve,

pra, në mëngjes pas ngritjes së diellit, i llogaritet tamam. Po ashtu, nëse e thotë pas drekës, i llogaritet tamam, dhe po ashtu pas akshamit, i llogaritet tamam, meqë kjo është koha për dhikër.

4. Përshtatshmëria e këtij dhikri: "dhe tek Ti është ringjallja", që thuhet në mëngjes, qëndron në faktin se kjo e kujton njeriun për ringjalljen e madhe, kur njerëzit do të vdesin dhe do të ringjallen Ditën e Kiametit. Kjo është një ringjallje e re dhe një ditë e re, në të cilën shpirtat kthehen, njerëzit përhapen dhe ky mëngjes i ri, që Allahu e krijoi, bëhet dëshmitar për birin e Ademit. Kështu që, koha dhe çastet janë depozita që ruajnë veprat tona.
5. Përshtatshmëria e këtij dhikri "dhe tek Ti është kthimi", për faktin që thuhet në mbrëmje, nënkupton se kur njerëzit kthehen nga punët e tyre dhe shpërndahen për nevojat dhe jetesën e tyre, ata rikthehen në shtëpitë e tyre dhe më pas pushojnë pas këtij angazhimi. Kjo e kujton njeriun për kthimin tek Allahu i Lartësuar, si destinacioni, përfundimi dhe vendqëndrimi i fundit.

(5490)

thosha këtë lutje." [Ky hadith është sahih] - رواه أبو داود والترمذي
[والنسائي في الكبرى وابن ماجه وأحمد]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ ka sqaruar se kush thotë çdo mëngjes pas lindjes së agimit dhe çdo mbrëmje para perëndimit të diellit, tri herë: "Bismil-lah, - Me emrin e Allahut" kërkoj ndihmë dhe mbrohem nga çdo gjë që mund të dëmtojë. " me të cilin asgjë nuk mund të dëmtojë", pra, kur të përmendet emri i Tij asgjë nuk mund të të dëmtojë, sado e madhe qoftë ajo "në tokë" apo që del jashtë saj nga fatkeqësitë, qoftë "në qiell", apo nga fatkeqësitë që zbresin prej tij. "Ai është Gjithëdëgjuesi" i fjalëve tona dhe "i Gjithëdituri" për gjendjen tonë (të tillin nuk e godet gjë).

Atë që e thotë këtë lutje në mbrëmje, nuk do ta godasë fatkeqësia papritur deri në mëngjes, sikurse atë që e thotë atë në mëngjes, nuk do ta godasë fatkeqësia papritur deri në mbrëmje.

Transmetuesi i hadithit, Eban ibn Othmani u godit nga paraliza (në një rën të trupit). Njeriu që e kishte dëgjuar hadithin prej tij e shikonte me habi! Atëherë Ebani i tha: "Pse më shikon kështu?! Pasha Allahun, unë nuk kam gënjyer për Othmanin dhe as Othmani nuk ka gënjyer për Profetin ﷺ. Por atë ditë kur më goditi kjo sëmundje, Allahu nuk kishte caktuar që ta thosha këtë lutje. Më kishte kapluar zemërimi dhe e harrova t'i shqiptoja këto fjalë të përmendura (në këtë lutje)."

Mësime nga hadithi:

1. Pëlqehet të thuhet ky dhikër në mëngjes dhe në mbrëmje, që njeriu të jetë i mbrojtur, me lejen e Allahut të Lartësuar, nga fatkeqësitë e papritura, dëmet apo sprovat e ngjashme.
2. Bindja e fortë e gjeneratave të para të Islamit ndaj Allahut dhe besimi i tyre i plotë në atë që ka njoftuar i Dërguari i Allahut ﷺ.
3. Një nga përfitimet e kufizimit të dhikrit në mëngjes dhe mbrëmje është këputja e shkujdesjes për muslimanin dhe kujdesi i tij i vazhdueshëm se ai është rob i Allahut të Lartësuar.
4. Në përpjestim me besimin e atij që e përmend Allahun, përulësinë, praninë e zemrës, sinqeritetin dhe bindjen, do të realizohet ndikimi i dhikrit.

(6093)

(348) - عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ حُذَيْبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّهُ قَالَ: حَرَجْنَا فِي لَيْلَةِ مَطِيرَةٍ وَظُلْمَةٍ شَدِيدَةٍ، نَطْلُبُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ؛ يُصَلِّي لَنَا، قَالَ: فَأَذْرَكْتُهُ، فَقَالَ: «قُلْ»، فَلَمْ أَقُلْ شَيْئًا، ثُمَّ قَالَ: «قُلْ»، فَلَمْ أَقُلْ شَيْئًا، قَالَ: «قُلْ»، فَقُلْتُ: مَا أَقُولُ؟ قَالَ: «{قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ} وَالْمَعُودَتَيْنِ حِينَ تُنْسِي وَتُصْبِحُ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ، تَكْفِيكَ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ».

[صحيح] - [رواه أبو داود والترمذي والنسائي]

(348) – Nga Abdullah ibën Hubejbi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë: "Një natë me shi dhe me erë të

fortë, dolëm të kërkonim Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!) që të na falte namazin. Kur e gjeta, më tha: 'Thuaj!' Por unë nuk thashë asgjë. Përsëri tha: 'Thuaj!' Por unë nuk thashë asgjë. Ai përsëri tha: 'Thuaj!' Kësaj here unë i thashë: 'Çfarë të them?' Ai tha: 'Kul huvallahu ehad dhe dy Mbrojtëset (Feleku dhe Nasi) në mëngjes dhe në mbrëmje nga tri herë, të mjaftojnë për çdo gjë'. [Ky hadith është sahih] - رواه أبو داود والترمذي والنسائي

Shpjegimi:

Sahabiu i madh Abdullah ibën Hubejbi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se ata dolën një natë në të cilën binte shi me rrebesh dhe frynte një erë e fortë për të kërkuar Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!) që t'u falte namazin dhe kur e gjetën, Pejgamberi i tha atij: "Thuaj!" d.m.th. këndo! Por, ai nuk këndoi asgjë. Kur Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i përsëriti fjalët, Abdullahu i tha: "Çfarë të këndoj, o Pejgamber i Allahut?" Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i tha që të këndonte suren El-Ihlas, suret El-Felek dhe En-Nas në mbrëmje dhe në mëngjes nga tri herë, ngase ato të mbrojnë nga çdo e keqe dhe nga çdo ligësi.

Mësime nga hadithi:

1. Pëlqehet që suret El-Ihlas, El-Felek dhe En-Nas të këndohen në mëngjes dhe në mbrëmje, ngase ato të mbrojnë nga çdo gjë e keqe.
2. Vlera e këndimit të sureve El-Ihlas, El-Felek dhe En-Nas.

(349) - عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ: فَقَدْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَيْلَةً مِنَ الْفِرَاشِ فَالْتَمَسْتُهُ فَوَقَعْتُ يَدَيَّ عَلَى بَطْنِ قَدَمَيْهِ وَهُوَ فِي الْمَسْجِدِ وَهُمَا مَنْصُوبَتَانِ، وَهُوَ يَقُولُ: «اللَّهُمَّ أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ، وَبِمُعَافَاتِكَ مِنْ عُقُوبَتِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ لَا أَحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَى نَفْسِكَ».

[صحيح] - [رواه مسلم]

(349) – Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Një natë, të Dërguarin e Allahut ﷺ nuk e gjeta në shtrat, ndaj fillova ta kërktoj, sakaq dora më preku shputat e tij, të shtrira, ndërsa ai ndodhej në sexhde, duke thënë: “All-llahumme, inni eudhu bi ridake min sehatik, ve bi muafatike min ukubetik, ve eudhu bike minke, la uhsi thenaen alejke, ente kema ethnejte ala nefsik" - "O Allah, kërktoj mbrojtje me kënaqësinë Tënde nga zemërimi Yt, me faljen Tënde nga dënimi Yt, dhe kërktoj mbrojtjen Tënde nga Ti! Unë nuk di të të lavdëroj siç e meriton, Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën)!” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Po flija pranë Profetit ﷺ dhe nuk e gjeta natën. Preka me dorë vendin ku ai falej në dhomë dhe e gjeta duke bërë sexhde me këmbët e ngritura, ndërsa thoshte:

"... kërktoj mbrojtje me kënaqësinë Tënde nga zemërimi Yt", respektivisht afrohem tek Ti përmes kënaqësisë Sate të

më mbrosh mua dhe umetin tim. Dhe kërkoj mbrojte "me faljen Tënde" të madhe "nga dënimi Yt." "...dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga Ti!" me cilësitë e bukurisë Sate nga cilësitë e madhështisë Sate, sepse askush nuk mund të ofrojë mbrojtje prej Teje përveç Teje, dhe nuk ka strehë e as shpëtim prej Allahut, përveçse tek Allahu. "Unë nuk di të të lavdëroj siç e meriton", jam i paaftë dhe nuk mund ta rendis apo ta numëroj, për shkak të pamundësisë sime për të përmendur plotësisht mirësinë dhe bujarinë Tënde në mënyrën që të takon Ty, sado që të përpiqem. "Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën!", sepse vetëm Ti e ke lavdëruar Vetën në mënyrën që të takon Ty, e kush mund të të lavdërojë siç duhet?!

Mësime nga hadithi:

1. Është e preferuar të thuhet këto lutje gjatë sexhdes.
2. Mireku ka thënë: "Një nga versionet e transmetuara nga Nesaiu, ai përmend: "Ai e thoshte këtë lutje pasi e përfundonte namazin dhe shkonte për të fjetur."
3. Është e pëlqyeshme të lavdërohet Allahu përmes cilësive të Tij dhe t'i bëhet lutje përmes emrave të Tij, të cilët janë të vërtetuar në Kuran dhe Sunet.
4. Kjo nënkupton madhërimin e Krijuesit në ruku (përkulje) dhe sexhde.
5. Kërkimi i mbrojtjes përmes cilësive të Allahut është i lejuar, ashtu siç është i lejuar kërkimi i mbrojtjes përmes Vetes së Tij.

6. Hatabiu ka thënë: "Kjo lutje mbart një kuptim të hollë, që është: Profeti ﷺ kërkoi mbrojtje tek Allahu për ta ruajtur atë nga zemërimi i Tij me kënaqësinë e Tij dhe nga dënimi i Tij me faljen e Tij, duke pasur parasysh se "kënaqësia" dhe "zemërimi" janë dy të kundërta dhe e njëjta gjë vlen për "faljen" dhe "dënimin". Megjithatë, kur e përmendi Atë që nuk ka të kundërt, domethënë Allahun e Lartësuar, ai nuk kërkoi mbrojtje veçse tek Ai nga Ai Vetë. Kjo do të thotë: Kërkimi i faljes së Allahut për mangësitë në përmbushjen e adhurimit kushtuar Tij, siç duhet dhe lavdërimi i Tij. Fjala e tij: "Unë nuk di të të lavdëroj siç e meriton". Domethënë: "Unë jam i pafuqishëm ta bëj këtë dhe nuk mund ta arrij këtë gjë."

(3566)

(350) – عن سَمُرَةَ بْنِ جَنْدَبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَحَبُّ الْكَلَامِ إِلَى اللَّهِ أَرْبَعٌ: سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، لَا يَضُرُّكَ بِأَيِّهِنَّ بَدَأْتَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(350) – Semura ibën Xhundubi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Fjalët më të mira tek Allahu janë katër: subhanallah (i Lartësuar është Allahu), elhamdulilah (lavdfalënderimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut) dhe

Allahu Ekber (Allahu është më i madhi). Nuk prish punë se me cilën fillon." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se fjalët më të dashura tek Allahu i Lartësuar janë katër:

Subhanallah, që nënkupton lartësimin dhe dëlirësimin e Allahut të Lartësuar nga çdo mangësi.

Elhamdulillah, që nënkupton përshkrimin e Allahut me të gjitha cilësitë e përsosurisë dhe plotësisë, duke e dashur dhe duke e madhëruar.

La ilahe il-lallah, që nënkupton se nuk ka të adhuruar meritë pos Allahut.

Allahu Ekber, që nënkupton se Allahu është më i çmuari, më madhështori dhe më krenari se çdo gjë tjetër.

Mirësitë e tyre dhe marrja e shpërblimit, që rezulton kur të thuhet, nuk nënkupton të shqiptohen me renditje.

Mësime nga hadithi:

1. Feja është e lehtë, prandaj nuk prish punë se me cilën nga këto fjalë fillon.

(5475)

(351) - عن أبي أيوب رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، عَشْرَ مَرَّاتٍ كَانَ كَمَنْ أَعْتَقَ أَرْبَعَةَ أَنْفُسٍ مِنْ وَلَدِ إِسْمَاعِيلَ». [صحيح] - [متفق عليه]

(351) - Ebu Ejubi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Atij që thotë dhjetë herë: "La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu, ve huve ala kuli shejin kadir (S'ka të adhurar të denjë përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdi, Ai ka fuqi për çdo gjë)", i llogaritet sikur t'i ketë liruar katër robër nga pasardhësit e Ismailit.”
[Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na ka treguar në këtë hadith se kush thotë: "La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu, ve huve ala kuli shejin kadir", kuptimi i së cilës është: Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit e pa ortak, dhe se Ai, i Lartësuar, është Ai që ka sundim të plotë, Ai që është i denjë për falënderim dhe lavdërim, duke ia bashkëngjitur kësaj dashurinë dhe madhërimit, e jo dikujt tjetër, si dhe Ai është i Plotfuqishëm dhe asgjë nuk është e pamundur për Të. Kushdo që e përsërit këtë dhikër madhështor dhjetë herë në ditë, do të marrë shpërblim të ngjashëm me shpërblimin e atij që ua hoqi robërinë katër robërve nga pasardhësit e Ismailit, të birit të Ibrahimit (alejhima selam). I veçoi pasardhësit e Ismailit (alejhi selam), sepse janë më të nderuar se të tjerët.

Mësime nga hadithi:

1. Vlera e këtij dhikri, sepse përfshin veçimin e Allahut të Lartësuar me adhurim, sundim, lavdërim dhe fuqi të plotë.
2. Ky shpërblim arrihet për këdo që e thotë gjatë ditës, goftë rresht, goftë veçmas.

(5517)

(352) - عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم قال:
«كَلِمَتَانِ خَفِيفَتَانِ عَلَى اللِّسَانِ، ثَقِيلَتَانِ فِي الْمِيزَانِ، حَبِيبَتَانِ إِلَى الرَّحْمَنِ: سُبْحَانَ اللَّهِ
الْعَظِيمِ، سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(352) – Ebu Hurejra (Allahu goftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, të rënda në Peshore dhe të dashura për të Gjithëmëshirshmin: "Subhanallahil Adhim, subhanallahi ve bihamdihi (I Lartësuar është Allahu i Madhëruar, i Lartësuar është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi)!" [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi për dy fjalë që njeriu i shqipton pa vështirësi, në çdo rrethanë dhe se për to ka shpërblim të madh në peshore dhe se Zoti ynë, i Gjithëmëshirshmi e i Lartmadhërishmi, i do ato:

Subhanallahil Adhim, subhanallahi ve bihamdihi (I Lartësuar është Allahu i Madhëruar, i Lartësuar është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi)!" Kjo, se ato ngërthejnë në vete përshkrimin e Allahut dhe madhështi e përsosuri, si dhe dëlirësimin e Tij nga mangësitë.

Mësimet nga hadithi:

1. Dhikri më madhështor është ai tek i cili bashkohet dëlirësimi i Allahut dhe lavdërimi i Tij.
2. Sqarimi se mëshira e Allahut është e gjerë me robërit e Tij, dhe se Ai për një vepër të vogël shpërblen shumë.

(5507)

(353) – عن أبي هريرة رضي الله عنه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: «مَنْ قَالَ: سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ، فِي يَوْمٍ مِائَةَ مَرَّةٍ، حُطَّتْ خَطَايَاهُ وَإِنْ كَانَتْ مِثْلَ زَبَدِ الْبَحْرِ». [صحيح] - [متفق عليه]

(353) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atij që thotë: "Subhanallahi ve bihamdihi (I patëmeta është Allahu dhe lavdërimi i takon Atij)", njëqind herë në ditë, i fshihen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit." [Ky hadith është sahih] - [Muttefekun alejhi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se, atij që thotë: "Subhanallahi ve bihamdihi (I patëmeta është Allahu dhe lavdërimi i takon Atij)", njëqind herë në ditë, i fshihen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit, kur valëzohet dhe shpërthen.

Mësime nga hadithi:

1. Ky shpërblim arrihet për këdo që e thotë gjatë ditës, qoftë ngjitur, qoftë ndaras.
2. Tesbihi nënkupton dëlirjen e Allahut nga mangësitë, ndërsa hamdi nënkupton përshkrimin e Allahut me përsosuri, duke ia bashkëngjitur kësaj dashurinë dhe madhërimin.
3. Ajo që nënkuptohet në këtë hadith është shlyerja e mëkateve të vogla. Sa u përket mëkateve të mëdha, për to duhet pendim.

(5516)

(354) - عن أبي مالك الأشعري رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «الطُّهُورُ شَطْرُ الْإِيمَانِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ تَمْلَأُ الْمِيزَانَ، وَسُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ تَمْلَأَانِ - أَوْ تَمْلَأُ - مَا بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ، وَالصَّلَاةُ نُورٌ، وَالصَّدَقَةُ بُرْهَانٌ، وَالصَّبْرُ ضِيَاءٌ، وَالْقُرْآنُ حُجَّةٌ لَكَ أَوْ عَلَيْكَ، كُلُّ النَّاسِ يَغْدُو، فَبَايَعُ نَفْسَهُ فَمُعْتَقَةٌ أَوْ مُؤَيِّقَةٌ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(354) – Ebu Malik el Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Pastërtia është gjysma e imanit, (thënia) "elhamdulilah" e rëndon peshoren, (thëniet:) "subhanallah" (i patëmeta është Allahu) dhe "elhamdulilah" (lavdërimi i takon Allahut) mbushin, - ose e mbush, - hapësirën ndërmjet qiejve dhe Tokës. Namazi është nur, lëmosha është dëshmi, durimi është ndriçim dhe Kurani është argument, për ose kundër teje. Andaj, çdo njeri, kur zgjohet në mëngjes, ose do ta shesë veten duke e liruar atë, ose do të vetëshkatërrohet." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se pastërtia e jashtme arrihet me abdes e gusël dhe ajo (pastërtia) është kusht i namazit. Thënia: "elhamdulilah" (lavdërimi i takon Allahut) e rëndon peshoren", është falënderim ndaj Allahut të Lartësuar dhe përshkrim i Tij me cilësi të përkryera, të cilat do të peshojnë në Ditën e Kiametit dhe do ta mbushin peshoren e veprave. Thëniet: "subhanallah" (i patëmeta është Allahu) dhe elhamdulilah" (lavdërimi i takon Allahut)

janë dëlirësim i Allahut nga të gjitha mangësitë dhe përkryera të Tij me cilësi të përkryera, që i përshtaten madhështisë së Tij, së bashku me dashurinë dhe madhërimin e Tij, gjë që e mbush hapësirën ndërmjet qiejve dhe Tokës. "Namazi është nur" për robin në zemrën e tij, në fytyrën e tij e në varrin e tij kur të ringjallet. "Lëmosha është dëshmi" dhe dëshmi për besimin e çiltër të besimtarit dhe për dallimin e tij nga hipokriti, i cili nuk jep, sepse nuk u beson premtimeve që përmenden për vlerën e saj. "Durimi është ndriçim", që nënkupton vetëpërmbytjen nga mosdurimi dhe pakënaqësia. Është ndriçim që sjell nxehtësi dhe djegie, si drita e Diellit, sepse është i vështirë dhe kërkon që shpirti të përpiqet e ta ndalojë kundrejt asaj që dëshiron, kështu durimtari vazhdon të jetë i ndritur, i udhëzuar dhe vazhdon të jetë në të drejtën. (Durimi ndahet në tri lloje): durimi në bindje ndaj Allahut, durimi për të mos e kundërshtuar Atë dhe durimi përballë fatkeqësive dhe të gjitha llojeve të vështirësive në këtë botë. "Kurani është argument, për" duke e lexuar dhe vepruar sipas tij, "ose kundër teje" duke e lënë atë pa e jetësuar dhe pa e lexuar. Pastaj Profeti ﷺ tregoi se të gjithë njerëzit japin mund, shpërndahen, zgjohen nga gjumi dhe largohen nga shtëpitë e tyre për punët e tyre të ndryshme: prej tyre ka që i përmbahen bindjes ndaj Allahut dhe çlirohen nga Zjarri, gjithashtu ka prej tyre që devijojnë prej kësaj dhe bien në mëkat, kështu që shkatërrohen duke hyrë në Zjarr.

Mësime nga hadithi:

1. Pastërtia ndahet në dy lloje: pastërtia e jashtme, që është me abdes e gusël (larje të tërësishme të trupit) dhe pastërtia e brendshme, që është me teuhid (monoteizëm), besim dhe vepra të mira.
2. Rëndësia e faljes së namazit përherë, pasi ai është nur për robin, në këtë botë dhe në Ditën e Kiametit.
3. Lëmosha është dëshmi për besimin e sinqertë.
4. Rëndësia e të punuarit sipas porosive të Kuranit dhe besimit në të, që të jetë argument për ty, e jo kundër teje.
5. Nëse ti veten nuk e angazhon me adhurim, ajo të angazhon ty me mëkatim.
6. Çdo njeri duhet të veprojë: ose e çliron veten nëpërmjet adhurimit, ose vetëshkatërrohet me mëkatim.
7. Durimi kërkon vetëpërmbajtje dhe llogaritje në shpërblim (të Allahut), si dhe është i vështirë.

(65004)

(355) - عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: «لَأَنْ أَقُولَ: سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا طَلَعَتْ عَلَيْهِ الشَّمْسُ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(355) – Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Që të them: "Subhanallah (i patëmeta është Allahu), elhamdulilah (lavdërimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) dhe Allahu ekber (Allahu është më i madhi)" është më e dashur tek unë se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se përmendja e Allahut të Lartësuar me këto fjalë madhështore është më e mirë se kjo botë dhe çdo gjë në të. Këto fjalë janë:

Subhanallah - është lartësim për Allahun nga çdo mangësi.

Elhamdulilah - është lavdërim për Allahun përmes cilësive të përkryera, duke e dashur dhe madhëruar.

La ilahe il-lallah, respektivisht nuk ka zot që meriton të adhurohet denjësisht pos Allahut.

Allahu ekber - është më madhështori dhe më i madhi se çdo gjë.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për ta përmendur Allahun dhe se kjo gjë është më e dashur se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind.
2. Inkurajimi për ta përmendur Allahun sa më shpesh, sepse në të ka shpërblim dhe mirësi.
3. Kënaqësitë e kësaj bote janë të pakta dhe kalimtare.

(6211)

(356) – عن جابر رضي الله عنه قال: سمعت رسول الله صلى الله عليه وسلم يقول: «أَفْضَلُ الذِّكْرِ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَفْضَلُ الدُّعَاءِ: الْحَمْدُ لِلَّهِ». [حسن] - [رواه الترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه]

(356) – Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëguar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: "Dhikri më i mirë është: "La ilahe il-lallah", ndërsa lutja më e mirë është: "Elhamdulillah." [Hadith hasen] - [رواه الترمذي والنسائي في الكبرى وابن ماجه]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ na tregon në këtë hadith se dhikri (përmendja e Allahut) më i mirë është: “La ilahe il-lallah”, që do të thotë se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut, e lutja më e mirë është: "Elhamdulillah (çdo lavdërim i takon Allahut)", që nënkupton pranimin se Dhuruesi është Allahu i Lartësuar, Meritori për cilësitë e përsosura dhe të bukura.

Mësime nga hadithi:

1. Inkurajimi për ta thënë shpesh fjalën e teuhidit dhe lutjen "elhamdulillah".

(3567)

(357) - عَنْ حَوْلَةَ بِنْتِ حَكِيمِ السُّلَمِيَّةِ قَالَتْ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ نَزَلَ مَنْزِلًا ثُمَّ قَالَ: أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ، لَمْ يَضُرَّهُ شَيْءٌ حَتَّى يَرْتَحِلَ مِنْ مَنْزِلِهِ ذَلِكَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(357) – Havle bint Hakim Sulejmije (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Atij që shkon në një vend dhe thotë: “Eudhu bi kelimatil-lahi tammati min sherri ma halek (Kërkoj mbrojtje nëpërmjet fjalëve të përsosura të Allahut kundër së keqes që ka krijuar)!", nuk i bën dëm asgjë derisa të largohet nga ai vend." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e udhëzon umetin e tij që të kapet dhe të kërkojë strehim të dobishëm, përmes të cilit mënjanohet çdo e keqe, prej së cilës frikësohet njeriu, atëherë kur të vendoset në një vend në tokë, qoftë në udhëtim, qoftë në piknik e të ngjashme. Pra, të kapet fort dhe të strehohet përmes fjalëve të Allahut, të cilat janë të përkryera në vlerën, begatinë dhe dobinë e saj, të cilat janë larg çdo të mete dhe mangësie, që ta ruajë Ai nga keqja e

çdo krijese që përmban të keqen, kështu që ai është i sigurt në atë vend nga çdo gjë që dëmton, përderisa qëndron aty.

Mësime nga hadithi:

1. Kërkimbrotja është adhurim, e ajo bëhet duke kërkuar mbrojtje përmes Allahut të Lartësuar, përmes emrave të Tij ose përmes cilësive të Tij.
2. Lejohet kërkimbrotja përmes Fjalës së Allahut, sepse ajo është një prej cilësive të Tij, ndryshe nga kërkimbrotja përmes ndonjë krijese, kushdo qoftë, e cila është shirk.
3. Vlera dhe begatia e kësaj lutjeje.
4. Fortifikimi përmes dhikrit (përmendjes së Allahut) është arsye për ta mbrojtur robin nga të këqijat.
5. Kërkimbrotja përmes dikujt tjetër pos Allahut, bie fjala, prej xhinëve, magjistarëve, gënjeshtarëve e të tjerëve, është e kotë.
6. Kjo lutje është e ligjësuar të thuhet kur dikush shkon dhe qëndron në ndonjë vend, qoftë kur është vendas, qoftë udhëtar.

(5932)

(358) - عَنْ أَبِي هُمَيْدٍ أَوْ عَنْ أَبِي أُسَيْدٍ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِذَا دَخَلَ أَحَدُكُمُ الْمَسْجِدَ فَلْيَقُلْ: اللَّهُمَّ افْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ، وَإِذَا خَرَجَ فَلْيَقُلْ: اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(358) – Ebu Humejdi ose Ebu Usejdi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Kur ndonjëri prej jush hyn në xhami, le të thotë: "Allahummeftah li ebvabe rahmetik (O Allah, m'i hap mua dyert e Mëshirës Sate)!" E, kur të dalë, le të thotë: "Allahumme inni eseluke min fadlike (O Allah, unë kërkoj nga Ti begatitë e Tua)." [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith e udhëzoi umetin e tij ta thonë lutjen me rastin e hyrjes në xhami (O Allah, m'i hap mua dyert e Mëshirës Sate), kështu që e lut Allahun e Lartësuar që t'ia përgatitë shkaqet për ta arritur mëshirën e Tij. E, nëse dëshiron të dalë prej saj, le të thotë: "O Allah, kërkoj nga Ti begatitë e Tua." Kështu, ai i kërkon Allahut mirësitë e Tij dhe t'ia shtojë begatitë e Tij, nga furnizimi hallall.

Mësime nga hadithi:

1. Kjo lutje rekomandohet të thuhet gjatë hyrjes dhe daljes nga xhamia.
2. Specifikimi i përmendjes së mëshirës gjatë hyrjes dhe e begatisë gjatë daljes është për faktin se, ai që hyn në xhami është i zënë me atë që do ta afrojë me

Allahun dhe te Xheneti i Tij, prandaj është me vend të përmendet në lutje mëshira, e, kur të dalë, përpiqet në tokë duke kërkuar begatitë e furnizimin e Allahut, prandaj është me vend që të përmendet begatia.

3. Këto lutje thuhën kur dëshirojmë të hyjmë në xhami dhe kur dëshirojmë të dalim prej saj.

(65092)

(359) - عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «إِذَا دَخَلَ الرَّجُلُ بَيْتَهُ، فَذَكَرَ اللَّهَ عِنْدَ دُخُولِهِ وَعِنْدَ طَعَامِهِ، قَالَ الشَّيْطَانُ: لَا مَبِيتَ لَكُمْ، وَلَا عَشَاءَ، وَإِذَا دَخَلَ، فَلَمْ يَذْكُرِ اللَّهَ عِنْدَ دُخُولِهِ، قَالَ الشَّيْطَانُ: أَذْرَكْتُمُ الْمَبِيتَ، وَإِذَا لَمْ يَذْكُرِ اللَّهَ عِنْدَ طَعَامِهِ، قَالَ: أَذْرَكْتُمُ الْمَبِيتَ وَالْعَشَاءَ». [صحيح] - [رواه مسلم]

(359) – Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të) tregon se e ka dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: “Kur njeriu futet në shtëpinë e tij dhe thotë: "Bismilah" gjatë hyrjes dhe gjatë ngrënies, shejtani thotë: "S'ka konak për ju sonte, e as darkë." Nëse hyn dhe nuk thotë: "Bismilah" gjatë hyrjes, shejtani thotë: "Gjetët konakun." E, nëse as gjatë ushqimit nuk thotë: "Bismilah", ai thotë: "Gjetët konakun dhe darkën.” [Ky hadith është sahih] - [E shënon Muslimi]

Shpjegimi:

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar që të përmendet Allahu kur hyjmë në shtëpi dhe para se të hamë ushqim, e, kur ta përmendim Allahun duke thënë: "Bismilah" kur hyjmë në shtëpi dhe kur të fillojmë të hamë, shejtani u thotë ndihmësve të tij: "Ju nuk keni hise në konak e as darkë në këtë shtëpi, sepse pronari i saj është mbrojtur nga ju me përmendjen e Allahut të Lartësuar." Por, nëse njeriu hyn në shtëpinë e tij dhe nuk e përmend Allahun kur hyn ose kur ha ushqim, atëherë shejtani u thotë ndihmësve të tij se për ta ka konak dhe darkë në këtë shtëpi.

Mësime nga hadithi:

1. Është e preferuar të përmendet Allahu kur hyjmë në shtëpi dhe kur hamë ushqim, pasi shejtani e kalon natën në shtëpi dhe e ha ushqimin e banorëve të atyre shtëpive, nëse ata nuk e përmendin emrin e Allahut të Lartësuar.
2. Shejtani e vëzhgon njeriun gjatë punës, sjelljeve dhe të gjitha çështjeve të tij, e, nëse është i pavëmendshëm dhe nuk e përmend Allahun, atëherë shejtani ia arrin atë që do prej tij.
3. Përmendja e Allahut e largon shejtanin.
4. Çdo shejtan ka pasues dhe ndihmëtarë që gëzohen me fjalët e tij dhe ndjekin urdhrat e tij.

Përmbajtja

Parathënie 1

Veprat vlerësohen sipas nijeteve dhe njeriut i takon ajo që e ka bërë nijet 3

Atij që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është e saj, i refuzohet 5

Islami është të dëshmosh se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhillëkun (këtë të fundit) po pate mundësi..... 6

“Islami është ngritur mbi pesë shtylla**Error! Bookmark not defined.**

E drejta e Allahut kundrejt njerëzve është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë ortak asgjë. Ndërkaq, e drejta e njerëzve tek Allahu është që të mos dënojnë askënd që nuk i bën ortak Atij asgjë..... 13

Nuk ndodh që një rob të deklarojë sinqerisht nga zemra se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, e që Allahu atë njeri të mos ia ndalojë Zjarrit**Error! Bookmark not defined.**

Për atë që thotë: "La ilahe il-lallah" dhe mohon çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, pasuria dhe gjaku është i ndaluar, e llogaria e tij është tek Allahu 18

Ai iu përgjigj: “Ai që vdes pa i bërë shirk Allahut asgjë, do të hyjë në Xhenet, ndërsa ai që vdes duke i bërë shirk

Allahut ndonjë gjë, do të hyjë në Zjarr.” **Error!**
Bookmark not defined.

Ai që vdes duke i bërë Allahut shok, do të hyjë në Zjarr
.....**Error! Bookmark not defined.**

Ti po shkon te një popull që janë ithtarë të Librit. Kur të
arrish tek ata, thirri të dëshmojnë se askush përveç Allahut
nuk meriton të adhurohet dhe se Muhamedi është i
Dërguari i Allahut.....22

Njeriu më fatlum që do ta fitojë ndërmjetësimin (shëfatin)
tim Ditën e Gjykimit është ai që deklaron: "La ilahe il
lallah (s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut)" me zemër
të singertë, - ose ka thënë: me sinqeritet.” **Error!**
Bookmark not defined.

“Imani është shtatëdhjetë e ca degë, më e larta e të cilave
është dëshmia "la ilahe il-lallah", ndërsa më e ulëta largimi
i pengesave nga rruga.....26

E kam pyetur Profetin ﷺ: "Cili është gjynahu më i madh
tek Allahu?" Më tha: “T'i bësh ortak Allahut, ndërsa Ai të
ka krijuar.....28

Unë aspak nuk kam nevojë për ortak. Kushdo që bën një
vepër duke më bërë Mua ortak dikë në atë vepër, Unë e
braktis atë së bashku me ortakërinë që ma ka bërë30

“Gjithë umeti im do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që
refuzojnë.....31

“Mos më shenjtëroni siç e kanë shenjtëruar të krishterët të
birin e Merjemes. Unë jam rob i Allahut, andaj thoni: "Rob
i Allahut dhe i Dërguari i Tij.”.....32

“Nuk ka besuar ndokush prej jush derisa të më dojë mua më shumë sesa prindin, fëmijën dhe të gjithë njerëzit e tjerë.”34

“Mos më pyesni për gjëra që ende nuk jua kam thënë. Ata që ishin para jush janë shkatërruar për shkak të pyetjeve (të panevojshme) dhe kundërshtimit të pejgamberëve të tyre.....35

“Kumtoni prej meje qoftë dhe një ajet, si dhe nuk ka të keqe t'i transmetoni gojëdhënat e benu israilëve. Ai që gënjen për mua qëllimisht, le të përgatitet për ulësen e tij në Zjarr.”38

Nuk është e largët koha kur ndonjë personi t'i arrijë hadithi nga unë, ndërkohë ai, duke qenë i mbështetur në kolltukun e tij, të thotë: "Mes nesh dhe jush është Libri i Allahut .40

Allahu i mallkoftë hebrenjtë dhe të krishterët: varret e të dërguarve i shndërruan në faltore!42

O Allah, mos ma bëj varrin idhull.....44

Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varre e as mos e shndërroni varrin tim në vendfestë, por më dërgoni salavate, sepse salavati juaj më arrin kudo që jeni!”.....45

Ata janë njerëz që, kur u vdes ndonjë rob i devotshëm, - ose ka thënë: burrë i devotshëm, - mbi varrin e tij ndërtojnë faltore.....47

Me ndërgjegje të pastër para Allahut, refuzoj të kem ndonjë mik të ngushtë nga mesi juaj, sepse Allahu i Lartësuar më ka zgjedhur mua për mik të ngushtë (ar. halil) ashtu siç e ka zgjedhur mik të ngushtë Ibrahimin 49

A të të dërgoj për atë me të cilën më ka dërguar i Dërguari i Allahut ﷻ: të mos lësh statujë pa prishur e as varr të ngritur pa e rrafshuar!.....51

Tijera (besimi në ogure të zeza) është shirk. Tijera është shirk. Tijera është shirk." - Këtë e tha tri herë. - "Secili prej nesh përjeton diçka nga kjo, por Allahu i Lartmadhëruar e largon atë me mbështetjen në Të52

Nuk është sipas udhëzimit tonë ai që bën tetajur (beson në ogure të zeza) ose bëhet për të tetajur, e as ai që bën fall ose shkon tek ai që bën fall, e as ai që bën magji ose bëhet për të magji.....54

Nuk ka sëmundje ngjitëse e as ogur të zi, mirëpo mua më pëlqen optimizmi (ndjellja e së mirës)" Dikush i tha: Çfarë është optimizmi (ndjellja e së mirës)? Ai tha: "Fjala e mirë!56

E dini se çfarë tha Zoti juaj?" Të pranishmit thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." I Dërguari vazhdoi: "Ai tha: "Disa robër të Mi më besuan, e disa të tjerë më mohuan58

Kush var hajmali në trup ka bërë shirk (idhujtari)!.....60

Me të vërtetë rukjet (yshtjet, që nuk përputhen me fenë), temimet (hajmalitë) dhe tiveleja (diçka që bëhej me pretendimin se sillte dashuri) janë shirk.".....62

Atij që shkon te fatthënësi dhe e pyet për diçka, nuk do t'i pranohet namazi dyzet ditë.....64

Ai që betohet në dikë tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër ose shirk."65

“Ai që betohet në amanet, nuk është prej nesh.”67

Betohem në Allahun se, me lejen e Tij, sa herë që betohem për diçka, ndërkohë kuptoj se ka një zgjidhje më të mirë, e shpaguaj betimin tim. Pra, veproj atë që është më e mira, pastaj e shpaguaj betimin.”68

Mos thoni: "Siç dëshiron Allahu dhe siç dëshiron filani!", por thoni: "Siç dëshiron Allahu, pastaj siç dëshiron filani!"70

“Vërtet gjëja që kam më shumë frikë për ju është shirku i vogël.” Të pranishmit i thanë: “Çfarë është shirku i vogël, o i Dërguari i Allahut?” Profeti ﷺ tha: “Syefaqsia72

“Nuk ndodh që dikush ta etiketojë tjetrin si mëkatar e as ta etiketojë me kufër, e kjo të mos i kthehet vetë atij, nëse i etiketuari nuk është i tillë.”74

“Dy gjëra, nëse gjenden ndër njerëz, janë kufër (mosbesim): Fyerja e prejardhjes dhe vajtimi për të vdekurin.”76

Mos u ulni mbi varre e mos u falni në drejtim të tyre! ..77

“Melekët nuk hyjnë në atë shtëpi që ka qen ose piktura (frymorësh).”78

“Melekët nuk e shoqërojnë atë grup të njerëzve që kanë qen apo këmborë80

“Shejtani i shkon ndokujt dhe i thotë: "Kush e ka krijuar këtë? Kush e ka krijuar atë?" Derisa t'i thotë: "Kush e ka krijuar Zotin tënd?" Nëse arrin deri aty, atëherë (njeriu) le të kërkojë mbrojtjen e Allahut dhe le të ndalet së menduari (këto gjëra).”81

Unë i shpall luftë atij që shfaq armiqësi ndaj mikut Tim!
Veprat më të dashura me të cilat më afrohet robi Im, janë
ato të cilat Unë ia kam bërë detyrim atij83

Ju porosis të keni frikë Allahun dhe të jeni të dëgjueshëm
e të bindur, edhe nëse ju bëhet prijës ndonjë rob abisinas.
Pas meje do të shihni kundërshti të shumta, andaj kapuni
fort pas traditës sime dhe traditës së kalifëve të drejtë e të
përdhur.....86

“Kush refuzon t'i bindet prijësit dhe largohet nga
muslimanët e unifikuar (në të vërtetën) e pastaj vdes në
këtë gjendje, vdekja e tij i ngjan vdekjes së periudhës (së
inJORANCËS) paraislame88

Çdo njeriu, të cilin Allahu e ka bërë përgjegjës për një tufë
njerëzish, që vdes duke e mashtruar tufën e vet, Allahu do
t'ia ndalojë Xhenetin.....91

“Do të vijnë prijës të cilët do të veprojnë gjëra të lejuara
dhe të ndaluara, andaj, ai që i dallon ato, i ka ikur mëkatit,
e ai që i kundërshton ato, ka shpëtuar, kurse ai që pajtohet
me to dhe i pason (nuk ka shpëtuar).....92

“Do të përballeni me anashkalim të të drejtave tuaja (nga
prijësit) dhe do të shihni gjëra që nuk do t'ju pëlqejnë.” Të
pranishmit pyetën: "O i Dërguari i Allahut, çfarë po na
porosit, pra?" Ai tha: “T'i kryeni detyrat që ju përkasin dhe
t'i kërkon i Allahut atë që ju takon.”94

Të gjithë ju jeni barinj dhe secili është përgjegjës për tufën
e tij96

O Allah! Ai që merr post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve dhe i mundon ata, mundoje edhe Ti atë! E, ai që merr post udhëheqës për diç nga punët e muslimanëve dhe i trajton me butësi, trajtoje edhe Ti me butësi!98

Feja është sinqeriteti.....99

Kur t'i shohësh ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, këta janë ata të cilët Allahu i ka përmendur. Andaj, ruajuni prej tyre!102

Kushdo prej jush që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij, e, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e, nëse nuk mundet as kështu, atëherë me zemrën e tij, por ky është imani më i dobët106

“Ai që i respekton kufijtë e Allahut dhe ai që i shkel ata i shëmbëlajnë një populli që kanë vënë short për një anije. Njëri grup (sipas shortit) qëndroi sipër (në kuvertë), kurse tjetri poshtë (në hambar)108

“Ai që thërret në udhëzim, do të ketë shpërblim aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre110

Kushdo që udhëzon dikë për një punë të mirë, do ta ketë shpërblimin të njëjtë sikurse ai që e bën atë punë.....112

Pasha Allahun, që Allahu të udhëzojë një njeri nëpërmjet teje është më e mirë për ty sesa të posedosh devetë e kuqe (lloji më i çmueshëm i deveve).”114

Ai që i përngjan një populli është prej tyre117

Njeriu është në fenë e shokut të tij, andaj secili prej jush të shikojë se kë shoqëron! 118

Kjo çështje (fe) do të mbërrijë aty ku ka mbërritur nata dhe dita. Allahu nuk do të lërë shtëpi e tendë pa e futur këtë fe 120

Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se nuk ka njeri nga ky umet, qoftë hebre, qoftë i krishterë, që dëgjon për mua, e pastaj vdes pa besuar shpalljen me të cilën jam dërguar, vetëm se do të jetë banor i Zjarrit..... 122

‘O njerëz, ruhuni nga ekstremizmi në fe, sepse ata që ishin para jush u shkatërruan nga ekstremizmi në fe!’..... 124

Do të shkatërrohen (në botën tjetër) ata që e teprojnë në shtrëngim (të dispozitave të fesë)..... 125

Hebrenjtë janë ata me të cilët Allahu është i zemëruar, ndërsa të krishterët janë të humbur 126

“Allahu i shkroi caktimet për të gjitha krijesat, pesëdhjetë mijë vjet..... 127

se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar, dhe thoshte: “Çdo njeriu i tubohet krijimi në mitrën e nënës së tij për dyzet ditë e dyzet net 129

“Xheneti është më afër jush sesa lidhësja e nallaneve tuaja. Ashtu është edhe Zjarri.” 131

“Zjarri është rrethuar me epshe, kurse Xheneti është rrethuar me vështirësi.” 132

Kur Allahu e krijoi Xhenetin dhe Zjarrin, e dërgoi Xhibrilin (alejhi selam) në Xhenet.....	134
“Zjarri juaj është një e shtatëdhjeta pjesë e zjarrit të Xhehenemit	137
“Allahu do ta kapë Tokën, ndërsa qiejt do t'i palosë me të Djathtën e Tij, pastaj do të thotë: "Unë jam Mbreti! Ku janë mbretërit e Tokës?".....	138
njerëzit që do të kenë dënimin më të ashpër tek Allahu në Ditën e Gjykimit, janë ata që imitojnë krijimin e Allahut	139
“Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se është afruar koha kur Isai, i biri Merjemes, do të zbresë mes jush dhe do të gjykojë me drejtësi: do ta thyejë kryqin, do ta mbysë derrin dhe do ta shfuqizojë xhizjen. Pasuria do të rrjedhë aq shumë, saqë askush nuk do të ketë nevojë për të.”	141
Thuaj: "La ilahe il-lallah, që të dëshmoj për ty në Ditën e Kiametit.....	142
“Gjerësia e Hauzit tim është sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është më e mirë se myshku	144
“Vdekja do të sillet në formë të një dashi laraman	145
Sikur të mbështeteshit tek Allahu denjësisht, do t'ju furnizonte siç i furnizon zogjtë: gdhihen barkzbraur, por kthehen barkplotë	147
“Ndaj dy mirësive shumica e njerëzve janë të shkujdesur: Ndaj shëndetit dhe kohës së lirë.”	149

Ai që është në mjet i jep selam atij që është në këmbë. Ai që është në këmbë i jep selam atij që është ulur. Ata që janë pak i japin selam atyre që janë shumë..... 151

O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë dhe e kam bërë të ndaluar edhe ndërmjet jush, andaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit 153

Ruhuni nga padrejtësia, sepse padrejtësia është errësirë në Ditën e Gjykimit. Ruhuni nga koprracia, sepse koprracia i shkatërroi ata që ishin para jush 157

“Allahu e lë zullumqarin të vazhdojë me zullumin e tij, që, kur ta dënojë, të mos shpëtojë 158

Me të vërtetë, Allahu i ka caktuar veprat e mira dhe të këqijat, pastaj i ka sqaruar. Nëse dikush dëshiron të bëjë ndonjë vepër të mirë, por nuk e bën, Allahu i shkruan një shpërblim të plotë. Mirëpo, nëse dëshiron ta bëjë atë dhe e bën, Allahu ia shkruan dhjetë shpërblime, madje ia shton deri në shtatëqindfish, bile-bile edhe më shumë se kaq. Ndërkaq, nëse dëshiron të kryejë ndonjë vepër të keqe, por nuk e bën, Allahu ia shkruan një shpërblim të plotë. Por, nëse dëshiron ta kryejë atë dhe e kryen, atëherë Allahu ia shkruan vetëm një të keqe 160

Ai që bën mirë në Islam, nuk do të llogaritet për veprat e periudhës paraislame, ndërsa ai që bën keq në Islam, do të llogaritet edhe për të parat, edhe për të fundit.” 162

Ajo që ti e thua dhe në të cilën thërret është gjë e mirë. Sikur të na tregoje se a ka shpagim për veprat tona! ... 163

Në Islam ke hyrë bashkë me veprat e mira të së kaluarës.”	165
“Allahu nuk i pakëson besimtarit asnjë vepër të mirë: për to i jep të mira në këtë botë dhe e shpërblen në botën tjetër	166
O bir i Ademit, sa herë që më lutesh e shpreson tek Unë, do të t'i fal ato që ke bërë dhe s'e kam dert	167
Një njeri bëri një mëkat dhe tha: “O Allah, më fal mëkatin!	170
Nuk ka njeri që bën një mëkat, pastaj ngrihet dhe merr abdes, pastaj fal namaz e i kërkon falje Allahut, përveçse Allahu do ta falë	172
“Allahu i Lartmadhëruar e shtrin Dorën gjatë natës, që të pendohet ai që bën mëkate gjatë ditës, dhe e shtrin Dorën gjatë ditës, që të pendohet ai që bën mëkate gjatë natës, derisa Dielli të lindë nga perëndimi.”	174
Zoti ynë i Lartësuar zbret (ashtu siç i takon madhërisë së Tij) çdo natë, pasi të mbetet e treta e fundit e natës	175
Pa dyshim, hallalli dhe harami janë të qartë	177
“Mos i shani shokët e mi, sepse, edhe nëse ndonjëri prej jush dhuron ar sa mali Uhud, (vlëra e tij), nuk arrin as sa grushtet e tyre (që ata kanë dhuruar), madje as sa gjysma e kësaj.”	179
O djalosh, po të mësoj disa fjalë: “Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut, e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu!	180

më thuaj një fjalë lidhur me Islamin, që, pas teje, nuk do të kem nevojë të pyes askënd." I Dërguari ﷺ tha: "Thuaj: "Besoj në Allahun e pastaj qëndro fuqishëm!182

"Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën e në solidarizimin ndërmjet tyre i ngjan një trupi të vetëm, aq sa kur vuan një gjymtyrë e tij, atëherë i gjithë trupi ndan me të pagjumësinë dhe ethet."184

Atij që merr abdes dhe e përsos atë, mëkatet do t'i dalin prej trupit të tij, saqë i dalin edhe ato nën thonjtë e tij.185

Uji i detit është pastrues dhe e ngordhura e tij është e lejueshme.....186

Nëse uji është dy fuçi, nuk mban papastërti.....188

"Kur të shkoni për të kryer nevojën fiziologjike, as mos u drejtoni nga kibla, as mos ia ktheni shpinën, por kthehuni nga lindja ose nga perëndimi!"189

"Mos e mbani me dorën e djathtë organin gjenital gjatë urinimit e as mos u pastroni nga jashtëqitja me dorën e djathtë, si dhe mos merrni frymë në enë (gjatë pirjes në të)!"190

"Kur dikush zgjohet nga gjumi, le t'i shpërlajë hundët tri herë, ngase shejtani futet në zgavrat e hundës së tij."..192

Profeti ﷺ merrte abdes me një palë grushte me ujë dhe lahej me një saë, deri në pesë palë grushte me ujë.....193

Allahu nuk e pranon namazin e asnjërit prej jush, nëse e ka prishur abdesin, derisa të marrë sërish195

se një burrë mori abdes dhe e la një pjesë në këmbën e tij sa një thua pa e larë. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e pa dhe i tha: "Kthehu dhe merr abdes mirë!" Ai e përmirësoi abdesin dhe pastaj u fal	196
“Mjerë thembrat (që do të preken) nga Zjarri! Përsoseni abdesin.”	198
Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz	200
Profeti ﷺ mori abdes duke i larë gjymtyrët vetëm nga një herë	201
Profeti ﷺ mori abdes duke i larë gjymtyrët nga dy herë	202
Atij që merr abdes sikurse ky abdes imi dhe i fal dy rekate, pa u shpërqendruar, do t'i falen mëkatet e së kaluarës .	203
“Ai që merr abdes, le ta futë ujin në hundë dhe le t'i fryjë, ndërsa ai që pastrohet me gurë nga jashtëqitja, le ta bëjë në numër tek	206
Këta dy po dënohen, por nuk po dënohen për ndonjë mëkat të madh (sipas tyre). Njëri prej tyre nuk ruhej nga stërpikat e urinës, kurse tjetri bartte fjalë.....	208
Para se Profeti ﷺ të hynte në nevojtores, thoshte: “Allahume inni eudhu bike minel-hubuthi vel-habaith! - O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde kundrejt të këqijve dhe të këqijave (shejtanëve meshkuj dhe femra)!.....	209
se Profeti ﷺ, kur dilte nga nevojtorja, thoshte: "Gufraneke - Kërkoj faljen Tënde (o Allah)!.....	210
Misvaku e pastron gojën dhe e kënaq Zotin	211

“Kur Profeti ﷺ ngrihej për namaz nate, e pastronte gojën me misvak.”	212
“Sikur të mos më dukej e rëndë për besimtarët, - Zuhejri thotë: për umetin tim, - do t'i urdhëroja ta përdorin misvakun për çdo namaz.”	214
“Secili musliman e ka për detyrë që të lahet (të paktën) një herë në çdo të shtatën ditë, kur dhe lan kokën dhe trupin.”	215
“Natyrrshmëria është në pesë: synetimin, rruajtjen e qimeve (në vendet e turpshme), shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve dhe shkëlqimin e qimeve të nënsqetullave	217
Shpesh më rridhte lëngu paraspermal, por, për shkak të raportit me të bijën e tij, kisha turp ta pyesja Profetin ﷺ për këtë, andaj e porosita Mikdad ibn Esvedin ta pyeste. Profeti ﷺ iu përgjigj: “Vetëm e pastron organin gjenital dhe merr abdes.”	218
Kur i Dërguari i Allahut ﷺ pastrohej nga xhunubllëku, së pari fillonte me duart, pastaj merrte abdes sikurse për namaz, pastaj lahej	220
Të mjaftonte të bëje me duart a tua kështu; mandej ai i përplasi duart e tij në tokë një herë dhe fërkoji shuplakën e djathtë me të majtën dhe pjesën e sipërme të duarve dhe fytyrën	222
Lëri, se i kam mbathur duke qenë me abdes	223

Jo, ajo që po të ndodh ty është gjakrrjedhje e çrregullt. Lëre namazin aq ditë sa të janë paraqitur menstruacionet më parë, pastaj laju dhe falu.”225

“Nëse dikush ndien diç (gazra) në bark, gjë që i ngjall dyshime nëse ka lëshuar ndonjë gaz apo jo, assesi të mos dalë nga xhamia pa dëgjuar zë ose pa ndier erë.”227

Nëse qeni pi në enën e ndokujt, le ta lajë atë shtatë herë.”228

“Kur myezini thotë: "Allahu ekber, Allahu ekber!" dhe ai që e dëgjon e përsërit: "Allahu ekber, Allahu ekber.....230

“Kur të dëgjon myezinin, përsëritni fjalët që i thotë e pastaj dërgoni salavate për mua232

I falen mëkatet atij njeriu i cili i thotë këto fjalë kur dëgjon muezinin: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i vetëm dhe nuk ka ortak dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Jam i kënaqur me Allahun si Zot dhe me Muhamedin si Pejgamber dhe me Islamin si fe234

“Ai që, pasi ta dëgjojë ezanin, thotë: “Allahumme rabbe hadhihi davetit-tammeti ves-salatil kaimeti, ati Muhammedenil vesilete vel fadilete, veb athhu mekamen mahmudenil-ledhi veadtehu. (O Allah, Zot i kësaj thirrjeje të përsosur dhe këtij namazi që po falet, jepja Muhamedit ndërmjetësimin dhe mirësinë. Ngrije në pozitën e lartë, - Mekami Mahmud, - të cilën ia ke premtuar), e meriton ndërmjetësimin tim Ditën e Kiametit.”236

Lutja që bëhet në mes të ezanit dhe të ikametit nuk refuzohet.....	238
A e dëgjon ezanin për namaz?” Ai iu përgjigj: “Po.” Profeti ﷺ i tha: “Përgjigjju, pra!”	240
“Çfarë mendoni sikur para portës së ndonjërit prej jush të ishte një lumë ku ai lahej pesë herë në ditë, a do të mbetej papastërti në trupin e tij?!”.....	241
Cila vepër është më e dashur tek Allahu? - “Namazi që falet në kohën e vet”, - u përgjigj ai. - Pastaj cila? - “Mirësjellja me prindërit”, - tha Profeti ﷺ. - Pastaj cila? - “Lufta në rrugën e Allahut.”	242
Cilido musliman, që kur hyn koha e namazit obligativ, merr abdes me përpikëri dhe i kryen veprimet e namazit me kujdes dhe përpikësi, ky namaz do të jetë shlyerje për mëkatet e tij të kaluara, për sa kohë që ai nuk kryen ndonjë mëkat të madh. Dhe kjo mirësi është për gjatë gjithë kohës	244
“Pesë namazet ditore, namazi i xhumasë deri në namazin e xhumasë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër janë falje për gjynahet e bëra mes tyre, nëse njeriu ruhet prej gjynaheve të mëdha.”	245
“Urdhërojeni fëmijët tuaj të falen që në moshën shtatë vjeçe e dispiplinojeni ata nëse nuk falen në moshën dhjetë vjeçe dhe ndajini në shtretër të veçantë.”	247
“Allahu i Lartësuar ka thënë: "Fatihanë e kam ndarë përgjysmë mes Meje dhe robit Tim, e robit Tim i takon ajo që e kërkon	248

Besëlidhja ndërmjet nesh dhe atyre është namazi. Andaj, ai që e lë namazin, ka rënë në kufër (mosbesim)	251
Vërtet ndërmjet njeriut dhe shirkut e kufrit qëndron lënia e namazit.....	252
O Bilal! Thirre ikametin (për namaz) dhe na qetëso me të!	253
Allahume baid bejni ue bejne hatajaje kema ba'adte bejnel meshriki uel magribi.....	254
kur i Dërguari i Allahut ﷺ e fillonte namazin, i ngrinte duart paralelisht me supet.....	256
Nuk ka namaz ai që nuk këndon Hyrjen e Kuranit (suren el-fatiha)	258
Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se nga të gjithë ju namazi im më së shumti i ngjason namazit të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Kështu falej derisa u nda nga kjo botë	259
Jam urdhëruar të bëj sexhden me shtatë gjymtyrë	261
Zoti është më afër robit në mes të natës	262
Do ta shihni Zotin tuaj, ashtu siç po e shihni Hënën: pa asnjë vështirësi	264
i Dërguari i Allahut ﷺ i lexoi në dy rekatet sunet të sabahut suret: Kafirun dhe Ihlas.”	265
“Ai që i fal dy namazet e freskëta (sabahun dhe ikindinë), do të hyjë në Xhenet.”	266
“Ai që e fal namazin e sabahut është në besë të Allahut	268

Atij që e lë namazin e ikindisë, i shkatërrohet puna	269
“Nëse dikush harron ndonjë namaz, le ta falë kur t'i kujtohet. Nuk ka shpagim tjetër, përveçse ta falë atë...	270
Namazi më i rëndë për hipokritët është namazi i jaciesë dhe i sabahut. Sikur ta dinin se çfarë (shpërblimi) ka në to, do të vinin, qoftë dhe zvarrë.....	271
Kur i Dërguari i Allahut ﷺ ngrihej nga rukuja, thoshte: “Semiallahu limen hamideh	273
se Profeti ﷺ ndërmjet dy sexhdeve thoshte: "Rabbigfirlij, rabbigfirlij!	275
Profeti ﷺ midis dy sexhdeve thoshte: "O Allah, më fal, më mëshiro, më jep shëndet, më udhëzo dhe më furnizo! .	276
“Kur të faleni, drejtojini safat dhe le t'ju prijë dikush nga ju. Kur të marrë tekbir, merrni edhe ju.....	277
I Dërguari i Allahut ﷺ ma mësoi teshehudin ashtu siç më mësonte ndonjë sure Kurani	282
O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi në varr dhe dënimi në Zjarr! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga sprova e jetës dhe e vdekjes, si dhe nga sprova e mesihut Dexhall!	285
“Bëj sa më shumë sexhde për Allahun, ngase për çdo sexhde që ia bën Allahut, Ai të ngre një shkallë dhe të fshin një mëkat.”	287
Nuk ka namaz kur shtrohet ushqimi e as nën presionin e nevojave fiziologjike	288

Ai është një shejtan që quhet Hinzeb. Kur ta vësh praninë e tij, kërko mbrojtjen e Allahut kundrejt tij dhe pështyj tri herë lehtë nga ana jote e majtë!.....289

“Personi më i keq vjedhës është ai që vjedh në namazin e tij.” I tha: "Si mund ta vjedhë namazin?" Profeti ﷺ ia ktheu: “Nuk e plotëson as sexhden e as rukunë.”291

Si nuk ka frikë ai që e ngre kokën para imamit se Allahu mund t'ia shndërrojë kokën në kokë gomari?” - Ose ka thënë: “... se Allahu mund t'ia shndërrojë pamjen në pamje gomari?”292

“Kur dikush ka dyshime në namaz dhe nuk di sa rekate i ka falur, tri apo katër, le ta shpërfillë dyshimin dhe le të mbështetet në atë që është i sigurt. Pastaj le t'i bëjë dy sexhde para se të japë selam.....293

i Dërguari i Allahut ﷺ pa një burrë, duke u falur vetëm prapa safit (rreshtit), dhe e urdhëroi atë që ta përsëriste namazin295

një njeri u përmend në prani të Profetit ﷺ, për të cilin u tha se ka fjetur tërë natën deri në mëngjes, e nuk është ngritur për namaz. Atëherë Profeti ﷺ tha: “Shejtani ka urinuar në dy veshët e tij, - ose ka thënë: në veshin e tij.”297

“Dita e premte është dita më e mirë në të cilën ka lindur Dielli298

“Ai që pastrohet ditën e premte, ashtu siç pastrohet prej xhunubllëkut dhe shkon në xhami, konsiderohet sikurse të ketë bërë kurban një deve.....300

O Allah! Ti je Paqedhënësi dhe vetëm prej Teje pres paqen! Ti je përgjithmonë i Begatshëm, o Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit!303

I Dërguari i Allahut ﷺ e madhëronte Allahun me këto fjalë pas çdo namazi (farz)304

i Dërguari i Allahut ﷺ e përfundonte namazin e detyrueshëm, thoshte307

“Ai që pas çdo namazi e lartëson Allahun (thotë subhanallah) tridhjetë e tri herë, e falënderon Allahun (thotë elhamdulilah) tridhjetë e tri herë dhe e madhëron Allahun (thotë Allahu ekber) tridhjetë e tri herë, që të gjitha bëhen nëntëdhjetë e nëntë, dhe të njëqindtën e plotëson duke thënë: "La ilahe il-lallahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul-li shej'in kadir (S'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdi, Ai ka fuqi për çdo gjë), do t'i falen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit.”308

“Atë që e lexon Ajetin Kursij pas çdo namazi obligativ, nuk e pengon të hyjë në Xhenet asgjë përveç vdekjes.”310

Nga Profeti ﷺ mbaj në mend dhjetë rekate (vullnetare)312

Profeti ﷺ asnjëherë nuk i linte katër rekate para drekës dhe dy para sabahut313

“Mes dy ezaneve (ezanit dhe ikametit) ka namaz. Mes dy ezaneve ka namaz.” - Pastaj, herën e tretë, tha: - “Për atë që dëshiron.”314
 “Kur ndonjëri prej jush hyn në xhami, le t'i falë dy rekate para se të ulet.”315
 Nëse në ditën e premte, teksa imami është duke ligjësuar, i thua shokut tënd: "Hesht!", veçse e ke humbur shpërblimin.....316
 Falu në këmbë. Nëse nuk mundesh, falu ulur. Nëse nuk mundesh, falu shtrirë317
 “Një namaz në këtë xhaminë time është më i vlefshëm sesa një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç në Xhaminë e Shenjtë (Qabe).”318
 Atij që ndërton një xhami për hir të Allahut, Allahu i ndërton një të tillë në Xhenet.”319
 “Pronarit të arit dhe argjendit, që nuk e jep hakun e tyre (zekatin), kur të bëhet Dita e Kiametit ato do t'i shndërrohen në pllaka prej Zjarri321
 Sadakaja (lëmosha) nuk e pakëson pasurinë. Robit i cili fal, Allahu i shton krenari dhe Ai do të lartësojë këdo që bëhet modest për hir të Allahut328
 “Allahu thotë: "Jep, o biri i Ademit, të të jap329
 “Nëse njeriu (musliman) shpenzon për familjen e tij, duke llogaritur në shpërblimin (e Allahut), atëherë kjo i shkruhet sadaka (lëmoshë).”331

“Kur të vdesë njeriu, i ndërpriten (shpërblimet për) veprat, përveç tri veprave: lëmoshës rrjedhëse, dijes prej së cilës kanë dobi (njerëzit) dhe fëmijës së mirë që lutet për të.”

.....332

“Këmbimi i argjendit me ar konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë; këmbimi i grurit me grurë konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë; këmbimi i elbit me elb konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehet dorë me dorë dhe këmbimi i hurmave me hurma konsiderohet kamatë, përveç nëse këmbehen dorë me dorë.”

334

“I Dërguari i Allahut ﷺ e ka obliguar sadakanë e fitrit: një saë me hurma ose elb, për muslimanin, qoftë rob a i lirë, mashkull a femër, i vogël a i madh, si dhe ka urdhëruar që të jepet para se njerëzit të dalin për namaz (të Bajramit).”

.....337

“O ju njerëz, përhapeni selamin (përshëndetjen islame mes jush), ushqeni të tjerët, mbani lidhjet farefisnore dhe faluni natën kur njerëzit janë në gjumë do të hyni në Xhenet të qetë.....

339

“O ju njerëz, Allahu është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Allahu i urdhëroi besimtarët për atë që i urdhëroi pejgamberët

341

Atë që e afatizon borxhliun ose ia fal, Allahu do ta strehojë nën hijen e Arshit (Fronit) të Tij në Ditën e Kiametit, atë Ditë kur s'do të ketë hije tjetër pos kësaj hijeje.....

344

“Allahu e mëshiroftë atë burrë që tregon tolerancë e mirësjellje kur shet e blen, si dhe kur e merr borxhin e dhënë!”345

“Një burrë u jepte borxh njerëzve dhe i thoshte shërbëtorit të vet: "Kur të shkosh te ndonjë huamarrës, toleroje, me shpresë që edhe Allahu të na tolerojë ne346

“Disa njerëz po zhyten në pasurinë e Allahut padrejtësisht. Ditën e Kiametit, të tillët i pret Zjarri.”348

“Allahu thotë: "Çdo vepër e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të349

Atij që agjëron Ramazanin duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës.”.353

“Kush harron se është agjërueshëm, pastaj ha ose pi, le ta plotësojë agjërimin, se Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë.”354

“Profeti ﷺ hynte në itikaf në dhjetëshen e fundit të Ramazanit derisa vdiq. Pastaj gratë e tij vazhduan të hyjnë në itikaf pas tij.”355

I Dërguari i Allahut ﷺ angazhohej me (adhurim) në dhjetëshen e fundit (të Ramazanit), aq sa nuk angazhohej jashtë tyre356

“Kur hynte dhjetëshja (e fundit e Ramazanit), i Dërguari i Allahut ﷺ e gjallëronte natën (me adhurim), e zgjonte familjen e tij, e shtonte angazhimin dhe i shtrëngonte rrobat (veçohet me adhurime dhe nuk u afrohet grave).”357

“Atij që agjëron një ditë në rrugën e Allahut, Allahu do t’ia largojë fytyrën nga Zjarri për shtatëdhjetë vjet (vjeshta).”359

I dashuri im ﷺ më ka porositur me tri gjëra: Agjërimin e tri ditëve të çdo muaji, faljen e dy rekateve të duhasë dhe faljen e vitrit para gjumit.....361

“Hani syfyr, sepse në syfyr ka bereqet.”363

“Në namazin e Bajramit isha i pranishëm tek Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili tha: “I Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar agjërimin e këtyre dy ditëve: ditën kur e përfundoni agjërimin tuaj (dita e Bajramit të Fitrit) dhe ditën kur hani prej kurbaneve (dita e Bajramit të Kurbanit).”364

“Atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës.”.366

“Ai që e kryen haxhillëkun në Qabe, duke u larguar nga çdo veprim intim bashkëshortor dhe pa mëkatuar, kthehet sikurse ditën që e ka lindur nëna.”367

telbija e të Dërguarit të Allahut ﷺ ka qenë kësisoj: “Lebbejke Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, inne-l-hamde ven-ni‘mete leke vel-mulk, la sherike lek. (Të përgjigjem, o Allah, vetëm Ty të përgjigjem! Të përgjigjem Ty, që nuk ke ortak, të përgjigjem! Vetëm Ty të takon lavdfalëndrimi, mirësia dhe sundimi, Ti nuk ke ortak)!”368

Nuk ka ditë ku veprat e mira janë më të dashura për Allahun sesa këto dhjetë ditë (të dhul hixhes)371

“Luftoni kundër idhujtarëve me pasuritë, shpirtrat tuaj dhe me gjuhët tuaja.”.....372

Lëre atë që të ngjall dyshim dhe kapu pas asaj që nuk të ngjall dyshim, sepse e vërteta sjell qetësi, ndërsa gënjeshttra sjell pasiguri.....374

“Vërtet Allahu umetit tim nuk ia merr në konsideratë ato që u vërtiten në mendje, për sa kohë që nuk i punojnë e nuk i shqiptojnë.”375

Me të vërtetë, Allahu nuk i shikon pamjet dhe pasuritë tuaja, por i shikon zemrat dhe veprat tuaja377

“Allahu bëhet xheloz (siç përkon me madhështinë e Tij), e edhe besimtari bëhet xheloz. Xhelozia e Allahut është kur besimtari i shkel gjërat që Allahu ia ka ndaluar.”378

“Largohuni nga shtatë mëkatet shkatërruese.....379

“A doni t’ju tregoj për më të mëdhatë e mëkateve të mëdha?.....381

Gjynahet e mëdha janë: t’i bëhet shirk Allahut, mosrespektimi i prindërve, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm.....384

Gjëra e parë që do të gjykohet mes njerëzve në Ditën e Kiametit janë gjaqet385

Ai që vret një person që është në besë (të ndonjë muslimani), nuk do ta ndiejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij ndihet dyzet vjet larg.....386

“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që i shkëput (lidhjet farefisnore).”.....388

Ai që dëshiron t'i shtohet rizku dhe t'i zgjatet jeta, le t'i mbajë lidhjet farefisnore.....	389
“Ai që viziton vetëm pasi të vizitohet nuk quhet mbajtës i lidhjeve, por mbajtës i lidhjeve është ai që i mban lidhjet me farefisnin, edhe kur ata i shkëpusin.”	390
“A e dini çfarë është përgojimi?” Ata thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Profeti ﷺ tha: “Të përmendësh për vëllanë tënd atë që ai e urren.”	391
“Çdo pije dehëse është alkool dhe çdo pije dehëse është haram. Ai që pi alkool në këtë botë dhe vdes duke qenë i varur prej tij e nuk është penduar, nuk do ta pijë në botën tjetër	393
I Dërguari i Allahut ﷺ e mallkoi atë që jep ryshfet dhe atë që merr ryshfet për të ndikuar në ndonjë vendim të caktuar	394
“Mos kini zili ndaj njëri-tjetrit, mos e mashtroni njëri-tjetrin, mos e urreni njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos ndërhyjni në shitblerjen e njëri-tjetrit. Bëhuni robër të Allahut, vëllezër të vërtetë.....	396
“Ruajuni nga paragjykimet, sepse paragjykimet janë gënjeshtër më të mëdha!.....	400
Nuk do të hyjë në Xhenet bartësi i fjalëve	402
I gjithë umeti im është i falur, përveç atyre që i publikojnë mëkatet e tyre!	403
O njerëz, Allahu jua ka larguar mburrjen me xhahilietin (periudhën paraislame) dhe lavdërimin me baballarët e tij	405

“Burri më i urryer tek Allahu është kundërshtari i
 përbetuar.”407

“Kur dy muslimanë ndeshen me shpatat e tyre, vrasësi dhe
 i vrari do të jenë në Zjarr.....408

“Ai që ngre armët kundër nesh nuk është prej nesh.”..410

Mos i shani të vdekurit, sepse ata kanë arritur te veprat që
 kanë punuar!411

Njeriut nuk i lejohet të mos i flasë vëllait të vet më shumë
 se tri net. Kur ata dy takohen, ky ia kthen shpinën, e edhe
 ai i tjetri ia kthen. Më i miri prej tyre është ai që fillon me
 selam.....412

“Atij që ma garanton atë që është mes dy nofullave dhe atë
 që është mes dy këmbëve, ia garantoj Xhenetin.”413

Femra nuk duhet të ndërmarrë udhëtim dyditor pa burrin
 e saj apo pa një mashkull të familjes.....415

Nuk kam lënë pas meje ndonjë sprovë më të dëmshme për
 burrat sesa gratë.....418

“Ai që i ka mundësitë, le të martohet, sepse e ka më të
 lehtë uljen e shikimit dhe ruajtjen e nderit. Ndërkaq, ai që
 nuk i ka mundësitë, le të agjërojë, sepse agjërimi ia shuan
 epshin.”.....419

“Kjo botë është e ëmbël dhe e bukur. Allahu do t’ju bëjë
 zëvendës në Tokë, që t’ju shohë se si do të veproni, andaj
 ruajuni nga mashtrimet e saj dhe ruajuni nga gratë420

ka thënë: "O i Dërguar i Allahut, cila është e drejta e gruas
 ndaj burrit të saj?" Ai tha: “Ta ushqesh kur ushqesh vetë,

ta veshësh kur vesh veten ose kur fiton të ardhura, mos ta godasësh në fytyrë, mos e fyej dhe mos e lër (në shpërfillje), përveçse brenda në shtëpi.”422

“O ju gra! Jepni lëmoshë, sepse (natën që jam ngritur në qiell) kam parë që ju jeni banoret më të shumta të Zjarrit.” Ato e pyetën: “Përse, o i Dërguari i Allahut?” Profeti ﷺ u tha: “Mallkoni shpesh dhe e përbuzni mirësinë (e bashkëshortit ose të dikujt të tillë). Nuk kam parë të mangëta në mendje dhe fe, e që ia turbullojnë mendjen burrit të matur më shumë se ju (gratë).”424

“Kujdes! Mos hyni te gratë.” Një ensar tha: "O i Dërguari i Allahut, e nëse është kunati?" - “Kunati është sikurse vdekja”, - i tha Profeti ﷺ429

Nuk ka martesë, përveçse me kujdestar431

Çdo grua që martohet pa lejen e kujdestarëve të saj, martesa e saj është e pavlefshme - tri herë (e përsëriti këtë). E nëse ai ka kryer marrëdhënie me të, ajo ka të drejtë për mehrin, në këmbim të marrëdhënive intime që ka pasur me të. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje mes tyre, atëherë sundimtari është kujdestari i asaj që nuk ka kujdestar.432

Është i mallkuar ai që kryen marrëdhënie anale me gruan e tij436

Ndër kushtet që më së shumti meritojnë t'i përmbushni janë ato përmes të cilave ju lejohet afrimi me gratë tuaja437

Dynjaja është një pasuri (kënaqësi) e përkohshme, ndërsa kënaqësia më e mirë e dynjasë është gruaja e devotshme.”438

E kam pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ (a bëj mëkat) në lidhje me shikimin e paqëllimshëm (në femrën e ndaluar), e ai më urdhëroi që ta ndal shikimin e të mos e vazhdoj atë439

Profeti ﷺ i theri dy desh të larmë e me brirë. Që të dy i theri me dorën e vet, duke thënë: "Bismilah (me emrin e Allahut)" e duke bërë tekbir (duke thënë: "Allahu ekber") dhe duke ua vendosur këmbën në faqe441

“Mos vishni mëndafsh e as veshje të përziera me mëndafsh, mos pini në enë prej ari e argjendi dhe mos hani në enë të tilla, sepse ato janë për ta (jobesimtarët) në dynja, kurse për ne në ahiret!”443

“Lapsi (për shkrimin e mëkateve) është pezulluar për tre persona: për atë që është në gjumë, derisa të zgjohet; për fëmijën, derisa të hyjë në moshën e pubertetit dhe për të çmendurin, derisa t'i kthehet mendja.”445

i Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar rruajtjen e pjesërishme të kokës (kazea)447

“Betimi (në tregti) mundëson shitjen e produktit, por e zhduk bereqetin.”448

Shkurtojini mustaqet dhe lëshojini mjekrat!450

Burri nuk duhet t'i shikojë pjesët intime të një burri tjetër, e as gruaja nuk duhet t'i shikojë pjesët intime të një gruaje tjetër450

Më i miri prej jush është ai që e ka sjelljen më të mirë.”	
.....	452
Vërtet besimtari përmes sjelljes së mirë i arrin shkallët e agjëruesit dhe të atij që falet natën (në vazhdimësi)	454
Besimtari me besimin më të plotë është ai që ka moral më të mirë. Më të zgjedhurit prej jush janë ata që janë më të mirët me gratë e tyre.....	455
se i Dërguari i Allahut ﷺ është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë.....	456
I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu me moralin më të mirë	
.....	458
Morali i Profetit të Allahut ﷺ ishte Kurani	459
Profetit ﷺ, gjatë mbathjes së sandaleve, krehjes së flokëve, pastrimit dhe çdo pune tjetër, i pëlqente të fillonte nga ana e djathtë	460
Me të vërtetë, Allahu ka urdhëruar mirësinë në çdo çështje	
.....	462
“Prijësit e drejtë tek Allahu do të jenë në podiume drite, në të djathtën e Rrahmanit (Allahut) të Lartësuar, e që të dyja Duart e Tij i ka të djathta.....	464
S'ka dëm e as dëmtim. Atë që e dëmton (ndonjë besimtar), Allahu do ta dëmtojë, ndërsa atij që ia vështirëson (ndonjë besimtari), Allahu do t'ia vështirësojë	465

“Shoku i mirë dhe shoku i keq i shëmbëllezin shitësit të parfumit dhe farkëtarit që i fryn gjyrykut	467
Mos u zemëro!	468
“Nuk quhet i fortë ai që triumfon mbi të tjerët, por, në të vërtetë, i fortë është ai që përmbahet kur është i zemëruar.”	469
“Ai që i ka këto katër tipare është hipokrit i kulluar. Ndërkaq, ai që ka vetëm njërin prej tyre, ka një prej tipareve të hipokrizisë, derisa ta braktisë atë. Ato janë: kur flet, gënjen; kur bën marrëveshje, tradhton; kur premtim, nuk e mban premtimin, si dhe kur polemizon, bëhet i pasjellshëm	471
“Besimtari nuk është fyes e as mallkues i madh, as i pandershëm e as fjalëndyrë.”	474
Turpi është prej besimit.....	475
Kur njeriu ta dojë vëllanë e tij (musliman), le ta lajmërojë se e do	476
Çdo vepër e mirë është sadaka (lëmoshë)	477
“Për çdo ditë që lind Dielli, njeriu duhet të japë sadaka (lëmoshë) për secilën nyjë të trupit	478
“Atij që i largon besimtarit një brengë të kësaj bote, Allahu do t'i largojë një brengë të Ditës së Kiametit	481
Këmbët e njeriut nuk do të lëvizin në Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për jetën e tij si e kaloi, për dijen e tij sa e zbatoi, për pasurinë e tij si e fitoi dhe si e shpenzoi dhe për trupin e tij si e konsumoi	485

“Ai që kujdeset për vejushën dhe për nevojtarin është sikurse ai që lufton në rrugën e Allahut, ose sikurse ai që falet natën dhe agjëron ditën.”486

“Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë487

Assesi mos nënvlerëso asnjë gjë, edhe po e takove vëllanë tënd me fytyrë të buzëqeshur489

“Kapuni fort për çiltërsinë, sepse çiltërsia shpie në mirësi, ndërsa mirësia shpie në Xhenet.....490

Atë që nuk i mëshiron njerëzit, Allahu nuk e mëshiron492

Të mëshirshmit do t'i mëshirojë i Gjithëmëshirshmi. Mëshirojini banorët e Tokës, që t'ju mëshirojë Ai që është mbi qiell.....493

Muslimani (i vërtetë) është ai nga gjuha dhe dora e të cilit muslimanët janë të sigurt dhe mërgimtar (i vërtetë) është ai i cili i braktis gjërat që Allahu i ka ndaluar494

Detyrat e muslimanit ndaj muslimanit janë pesë: kthimi i selamit, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes, përgjigjja ndaj ftesës dhe lutja për atë që teshtin496

“Nuk keni për të hyrë në Xhenet derisa të besoni, e nuk keni për të besuar derisa të duheni mes vete. A t'ju tregoj për një gjë që, nëse e bëni, do të duheni ndërmjet vete? Përhapeni selamin në mesin tuaj!”497

një burrë e pyeti Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!): "Cila cilësi e Islamit është më e mira?" Ai u përgjigj: "Të japësh

ushqim dhe të përshëndesësh me selam ata që i njeh dhe ata që nuk i njeh.....	499
“A doni t'ju tregoj për një gjë, me të cilën Allahu jua fshin mëkatet dhe jua lartëson gradat?	500
“Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët, e megjithatë të dy kanë mirësi	503
“Afrojuni përsosmërisë dhe jini mesatarë! Dijeni se asnjëri prej jush nuk do të shpëtojë (nga Zjarri) me veprat e tij. - O i Dërguari i Allahut, as ti?! - e pyetën të pranishmit. - “As unë, përveç nëse Allahu më përfshin me mëshirën dhe mirësinë e Tij, - tha Profeti ﷺ.....	505
“Xhibrili ﷺ vazhdimisht më porosiste për raporte të mira me fqinjin, saqë mendova se do t'i japë të drejtë në trashëgimi.”	509
Atij që e mbron nderin e vëllait të vet, Allahu do t'ia mbrojë fytyrën nga Zjarri në Ditën e Kiametit	510
“Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e vet atë që e do për veten e tij.”	511
Çdo gjë që shoqërohet nga butësia, zbukurohet, e çdo gjë që zhvishet nga butësia, shëmtohet	513
“Feja është e lehtë, kështu që këdo që mbingarkon vetveten në fenë e tij, feja do ta mundë. Andaj, jini mesatarë, afrojni përsosurisë dhe përgëzohuni (për shpërblimin që ju pret)	514
Lehtësoni e mos vështirësoni, jepni lajme të mira e mos largoni!	517

Teksa ishim te Omeri, ai na tha: "Na është ndaluar teprimi	519
Kur ndonjëri prej jush dëshiron të hajë, le të hajë me dorën e djathtë, e, kur të pijë, le të pijë me dorën e djathtë, sepse shejtani ha me dorën e majtë dhe pi me dorën e majtë	520
O djalosh! Thuaj: "Bismilah", ha me të djathtën dhe ha pranë vetes!.....	521
Vërtet Allahu kënaqet me robin që ha një kafshatë dhe e falënderon Atë për të dhe pi një gllënjë dhe e falënderon Atë për të	522
Njëherë, një person hëngri me dorën e majtë në prani të të Dërguarit të Allahut ﷺ, e ai i tha: - “Ha me të djathtën!” - Nuk mundem, - ia ktheu ai. - “Mos mundsh!”.....	524
“Ai që ha hudhër ose qepë, të mos na afrohet, - ose ka thënë: të mos i afrohet xhamisë sonë, por le të qëndrojë në shtëpinë e vet.”	525
“Atij që ha ushqim dhe thotë: "Lavdia i takon Allahut, i Cili ma mundësoi ta ha këtë ushqim dhe më furnizoi pa mundin dhe fuqinë time", do t'i falen mëkatet e mëparshme.”.....	528
se, sa herë që teshtinte i Dërguari i Allahut ﷺ, vendoste në gojën e tij dorën ose rrobën, me to e zvogëlonte ose e ulte zërin	529
Vërtet Allahu do që të shfrytëzohen lehtësimet e Tij, ashtu siç do që të plotësohen obligimet e Tij.....	530
Atë të cilit Allahu i do mirësi, e sprovon	531

Çdo fatkeqësi që mund ta godasë muslimanin, qoftë lodhje e sëmundje, qoftë brengë e pikëllim, qoftë shqetësim e mërzi, madje dhe një shpim gjembi, përmes saj Allahu do t'ia fshijë disa gjynahe	532
Sprova vazhdon ta godasë besimtarin dhe besimtaren në vetet e tyre, fëmijët dhe pasurinë derisa ta takojnë Allahun dhe të mos kenë mëkate fare	533
“Sa e çuditshme që është çështja e besimtarit: gjithçka që e godet atë, është në të mirën e tij dhe kjo nuk është për askënd përveç besimtarit	535
“Kur robi sëmuret ose udhëton, shpërblimi i shkruhet njësoj siç ka punuar sa ka qenë vendas dhe i shëndoshë.”	537
“Shpejtoni në kryerjen e veprave të mira para se të vijnë sprova si copëzat e natës së errët.....	538
“Atij që Allahu ia do të mirën, ia mundëson kuptimin e fesë.....	540
Allahu e ndriçoftë një njeri që dëgjon prej nesh diçka dhe e përcjell ashtu siç e ka dëgjuar, sepse ndodh, që ai të cilit i përcillet, të jetë më i kuptueshëm se ai që e ka dëgjuar	541
Mos kërmoni dituri për t'u mburrur para dijetarëve, as për të diskutuar me mendjelehtët.....	543
Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve.....	545

ata i mësonin dhjetë ajete nga Profeti ﷺ dhe nuk i mësonin dhjetë ajete të tjera pa e mësuar dijen dhe veprimin që përmbanin ato546

“Ai që lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, ka një shpërblim, i cili shtohet dhjetëfish547

Lexuesit të Kuranit do t’i thuhet (në Ditën e Gjykimit): "Lexo dhe ngrihu (shkallëve të Xhenetit), lexo drejt dhe bukur, siç ke lexuar në dynja, se vendi yt është në ajetin e fundit që e lexon.”548

“A dëshiron dikush nga ju që, kur të kthehet te familja e vet, të gjejë tri deve me barrë, të mëdha e të shëndosha?549

“Përsëriteni Kuranin vazhdimisht, sepse betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se ai ikën më shpejt se deveja kur zgjidhet nga litari.”550

“Shtëpitë tuaja mos i bëni varreza, se shejtani ikën prej shtëpisë në të cilën lexohet surja el Bekare.”551

O Ebu Mundhir, a e di se cili është ajeti më i madh (më me vlerë) në Librin e Allahut, që e ke me vete?” - më pyeti sërish. - “Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!” (El Bekare, 255) - i thashë. Atëherë me goditi në gjoks dhe më tha: “Për Allahun, e gëzofsh dijen, o Ebu Mundhir!” ..553

Atij që i lexon dy ajetet e fundit të sures el Bekare gjatë natës, do t’i mjaftojnë554

“Ai që i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të jetë i mbrojtur nga (sprova e) Dexhallit.” .555

Lutja është vetë adhurimi	557
Profeti ﷺ e përmendte Allahun në çdo gjendje	559
Nuk ka asgjë më fisnike për Allahun sesa lutja	560
Asnjë musliman nuk i lutet Allahut me një lutje që nuk përfshin mëkat apo këputje të lidhjeve farefisnore, veçse Allahu do t'i japë një nga këto tre: ose do t'ia pranojë lutjen shpejt, ose do ta ruajë për të në botën tjetër, ose do t'i largojë prej tij një të keqe të barabartë me të." Të pranishmit thanë: "Atëherë do të lutemi më shumë!" Profeti ﷺ tha: "Allahu është edhe më shumë (i gatshëm për t'ju dhënë).....	561
Shpeshherë i Dërguari i Allahut ﷺ e thoshte (këtë lutje): "O rrotullues i zemrave, mbaje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!.....	563
"O Allah, ma rregullo fetarinë time, e cila është mbrojtja e çështjeve të mia	565
All-llāhumme innī es'elukel 'āfijete fid-dun'jā wel āhīrah	568
All-llahumme inni eseluke minel hajri kul-lihi, axhilihi ue axhilihi, ma alimtu minhu ue ma lem a'lam, ue eudhu bike minesherri kul-lihi, axhilihi ue axhilihi, ma alimtu minhu ue ma lem a'lem. All-llahumme inni eseluke min hajri ma seeleke abduke ue nebij-juke, ue eudhu bike min sherri ma adhe bihi abduke ue nebij-juke. All-llahumme inni eselukel xhennete, ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amelin, ue eudhu bike minen nar, ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amelin, ue eseluke en texhale ala kul-li kadain	

kadajtehu li hajran! - O Allah, e kërkoj prej Teje çdo të mirë, atë të menjëhershmen dhe të vonuarën, atë që e di dhe atë që nuk e di. Dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga çdo e keqe, ajo e menjëhershme dhe e vonuara, atë që e di dhe atë që nuk e di.....571

Besimi vjetrohët brenda ndonjërit prej jush ashtu si vjetrohët rroba, prandaj kërkonë nga Allahu që të ripërtërijë besimin në zemrat tuaja.....574

“Ai që është i kënaqur me Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin ﷺ për të Dërguar e ka shijuar ëmbëlsinë e imanit.”575

Të porosis që kurrë të mos e braktisësh në fund të çdo namazi të thuash: "O Allah! Më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!577

Robi është më së afërti me Zotin e tij kur ndodhet në sexhde, prandaj shpeshtoni lutjet (në të)579

Lutja më e shumtë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) ishte: 'O Allah, jepna në këtë jetë mirësi dhe në jetën tjetër mirësi dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!'580

A t'ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më të pastër te Sunduesi juaj dhe më të lartë për ju në pozitë.....581

Vërtet më ke pyetur për një çështje të madhe, që është e lehtë për atë të cilit Allahu ia lehtëson585

Çdo natë, kur Profeti ﷺ binte në shtrat, i bashkonte shuplakat e duarve dhe frynte në to duke lexuar suret: el Ihlas, el Felek dhe en Nas.....590

Zotëria i istigfarit.....591

O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin dhe me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është ringjallja594

Atë që thotë: 'Bismil-lahi el-ledhi la jedurru measmihi shejun filardi ua la fis-semai ue huves-semiul alim, - Me emrin e Allahut, me të cilin asgjë nuk mund të dëmtojë në tokë dhe në qiell, dhe Ai është Gjithëdhëguesi, i Gjithëdituri", tri herë, nuk do ta godasë ndonjë fatkeqësi e papritur deri në mëngjes597

'Kul huvallahu ehad dhe dy Mbrojtëset (Feleku dhe Nasi) në mëngjes dhe në mbrëmje nga tri herë, të mjaftojnë për çdo gjë599

O Allah, kërkoj mbrojtje me kënaqësinë Tënde nga zemërimi Yt, me faljen Tënde nga dënimi Yt, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga Ti! Unë nuk di të të lavdëroj siç e meriton, Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën)!”601

“Fjalët më të mira tek Allahu janë katër: subhanallah (i Lartësuar është Allahu), elhamdulilah (lavdfalënderimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (s'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut) dhe Allahu Ekber (Allahu është më i madhi). Nuk prish punë se me cilën fillon603

“Atij që thotë dhjetë herë: "La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu, ve huve ala kuli shejin kadir (S'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdi, Ai ka fuqi për çdo gjë).....605

Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, të rënda në Peshore dhe të dashura për të Gjithëmëshirshmin.....606

Atij që thotë: "Subhanallahi ve bihamdihi (I patëmeta është Allahu dhe lavdërimi i takon Atij)", njëqind herë në ditë, i fshihen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit607

Pastërtia është gjysma e imanit, (thënia) "elhamdulilah" e rëndon peshoren, (thëniet:) "subhanallah" (i patëmeta është Allahu) dhe "elhamdulilah" (lavdërimi i takon Allahut) mbushin, - ose e mbush, - hapësirën ndërmjet qiejve dhe Tokës609

Që të them: "Subhanallah (i patëmeta është Allahu), elhamdulilah (lavdërimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) dhe Allahu ekber (Allahu është më i madhi)" është më e dashur tek unë se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind612

Dhikri më i mirë është: "La ilahe il-lallah", ndërsa lutja më e mirë është: "Elhamdulilah613

Atij që shkon në një vend dhe thotë: "Eudhu bi kelimatil-lahi tammati min sherri ma halek (Kërkoj mbrojtje nëpërmjet fjalëve të përsosura të Allahut kundër së keqes që ka krijuar)!", nuk i bën dëm asgjë derisa të largohet nga ai vend614

"Kur ndonjëri prej jush hyn në xhami, le të thotë: "Allahummeftah li ebvabe rahmetik (O Allah, m'i hap mua dyert e Mëshirës Sate)!" E, kur të dalë, le të thotë: "Allahumme inni eseluke min fadlike (O Allah, unë kërkoj nga Ti begatitë e Tua)."616

“Kur njeriu futet në shtëpinë e tij dhe thotë: "Bismilah"
gjatë hyrjes dhe gjatë ngrënies, shejtani thotë: "S'ka konak
për ju sontë, e as darkë617